


IDENTITETI ISLAM I EUROPËS

Ferid Muhiq



© LOGOS·A
SHKUP
PRISHTINË
TIRANË
2 0 1 3



LOGOS·A

Ferid Muhiq
IDENTITETI ISLAM I EUROPËS

Boton: LOGOS-A
Biblioteka: LEXO

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Ali Pajaziti

Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Halil Berisha
Faqosës: Sedat Halimi
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup
Shtypi: Focus Print - Shkup

ISBN 978-9989-58-492-3

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2013

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

IDENTITETI ISLAM I EUROPËS

Ferid Muhiq

PËRKTHEU NGA BOSHNIJAKISHTJA:
Nexhat Ibrahimimi

TITULLI I ORIGJINALIT:
Ferid Muhić,
Islamski identitet Evrope,
Logos-A, 2013



PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE	9
Pasqyrë e tërësive themelore tematike:.....	19
TREGIMI PËR TRE VËLLEZËRIT	25
HYRJE	31
Një përkujtesë: Intonacioni dhe e vërteta	31
I. ARROGANCA KULTURORE E ANTI-ISLAMIZMIT	
BASHKËKOHOR.....	35
I.1. Baza historike dhe sfondi ideologjik i anti-islamizmit bashkëkohor.....	39
I.2. Fushata mediale e anti-islamistëve bashkëkohorë europianë	41
I.3. Europa që turpërohet prej vetes	48
I. 4. Bat Ye’or – E Bija e Nilit noton kundër fakteve	58
I. 5. Dhe si ka qenë gjendja atje ku nuk ka pasur dhimmitude dhe ç’do të ndodhte sikur të ishte?.....	75
I.6. Projekti i demaskuar i anti-islamistëve; Gurabitët për Eurabinë.....	85
II. EUROPIANËT MUSLIMANË: TREGUESIT DEMOGRAFIKË	105
II. 1. E tash, të shohim faktet: Popullata islame e Europës	105
II. 2. Projektionet statistikore të lëvizjeve demografike të muslimanëve europianë.....	109
II. 3. Emigracioni, integrimi, asimilimi, tëhuajësimi i europianëve muslimanë.....	114
II. 4. Kërcënimet dhe sfidat e integritit të muslimanëve emigrantë në vendet e BE	122
III. HISTORIA E MARRËDHËNIEVE POLITIKE DHE KULTURORE TË SHTETEVE EUROPIANE ISLAME DHE KRISTIANE.....	187
III.1. Rasti studimor Al-Andalus	187
III. 2. Kronologjia e Europës Islame: Gadishulli Iberik	

dhe Europa juglindore	190
III. 1. Pasqyrë kronologjike e historisë dhe e marrëdhënieve politike të Al-Andalusit, shtetit të parë evropian musliman, me shtetet krisitane europiane	193
IV. AL-ANDALUSI - MËSIM PËR EUROPËN MODERNE	253
Mësimi i parë: Kordoba, e largët dhe e vetme	253
Mësimi i dytë: Rasti i Valencias së El-Sidit: eksperimenti evropian i bashkësisë judeo-kristiane-islame	257
IV. 1. Pasqyrë e shkurtër e trashëgimisë qytetëruese të Al-Andaluzisë, të pranishme në identitetin e Europës	262
Trashëgimia kulturore	283
Trashëgimia teknologjike	288
Trashëgimia gjenetike e shtetit të parë evropian musliman	290
Bibliografia themelore	291
V. ISLAMI NË BALLKAN	293
V. I. Shqiptarët dhe boshnjakët – popuj autoktonë evropianë islamë	297
E VËRTETA PËR BOSNJËN	312
MITI PËR EUROPËN KRISTIANE DHE ORIENTIN	
ISLAM – BOSNJA SI PARADIGMË HISTORIKE	
DHE KULTURORE E EUROPËS	325
Identiteti evropian i boshnjakëve	325
Hyrje	326
Identiteti judeo-kristian-islam shpirtëror dhe kulturor i Europës	327
Identiteti evropian i Bosnjës dhe i boshnjakëve	330
Përfundim	349
Literatura	350
IDENTITETI NACIONAL SI MOTIV KYÇ PËR PRANIMIN	
APO MOSPRANIMIN E ISLAMIT NË BOSNJË	353
VI. TURQIA EUROPIANE – OSMANLI DEVLETI	369
Turqia evropiane – Osmanlı Devleti	369

MOTIVET THEMELORE PËR PRANIMIN	
DHE MOSPRANIMIN E ISLAMIT NË BALLKAN	
NË KOHËN E OSMANLI DEVLETIT	373
Vërejtje hyrëse.....	373
Rëzimi i makinës diabolike; parimi i fesë së lirë	
si e vërtetë historike.....	376
Koordinatat metodologjike të mitit për	
“islamizimin e dhunshëm”	381
Për respektimin e ligjit: Rasti Muslibegoviq kundër	
kryepleqve ortodoksë më 1687	397
Koment mbi historinë si shkathtësi të falsifikimit	402
Përfundim	409
VII. TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE OSMANE SI BAZË	
E PËRBASHKËT E IDENTITETEVE MUSLIMANE	
NË BALLKAN	411
Ligjet administrative:	418
Faktori i tretë – Islami.....	423
SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE	433
Qytetërimet pa konflikte	433
Arsyet për brengë	439
Më në fund.....	445

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” (Ali Imran: 103)

*Rruga e së vërtetës është e qartë,
dhe rruga e gënjeshtres është e qartë;
Rruga e së mirës është e qartë,
dhe rruga e së keqes është e qartë;
Vetëm në kokën tonë është e turbullt.*

PARATHËNIE

Libri trajton historinë, përmbajtjet dhe efektet e pranisë së Islamit në Europë, hollësisht analizon ndikimin e Islamit në të gjitha aspektet kyçe të dukurive, të cilët nënkuptohen me sintagmën e gjithëpranuar “identiteti europian”, dhe në bazë të ekspertizës së këtillë, formon vlerësimin vetjak të historisë së krijimit të identitetit europian, karakterin e tij objektiv, sikurse edhe perspektivën e ndërveprimit të Islamit dhe dy religjioneve të mëdha monoteiste në truallin e Europës, të cilat, jashtë çdo dyshimi, në masë të madhe do të përcaktojnë edhe të ardhmen e këtij kontinenti.

Udhëzimi themelor metodologjik, që përmbajtja e projektit apo studimit shkencor të paraqesë përpunimin e temës së formuluar në titull, është zbatuar edhe në këtë projekt shkencor-hulumtues. Në këtë kontekst, titulli *Identiteti islam i Europës*, tregon që tema qendrore e tij është, *in sensu stricto*, interpretimi i identitetit islam të Europës. Konkretisht, kjo do të thotë se lënda është komentimi dhe perceptimi i përbërësve sociale, politike, kulturore, dhe gjithsesi, fetare të Europës bashkëkohore, të cilat janë formuar nëpërmjet ndikimeve thelbësore islame dhe të cilat, gjatë 14 shekujve të kaluar, janë bërë elemente integrale dhe konstitutive të identitetit europian.

Afirmimi i argumentuar i këtij pohimi, i bazuar në lëndën faktografike dëshmuese të pakundërshtueshme, do t'i zbuste ndjeshëm tensionet dhe do ta rrëgjonte praktikën e organizuar të stimulimit mediatic të qëndrimit armiqësor ndaj Islamit në mënyrë të gabueshme por kontinuitive dhe sistematike të prezantuar si një lloj *trupi të huaj, egjre* apo madje *kërcënimi* ndaj Europës, të shprehur nëpërmjet formave të shumta të anti-islamit.

mizmit, satanizimit të Islamit, islamofobisë, tashmë një kohë të gjatë të pranishme në tërë botën, por para së gjithash dhe me intensitetin më të madh, pikërisht në truallin e Europës. E themeluar mbi prodhimin sistematik të miteve të veçanta nacionaliste të kombeve mbizotëruese kristiane të Europës, kjo praktikë emëruesin e saj të përbashkët e gjen para së gjithash në fabrikimin e vazhdueshëm të lëndës së falsifikuar historike, e cila e riciklon mitin për gjoja karakterin ekskluzivisht kristian të kulturës europiane, në krijimin e miteve dhe stereotipave të theksuara komplementare negative për natyrën dhe karakterin e Islamit, sidomos në truallin e Europës, sikurse edhe në fshehjen e së vërtetës për kontributin kyç të Islamit në konstituimin e karakterit humanist të identitetit shpirtëror european dhe në themelimin e traditës europiane të tolerancës fetare, etnike dhe kulturore.

Vëmendja e Europës, dhe botës në tërësi, sot padyshim është e përqendruar në raportin e shteteve dominuese kristiane dhe jo-islame ndaj Islamit. Evropa bashkëkohore edhe më tutje, e udhëhequr sipas imperativave ideologjike të supremacionit perandorak dhe ambicieve neokolonialiste si motive të tij qendrore politike, vazhdon të gjenerojë raport qëndrimin negativ ndaj Islamit, duke e konsideruar si sistem vlerash e mënyrë të jetesës radikale anti-europiane dhe anti-kristiane të jetës shoqërore. Ky fakt drejtpërdrejt ndikon në organizimin e ekspozimit të problematikës themelore. Lënda e këtij libri është e dyfishtë: e para, ta hedhë poshtë këtë stereotip dominues negativ për Islamin dhe të tregojë paqëndrueshmërinë e tyre historike dhe faktografike; ta tregojë kontributin thelbësor islam për vlerat e Europës, në ndërlidhje me synimet më të larta aksiologjike të saj, me çka do të dëshmohet edhe karakteri thelbësor islam i identitetit të Europës! Kjo temë sipas rëndësisë së vet është më urgjentja, kurse sipas implikimeve është tema më e rën-

dësishme në shkencat humanistike botërore të kushtuara marrëdhënieve ndërkombëtare, ruajtjes së paqes dhe promovimit të tolerancës dhe bashkëpunimit aktiv në botë! Në shkencat shoqërore dhe studimet politike është shkruar shumë e madje më shumë është folur për Europën. Nganjëherë do të thuhej, rrallë do të theksohej, e më së shpeshti, do të merrej symbyllazi, si vetvetiu e kuptueshme, që Europa dhe *Europa kristiane*, janë sinonime, respektivisht janë dy formulime të të njëjtit realitet identik social, kulturor dhe historik. Nga fundi i shekullit XIX, me synim që kjo e pavërtetë historike të imponohet dhe përforcohet, në pjesën e prodhimit shkencor kushtuar frymës autentike europiane dhe identitetit specifik european, është futur, e deri më sot thuajse në tërësi edhe është pranuar, përcaktimi plotësues: *Europa judeo-kristiane*, me ç'gjë prania e Islamit në ndërtimin e identitetit european edhe më ndjeshëm është mohuar.

Lënda e këtij projekti është që të afirmohet e vërteta e plotë për praninë e fuqishme të kontributeve islame shpirtërore, morale, institucionale, shkencore dhe atyre jetësore dhe ekonomike relevante e madje edhe vendimtare për formimin e identitetit european çfarë është sot; pra që identiteti i Europës (sigurisht për herë të parë në interpretimet e deritashme), të ndriçohet dhe perceptohet në kontekst të ndikimit të vazhdueshëm dhe krijues intensiv të Islamit. Nëse përgjithësisht deri tash edhe është marrë në shqyrtim ndikimi i Islamit, praktikisht dhe pa përjashtim dhe pa ndonjë arsye të vlefshme është anashkalluar apo injoruar në të gjitha studimet për prejardhjen dhe karakterin e identitetit european. Të kuptuarit e vëllimit dhe të karakterit të të gjitha segmenteve të identitetit islam të Europës jep çelësin e vetëm për të kuptuarit autentik dhe integral të identitetit të Kontinentit të Vjetër. Me fjalë të tjera, Europa, e tillë çfarë është, paraqet tërësinë e gjithë ndikimeve historike, të cilat

e kanë trajtësuar realitetin e saj të përgjithshëm, ndërsa kjo do të thotë edhe të të gjitha atyre formave sipas veprimit objektiv, kurse sipas përmbajtjes formave të shumëfishta nëpërmjet të cilave Islami përherë ka implantuar formulën e vet të ADN-së shpirtërore dhe e ka vënë vulën e vet praktikisht në të gjitha aspektet e jetës shpirtërore, sociale, politike dhe kulturore europiane!

Motivi kryesor i këtij studimi është që nëpërmjet paraqitjes integrale dhe historike objektive të pranisë mijëvjeçare të Islamit në truallin e Europës, si dhe të të kuptuarit përkatës të ndikimit të tij në formimin e identitetit europian, të hapë debate, kurse nëpërmjet tyre edhe në proceset të cilat do të mundësojnë ndryshimin radikal pozitiv në perceptimin e Islamit dhe me këtë të kontribuojë për integrimin e frymës europiane. Nëse *filozofia në fakt është forma më e lartë e vetënjohjes (autognozisë) dhe vetëdijes së tërë historisë, e shprehur në koncepte* – le të na lejohet ta parafrazojmë G. W. Hegelin – atëherë çdonjëri, e kështu edhe identiteti europian, është një lloj *i vetënjohjes dhe vetëdijes* integrale, autentike të tërësisë së historisë vetjake.

Pikërisht vetëdija për këtë tërësi deri tash ka munguar në vetëperceptimin e Europës. Identitetin e saj Europa e ka perceptuar në një kontekst të theksuar reduksionist, me theks të veçantë në injorimin e vetëdijshëm, shpërfilljen e qëllimshme dhe falsifikimin e drejtpërdrejtë të pranisë së Islamit në historinë e vet. Nervozizmi dhe zelli i tepruar në theksimin e ndodhive imagjinare dhe kuazi-fakteve, me të cilat tentohet me çdo kusht të paraqitet moslidhja dhe kundërshtueshmëria radikale, nga një anë e Islamit dhe nga ana tjetër, gjoja të Europës monolite kristiane, e karakterizojnë këtë prodhim reduksionist aq sulmues, sa duket sikur Europa kristiane në Islam njeh kushëririn e vet shumë të afërm, por të cilin për disa arsye misterioze dhe të errëta, me asnjë çmim nuk dëshiron ta pranojë si një fakt në gjenealogjinë e vet familjare!

Eliminimi prerazi i Islamit si përbërëse e përhershme e identitetit integral evropian, i motivuar me bashkimin e interesave politikë, ideologjikë dhe ekonomikë, i maskuar me gjoja mospajtueshmërinë e dallimeve doktrinare teologjike të Islamit dhe kristianizmit, me armiqësinë e theksuar ndaj elementeve të identitetit vetjak islam, e ka shtrembëruar në mënyrë dramatike pasqyrën e identitetit autentik në vetëperceptimin e njeriut evropian, duke sjellë një çarje të thellë në vetëdijen e tij. Të frymëzuar me mitin për gjoja identitetin ekskluziv kulturor të Europës, të bazuar në unilateralitetin dhe ortolinearnitetin e karakterit eminent kristian të frymës evropiane, të ngritur në shkallë të paradigmës qendrore interpretuese, *Kristianët evropianë* tentuan t'i zmbrahsnin edhe Islamin, edhe *Muslimanët evropianë*, nga historia e tërësishme evropiane, pra edhe vetjake, evropiane. Oponenca e rreptë ndaj Islamit dhe konfrontimi i kristianizmit evropian me Islamin evropian, sikurse edhe çarja e plotë në vetëdijen integrale të njeriut evropian, kanë qenë pasojat e drejtpërdrejta dhe njëkohësisht më të dëmshmet të këtij falsifikimi skandaloz ideologjik, pasoja të cilat, për fat të keq, sot bëhen pengesë gjithnjë e më e madhe në konstituimin e identitetit unikal, historikisht të bazuar, integral evropian. Për moskuptimin e historisë vetjake të pjesës kristiane të Europës ka kontribuar edhe refuzimi që popujt, të cilët në Europë kanë ardhur me Perandorinë Osmane, të pranohen si evropian, madje edhe disa qindra vjet pas shpërnguljes së tyre dhe pranisë së përhershme të tyre në kontinentin evropian.

Një shpirtngushtësie të këtillë shoviniste mund t'i drejtohen dy vërejtje kyçe, nga të cilat çdonjëra individualisht është e mjaftueshme që këtë refuzim të trashëgimisë shumëkulturore dhe shumëfetare mbi të cilën është ndërtuar identiteti aktual i Europës, sikurse edhe çdo dallim tjetër, i bazuar mbi të midis qytetarëve evropianë në të ashtuquajtur “Evropianë autoktonë

dhe joautoktonë”, ta përgënjeshtrojë në themel, kurse diskutimin e mëtejshëm rreth kësaj teme e bënë përfundimisht të kotë:

1. Popullata që në diskutimet bashkëkohore trajtohet si demografikisht dhe etnikisht “autoktone europiane”, sipas prejardhjes së saj, në shkencë është trasuar si “indo-europiane” – që drejt-përdrejt do të thotë popullatë, e cila vetëm pas ardhjes nga zonat e Indisë dhe Azisë Qendrore (*Arianët*, emigrantët nga pllajat iraniane) u bë europiane! Pra, të ashtuquajturit “europianë autentikë”, sipas pretendimeve përgjithësisht të pranuar të vetë shkencës europiane, në fakt janë emigrantë nga Azia! Me këtë qëndrim është krejtësisht e logjikshme, që tërë teoria për banorët e Europës si “europianët autentikë, primordiale”, në tërësi të refuzohet, sepse ata, në pajtim me tërë teorinë për prejardhjen indoeuropiane, duhen shikuar si në “Aziatikë primordiale!” Krahas kësaj, duhet pasur parasysh se edhe popujt të cilët në Europë e kanë sjellë Islamin: nga arabët të cilët Islamin e sollën në gadishullin e Prinejeve dhe e përhapën në tërë Mesdheun, duke përfshirë edhe Detin Adriatik, nga tatarët dhe mongolët, të cilët Islamin e forcuan në rajonet lindore të Europës, përgjatë lumit Vollga dhe rreth pellgut të Detit të Zi, e deri te të gjithë popujt të cilët e populluan Europën me ardhjen e Shtetit Osman dhe me këtë në mënyrë të përhershme e futën Islamin si përbërëse të pashlyeshme të identitetit të Europës – rrjedhimisht, të gjithë ata, pa marrë parasysh kohën e ardhjes së tyre në Europë, të gjithë pa përjashtim janë me prejardhje nga ato zona, respektivisht, nga po ajo pjesë të botës, nga e cila, sipas shkencës bashkëkohore europiane, arritën edhe të ashtuquajturit “europianët autentikë”, nga Azia qendrore, dhe as mbi këtë bazë nuk ka kurrfarë shkak të arsyeshëm sipas të cilit ata të cilët erdhën më herët, mund të konsiderohen se së paku pak më tepër janë “europianë”, sesa këta të tjerët: europianët nga anija “Mayflower”, të cilët erdhën në kontinentin të quajtur Amerikë, nuk janë as-

pak më shumë “amerikanë autoktonë”, nga europianët të cilët kanë ardhur në kontinentin e njëjtë 20 vjet më vonë.

Kësaj duhet shtuar edhe fakti se të dy popujt evropianë, të cilët shtetet e tyre i kanë në Europë, kurse qytetarët e të cilave janë muslimanë me shumicë, pra shqiptarët dhe boshnjakët (turqit jetojnë në shtetin i cili jeton edhe në Azi, edhe në Europë), në fakt në kuptimin e fjalëpërfjalshëm janë “europianë autoktonë”, proto-europianë të mirëfilltë, të cilët në këtë pjesë të Europës jetojnë nga fillimi i tyre e deri sot! Në vërejtjen se megjithatë ekziston dallim i madh në kohën e ardhjes së këtyre dhe atyre dhe se, në pajtim me këtë, si faktor vendimtar megjithatë duhet të merret parasysh *kriteri kronologjik*, i cili në mënyrë të qartë flet në të mirë të atyre të cilët, nëse tashmë edhe nuk janë europianë autoktonë, kanë ardhur para të tjerëve, dhe se pikërisht kjo edhe u jep të drejtë që atributin “europian” përjashtimisht ta përvetësojnë për vete, duhet vënë në dukje se:

2. Në truallin e SHBA aktuale, emigrantët e parë kanë arrihur nga fundi i shekullit XVI, kurse shumica dërrmuese e banorëve të tanishëm të këtij shteti kanë ardhur aty nga fillimi i shekullit XX, që do të thotë, diç më pak se njëqind vjet më parë! Megjithatë, të gjithë ata konsiderohen amerikanë autentikë (*True Americans*), ata sot askush nuk i trajton si të huaj, aq më pak si amerikanë joautentikë! Nëse e njëjta logjikë kronologjike zbatohet edhe për problemin e autenticitetit të europianëve (që jemi të detyrueshëm ta bëjmë edhe sipas ligjeve të analizës logjike, edhe sipas ligjeve të matematikës e statistikës demografike, përkatësisht ekspertizës politike, sepse vetëm nëpërmjet emëruesit të përbashkët mund në mënyrë racionale të qenësishme të zgjidhet ky ekuacion!), do të përballemi me dy alternativa:

a. Që (në pajtim me logjikën sipas të cilës të gjithë emigrantët në SHBA, pa marrë parasysh kohën e emigrimit, janë

“amerikanë” autentikë, respektivisht, janë qytetarë plotësisht të barabartë të SHBA), të gjithë banorët e Europës të cilët në mënyrë legale janë paraqitur dhe e kanë lejen për qëndrim të përhershëm, pa kushte të pranohen si evropianë autentikë pa marrë parasysh kur janë shpërngulur, përkatësisht, kur e kanë marrë atë leje, duke i përfshirë, kuptohet, edhe të gjithë ata feja e të cilëve është Islami, kurse evropianiteti autentik i të cilëve pa të drejtë vihet në dyshim; apo

b. Që (në pajtim me teorinë diskriminuese për *karakterin ekskluziv kristian të identitetit evropian dhe për kristianët sikurse për evropianët e vetëm autentikë*), të gjithë banorët e SHBA, si edhe të tri Amerikave, përveç pasardhësve gjakëpastër të banorëve parakë të saj (pra, banorëve e cila me terma teknikë përkufizohen si *indigenoues*, përkatësisht, *native population*), t'i konsiderojmë si emigrantë, prania e të cilëve duhet të kontrollohet, të pakësohet, integrohet, dhe në fund të fundit, të asimilohet në ekzemplarë tradicionalë kulturorë dhe në standardet e vlerave të këtyre amerikanëve të mirëfilltë autoktonë! Këto përfundime janë mbështetur fuqishëm në mënyrë plotësuese, kurse karakteri i tyre imperativ është theksuar, me faktin se edhe vetë Kolumbi ka shkelur në tokën e ujdhesave karaibiane vetëm në vitin 1492, pra 781 vjet *pas themelimit të shtetit të parë islam në truallin e Europës* (711), kurse emigrantët e parë filluan të formonin vendbanimet e tyre të përhershme në truallin e Botës së Re në kohën kur Shteti Osman tashmë katër shekuj kishte pasur kryeqytetin e vet në truallin e Europës (Edirne, Edreneja), respektivisht, dy qind vjet pasi *capital city* i këtij shteti islam evropian, nga qyteti Edirne, u transferua në Stamboll, (Konstantinopoja e dikurshme). Po të sjellim ndër mend se Shteti Osman tashmë ishte në fundin e vet, pas më shumë se gjashtë shekujsh ekzistence, në kohën kur Xheronimi me apa-

çët e tij Çirikua ende luftonte në Arizonë¹, kurse hapësinat e mëdha të SHBA të sotme ishin ende plotësisht të pabanuara, për të gjithë mbrojtësit e tezës për kristianët e Europës si “europianë autoktonë” dhe për muslimanët e Europës si “ardhacakët jo-europianë”, do të bëhet menjëherë e qartë se për ta është shumë më e mençur aty për aty të lëshohet dhe refuzohet koncepti *i kriterit kronologjik*, që të mos gjenden në vështirësi nga të cilat assesi nuk do të mund të dilnin! Sepse përndryshe, sipas logjikës së tyre, ai i cili ka ardhur i fundit, e kishte për detyrim dhe të drejtë që ta mbyllte në rezervate vendësin!

Nuk mundet të pohohet njëkohësisht edhe që europianët, aziatikët e afrikanët të cilët jetojnë në truallin e tri Amerikave, sidomos në SHBA, janë amerikanë autentikë, pa marrë parasysh se të gjithë me radhë janë ardhacakë, *dhe t’ju mohohet statusi i tillë pjesëtarëve të Islamit, të cilët në truallin e Europës jetojnë aktivisht dhe veprojnë në të gjitha ndodhitë sociale, kulturore dhe ekonomike si model shtetëror dhe si klishe kulturore e si praktikë religjioze, plot tetëqind vjet para se Europa mësoi për Botën e Re, për Amerikën – se fare ekziston!* Nuk mundet Europa kristiane as veten ta promovojë si bartës unikal të identitetit europian, as të mohojë identitetin islam të Europës në bazë të kriterit kronologjik, vetëm për shkak që disa indo-europianë kanë arritur para disa indo-europianëve të tjerë (ndërkaq edhe këta, edhe ata megjithatë janë indo-europianë, e madje edhe kanë ardhur nga vise të njëjta!), e as, duke iu drejtuar dallimit për kohën në të cilën *arritën* kristianizmi dhe Islami në Europë, (fjala kyçe është, s’ka dyshim, *arritën*, që drejtpërdrejt do të thotë se edhe kristianizmi edhe Islami sipas prejardhjes së tyre

¹ Lideri i apaçëve Çirikua (Chirikuaua apaches) Goya, më i njohur me emrin Xheronimo, u dorëzua në tetor të vitit 1886, me 31 luftëtarë dhe 103 femra, fëmijë dhe pleqë.

janë fe jo-europiane, të cilat në Europë *arritën, erdhën* nga pjesa e njëjtë e botës, pikërisht ashtu si edhe vetë “europeanët”, pa marrë parasysh a kanë ardhur si kristianë apo si muslimanë), e ndërkaq në asnjë mënyrë mos ta vënë në pyetje statusin e vet në truallin e tri Amerikave, duke e pasur parasysh faktin se kristianizmi arriti në Amerikë më shumë se një mijë vjet pas datës kur Islami, të cilit i kontestohet po ky status në truallin e Europës, ka formuar shtetin e tij të parë islam në truallin e Europës!

Synimi kryesor i këtij libri është inicimi i proceseve të cilët do të çojnë në krijimin e vetëdijes integrale të njeriut evropian, të vetëkuptuarit e tij autentik, heqja e klisheve dhe stereotipave të motivuar me armiqësinë fetare, sikurse edhe mosdurimit (fanatizmit) racor e nacional, dhe me këtë të mundësojë afirmimin e identitetit unikal, *inclusive*, islam evropian, si bazë autentike e tij e absolutuar!

Qasja themelore është përvijuar me analizën e historisë së Islamit dhe pranisë së tij në truallin e Europës. Fakti kyç se Europa nuk ka Të Dërguar të tij të Zotit, e kështu as besimin e tij autokton, do të thotë drejtpërdrejt se edhe Judaizmi edhe Kristianizmi, edhe Islami, *de facto* dhe thellësisht janë fe jo-europiane, të cilat nuk e kanë në Europë shtëpinë e tyre të lindjes, por në Europë e kanë gjetur shtëpinë e tyre, pa dyshim e heq nga rendi i ditës çështjen e statusit indigjen, e me këtë edhe monopolistik dhe me disa të drejta më të mëdha apo më të vogla, e sidomos ekskluzive të cilësdo nga këto tri fe të mëdha botërore në Europë si kontinent të vetin të lindjes! Kjo më tej do të thotë se Europa, e cila dëshiron ta kuptojë veten brenda realitetit vetjak shpirtëror historik, nuk mund ta diskreditojë justifikueshëm asnjërin besim në truallin e vet – pra, gjithsesi as Islamit – si “më pak” apo “më shumë” evropian, as ta skuafikojë si “joeuropian”.

Duke e marrë parasysh se ky studim përqendrohet te hulumtimi dhe interpretimi i identitetit islam të Europës moderne, theksi i tërë projektit është vënë në paraqitjen e ardhjes, përhapjes dhe ekzistimit të Islamit, së pari duke i përmbledhur këto procese në tërë truallin e Europës, e pastaj edhe veçanërisht, nëpërmjet pasqyrës së kronologjisë së ardhjes së Islamit, në analizën e hollësishme të përmbajtjes dhe efekteve të pranisë së tyre në disa rajone të kontinentit europian.

Aspekt të veçantë paraqet zbulimi sistematik i metodologjisë cilësore hulumtuese, si edhe i metodës së analizës së thellë të përmbajtjeve kyçe të traditës europiane, politikës, kulturës, ekonomisë, praktikës politike dhe një vargu elementesh të tjerë konstitutiv të identitetit islam të Europës moderne, të formuara nën ndikimin e fuqishëm të traditës islame dhe në frymën e Islamit, të cilët nga Europa sot përbëjnë tërësinë unike qytetëruese të përshkuar me frymën e të tri besimeve të mëdha monoteiste të botës, dhe të fisnikëruar me frymën e Islamit, i cili për besimtarët paraqet Fjalën e tretë dhe të fundit të Zotit.

Pasqyrë e tërësive themelore tematike:

1. Konstatimi i neverisë ndaj Islamit, receptimit negativ dhe armiqtësisë ndaj muslimanëve, shkurt, islamofobisë dhe anti-islamizmit në të gjitha format dhe shkallët të theksueshmërisë, përbën bazën përshkruese të qëndrimit mbizotërues të europianëve jo-muslimanë ndaj europianëve muslimanë. Intensiteti i ndjenjave neveritëse ndaj çdo gjëje që është islame, të dukshme si paradigmë sunduese e receptimit të Islamit dhe muslimanëve në sytë e opinionit europian, që nga fanatizmi famëkeq i qytetarëve me arsimim nënmesatar, e deri te qendrat politike-partiake dhe institucionet shkencore të rangut më të lartë, instituteve hulumtu-

ese dhe universiteteve, të cilat fabrikojnë analiza të bashkërenditura dhe studime kuazi-teorike me thumbime të theksuara anti-islame, të cilat krahas përkrahjes së fuqishme të mediave për këtë qëllim të paguara, përhapin rrëfenjën për rritjen alarmante të fundamentalizmit islam nëpër Europë, tregon lajthitjen e pranishme në të njëjtën masë, pa marrë parasysh shkallën e arsimimit, përkatësinë etnike apo bindjet politike të jo-muslimanëve:

a. Se prania e Islamit në truallin e Europës është shprehimisht destruktive dhe negative për vlerat fundamentale europiane;

b. Se vlerat fundamentale europiane dhe standardet morale janë të ndryshme thelbësisht dhe pa dyshim më superiore në krahasim me ato islame;

c. Se me synim që të ruhen vlerat fundamentale europiane është e domosdoshme së pari, të ndalet përhapja e mëtejme e Islamit dhe emigrimi i muslimanëve në Europë, pastaj deportimi në vendet amë islame i sa më shumë muslimanëve që është e mundur dhe përfundimisht;

ç. Se imperativi strategjik është intensifikimi maksimal i proceseve integruese të muslimanëve europianë, me synimin përfundimtar të asimilimit të tyre të plotë. Të 26.5 milionë emigrantët muslimanë (nga të cilët besohet se rreth 6 milionë janë pa dokumente të vlefshme), që vlerësohet se sot punojnë në Europë, shihen si një pengesë, kurse përkushtimi i tyre ndaj vlerave vetjake kulturore dhe shpirtërore, interpretohet si refuzim që të integrohen dhe asimilohen. Ndërkaq askush nuk flet për faktin se Europa kristiane nga secili musliman i punësuar fiton së paku 10 euro për një ditë, që paraqet më së paku 600-700 miliardë euro në vit! Përkundrazi, tërë vëmendja është përqendruar në paraqitjen e skenave katastrofike horror, të bazuara në programet e mëdha konspirative të shndërrimit të Europës në koloni islame si Eurabi.

2. Kalimi në *Analizë* hapet me pasqyrën statistikore të pranisë së muslimanëve në Europën e sotme – sipas sistemimit territorial dhe numrit. Duke i dhënë përgjigje pyetjes se si është e mundur që muslimanët me atë numër dhe të pranishëm në atë territor të madh në Europë, sidomos duke i pasur parasysh dëbimet periodike sistematike dhe masat e vazhdueshme të ndalesës dhe kufizimit të imigrimit të tyre në disa vende europiane, do të hapet rruga për analizën teorike dhe historike, e cila do t'i eliminojë lajthitjet dhe paragjykimet dominuese për të ashtuquajturën *Europën kulturore monolite*. *Kundërthënia e domosdoshme e çdo përkufizimi, i cili Europën e trajton si kulturalisht monolite, historikisht homogjene, si identitet shpirtëror të njëzoshëm, me të vërtetën empirike se Europa është e modelit classic case, i cili përcaktohet si amalgamë kulturore, e krijuar nga integrimi i thellë, molekular i të dy apo më shumë traditave autonome, dëshmon pa mëdysheje për karakterin ideologjik të qëndrimeve dhe qasjeve amti-islame të prodhuara sistematikisht, të cilat përbëjnë një burim të mirëfilltë të krijimit të pasqyrës mitologjike të Europës si kontinenti autokton dhe ekskluzivisht kristian*. Duke sjellë ndërmend se: Europa nuk ka besim të vetin autokton dhe se, në të njëjtin kontekst, ka probleme serioze me të vetëkuptuarit e identitetit vetjak, duhet treguar se edhe kristianizmi, edhe Islami janë me status plotësisht të njëjtë sipas Europës si zonë joamë, që do të thotë se Europa ka po të njëjtat raporte ndaj kristianizmit dhe Islamit ashtu si edhe ndaj faktorëve të jashtëm, dhe se së këndejmi ndërmjet kristianizmit dhe Islamit, në truallin e Europës në tërësi, as thelbësisht, as me arsye logjike, nuk mund të vendoset raporti i shtëpiakut me të huajin, aq më pak raporti i poseduesit legjitim dhe imponuesit! Duhet të tregohet se nga viti 711 deri më sot, Islami në Europë është i pranishëm *in continuo* dhe çka është edhe më e

rëndësishme, se nga vetë fillimi, pra nga shekulli VIII², Islami ka hyrë në skenën europiane në nivel të shtetit jashtëzakonisht të organizuar me sistemin e institucioneve të zhvilluara dhe autonome juridike, ekonomike, politike dhe kulturore! Njëkohësisht duhet theksuar edhe fakti se që nga atëherë e deri sot përbërësja kulturore dhe shpirtërore islame është vazhdimisht e pranishme dhe nëpërmjet shteteve konkrete, të cilat për shumë shekuj bënë pjesë ndër shtetet më të zhvilluara dhe më të fuqishme në truallin e Europës! Shembujt e Andaluzisë në rajonin e Gadishullit të Pirinejeve, Mbretërisë Bullgare në territorin e Tataristanit të sotëm nga shekulli VIII i erës sonë (The Bulghar Kingdom), të Hanatit të Krimesë, Kazanit dhe Astrahanit, rreth Detit të Zi dhe në pellgun e lumit Vollga, sikurse edhe Shtetit Osman, e pohojnë mjaft qartë këtë fakt.

3. Në sintezë themelësisht, në mënyrë empirike maksimalisht të argumentuar, *in extenso*, demonstrohet ndikimi vendimtar i sistemit shoqëror dhe shtetëror islam në konstituimin e një vargu nocionesh qendrore, jashtëzakonisht në mënyrë pozitive të ranguara të filozofisë aksiologjike, morale dhe politike, e sidomos intensivisht në postulatet kyçe të teorisë juridike dhe praktikës së mendimit të ashtuquajtur *europërendimor*, sikurse janë toleranca fetare dhe kulturore, e drejta në gjuhën vetjake, të drejtat universale dhe kolektive njerëzore, sistemi juridik i njëjtë për të gjitha subjektet, sikurse edhe një numër i masave politike kundërthënëse të zbatuara sot, të cilat janë objekt i debatit teorik. Për proceset e respektit dhe tolerancës së ndërsjellë të kulturave botërore dhe feve botërore fatale është ideologjia e neobihejvioriz-

² Flasi për praninë e shtetit islam në truallin e Evropës. Përndryshe, ardhja e parë e organizuar e muslimanëve në truallin e Evropës, sigurisht daton gjysmë shekulli më herët, konkretisht në vitin 641, kur Abdurahman ibn Rebi'a el-Bahili mori pjesët e Kaukazit të Jugut, ku, sipas disa burimeve, tashmë kishte takuar bashkësitë e para muslimane.

mit, e promovuar si synimi kyç strategjik i fuqive më të fuqishme botërore të riafirmuara në variantin e psikologjisë eksperimentale të B. F. Skinnerit. Përbri propagandës së fuqishme të projekteve multimediale, në mënyrë programuese të koordinuara, synimeve të dominimit monokulturor shumë iu kontribuon edhe edukimi i njëtrajtshëm ideologjik të përfaqësuesve të talentuar të brezave të rinj, pa marrë parasysh përkatësinë fetare, nacionale, kulturore, racore e ndonjë tjetër, krahas injorimit të vlerave themelore të bashkësive të tyre, funksionon me politikën e dhënies së bursave për të rinjtë e talentuar si ideologjizimi i tyre total në frymën e supremacionit europaerëndimor, në suaza të miratimit jokritik të të gjitha aspekteve të proceseve globalizuese, të cilët gjithnjë e më shumë bëhen formë e imperializmit global.

4. *Përfundimi* ka dy detyra themelore: nga një anë, me argumente të dëshmoheq paqëndrueshmëria e tezës për *karakterin ekskluziv kristian, kulturalisht singular dhe monolit të kulturës europiane*; nga ana tjetër, barabar me argumente të pohohet *karakteri plural dhe sintetik i identitetit të saj*, që në mënyrë apodiktike të theksohet dukshmëria e pranisë së fuqishme dhe ndikimit vendimtar të Islamit në formimin e identitetit politik, ekonomik, kulturor dhe shpirtëror të Europës. Së këndejmi çdo analizë, e cila Europën e trajton kulturalisht si monolite, historikisht tërësi (entitet) homogjene të identitetit unik shpirtëror, është e gabuar nga baza metodologjike dhe në kundërshtim me faktet, të cilat përfundimisht e pohojnë se Europa është parësisht si një aliazh kulturor, i derdhur nga elementet burimore të importuara, mbizotërueshëm kristiane dhe islame, krahas pranisë së ndjeshme të traditës hebraike, sikurse edhe një numri të madh përzierjesh arkaike autoktone europiane, të ruajtura në të gjitha pjesët e kontinentit! Në këtë kontekst, çdo ligjërim për temën e identitetit të saj, duhet të zërë fill nga fakti se Europa është në fakt

sintezë e shumësisë së identiteteve kulturore, që do të thotë se, me vetë këtë, edhe të kuptuarit autentik të Europës është i mundur vetëm nëpërmjet prizmit të ndërveprimit të tyre dhe ndikimeve të ndërsjella të cilat, përmes pranisë së vazhdueshme dhe me ndërhyrjen e klisheve të tjera kulturore, kanë krijuar një rrjet kulturor kompleks unik, të dalluar sipas elementeve të theksuara të identitetit judeo-kristian, ashtu edhe islam të Europës!

5. Gjendja globale gjithnjë e më shumë po përcaktohet si trajektore e skicuar nga raportet e pjesës së botës islame dhe jo-islame. Në këtë lajthitje thelbësore, e cila është e njohur si konstrukt ideologjik, është formuluar edhe teoria për të ashtuquajturën *Përplasja e qytetërimeve* ("The Clash of Civilizations"), e prodhuar për nevoja të qarqeve militarizuese të përfaqësuesve të opsionit totalitar ekstrem të djathtë të disa nga vendet më të fuqishme të botës. Njerëzve u duhet treguar qartë se çfarë është e gabuar në këtë teori. Bota nuk është e përbërë nga pjesë! Bota është një dhe e integruar. Por nëse nuk është e përbërë prej pjesëve, bota mund të ndahet jo në pjesë por në grimca, fragmente, copëza. Ideja për botën e cila është e përbërë prej dy qytetërimeve, domethënë prej atij kristian dhe islam, të cilët sipas një domosdoshmërie fati duhet të hyjnë në konflikt, ashtu që vetëm njëri të mbetet në fushëbetejë dhe të dominojë botën, kurse tjetri të fshihet nga faqja e dheut, kjo ide nuk sheh se bota nuk është e bashkuar dhe vetëm për këtë mendon se do të mundet sërish të bashkohet kur të thyhet njëherë uniteti i saj. Përgënjeshtrimi i këtij skenari mjaft të rrezikshëm dhe për një kohë të gjatë të promovuar si global strategjik, pason dy vija themelore të argumenteve; e para, demaskimin e tërë rrëfimit për *përplasjen e qytetërimeve dhe këtë drejtpërdrejt në rrafshin empirik dhe pragmatik*; e dyta, shtrembërimin ideologjik të motiveve të totalitarizmit dhe neokolonializmit si lëvizëse themelore të skenarëve për përplasjen e qytetërimeve.

TREGIMI PËR TRE VËLLEZËRIT

Europa është kontinent me fat të veçantë. Me sa njohim, vetëm Europa ka mitin e saj për formimin (lindjen) vetjak. Janë ruajtur madje dy tradita mitologjike se si e ka marrë emrin e saj kontinenti Europa. Sipas një tradite, Europa është e bija e Okeanit dhe Tetijes, e motra e Thrakies, Azisë dhe Libisë, e cila i lindi Zeusit të birin, Dodonin, heroin eponim të Dodonës. Sipas traditës tjetër, e cila është shumë më e njohur dhe të cilën ndjek edhe Homeri në Iliadë, Europa ishte e bija e mbretit fenikas Atenorit dhe bashkëshortes së tij mbretëreshë. Një variant si prindër të Europës përmend mbretin fenikas Atenorin dhe mbretëreshën Telefas, ndërsa tjetri flet për mbretin fenikas Fenikun dhe mbretëreshën Perimedën. Në të dyja rastet, prejardhja e Europës, pa dyshim, vendoset në të njëjtin rajon, në Fenikinë e dikurshme, pra jashtë vetë Europës, konkretisht në Lindjen e Afërme, me qendrën në territorin e Jerusalemit.

Sipas këtij tregimi Zeusi, babai i zotave, u dashurua në vashën tejet të bukur semite, princeshën fenikase. Që mos ta frikësonte shumë herët, u shndërrua në dem të madh të bardhë, me natyrë të qetë, me aromë mallëngjyese të trëndafilut dhe shafranit. Një ditë, kur në livadhin e qetë idilik Europa vilte lule në shportën prej thuprash, para saj u shfaq një dem i bardhë. E dehur nga aroma e fuqishme, nga forca dhe karakteri i urtë i demit të madh të bardhë, Europa iu afrua dhe filloi ta përkëdhelte. Në fund madje mori guxim që të ngjitet në shpinë të demit të butë të bardhë. Atëherë demi nxitoi me galop në det dhe notoi me Europën në shpinë, deri te ujdhesa Kreta, i përcjellë me këngë dasmore të Nereidave dhe me mbrojtjen e drejt-

përdrejtë të Poseidonit, Amfitrites dhe Afërditës. Këtu Europa me Zeusin lindi tre djem hyjnorë. Në shenjë të dashurisë së madhe ndaj Europës, “babai i zotave” urdhëroi që kontinenti në veri të Kretës të quhej sipas emrit të saj, dhe atë deri në fund të fundit, më larg se sa që mund të arrijë edhe shikimi më i mprehtë njerëzor.

A munden këta tre djem, në një vizion të qartë profetik, të jenë paralajmërim i tri feve të mëdha, të cilat, nga po kjo pjesë e botës, dhe pikërisht nëpërmjet ujdhesës së Kretës si etapë e parë (të kujtojmë faktin se Islami në Kretë ka vendosur praninë e tij të organizuar fuqishëm: politike, ekonomike dhe shtetërore qysh para dymbëdhjetë shekujsh nëpërmjet emiratit të formuar në këtë ujdhesë në vitin 824), dhe se pastaj vetes do t'i gjenim qëndrim të përhershëm dhe të formonim shtete të fuqishme dhe të zhvilluara në këtë kontinent, para së gjithash në dy prej tri siujdhesave të mëdha: Pirineje, Ballkanike, (pa Apeninen), dhe me këtë ka përcaktuar në mënyrë të përhershme fatin edhe të tyre, edhe të tërë kontinentit!? A mundet tregimi për nënën semite të tre vëllezërve, të cilët do ta marshojnë nëpër kontinentin e Europës dhe do ta popullojnë përgjithnjë, duke u quajtur sipas nënës së tyre (!), të bëhet parandjenjë e frymëzuar mitologjike dhe profeci, e cila paralajmëron Kristianizmin, Islamin, Judaizmin, ata tre djem hyjnorë, tre vëllezër. Tri porosi Hyjnore, të dërguara nga vendi i Shenjtë, do ta përhapin fjalën e Zotit në kontinentin e Europës, dhe prej aty, do ta përcjellin në tërë botën!? Nuk përjashtohet, sepse struktura e tregimit mitologjik për emërtimin e kontinentit tonë me emrin Europë edhe në kontekstin filozofik, edhe në atë didaktik është thellësisht fetare. Të kujtojmë, se fjala është për të bijën e mbretit semit të marrë nga vetë Zeusi në Kretë, ku lindi me të tre djem, të cilët në shenjë të dashurisë së madhe i japin tërë konti-

nentit emrin e saj. Drama e Europës mitologjike është e rreptë dhe konvulsive, është brutale dhe e dhunshme, është e mbështetur në poshtërsi dhe mashtrim. Por, njëkohësisht kjo është dramë e cila të gjitha elementet negative të përmbajtura në premissa, i sublimon dhe i zgjidh maksimalisht në mënyrë pozitive në përfundimin e tij moral! Zeusi vërtet ka shfrytëzuar mashtrimin, por vetëm sepse para kësaj e ka dashuruar sinqerisht Europën. Rrëmbimi i Europës është kryer edhe me pajtimin e saj (qoftë edhe jo tërësisht e vetëdijshme), sepse edhe ajo menjëherë u pajtua me demin e fuqishëm me lëkurë të përsosur të bardhë, me karakter të urtë, i cili kishte aromë më të këndshme se trëndafili dhe shafrani, kurse asaj i nxiti ndjenjën e drejtpërdrejtë të besimit, e cila ishte aq e madhe saqë madje vetë i hipi në shpinë. Dashuria është alibia absolute i këtij mashtrimi, e cila e tëra, nga fillimi deri në fund ka qenë në shërbim të dashurisë, që është pohuar edhe nëpërmjet lindjes së tre djemve, nëpërmjet fatit të lumtur të mëvonshëm të Europës, sikur edhe faktit se në shenjë dashurie ky kontinent i tëri e mori emrin e vashës, të cilën babai Zeusi aq shumë e kishte dashuruar. Nëse i shtojmë edhe të dhënë se po në këtë kontinent qëmoti gjendej Olimpi, pra vetë qendra e zotave mitologjikë në krye me Zeusin, e që megjithatë kurrë para këtij rasti ky kontinent nuk kishte pasur emrin e tij, por e fitoi sipas kësaj vashë semite nga Lindja e Afërt, do të bëhet e qartë se ky tregim mitologjik në fakt është alegori e energjisë mrekulluese paralajmëruese, e cila tërheq vëmendjen në elementet e dhunës dhe mashtrimit, por vetëm që të theksohet më fuqishëm elementi i erosit të shpërthyer në dashuri, dhe të theksohet barabarësia thelbësore e të tri feve të lindura në Lindjen e Afërt, kurse të ardhura në Europë nëpërmjet metaforës së tre vëllezërve të lindur, të ngjizur hyjnisht në mitrën e pëlleshme të Lindjes së Afërt!

Dhe deri sa këta tre vëllezër jetonin së bashku, qenë të pajtimit. Një ditë u nisën në rrugë për në Europë, kontinenti i panjohur i quajtur sipas emrit të nënës së tyre, vëllai më i vjetër dhe i mesmi. Vëllai i mesëm në fillim ishte i afërt me më të madhin. Kur arritën së bashku në Europë, vëllai më i madh e ndihmoi të bënte për vete zemrat e shumë popujve, të sundonte mbi shumë shtete dhe të shtinte në dorë pjesë të mëdha të kontinentit, por më vonë tërë pushtetin e grabiti vetëm për vete. Kur duke ndjekur rrugën e vëllezërve të vet, edhe vëllai më i vogël arriti në Europë, edhe ai bëri për vete shumë zemra dhe formoi shtetin e tij, në të cilin jetonin në harmoni dhe me të drejta të barabarta i gëzonin edhe pasardhësit e vëllait të madh dhe të mesëm. I vendosur ta pushtonte për vete tërë kontinentin, vëllai i mesëm i shpalli luftë vëllait më të vogël, e shkatërroi shtetin e tij të cilin e kishte themeluar në Siujdhesën e Pirinejeve, grabiti territorin e tij dhe i përndoqi të gjithë pasardhësit e vëllait më të madh dhe më të voglit. Por, pasardhësit e vëllait më të vogël, tashmë e kishin edhe shtetin e tyre të dytë në Europë, në Siujdhesën Ballkanike, një perandori të fuqishme me fuqi të plotë, në të cilën drejtësia ishte ligji më i lartë, ndërsa i patën hapur më dy kanatash portat dhe në shtetin e tyre, në të cilin pasardhësit e vëllait të mesëm kishin jetuar në paqe dhe të kursyer nga luftërat, i pranonin pasardhësit e përndjekur edhe të vëllait më të madh, edhe më të voglit, duke dëshmuar se të tre vëllezërit, në Europë, e cila iu përket barabar të gjithëve, mund të jetonin në harmoni dhe së bashku.

Por kjo mëshirë e vëllait më të vogël e hidhëroi mjaft vëllain e mesëm. Që atëherë, vëllai i mesëm u kthye kundër vëllait më të vogël dhe i shpalli luftë deri në vdekje. Fati i luftës kishte lëvizur nga njëra anë në anën tjetër, e më në fund do të vendosej paqja. Vëllai i mesëm nuk arriti ta dëbonte tërësisht vëllanë

më të vogël nga Europa, dhe, pas një beteje të madhe në të cilën ai humbi deri në fund, hoqi dorë nga përndjekja e mëtejshme dhe i la pak vend në juglindje të kontinentit. Vëllanë e madh, i cili nuk kishte shtetin e tij, vëllai i mesëm e vrau egërsisht në territorin e vet të Europës dhe kreu një holokaust të vërtetë, sepse me milionë pasardhësish të vëllait më të madh i vrau pa mëshirë në llogore, të cilat edhe i pati ndërtuar për këtë qëllim. Edhe pasardhësit e vëllait më të vogël, të cilët patën mbetur në vatrën e veta, kur shtetin e tyre e pushtuan pasardhësit e vëllait të mesëm, e pësuan prej zemërimit të tyre të papërligjur dhe hakmarrjes së pakuptimshme, dhe vijuan të ishin të dëbuar dhe u vranë deri në ditët e sotme, kur u janë mohuar të drejtat e tyre.

I lexuar si alegori, ky tregim qartë tregon se kush janë këta tre vëllezër: vëllai më i madh është Judaizmi, vëllai i mesëm është Kristianizmi dhe vëllai më i vogël është Islami. Ky libër flet për atë se si ndodhi që vëllai i mesëm ta konsiderojë vetëm vetveten për europian autokton, kurse tërë kontinentin ta shpallte për pronë të tij legjitime dhe që gjatë kësaj vëllezërit e tij, më të madhin dhe më të voglin, t'i shikonte si trup të huaj, edhe pse të tre, sipas asaj legjende, janë të lindur në Lindjen e Afërt nga nëna e njëjtë dhe i njëjti baba hyjnor.

HYRJE

Një përkujtesë: Intonacioni dhe e vërteta

*Për atë se ç'ka ndodhur dhe si duhet të flitet: me arsye, me urtësi dhe kthjelltësi. Sepse çfarëdo qofshin rrethanat të cilat kanë sjellë deri te kjo mosmarrëveshje e madhe, ato nuk do të mënjanohen me kërcënime, akuza, e as duke ia hedhur fajin tjetrit. Qasja e qetë dhe ligjërimit i matur do ta zbuste zemërimin dhe do ta kthjellonte mendjen, ndërsa ligjërimit i ashpër vetëm do ta forcojë urrejtjen dhe do ta topisë tehun e arsyes. **Të rrëgohen vajtimet, të mos përdoret karta e viktimizimit.** Sado që rëndësia e temës me të cilën merret ky libër kërkon vëmendjen më të madhe ndaj mënyra me të cilën do të flitet për të, pikërisht po kjo rëndësi detyron edhe më shumë në respektohen pa kompromis faktet, të dhënat dhe përshkrimet e asaj që ka ndodhur, shkurtimisht, respektim i së vërtetës! Sepse, nëse korrektësia dhe respekti i ndërsjellë i pjesëmarrësve në bisedë është bazë e çdo bisede, e vërteta është synimi i tyre i vetëm i arsyeshëm. Ky është raporti i intonacionit dhe së vërtetës, të cilin do të përpiqet ta ndjekë ky libër.*

Liria nuk është liri nëse është vetëm për disa; liria është liri nëse është për të gjithë!

Kristianët e Europës flasin për nevojën që muslimanët të cilët jetojnë në Europë, të integrohen në “Europën kristiane”; që ta kuptoni atë që u flasin juve, flisni, ju muslimanët, për nevojën që kristianët të cilët jetojnë në Europë, të integrohen në “Europën islame”. Dhe vazhdoni t’ua thoni po këtë edhe të tjerëve, gjithnjë ndërsa edhe ju edhe ata ta kuptoni se integrimi i vetëm i mirëfilltë është vetëm ai, në të cilin askush nuk i tregon tjetrit se çfarë të bëjë.

Europa liberale, konservatore dhe e djathtë sot e kundërsh-ton ashpërsisht praninë e Islamit dhe imigrimin e muslimanëve, me synim që “të ruhet identiteti evropian dhe trashëgimia euro-piane”. Ky synim, ndërkaq, u vë si detyrim pikërisht të kundër-tën: që po me atë energji të angazhohen për praninë e Islamit në Europë, sepse, gjatë 14 shekujve të fundit, identiteti evropian dhe trashëgimia evropiane, janë përcaktuar thelbësisht me pra-ninë e Islamit dhe janë trajtësuar me vlerat shpirtërore dhe veço-ritë kulturore të muslimanëve!

Në asnjë livadh nuk lulëzon vetëm një lule, në asnjë mal nuk rritet vetëm një dru!

Të mos flitet në mënyrë mbrojtëse! Assesi duke u arsyetuar! Tregimi i muslimanëve evropianë nuk mund të bastardohet në imazhin e martirit, në vajin e viktimave, apo në britmat e fatke-qëve. Tregimet e dhimbshme tashmë një kohë të gjatë nuk e pre-kin askënd. Në vend që të nxisin simpati, këto bëjnë që njerëzit të ndihen të pakënaqur dhe të distancohen nëpërmjet sigurisë së indiferentizmit. Sepse çdo pësim është akuzë implicite për të gjithë ata të cilët nuk kanë bërë asgjë që ta pengojnë. Njerëzit nuk dë-shirojnë që kushdoqoftë t’u kujtojë fajin moral, qoftë ky edhe faji i bashkëpjesëmarrësit pasiv. Të gjitha rrëfimet për tragjeditë nje-rëzore dhe pësimin masiv, për fat të keq, kundrohen si potencia-lish të interesante vetëm edhe nëpërmjet prizmit të ex post facto, nga perspektiva e përfitimit të mundshëm duke bërë filma, duke shkruar libra apo duke ngritur akuza për dëmshpërblimin e luf-tës. Askujt më nuk i ka mbetur mendja të viktimizimi dhe dëgji-mi i vajtimeve. Shikoj vetë plagët tua, mos t’i shikojnë sytë e huaj! Mbështilli me pelerinën e qiellit, përgjumi me pluhurin mjekues të gjurmimit të atyre që i kanë shkaktuar dhe me pritjen e nxje-rrjes së tyre para gjyqit. Nëse edhe nuk përthahen tërësisht, do të mjekohen më së miri me ndëshkimin e drejtë të kriminelëve. Në

vend që në çdo rast të nxjerrin victim-joker, europianët muslimanë duhet të kujtojnë kontinentin e vet në të gjitha të mirat që për pozitën dhe lavdinë e tij kanë bërë deri tash, (e që europianët kristianë jo vetëm e kanë harruar, por edhe ia kanë veshur vetes për meritë!?), dhe të tregojnë sesa shumë të mira mund të bëjnë për këtë kontinentin e tyre të përbashkët. Çdo popull dhe çdo kulturë, e më së shumti çdo besim, kanë të drejtë ta mbrojnë integritetin vetjak në atë masë në të cilën janë të gatshëm ta respektojnë integritetin e çdo populli tjetër, të çdo kulture dhe të çdo feje tjetër! Dhe vetëm në të njëjtën masë me të cilën e respektojnë sovranitetin e tjetrit, kanë të drejtë për sovranitetin vetjak!

Krahas kësaj gjithsesi, dhe energjikisht të vihet gishti mbi satanizimin e palejueshëm të Ballkanit si “të ndryshmit të botës së qytetëruar”, duke e kujtuar qartë faktin se krimet më të mëdha në historinë e botës, sikur edhe në vetë Europën, janë shkaktuar pikërisht nga pjesëtarët e “botës së qytetëruar”, konkretisht nga europianët jo-ballkanikë. Jo me synim që të hapet diskutimi në lidhje me atë gënjeshtër të sëmurë e fyese, por pikërisht me synim që ky diskutim të mbyllet, kurse kjo mitologjëmë e fabrikuar ideologjikisht për Ballkanin, të këmbetet me të vërtetën, e cila tregon se të gjitha burimet e qytetërimit të ashtuquajtur perëndimor, të filozofisë, të artit të demokracisë, pa përjashtim kanë buruar pikërisht në Ballkan dhe nga lartësitë e Ballkanit janë derdhur në pjesën tjetër të Europës.

I. ARROGANCA KULTURORE E ANTI-ISLAMIZMIT BASHKËKOHOR

Kushdo që dëshiron të bindet në tolerancën e Islamit, le ta lexojë me vëmendje Kur'anin, në të cilën është tubuar tërë tradita e pejgamberëve të Zotit, me një mesazh i cili i trimëron të gjithë popujt që të ngrihen deri në mundësitë e tyre më të larta! (Lev Nikolajeviq Tolstoj, Thënie të përzgjedhura të Pejgamberit të Zotit, Muhammedit a.s.)

Edhe sot shumë politikanë udhëheqës dhe përfaqësues të respektuar të qarqeve akademike në Europë, e ndajnë mendimin e W. Churchillit se "... ndryshe nga numri më i madh i kategori-ve të tjera të emigrantëve, muslimanët më së vështiri vendosin ta pranojnë asimilimin, dhe *tepër shpesh* (Churchill fjalë për fjalë thotë: *tepër shpesh - all too often*, sikur flet për fëmijët të cilët së tepërmi shpesh shkojnë në kinema) përpiqen ta çojnë sipas të tyre."³ Sikur t'i ketë kapur në një kundërvajtje sociale të skajshme komprometuese, kryeministri i dikurshëm britanik flet për muslimanët si për fëmijët e lënë pas dore në edukim, të cilët me këmbëngulje bëjnë diçka që nuk e kanë të lejuar dhe që i kapërcen mundësitë e tyre: *përpiqen ta çojnë sipas të tyre!* Zotëri Churchill e quan qartas se muslimanët janë të detyruar ta çojnë sipas të tyre! Ky është ai pozicion për të cilën *fanatiku është personalitet, i cili bën atë që ai dëshiron, në vend të bëjë atë që i themi!* Ky sigurisht është edhe argumenti kryesor për llogari të pohimit se muslimanët janë fanatikë: refuzojnë në mënyrë fanatike që të

³ Matthew Carr: "The Moriscos: a Lesson from History?," *Arches Quarterly*, spring-summer 2011, f.15

bëjnë atë që ua themi me qëllimin më të mirë, për të mirën e tyre, dhe me këmbëngulje përpiqen që ta çojnë sipas të tyre. Në shtator të vitit 2000, kardinali Gjakomo Bifi, arqipeshkvi i Bolonjës, bëri thirrje për kufizimin dhe ndërprerjen e plotë të imigrimit të mëtejshëm musliman, për shkak se “... tashmë është plotësisht e qartë se, në shumicën e rasteve, muslimanët erdhën të vendosur fuqishëm që t’u mbetet i huaj modeli ynë i humanizmit individual e shoqëror dhe gjithçka që për ne është më e rëndësishme dhe më e çmueshme.” Nipi i W. Churchill shkoi një hap më tej duke përkujtuar se “... marrja e xhamisë britanike nga sekta Deoband është krijimi i folesë së gjarprit në krahun tonë.” Filip Dewinder, lideri i partisë belgjikiane ekstreme të djathtë Vlaams Belang, gjithashtu kërkon ndërprerjen e plotë të emigrimit musliman, duke pohuar se “... sot tashmë është tërësisht e qartë se besimtarët islamë është e pamundur të asimilohen në vendin tonë.”

Këtu duhet goditur në vetë thelbin e debatit! Ekstremistët ideologjikë, sikurse edhe të maturit, e djathta dhe e majta, legalistët dhe luftëtarët për të drejtat e njerëzve, pa përjashtim e quajnë se integrimi i muslimanëve emigrantë në klishtë kulturore të shoqërisë perëndimore-europiane është domosdoshmërisht i nevojshëm dhe se, sado qoftë i vështirë, në parim megjithatë është i mundur! Edhe këta, edhe ata pjesërisht kanë të drejtë. Kështu anti-islamistët kanë të drejtë kur pohojnë se muslimanët më vështirë integrohen se grupimet e tjera kulturore, dhe asimilohen edhe më me vështirësi se ata. Nga ana tjetër, numri i madh i rasteve të muslimanëve krejtësisht të integruar dhe madje të asimiluar u jep të drejtë integracionistëve. Kjo s’ka të bëjë vetëm me muslimanët: punëtorët emigrantë dhe familjet e tyre, por madje edhe me muslimanët autoktonë europianë. Dëshmi bindëse paraqet shembulli i boshnjakëve, muslimanëve të Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilët më 1990 qenë në

prag në asimilimit të plotë, pas proceseve praktikisht njëshekullore shkombëtarizuese dhe deislamizuese, të cilave u qenë nënshtruar në vazhdimësi sidomos ndërmjet vitit 1878 dhe 1991.

Mirëpo, vetë debati mbetet në suaza të arrogancës kulturore eksplicite dhe të supremacisë, që është mbuluar plotësisht në pothuajse të gjitha diskutimet e mëparshme! Pyetja vendimtare është: *Përse muslimanët në përgjithësi duhet të integrohen, kurse edhe më tej - të asimilohen?* Askush nuk e ka shtruar këtë pyetje, sepse është rrënjësor mendimi që kjo kuptohet vetvetiu. Dhe çka është më e keqja, kuptohet sipas parimit se ai ai më i keqi duhet të harmonizohet me atë më të mirin, kurse ai më inferiori me atë më superiorin! Dhe pikërisht për shkak të kësaj premise diskriminuese, e cila pranohet si aksioma e parë e arsyes së shëndoshë, kjo pyetje është më se e arsyeshme t'u shtrohet të gjithë përfaqësuesve të anti-islamizmit, sikurse edhe mbrojtësve të tezës për integrimin e mundshëm kulturor të muslimanëve! Për shkak gjoja të vetëkuptuarit të kësaj lajthitjeje të ngritur në shkallë të postulatit, kurrë nuk është shtruar as pyetja, se a janë integruar kurdoherë evropianët kristianë në kultura të tjera, dhe a ia kanë shtruar ndonjëherë vetes pyetjen: A munden, a duhet, a dëshirojnë të integrohen në kulturën muslimane, kineze, indoneziane, afrikane!? A kanë përvetësuar kristianët, të ndodhur në territoret e shteteve islame, të rrethuar me shumicë muslimanësh, cilëndo traditë të muslimanëve apo janë harmonizuar me normat islame: a kanë filluar të agjërojnë Ramazanin, a kanë veshur sarong sikurse indonezianët!? Tradita e madhe e supremacisë kolonialiste dhe arrogancës kulturore, e cila përgjatë shekujve ka sedimentuar në themelet e gjoja *superioritetit qytetërues*, këto çështje i ka mënjanuar krejtësisht nga horizontet dhe kështu i ka hequr plotësisht nga rendi i ditës. Dhe pikërisht aty, ku fillojnë temat e përmbajtura në këto çështje, fillon

kuvendimi i mirëfilltë për raportet e qytetërimit, kulturave, feve. Vetëm aty bëhet e mundur që të shtrohen pyetjet e vërta-ta! Po ata të cilët e quajnë si kërkesë të vetëkuptueshme që të gjithë të tjerët të harmonizohen me modelin e tyre të jetës dhe të integrohen në vlerat e tyre, njëkohësisht e quajnë si marrëzi-në më të madhe pikërisht theksimin e nevojës që ata vetë të har-monizohen dhe integrohen me vlerat e mjedisit në të cilin ata janë pakicë! Ai që me kurrfarë kushtesh nuk dëshiron të integ-rohet me askënd, kërkon nga të gjithë që pa kushte të integro-hen me të!? Që të tjerët po ashtu kulturën e vet ta quajnë për më të mirë dhe më superiore nga të tjerat, duke përfshirë këtu edhe të ashtuquajturën kulturën perëndimore-europiane, kjo jo vetëm që askujt nuk i ka shkuar ndër mend, por edhe vetëm përmendja e kësaj mundësie do të konsiderohej shaka pa shije! Europa, e cila nuk krijoi fe të veten, ka imponuar për një she-kull fenë (kristianizmin) e vet të adoptuar në të tri Amerikat dhe në Australi, ndërsa njëkohësisht, edhe pas plot 1300 vje-tësh të pranisë së vazhdueshme dhe jashtëzakonisht aktive po ashtu të Islamit të adoptuar në këtë kontinent, refuzon t'ia njohë jo vetëm barabarësinë, por edhe vetëm të drejtën e qytetarisë!? Kjo perspektivë e ngushtuar dhe psikopatologjia e kulturëbar-tësve anti-islamistë ua kufizon absolutisht pikëshikimin dhe aftësinë e gjykitimit racional. *Kapërcimi i një psikologjie të këtillë dhe mohimi nga pozicioni i arrogancës kulturore, përbën kush-tin e parë dhe të domosdoshëm të çdo debati të ardhshëm në këtë temë.* (Shembulli i Malajzisë ku në bashkësinë e ndërlikuar mul-tietnike, shumëracore dhe shumëfetare të malajëve, kinezëve dhe indusëve, askush nuk integron askënd, por megjithatë jetojnë në bashkësi të harmonishme, sado qoftë thelbësor dhe instruk-tiv, pak kush e konsideron të nevojshëm ta komentojë, ndërsa as nuk bëhet fjalë që ta përshtatë dhe ta zbatojë te vetja). *Duhet*

sërish t'i mësojmë brezat e ardhshëm se dallimet në mënyrën e jetës janë po aq të natyrshme, sikurse edhe dallimet në përkatësinë fetare. Kundërshtitë e integritimit, kufiri i padukshëm i asimilimit, jeta e lirë, ndryshimi i bërthamave të forta, shumësia e kulturave si triumf moral, realizimi i bashkëpunimit kulturor, afirmimi i idesë së integritimit të njerëzimit dhe veprimi në sendërtimin e saj! Integritimi i njerëzisë është i mundshëm vetëm nëpërmjet autonomisë së plotë të mënyrës, modelit, traditës, klisheve të jetës shoqërore dhe unitetit në synimet e tyre të përbashkëta.

I.1. Baza historike dhe sfondi ideologjik i anti-islamizmit bashkëkohor

Anamneza: 29 maj 1453, dita e martë

“Shumë grekë e admironin Muratin II, i cili, megjithëse musliman i zjarrtë, megjithatë ishte i sjellshëm, i ndershëm dhe i drejtë ...”. (Steven Runciman, *The Fall of Constantinople 1453*, p. 31)

Njeriu e lexon këtë dhe as ka nevojë të lexojë më tej. Çdo gjë e ka të qartë. Me çfarë lehtësie historiani i famshëm Runcimani lejon që të turpërohet pikërisht si historian!? I shtrënguar nga dëshmitë, ai pranon se Murati II ishte i sjellshëm, i ndershëm dhe i drejtë, por menjëherë i del në ndihmë edhe vetes dhe lexuesve bashkëmendues të tij, me siguri të habitur nga ky informacion, dhe ua vë para hundëve shishen me amoniak në trajtën e formulimit të kontrastuar helmues: *mëgjithëse ishte musliman (dhe krahas kësaj, që habia të bëhet më e madhe, edhe musliman i zjarrtë)*. Pra, ai nuk ka harruar se muslimanët janë në parim, si grup, edhe barbarë, edhe mashtrues, edhe të padrejtë, por për këtë edhe ai vetë habitet se disa nga muslimanët, i paskan admiruar edhe grekët! Qysh në fjalinë e ardhshme Run-

cimani nuk mundet më ta përballojë dhe nxiton që ta përgënjeshtrojë krejtësisht edhe këtë përjashtim, ashtu që të dalë se në fakt fajtorët e vetëm për këtë habi të muslimanit të drejtë dhe të ndershëm, kanë qenë grekët, të cilët e kanë vlerësuar gabimisht. Se çfarë paragjykimi dhe subjektiviteti është në pyetje, shihet nga fakti se *Konstantinopoja* e dikurshme në asnjë vend të këtij libri nuk emërtohet me emrin e vet *Stamboll*, që përndryshe përbën një vështirësi të dukshme të përbashkët të shumë historianëve britanikë, francezë dhe gjermanë, aq sa *Leningradi* quhet *Sankt Peterburg* pa marrë parasysh se a është fjala për qytetin i cili tre vjet ishte nën rrethimin e trupave naziste gjermane, apo për qytetin në të cilin ka lindur poeti Josif Brodski, pra në kohën në të cilën ai qytet ka qenë dhe është *Leningrad*. Pjesa më e madhe e pakënaqësive të pjesës kristiane të Europës ndaj pjesës së saj islame, rrjedh nga ajo datë, nga 29 maji 1453, dita e martë, e cila nga atëherë deri më sot për grekët tradicionalisht është trajtuar si *ditë fatkeqe*. Këto paragjykime në mënyrë tipike e rrëgojnë edhe arsyen, edhe vetëdijen e dogmatikëve, të cilët e përjetojnë Europën krejt gabimisht si njëfarë kontinenti përjashtimisht kristian. Deri sot serbët urrejtjen e vet ndaj Islamit dhe muslimanëve e sjellin në lidhje me Betejën e Kosovës nga viti 1389, në të cilën ushtria e princ Llazarit u thye nga sulltan Murati I. Po kjo psikologji primitive e urrejtjes dhe me semantikë besëtytnie, shihet madje edhe sot në praktikën e tërbuar të ndryshimit të emrave tradicionalë të qyteteve të Bosnjës nga ana e pushtetit serb nëpërmjet neologjizmave të tipit Sërbinje në vend të emrin Foça, të cilin ky qytet e ka pasur nga themelimi i vet. Ç'të thuhet për ata të cilët veprojnë kështu?! *Edhe pse nuk janë muslimanë, por kristianë, disa nga mesi i tyre janë të pasjellshëm, të pandershëm dhe të padrejtë!* – le të na lejohet ky inversion cinik.

I.2. Fushata mediale e anti-islamistëve bashkëkohorë europianë

*O Zot, mos ua falë,
sepse e dinë saktë ç'po veprojnë!*

“Europa muslimane!” – Me këtë titull alarmant më 12 janar 2010 Xhejmi Glazov (Jamie Glazov) botoi bisedën e tij me Pamela Gelerin (Pamela Geller). Më është kujtuar po ashtu thirrja alarmante: “Mbi Beogradin! Mbi Beogradin!”, me të cilën humanisti i madh dhe mendimtari i lirisë Jarosllav Hashek, e fillon librin e vet *Përjetimet e ushtarit të mirë Shvejk*, këtë parodi të shkëlqyeshme dhe kritikë të mrekullueshme të militarizmit, frymës imperiale dhe të të gjitha llojeve të mostolerancës!

Ndryshe nga Jarosllav Hasheku, i cili ka shkruar kështu për Europën para njëqind vjetësh (saktë, për Europën nga viti 1914, pra para 97 vjetësh), Xhejmi Glazovi dhe bashkëbiseduesja e tij Pamela Geler, tentuan, pa aspak talent letrar, pa frymë humaniste dhe respekt të lirisë njerëzore, ta afirmnin pikërisht atë që J. Hasheku ashtu bindshëm ia kishte vënë në tallje para një shekulli! Ata të cilët besojnë fuqishëm në ngadhënjimin e vlerave universale njerëzore, ky fakt duhet t’i bëjë të mendojnë! Pas dy luftërave botërore, pas gjithë atyre luftërave neokolonialiste, pas këtyre shembujve të shkeljes së sovranitetit të shteteve dhe lirisë së shumë popujve, klisheve kulturore dhe paradigmatve fetare të cilët kanë demonstruar pasoja katastrofike të orvatjeve për imponimin e supremacisë politike, pas gjithë atyre tentativave që me deklarata dhe vendime të OKB-së dhe institucioneve më të larta të së drejtës ndërkombëtare botërore, të pamundësohet një praktikë e këtillë dhunuese dhe të afirmohen të drejtat e barabarta të të gjithë popujve, kulturave dhe feve, sot sërish po forcohet ideologjia e urrejtjes dhe praktika e agresio-

nit pa pasur pasoja të dëmshme dhe pa kurrfarë gjykimi apo ndëshkimi për agresorin! Dhe jo vetëm pa pasoja të dëmshme por, siç tregojnë ndodhitë botërore në njëzet vitet e fundit, në dobi të madhe pikërisht të vetë agresorëve! Ky moment njëkohësisht përcakton edhe një ndryshim krejtësisht të ri radikal, të panjohur në historinë e mëhershme botërore: heqjen e plotë të vetë nocionit të agresorit dhe fshirjen e nocioneve *lufta e drejtë*, respektivisht *lufta mbrojtëse* si nga fjalori politik dhe media, ashtu edhe nga terminologjia teknike e shqyrtimeve teorike dhe projekteve shkencore-hulumtuese!? Dhe pikërisht kjo shenjë pikësimi çuditëse është plotësisht e paarsyeshme. Praktikisht të gjitha luftërat të zhvilluara pas Luftës së Dytë Botërore kanë filluar me agresionin e armikut më të fuqishëm mbi palën e dobët. Dhjetë viteve të fundit luftërat i fillon përjashtimisht vetëm shteti më i fuqishëm i botës! Agresioni i hapur mbi shtetet sovranë mbulohet me eufemizmin *Preemptive attack*, që në praktikë do të thotë se sulmi i paprovokuar nga asgjë arsyetohet si një *carte blanche* e drejtë e shtetit më të fuqishëm të botës, i cili nuk është dhe nuk mund të jetë objektivisht i rrezikuar, por është mjaftueshëm i fuqishëm, që interesat e veta t'i zbatojë me forcën e armëve duke mos pritur të sulmohet, sa herë që interesat e tij këtë e kërkojnë dhe madje duke mos kërkuar përveç këtyre interesave, kurrfarë shkakut tjetër për përdorimin e dhunës. Ndryshe nga logjika mbi të cilën në shkencën tradicionale është ndërtuar paraqitja e historisë botërore, bazuar në gjykimin moral të agresorit dhe afirmimin e të drejtës së padiskutueshme të shtetit dhe popullit të sulmuar për mbrojtje, sot agresioni të cilin e bën shteti më i fuqishëm i botës, jo vetëm që më nuk hasë në gjykimin ndërkombëtar, por merr përkrahjen sado hipokrite dhe të shkaktuar nga frika, ndërsa njëkohësisht çdo përpjekje për rezistencë e popullit mbi të cilin është bërë agresioni,

has në gjykim të rreptë dhe përkufizohet si terrorizëm. Nuk është pa rëndësi të theksohet fakti se në të gjitha rastet, viktimat e një agresioni të këtille gjatë dy dekadave të fundit kanë qenë pa përjashtim shtetet islame: Iraku, Afganistani, Libia, përkatësisht, sikurse në rastin e agresionit lokal mbi shtetin me shumicë popullsi muslimane, të kryer nga kundërshtari ndjeshëm më i fuqishëm, si për shembull, Bosnja dhe Hercegovina. Në botën në të cilën jetojmë më i fuqishmi merr mandatin e opinionit botëror për ta pushtuar cilindo shtet kur e vlerëson se kjo është në interesin e tij, kurse akti i tillë agresor të *travestisë së paskrupull epistemologjike dhe etike të nocionit të luftës* në suaza globale legjitimohet si futje e demokracisë, në të vërtetë është jo vetëm në kundërshtim të thellë me tërë historinë e mëhershme të botës, por është edhe drejtpërdrejt në kundërshtim me të gjitha parimet e vlerave kyçe humaniste, mbi të cilat kjo histori është ndërtuar: me parimet e lirisë, dinjitetit dhe drejtësisë!⁴

⁴ Në këtë kontekst, është më se karakteristik libri i B. F. Skinnerit, profesorit të ndjerë nga Universiteti i Harvardit, në të cilin, pas titullit haptazi totalitar dhe madje të intonuar fashist “Beyond Freedom and Dignity” (Harvard University Press, 1973, botimi i parë 1971), autori me zjarr frenetik përfaqëson tezën se nocionet *liria dhe dinjiteti dhe respektimi i tyre, i kanë shkaktuar njerëzisë dëmet më të mëdha, humbjet më të rënda dhe më tej e kanë larguar nga organizata racionale në të cilën jo vetëm të gjithë qytetarët do të jenë të mirë, por nuk do të mund të mos jenë të mirë, dhe këtë saktë ashtu si pushteti shoqëror, i cili do të ketë guxim që njëherë dhe përfundimisht t’i refuzojë nocionet e lirisë dhe dinjitetit, do ta planifikojë – t’i parafrazojmë formulimet e saj kyçe nga Hyrja (Introduction). Skinner në mënyrë eksplicite shkruan: “Thuajse të gjitha problemet kryesore inkuadrojnë mirësjelljen njerëzore, dhe këto probleme nuk mund të zgjidhen me teknologjinë psikike dhe biologjike. Ajo që është e nevojshme është teknologjia e mirësjelljes njerëzore. (“Almost all major problems involve human behavior, and they cannot be solved by physical and biological technology alone. What is needed as a technology of human behavior.” – f. 24, Italiku, F. M.). Në një vend tjetër ky teknolog i mirësjelljes njerëzore dhe armiku vdekjeprurës i lirisë dhe dinjitetit, predikon të mjerrët e paudhëzuar të cilët ende besojnë në liri dhe dinjitet: “Dinjiteti ka shkaktuar më shumë dëm se sa çdo gjë tjetër në historinë njerëzore... dinjiteti është proces në të cilin njerëzit marrin arsytimin për veprimet e tyre, por vetë supozimi për veprimin e lirë thellësisht është i pasaktë.” (Dignity have caused greater damage than anything*

Prandaj ata të cilët janë të vetëdijshëm për kontekstin thelbësor të ngjarjeve në skenën politike botërore nuk duhet t'i befasojë së tepërmi fakti, se çdo gjë që është në kundërshtim me frymën e tolerancës dhe vizionin e botës në të cilin do të jetojnë lirisht popujt e barabartë, në këtë intervistë, sikurse edhe në shumë akte, vendime dhe dokumente të tjera bashkëkohore, jo vetëm që publikisht afirmohet nëpërmjet mjeteve kryesore mediale, por edhe theksohet si legjitime dhe së këndejmi, konsiderohet si plotësisht e arsyeshme! Nevoja nga konfrontimi i hapur me vetë idenë e barazisë së të gjithë njerëzve dhe të drejtës sovrane për ekzistim të të gjitha kulturave dhe çdo feje, sot kudo, dhe po kështu edhe në këtë intervistë, promovohet në imperativin jetik të konstruktit fantazmë të quajtur *Europa e pastër!* Disa kryqtarë të rinj i ngjeshin radhët e veta, të *tmerrshëm dhe të shëmtuar si dhunues nën flamuj* – po ta parafrazojmë Umberto Ekon, i cili thotë të *tmerrshëm dhe të bukur si ushtri nën flamuj!* Të dëgjojmë për një çast çka brohorasin ata dhe do të bindemi se kjo nuk është e padëmshme, as një bërtitje e vetmuar e një grupi fanatikësh ksenofobë, por propagandë sistematike e orkestruar, pas së cilës qëndrojnë disa prej qeverive më të fuqishme të BE dhe botës bashkëkohore. Vlen të përkujtohet se, e kundërta e stereotipit të shtrirë e cila pohon se si

else in human history... Dignity is the proces by which people are given kredit for their actions... but the very assumption on free action is essentially wrong." – Italik F. M. – f. 58). Ky libër, në periudhën pas botimit e deri më sot, ka luajtur rolin vendimtar në formimin e politikës së jashtme të shtetit më të fuqishëm të botës. Themi i kësaj filozofie të parë sistematike të *dehumanizimit të njeriut*, është mohimi i çfarëdo vlerash universale humaniste dhe zhvillimi i një teorie gjenerale të manipulimit njerëzor në themel të eksperimenteve laboratorike me minj dhe brejtësit e tjerë. Bota, në ndërkohë, është trajtuar si një kafaz i madh në të cilin kryhen eksperimentet për mirësjelljen e kontrolluar të njerëzve-brejtës. Kuptohet vetvetiu që rolin e eksperimentuesit në këtë koncept të botës si aleancë, mbi vete e marrin qarqet militante të shtetit më të fuqishëm në botë, deri sa të gjithë popujt të cilët përpiqen ta ruajnë lirinë dhe pavarësinë e vet, janë vendosur në rolin e minjve laboratorik.

të gjitha luftërat gjithnjë i kanë udhëhequr të marrët! - çdo luftë e planifikojnë dhe e organizojnë strukturat më të fuqishme, më të pasura dhe më inteligjente të një shoqërie! Nëse lufta është *vazhdim i politikës së një shteti me mjete të tjera*, duhet sjellë ndër mend se një vazhdim i tillë njëkohësisht paraqet angazhim total të të gjitha potencialeve nacionale, sepse çdo luftë, sikurse është e njohur, i integron të gjitha forcat e një shteti, duke i bashkuar dhe duke e vendosur në veprim të bashkërenduar potencialin e saj të përgjithshëm politik, ekonomik, ushtarak, por edhe intelektual dhe shkencor!

Dhe kjo është pikërisht *diçka së cilës është urtësi t'i druhe-mi!* – po ta citojmë Shekspirin.

Prandaj, kjo bisedë paradigmатike fillon me tregimin provokues për planin e disa shteteve europiane “të orientuar nga imigrimi masiv i muslimanëve në Europë, për të cilin di një numër i vogël njerëzish”. Titulli alarmant nga vetë fillimi është forcuar ashpërsisht me insinuata inteligjente (lexo: tradhtarë), se fjala është për planin sekret të popullimit të Europës me muslimanë, të cilët pa kurrfarë argumente trajtohen dhe automatikisht pranohen si armiq vdekjeprurës tejet të njohur të Europës. Me këtë dredhi PR (edhe pse duhet të përkufizojë institucionin “Public Relation”, është e qartë se kjo logo edhe sot ka po atë kuptim që e ka pasur gjithnjë: propagandë e paskrupull para së gjithash e angazhuar në detyrën e ofrimit të të dhënave të rrejshme dhe manipulimit me opinionin publik), opinionin i imagjinuar europian në vend është ndarë në “europianë patriotë” dhe “europianë tradhtarë”. Gjatë kësaj nënkuptohet se patriotët e vërtetë janë ata të cilët i urrejnë muslimanët dhe në pajtim me këtë, e quajnë se për muslimanët nuk ka vend në Europë, ndërsa tradhtarët janë ata të cilët e quajnë se edhe për muslimanët ka vend në Europë.

Në sugjerimin provokativ të Glazovit, përgjigjja e Pamela Gelerit fishkëllon si copë granate e vërtetë, e shpërthyer në afërsi të drejtpërdrejtë: “Pakti i tmerrshëm dhe vetëvrasës i quajtur Partneriteti Euro-Mediterran tashmë është në realizim e sipër, pa fanfara dhe pa verifikim kritik. Njeriut i mbush mendjen edhe vetë ideja se një operacion, me pasoja të tilla dhe dridhje kulturore sizmike, mund t’i marrë mandatet në përgjithësi dhe të depërtojë pa kurrfarë komente në mediat qendrore publike. Grupi për të drejtat njerëzore europiane nën emrin “Stop islamizimit të Europës” (Stop the Islamization of Europe – SIOE), punon pa u lodhur që t’ia shtrojë opinionit këtë plan për imigrimin masiv të muslimanëve në Europë, pas të cilëve qëndron pakti i theksuar Partneriteti Euro-Mesdhetar. Në kumtesën e këtij grupi, ndër të tjera, thuhet: *Është shokuese të dëgjohet se ekziston një plan i tillë, duke e ditur se politikanët danezë dhe mediat servile daneze – të cilat përndryshe janë krenare dhe kritike – nuk ia thonë popullit danez asnjë fjalë për projektin, i cili tashmë ka filluar në janar të vitit 2010.*

Synimi i këtij bashkëpunimi Euro-Mesdhetar është të krijojë një Bashkim të ri dhe më të madh European, duke i përfshirë edhe Europën edhe Afrikën Veriore, nëpërmjet të cilit Mesdheu duhet të bëhet Deti Euroarab. Sipas tyre, synimi është të vendoset “partneriteti intensiv politik, zona e lirë tregtare dhe integrimi ekonomik”, “shumë më tepër para për partnerët tanë” – që sërisht do të thotë importimin e kulturës islame në Europën paskristiane. Sipas shqyrtimeve të SIOE-së ky plan Euro-Mes do të çojë deri aty sa Europa të islamizohet. Demokracia, kristianizmi, kultura europiane dhe europianët do të dëbohen nga Europa. Më shumë se 50 milionë afrikanë veriorë nga vendet muslimane do të shpërngulen në BE.”

Pas kësaj pamjeje kataklizmike, pasojnë çështjet se kush njëmend qëndron pas kësaj agjende sekrete, përse ajo është planifikuar larg nga sytë dhe veshët e opinionit dhe si e tëra kjo lejohet, për të cilat P. Geleri përgjigjet: “Xhejmi, kjo agjendë fuqizohet nga niveli më i lartë i Bashkimit European. Web-faqja oficiele e Partneritetit Euro-Mesdhetar thotë se kjo është ’nis - më e BE dhe e fqinjëve të saj jugorë’. Ndërsa ky është një territor jashtëzakonisht i madh. Para disa kohësh në Bruksel është mbajtur samiti i ministrave të tregtisë së 43 vendeve të Europës dhe të Mesdheut. Mbledhja është mbajtur në fshehtësi për shkak se elitat në pushtet e dinë që popujt evropianë nuk do ta lejonin kurrë këtë, në rast se do ta dinin se ç’po ndodh. Europeanët dhe amerikanët duhet medoemos ta kuptojnë se ç’po ndodh dhe të luftohet kundër kësaj. Partneriteti european dhe amerikan do ta shkatërrojë qytetërimin evropian dhe përfundimisht do t’i tundë vetë themelet e këtyre vendeve. Njerëzit e lirë nuk duhet ta lejojnë këtë. Duhet të ngrihemi duke u marrë vesh dhe të kërkojmë nga liderët tanë ta mbrojnë qytetërimin tonë dhe të na kthejnë vendet tona.”

Kjo bisedë është bërë para dhjetë muajve. Brenda më pak se një viti, u dëshmuua se liderët në organizatën e SIOE (Stop islamizimit të Europës) kanë arritur ta bindin edhe kreun e BE dhe kreun e SHBA për arsyeshmërinë e drojës së tyre. Kështu si janë punët, nuk përjashtohet që politikën e BE dhe SHBA të drejtojnë Xhejmi Glazovi dhe Pamela Geleri. Mbase edhe me rend të kundërt. Sepse, sot është krejtësisht e qartë që nga Partneriteti European-Mesdhetar nuk ka gjë. Europa ka shpëtuar. Dhe jo vetëm ka shpëtuar, por Europa dhe SHBA kanë vendosur thuajse pushtetin dhe kontrollin e tyre total mbi Mesdheun dhe pikërisht mbi pjesët në të cilat kanë ekzistuar shtetet e parvarura muslimane. Dy shtetet më të mëdha dhe më të fuqishme

muslimane në Mesdhe tashmë janë në duar të SHBA dhe BE. Xhamahiria e Libisë u shkatërrua, Muamer Gadafi është vrarë praktikisht me tërë familjen, duke përfshirë këtu edhe nipat e tij; Mubaraku është në kafaz, e krahas kësaj është edhe në shtratin e vdekjes, kurse Egjipti është vënë nën kontroll. Përkrahësit e së djathtës evropiane islamofobike mundën qoftë përkohësisht të prehen. Nëse edhe koten, gjithnjë do të gjendet në rezervë një Bering Breivik i trajnuar për raste të tilla, i gatshëm të vrasë qindra bashkëqytetarë-kristianë europianë të vet të përgjumur, dhe kështu u përkujton tejet bindshëm rrezikun që u kërcënohet nga imigrantët muslimanë!

I.3. Europa që turpërohet prej vetes

Dhe kështu ndodhi që Europa të harrojë në rrënjët e saj islame, dhe e djathta evropiane ta mohojë dhe krejtësisht ta fshijë kujtesën e vet në historinë vet të gjatë dhe të pasur të filozofisë së tolerancës, e cila në skenën botërore është promovuar me aq sukses pikërisht në truallin e Europës. Për këtë nuk duhet të habitemi edhe aq shumë. Sepse atë më të mirën, atë me të cilën Europa me të drejtë krenohet, sikurse janë respektimi i të drejtave kolektive për gjuhën, traditën dhe zakonet e veta, pastaj toleranca fetare e pakushtëzuar dhe e përgjithshme, barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit, e ka formuluar dhe në praktikë e ka zbatuar pikërisht faktori islam i identitetit evropian! Të gjithë ata që dinë diçka për Islamin dhe ndërlidhimet të cilat zbatimi i parimeve të tij sjell mbi jetën sociale dhe organizatën politike të shoqërisë, e dinë edhe se fjala është për besimin me koeficientin më të lartë të tolerancës shpirtërore, kulturore dhe sociale në raport me të gjitha besimet e tjera të botës. Madje edhe një kundërshtar aq i hapur dhe radikal i

Islamit dhe historian subjektiv siç është Stefen Runcimani, nuk del dot kundër këtij fakti. Sado kundër vullnetit të tij, megjithatë e pranon drejtpërdrejt *se kristianët shpesh herë mezi kanë pritur që pushtetin e zotërinjve kristianë ta zëvendësojnë me pushtetin e sulltanëve osmanë për shkak të taksave tejet më të përballueshme dhe kushteve më të mira të jetës që i ofronte shteti islam.*⁵ I njëjti historian në mënyrë eksplicite refuzon islamizimin gjoja të dhunshëm të popullsisë kristiane në shtetin osman, për të cilin gjatë gjithë shekullit me plot zërin trumbetohet praktika e vërtetuar duke e shpallur si trillim plotësisht të pabazuar: “Edhe pse disa kristianë vullnetarisht dhe me vendimin e tyre e kanë pranuar Islamin nga dëshira e natyrshme që t’u bashkohen klasave sunduese, nuk bëhet as fjalë për islamizimin e dhunshëm.”⁶

Fakti se këto vlera themelore humaniste të shoqërisë moderne janë afirmuar në mënyrë parësore nëpërmjet institucioneve dhe praktikës së Europës islame, atyre nuk u shkon aspak pas qejfi. Përpjekja që kjo jo vetëm të harrohet, por që Islami të shpallet për opsionin skajshmërisht jotolerant, ekstrem dhe madje terrorist, është shkak kryesor që e djathta ekstreme europiane është aq e zëshme në klithmën e saj për rrezikun nga Islami. Fjala është për sindromin klasik të *kompleksit të fajit për shkak të identitetit vetjak*. Ashtu si sot shumë europianë muslimanë turpërohen nga feja e vet dhe përpiqen të fshihen pas perdes së europianizmit të tyre, si opsion gjoja trans-religjioz i qytetarit bashkëkohor të emancipuar, po kështu, nën ndikimin

⁵ Steven Runciman, *The Fall of Constantinople 1453*, Cambridge University Press, f. 39.

“... more often than not, Christians were hardly waiting to replace the rule of their Christian masters, with the rule of Ottomans sultans, for the sake of significantly lower taxes and comparably better conditions of life offered by Islamic state.”

⁶ Steven Runciman, op. cit., f. 56.

e fuqishëm të këtij kompleksi, edhe Europa qysh moti turpërohet nga identiteti i saj islam, duke u orvatur ta bindë veten për vërtetësinë e pasqyrës imagjinare të vetëkrijuar të kontinentit burimor kristian dhe autokton demokratik. Për fatin e keq të këtyre europeanëve muslimanë dhe të kësaj Europe të kompleksuar, edhe njëra edhe tjetra orvatje për fshehjen e së vërtetës mbi prejardhjen vetjake, si teknika të mjekimit të komplekseve sociale, po japin dhe tashmë kanë dhënë rezultate të suksesshme si të dëmshme. *Të suksesshme si të dëmshme*, për shkak se simptomat e kompleksit të përmendur, me terapi të gabuar tashmë janë rritur në stadin e skizofrenisë thaujse të pashërueshme! Frikat sipas veprimit të tyre janë dukshëm më të ndërlikuara sesa e mendojnë ata, të cilët besojnë naivisht në epërsinë e së mirës dhe inferioritetin e së keqes. Kur është fjala për raportin normal ndaj identitetit vetjak, frika bazore është përqendruar jo në mossuksesin e mundshëm të qëllimit që identiteti të ndryshohet, por pikërisht në rrezikun që identiteti të ndryshohet, pa marrë parasysh se çfarë është sipas konotacionit të tij etik. Synimi është mosndryshimi, sepse ndryshimi logjikisht do të thotë ndryshim i identitetit, ndërsa ndryshimi i identitetit, nga ana e tij, automatikisht do të thotë një lloj vdekjeje personale, pushimi i ekzistimit të asaj çka ka qenë njeriu dhe bërja *tjetërfare*. Ai i cili e ka pranuar veten ashtu çfarë është, kush pra, e ka përvetësuar identitetin e vet, sado që do të mund konsideronin të tjerët të keq, dhe madje nëse ai veten e vet e sheh si të tillë, përsëri zgjedh më rrallë të mbetet ai që është dhe i tillë çfarë është, sesa, me ndryshimin e cilësive të tij thelbësore, të humbë identitetin e tij dhe bëhet *ndonjë tjetër*. Njeriu i tillë jo vetëm që nuk dëshiron të bëhet *i mirë*, por nga kjo frikësohet më së shumti. Sepse të bëhesh i mirë, për atë që është i keq, domethënë të pushojë të jetë ai që është, apo së paku, i tillë si e

sheh veten! Edhe në këtë kuptim, frika më e thellë e skizofrenit, po e njëjtë edhe e njeriut të shëndoshë mendërisht, është frika nga ndryshimi i identitetit. Dallimi i vetëm thelbësor është se për njeriun mendërisht të shëndoshë ndryshimi radikal do të thotë marrëzi, ndërsa për njeriun me çrregullime mendore ndryshimi i identitetit do të thotë rënie nga marrëzia në normalitet; dhe sado që njeriu normal frikësohet që të mos çmen-det, aq skizofreni frikësohet që të mos bëhet normal! Raporti i tyre pohues, pozitiv ndaj identitetit vetjak në thelb është i njëjtë, pothuajse *shenja para kllapave* të identitetit të tyre në të dyja rastet është “plus”, edhe pse përmbajtja në kllapa është diametralisht e kundërt. Kësaj i duhet shtuar edhe fakti, që njeriu i cili zotëron vetëdijen për prejardhjen e vet dhe e pranon tërësisht identitetin e vet, jeton jetën e vet autentike! Nga ana tjetër, duke e fshehur identitetin e vet të vërtetë dhe duke hequr dorë si këmbim për ndonjë identitet tjetër imagjinar, fiktiv, individët sikurse edhe tërë popujt, të cilët turpërohen nga prejardhja e tyre dhe heqin dorë nga pjesa vendimtare e personalitetit vetjak, nuk e jetojnë jetën e tyre autentike, sepse e kanë zbrapsur në harresë të vërtetën për identitetin vetjak, të vërtetën nga e cila ata nga cilindo shkak i turpërohen dhe nga zbulimi i së cilës ia kanë drojën nga thellësia e shpirtit. Droja e tyre kryesore është që të mos bëhen sërish ata që kanë qenë dikur. Por, meqë këtë të vërtetë vetëm e kanë *zbrapsur* (ndrydhur) por jo edhe fshirë, ata i kthehen kundër pikërisht atyre të cilët me identitetin e tyre vazhdimisht i irritojnë dhe nga të cilët më së shumti frikësohen, sepse u kujtojnë pikërisht atë të vërtetë të cilën ata, mbi të gjitha, dëshirojnë ta harrojnë, dhe te të cilët ata, rrjedhimisht, shohin armiqtë e tyre vdekjeprurës. Në rastin konkret, të afërmit e vet europianë islamë! Sepse me ata që nuk kanë kurrfarë problemesh me identitetin e vet islam, pikërisht këta

muslimanë europianë, e rëndojnë thelbësisht pranimin e tregimit vetëmashtrues për *identitetin e pastër kristian të Europës dhe identitetin antieuropian të Islamit*, në rast se nuk e bëjnë edhe tërësisht të papranueshme madje edhe si iluzion. Formula e thjeshtë binome: “Unë jam europian, ergo unë jam kristian. Ti je musliman, ergo ti nuk je europian!” sipas logjikës së gjyqimeve universale pohuese, qëndrimi *Të gjithë europianët janë kristianë!* – edhe pse nuk nënkupton se edhe “të gjithë kristianët janë europianë”, megjithatë domosdoshmërisht nënkupton se asnjë musliman nuk është dhe nuk mund të jetë europian.

Është në natyrën e njerëzve që të synojnë ndërtimin e pasqyrës vetjake për veten. Kur kjo pamje është në pajtim me statusin social dhe me perceptimin e identitetit të prindërve të tyre, identiteti vetjak zakonisht ndërtohet në pajtim me këtë pamje familjare të identitetit. Mirëpo, është në natyrën e njerëzve që interesat e vet nganjëherë t’i vendosin në vend të parë, dhe kështu në emër të interesave të vet jo vetëm që heqin dorë prej prindërve nga të cilët turpërohen për ndonjë gjë, por edhe fillojnë t’i urrejnë me tërë shpirtin, vetëm për arsye se pikërisht ata, të tillë dhe ashtu çfarë janë – janë prindërit! Vetë fakti se këta prindër, nga të cilët këta turpërohen dhe të cilët me çdo mënyrë përpiqen t’i mënjanojnë, nëse tashmë nuk mund t’i këmbëjnë me ata të cilët më shumë do t’i përgjigjeshin iluzionit të tyre vetëkrijues për identitetin vetjak, janë ende aty, se sillen vërdallë para syve të opinionit – për njerëzit e tillë paraqet rrezikun më të madh për legjitimitimin e papenguar të identitetit të njëjtë imagjinar të vetëkrijuar, vetëtrajtuar, i cili dëshirohet të imponohet në vend të të vërtetit. Pikërisht ky është tregimi i asaj Europe, e cila e mohon identitetin vetjak autentik islam!

Europa e cila turpërohet nga identiteti i vet islam, turpërohet nga vetvetja! Prania e muslimanëve në Europë, do të thotë,

nga një anë, përkujtim i pandërprerë për prejardhjen e vet, identitetin e vet të mirëfilltë, për gjenet vetjake islame, ndërsa nga ana tjetër, paraqet kërcënim të përhershëm për amnezinë e vet të arritur me vështirësi.

Frika nga kujtesa e kthyer, shpesh është më e fuqishme nga frika prej harresës! Në rastin e Europës, kjo frikë është rritur në fobi posesive dhe në anti-islamizëm të theksuar! Çdo european i cili e mohon identitetin islam të Europës, rrjedhimisht edhe praninë e Islamit në traditën e tij vetjake kulturore, ka krijuar për veten pamjen fiktive të luftëtarit mitik, El-Sidi, me çdo kusht e mbronte kristianizmin european dhe vlerat europiane nga saracenët dhe nga “jobesimtarët e tjerë islamë, barbarët islamë”, edhe pse një imazh i tillë është në kundërshtim me faktet historike! Duke dëshiruar ta ruajë këtë pamje të rrejshme, ai nuk e pranon të vërtetën për veten, sepse më shumë se çdo gjë tjetër frikësohet se mos pamja që e ka krijuar për veten do të thyhet copë e grimë dhe që përsëri mos të bëhet ai i cili është, ndërsa me aq këmbëngulje refuzon të bëhet! Në këtë kuptim, çdo european, i cili e ka brendësuar këtë aberracion kolektiv, i cili është familjarizuar me identitetin e fabrikuar skizofrenik, më shumë se çdo gjë tjetër ka drojë që të mos bëhet normal! Krejt realisht, gjendja është mjaft e keqe, kurse përmirësimi i saj është i mundur vetëm me mjekimin e plotë nga sëmundja e quajtur anti-islamizëm! Rasti me krimin psikopatik të A. B. Breivikut nuk lë vend për dyshim. Pjesa anti-islame e Europës aq thellë e ka pranuar gënjeshtrën e vet; aq i është bërë e dashur marrëzia, sa që ka drojë nga shërimi vetjak; dhe aq i është bërë e afërt urrejtja në zemër, sa që ikën nga vetë mendimi për dashuri!

Ruga e Europës drejt konstituimit të integritetit burimor shpirtëror, unitetit politik dhe identitetit autentik është plotësisht e qartë: për Europën bashkëkohore sot është më e nevoj-

shme që të kujtohet për pjesën e tjetër të saj vendimtare, prejardhjen e saj islame, dhe jo ta harrojë atë! Ta përqafojë të kaluarën e vet islame, e jo ta refuzojë atë! Që muslimanët europianë përfundimisht t'i kundrojnë në dritën e vërtetë, që t'i njohë si bashkëqytetarë të vet, ta pranojë të vërtetën për ta sikurse për farefisin më të afërt historik dhe shpirtëror, që te muslimanët europianë ta shoh shpëtimin e vet e jo shkatërrimin e vet!

E ajo Europë që i turpërohet vetvetes, është mjaft larg nga kjo! Është dëshpëruese edhe të shikohet se sa larg është Europa bashkëkohore nga gatishmëria që të fillojë seriozisht të bisedojë për këtë. Europa e djathtë militante, e cila dëshiron ta shohë veten si mbrojtës të vlerave kristiane europiane, kundër pushtimit të barbarizmit oriental aziatik, të mishëruar në Islam, edhe me tej ka probleme të pazgjidhura me identitetin vetjak! Europa e këtillë në pjesën më të madhe refuzon madje edhe të dëgjojë argumentet dhe t'i shikojë në sy faktet të cilat konfirmojnë se, sipas prejardhjes së tyre, edhe Kristianizmi edhe Islami jo vetëm që janë jo-europianë, por janë aziatikë dhe pikërisht besime orientale, e lëre që ta pranojë të vërtetën për faktorin imanent islam të gjenezës së saj vetjake. Këtë fakt e konfirmon krejtësisht qartë vërtetësia e pohimit thaujse evident, në vazhdimësi i vetëkuptueshëm se “çdo përmendje e Islamit dhe e Europës në një fjali të vetme, me siguri nxit përshtypje negative dhe asocion gjoja me radikalizmin, fundamentalizmin dhe terrorizmin islam. Është bërë modë që prania muslimane në Europë të përshkruhet nëpërmjet nocioneve të Eurabisë, islamifikimit, ballkanizimit. Synimi i tyre është që të nxisin frikë dhe mosbesim ndër masat dhe që Islamin ta paraqesin si diç që është e re, e huaj dhe tejet kërcënuese për Europën.”⁷ Kush (edhe më) i frikë-

⁷ Abdullah Faliq, “From the Editor“, *Arches Quaterly*, Volume 4, Edition 8, spring/summer 2011, f. 6.

sohet Virxhinia Vulfit? Dhe kush (edhe më) në këtë dhe Europën e këtillë nuk i frikësohet Islamit?

Që të kuptohet tërë serioziteti i sindromës të krijimit të fiksionit ideologjik të *Europës së ashtuquajtur judeo-kristiane* dhe historisë së saj, nga e cila me frikë patologjike dhe me këmbëngulje maniakale fshihen të gjitha gjurmët e identitetit islam, duhet të themi se edhe i këtillë çfarë është, intervista e cekur, pavarësisht zërave që përmendin “tolerancën”, multikulturalizmin”, “inkluzivitetin”, dhe thërrasin në protesta kundër diskriminimit të të gjitha llojeve, thjesht vlon nga organizatat të cilat rolin kryesor të tyre e shohin në atë që të parakalojnë me programet e mbrojtjes së Europës nga *islamifikimi*, *arabizimi*, *rreziku musliman*. Fakti se me këtë veprojnë drejtpërdrejt në llogari të diskriminimit, mostolerancës, urrejtjes – shkurtimisht, kundër kategorive themelore të të kuptuarit njerëzor, tolerancës dhe bashkëpunimit shoqëror, sikur nuk e shqetëson askënd deri sa ky aktivitet është i orientuar drejtpërdrejt kundër pranimin të muslimanëve dhe të vërtetës së padiskutueshme për identitetin imanent islam të Europës⁸ Bloggerët norvegjezë kërkojnë moratorium ndërkombëtar mbi shpërnguljet muslimane në Europë me parullën ‘Stop Immigration International’, duke tërhequr vërejtjen ndjellakeqe në mundësinë e grevës së përgjithshme përmes Europës nëse nuk ndërpritet ardhja imigruese e muslimanëve; organizata qytetare Pax Europa, (në përpjekjen e dukshme por naive që të aludojë te periudha e shkëlqyeshme e paqes, e cila në pjesën islame të Europës ka zgjatur thuajse tre shekuj, kurse në histori ka mbetur në kujtesë si Pax Ottomanica),

⁸ Analizë të shkëlqyeshme historike dhe filozofike të bërjes sistematike e madje edhe prodhimit të perceptimit negativ të Islamit e përmban studimi monografik i Adnan Sillajxhiqit, *Islam u otkriću krsćanske Evrope – Povijest međjureligijskog dijaloga* (Islami në zbulimin e Evropës krishtere – Historia e dialogut ndërfetar), FIN, Sarajevë, 2003.

me seli në Gjermani, organizon protesta të rregullta me moton “Për Europën – kundër Eurabisë”, të cilat shpesh janë aq masive saqë pushtetit i është dashur ta ndalojë përpjekjen e tyre për tubim në Bruksel; European Muslim Union (EMU), njofton se ka regjistra për likuidimin e muslimanëve të shquar, të cilët jetojnë në Gjermani, të bërë nga qendrat e organizatave sekrete djathtiste në truallin e Gjermanisë, kurse organet policore refuzojnë t’i bëjnë publikë këta regjistra edhe pse i kanë nëpër duar!

Sikur nuk e alarmon askënd fakti se me refuzimin që këta regjistra së paku të bëhen publikë, jo vetëm që rrezikohen jetët e njerëzve emrat e të cilëve gjenden në listat e zeza, por madje edhe mbrohen autorët e tyre, të cilët mbjellin urrejtje ndaj Islamit dhe muslimanëve! Prania e muslimanëve në truallin e Europës e pengon edhe organizatën *Stop islamifikimit të Europës*, udhëheqja e së cilës e afirmon inteligjencën e saj vetjake në mënyrë adekuate me sloganin e turpshëm: “Racizmi është forma më e ulët e marrëzisë njerëzore, por islamofobia është forma më e lartë e mendjes së shëndoshë!” Radovan Karaxhiqin, njërin prej organizatorëve kryesorë të gjenocidit të kryer mbi boshnjakët muslimanë në Srebrenicë në vitin 1995, sikurse edhe Ratko Mlladiqin, ekzekutorin e drejtpërdrejtë të këtij gjenocidi e po ashtu edhe të shumë vrasjeve dhe krimeve të tjera masive mbi boshnjakët muslimanë, organizatat e djathta ekstreme në Serbi, e madje edhe në vetë Bosnjë dhe Hercegovinë, edhe pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë për gjenocidin e bërë, edhe sot me tërë gojën i lavdërojnë dhe i falënderojnë, sidomos në suazën e njësisë administrative të Republikës Srpska. Pushteti lokal i kësaj njësie administrative në kuadër të BeH shkronja aq larg në demonstrimin e urrejtjes së tyre ndaj muslimanëve dhe Islamit, sa gjatë rrugëve dhe bulevardeve të qyteteve në të cilat jetojnë boshnjakët, të afërmit dhe miqtë më të afërt

të viktimave të këtij gjenocidi, japin emrat e këtyre dhe ekzekutorëve të tjerë të krimeve masive mbi boshnjakët muslimanë!

Madje edhe në atmosferën e lartë tolerante dhe demokratike të respektimit të të drejtave themelore njerëzore, çfarë janë vendet e Europës bashkëkohore kristiane, muslimanët sot janë viktima të drejtpërdrejta të diskriminimit fetar dhe të refuzimit të të drejtave universale njerëzore. Kështu *hixhabi*, *nikabi* dhe *burka* janë pjesë të veshjes femërore tradicionale të muslimaneve, kurse sipas vlerësimit të kabinetit qeveritar holandez, të marrë në nëntor të vitit 2006, *burka* është shpallur madje edhe si *kërcënim terrorist*, për ç'arsye edhe është ndaluar që të bartet në vendet publike në territorin e tërë Holandës, përndryshe, vendit më demokratik dhe më liberal të Europës – për fat të keq, vetëm kur janë në pyetje jo-muslimanët.

Dhe e tërë kjo ndodh në Europë, 1300 vjet pasi që nëpërmjet halifatit të shkëlqyeshëm të abasitëve, pikërisht Islami në truallin e Europës për herë të parë në historinë e saj e solli frymën e tolerancës fetare dhe kulturore, kurse muslimanët e kanë demonstruar me sukses dhe e kanë përhapur përgjatë tërë Mesdheut! Deri në vitin 1492, kur Europa militante u ngrit kundër Europës tolerante, duke ngadhënjyer, jo për herë të fundit dhe duke i dëbuar nga Gadishulli i Pirinejeve të gjithë muslimanët dhe hebrejtë europianë. Që absurdi të bëhet më i madh, kuptimi i këtyre protestave kundër pranisë së Islamit në po atë Europë, identiteti i së cilës është imanent islam, sepse thelbësisht është formuar me praninë e gjatë dhe mirëbërëse të tij, është të tregojnë se si Islami është egjër mjaft e rrezikshme, i cili gjoja, u fut në Europë dhe të dëbohet nga Europa sa më shpejt si kërcënim kryesor për sigurinë dhe identitetin e saj!?

Toleranca, sikurse mund të shihet në bazë të fakteve të pa-diskutueshme, është fryt që ka mbëltuar në kopshtet islame.

Konkretisht, toleranca religjioze në truallin e Europës është trashëgim që përkon me konstituimin e shtetit të parë islam në Europë (711) – përndryshe e marrë nga tradita islame e ndër-tuar me Kushtetutën e Medinës, aktin e parë të këtillë të shkruar në historinë e botës – dhe në këtë kontekst gjithsesi është ndër cilësitë më të vjetra të traditës europiane të përcaktimit dhe respektimit të të drejtave njerëzore dhe kolektive. Përkundër kësaj, manifestimet ekstreme të mostolerancës sikurse janë inkuizicioni, jotoleranca, dëbimi, kampet e përqendrimit dhe kamerat e gazit, gjenocidi dhe holokausti të bazuar në mosdurimin etnik dhe fetar, janë praktika shumë më të reja e specifike, dhe duhet thënë, përjashtimisht të asaj pjese të Europës, e cila gjatë historisë e ka ruajtur traditën e pandryshueshme europiane të ekskluzivizmit kulturor dhe fetar, ksenofobisë dhe mostolerancës fetare, të sjellë deri në kufijtë e fanatizmit, i cili me Islamin nuk ka asgjë të përbashkët, pikërisht për shkak se përjetësisht ka mbetur jashtë ndikimit të tij mirëbërës human dhe parimeve të tolerancës kulturore dhe fetare.

I.4. Bat Ye’or – E Bija e Nilit noton kundër fakteve

Dhe megjithatë, askush nuk flet për kërcënimin, i cili do të mund të vijë nga vepruesi i atyre krimeve, por e drejton gishtin te Islami dhe muslimanët, të cilët jo vetëm që kurrë nuk u kanë bërë krime të tilla hebrenjve, por i kanë ndihmuar në çastin më të rëndë, pas dëbimit të tyre të përgjithshëm nga Spanja katolike (viti 1492) dhe inkuizicioni i saj. Është e pabesueshme, për shembull, që sulmet më të reja mbi Islamin, sidomos nga qarqet ultrasioniste, i shpërfillin tërësisht vlerësimet e njohura mirë prej historisë së paradokohshme, kurse edhe më e pabesueshme është që dhuna e tillë mbi faktet kalon e pavërejtur, pa kurrë

farë komentesh!? Edhe pse është absolutisht i pakontestueshëm fakti se krimi më i madh kundër hebrenjve – holokausti, prej të cilit e kanë pësuar disa milionë hebrenj gjatë Luftës së Dytë Botërore – është kryer në truallin e Europës; se është frymëzuar nga keqpërdorimi i religjionit kristian me synim të teorisë të hapur antisemite për inferioritetin racor të hebrenjve dhe nevojën e shfarosjes së tyre dhe dëbimin total nga Europa; se tërë ky krim monstruoze është i planifikuar, organizuar dhe realizuar nga një shtet evropian kristian; se në tërë këtë asnjë shtet musliman, as muslimanët si bashkësi apo si individ, nuk kanë marrë pjesë absolutisht hiç – përkundër të gjitha këtyre, në të gjitha sulmet bashkëkohore mbi Islamin dhe muslimanët këto fakte kapitale historike jo vetëm që nuk merren parasysh, por me asnjë të vetmen fjali nuk përmenden as përndjekjet dhe holokausti i kryer ndaj hebrenjve nga jo-muslimanët, as ndihma që iu kanë ofruar muslimanët hebrenjve!? Në sulmin ideologjik të kontaminuar të *verbërisë së pulave*, sionizmi ekstrem dhe neo-fashizmi, armiqtë e papajtuësishëm vdekjesjellës, kanë gjetur gjuhën e përbashkët dhe i bashkojnë interesat e tyre në forcimin e anti-islamizmit patologjik!? Në verbërinë dhe astigmatizmin e saj ideologjik, edhe e djathta hebraike, edhe neofashistët evropianë tërë barrën e përgjegjësisë për pësimin e hebrenjve ia veshin Islamit dhe këtë, besoni apo jo! – duke iu drejtuar praktikës së quajtur “dhimmitude”, si argumenti i tyre më të fuqishëm! Pas këtij konstrukti, të cilën Bat Ye’or pa të drejtë ia quan vetes, fshihet praktika e cila mbështetet në mëtimin se në vendet muslimane jo-muslimanët kanë paguar tatim diç më të lartë (??).

Dhe kështu më në fund na është *zbuluar* motivi qendror i urrejtjes historike të sionistëve bashkëkohorë ndaj Islamit! Tërë ajo përpjekje e madhe që Islami të shpallet si rreziku dhe kërcënimi më i madh botëror ndaj *qytetërimit perëndimor*, u

rrëgjua në frikën se, në rast se Islami dominon Europën, do të mund të ndodhë që jo-muslimanët (e ajo që është më e rëndësishme, me vetë këtë edhe hebrenjtë!), të paguajnë tatim 2% më të lartë nga muslimanët! Tërë kjo zhurmë vetëm për shkak të frikës se do të mund të ndodhë diçka e tillë e tmerrshme siç është 2% i tatimit më të lartë për t'u paguar! Çfarë degradimi i mjerë i kinse *luftës së shenjtë*. Bat Ye'or, Pamela Geleri dhe ultrasionistët e tjerë aq shumë i urrejnë muslimanët për shkak të këtij 2% të tatimit të cilin paraardhësit e tyre të hershëm dikur e paskan paguar, sa janë bashkuar kundër tyre me neofashistët!? Të gjashtë milionë hebrenjtë, bashkëqytetarë të tyre, të vrarë nga fashistët në holokaust para 70 vjetëve, për ta vlejné më pak se 2% të tatimit më të lartë për t'u paguar ndaj muslimanëve para 370 vjetëve! *Aferim! Ich gratulire dich!* Çdo respekt zonja dhe zotërinj të tubuar rreth Bat Ye'or!

E madje edhe në këtë rrëgjim nënçmues të të gjitha motiveve të *shenjta* vetëm në aspektin e drejtpërdrejtë tregtar financiar, në analizën e nocionit "Dhimmitude", Bat Ye'or i ka shpërfillur plotësisht privilegjet e mëdha, të cilat *dhimi*-të (termi arab, i cili do të thotë "i mbrojtur" dhe është lidhur me jo-muslimanët, pra edhe me hebrenjtë) i kanë gëzuar në shtetet islame për çmimin prej 2% më shumë të tatimit të theksuar! Me fjalë të tjera, në pamfletet e veta anti-islame askund nuk përmend se shtetet islame, kundër të cilave është orientuar tehu "i kritikës" së saj të mjegullt, me këtë 2% më shumë tatim, *dhimmive*, pra të *mbrojturve* u është garantuar siguria, prona private, liria e lëvizjes, mbrojtja e të drejtës në tregti në tërë territorin islamik dhe çka është më e rëndësishme, siguria e tyre dhe jeta e qetë! Por përzgjedhja e saj në theksimin e të dhënave, të cilat do të mundësonin të kuptuarit e pamjes së plotë në shtetet islame gjatë mesjetës, nuk përfundon këtu. Kështu, jo vetëm që në

shkrimet e saj askund nuk përmendet detyrimi i cili vlen vetëm për muslimanët, që njëherë në vit të paguajnë *zekatin* (2.5 % nga vlera e përgjithshme që zotërojnë, e jo vetëm mbi bazën tatimore siç e paguanin jo-muslimanët), por tërësisht injorohet fakti se jo-muslimanët (pra edhe hebrenjtë) kanë qenë të liruar nga detyrimi ushtarak, i cili ka qenë i prerë për të gjithë muslimanët! Me fjalë të tjera, për sigurinë, mbrojtjen, dhe paqen e hebrenjve, sikur edhe të gjithë jo-muslimanëve të tjerë, qytetarëve të shtetit islam të përbashkët, kanë vdekur përjashtimisht vetëm muslimanët! Cili popull, në tërë historinë e njerëzisë, para apo pas shteteve islame, e ka pasur një privilegj të tillë? Cili shtet sot ofron privilegj të tillë për cilindo, sidomos për bashkësitë të cilat nuk i përkasin bartësit të drejtpërdrejtë të sovranitetit, siç ka qenë pikërisht rasti me muslimanët dhe jo-muslimanët në shtetet islame!?

Që të kuptohet tërësisht logjika e fshehtë e këtij tentimi të orientuar në mohimin e Islamit dhe amnistimin e Izraelit për çfarëdo përgjegjësie lidhur me veprimet ndaj palestinezëve (mëkati kryesor i të cilëve është sepse janë muslimanë), ka nevojë të shtrohen hollësisht tezat themelore të këtij anti-islamizmi ultrasionist dhe të sqarohet synimi kryesor i të drejtuarit të tij Europës, sikurse edhe gjoja kujdesi i tyre për shpëtim dhe përkushtim *vlerave perëndimore*. Në bazë të analizës së këtillë objektive dhe të paanshme, mundet të pohohet arsyeshëm dhe të demonstrohet bindshëm se paraqitja si kryesore e intereseve dhe e strategjisë së të djathtës izraelite në raport me të gjithë aktorët e tjerë ndërkombëtar të angazhuar aktivisht në kërkimet për zgjidhjen e konfliktit në Lindjen e Afërt, është ajo *entelekia* e mirëfilltë, synimi i të gjitha synimeve dhe caku i të gjitha caqeve të këtij anti-islamizmit radikal dhe projekteve të ngjashme me të! Në vërshimin e literaturës

anti-islame⁹ veçohen disa libra, të cilat janë tipikë me urrejtjen e tyre të theksuar eksplicite ndaj Islamit dhe me përpjekjet e qarta, që interesat vetjakë ideologjikë t'i paraqesin si kujdes për mbrojtjen e kulturës *perëndimore*. Për shkak se ka shumë elemente shprehimisht qartë të theksuara të këtij ligjërimi urrejtës, do të veçojmë opusin e autores Bat Ye'or si *locus classicus* dhe do t'i shikojmë me themel tezat e saj kryesore. Për më tepër që anti-islamizmi i saj i ashpër dhe shfrenues jep drejtpërdrejt shenjë kundër pranisë muslimane në truallin e Europës, një e dhënë kjo e cila njerëzit e paudhëzuar mjaftueshëm mund t'i shpjerë në urrejtjen fanatike ndaj muslimanëve, krahas rrezikut të qartë nga veprimet e pamatura në gjendje paniku. Te kjo tërheq vërejtjen edhe fakti që vrasësi masiv nga Oslo A. B. Breivik, i cili në korrik të vitit 2011 vrau mbi 80 njerëz të rinj, në *Manifestin* e tij (?) në mënyrë eksplicite thekson qëndrimet anti-islame të Bat Ye'or si frymëzim të tij! Keqardhja e shprehur nga ana e Bat Ye'or, e pastaj edhe mohimi i saj i thënies të transmetuar në mënyrë autentike për keqardhjen që vrasësi norvegjez, frymëzimin e vet, ndër anti-islamistët e tjerë, e ka gjetur edhe në ligjëratën e saj, vetëm si një shtojcë e ka theksuar anti-islamizmin të përfaqësuar hapur! Është interesante të shto-

⁹ Në vargun e literaturës anti-islame, krahas pamfleteve të shumta, me shovinizmin e tij radikal kulturor dhe me prezantimin e njëanshëm, respektivisht, të hapur falsifikues të kulturës dhe religjionit islam, e gjejmë vendin e tyre edhe autorët e renomuar sikurse janë Oriana Fallaci (*The Force of Reason*); Chantal Delsol (*Unlearned Lesson of Twentieth Century*); Melanie Philips (*Londonistan: How Britain has created a Terror State Within*); Bruce Bower (*While Europe Slept: How radical Islam is destroying West from Within*); Bat Ye'or (*The Third Choice: Islam Dhimmitude, and Freedom*). Sado të jenë të bazuara në pohimet e fabrikuara, e edhe më shpesh, të falsifikuara dhe të trilluara, këta dhe libra të ngjashëm nuk duhet as nënçmuar, as injoruar sepse shërbejnë si mbulesë dhe për disa hulumtues seriozë të cilët thirren në to që ashtu, pa eksponim direkt, kanë gjetur mundësi për shfaqjen e anti-islamizmit vetjak të fshehur. Për këtë, gjerësisht do të flitet në tekstin e mëtejshëm të këtij libri.

het se Bat Ye'or i ka mbrojtur qëndrimet e veta anti-islame duke iu drejtuar lirisë së mendimit dhe të drejtës së shprehjes, njëkohësisht krahas kontestimit të rreptë të po kësaj lirie dhe të drejte nga ana e të gjithë kritikëve të qëndrimeve të saj, duke i denoncuar si propagandë publike të *anti-semitizmit dhe komplot majtist*. Ndërkaq, kuptohet vetvetiu, se në këtë rastin e dytë, liria e mendimit dhe e drejta e të shprehurit edhe ashtu nuk mund të vlekcan për muslimanët dhe përfaqësuesit e tyre! Sado që kot përpiqet ta paraqesë angazhimin e saj si *luftë të shenjtë kundër kërcënimit të Islamit*, nga konteksti i çdo fjalie të pamfletëve të saj, është e qartë se këtu është fjala për një shembull të pastër të falsifikimit të paskrupull të fakteve historike me synime të propagandës ideologjike. Tërë angazhimi i saj për ta njolllosur Islamit dhe për t'i demonizuar muslimanët përqendrohet në detyrën që opinioni publik i Europës kristiane të kthehet kundër Europës islame dhe Islamit në përgjithësi, që t'u bëhet krah aspiratave të opsionit ekstrem djathtist të qarqeve izraelite ultrarasioniste, me synimin e fundit që atyre t'u sigurohet statusi i privilegjuar i arbitrit absolut.

Të shikojmë, së pari, informatat themelore për autoren. Bat Ye'or është pseudonim i Zhizel Litmanit (frëngj. Gisele Littman), e cila gjithashtu ka publikuar edhe me pseudonimin Y. Masriya (Yahudiya Masriyha - "Hebraikja egjiptiane"). Sot është anëtare e bordit të organizatës International Free Press Society, dhe njëkohësisht njëra nga bashkëpunëtorët e titulluar si "ekspert" në ueb-faqen Europa anti-xhihadike (Counter Jihad Europe). Është pranuar nga neokonservatorët amerikanë, sionistët ekstremë, e ajo që është sidomos interesante duke e pasur parasysh identitetin e saj hebraik, me mjaft entuziazëm (të sinqertë) dhe nga neo-fashistët europianë, përndryshe në përgjithësi të njohur për anti-semitizmin e tyre. Por, këtu shumë pak mund të

bëhet! Aty ku morali nuk e ka fjalën kryesore, interesat privatë janë gjykimi vdekjeprurës për miqtë tanë dhe shpëtim për armiqtë tanë! Për shkak të interesave të saj privatë, Bat Ye'or e ka sulmuar Islamin pa mëshirë, duke harruar se shteti islam u ka ofruar dorën miqësore hebrenjve qysh në vitin 1492, kur ata e kishin më të vështirë, kurse ajo është afruar me fashistët, të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë bërë holokaustin mbi hebrenjtë, krimin më të rëndë kundër njerëzimit! Por, për këtë arsye interesat privatë edhe janë testi më i mirë i moralit tonë.

Ka lindur në Kajro (edhe pse vitin e lindjes askund nuk e ka njoftuar, hulumtuesit kanë pohuar se ky është viti 1933), nga një baba italian dhe nëna franceze, në një familje të cilën vetë e përshkruan si “familje hebraike e pasur borgjeze”. Në vitin 1955 hoqi dorë nga shtetësia egjiptiane, kurse më 1957 emigroi në Londër, ku pas martesës me Dejvid Litmanin, qysh në atë kohë oficer i Mossadit izraelit, arriti të drejtën për shtetësinë britanike (1959). Sot jeton në Zvicër. Me ndjenjën e mirë për biznes, duke e vlerësuar si dobiprurëse në perspektivë, Bat Ye'or i përkushtohet më 1969 publicistikës anti-islame, si profesionit të saj themelor, pasi paraprakisht, në periudhën 1960-1964, lindi tre fëmijë. Duke u paraqitur me dokumente të rreme si shtetase franceze e fesë katolike, Zhizela me burrin e saj Dejvid Litmanin gjatë vitit 1961 aktivisht ka marrë pjesë në kontrabandimin e 530 fëmijëve hebrenj nga Maroku në Izrael, operacion ky *top secret* i njohur me emrin *Mural*, të cilin e organizoi shërbimi sekret izraelit Mossad-i. Kaq për objektivitetin dhe neutralitetin e Gizele Litmanit, alias Bat Ye'or si publiciste *free lance*, hulumtuese individuale dhe shkencëtare, që në atë fotografi rastësisht mos të dyshohej.

Librin e saj të parë, *Hebrenjtë në Egjipt (Les Luifs en Egypte, 1971)*, e botoi frëngjisht dhe hebraisht, por tezat e saj themelo-

re i formuloi në librin e dytë me titull *Le Dhimmi* (1980), i cili është përkthyer nga qarqet sioniste të diasporës amerikane, ruse dhe hebraike. *The Decline of Eastern Christianity under Islam. From Jihad to Dhimmitude* (Rënia e Krishterimit Lindor nën sundimin islam. Nga xihadi drejt dhimmizmit, 1991) ka paraqitur në mënyrë autentike pikat kryesore të qëndrimit të saj në përgjithësi të njohur anti-islam, fillimisht të formuluar gjashtë vjet më herët në librin *The Dhimmi: Jews and Christians under Islam* (Dhimmitët: Hebrenjtë dhe kristianët nën qeverisjen islame, 1985). Libri *Islam and Dhimmitude. Where Civilizations Collide* (Islami dhe dhimizmi. Aty ku ndeshen qytetërimet, 2001) nuk sjell asgjë të re; në pyetje është orvatja e Bat Ye'or-it që të inkuadrohet në rrjedhat kryesore të propagandës anti-islame, duke iu ofruar haptazi, me përvetësimin e hipotezës së mjegullt për përplasjen e qytetërimeve, të parashtruar në librin e diskredituar po me këtë titull të Samuel Huntington-it. Realizimi i saj më i ri *EURABIA: The Euro-Arab Axis* (Eurabia: Boshti Euro-Arab, 2005), i ngriti fiksimit e saj anti-islame në nivelin më të lartë, ndërsa niveli i shpërthimit të këtyre krijesave halucinatorë përfundimisht ra në nivelin më të ultë të argumentimit, logjikshmërisë dhe racionalitetit. Po ta themi thjesht, ky libër i Bat Ye'or-it paraqet nga njëra anë, formën më të rëndë të diarresë së nacional-shovinizmit e urrejtjes fetare, dhe nga ana tjetër, kapsllëkun akut të argumentimit të çdo lloji.

Por ka më shumë vende për dyshim sesa, në emër të vullnetit të mirë, janë të gatshëm t'i mbulojnë madje edhe bashkëkombësit e saj objektivë! Së pari, Bat Ye'or nuk është e arsimuar në mënyrë akademike për punën me të cilën merret. Sikur edhe për asgjë tjetër, sepse thjesht nuk ka kurrfarë arsimimi fakulteti. Sipas përshkrimit të cilin e jep Adi Shvarc, gazetar në

gazetën ditore izraelite “Harec” (“Haaretz”): *“Bat Ye’or nuk ka përfunduar fakultet; ajo nuk ka kurrfarë kualifikimi formal prej historiani, nga cilido universitet zyrtar i njohur. E përshekruan veten si ‘hulumtuese e pavarur’, që është eufemizëm për personin i cili shkon në bibliotekë, hap librat e pastaj fillon të shkruajë”*. Mund të pajtohem me faktin se dikush, i cili ka pretendime që të merret me shkencë, nuk ka arsimim fakulteti, nuk është vetvetiu argument për skualifikim, por gjithsesi edhe me më shumë arsye duhet të pajtohem, se dhe ky nuk është argument, i cili një autor të tillë do ta konfirmonte si të kualifikuar për disiplinën shkencore me të cilën merret! Kjo është e domosdoshme të theksohet, për më tepër sepse adhuresit e figurës dhe veprës së Zhizelë Litmanit, alias Bat Ye’or, në entuziazmin e tyre ofrojnë vlerësime krejtësisht të pamatura, duke e shpallur për “shkencëtarin udhëheqës botëror të Islamit.”¹⁰ Qëndrimi i këti-llë totalisht jokritik, sado qoftë të duket në pamje të parë i papritur, logjikisht pajtohet në jologjikshmërinë, jokriticizmin dhe keqdashjen e përzgjedhjes së burimeve, të cilave u drejtohet Bat Ye’or, dhe është plotësisht në pajtim me konceptin e saj të njohur në përgjithësi të njohur me emrin EURABIA. Megjithatë, njëmend është më shumë sesa jopërgjegjësi, që dikush që nga e arsimimi nga shkencat shoqërore ka vetëm kartelën prej anëtar të bibliotekës, ka kompjuter dhe internet, e krahas kësaj e urren Islammin nga fundi i shpirtit, të shpallet për “shkencëtar udhëheqës botëror i Islamit”. Mbetet që qarqet ekstreme antisemite ndonjë anëtar të tyre pa arsimim universitar, ta shpallin për shkencëtar udhëheqës botëror të judaizmit! Të themi: “Shkencëtari udhëheqës botëror nga fusha e judaizmit është pjesëtari i Hamasit, antise-

¹⁰ Këto dhe atribute të ngjashme i ka futur në tekstet e saj Pamela Geler, kurse përkrahësit e qëndrimeve të këtij opsioni radikal racist anti-islam, në mënyrë jokritike i kanë përvetësuar, duke e mjegulluar kështu nga sytë e opinionit jo mjaft të udhëzuar faktin që Bat Ye’or nuk ka arsimim fakulteti.

mit i përbetuar, pa kurrfarë arsimimi akademik!” Do të besonit? Ja, tash e dini edhe sa duhet besuar kualifikimeve profesionale, dijës dhe objektivitetit të asaj çka shkruan Bat Ye’or.

Qëndrimet ekstremiste të Bat Ye’or hasin në kritika të ashpra edhe në mesin e vetë izraelitëve, sidomos të opinionit akademik, dhe në qarqet të cilat përpiqen për të kuptuarit dhe për paqen me palestinezët e me botën islame. Në notën e ashpër protestuese dërguar botuesit, i cili i shtyp librat e Bat Ye’or në Izrael, Adam Keleri, publicisti i njohur dhe luftëtari i dalluar për paqe me palestinezët, heq paralelen direkte ndërmjet antisemitizmit të dikurshëm dhe anti-islamizmit bashkëkohor të Bat Ye’or:

Në vitin 1886 anti-semiti francez Eduar Drymon (Edouard Drumont) ka botuar tesktin “Franca hebraike”, duke krijuar kësh-tu imazhin prej ankthi të rrejshëm të Francës me të cilin sundojnë hebrenjtë, dhe me këtë ka mbjellë farën helmuese, e cila frytet e saj do t’i jepte në Francë nga koha e Vishisë, zyrtarët e së cilës do të bashkëpunonin aktivisht në vrasjet masive të hebrenjve francezë...

Bat Ye’or është pamfletiste britanike, e cila paraqitet si historiane dhe e cila, shpreh keqardhje që më duhet ta them, është hebreje. Në këtë libër – i cili, sikurse edhe në të gjithë librat e tjerë të kësaj autoreje, mezi është diç më shumë se sa traktat i tërbuar anti-musliman – Bat Ye’or ecën në të njëjtat gjurmë famëkëqija, duke krijuar imazhin prej ankthi të rrejshëm të Europës, në të cilin sundojnë arabët dhe muslimanët. Ashtu si që Eduar Drymoni ishte përpjekur t’i shtynte francezët t’i përndiqnin dhe vrisnin fqinjët e tyre hebrenj, po ashtu zonja Litman përpiqet t’i shtyjë europeanët në orgji kontinentale të urrejtjes dhe dhunës kundër imigrantëve muslimanë, të cilët sot përbëjnë një pakicë të konsiderueshme në tërë kontinentin. Numri më i madh i këtyre njerëzve nuk dëshiron asgjë tjetër pos të jetojë jetë të dobishme dhe të shijojnë frytet e punës së vet në vendet e tyre të reja.

Arsyet e zonjës Litman për shkrimin e librit të saj racist dhe të zjarrtë janë më së të qarta. Shkaqet për shkak të të cilëve ju, si shtëpi botuese me famë, e keni zgjedhur këtë libër t'ia paraqisni opinionit izraelit, janë shumë më të errëta. Cilatdo shkaqe të jenë në vështrim, është e sigurt – tashmë kur e keni bërë këtë hap – se do të ishte korrekte sikur detyrën tuaj ta plotësonit me shtypjen edhe të atij vëllimi i cili do ta lehtësonte të kuptuarit të saktë të këtij libri, pra, me përkthimin e veprës “Franca hebraike”? Në fund të fundit, publiku lexues izraelit i informuar meriton shansin ta krahasojë një vepër të tillë klasike të mjeshtrit të demagogjisë raciste, me veprën e nxënësit të tij bashkëkohor dhe ndjekësit besnik.

Gjithsesi, supozoni se botuesi nuk e ka parë të nevojshme as të përgjigjet në këtë letër publike të shkëlqyer të Adam Kele-rit!? Dhe keni të drejtë: edhe pse tërë opinionin paqedashës bo-tëror e ka përcjellë tekstin e tij, përsëri libri i zonjës Litman, alias Bat Ye'or është shtypur pa vëllimin shtesë dhe i është paraqitur publikut lexues solemnisht, krahas promovimit jo-shës publik. Të shikojmë më hollësisht çka në fakt shkruan në librat e saj, që të kuptojmë më saktë kush janë ata që e përkra-hin këtë, e popullarizojnë dhe i paraqesin si njohuri shkencore, dhe nga cilat arsye, apo nëse dëshironi, me çfarë qëllimi e bëjnë këtë. Këtë fantazmagori anti-islame e përkrah veçanërisht fuqi-shëm spektri i organizatave politike të së djathtës europiane ekstreme dhe neo-fashiste. Në të gjitha librat e kësaj autoreje, varion në fakt po ajo temë. Pa marrë parasysh këndvështrimin nga i cili e diagnostifikon situatën në Europë, gjithnjë në bazë është fjala për pohimin e mjegullt se në vepër janë forcat, që Eu-ropën do ta shndërrojnë në koloni islame, gjë për të cilën tashmë është përgatitur edhe emri përkatës: Eurabia. Me ndërthurjen e veprimeve karakteristike për literaturën shkencore-fantastike, utopinë negative dhe pasazhet monomaniake, Bat Ye'or në fakt

fjalë për fjalë ndjek strategjinë rrëfyese të zbatuar në konstruktin anti-semit *Protokolet e të urtëve nga Sioni*. Ngjashmëritë me qasjen në këtë libër, të cilat për shkak të semplicitetit dhe parashikueshmërisë naive-eksplicite të tekstit do të ishte pretencioze të quheshin “dramaturgji”, janë aq të mëdha sa Bat Ye’or mbetet vetëm t’u ndërrojë emrat bartësve të roleve kryesore, ashtu që hebrenjtë nga *Protokoli ...* do t’i përcaktojë si muslimanë evropianë dhe do t’u japë rolin e agentëve sekretë në projektin e komplotit të madh, i cili ka për qëllim nënshtrimin e plotë të Europës ndaj Islamit. Në rrëfimin linear të vendosur kështu, nuk është aspak e vështirë të kuptohet se sipas parashikimeve të Bat Ye’or, ky synim nënkupton edhe futjen e të drejtës së shariatit e cila, pas më shumë se pesëmbëdhjetë shekujsh, sërish do të vendosë atë 2% më shumë tatim për jo-muslimanët.

Rreth asaj se a do t’u japin gjithë ato garanci të cilat i patën gëzuar, duke përfshirë edhe lirimin nga detyrimi ushtarak dhe pjesëmarrja në luftëra, edhe këtë herë Bat Ye’or nuk flet asnjë fjalë, sikurse për këtë nuk ka folur as në paraqitjet e veta kuazi-historike për shtetin islam dhe pozitën e jo-muslimanëve në të. Duke e ngritur zërin, dhe gabimisht duke konsideruar se kjo ngre edhe tensionin dramatik dhe se e rrit tendosjen emotive të ekspozesë, Bat Ye’or pohon se *çdo xhami e re në Europë, çdo investim i ri arab, çdo ndihmë teknike mediave, çdo donacion për organizatat humanitare dhe universitetet me para arabe në truallin evropian, është sequenca e re e mazokizmit evropian, e thyrjes shpirtërore dhe nënshtrimit ndaj parimit islam të quajtur ‘dhimmitude’ (shqiptohet si ‘dhimitid’)*.¹¹ Duke e pasur parasysh

¹¹ Cituar sipas: Matthew Carr, “The Moriscos: A Lesson from History?”, *Arches Quarterly*, f. 14.

“... every new mosques, every new Arab investment or Arab endowment to a media, humanitarian organizations or European university is a confirmation of European masochism, spiritual sickness and subservience to Muslim ‘dhimmitude’.

domethënien kyçe të cilën ajo ia jep këtij togfjalëshi në suaza të interpretimit vetjak të gjoja aksionit subversiv historik të Islamit, i cili gjatë tërë këtyre shekujve *synon nënshtrimin e Europës dhe shndërrimin e saj në Eurabi*, është e domosdoshme që ta përcaktojmë saktësisht kontekstin e të njëjtit nocion. Nuk ka kurrfarë dyshimi se termi *dhimitid*, është shenjë e njohjes së pamfleteve anti-islamë të Bat Ye'or-it dhe në atë masë, sa që aty për aty lidhet me këtë autore. Web-faqja e saj zyrtare pohon se Bat Ye'or-i është autore e këtij togfjalëshi në përgjithësi të njohur, që edhe ajo në mënyrë eksplicite pohon në disa intervista. Megjithatë, madje edhe në këtë rast Bat Ye'or-i nuk ka mundur t'i përballojë sprovat e metodës vetjake të shkrimit; tendencat që faktet të fabrikohen, të falsifikohen, të qepen sipas skicave vetjake, edhe njëherë kanë fituar ndaj imperativit të korrektesisë faktografike dhe objektivitetit të qasjes. *Dhimitid*, përkundër pohimeve të kundërta të veb-faqes se saj dhe vetë autores ambicioze, nuk është patenti i saj. Një vit para Bat Ye'or, në fillim të vitit 1983, e ka përdorur në fjalimin e tij kryetari libanez Bashir Gemajel.

Fjalët e magjepsin njeriun! Sidomos kur i kupton ato vetëm pjesërisht. Dhe nëse shija e tyre i pëlqen, i pranon; nëse i duken të hidhëta, i refuzon. Kështu sillen shumë njerëz ndaj fjalëve që dëgjojnë, sikurse ndaj ushqimit që e hanë; e gëlltisnin atë që u duket me shije të këndshme, e pështyjnë atë që u duket me shije të pakëndshme. Por ajo që është e ëmbël dhe e shijshme mund të jetë helm. Edhe ajo e hidhëta dhe e tharta mund të jetë ilaç. Sidoqoftë, vetë shija nuk e përcakton se a është diç helm apo ilaç. Këtë e përcaktojnë vetë cilësitë e asaj që e gëlltisim dhe veprimi i tyre i drejtpërdrejtë, objektiv në organizëm. Kështu është edhe me fjalët. Fjalët e bukura mund të marrin kuptim të shëmtuar, fjalët e shëmtuara mund të kenë kuptim të

shkëlqyer. Jo zëri, por kuptimi; jo këndshmëria apo pakëndshmëria por domethënia - duhet të na udhëheqin në përdorimin e tyre, kur tentojmë ta kuptojmë atë me të cilën kanë të bëjnë fjalët. Është koha që të demistifikohet përfundimisht kuptimi i vërtetë i fjalës *dhimmi*, *dhimmeh*, *dhimmitude*, dhe të tregohet se tërë helmin në ato fjalë e ka derdhur vetë Bat Ye'or-i, ashtu sikurse agjentët sekretë hedhin helm në lëndët përndryshe të mira dhe në ushqimin e padëmtuar, duke i bërë vdekjeprurës. Edhe pse Bat Ye'or as për së afërmi nuk ka shkathtësi të barabartë me atë të cilën e kanë inspektorët e shërbi-meve sekrete. Por kjo nuk është ndonjë handikap për efikasitetin e saj. Naiviteti, shpirtdëlirësia, shpirtkeqësia e njerëzve sot kanë arritur përmasa të tilla sa ua lehtësojnë thelbësisht punën helmuesve. Sidomos punën e atyre të cilët e furnizojnë tregun me helm, që kërkohet më së shumti në disa qarqe. Bat Ye'or shet helmin e anti-islamizmit, të prodhuar në laboratorët e ekstremistëve ultra-sionistë, të kërkuar nga shumë prej tyre dhe në mënyrë efikase të futur në rrjetin e matrapazëve, të cilët kanë pjesën e tyre të dobisë nga shpërndarja e këtij helmi.

Pra, fjala *dhimmitude*, vjen nga fjala arabe *dhimmi*, e cila do të thotë 'i mbrojtur'! Historikisht, fjala *dhimmi* konkretisht kishte të bënte me popullatën indigjene jo-islame të cilën çliruesit islamë e hasën në procesin e bashkëngjitjes së asaj popullate dhe të atyre vendeve shtetit islam. Me fjalë të tjera, problemi si të rregullohet politika zyrtare shtetërore ndaj asaj popullate, e cila, nga një anë ishte bërë pjesë e shtetit islam, e nga ana tjetër, duke e ruajtur kulturën, traditën dhe sidomos fenë e vet, në një pjesë të konsiderueshme kishte mbetur edhe jashtë atij shteti, duhet të zgjidhej në mënyrë ligjore, me parime të njëjta dhe në mënyrë të përhershme!? Arbitrariteti i disa drej-

tuesve rajonalë duhej të sanksionohej si i tillë, sidomos duke marrë parasysh vështirësitë e mëdha të kontrollit mbi ta, në një botë në të cilën kali ishte mjeti më i shpejtë i transportit, letra të cilën e mbante kalorësi mënyra më e shpejtë e komunikimit, kurse largësitë kanë qenë po aq të mëdha sikurse janë edhe sot. Nga një anë, ishte e qartë se shteti islam këta njerëz nuk mund t'i trajtonte si të huaj, aq më pak si armiq të tij, e nga ana tjetër, duhet të përcaktoheshin qartë dallimet të cilat thelbësisht i ndanin nga qytetarët muslimanë! Të detyrohen ta pranojnë Islamin, ishte drejtpërdrejt në kundërshtim me ndalesën eksplicite të përdorimit të forcës dhe dhunës në çështjet e fesë, të theksuara në Kur'an, autoriteti absolut për muslimanët¹²; të braktiseshin krejtësisht jashtë çdo kontrolli shtetëror do të thoshte ta revokohej pushteti i tij mbi ta dhe t'u pranohej e drejta për pavarësi të plotë, duke përfshirë edhe krijimin e njëfarë shteti joislam brenda shtetit islam! Si të pajtoheshin interesat shtetërorë, siguria e shtetit dhe kontributi i të gjitha subjekteve të tij, të cilët në themel janë të njëjta për të gjitha shtetet, me detyrimin e shtetit specifik islam ta respektonte traditën kulturore, gjuhën, traditat dhe sidomos, praktikimin e papenguar të besimit vetjak për të gjithë qytetarët e vet, si muslimanë sikurse edhe si jo-muslimanë!? Zgjidhja optimale është gjetur pikërisht në konceptin të përcaktuar me termin *dhimi*. Konteksti themelor çonte drejtpërdrejt në koordinatat e kësaj zgjidhjeje. *Të mbrojturit* janë kategori e njerëzve, e cila është nën mbrojtje të shtetit islam, pra kategori për fatin e së cilës përgjegjësinë direkte e ka marrë shteti islam, nënkuptohet, me kushte të caktuara të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella! Konkretisht në rend të parë kjo do të thotë se të gjithë *të mbrojturit* (*dhimmi*), si subjekte të shtetit islam, kanë të drejtën

¹² Kur'an, el-Bekare, 256.

për jetë, dhe po aq, sigurinë e garantuar fizike. E dyta, në të njëjtën cilësi të *të mbrojturit* të shtetit islam, *dhimmijtë* fitojnë garancitë për pronën e tyre private, para së gjithash pronë toke në pajtim me dispozitat të cilat i solli halifi Omer dhe të drejtën që ta rrisin në pajtim me ligjet dhe dispozitat ekzistuese të shtetit, të cilat janë të vlefshme për të gjithë subjektet e saj, si të përkatësisë islame ashtu edhe të përkatësisë fetare jo-islame. E treta, *të mbrojturit* kanë të drejtë në jetë të lirë në pajtim me kulturën dhe traditën e vet, për praktikimin e papenguar të fesë së tyre, të traditave, shkollimit në gjuhën/gjuhët e tyre ... dhe më tej, deri te e drejta plotësisht e garantuar për të gjithë dhe të çdo bashkësie jo-islame që nën patronatin (dhimmitude, mbrojtjen) e shtetit islam, ta ruajnë jetën, sigurinë, pavarësinë ekonomike, sikur edhe ta afirmojnë lirshëm dhe pa pengesa identitetin vetjak kulturor dhe përshtirësor.

Kur u bë halif Omer Ibn el-Hattabi dha urdhrin që në raport me popullsinë jo-muslimane të territoreve të pushtuara të zbatoheshin rigorozisht tre urdhërat vijues: 1. Pronat tokësore mbeten të pandryshuara, që do të thotë në pronësi të atyre që deri atëherë i kanë pasur; 2. Ndalohet rreptësisht çdo lloj detyrimi në besim, që do të thotë se hebrenjtë dhe kristianët kanë të drejtë të pacenueshme ta ruajnë fenë në të cilën kanë qenë para ardhjes së muslimanëve; 3. Ndaj të gjithë individëve duhet të kihet respekt i njëjtë dhe të trajtohen në mënyrë të njëjtë edhe në jetën e përditshme edhe në gjykatë, pos që jo-muslimanët nuk janë të detyruar të shërbejnë ushtri, as të marrin pjesë në luftërat që i zhvillojnë muslimanët. Liria e besimit, në pajtim me dispozitat e Kur'anit në kohën e halifit Omer, nënkuptonte të drejtën për kryerjen e lirë e të gjitha ritualeve dhe traditave fetare, që do të thotë se kambanat kanë rënë në kisha, se në procesione publikisht mbahej kryqi, se

të gjitha festat fetare të hebrenjve dhe kristianëve kanë qenë të lira të festoheshin në po atë mënyrë, në të njëjtat data dhe në të njëjtat vende sipas rastit dhe ku janë festuar dhe më parë. Për tërë këto, gjatë sundimit të halifit Omer Ibn el-Hattabit, qenë hartuar disa marrëveshje, të cilat garantonin të gjitha këto liri dhe të drejta.

Po me këtë koncept, kuptohet vetvetiu, janë rregulluar edhe obligimet e të *mbrojturve* të subjekteve jo-islame ndaj shtetit islam. Së pari, në detyrimet tatimore të jo-muslimanëve, në baza të barabarta me detyrimet tatimore të muslimanëve, shteti islam shton edhe 2%. Tashmë më kemi thënë se kjo ka qenë praktikisht një lloj kompensimi për 2 % e *zekatit*, detyrë të cilën jo-muslimanët nuk e paguajnë, kurse në fakt në sasinë përfundimtare ka qenë më e lartë sesa 2% tatim, sepse *zekati* nuk ka të bëjë me bazën e tatimit, por me vlerën e përgjithshme të arit, parasë së gatshme dhe stolive, të cilat zotërohen drejtpërdrejt, respektivisht të cilat nuk janë të angazhuara në projektet prodhuese, tregtare apo në projekte të tjera ekonomike. Po, ashtu është! Do të pajtohemi me ata të cilët këtu do të na kujtojnë që Bat Ye'or, sado të theksojë këtë 2% të tatimit më tepër, nuk mbetet vetëm me këtë *padrejtësi* ndaj të *mbrojturve*, pra ndaj hebrenjve dhe jo-muslimanëve të tjerë, qytetarëve të shtetit tradicional islam! Vërtet, Bat Ye'or-i tehun e kritikës së saj të sistemit të *dhimmitude/mbrojtjes* së jo-muslimanëve në shtetet islame e drejton edhe në sanksionimin e *ofendimit, përqeshjes, atakimit të Islamit, Kur'anit, Muhammedit a.s. dhe të drejtës së sheriatit*, duke përmendur shembujt, kur të tilla raste qenë ndëshkuar madje edhe me vdekje. Në këtë vend, Bat Ye'or bën *salton iracionale* të saj, d.m.th. kërcim në fiksionin e plotë të privuar nga çfarëdo koordinatash logjike dhe faktografike. Duke përmendur sërish atë 2 % tatimin e famshëm të tepërt, të

cilin ia kanë paguar jo-muslimanët, e me këtë edhe hebrenjtë, shtetit islam, kjo anti-islamiste e ashpër pohon se me këtë janë krijuar *të gjitha kushtet për një jetë të mjerë, të pandershme, përçmuese në gjendjen e të mbrojturit – dhimmitude*, të cilin tash për ‘tërë Europën, e planifikojnë muslimanët arabë dhe aleatët e tyre europianë, tradhtarë të Europës së lirë kristiane dhe vlerave të saj tradicionale’.¹³

1.5. Dhe si ka qenë gjendja atje ku nuk ka pasur dhimmitude dhe ç’do të ndodhte sikur të ishte?

Përgjigjja më e shkurtër: Më mirë edhe të mos shtrohet kjo pyetje! Por pasqyra e shkurtër dhe njohja me praktikën e shteteve kristiane me popullsi të ngadhënjyer, pra, sikur të gjendeshin në të njëjtën situatë si edhe muslimanët gjatë kohës së halifit Omar Ibn el-Hattabit, megjithatë është borxh qoftë edhe ndaj objektivitetit minimal të diskutit shkencor. Para se të vazhdojmë me analizën e këtij koncepti të realizuar nëpërmjet ligjëvënies dhe praktikës së shteteve islame, t’i shikojmë, pra zgjidhjet institucionale dhe praktikën historike të shteteve jo-islame dhe raportin ndaj të ngadhënjerve, vendet e të cilëve i kanë pushtuar gjatë historisë e deri më sot. Të pyesim se si do të dukej bota sot, sikur popujt e ngadhënjyer të të tri Amerikave, Australisë dhe pjesëve të mëdha të Afrikës pushtuesit spanjollë, francezë, britanikë t’i kishin trajtuar njësoj si *dhimmi* / *të mbrojtur* në pajtim me parimin të kritikuar aq rreptë të *dhimmitude-s*? Sikur t’u ishte garantuar jeta, e drejta e pronësisë, liria e lëvizjes, liria e plotë të praktikimit të besimit, traditave,

¹³ Bat Ye’or (2005) *Eurabia: The Euro-Arab Axis*. New Jersey, USA: Fairleigh Dickinson University Press, f. 19.

“... Muslim, Arabs and their European allies, traitors of Christian Europe and its traditional values are planning for the xhole of Europe.”

gjuhës, me një fjalë, sikur ndaj tyre ta kishin vendosur raportin e *dhimmitude*, ashtu si e kanë bërë këtë shtetet islame me popujt e ngadhënjyer në suaza të shtetit islam! Dhe për këtë status të tillë shoqëror të kishin qenë të detyruar të paguanin vetëm 2% më shumë tatim sesa pushtuesit e bardhë!? Mjafton të sjellim ndër mend vlerën e madhe të shantazhit të cilin pushtuesit jo-islamë, spanjollët e kanë kërkuar dhe e kanë marrë për blerjen e mbretit Atahualpe¹⁴ të robëruar në mashtrim pas betimit solemnisht të bërë duke vënë dorën mbi Bibël, (edhe pas premimit se do ta lironin, megjithatë e ekzekutuan kur u bindën se pjesa më e madhe e arit që kishin thesaret e inkëve tashmë ua kishin dhënë për blerjen e kokës së tij), që me siguri të përfundojmë se me këtë do të paguhej tatimi i të gjithë indianëve; dhe të cilët në atë kohë të gjithë kanë jetuar në hapësirën prej Alas-

¹⁴ Sipas të dhënave, të cilët thirren në raportet origjinale nga kjo kohë, Francisko Pisaro, vetëm për riblerjen e Atahualpes, mbretit të Inkëve ka dërguar në Spanjë rreth 360 tonelata shufra ari. Shufrat janë fituar nga shkrirja e mijëra gjësendesh, statujash, gravurash nga ari i pastër, për të cilat vetë Pisaro thotë se kanë qenë më të bukura dhe të punuara me më shumë shkathtësi nga tërë ajo që deri atëherë mund të shihej në Evropë. Vlera e këtij ari pakrahasueshëm është më e lartë nga vlera e tregut e arit dhe thjesht është e pavlerësueshme sepse dëmi artistik, arkeologjik dhe historiko-antropologjik i shkaktuar me shkatërrimin e tyre dhe me shkrirjen në shufra, jo vetëm që është i pakrahasueshëm por edhe i pakompensueshëm! E madje dhe vetëm në bazë të arit dhe argjendit të plaçkitur të Inkëve, Spanja për më pak se një dekadë, prej vitit 1532-1541, u bë shteti më i pasur i Evropës, gjatë së cilës BNP (Bruto National Product – Prodhimi Nacional Bruto) është rritur më shumë se katërfish! Është interesant se për shkatërrimin e trashëgimisë botërore kulturore nga ana e pushtuesëve kristianë kryesisht nuk flitet as në studimet e specializuara, kurse aty ku thuhet për këtë çështje ndonjë fjalë, mungojnë pasqyrat e hollësishme dhe shpjegimet. Kështu deri sot nuk është shkruar studim sistematik me së paku regjistrin e përafërt të tempujve, objekteve, artefakteve të shkatërruara në pushtimet e evropianëve kristianë, deri sa shumëfish stërmadhen dhe dramatikisht theksohen veprat e ngjashme të evropianëve muslimanë. Sikur edhe në të gjitha sektoret e tjera të hulumtimit shkencor dhe fushat themelore të jetës sociale, edhe këtu është theksuar praktika e pranishme e përdorimit ideologjik të opozitës binare të stereotipit pozitiv dhe negativ, gjatë së cilës pa përrjashim ata negativë janë rezervuar për vlerësimin e efekteve të veprimit islamik.

kës deri te Toka e Zjarrtë (Tierra del Fuego - përkthyesi) dhe këtë në shumën prej 200% (e jo gjithsej 2% sa jo-muslimanët e ngadhënjyer i paguanin qeverisë së shtetit islam) duke qenë më i madh nga ai që ishte detyrim i pushtuesve të bardhë; dhe jo për një vit, por për të gjitha 500 vitet. Dhe ndërsa katedralet, sinagogat dhe kishat e *dhimijve / të mbrojturve*, si ato që gjendeshin kur u vendos administrata islame, ashtu edhe ato të cilat qenë ndërtuar në ndërkohë, vijuan të qëndronin dhe vepronin edhe pas ikjes së shtetit islam e deri më sot, kurse nga të gjitha objektet fetare në truallin e të tri Amerikave, kanë mbetur vetëm rrënojat. E për rrënimin nuk është pritur aspak: çdo gjë që zbulohet, menjëherë edhe rrënohej.

Dhjetëra milionë njerëz janë vrarë në bazë të të drejtës së të fortit, pa kurrfarë mundësie që të përshtaten në modelin social të ngadhënjyeshit, pa kurrfarë shansi që ta ruanin jetën e tyre, ndërsa për ruajtjen e traditave, gjuhës, kulturës dhe besimit të tyre as që mund të bëhej fjalë. Përkundrazi, praktika e tyre jetësore dhe tradita, besimet dhe kultura e tyre, u dëbuan në çdo hap dhe u shfarosën në gjithë rrënjë. Njëri prej shteteve demokratike dhe më liberale të botës jo-islame SHBA, deri para pak kohe (viti 1971), kishin të ndaluar dhe të sanksionuar praktikimin e zakoneve fetare dhe ritualeve të popujve indigjenë, duke i trajtuar si shkelje të ligjit, kurse krimin e fundit masiv mbi indianët ushtria e SHBA e ka kryer në vitin 1891, vetëm për shkak se bashkëfisorët e një fallxhori nuk kishin pranuar të ndërprisnin këndimin e këngëve rituale, të cilat i drejtonte ai!? Madje as vetë ekzistenca nuk u qe garantuar. Territorret e tyre janë grabitur, ata të cilët dorëzoheshin, janë shfrytëzuar si fuqi punëtore skllave e pa pagesë; ata të cilët mbetën pa u vrarë gjatë luftërave janë mbyllur nëpër rezervate. Asnjë nga gjenocidet e shumta të njohura dhe të panjohura nuk do të

kryheshin, do të ruheshin fakte të shumta të historisë kulturore, antropologjisë, filozofisë, besimit, të cilat janë shkatërruar pa kursim, gjuhët e zhdukura ende do të jehonin si të folura amtare të qindra fiseve të cilat, të lëna pa kurrfarë *mbrojtjeje*, njerëzit nuk do të trajtoheshin si egërsira për t'u vrarë dhe nuk do të shfaroseshin brutalisht sikur me ato dhera të sundonin muslimanët! Madje edhe sot, në vendet e Europës së ashtuquajtur *Perëndimore*, nga muslimanët kërkohet që të *integrohen* dhe të *asimilohen* në standarde vlerash dhe në praktikën e shoqërive në të cilat përbëjnë pakicën, një kërkesë e cila është shumë poshtë nën pragun e tolerancës kulturore dhe fetare, të cilën shtetet islame e kanë ndërtuar në raportin e tyre ndaj dhimmive/të mbrojturve, duke lënë liri të plotë për praktikimin e traditave, veshjes, mënyrës së jetës, gjuhës, fesë së tyre.

E kur është fjala për “argumentin” vendimtar të Bat Ye’or-it, që jo-muslimanët, pra gjoja *dhimmitë* e përçmuar, nuk kanë pasur të drejtën e të folurit, sepse nuk kanë pasur të drejtë ta përçmojnë Kur’anin, ta përqeshin fenë islame (fenë e pushtuesit, thotë ajo), ta shajnë Muhammedin a.s. – le të mjaftojë kaq sa vijon: 1. Kjo nuk u lejohet as muslimanëve dhe kundravajtjet e tilla eventuale të cilat ata do t’i bënin, ndëshkoheshin madje edhe më ashpër, sesa sikur t’i bënin jo-muslimanët. Përveç kësaj, duhet shtuar se muslimanët e kanë më së rrepti të ndaluar t’i fyejnë dhe përbuzin cilëndo fe...! Për më tepër për muslimanët edhe sot është i papranueshëm arsyetimi me të cilin tentohet të përligjet ofendimi i Muhammedit a.s. duke iu drejtuar lirisë së mendimit dhe të drejtës së shprehjes! Për ta, ofendimi i fesë thjesht nuk është çështje lirie dhe të drejte, por njerëzishmërie, fyerjeje të qëllimta dhe blasfemie, e pikërisht për këtë arsye çdo akt i tillë nga kushdo qoftë që vjen, është një provokim ndaj të cilit duhet reaguar më së ashpri!

Pikërisht kjo ose injorohet, ose nuk merret parasysh nga mosdija për sulmet mbi muslimanët si “grupim jotolerant” në aspektin kulturor për shkak të reagimit të tyre gjoja *paarsyeshëm të rreptë për talljen me Islamin në mediat publike*. Dhe kjo është krejt e kuptueshme dhe e logjikshme për dy shkaqe thelbësore. 1. Kudo që ekziston institucioni social i shenjtërisë, aty ekziston edhe rreziku nga përdhosja, herezia, blasfemia! Në disa mjedise tolerohen edhe sharjet më të rënda, thuajse deri në shkallë të përzemërsisë, ndërsa në disa mjedise të tjera edhe sharja më e pasherr konsiderohet ofendim maksimal. Fakti që njerëzit nga grupi i parë ndërsjelltas shahen pa kurrfarë pasojash dhe ndjenjash të këqija, në asnjë rast nuk u jep të drejtë të sillen po në atë mënyrë edhe me njerëzit e këtij grupit të dytë, në të cilin sharja dënohet si ofendim. 2. Sulmi i hapur dhe publik, ofendimi dhe tallja e parimeve dhe institucioneve të cilitdo shtet edhe sot në tërë botën është sanksionuar të dënohet në mënyrë ligjore. Ku mund të ofendohet pandëshkueshëm kushtetuta e ndonjë shteti, të pështyhet mbi ligjet e tij dhe të tallet në mënyrë publike sistemi i tij i vlerave? Kurse për shtetin islam Kur’ani, Muhammedi a.s., sistemi juridik sheriatik, janë mishërime të drejtpërdrejta të vlerave më të larta, të normave, kushtetutës dhe ligjëvënies të asaj shoqërie dhe të mënyrës së jetës! Prandaj, pikërisht kjo e dhënë të cilin Bat Ye’or-i orvatet ta kontrabandojë si dëshmi për rolin nënshtrues dhe marrjen e të drejtave për lirinë e të menduarit dhe të shprehurit për popullatën jo-islame në sistemin e shtetit islam të quajtur *dhimmitude*, në fakt në mënyrën më bindëse përgënjeshton të gjitha interpretimet e ngjashme. E drejta e pështyrjes sipas vlerave shoqërore në shtetin islam njëmend nuk është lejuar pa marrë parasysh pretekstin, por po ashtu, kjo e drejtë nuk i është dhënë tekstualisht askujt: as muslimanëve as jo-muslima-

nëve, as plebeut e as aristokratëve, as të varfërve e as të pasurve, as nënshtetasve, e madje as vetë sunduesit!

Dhe në vend që ta kundrojë këtë dallim kapital, kjo pafundësi e cila e ndanë frymëzimin humanist të përkufizimit të statusit të jo-muslimanëve dhe praktikën shoqërore islame të quajtur *dhimmitude* në traditën e shtetit islam, nga praktika gjenocidale e shoqërive jo-islame të privuara nga çfarëdo humaniteti, Bat Ye'or plotësisht njëanshëm, selektivisht dhe në mënyrë evidente qëllimkeq veçon vetëm rastet e ndëshkimit të jo-muslimnëve; ajo, pothuaj, vetëm komunikon aktgjykimet e marra, duke mos theksuar as akuzat për kundërvajtje, as dëshmitë të cilat akuzat e tilla i konfirmojnë!

Duke e shpjeguar me këtë në mënyrë strikte çelësin amator psikoanalitik dhe ideologjik, Bat Ye'or e derdh tërë ankthin dhe zemërimin e vet pikërisht mbi konceptin e *mbrojtjes / dhimmitude*. Për çfarëdo arsye që të jenë gjykuar, *dhimmitjtë / të mbrojturit* paskan qenë jofajtorë sepse kanë qenë jo-muslimanë, kurse gjykatësit paskan gjykuar të pafajshmit, sepse gjykatësit kanë qenë muslimanë! Gjithçka që e ka thënë herët e më herët, është keq e më keq, por ndër të tjera ajo thotë edhe: "...gjendja e vazhdueshme e quajtur *dhimmitude* së cilës i qenë nënshtuar hebrejtë dhe jo-muslimanët e tjerë në shtetin islam, ka krijuar modele negative të mirësjelljes të diktuar nga frika, sikurse është pacifizmi si përgjigje ndaj agresionit në vend të rezistencës aktive, mazokizmi, serviliteti, frikshmëria dhe aftësia e zvogëluar e vetëmbrojtjes".¹⁵ Mu atij blogeri nga portalet anti-islama-

¹⁵ Intervista e Bat Ye'or-it për *Front Page Magazine*, e dhënë Xhejmi Glazovit (Jamie Glazow) më 21 shtator 2004, me qasje në internet nga 6 korrik 2009.

"Permanent state called *dhimmitude*, to which Jews and other non-Muslims were exposed in islamic state, have created extremely negative patterns of behaviour dictated by fear, such as pacifist answer to agresion instead of aktive resistance, masochism, servility, timidity, and reduced capacity of self-protection."

miste, Xhejmi Glazovit, Bat Ye'or ia ka skicuar saktë edhe fazat në të cilat Europa e tanishme kristiane do të përparojë drejt Eurabisë islame, kolonisë së ardhshme të muslimanëve, duke theksuar se është në pyetje “projekt i cili tashmë është në rrjedhë dhe i cili imagjinohet, planifikohet dhe në mënyrë konsistente realizohet nëpërmjet politikës së imigracionit, propagandës, përkrahjes së kishës, organizatave ekonomike dhe në format e ndryshme të ndihmave për organizatat joqeveritare, si edhe me bashkëpunimin kulturor, mediatik dhe akademik. Tashmë disa breza të tërë janë rritur brenda të këtylla suazave politike dhe ideologjike; ata pakthim janë humbur për çështjen tonë sepse tashmë janë edukuar dhe kushtëzuar, formësuar që këto projekte t'i përkrahin dhe t'i ndihmojnë. Pikërisht në këto projekte qëndron edhe burimi i anti-amerikanizmit gjithnjë e më të fuqishëm në Europë, sikurse edhe obsesionet paranoike ndaj Izraelit, dy gurë themeli mbi të cilët zë fill strategjia e Eurabisë.”¹⁶

Në librin e vet *Eurabia: The Euro-Arab Axis*, në sulmin e pandërprerë të irracionalitetit dhe halucinacioneve urrejtëse, Bat Ye'or shkruan se nënshtrimi ideologjik i Europës strategjisë globale xhihadiste tashmë është çështje e kryer dhe se duhet në tërësi t'i vishet pasojave të gjendjes së *dhimmitude/ të mbrojturve ... fryma e së cilës na ka bërë plotësisht të verbër, ka futur ndër ne urrejtjen ndaj vlerave tona vetjake, dëshirën që vetë t'i shkatërrojmë burimet tona vetjake, ta mohojmë historinë tonë.*¹⁷

Ja sinopsisi i shkurtër i kësaj strukture somnambulike. Sipas vlerësimeve të saj, Europa tashmë është në vetë skajin që

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Cituar sipas: Fekete, Liz (2012). The Muslim conspiracy theory and the Oslo massacre”. *Race&Class* 53 (3): 30-47.

“... The spirit of which made us totally blind, inspired hatred toward our own values, provoke desire to destroy own springs, and to deny our own histori.”

të shndërrohet në kontinent të nënshtruar, synim të cilin kronikat arabe e konfirmojnë qartë, duke parashikuar që Europa do të bëhet koloni kulturore dhe zorra e verbër e botës muslimane, kurse në favor të së cilës shkon pikërisht karakteri skllëvëror i jo-muslimanëve modernë, i cili është pasojë e drejtpërdrejtë e gjendjes fatale të *dhimmitude/ të mbrojturve*, viktima të të cilëve me shekuj kanë qenë pikërisht të parët e europianëve dhe hebrenjve të tanishëm... Në këtë provincë të re të Islamit, konturet e të cilës tashmë vërehen, sendërtimin e së cilës me gjithë zemër e ndihmojnë edhe hebrenjtë, sikurse edhe të gjithë jo-muslimanët e tjerë. Kristianët, hebrenjtë do të kthehen në statusin e *dhimmiëve/ të mbrojturve*, - pra në klasë më të ulët qytetare, të cilët do të luajnë sipas notave që do t'i përcaktojnë sunduesit islamë të Europës. Kjo, natyrisht, nuk do të ndodhë rastësisht, por me realizimin sistematik të planit sekret, okult, një lloj konkordati konspirativ të lidhur ndërmjet grupit të përfaqësuesve udhëheqës të Ligës Arabe (lidhjet e së cilës në Mossad ende nuk janë identifikuar apo, si është më e sigurtë, janë identifikuar, por kanë vënë embargo mbi emrat e tyre), dhe politikanëve të shquar europianë sikurse janë Zhak Shiraku dhe Meri Robinsoni (të cilët, nëpërmjet të njëjtave lidhje nga organizata e përmendur, kanë marrë qartë udhëzime që publikisht t'i denoncojë), të cilët përndryshe janë dashamirë të fshehtë të Islamit nëse jo edhe të konvertuar islamë, ndërsa qëllimisht i hapin më dy kanatash portat e Europës për migrantët islamë, me qëllim që sa më parë t'i mësyjnë në numër të madh. Këtu Bat Ye'or drejtohet te Oriana Fallaçi (Orianna Fallaci), bashkëmendimtarja e saj e vdekur dhe bashkëluftëtarja kundër kërcënimit të quajtur Eurabia, duke theksuar formulimin, të cilin Fallaçi e ka përjetësuar në himnin e saj falënderues kushtuar Bat Ye'or si dëshmi kulmore për realitetin e projektit

të quajtur Eurabi (apo mos e kishte Gurabi!? Tashmë më ka habitur krejt): “Muslimanëve u është thënë: Shkoni atje dhe shumëzohuni sikur minjtë!”

Dhe ndërsa sipas Bat Ye’or-it dhe Oriana Fallaçit, të gjithë njerëzit normalë lindin fëmijë deri sa vetëm muslimanët *shumëzohen si minj*, po ashtu së prapthi qëndrojnë gjërat edhe me palestinezët. Me fjalë të tjera, edhe pse duket se palestinezët janë të dëbuar, të rrethuar në Gazë, janë dëbuar nga vendi i tyre prej shtetit izraelit, Bat Ye’or-i *zbulon të vërtetën* se në fakt palestinezët janë fiksism, popull imagjinar të *cilin e trilloi Europa anti-semite*, me qëllim që të çlirohet nga kompleksi i fajtit ndaj hebrenjve, kështu që hebrenjt do t’i ndëshkojë me braktisjen brenda botës arabe, ndërsa vetë do t’i nënshtrohet Islamit dhe prej vetes do ta bëjë Eurabinë (ç’është ajo Gurabia!?) apo si do të quhet ajo koloni islame atëherë! Sipas fjalëve të Bat Ye’or-it, *palestinizmi (Palestinianism) është rrënja e vërtetë e vetëshkatërrimit europian*, nëpërmjet të cilit, me këtë nocion të rëndë duhet kuptuar fiksimi i quajtur “Kulti euro-arab i Palestinës”. Dhe cilët janë këta pasues të këtij kulti palestinez? Bat Ye’or-i e ka përgjigjen të gatshme: “Ky kult i ka bashkuar neo-nazistët, judeofobët, anti-amerikanët, komunistët dhe xhihadistët. Kulti i Palestinës është ringjallja e disponimit nacist anti-hebraik dhe anti-kristian... sepse është e njohur se nazistët kanë pasur lidhje të forta me palestinezët gjatë viteve 1930-1940, dhe këto simpati të ndërsjella kanë vazhduar edhe gjatë viteve pas Luftës së Dytë Botërore, duke kulmuar me krijimin e kultit të palestinizmit, trillimit të kombit palestinez dhe vënien e tërë Europës perëndimore nën ombrellën gjigante të aparatit të quajtur Dialogu euro-arab.”¹⁸

Kush mund t’i lidhë këto fije të nxjerra nga realiteti, fiksioni dhe urrejtja obsesive, kush mund t’i kuptojë këto thërrime

¹⁸ Intervistë për *Front Page Magazine*, 6 korrik 2009.

(fragmente) të të menduarit racional, të të dhënave kontingjente dhe vizioneve paranoike!? Nga njëra anë, nuk ekzistokan kurrfarë palestinezësh, çdo gjë është mashtrim dhe konspiracion, erë dhe mjegull. Anti-semitizmi evropian i paska trilluar palestinezët, dhe këtë vetëm pas krijimit të shtetit të Izraelit, si komb që të hakmerret ndaj hebrenjve! Nga ana tjetër, nazistët qysh nga viti 1930 kanë lidhur marrëdhënie të ngushta me palestinezët dhe i ruajnë deri sot, me qëllimin e vetëm që t'u bëjnë keq hebrenjve. Kjo, ndërkaq, e përjashton qëndrimin pararendës si absurd, sepse do të thotë se palestinezët kanë ekzistuar si komb më së paku prej atëherë, dhe se në pajtim me këtë edhe nuk janë trilluar si komb! Nga njëra anë, qarqet anti-semitë e paskan ndëshkuar Izraelin me themelimin e shtetit hebraik në territor të palestinezëve (të trilluar apo të atyre real), nga ana tjetër, mbajtkan me palestinezët raporte të ndërsjella miqësore, të cilat i konfirmojnë me faktin që i dëbojnë nga vatrata e tyre dhe i lënë të jetojnë në kampet e refugjatëve, pa vendin e tyre dhe pa shtetin e tyre dhe tashmë mbi gjashtëdhjetë vjet!? Dhe gjatë kësaj, edhe pse holokaustin ndaj hebrenjve e bënë evropianët (gjermanët), megjithatë dushmanët e vërtetë të hebrenjve qenkan palestinezët!? Mbase për arsye që ata kanë lejuar që miqtë e tyre të vjetër nazistët nga Europa, me të cilët bashkëpunojnë qysh nga viti 1930, t'i trillojnë si popull, dhe tash dëshirojnë t'u hakmerren hebrenjve ashtu që me ndihmën e tyre, sipas recetës të vjetër më shumë se njëmijëveçare, nga Europa do të krijojnë Eurabinë (apo më mirë, mos do që Gurabinë?), kurse evropianët modernë t'i shndërrojnë në të mbrojtur të vet dhe t'ua imponojë sërish atë tatimin ekstra 2%!?

I.6. Projekti i demaskuar i anti-islamistëve; Gurabitët për Eurabinë

Projekti i anti-islamistëve të llojit Bat Ye'or është demaskuar. Manipulimi me vështirësitë ekonomike të Europës, drejtimi i gishtit drejt emigrantëve, duke klithur me tërë zërin: “Muslimanët! Muslimanët!”, duke hedhur disa të dhëna të shkëputura për raportin e muslimanëve ndaj jo-muslimanëve prej më herët se një mijë vjet, e pastaj i drejtohen auditorit gjysmë të habitur, duke ua shtrydhur tezën për planin shekullor të muslimanëve se po atë që dikur ua kanë punuar jo-muslimanëve në shtetet e tyre islame, kanë për qëllim t’ua bëjnë këtu, në zemër të kontinentit të tyre, prej të cilit dëshirojnë të bëjnë Eurabinë!” Apo megjithatë, mos ka qenë Gurabinë!? Të pakënaqur në Europën Perëndimore ka me miliona, në çdo hap, të të gjitha llojeve dhe për shumë shkaqe: për shkak të papunësisë, për shkak të gjendjes së keqe ekonomike, për shkak të mospajtimit me politikën e BE si të brendshme ashtu edhe të jashtme, për shkak të rritjes së shpenzimeve të jetës, të pranisë së emigrantëve, për shkak të sezonit të dobët të klubit të tyre futbollistik, për shkak të bashkëshortit / bashkëshortes jobesnik/e, për shkak të arritjeve të dobëta të fëmijëve në shkollë, për shkak të kaosit në trafik, ndërsa secili nga ata, krahas kësaj, është i zemëruar me politikën e së djathtës apo së majtës, socialistëve apo demokristianëve, dhe në atë grup të madh të të pakënaqurish europianë pa marrë parasysh për shkaqet, ende veprojnë anti-semitët dhe judeofobistët, antinazistët dhe neonazistët, anti-islamistët dhe xhihadistët, neokapitalistët dhe socialistët (komunistë tashmë një kohë nuk ka, nëse ndonjëherë ka pasur të tillë), dhe sikurse është e njohur, krahas pro-amerikanizmit gjithnjë e më shumë po forcohet edhe anti-amerikanizmi. Dhe të gjithë ata kërkojnë vetëm një

gjë, në thelb plotësisht e njëjtë: kërkojnë *viktimën mbi të cilën do të shfryjnë mllefin, kërkojnë fajtorin për pakënaqësitë e tyre!*

Muslimanët! Ja rast i shkëlqyeshëm i cili nuk bën të ikë duarsh! Të gjithë ata tok (toptan) të binden se muslimanët janë fajtorë për të gjitha tundimet e tyre dhe përgjegjës për të gjitha pakënaqësitë e tyre qytetëruese dhe private, të thirren me emër disa personalitete publike, të cilat edhe ashtu gjithnjë janë në shënjestër të qytetarëve të pakënaqur, dhe të orientohet mllefi dhe urrejtja e tyre, siç është krejt normale, mu në burim, përkatësisht, në shkakun e pakënaqësisë vetjake, pra, pikërisht mbi muslimanët! Por, pasi njerëzit, nëse jo çdoherë të paktën mjaft shpesh dhe kjo nuk duhet të shpërfilllet, janë *qenie racionale*, u duhet ofruar argumente bindëse, diçka që nuk do të jetë tepër e ndërlikuar por që së paku do t'i imitojë argumentet, insinuatat, të cilat do ta luajnë rolin e dëshmimeve! E për këtë teoria e komplotit ka dhënë shpirtin. Me një teori të tillë mjaftueshëm të formuluar, nga njëra anë, theksohet rrezikshmëria e përbashkët, e cila përshkon gjithë të pakënaqurit; nga ana tjetër, duke e formuluar si rrezikshmëri nga muslimanët tregohet qartë grupi konkret si armiq, dhe duke e theksuar fuqinë financiare të disa vendeve të botës arabe, sugjeron se çdonjëra nga këto kategori është aleat sekret i komplotit musliman, i korruptuar me parane muslimane, pardon, arabe! Të gjithë neve na kërcënon i njëjti rrezik nga armiku i përbashkët dhe këta janë muslimanët e të gjitha kombeve, të të gjitha kulturave, të të gjitha ngjyrave dhe bindjeve; por kujdes nga të gjithë dhe vetëm vetvetes t'i besoni! *Sepse muslimanët i kanë korruptuar të gjithë të tjerët (përveç jush, këtë së paku e dini sigurisht), që prej Europës suaj të bëjnë Eurabinë, kurse ju që jeni europianë autoktonë dhe autentikë, t'ju degradojnë në qytetarë të rendit të dytë, të mbrojtur / dhimmi të frikësuar, servilë, të përçmuar! E si kanë jetuar dhimmi-*

të, këtë ua kemi shpjeguar! Prandaj, më e mira që mund të bëni dhe e vetmja që mund ta shpëtojë edhe Europën që mos të bëhet Eurabi dhe europianët që mos të bëhen dhimmi, është që të luftoni në çdo hap kundër çdo gjëje që është islame dhe kundër muslimanëve të të gjitha kombeve, ngjyrave dhe bindjeve! Me këtë do t'i ngadhënjeni edhe të gjitha ato qarqe europiane, opsionet dhe liderët politikë të cilët gjithnjë i keni konsideruar të dëmshëm për vlerat europiane, kurse sigurisht tashmë janë të korruptuar dhe në lidhje të fshehtë me muslimanët, këtë armik pa-rësor të kulturës dhe qytetërimit europian!

Njeriu njëmend duhet të pyesë veten, vallë muslimanët nuk kanë merituar një kritikë më inteligjente dhe më seriozisht të argumentuar nga kundërshtarët e tyre!?

Dhe kur mamurllëku i këtij kokteji dokrrash të kalojë, kurse njeriu të vijë pak në vete nga ajo shastisje, të pyesim çka i bëhet e qartë!? Nëse shikohen në pasqyrë, do t'i shohin ata veshë gomari proverbial se si u buzëqeshin me shpirtmirësi nga fytyrat e tyre vetjake! U kanë dalë për disa arsye. Së pari, sepse besuan që dikush tjetër kujdeset më shumë për ta sesa ata kujdesen për veten; pastaj, sepse besuan në fantazi të tilla paranoi-ke, thjesht nga dëshira që te dikush të shfryhet mllefi i tyre dhe të gjejë lehtësim pakënaqësia e tyre; përfundimisht, për arsye se i ka mashtruar drejtpërdrejt çdokush që i ka bindur se synimi skajor i tërë asaj që dikush u flet dhe për çka i përkrah, nuk është për dobinë e tij, por për dobinë e tyre! Imazhi të cilin do ta ketë para syve secili nga ata që hipotetakisht do ta pranojë tregimin paranoik ideologjik për Eurabinë, i zbulon krejt qartë ata të cilët janë manipuluar me këtë rrëfim dhe të cilët nga njëra anë, janë të gjithë në humbje, kurse vetë manipuluesi nga ana tjetër, është i vetmi në fitim. Europa është në kolaps skizofrenik sepse është kthyer kundër vetes së vet, me atë që është kthyer

kundër muslimanëve të vet, si kundër atyre autoktonë, ashtu edhe kundër emigrantëve të kohëve të fundit, të cilët i shikon si *Tjetri*; e bashkuar prej frikës patologjike nga Islami dhe urrejtjes kundër muslimanëve, Europa megjithatë është thellë e pasigurt në vete, jobesnike dhe e përçarë; krahas konfrontimit të brendshëm, Europa drejtpërdrejt ka shkuar në konfrontim me këshilltarin e vet kryesor, SHBA, sepse bindshëm është denoncuar për shkak të anti-amerikanizmit të vet; me atë që ka lejuar që dikush ta paralajmërojë për rrezikun dhe të kujdeset për sigurinë e saj, Amerika (SHBA) i ka lejuar vetes rolin e kujdestarit, këshilluesit, i cili në këtë mënyrë jo vetëm që është dëshmuar si armiku më i madh, por edhe si vëllai më i madh, mendimi i të cilit vlerësohet kurse këshillat dëgjojen!

Ky është regjistri i humbësve të manipuluar. Kush është manipuluesi fitues!? Nuk bëj shaka, vërtet nuk do t'ua them. Sepse nuk ka mundësi mos t'ju kujtohet, e megjithatë është tjetër kur njeriut i lihet së paku rasti që vetë të kujtohet dhe të kuptojë kush me këmbëngulësi tenton t'ia hedhë. Prandaj, mendoni mirë ju, europeanë të të gjitha kombeve, kulturave, besimeve të statuseve sociale dhe bindjeve politike. Dhe të gjithë ju që jeni qytetarë të SHBA, pa marrë parasysh racën, fenë, statusin social, bindjet politike. Mendoni mirë secili për vete dhe mendoni mirë së bashku: kush orvatet këtë t'ua hedhë me këmbëngulësi, duke ju ftuar në luftë kundër të ashtuquajturit *kërcënimit islam!*

Përkundër të gjithë kësaj, Bat Ye'or vazhdimisht i falsifikon faktet historike. Sipas pohimit të saj, *Dhimmitude* është qëndrim *i inferioritetit të pranuar dhe nënshtrimit ndaj Islamit*. Atë që dikur (nuk) e kanë bërë me hebrenjtë dhe kristianët në vendet e pushtuara, shton Bat Ye'or, arabët me para dhe dinakëri e kanë arritur sot, që do të thotë se Europa bashkëkohore

po zhvillon pikërisht po këtë qëndrim ndaj arabëve, ajo në mënyrë eksplicite thotë: “Europa po bëhet Eurabi. Në Eurabinë e këtillë mbi Islamin shikohet nëpërmjet syzave të shëmtuara. Njëkohësisht, në shenjë të këtij serviliteti shpirtëror ndaj Islamit, në Eurabi fuqizohen anti-amerikanizmi, antisemitizmi dhe anti-sionizmi. Madje edhe muslimanët më liberalë dëshirojnë ta bëjnë Eurabinë nga Europa dhe t’ia nënshtrojnë të drejtës së shariatit. *Eurabia e këtillë është në thellësi anti-kristiane, anti-perëndimore, anti-semite, drejtpërdrejt e orientuar në shkatërrimin e Izraelit si shtet dhe në satanizimin dhe izolimin e SHBA nga bota tjetër.*”¹⁹

Ta lexojmë me kujdes këtë fjali përfundimtare të citatit edhe njëherë: “Eurabia e këtillë është thellësisht anti-kristiane, anti-perëndimore, anti-semite, drejtpërdrejt e orientuar në shkatërrimin e Izraelit si shtet dhe në satanizimin dhe izolimin e SHBA nga bota tjetër.” Një nga metodat më të sigurta që ta deshifroni se çka mendon dikush për ju është të përdorni metodën e projektimit. Atë që ai ua atribuon juve, duke pohuar se ju e këtë e mendoni dhe ndjeni ndaj tij, nga fjala në fjalë shpreh saktësisht atë që në fakt *ai mendon dhe ndien ndaj jush!* Çka na zbulon fjalja e theksuar sipas çelësit të metodës së projektimit? Se Europa si e dëshiron Bat Ye’or është thellësisht anti-islame, anti-lindore, anti-muslimane, dhe se është drejtpërdrejt e orientuar në shkatërrimin e shteteve arabe, krahas synimit shtesë që SHBA e satanizojnë botën muslimane dhe se po e izolojnë nga bota tjetër! Dhe vërtet, posa të ndërrohet metoda e projektimit, menjëherë bëhet përsosurisht e qartë se Bat Ye’or me theksimin e përhershëm të anti-kristianizmit islam, edhe më

¹⁹ Bat Ye’or (2005) *Eurabia: The Euro-Arab Axis*, f. 17.

“Eurabia is fundamentally anti-Christian, anti-Western, anti-American and Antisemitic, while striving for Israel’s disappearance and the vilification and isolation of USA from the rest of the world.”

theksueshëm e fuqizon anti-islamizmin vetjak, duke treguar në mënyrë të vazhdueshme se arabët dëshirojnë ta shkatërrojnë Izraelin, zbulon dëshirën e saj jetësore që të shkatërrohen vendet arabe; që me denoncimin e muslimanëve si anti-amerikanë, ta nxisin Amerikën kundër muslimanëve dhe t'i qortojnë SHBA se muslimanët po i satanizojnë dhe përpiqen t'i izolojnë; e demaskon synimin e saj themelor që t'i nxisë SHBA kundër muslimanëve, që t'i satanizojnë dhe t'i izolojnë nga bota tjetër në politikën e saj të jashtme!

Trishtimi dhe frustrimi i Bat Ye'or-it depërton qartë edhe nëpërmjet denoncimit prej saj të institucioneve të dialogut, sikurse edhe të intelektualëve dhe politikanëve të Europës dhe vendeve arabe (nuk e dua dhe e refuzoj sintagmën “Bota arabe”, sepse më shumë se dukshëm sugjeron se kjo është njëfarë bote tjetër, e jo bota jonë, bota e vërtetë në të cilën ne jetojmë), të cilët i kanë lejuar vetes atë mëkat që të zhvillojnë dialog njëri me tjetrin! Kur të tubohen dhe ta lidhin tërësinë qëndrimet themelore të këtij denoncimi kancerogjen të muslimanëve e konkretisht arabëve, çfarë në të vërtetë paraqet libri i saj, bëhet e qartë se çka dëshiron të arrijë kjo dushmane e përbetuar e çdo bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe dialogu me arabët, Islamit dhe muslimanët me pohimet se *ky transformim i Europës në Eurabi (Gurabi?) erdhi për shkak të hapjes së dialogut të politikanëve dhe intelektualëve europianë dhe arabë të zhvilluar tri-dhjetë viteve të fundit, në të cilin është vendosur porosia ideologjike, e cila jo vetëm që e ka shprehur armiqësinë thelbësore islame ndaj parimeve etike dhe të vlerave mbi të cilat zë fill Europa, por ka rezultuar edhe me futjen e një vargu ligjesh të cilat i kanë ashpërsuar edhe më tej presionet jokorrekte dhe kanë rritur shtrembërimin në paraqitjen e konfliktit izraelito-arab në dëm të Izraelit. Pavarësia e frymës së Europës është minuar mu në*

*themele.*²⁰ Pavarësia e frymës së Europës për të është minuar sigurisht për shkak se ndonjë zë në Europë ka marrë guximin të thotë, se sulmi i forcave speciale izraelite mbi karvanin e Kryqit të Kuq në ujërat ndërkombëtare, krahas vrasjes gjakftohtë të nëntë aktivistëve të paarmatosur paqedashës, sipas regjistrit paraprakisht të përgatitur, plaçkitja e anijes, konfiskimi i tërë ndihmës të destinuar për qytetarë të sëmurë dhe fëmijë të uritur në Gazë, të rrethuar nga ushtria famëkeqe izraelite, arrestimi dhe pastaj dëbimi i të gjithë pjesëmarrësve në atë karvan të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, megjithatë është akt i pastër i krimit ndërkombëtar dhe duhet të gjykohet në mënyrën më të rreptë. E kur edhe krahas tërë lakuriqësisë së këtij krimi të shtetit izraelit, madje as vendet e BE-së, e madje as OKB-ja nuk mbajtën qëndrim të mjaftueshëm moral që ta gjykojnë, duhet pranuar se diagnoza të cilën Bat Ye'or e ka dhënë për pavarësinë e frymës së Europës në parim është e saktë: ajo frymë njëmend është minuar në vetë themelet. Por jo për arsye se dikush e gjykon Izraelin dhe për atë që nuk ka bërë, por ngaqë askush nuk e gjykon madje edhe për shkak të krimeve më të rënda, të cilat me dekada qeveria izraelite, armata dhe shërbimi sekret, po i kryejnë në Lindjen e Afërt dhe të Mesme!

Çdo libër thellësisht anti-islam, jotolerant, racist dhe fashist i Bat Ye'or-it paraqet apoteozën e botës judeo-centriste, në të cilën do të jetë vetëm një popull i pagabueshëm dhe së

²⁰ Po aty, f. 21.

“... this transformation of Europe into the Eurabia happened as a result of opening dialogue between European and Arab politicians and intellectuals during last thirty years, which resulted in ideological messages expressing not only essential Islamic animosity toward basic ethical values and principles of Europe, but also in introduction of many new laws, which sharpened incorrect pressures and push further the distortion in public presentation of Israeli-Arab conflict, on the expense of Israel. The independence of the spirit of Europe is undermined in its very foundation.”

këndejmi, arbitër suprem i korrektes dhe jokorrektes, të lejua-rës dhe të palejuarës, besimdrejtësisë dhe shtrembërdrejtësisë: hebrenjtë! Dhe vetëm një lloj jobesimtarësh absolutisht i gabu-eshëm, a priori është i gabuar për të gjitha shkeljet dhe çdo gjë që është e shëmtuar dhe e palejuar në botë: arabët, respekti-visht të gjithë që janë muslimanë! Që këtë tezë ta bëjë sa më bindëse *E bija e Nilit*, - e cila me plotë gojën e mallkon vendin nëpër të cilin *Babai* i saj *i Lumenjve (Nili)* rrjedh, dhe më së shumti në botë urren njerëzit të cilët në atë tokë të saj të pë-lleshme jetojnë! – në mënyrë sistematike dhe keqdashëse injo-ron tërë faktet e së kaluarës dhe të tanishmes në një interpre-tim, i cili ka një synim të qartë: ta nxisë botën, në radhë të parë më të fortët, kundër Islamit, me synim dominimin nga ana e Izraelit. Kush i dëboi hebrenjtë nga Europa? Muslimanët? Jo! Këtë e kanë bërë murgjit kristianë, katolikë. Kush i ka përndje-kur? Ulemaja islame? Jo! Këtë e bëri inkuizicioni, skalioni më elitar i kishës katolike. A është distancuar kisha katolike nga kjo përndjekje dhe vepërkeqe e inkuizicionit? Jo! Edhe sot Injac Lojola është shenjtor në kalendarin katolik! Kush ka pranuar numrin më të madh të hebrenjve të dëbuar nga Spanja kristia-ne në shtetin e vet? Shteti islam osman, sulltani dhe halifi! Kush e shpalli dekretin më liberal dhe më korrekt të respektuar për tolerancën fetare të fesë të kundërshtarëve të vet – Ahdna-men? Sulltan Mehmed el-Fatih II. Sunduesi islam! A është respektuar një dokument i tillë? Absolutisht dhe në mënyrë pakompromis. Dëshmi janë të gjitha kishat, katedralet, sinago-gat dhe faltoret e tjera të ruajtura deri më sot, si ato që janë ndërtuar para ardhjes së pushtetit islam në këto troje, ashtu edhe shumë të tjera të ndërtuara gjatë kohës së kësaj qeveris-jeje, shpesh edhe me paratë nga thesari shtetëror, jo rrallë edhe me donacione personale të sulltanëve! Dhe ndërsa Devleti

Osman, si shtet islam i Europës gjatë kohës së qeverisjes së tij, ka lënë të paprekura të gjitha objektet fetare pa marrë parasysh në fenë që predikohet në to, qeveritë në shtetet e Europës kristiane pa përjashtim kanë pasur praktikën e jotolerancës totale ndaj objekteve islame fetare.

Vërtetimi mbresëlënës i kësaj praktike diametralisht të kundërt mund të shihet te fakti se *fjalë për fjalë askund në Europë*, jashtë territorit të këtij shteti islam europian, nuk janë ndërtuar në të njëjtin qytet dhe në të njëjtën hapësirë kisha ortodokse, katedrale katolike, sinagoga hebraike dhe xhami muslimane, ndërsa shembuj të tillë ka në disa qytete brenda kufijve të dikurshëm të shtetit osman (Sarajevë, Bejrut - përkthyesi). Kuptohet, nga territoret e Europës nga të cilat pushteti osman islam tërhiqej, traditën europiane të tolerancës të ndërtuar nga Evropa islame, e ka zëvendësuar në vend tradita e jotolerancës e ndërtuar dhe e promovuar nga Evropa kristiane. Kundërshtia totale e qëndrimeve të pushteteve zyrtare të Europës islame dhe joislame ndaj tolerancës fetare dhe kulturore, më së fuqishmi bie në sy në kohën e Mesjetës së vonshme dhe në fillim të kohës moderne, kur dobësohet fuqia e shtetit osman, i cili i lëshon territoret që i kishte sunduar me shekuj. Burimet historike theksojnë se në vitin 1686, kur pushteti osman është tërhequr nga Budapesti, kanë lënë pas vetes në këtë qytet të paprekura të gjitha kishat, të cilat i kishte gjetur në vitin 1526, kur kishte vendosur aty pushtetin e vet, sikurse edhe të gjitha kishat të cilat ishin ndërtuar në këtë periudhë, duke përfshirë edhe një numër të madh të kishave ortodokse dhe të sinagogave, krahas 212 xhamive të cilat vetë i kishte ndërtuar. Përkundër këtij shembulli të tolerancës së jashtëzakonshme fetare, diçka që në Europë e ka demonstruar dhe i pari e ka futur shteti islam si model të përgjithshëm të jetës sociale, po në këtë qytet shteti

kristian ka demonstruar jotolerancën dhe përjashtimësinë e vet tipike: për më pak se një vit pas largimit të osmanlinjve dhe nga vendosja e pushtetit të Europës kristiane, në Budapest u rrënuan të gjitha xhamitë, deri te e fundit, dhe kështu ka mbetur deri në ditën e sotme! Dhe sa herë që me këtë të dhënë kam dalë para auditorit shumicë kristian (madje nëse këta kanë qenë edhe njerëz me arsimim të lartë të parime liberale në çdo aspekt, sidomos ndaj dallimeve fetare), kam pasur ndjenjën që duan të më thonë diçka shumë të rëndësishme, që unë e kam harruar, por që atyre u vinte keq të ma thoshin. Me një rast u jam drejtuar të pranishmëve në një debat të më thoshin, a mos po më mashtronte ndjenja ime dhe a vërtet po druheshin që të thoshin diçka mjaft të rëndësishme, e cila mua më kishte dalë nga mendja. “Ju sigurisht nuk bëni dallim ndërmjet kishës dhe xhamisë! Kjo megjithatë nuk është e njëjtë. Kisha është tempull evropian, xhamia është aziatike apo tempull oriental. Në Europë është normale të mos rrënohen kishat por të rrënohen xhamitë!” Kjo thënie autentike m’i ka hapur sytë. Europa edhe më tej është e robëruar plotësisht prej mendësisë, të cilën e ka konstatuar Marcel Maussi, nxënësi më i talentuar i Emil Durkheimit, në dallimin e njohur ndërmjet asaj që është e mirë dhe asaj që është e keqe, të cilën pjesëtarët e një fisi afrikan e kanë përkuftizuar me shembullin vijues: “Kur ne vjedhim lopë dhe i marrim gratë e armiqve tanë, kjo është e mirë. Kur ata i vjedhin lopët tona dhe i marrin gratë tona, kjo është e keqe!” Pra, shumë evropianë dhe më tej nuk kuptojnë se xhamia është po aq “tempull evropian” sa edhe katedralja katolike apo kisha ortodokse dhe protestante! Ende nuk e kuptojnë se kristianizmi nuk është aspak më shumë “fe evropiane”, sesa janë Islami apo judaizmi!

Sipas burimeve të dokumentuara, në Beograd ka pasur mbi 250 xhami në kohën e largimit të pushtetit osman, kurse sot ka

mbetur vetëm një! Dhe edhe ajo është djegur shumë herë, për çka çdo gjë ka mundur të shërbejë si pretekst i mirë. Veprim të menjëhershëm të ngjashëm me rrënimin e objekteve fetare islame kanë ndërmarrë qeveritë kristiane edhe në Rumani, Serbi, Greqi, Mal të Zi, ndërsa Shqipëria, Bosnja, Sanxhaku, Maqedonia, duke përfshirë edhe pjesë të Greqisë së sotme dhe Bullgarisë, kanë shmangur goditjen e parë të shkatërrimit total vetëm për shkak të mbijetimit të vazhduar të pushtetit osman në këto territore. Me ikjen përfundimtare të tij, shkatërrimi i gjurmëve të pranisë islame është vazhduar, edhe pse me intensitet të dobësuar, pjesërisht për shkak se në pjesën më të madhe trashëgimia islame kulturore, e mishëruar në tempuj religjiozë, shkolla, hamame, në masë të madhe tashmë ishte rrënuar, e pjesërisht së këndejmi për shkak se standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e përmendoreve kulturore tashmë filluan të hyjnë në fuqi edhe në këto territore.

Në këtë kontekst, një varg çështjesh vendimtare, por të thjeshta, duhet t'u shtrohen falsifikatorëve të historisë:

Si ka mundur “bashkësia hebraike të bëhet vitale dhe të prosperojë 2600 vjet në truallin e Egjiptit”, nëse 1400 të fundit po këta hebrenjë i kanë kaluar nën qeveritë gjoja jotolerante dhe armiqësore islame!? Cilët popuj kanë mbijetuar dhe e kanë ruajtur identitetin e tyre nën administrimin e huaj duke përfshirë fenë, tempujt, gjuhën, traditat? Ç’ka ndodhur me popujt që ranë nën pushtetin e shteteve kristiane? Ku janë sot shtetet e inkëve, majave, actekëve, ku janë popujt e lirë të cilët kanë jetuar nga Alaska deri në Tierra del Fuego - Tokat e Zjarrta, pasi ranë nën pushtetin e qeverive kristiane? Flitet për Xhingis Hanin si për sinonim të vrazhdësisë dhe tolerancës, kurse injorohet plotësisht vrazhdësia dhe mostoleranca vetjake e drejtpërdrejtë ndaj palestinezëve! Kush është sot i vetëdijshëm se Xhin-

gis Hani kurrë nuk ka mbajtur aq gjatë, aq numër të madh dhe me kushte të tilla johumane asnjë popull siç i mbanë pushteti izraelit palestinezët në Gazën e pushtuar! Asnjë popull, pos atyre që kanë qenë nën sundimin islam, as pas 500 vjetësh nuk ka mundur të mbijetojë nën pushtetin e huaj e të mos e mësonte gjuhën e pushtuesit, dhe ta ruante të paprekur fenë, traditën dhe kulturën e vet. Kur shteti islam Osmanlı Devleti pas 540 vjet të plotë, i lëshoi territoret europiane, të gjithë popujt e këtij rajoni: shqiptarët, boshnjakët, bullgarët, malazeztë, grekët, maqedonët, serbët, rumunët, hungarezët, e kanë ditur shumë më mirë gjuhën e tyre sesa gjuhën turke, edhe pse të gjithë këta popuj kanë qenë relativisht me numër më të vogël, prej 500.000 e deri te disa milionë pjesëtarë. Nga ana tjetër, në të tri Amerikat, në hapësirën e madhe prej Alaskës deri në Patagoni, menjëherë pas ardhjes së pushtuesve kristianë, humbën gjuhët lokale, janë rrënuar të gjithë tempujt, u çrrënjosën të gjitha fetë, kështu që sot në SHBA dhe Kanada flitet anglishtja (në Kuebek frëngjishtja), në të gjitha shtetet tjera të Amerikës së mesme dhe jugore flitet spanjishtja, me përjashtim të Brazilit, ku flitet portugalishtja! Apo shembulli tjetër i habitshëm i asimilimit gjuhësor nga ana e pushtuesve kristianë: ka qenë i mjaftueshëm pushtimi relativisht i shkurtër nga ana e Britanisë, që edhe sot, po thuajse mbi shtatëdhjetë vjet të pavarësisë, një miliard e njëqind milionë banorë të Indisë të përdorin anglishten si gjuhë zyrtare!? As nuk zihet në gojë që automjetet i ngasin në anën e majtë apo se sporti nacional është poloja! Harrojnë përkrashtit e Bat Ye'orit që të bëjnë pyetjen se si është e mundur që Selaniku, në kohën kur ishte në suazat e shtetit osman, ka qenë qyteti më i madh hebraik në botë!? Si ka mundur të bëhej kjo? Pikërisht falë tolerancës të paprecedent në historinë e deriatëhershme botërore. Sikur qëndrimi themelor ndaj hebrenjve dhe ndaj

feve të tjera e traditave kulturore të ishte opsioni politik i shtetit aq të fuqishëm, kurrë nuk do të mund të ndodhte, ashtu sikur që nuk ka ndodhur.

E udhëhequr hapur me synime ideologjike që ta satanizojë Islamin dhe muslimanët, dhe t'i denoncojë të gjithë ata të cilët nuk janë të gatshëm që t'i satanizojnë pakusht dhe t'i shpallin armiq të përbetuar të Europës kristiane, kjo nxitje shtjellon rrëfimin e vet mbi ndërthurjen e hipotezave paranoike dhe pohimeve totalisht absurde, për të cilat nuk ofrohen kurrfarë dëshmish (në të vërtetë me arsye, sepse për marrëzi të tilla dëshmi nuk mund as të ketë!), dhe tërë këto i paraqet si dëshmi të padiskutueshme!? Për ilustrim, ja disa shembuj të cituar drejtpërdrejt nga blloku i shënimeve psikiatrike.

Kur flet për rezervat e naftës në vendet arabe, intonacioni Bat Ye'or-it sugjeron padiskutueshëm se arabët qëllimisht e kanë përvetësuar tërë atë naftë nga diku, apo mbase edhe e kanë grabitur pikërisht nga jo-muslimanët, para së gjithash nga hebrenjtë dhe sipas të gjitha gjasave, nga farefisi më i afërm i Bat Ye'or-it në kohën kur është vënë ai 2% tatim më tepër mbi *dhimmitët*. Natyrisht, këtë nuk e kanë bërë pa qëllim të keq, por me synim të qartë t'u bëjnë keq hebrenjve, Europës judeo-kristiane dhe rrënjëve iluministe dhe vlerave të Europës, duke përgatitur kështu kapitullimin e saj të plotë dhe shndërrimin në koloni të Islamit. Plani djallëzor, të cilin arabët e paskan imagjinuar dhe Bat Ye'or-i e paska demaskuar dhe kështu *i ka treguar tërë botës se çfarë rreziku i kërcënohet nga të gjithë ata muslimanë djallëzorë që janë rritur si minjtë, përcaktoka që me pasurinë e arritur me naftën të shtënë në dorë ashtu dyshimshëm, të fillojë lufta psikologjike dhe diplomatike me të gjitha mjetet, duke përfshirë madje edhe filozofinë pasmoderniste, në mënyrë që të blihen intelektualët, elitat politike dhe diplomatët*

e Europës, *me detyrë që t'i rrënojnë nga brenda themelet e trashëgimisë sonë shpirtërore*. Dëshmitë se intelektualët, elita politike dhe diplomatët janë bërë aleatë të muslimanëve, janë mjaft bindëse: kështu, të gjithë që e gjykojnë agresionin e SHBA në Irak, praninë e burgut në Guantanamo për të cilin nuk vlej në kurrfarë konventash ndërkombëtare e as të drejtat njerëzore, vrasja e civilëve palestinezë nëpër kampet e refugjatëve dhe në anijet e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe kjo në ujërat ndërkombëtare, si edhe të gjithë ata të cilët publikisht angazhohen për të drejtat ndërkombëtare të palestinezëve, janë haptas apo fshehtas, spiunë muslimanë në shërbim të komplotit islam kundër Europës judeo-kristiane. Po të mendojë njeriu më mirë, kjo nuk është edhe aq absurde! Do të mund të ishte Bat Ye'or-i thelbësisht në të drejtën, kur tregon faktin se muslimanët, (të cilët në pajtim me vlerat themelore islame, vërtet janë kundër çdo agresioni, kundër shkeljes së drejtave njerëzore, kundër vrasjes së civilëve, për tolerancë, bashkëpunim dhe mirëkuptim mes popujve, kulturave dhe feve), në njëfarë kuptimi, vërtet janë të kundërvënë në mënyrë antagoniste me ato synime dhe metoda për të cilat angazhohet Bat Ye'or-i, e nëse synimet e tyre përkojnë me *vlerat tradicionale të qytetërimit perëndimor-europian*, atëherë edhe me ata! Në po këtë kontekst, të gjithë ata intelektualë, elita politike dhe diplomatë, të cilët angazhohen për të njëjtat vlera, të cilat Bat Ye'or-i ua vesh muslimanëve si mëkat të rëndë dhe në këtë i kundërvihen aktivisht shkeljes së të drejtave njerëzore, çdo agresioni mbi shtetet sovranë, vrasjes së civilëve të angazhuar në aksionet paqësore, janë thelbësisht në të njëjtën anë të barrikadës me muslimanët, kurse në kundërshtim nga ajo me të cilën i ka vendosur pozitat e saj Bat Ye'or. *Arabët tinëzarë dhe muslimanët dinakë* gjithashtu keqpërdorkan pakënaqësinë e Europës kundrejt epërsisë së

SHBA, sikurse edhe psikopatologjinë kulturele të Europës, e cila nga ndjenjat e fajësisë ndaj hebrenjve, e ka themeluar shtetin Izrael, dhe kështu e ka kthyer Perëndimin kundër Izraelit.

Veprojnë edhe faktorë të tjerë, të cilat muslimanët me shkahtësi i shfrytëzojnë dhe me të cilët i manipulojnë europianët naivë, sikurse është zilia e francezëve ndaj anglo-saksonëve për shkak se krahasuar me ta janë më të aftë në çdo pikëpamje, ndërsa ambicia më e madhe e BE është që veten ta vendosë si rival strategjik të SHBA me ndihmën e bllokut arab, duke pasur në mënyrë konstante në plan të parë të këtij konspiracioni të njohur islam të muslimanëve, atë që njihet me emrin EURABIA (Nuk më le të qetë kjo ide: mos është megjithatë Gurabia!?).

Lexuesit tashmë gjithsesi kanë imazh të plotë për këtë propagandë helmuese të urrejtjes racore dhe fetare, të orientuar ekskluzivisht kundër Islamit dhe muslimanëve, për të cilët, sipas Bat Ye'or-it, ky është emëruesi i përbashkët për shkak të të cilit meritojnë të shkatërrohen dhe të zhduken nga faqja e dheut, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe kulturore.²¹ Më pak është e qartë, ndërkaq, ajo që të folurit e tillë eks-

²¹ Që ta mënjanojmë edhe hijen e fundit të dyshimit në aspekt të trajtimit historikisht të bazuar të hebraikëve si subjekt të shtetit islam, ju përdhim në tekstin e *Kushtetutës së Medines*, të cilin vetë Muhammedi a.s. e ka hartuar në vitin 622 dhe i cili në mënyrë eksplicite ka përkufizuar statusin e hebrenjve dhe të muslimanëve, detyrimet e tyre dhe raportet e ndërsjella. T'i theksojmë nenet kyçe të Kushtetutës së Medines të cilat e rregullojnë këtë çështje dhe përfundimisht zbulojnë karakterin ideologjik të falsifikimeve historike të Bat Ye'or-it:

1. Kurdo që qëndrimet e juaja dallojnë në diçka (në raport me këtë Dokument), zgjidhjen duhet kërkuar nga Allahu dhe Muhammedi a.s.
2. Hebraikët do ta japin kontributin e tyre për luftë kur luftojnë në anën e muslimanëve besimtarë.
3. Hebraikët Beni Aufit konsiderohen të barabartë dhe i përkasin bashkësisë së njëjtë me besimtarët muslimanë. Hebrenjtë kanë fenë e tyre. Kjo vlen edhe për ish-skllëverit e tyre të cilët ata i kanë liruar. Nga kjo do të përjashtohen vetëm ata të cilët do të bëjnë vepra kriminale. Duke vepruar kështu, ata i bëjnë keq vetes dhe familjeve të tyre.

plicit i urrejtjes dhe kotësisë paranoike totalisht të mjegullt për shndërrimin e Europës në Eurabi (natyrisht që kam mëdyshje: Gurabi!?) në vend që totalisht ta injorojnë apo refuzojnë, e përkrahin edhe disa autorë, të cilët paraprakisht kanë dhënë dëshmi të mjaftueshme për kapacitetet dhe paanësinë e tyre shkencore. Kështu për shembull, Melanie Phillips, Daniel Pipes, Niall Ferguson, e vlerësojnë Bat Ye'or-in si një lloj heroi të shpërfillur, të heshtur, me shkaqe jobindëse të *korrektësisë politike*. Në qarqet e Torëve dhe përgjithësisht në të djathtën, veprat e saj rekomandohen veçanërisht si lexime për rininë. Është interesante se këta dhe të gjithë autorët e tjerë, pa marrë parasysh gradat dhe kualifikimet e tyre, të cilët përndryshe janë jashtëzakonisht të ndjeshëm për çdo notë antisemitiste, qoftë edhe më diskrete, mbeten plotësisht të heshtur në këtë murmurimë të këtyllë mirëfilli anti-islame, e cila të gjithë muslimanët pa dallim i shpall për gjarpërinj helmues, kështu që është krejt e arsyeshme të shtrohet pyetja, se cilat janë motivet që Bat Ye'or-i dhe bashkëmendimtarët e saj, të trajtohen si njerëz të cilët kanë për të thënë diçka dhe të cilët e dinë ç'flasin!? Megjithatë, falë autorëve tashmë të theksuar të cilët publikisht e kanë demaskuar Bat Ye'or-in dhe projektin e saj shovinist të bazuar mbi falsifikime dhe konstruksionet e saj kuazi-teorike, kjo fushatë më e re fetare dhe etnike mbi muslimanët dhe arabët e ka humbur momentumin e saj në opinion, ndërsa në qarqet akademike është refuzuar në tërësi. Vlerësimin e tillë dhe argumentet e saj themelore, shkëlqyeshëm, i përmbledhin argumentet vijuese të Mathew Carr-it: “Që të pranohen tezat qesharake të Bat Ye'or-it, duhet besuar jo vetëm në ployën e orkestruar islame të orientuar në copëtimin e Europës, në të cilën do të duhej medoemos të jenë të përfshira të gjitha qeveritë arabe, pa marrë parasysh a janë islame apo jo, por gjithashtu të

besohet edhe në trupin e fshehtë dhe të pazgjedhur parlamentar, i cili ka aftësi të pabesueshme t'i transformojë të gjitha institucionet kryesore europiane politike, ekonomike dhe kulturore në instrumentin nënshtrues në duart e 'xhihadit', e që për këtë asnjë institucion mediatik apo legalisht i përzgjedhur nuk kanë kurrfarë të dhënash. Në asnjë hollësi të tij ky interpretim i motivuar ideologjikisht i marrëdhënieve euro-arabe i Bat Ye'or-it nuk i është përqsuar as përafërsisht ta dëshmojë 'historinë sekrete', për të cilën është zotuar se do ta zbulojë."²²

Faktet janë të qarta dhe të padiskutueshme: Islami dhe muslimanët kanë rol të madh dhe thelbësor në ndërtimin e identitetit europian dhe këtë në të gjitha aspektet e tij. Është e mirënjohur që Europa e ka krijuar identitetin e saj në mënyrë mjaft konvulsive. Betejat e rrepta, luftërat ndërmjet disa shteteve të cilat kanë zgjatur me dekada, nganjëherë edhe më gjatë se njëqind vjet²³, revoltat dhe kryengritjet, konfliktet e përgjakura fetare të katolikëve dhe protestantëve, katolikëve dhe ortodoksëve, sidomos të rrepta dhe të gjata në rastin e Polonisë e Rusisë, e kanë tronditur ndjeshëm nga brenda pjesën kristiane të Europës më gjatë dhe me pasoja të rënda, të matura me jetë njerëzish dhe rrëtime, sesa të gjitha konfliktet në të cilat Europa kristiane ka luftuar kundër Europës islame. Në këtë kuptim, gjithsesi duhet theksuar të dhënat befasese, thuajse të

²² Mattyew Carr, (2006). You are now entering Eurabia". *Race&Class*, f. 48.

"In order to accept Bat Ye'or ridiculous thesis, it is necessary to believe not only in the existence of a concerted Islamic plot to subjugate Europe, involving all Arab governments, wether 'Islamic' or not, but also to credit a secret and unelected parliamentary body with the astounding ability to transformo all Europe's major political, economic and cultural institutions into subvrient instruments of 'jihad' without any of the continent's press or elected institutions being aware of it. Nowhere in this ideologically griven interpreton of European-Arab relations does Bat Ye'or come to proving the 'secret history' that she professes to reveal."

²³ E ashtuquajtura "Lufta njëqindvjeçare", të cilin e ka zhvilluar Anglia dhe Franca, në fakt ka zgjatur plot 114 vjet.

pabesueshme por tërësisht të sakta, se konfliktet dhe armiqësitë ndërfitare në truallin e Europës (si brenda kristianizmit, ashtu edhe në suaza të Islamit), si temë e veçantë janë mënjanuar në tërësi apo janë minimizuar në doracakët bashkëkohorë shkollorë, njësoj si edhe në studimet shkencore, dhe kjo deri në atë masë sa shpjegimi për të gjitha luftërat e Europës kristiane feudale jepet përjashtimisht nëpërmjet prizmit të luftërave për territore dhe dominim politik!? Për çështjen se në historinë e re të Europës pikërisht motivet fetare kanë përbërë më shumë se motivin qendror të armiqësive të papajtueshme dhe masakrave të mëdha (luftërat e papëve kundër sunduesve jo fort të dëgjueshëm, të katolikëve kundër protestantëve, të katolikëve kundër ortodoksëve, përndjekjet e pamëshirshme të kristianëve heretikë etj.) gati se edhe nuk flitet, ndërsa njëkohësisht mjaft pak vëmendje i përkushtohet vargut të rasteve, në të cilat kristianët dhe muslimanët bashkërisht kanë luftuar kundër kristianëve, përkatësisht kundër muslimanëve!

Nga ana tjetër, gjithashtu në mënyrë sistematike injorohet historia e gjatë e paqes dhe praktika intensive e bashkëpunimit të Europës islame dhe kristiane. Mungojnë studimet të cilat do të përfshinin evidentimin empirik dhe materialin arkivor praktikisht krejtësisht të pahulumtuar por shumë të pasur, i cili në mënyrë të dokumentuar dëshmon faktin se Europa identitetin e saj filozofik, shpirtëror, shkencor, artistik, ekonomik dhe politik e ka ndërtuar mbizotërueshëm nëpërmjet ndërveprimit intensiv të faktorit islam dhe kristian në realitetin vetjak demografik, pra, me bashkëpunim të të gjithë popujve të saj europianë, si muslimanë ashtu edhe kristianë. Mohimi i këtyre fakteve domethënë vendosja e padijes mbi dijen, trillimit mbi faktet, gënjeshtërs mbi të vërtetën. E meqë padija në parim është arrogante, fikSION patologjik, kurse gënjeshtër destruktive, mohimi

i organizuar dhe i vetëdijshëm i identitetit islam të Europës, domethënë edhe angazhimi i drejtpërdrejtë për konflikt irracional fetar. Sikurse edhe ai i pari, i frymëzuar me ideologjinë e urrejtjes, edhe ky do të ishte rimarrja e të gjitha veprimeve të fanatizmit fetar, përjashtimit zelotian (fanatik) dhe racizmit, i cili është vazhdë joislame dhe anti-islame e identitetit evropian, që tashmë është demonstruar me virtuozeitetin e kobshëm nëpërmjet serisë së tragjediave njerëzore dhe avarive morale, siç kanë qenë luftërat kryqtare, inkuizicioni, përndjekja totale e muslimanëve dhe hebrenjve nga vatrat e tyre shekullore në gadishullin iberik sikurse edhe nga ishujt më të mëdhenj mesdhetarë, nga të cilët disa, sikurse ai në Sicili, përfaqësojnë rastet klasike të gjenocidit total, kryqëzimit të dhunshëm, deportimeve, kampeve të përqendrimit, dhomave të gazit, holokaustit!

Të jesh mbrojtës përballë një kërcënimi të tillë të shumtë, nuk qenka as e urtë, as pragmatike! Në vend të kësaj duhet edhe më tej të bëhen përpjekje për të bindur qarqet anti-islame të opinionit, shkencës dhe politikës europiane, se edhe *muslimanët kanë dhënë kontributin e tyre për Europën, dhe se së këndejmi edhe Islami është pjesë e historisë europiane*, t'u parashtrahet qartë atyre fakti se Islami dhe muslimanët nuk janë kurrfarë shfaqjeje kontingjente, as rastësore, aq më pak "trup i huaj" në indin e identitetit evropian kulturor! Kur flitet për identitetin e Europës përbri përmendjes së Islamit nuk duhet të vendos kurrfarë "por", e cila Islamin do ta inkuadrojë në Europë si ndonjë shtojcë (e të tjera), sepse muslimanët nuk janë kurrfarë shtojcë në Europë, por pjesë e saj imanente, faktor integral i identitetit evropian. Historia e Europës është pluraliste në mënyrë të theksuar, por edhe fuqishëm kohezive dhe inkluzive! Shekujt e luftërave, trazirave dhe armiqësive gati të vazhdueshme, në të njëjtën kohë kanë zhvilluar dhe kultivuar në vazhdi-

mësi një ndjenjë të fuqishme për vlerat e kompromisit dhe bashkëpunimit! Në një histori të tillë, në të cilën edhe kristianizmi, edhe Islami, edhe hebraizmi shkallë-shkallë i kanë gjetur pasuesit e tyre, duke u zgjeruar në kontinentin i cili ishte i ri për të tri fetë, edhe kristianët, edhe muslimanët, edhe hebrejtë, në periudhën e parë kanë qenë njëkohësisht edhe ardhacakë edhe nikoqirë në truallin e Europës! Asnjëra nga këto tri fe dhe tradita të mëdha kulturore, pas gjithë këtyre shekujve të mbijetimit të përbashkët në Europë, nuk ka kurrfarë nevoje, sikurse përndryshe, nuk ka as të drejtë, që sot nga të tjerët të kërkojë diçka, as që t'ju përcaktojë kushtet, shkallët dhe nivelet e integritimit, e edhe më pak të asimilimit! Të rinjtë europianë sot, sikurse edhe brezat e ardhshëm të qytetarëve europianë, duhet të dinë të vërtetën për të kaluarën dhe identitetin shpirtëror të kontinentit të vet dhe të jenë barabar krenarë për kontributin e të gjithë të parëve të tyre legjitimë, të cilët e kanë përcaktuar fizionominë dhe e kanë ndërtuar identitetin e Europës bashkëkohore – kristianë, muslimanë, hebrej dhe të gjithë të tjerëve. Sepse kjo e vërtetë është kapitali më i madh i Europës, themel i emrit dhe autoritetit të saj, ajo është zotimi i saj më i vlefshëm për afirmimin global të humanizmit, drejtësisë dhe së vërtetës!

II. EUROPIANËT MUSLIMANË: TREGUESIT DEMOGRAFIKË

II.1. E tash, të shohim faktet: Popullata islame e Europës

Numri i muslimanëve në vendet e BE, dhe më gjerë, gjatë disa dekadave të fundit nuk është më vetëm çështje demografike. Për këtë temë gjithnjë e më shpesh organizohen debate publike të përqendruara në aspektet shprehimisht të theksuara ideologjike dhe politike siç janë: verifikimi kritik i politikës imigruese me qëllim pengimin e rritjes së mëtejshme të popullatës muslimane në Europë, çështja e rritjes së kriminalitetit dhe sigurisë së qytetarëve lidhur me praninë e rritur të muslimanëve në Europë, deri te çështjet bazore teorike të identitetit kulturor, terrorizmit, moralit publik, xhihadit ... Se këto polemika nuk janë vetëm ballafaqim i mendimeve të ndryshme, por japin edhe rezultatet e veta të (pa)dëshiruara tregon edhe masakra masive e korrikut, të cilën e kreu qytetari norvegjez Anders Behring Breivik, si thotë vetë në Manifestin e tij (?): "... që në këtë mënyrë ta tërheq vëmendjen e qytetarëve të mi mbi rreziqet e imigrimit të pakontrulluar musliman." Fakti që vetë Breiviku brenda gjysmë ore ka vrarë shumë qytetarë të tij, sesa kanë vdekur europianë jo-muslimanë nga të gjithë 20 milionët e emigrantëve muslimanë gjatë katër dekadave të fundit (!!), vetvetiu tingëllon jo vetëm i pabesueshëm, por edhe tërë rrëfimin për rreziqet nga imigrimi musliman në vendet e BE e shndërron në flluskë sapuni ideologjike. Megjithatë, bëhet ankand publik me parashikimin e ardhjes së një numri sa më të madh të muslimanëve në një periudhë sa më të shkurtër, me *islamizimin përfundimtar të Europës Perëndimore*, si pasojë e tij e skaj-

shme, edhe më tej paraqet një rën nga top temat e mediave massive të frymëzuara anti-islame në shumë shtete të Europës!

Numri i saktë i muslimanëve në të gjitha shtetet e Europës (anëtare të BE, si edhe vendet që nuk janë, duke e llogaritur edhe Turqinë, edhe Rusinë të cilat janë si transkontinentale, ashtu dhe njëkohësisht edhe vende evropiane, edhe aziatike), nuk është vërtetuar saktësisht. Në vlerësimet demografike është e zakonshme që në mënyrë të veçantë të ceket numri, respektivisht përqindja e muslimanëve në vendet e BE, në shtetet evropiane që nuk janë anëtare të kësaj organizate. Vlerësimi zyrtar i vitit 2007 sugjeron numrin prej rreth 53 milionë, apo afër 11% qytetarë muslimanë, prej të cilëve 16-18 milionë në shtetet anëtare të BE, ndërsa ky numër është në rritje të përhershme dhe sipas projekteve të burimeve të njëjta, në vitin 2011 numri ka qenë sigurisht rreth 55 milionë.²⁴ Nëse këtij regjistri i shtojmë edhe Azerbejxhanin, Bellorusinë, Jermaninë, Rusinë, Turqinë dhe Ukrainën, shtete evropiane që nuk janë anëtare të BE, shtete në të cilat jetojnë rreth 100 milionë muslimanë, atëherë në të gjitha vendet e Europës sot jetojnë rreth 155 milionë muslimanë, nga të cilët ka më së shumti rreth 20 milionë (15%) emigrantë, që kanë ardhur në Europë gjatë 50 viteve të fundit, ndërsa 135 milionë të tjerë apo 85%, janë muslimanë autoktonë të Europës, me traditë islame të gjatë 400 deri 1300 vjet. Duhet pasur parasysh se në shtetet evropiane, sikurse janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Azerbejxhani, përqindja e muslimanëve lëviz prej 70 %, në 50%, 92% deri 99%. Ndërsa në pjesën evropiane të shtetit transkontinental të Turqisë, kjo përqindje është gjithashtu rreth 99%. Që të kuptohet domethënia e vërtetë e të dhënës për traditën islame në Europë, gjithashtu duhet përmendur fakti se tradita e kristianizmit në pje-

²⁴ Arkivi i Institutit Qendror Islam në Gjermani, viti 2007.

sën më të madhe të Europës është e gjatë rreth një mijë vjet, pra gjithsej tre shekuj më e shkurtër nga prania më e hershme e vazhdueshme e pranisë islame në Europë!!

Gjatë viteve të gjashtëdhjeta të shekullit XX, si nevojë teknologjike dhe si përkrahje për zhvillimin më të shpejtë të prodhimit, paraqitet emigrimi i parë më i rëndësishëm i punëtorëve nga vendet islame, para së gjithash nga Turqia dhe shtetet veriore-afrikane, Algjeria dhe Maroku. Edhe pse ky proces ka filluar në mënyrë të paorganizuar, sporadike dhe me ardhje individuale (kështu në vitin 1967 në Gjermani, sipas të dhënave zyrtare, ende kishte më pak se 7.000 punëtorë nga Turqia), shumë shpejt u rrit në mënyrë të organizuar me përmasa të mëdha, juridikisht i rregulluar dhe i përkrahur me nismë të fuqishme politike. Është hapur mundësia e azilit ekonomik të punëtorëve, është rregulluar në mënyrë ligjore e drejta për ardhje dhe qëndrim të përhershëm të familjeve të tyre në vendet në të cilat kanë qenë legalisht të punësuar, që, krahas punës së siguruar, lehtësive sociale dhe fitimeve ndjeshëm më të mëdha nga ato mesatare në vendet nga të cilat punëtorët kanë ardhur, në një periudhë shumë të shkurtër nga vetëm disa vjetësh, e ka përsheptuar ndjeshëm dhe në përmasa të mëdha e ka rritur numrin e *punëtorëve mysafirë* në Europë. Në fillim të këtij projekti, faktorët përgjegjës në vendet e Europës Perëndimore, kujdesin e tyre për përbërjen e punëtorëve emigrantë, e kanë rrëguar kryesisht në përkatësinë e tyre racore dhe etnike²⁵, që, krahas faktit se BE nuk mban statistikë zyrtare për përkatësinë fetare, relativisht me vonesë ka tërhequr vëmendjen te fakti se punëtorët emigrantë me shumicë janë muslimanë. Kjo ka sjellë deri te përqendrimi sistematik në strukturën nacionale

²⁵ Ceri Peach, profesor i gjeografisë sociale, report 2007, Center for Strategic and International Studies (CSIS).

të emigrantëve, sidomos gjatë dekadës së parë të shekullit XXI, kurse në qershor të vitit 2009 është komunikuar që në vendet e BE punojnë dhe qëndrojnë 18.5 milionë emigrantë nga vendet jashtë BE, krahas vlerësimit për 8 milionë shtesë, të cilët qëndrojnë ilegalisht, respektivisht të paparaqitur²⁶ edhe pse numri i saktë i muslimanëve edhe më tej ka mbetur statistikisht i pakonfirmuar. Në raport me përqindjen e muslimanëve në vendet e BE, burimet me peshë vlerësojnë se në Francë jetojnë diç më shumë se 8%, në Holandë 6%, në Gjermani pak më shumë se 4%, dhe në Mbretërinë e Bashkuar 3%, e ndërkaq në qytetet më të mëdha të BE, përqindja e muslimanëve lëviz rreth 20% të lartë.²⁷ Popullsia e përgjithshme e muslimanëve emigrantë në vendet e BE vlerësohet në 20 deri 23 milionë, krahas vërejtjes se ky numër mund të rritet ndjeshëm në dekadat që vijnë, si për shkak të ardhjes së mëtejme të emigrantëve nga vendet islame, ashtu edhe për shkak të shkallës së tyre shumë më të lartë të lindshmërisë në raport me shkallën e rritjes demografike në vendet e BE. Megjithatë, duhet pasur parasysh paralajmërimi i CSIS se praktikisht të gjitha vlerësimet e popullsisë muslimane në BE janë lartë të paqëndrueshme, e për këtë arsye duhet t'i marrin me rezervë të shtuar, sidomos nga shkak i faktit se shpejtësia e rritjes reale të popullsisë muslimane në vendet e BE, të cilat disponojnë me të dhëna të sakta, është shumë më e vogël se parashikimet të cilat mbështeten vetëm në tepriçën e pritur të emigrimit të muslimanëve dhe shkallën e tanishme të lindshmërisë së tyre. Gjithashtu, britmat gjithnjë e më të shpeshta për rrezikun e çrregullimit dramatik të statusit demografik të Europës, ku do të sillte pranimi i Turqisë në BE, e me këtë edhe ardhja e 75 milionë muslimanëve të rinj, kanë vetëm funksion

²⁶ The European Union's June 2009 Strategy Report on Immigration.

²⁷ Brookings Study 2008.

ideologjik, sepse është e qartë që BE, e cila këtë vendim e shtyn tashmë prej më gjatë se 40 vjetësh, sot është më larg nga marrja pozitive e vendimit sesa ka qenë ndonjëherë më parë.

II.2. Projektionet statistikore të lëvizjeve demografike të muslimanëve europianë

Nga pikëpamja e parashikimit të lëvizjeve të popullatës muslimane në Europë, është e lehtë të vërehet se ato ndahen në dy kategori: ato të frymëzuara me ideologji të hapur anti-islame, dhe ato të bazuara objektivisht. Ndërsa disa autorë, si Don Melvin, parashikojnë se popullata muslimane në Europë do të dyfishohet deri në vitin 2020, nëse përjashtohet Rusia, duke u mbështetur në informacionin (statistikisht të joargumentuar) se emigracioni ka qenë faktor madje i 85% të rritjes së përgjithshme të popullsisë së përgjithshme të Europës në vitin 2005.²⁸ Projektionet e tjera paralajmërojnë se popullata muslimane do të dyfishohet tashmë që në vitin 2015, ndërsa njëkohësisht popullata jo-muslimane e Europës numerikisht do të zbrësë me ritëm prej 2-3%.²⁹ E njohur sipas projeksioneve të saj alarmuese, Ester Pan vlerëson se në vitin 2050 muslimanët në vendet e BE do ta arrijë numrin prej 100 milionësh, që do të thotë se atëherë një në çdo pesë banorë të Europës do të jetë musliman.³⁰ Profesori Filip Xhenkins nga Universiteti Pen Stejt, llogarit se në vitin 2100 muslimanët do të përbëjnë 25% të popullsisë së përgjithshme të Europës, edhe

²⁸ Don Melvin, "Europe Works to assimilate Muslims", *Atlantia Journal Constitution*. 2004 -12-17

²⁹ Tolerance and and Fear Collide in the Netherland, *UNHCR Refugees Magazine*, issue 135.

³⁰ Esther Pan, *Europe: Integrating Islam*, Council on Foreign Relations 2005-07-13

pse me rezervë të caktuar për shkak të natalitetit të lartë të emigrantëve kristianë.³¹

Projeksionet e lëvizjeve të ardhshme demografike të europianëve të ndara sipas përkatësisë fetare, respektivisht kulturore, në kristianë dhe muslimanë, dallohen ndjeshëm. Në disa pjesë të Europës me shumicë kristiane por edhe me përqindje të madhe të popullsisë islame, frika nga steriliteti vetjak kulturor dhe ndjenja e inferioritetit ndaj muslimanëve, shpesh ka shpërthyer si frikë nga lindshmëria e lartë e muslimanëve dhe rreziqet e lidhura me këtë, saqë pasqyra demografike të përmbysset plotësisht dhe që muslimanët të bëhen faktori shumicë. Nga kjo pikëpamje, irracionaliteti i këtyre shqetësimeve ka gjetur strehë në vlerësimet totalisht joreale jo vetëm të lindshmërisë së vërtetë, por edhe të asaj të mundshme teorikisht të rritjes të llojit njerëzor! Nuk është e rastit që edhe vetë Oriana Fallaçi, e vetëdijshme për ekzagjerimin e këtyre vlerësimeve statistikore alarmuese, duke folur për muslimanët ka dalur jashtë suazave të antropologjisë dhe ka konstatuar se *muslimanët pjellin si minjtë*. Ndërkaq, Oriana Fallaçi nuk ka qenë as e para as e fundit, që e ka përdorur këtë krahasim të muslimanëve me minjtë. Pos që implikon, e madje edhe drejtpërdrejt bën thirrje për *deratizim*, pra për shkatërrimin total të muslimanëve si dëmtues, ky formulim është në qarkullim qysh nga koha e mbretit të Spanjës Filipit III, pra prej fundit të shekullit XVI, dhe njëkohësisht përbën një shprehje idiomatike standarde edhe në qarqet bashkëkohore anti-islame të Europës. Dhe ashtu si disa këshilltarë të Filipit III kanë propozuar tredhjen totale të meshkujve *moriskos*, si muslimanë të fshehtë, ashtu edhe shumë anti-islamistë të RSF të Jugosllavisë në vitet e tetëdhjeta të she-

³¹ Phillip Jenkins, "Demographics, Religion, and the Future of Europe", *Orbis: A Journal of World Affairs*, vol. 50, no. 3, summer 2006

kullit të kaluar, kanë kërkuar publikisht që muslimanëve, sidomos shqiptarëve, t'u ndalohet lindja në spitalet shtetërore të rezervuara për kristianë. Duke e marrë parasysh se atëherë të gjitha institucionet shëndetësore kanë qenë shtetërore, kjo donte të thoshte drejtpërdrejt një kërkesë që muslimanët (për të cilët në tekstet anonime në faqet e shtypit të atëhershëm përkrahësit e kësaj nisme gjithashtu kanë përdorur shprehjen që *pjellin si minjtë*) të lindin jashtë RSF të Jugosllavisë, jashtë vendit, dhe që muslimanëve të porsalindur, mbi këtë bazë, t'u mohohet e drejta për shtetësi! Autori i këtyre rreshtave modestë, personalisht ka kaluar disa vjet interesantë duke polemizuar në mediat publike me këta neo-fashistë anti-islamë, bashkëmendimtarë të nazi-doktorit famëkeq Jozef Mengele, të shndërruar si humanistë të orientimit socialist!

Se njohja e demografisë është përballur joesencialisht me arsyen të ngarkuar me urrejtje, dhe se të gjitha faktet janë plotësisht irrelevante për logjikën e stereotipave negativë të mendimit, e konfirmon harmonia e pabesueshme e vlerësimeve të stërtheksuara të lindshmërisë së muslimanëve në Spanjën e shekullit XVI dhe RSF të Jugosllavisë së shekullit XX. Imazhi që i është paraqitur Filipit III ka sugjeruar që në Spanjë pasardhësit e muslimanëve të kristianizuar me dhunë, kripto-katolikët *morisko*, për më pak se 50 vjet do të mund të barazoheshin me *katolikët gjakpastër*. Kjo do të thoshte që në periudhën e cekur prej 50 vjetësh 350.000 njerëzit e një grupi, me lindshmërinë e tyre do të mund ta rrisnin numrin e përgjithshëm prej përtej 12 milionësh të grupit tjetër!? E është qartas krejt e pamundur, përveç nëse nuk kihet parasysh se në njërin grup fjala është për muslimanët, të cilët *pjellin si minjtë*, deri sa në rastin tjetër fjala është për njerëzit, numri i të cilëve rregullohet me ritmin e lindjeve normale njerëzore!! Gjithashtu, në polemikën

publike në mediat e RSF të Jugosllavisë së atëhershme, kundër lindshmërisë alarmante të lartë dhe të planifikuar të muslimanëve, të cilët dëshirojnë që numerikisht të tejkalojnë popullsinë kristiane dhe që me këtë revolucion numerik të përvetësojnë territore në të cilat, tash për tash jeton popullsia shumicë kristiane, pohohej se numri i shqiptarëve vetëm nga Kosova, deri në vitin 2025 (nga viti 1985, pra po ashtu për 50 vjet) nga 1.7 milionë të atëhershëm do të arrijë dhe kalojë numrin prej 15 milionë!? Nëse nuk ndërmerret diçka dhe nëse muslimanët lejohen të pjellin si minjtë. Edhe pse, pos orvatjes së pasuksesshme të pushtetit serb që të përndiqeshin me forcë nga Kosova, dhe agresionit mbi Kosovën nga viti 1999-2000, nuk është ndërmarrë asgjë rreth çështjes së lindshmërisë së shqiptarëve, numri i tyre sot, në vitin 2012, d.m.th. 27 vjet më vonë, në Kosovë ende është rreth numrit prej rreth 1.7 deri 1.8 milionë, mjaft larg prej 3 milionëve, e krejt i paimagjinueshëm larg nga numri prej 15 milionësh, me të cilin klero-nacionalistët ekstremë i kanë frikësuar albanofobët dhe kanë nxitur kundër kosovarëve dhe të gjithë muslimanëve të tjerë! Edhe sot statistikat botërore, përkatësisht europiane demonstrojnë dallime të mëdha në vlerësime, duke konfirmuar, në këtë mënyrë, një nivel të lartë të nënshtrimit ndaj presioneve ideologjike. Ato djathtiste, antiislame e stërmadhojnë dukshëm tendencën e rritjes së europianëve muslimanë dhe rënien e numrit të europianëve kristianë, me synim që të sugjerojnë nevojën për masa, të cilat do ta ndalojnë një tendencë të tillë apo do ta zbusin thelbësisht.³² Ata më të kthjellët dhe ajo që ka rëndësi të veçantë, hulumtuesit më të pavarur, në bazë të hulumtimeve të tyre cekin të dhëna drejt-

³² Kështu Pew Forum Study, e publikuar në Janar 2011, parashikon në 20 vitet e ardhshme rritjen e numrit të muslimanëve të Evropës për rreth 35%, nga tash 6% e deri në 8% nga popullsia e përgjithshme e Evropës.

përdrejt të kundërta me ato paraprake, që i japin përparësi parashikimeve për rënien objektive të fertilitetit/lindshmërisë së muslimanëve evropianë dhe tregojnë tendencën e rritjes së lehtë të fertilitetit/lindshmërisë së kristianëve evropianë, me projeksionet të cilat janë larg nga ato alarmante. Këtë largësi skeptike ndaj parashikimeve për rritjen e shpejtë të numrit të muslimanëve në botë dhe në Europë, e kanë argumentuar me të dhënat të cilat sugjerojnë rënien e fortë në rritjen natyrore të muslimanëve dhe madje paralajmërojnë rritje të lehtë të lindshmërisë së banorëve jo-muslimanë të Europës.³³ Një varg i tërë hulumtimesh demografike dhe statistikore të kryera në Europë ndërmjet vitit 2007 dhe 2011, vijnë deri te rezultate, të cilat konfirmojnë qëndrimin në vend apo rënien e lindshmërisë të të gjitha grupet kulturore dhe fetare të Europës, duke përfshirë muslimanët si ata autoktonë, ashtu edhe ata emigrantë. Disa nga këto hulumtime, të planifikuara me kujdes që t'i verifikojnë vizionet alarmante dhe skenarët me panik të motivuara ideologjikisht nën ndikimin e të cilave ka rënë Bat Ye'or-i, kurse siç kemi parë, i kanë pranuar edhe disa hulumtues të famshëm, sipas të gjitha gjasave sionistë të mbuluar dhe anti-islamistë latentë, qysh në titull polemizojnë me pohimet e saj të privuara nga të gjitha argumentet, duke treguar paqëndrueshmërinë totale të rrëfimit të fabrikuar me makth mbi Eurabinë.³⁴

³³ Studimi i pavarur statistiko-demografik i grupit të hulumtuesve PEW (2010) tregon në tendencën e rënies së natalitetit ndër evropianët muslimanë, duke prognozuar rënie të mëtejme nga 2.2 promilë të tanishëm në më pak se 2.0 promilë në vitin 2030, krahas rritjes paralele të natalitetit të evropianëve jo-muslimanë nga 1.5 promilë të tanishëm në 1.8 në vitin 2030.

³⁴ T'i cekim disa nga këto hulumtime të cilat kanë nxitur vëmendje sidomos të theksuar mediatike: Mary Mederios Kent, Do Muslims have more children than other women in western Europe?, *Population Reference Bureau*, February 2008, Simon Kuper, Head count belies vision of 'Eurabia', *Financial Times*, 19 August 2007, Doug Saunders, The 'Eurabia' myth deserves a debunking, *The Globe and Mail*, 20 September 2008, Islam and demography: A waxing crescent, *The*

II.3. Emigracioni, integrimi, asimilimi, tëhuajësimi i europianëve muslimanë

Prania e europianëve muslimanë gjithnjë i ka shqetësuar europianët jo-muslimanë, sidomos kristianët; ndjenja për posedim është tejet e fortë te të gjithë njerëzit, por askund aq sa tek europianët, të cilët, meqë edhe vetë të ndërfutur (imponuar), nuk kanë zhvilluar instinkt posaçërisht të rafinuar për mbrojtjen e asaj që e kanë përvetësuar pa të drejtë. Kontrolli dhe kufizimi i numrit të muslimanëve në këtë kontinent janë bërë tema qendrore sidomos gjatë disa viteve të fundit, në fillim të krizës ekonomike, si një prej mënyrave që BE të çlirohet nga po ata njerëz, të cilët e kanë ndihmuar thelbësisht përparimin ekonomik të Europës në periudhën e emigrimit intensiv të punëtorëve muslimanë, ndërmjet vitit 1970-2000, të cilët tash shpallen si një lloj kërcënimi për qytetërimin europian. Kjo nismë e skajshme e turpshme e disa qendrave të caktuara ekonomike të BE, fshihet pas strukturave ekstreme djathtiste, neo-naziste dhe sioniste, të frymëzuara me ideologji shoviniste dhe anti-islame, me ç'rast janë përdorur të gjitha pretekstet e mundshme, nga terrorizimi islam deri te projekti i Eurabisë, me qëllim të qartë që të satanizohen muslimanët dhe të fshihet mungesa e çfarëdo shkaku të vlefshëm për një veprim të këtillë.

Ngjarjet jomjaft të ndriçuara në New York më 11 Shtator 2001, e motivojnë aksionin global të forcave udhëheqëse botërore dhe europiane, të quajtur *Luftë kundër terrorizmit islam*. Projekti i cili përfshin edhe ndërhyrjen ushtarake deri te push-

Economist, 27 January 2011; për natalitetin e muslimanëve jashtë Evropës shih: Farzaneh Rouzhdhi-Fahimi and Mary Mederios Kent, Fertility Declining in the Middle East and North Africa, prb.org, April 2008, sikurse edhe: Farzaneh Rouzhdhi-Fahimi and Mohammad Jalal Abbasi Shavazi, UN. org, *Recent changes and the future of fertility in Iran*.

timi i plotë, i drejtuar rigorozisht kundër vendeve muslimane si synime të vetme, mediatikisht është përkrahur fuqishëm me përhapjen sistematike të islamofobisë, madje edhe krimi i përmasave të tilla siç është vrasja gjakftohtë e mbi 80 njerëzve të rinj në Oslo, tentohet të *shpjegohet* me atë që vrasësi Anders Behring Breivik, *me këtë akt ka synuar të paralajmërojë rrezikun nga islamizimi gjithnjë e më i madh i Europës Perëndimore* (??); nëse kësaj i shtojmë edhe vlerësimet eksplicite për *mossuksesin e projektit të Europës multikulturore dhe multifetare*, të orkestruar dhe njëkohësisht të vendosur nga krerët e vendeve anëtare udhëheqëse të BE, siç janë Britania, Gjermania dhe Franca, atëherë bëhet shumë më e qartë fushata gjithnjë e më e zhurmshme e cila ngrihet në tërë Europën, sidomos në vendet anëtare të BE, kundër muslimanëve emigrantë, si dhe kërkesat për integrimin, asimilimin e edhe përndjekjen e tyre, bëhet shumë më e qartë ndërsa motivet e saj më të kuptueshme!

Megjithatë, sado qoftë të shprehura zëshëm, këto qëndri-me ekstremisht armiqësore ndaj muslimanëve, në asnjë rast nuk janë të vetmet të cilat mund të hasen dhe dëgjohen në të gjitha nivelet në media dhe debatet publike në BE. Vlerësimet më të matura i qasen pranisë së numrit relativisht të madh të emigrantëve muslimanë në vendet e BE në mënyrë më të matur, krahas thirrjes për analiza dhe raporte të shumta, dhe shfrytëzimit të evidencës empirike të pasur dhe të llojllojshme, por megjithatë, pa përjashtim, e trajtojnë si *problem shoqëror serioz*. Edhe kjo duhet shënuar! Me fjalë të tjera, europianët emigrantë muslimanë shikohen si një problem i brendshëm i europianëve jo-muslimanë, *të cilin ata duhet ta zgjidhin praktikisht pa konsultimin me muslimanët*. Qysh në vetë startin, europianët muslimanë janë trajtuar nga ana e europianëve jo-muslimanë si problem i një trupi të huaj, jo si problem për tërë BE apo anëta-

rët e saj individualë! Në njëerën anë jeni ju muslimanët, në anën tjetër jemi ne jo-muslimanët. Ju jeni *atje*. Ne jemi *këtu*. Ne jemi epiqendra e perspektivës dhe qendra e cila vendos! Pra, së pari duhet kuptuar dredhia: ju muslimanët dhe ne jo-muslimanët nuk jemi në të njëjtën anë! Ju muslimanët tash jeni bërë problem për ne jo-muslimanët këtu në Europë, në shtëpinë tonë, në të cilën ne jemi nikoqirë kurse ju jeni mysafirë! Nuk munden mysafirët të vendosin sa dhe në çfarë kushtesh do të mbesin në shtëpinë e huaj! Për këtë vendos nikoqiri! Ne jemi të nikoqirë mikëpritës, mbase madje edhe së tepërmi mikëpritës, por për çështjen se a jemi nikoqirë nuk mund të ketë kurrfarë dileme! Ju jeni mysafirë, sado të jeni të mirë apo të këqij, por jeni mysafirë. Europa është shtëpia jonë, kurse bujtina juaj! Siç mund të shihet qartë, në këtë skenar që nga vetë fillimi, rolet janë të ndara dhe në atë mënyrë që për to nuk mund të diskutohet! Nuk ka diskutim pika që prania e numrit relativisht të madh të punëtorëve-emigrantëve muslimanë, të kuptohet integralisht, që të trajtohet si problem integral, immanent i një shteti apo tërë BE. Muslimanët emigrantë në asnjë çast as nuk janë perceptuar, as trajtuar si europianë, si qytetarë të barabartë të shteteve të BE, në të cilat punojnë me vite të tëra, madje edhe me dekada, edhe pse shumë prej tyre kanë arritur pensione të merituar, kanë shkolluar fëmijët, edhe përveç faktit se në brezin e dytë, të tretë apo madje të katërt lindin, jetojnë edhe vdesin në ato vende.

Një numër i konsiderueshëm i muslimanëve emigrantë inkuadrohen me sukses në biznes, shkollohen dhe bëjnë karriera akademike, sidomos në Francë dhe Gjermani; e megjithatë, në të gjitha vendet e BE ku ka muslimanë në numër më të madh, sidomos pikërisht në Francë dhe Gjermani, ka shenja për integrimin e tyre të pamjaftueshëm, e madje edhe për rezistencën e muslimanëve ndaj integritit, përkatësisht asimilimit. Ceken

lagjet e mbyllura, etnike dhe muslimane thuajse të getoizuara (lagjet hebraike, sikurse edhe ato kineze nuk konsiderohen kurrfarë problemi, por pikërisht emblemë e qyteteve në të cilat ekzistojnë, sillni ndër mend parullat *Visit our China Town!*), shkalla e lartë e krimit në to, thirrjet për futjen e të drejtës së sheriatit për rregullimin e marrëdhënieve të tyre të brendshme, në vend të së drejtës publike që sundon në ato shtete, veshja tradicionale, kërkesat që të hapen xhami, ruajtja e traditave dhe pikëpamjeve të tyre, ruajtja e gjuhëve të tyre amtare, sikur edhe një varg shfaqjesh të tjera më pak të rëndësishme apo krejt anësore, të cilat do të duhej të shërbenin si dëshmi që këto rezistenca ndaj integritetit dhe ruajtja këmbëngulëse e modeleve vetjake kulturore dhe vlerave tradicionale, në fakt vijnë në konflikt me vlerat tradicionale europiane, që, gjithsesi, kjo nuk mund dhe nuk bën të tolerohet. E gjithë kjo huton jo vetëm europianët muslimanë, të cilët fillojnë të ndihen, krejt pa bazë, sikur vërtet nuk kanë të drejtë ta konsiderojnë veten për europianë me të drejta të barabarta sikurse edhe europianët jo-muslimanë, por shpie në lajthitje edhe europianët jo-muslimanë të cilët po ashtu seriozisht, dhe po aq pa bazë, fillojnë të besojnë se vetëm ata janë europianë legjitimë, të cilët kanë disa të drejta më të mëdha nga europianët muslimanë, duke përfshirë edhe të drejtën të vendosin për fatin e tyre të mëtejme në truallin e Europës, pa detyrime që për këtë madje edhe të konsultohen me ta! Në rrethanat e presionit të vazhdueshëm mbi opinionin, me qëndrimin e hapur apo më të butë anti-islam, nëpërmjet të cilit Islami futet në të gjitha llojet e diskutimeve kundërthënëse, bëhet njëmend e vështirë për qytetarët e zakonshëm ta pranojnë “...këtë prani të re të muslimanëve në Europë, si faktor pozitiv” – si shkruan Tarik Ramadan nga Universiteti Oxford në punimin e tij për *Christian Science Monitor*, duke reaguuar në

referendumin e mbajtur në nëntor të vitit 2009, me të cilin në Zvicër është votuar ndalesa e ngritjes së minareve. Frika nga ndërrimi i mundshëm më i madh në përbërjen demografike të Europës në kuptim të numrit edhe më të madh të muslimanëve, sikurse edhe problemet, vështirësitë dhe rezistenca të cilën muslimanët bëjnë ndaj integritimit dhe asimilimit, janë një shtojcë tjetër, me të cilën përballen muslimanët dhe jo-muslimanët e Europës, duke i ngarkuar në masë të madhe marrëdhëniet e tyre!

Duke e pranuar në tërësi anamnezën e mosmarrëveshjeve në raportet e muslimanëve dhe jo-muslimanëve të Europës përfundimtare, sikurse edhe identifikimin e pikave neuralgjike në qasjet e tyre tepër shpesh të ballafaquara në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, në trajtimin e Tarik Ramadanit, shënojmë një lëshim, i cili, edhe pse në dukje pa ndonjë rëndësi më të madhe për tërë këtë temë, megjithatë tregon sesa fuqishëm disa lajthitje faktografike dhe falsifikime janë përvetësuar, e në nivelin racional janë absolvuar dhe janë përthithur thellë si të vërteta të padiskutueshme. Me fjalë të tjera, pjesa e parë e deklaratës së cituar të Tarik Ramadanit, i cili flet për *praninë e re të muslimanëve në Europë*, në të vërtetë vetëm lan llogaritë, të cilat qytetarëve të Europës, jo-muslimanëve, barabar si edhe muslimanëve, ua ka konstatuar praktika e gjatë me shekuj e historianëve europianë përfundimorë në shërbim të ideologjisë anti-islame, kurse ata e kanë paguar shumëfish më shtrenjtë për shkak të naivitetit të tyre dhe mungesës së distancës kritike! Sepse, sado ta themi këtë, duke e marrë parasysht të pavërtetën të rrënjësuar thellë për *praninë e re të muslimanëve në Europë*, duhet sërish ta përsërisim, se ky mashtrim nuk fshihet plotësisht nga vetëdija: prania e muslimanëve në Europë nuk është e re! Ajo është relativisht e re në *disa pjesë të Europës*, por edhe prania e anglezëve dhe francezëve, gjermanëve dhe italianëve, e

mos të flasim për praninë e rusëve dhe portugezëve, spanjollëve dhe finlandezëve, në shumë pjesë të Europës gjithashtu është relativisht krejt e re! Muslimanët në shumë pjesë të Europës janë të pranishëm shumë më gjatë sesa kristianët, madje e llogaritur edhe me shekuj të tërë, ndërsa vazhdimisht duhet pasur në mendje se edhe judaizmi, dhe kristianizmi, dhe Islami sipas prejardhjes së tyre janë thelbësisht jashtë-europianë, pra besime jo-europiane, e kështu çdonjërin prej tyre e privon pa kusht nga e drejta që ta shpallë veten për *fenë autentike, vendëse, europiane!* Pra, sipas shembullit të referendumit në Zvicër të mbajtur në nëntor të vitit 2009, si edhe në secilin referendum apo diskutim të ardhshëm për këtë temë, duhet këmbëngulur në faktin se muslimanët thjesht nuk janë kurrfarë shfaqjeje e re në Europë, por aty janë prej mbi 1300 vjetësh, pra më shumë se një mijëvjeçar i tërë, praktikisht më gjatë se të gjithë paraardhësit europianë të gjallë sot në truallin e të tri Amerikave, Australisë dhe Afrikës së Jugut. Në po këtë kontekst, fjalia me të cilën Tarik Ramadani e shpjegon turbullirën e qytetarëve të Zvicrës dhe rezultatin e referendumit për temën e minareve, do ta thekson themlësinë e vet me fakte. Kurse pasoja e saktë e diagnozës për muslimanët si faktor pozitiv në Europë si një shtesë do ta forconte, që besimi i shtrirë për praninë e re të muslimanëve në Europë, përbën një mashtrim anti-musliman dhe anti-islam ideologjikisht të fabrikuar, i cili si një shtesë ka luajtur rol negativ në përcaktimin e votuesve zviceranë, si faktor i manipulimit të vetëdijshëm dhe qëllimkeq me zgjedhjen e tyre, me qëllim kontrollimin e rezultatit përfundimtar të referendumit!!

Çdo ligjërim për integrimin e muslimanëve në Europë, të perceptuar dhe demografikisht, kulturalisht dhe fetarisht të kategorizuar si jo-europianë, pra si për integrimin e muslimanëve në botën sociale të jo-muslimanëve, të cilët, pa e lodhur

kokën, pranohen si europianët e vetëm autentikë, nga vetë fillimi përbën nënvarësinë e raporteve të tyre. Kjo pabarazi shfaqet si marrëdhënie e ngulitur, e cila thelbësisht dhe ajo që ka rëndësi të veçantë, vazhdimisht, nëse jo edhe përgjithmonë, e përcakton raportin e muslimanëve dhe jo-muslimanëve si inferioritetin e disave dhe superioritetin e të tjerëve, si e drejta njëkrahshë për nismë dhe marrjen e vendimeve për fatin e tjetrit, i cili këto vendime *de facto*, është i detyruar t'i pranojë pasivisht dhe pa vërejtje, dhe aq sa ta përkufizojë këtë raport si pabarazi thelbësore *in nuce*. Shoqëria harmonike dhe e drejtë multikulturore, multifetare nuk i qaset integritimit kulturor, etnik dhe fetar si problem të një grupi i cili për atë shoqëri është i huaj, i jashtëm, në njëfarë dore, përkohësisht dhe kushtimisht i pranuar që aty të qëndrojë, ndërsa për asimilim nuk mendohet fare, e madje as në ligjëratën hipotetike teorike. Në Malajzi popullata me shumicë muslimane nuk paraqet kurrfarë kërkesash për integrim të segmenteve kineze dhe induse, të cilët paraqetsin përqindje të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme. Kinëzët nuk qëndrojnë para kërkesës që të integrohen, pra të bëhen *më pak kinezë* sesa janë, njësoj sikurse edhe indusët, në klishtë kulturore dhe të përshpirtshme të popullatës shumicë malajase, të cilët janë muslimanë. Detyrimet e tyre qytetare janë të barabarta, por identiteti i tyre kulturor nuk e kualifikon as e skualifikon aftësinë e tyre për kryerjen e atyre detyrimeve. Në Maqedoni, një përqindje të rëndësishme të popullsisë e përbëjnë shqiptarët, por edhe aty nuk ka kurrfarë nismash për integrimin dhe asimilimin e tyre, nëse kjo do të nënkuptonte kërkesën për çfarëdo kompromisi të shqiptarëve me elementet kulturore, etnike, fetare, gjuhësore apo me ndonjë element tjetër të identitetit të tyre. Po kështu qëndrojnë gjerat edhe me bashkësitë e tjera kulturore shumë më pak të përfaqësuara në Ma-

qedoni. *Këta shembuj, ndërsa ka edhe shumë të tjerë, konfirmojnë qartë se kërkesa për integrim dhe asimilim të evropianëve muslimanë në klishetë e evropianëve kristianë, nuk ka kurrfarë arsytimi qytetërimor, moral apo politik, e madje as mbështetje pragmatike. Fjala është për rastin tipik të imponimit të supremacionit kulturor, kërkesë e cila, madje edhe sikur të pranohet nga të dyja palët me qëllimet më të mira, hap një varg problemesh dhe sjell në rrezik qysh nga mosmarrëveshjet serioze e madje deri te konflikti i hapur!*

Kur është fjala për raportet e jo-muslimanëve dhe muslimanëve në vendet e BE, jemi të ballafaquar me faktin se situata reale shoqërore është mjaft larg nga ajo ideale, e herë-herë edhe drejtpërdrejt në kundërshtim me të. Po ashtu është e qartë se ajo që vlen për të gjitha shoqëritë, sipas përkufizimit vlen edhe për BE, që në rastin konkret do të thotë se *vështrimi* objektiv dhe i paanshëm i tërë situatës në të cilën janë ndërthurur raportet muslimanët kundrejt jo-muslimanëve, të perceptuar si problem shoqëror, njëkohësisht është i domosdoshëm për të kuptuarit e këtij *problemi*, dhe se përbën hapin e parë të çdo aksioni të planifikuar mirë për konstatimin e gjendjes *ashtu si është*, si një bazë nga e cila planifikohen masat e afrimit të gjendjes *ashtu si duhet të jetë!* Duke e pasuar këtë postulat metodologjik, do t'i skicojmë momentet themelore të cilat e përcaktojnë gjendjen e muslimanëve evropianë, të trajtuar nga jo-muslimanët evropianë, si emigrantë të cilët nuk i përkasin kulturës evropiane dhe të cilët si të tillë, sidomos për shkak të numrit të tyre relativisht të madh, paraqesin problem të caktuar për ato vende të Europës, në të cilat prania më e madhe e muslimanëve është shfaqje e një date relativisht më të re. Në këtë kontekst veçojmë si kyçe aspektet vijuese të asaj që do ta përkufizojmë me formulimin:

II.4. Kërcënimet dhe sfidat e integrimit të muslimanëve emigrantë në vendet e BE

Diskriminimi ekonomik dhe segregacioni kulturor

Praktikisht të gjitha hulumtimet empirike të kushteve jetësore ekonomike dhe sociale të qytetarëve europianë në statusin e muslimanëve emigrantë në vendet e BE, kanë konstatuar dy fakte të përbashkëta, mund të thuhet, universalisht të pranishme: 1. Statusi ekonomik mesatarisht është shumë më i pafavorshëm kurse paga e muslimanëve për të njëjtat punë është më e ulët në raport me bashkëqytetarët e tyre jo-muslimanë. Muslimanët në parim janë grupi më i varfër kulturor dhe fetar në të gjitha vendet e BE, edhe pse ekzistojnë variacione të caktuara brenda kësaj kategorie. Dallimi në pagat për të njëjtën punë në raportin musliman/jo-musliman varion edhe nga shteti në shtet të anëtarëve të BE, por sipas rregullit çdo kund është më i ulët për muslimanët, kështu që me siguri mund të përfundohet se *diskriminimi ekonomik* i qytetarëve europianë në vijën e përkatësisë fetare është në dëm të muslimanëve, është fakt i pakontestueshëm dhe praktikë e përgjithshme në kufijtë e BE. Në bazë të kësaj, është vërtetuar se gjendja e pafavorshme ekonomike e popullsisë muslimane në BE, duke përfshirë vështirësitë gjatë punësimit dhe fitimin më të ulët për të njëjtën punë, ndikon thelbësisht në rritjen e tensioneve dhe vështirësive në procesin e integrimit të tyre. Hulumtuesit francezë kanë konfirmuar vlerësimin e ekspertëve se rebelimet në Paris në vitin 2005 kanë pasur shumë pak lidhje me fenë dhe shumë lidhje me problemet ekonomike dhe vështirësitë e muslimanëve gjatë punësimit. Po ashtu, rezultatet empirike pakontestueshëm tregojnë se shkalla e papunësisë ndër muslimanët e BE, jo vetëm që është më e lartë sesa ndër jo-muslimanët, por se është më e

lartë madje edhe se çdo grup tjetër etnikë jo-muslimanë i cili ka statusin e njëjtë të punëtorit emigrantë, edhe pse, me përjashtim të popullatës etnike induse, shkalla e papunësisë e grupeve etnike me *ngjyrë*, pa përjashtim është më e lartë se çdo grup tjetër etnik *i bardhë*.³⁵

Kjo praktikisht domethënë se ndër punëdhënësit e BE paragjykimet ndaj Islamit, përkatësisht, ndaj muslimanëve, janë më të fuqishme madje edhe nga paragjykimet mjaft fanatike racor.³⁶ Nga ana tjetër, tezën se rrethanat e pafavorshme ekonomike të cilat ekspozohen si forma të diskriminimit ekonomikë të muslimanëve jo vetëm në BE dhe në SHBA, pengesë e rëndësishme për integrim, tërthorazi e afirmojnë edhe rezultatet sipas të cilëve *muslimanët e klasave të mesme të ardhurat dhe arsimimi i të cilëve janë të njëjtë me nivelin e përgjithshëm shoqëror të këtyre kategorive, janë më afër integritit e madje edhe asimilimit në shoqërinë amerikane, nga shtresat e varfra të bashkësisë muslimane*.³⁷

Nga ana tjetër, qytetarët evropianë muslimanë në statusin e punëtorit emigrant, në të shumtën e rasteve jetojnë edhe në kushtet e segregacionit të theksuar urban.³⁸ Hapësira e tyre jetësore sipas rregullit është e mënjanuar apo krejt dukshëm e veçuar dhe e vendosur në lagjet më të varfra të qyteteve, me shkallë të lartë të kriminalitetit dhe me standard të infrastrukturës mjaft të ulët nga mesatarja për të njëjtat qytete. Getoizimi përndryshe është model tejet i njohur, sidomos i theksuar në SHBA, sikurse edhe në shumë qytete të Amerikës së Jugut, si dhe

³⁵ Unemployment Statistics in Britain for 2004.

³⁶ Report from Quillian Foundation 2009.

³⁷ PEW poll, 2007.

³⁸ Përqindja e muslimanëve evropianë me statusin e punëtorëve emigrantë, pa marrë parasysh në prejardhjen etnike, kulturore dhe racore, të cilët jetojnë në një lloj getoizimi, kalon 92%. Shih: 2007 Report from the Centre for European Policy Studies.

të Republikës Jugoafrikane, me ndryshimin që atje parimisht është në pyetje parimi i segregacionit racor, ndërsa në vendet e BE theksi është vënë në diskriminimin fetar. Edhe në njërin edhe në tjetrin rast, fjala është për getoizimin tipik, i cili frymëzohet me motivet e mostolerancës kulturore, racore dhe fetare, që të mos përdorim fjalë më të forta! Getoizimi i qytetarëve më të varfër, i cili është e lidhur drejtpërdrejt me një më shumë apo me të tria bazat e mostolerancës dhe diskriminimit, funksionon në logjikën e vetizolimit dhe vetëshkatërrimit të tyre të përpunuar në Detroit, si shembull klasik. Veprimi në bazë është i thjeshtë, kurse nga kapja e shtrëngimit të lakut rreth qafës vetjake është paramenduar sa është e mundur vetëm dalje individuale dhe këtë në raste të rralla dhe në rrethana përjashtuese, ndërsa për bashkësinë e getoizuar në tërësi, realisht nuk ka shpëtim!

Jeta e të varfërve është sikurse uji: rrjedh teposhtë! Sikurse edhe uji, jeta e tyre në pjesën e rrafshët ndalet, përpjetë nuk mundet të ngrihet. Të varfrit shpërngulen jo atje ku duan, por atje ku munden, kurse kjo sipas rregullit do me thënë në pjesët më të papërshtatshme dhe nga ana infrastrukturore më të pazhvilluara të qytetit, të cilat pikërisht për këtë sepse janë më të lirë, njëkohësisht janë edhe të vetmet aq sa janë të kapshme për xhepat e tyre të cekët. Meqë mezi e arrijnë të mbahen gjallë, banorët e getos nuk kanë mjete t'i përmirësojnë kushtet e jetës, ndërsa qyteti gjen arsye të mos investojë nga ana e tij asgjë dhe kështu ta përshpejtojë përkeqësimin e gjendjes edhe ashtu së keqe. Në vend që ta forcojë kontrollin dhe të garantojë sigurinë e qytetarëve, e cila është vënë seriozisht në pikëpyetje pikërisht për shkak të varfërisë dhe mungesës së çfarëdo jete shoqërore të rregulluar, policia qëllimisht i lë këto hapësira pa kontroll, me pretekstin e rrezikut të rritur. Me këtë përmbajtje të dukshme nga ndërhyrja sistematike e policisë, përkrahet si-

domos përhapja e prostitucionit, narkomanisë dhe të gjitha formave të sjelljes përfutuese të krimeve, duke përfshirë edhe vrasjet. E tërë kjo shpie deri te keqësimi i mëtejshmë i kushteve të jetës, të cilat bëhen të papërballueshme edhe për shumicën e banorëve të getos, që janë takuar aty thjesht të detyruar nga varfëria e jo sipas zgjedhjes së tyre. Të vetëdijshëm për gjendjen ekstremisht të rrezikshme, e cila drejtpërdrejt kërcënon t'ua rrënojë familjen, ata të cilët ende munden bëjnë përpjekje dëshpëruese ta braktisin këtë geto dhe të shpërngulen në ndonjë vend tjetër, nëse jo më të mirë, së paku më të sigurt për jetën. Mbesin vetëm ata të cilët nuk kanë kurrfarë gjasash që së paku të tentojnë të kërkojnë shpëtim në vend tjetër, dhe ata të cilët tashmë kanë rënë në kurthin e drogës dhe krimin. Siç mund të shihet edhe nga ky sinopsis (pasqyrë), ideja është e qartë: *Të braktiset ky parazit, me qëllim që vetë të shkatërrohet!* Kurse shkatërrimi i këtij paraziti është i pashmangshëm sepse njerëzit në mjediset e tilla të getoizuara gjithnjë e më shumë po zhyten në drogë dhe krim, për shkak se nuk ka polici, kurse polici nuk ka për shkak se po bëhet gjithnjë e më e rrezikshme të vizitohen dhe të mbahet rendi, ngaqë njerëzit gjithnjë e më shumë po zhyten në drogë dhe krim! *Circulus viciosus* është receta e vjetër për sëmundjen vdekjeprurëse, por kundër saj ende nuk është gjetur ilaç! Kur fillon të shihet fundi, banorët e mbetur arrestohen, kriminelët më të mëdhenj burgosen, të tjerët shpërngulen, pushteti komunal ndërmerr aksionin e madh të rindërtimit të asaj pjese, investojnë mjete të konsiderueshme, e riparojnë dhe e përmirësojnë infrastrukturën, ndërtojnë ndërtesa të këndshme banimi dhe shtëpi familjare, automatikisht ngrihen çmimet e truallit dhe hapësirës ndërtimore për shkak të përmirësimit thelbësor të kushteve të jetës dhe në fund aty i shpërngulin qytetarët e qetë, me gjendje më të mirë materiale.

Në thelb, kjo logjikë e njëjtë është në prapavijë të getoizimit të qytetarëve europianë me status të muslimanëve emigrantë. Me këtë vlerësim, për shkaqe të dukshme, nuk pajtohet interpretimi zyrtar sociologjik, i cili shpjegimin për getoizim shpesh e kërkon në *nevojën njerëzore që të organizohen në grupe në bazë të afërsisë sociale, kulturore dhe çfarëdo tjetër*. Qasjet më të matura tregojnë që pakicave (minorities) në Shtetet e Bashkuara, vendimi i tyre që të jetojnë në geto, shpesh u diktohet nga rrethanat socio-ekonomike, më shumë se nga parapëlqimet kulturore.³⁹ Mbi këtë dallgë surfojnë edhe institucionet zyrtare hulumtuese të BE, të cilat kryesisht pajtohen në vlerësimin se *segregacioni dhe getoizimi i muslimanëve janë njësoj edhe shfaqje natyrore, edhe problematike, dhe si të tilla edhe duhet të vlerësohet*.⁴⁰ Megjithatë, nuk është i vogël numri i analistëve dhe ekspertëve, të cilët këmbëngulin në tezën që qytetarët europianë muslimanë veçohen vullnetarisht, *parapëlqejnë vetë-segregacionin kundrejt jetës sociale në bashkësi me jo-muslimanët, si për shkak të barrierave gjuhësore, ashtu edhe për shkak të dallimeve në normat kulturore, siç është ndalesa e konsumimit të alkoolit*.⁴¹ E njëjta autore megjithatë theksin kryesor e vë në hipotezën, se muslimanët vendosin për vetësegregacion dhe vetëgetoizim për shkak të *papërshtatshmërisë së tyre me demokracinë, e cila është pasojë e karakterit jodemokratik të Islamit si fe, që i shtyn të ngulmojnë në krijimin e bashkësive të mbyllura siç janë amishët në SHBA, me qëllim që vetë t'i rregullojnë raportet e tyre të brendshme me bazat e Islamit*.⁴² Duke u orvatur ta zbusë skualifikimin e shprehur të potencialit demokratik të Islamit, Cesari parashton një dallim, i

³⁹ Dalia Mogahed, drejtori ekzekutiv i Gallup Center for Muslim Studies, 2007.

⁴⁰ PEW Report 2005.

⁴¹ Jocelyne Cesari, *When Islam and Democracy Meet* (Harvard 2004).

⁴² Po aty.

cili duhet t'i ndajë muslimanët në të mirë dhe të këqij, beninjë dhe malinj, të parrezikshëm dhe të rrezikshëm, duke i këshilluar *europianët që edhe vetë ta vështrojnë këtë dallim dhe të mësojnë t'i dallojnë muslimanët konservatorë nga xhihadistët*.⁴³

Në vend të përgjigjes në këto hipoteza në mënyrë raciste të intonuaara, do të përgjigjemi me kujtesën në atë që tashmë e kemi thënë: Jeta e të varfërve është sikurse uji. Rrjedh vetëm teposhtë, kurrë përpjetë. Kjo do të thotë vetëm atje ku mundet, kurrë ku dëshiron. Asnjë banor i getos në asnjë anketë kurrë nuk ka thënë të jetojë në geto për shkak se atje dëshiron të jetë!

Si faktorë plotësues, të cilët ekzistencën e kategorisë së qytetarëve europianë muslimanë në statusin e punëtorëve emigrantë, këta autorë e shohin si kërcënim të përhershëm për rendin dhe paqen, theksohen edhe shkalla e lartë e krimit dhe njësoj varësia e lartë nga sistemi i ndihmës sociale. Të gjitha këto qasje e theksojnë praninë e muslimanëve si të ndryshëm nga jo-muslimanët, si problem serioz për të cilin zgjidhja e vetme e përhershme është integrimi. Duhet pasur parasysh se dallimi, të cilin në diskutimet bashkëkohore publike dhe teorike në BE e shënon vija e ndarjes së atyre të cilët janë për integrim pa asimilim dhe pozicioni i të cilëve cilësohet si real e i matur, dhe të atyre të tjerëve, të cilët haptazi këmbëngulin për asimilim, dhe si të tillë përdorin epitete të ekstremistëve e radikalëve, në fakt është vetëm i natyrës terminologjike. Me fjalë të tjera, nuk ka dyshim se çdo integrim në thelbin e vet është *asimilim jo i përkryer*, sepse me logjikën e vet imanente, *in ultima linea*, domosdoshmërisht shpie në asimilim, që do të thotë se asimilimi *de facto*, është *integrim i kryer*! Po ta themi me terma teknikë, fjala është për dallimet në shkallë e jo në cilësi, pra për fazat e ndryshme të (jo)kryerjes së po atij procesi!

⁴³ Po aty.

Por, kjo nuk është kundërshtia e vetme deri te e cila domosdoshmërisht vihet kur një kategori qytetarësh të Europës (muslimanët me status të emigrantëve), sistematikisht të trajtohet sikur nuk janë ata që janë! Kjo antinomi më së miri shihet pikërisht në orvatjet që të merren parasysh të gjitha faktet objektive të lidhura me mirësjelljen sociale të muslimanëve të kësaj kategorie në shtetet e BE, përveç faktit që ata objektivisht janë europianë (i cili qëllimisht dhe sistematikisht mohohet apo injorohet), gjithsesi të ndryshëm dhe të pavarur në raport me europianët jo-muslimanë, por që pa kurrfarë rezerve, megjithatë janë po aq europianë sikurse edhe europianët jo-muslimanë! Kështu, në librin e saj tashmë të cekur, J. Cesari tregon për seriozitetin e problemit të muslimanëve dhe domosdoshmërinë e integritit të tyre, duke iu drejtuar qëndrimeve disfunktionale (*disfunctional attitudes*) të muslimanëve, të cilët, meqë janë objektivisht kategoria më e varfër shoqërore, “... fillojnë të sillen ashtu si sillen edhe europianët më të varfër”. Konkretisht, kjo do të thotë që këta muslimanë pranojnë matrica të sjelljes përfutuese të krimeve, karakteristike përndryshe për europianët më të varfër. Ç’do të thotë kjo në fakt në raport me integritimin? As më pak e as më shumë, por se po këta muslimanë të varfër në aspektin social të integrohen, dhe madje të asimilohen në mjedisin social të europianëve të varfër jo-muslimanë! Por prisni, vallë integritimi dhe asimilimi nuk janë pikërisht ato që i kemi shpallur për të domosdoshme që të zgjidhet problemi i muslimanëve!? Po, kemi thënë, por problemi është që muslimanët nga e njëjta kategori sociale, të cilët nuk janë integruar por i kanë ruajtur të gjitha veçanësitë thelbësore të identitetit të vet islam, shumë rrallë, e në parim kurrë, nuk i jepen asaj *sjelljeje disfunktionale*, pra nuk i jepen papunësisë, alkoolit, drogave, krimet. Prej nga kjo tash? Vetë J. Cesari këtë e

pohon *expressis verbis*, duke treguar se ka një përpjesëtim të kundërt ndërmjet përmbajtjes së normave të përkatësisë islame dhe sjelljes kriminale, të konstatuar në mënyrë empirike dhe të vërtetuar në mënyrë statistikore me përpjesëtim mjaft të lartë: “Në qoftë se muslimanët janë të lidhur më thellë me besimin e tyre, aq më shumë bie mundësia që do të marrin pjesë në format ilegale dhe kriminale të sjelljes, sikurse janë grabitja, narkomania, alkoolizmi. Atë që ne assesi nuk dëshirojmë është Islami, i cili, në realitet, e shpëton individin, por nuk e ndihmon që të *akomodohet* me normat e shoqërisë.”⁴⁴

Një minidialog: antinomia e integritit me çdo çmim

Ja edhe antinomia! Kjo anë, që muslimanët të cilët këmbëngulin në identitetin e tyre, nuk droghen dhe nuk jepen pas krimit, kjo është e mirë! E ç’është në këtë atëherë e keqe? E po e keqe është ajo që ata mbesin muslimanë! Sepse duke mbetur muslimanë, ata refuzojnë që të integrohen dhe asimilohen! Pra, që të mund të integrohen dhe asimilohen, duhet ta relativizojnë identitetin e tyre musliman dhe ta ndrydhnin tërësisht përkushtimin e tyre ndaj Islamit! Mirë, kjo tash është diç më mirë! Por ja sërish telashe në dukje! Ata muslimanë të cilët i lirojnë shtrëngueset e tyre islame, integrohen dhe asimilohen thuajse me përsosuri në forma sjelljeje të jo-muslimanëve europianë, karakteristike prë klasën sociale së cilës i përkasin, bëhen pra, europianë të *mirëfilltë*, por këto forma të sjelljes janë hajdutëria, alkoolizmi, narkomania, shkurt, kriminaliteti!

A mund të pyes për diçka? Meqë gjërat tashmë qëndrojnë kështu, si do të bëhej që jo-muslimanët e varfër të integroheshin dhe asimiloheshin me muslimanët e përkushtuar ndaj Islamit. A

⁴⁴ Jocelyne Cesari (2004).

nuk është kjo më logjike, a nuk po gjendemi para zgjidhjes serioze dhe të frytshme të problemit të sjelljes kriminale të europianëve më të varfër jo-muslimanë!? Me pranimin e Islamit, këta jo-muslimanë me prirje kriminale, të varfër, a nuk do të ishin të detyruar të pranonin edhe detyrimin e sjelljes shoqërore korrekte dhe me këtë, jo vetëm ta përmirësonin gjendjen e tyre jetësore, por edhe shoqërisë do t'i bënin një të mirë të madhe, duke e çliruar nga të këqija të tilla, siç janë alkoolizmi, narkomania, prostitucioni, hajdutëria!? Kjo assesi! Përse jo? Për arsye se ekziston vetëm një drejtim i mundshëm i integritimit dhe asimilimit, e ky është që muslimanët të pushojnë së qeni muslimanë! Assesi e kundërta! Por përse të pushojnë fare së qeni muslimanë, përse atëherë të heqin dorë nga Islami dhe të integrohen, apo madje të asimilohen në jo-muslimanë, kur sjellja e tyre shoqërore është sa më korrekte dhe më e dobishme, është aq më pak disfunktionale e më shumë funksionale, në qoftë se është theksuar më tepër identiteti i tyre musliman, kurse përkushtimi i tyre ndaj Islamit më i fortë!? Edhe këtu përgjigjet e faktorëve zyrtarë të shumicës së vendeve euro-perëndimore janë krejtësisht të parashikueshme:

- Për arsye se ne nuk i duam muslimanët në afërsinë tonë! Më mirë edhe kriminel jo-musliman, sesa qytetar shembullor, i cili është musliman!

- Por kjo nuk është përgjigjja për pyetjen time!

- Po, kjo është përgjigjja! Kjo se nuk duam muslimanë në afërsinë tonë, pikërisht ky është thelbi i kërkesës sonë për integritet si fazë e parë e asimilimit të tyre të plotë! Dhe pikë!

Ky minialog, sado që të tingëllojë si parodi, në fakt zbulon kundërshtinë dhe karakterin absurd të vetë kërkesës që shoqëria multietnike, multikulturore dhe multifetare të luftojë kundër karakterit vetjak imanent! Asnjë kulturë, traditë, etni apo besim, nuk janë gunga të cilat e prishnin pamjen estetike të një shoqërie

dhe të cilat duhet mënjanuar me ndërhyrje kirurgjike. Ashtu si njeriu i arsyeshëm nuk ka problem me pamjen e tij, por që e pranon njësoj me lehtësi edhe atë që e sheh te vetja se është e bukur, sikurse edhe atë që e konsideron më pak të bukur, duke ndier çdo pjesë të tij dhe tërë veten si tërësi organike, në të cilën asgjë nuk është e panevojshme as e tepërt, ndërsa normalisht i kryen funksionet e saj, po ashtu edhe shoqëria e arsyeshme nuk ka problem t'i pranojë të gjithë qytetarët e vet si elemente integrale të shoqërisë në tërësi, duke u dhënë të drejta të barabarta të bëhen të atillë çfarë janë dhe ajo që janë, ndërsa i kryejnë rolet e tyre shoqërore. Por sot ka pak njerëz të arsyeshëm, edhe më pak shoqëri të arsyeshme. Nën diktatin e shtëpive të modës, njerëzit gjithnjë e më shpesh i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjike që fytyrën e vet autentike, e cila e shfaq identitetin e tyre individual, e ndërrojnë me një imazh anonim pa identitet, të modeluar sipas disa normave estetike abstrakte dhe arbitrare; nën diktatin e qendrave politike, shumë shtete me lehtësi heqin dorë nga identiteti i tyre autentik dhe fizionomia e formuar historike, që ta zëvendësojnë me kopje anemike të identitetit të urdhërdhënësve të vet. Një nga direktivat themelore të këtyre qendrave politike sot është e thjeshtë dhe e qartë: “Hiqni dorë nga identiteti juaj islam, nëse jeni muslimanë; ju që nuk jeni muslimanë, lirohuni nga muslimanët nëse ka te ju; ata nga të cilët për çfarëdo shkaku nuk mund t'i liroheni, integrojini, asimilujini, apo thjesht, i dëboni!”

Në suazat e rrëfimit për *Rendin e Ri Botëror (Novus Ordo Seclorum)*, në të cilin pajtohen në mënyrë të përkryer proceset e dukshme të centralizimit gjithnjë e më të madh të të gjitha formave të fuqisë shoqërore në duart e një numri gjithnjë e më të vogël prej një numri të përcaktuar prerazi shtetesh, shihet synimi gjithashtu i dukshëm që të vendosin kontroll në përmasa planetare, të realizuar nëpërmjet imperializmit global si ob-

jektiv përfundimtar. Kështu dalin dy gjëra vendimtare që ky projekt të mund të nxirret si alibi bindëse: 1. Të ndërtohet një filozofi sistematike bihejvioriste si mënyra e vetme legjitime e të menduarit, me tezën se të gjithë njerëzit janë jo vetëm të barabartë por edhe të njëjtë (?), dhe se të gjitha dallimet ndër njerëzit janë vetëm variacione dhe deviacione psikologjike të shkaktuara nga dallimet e përkatësisë kulturologjike. Kur të imponohet modeli unik shoqëror, përkatësisht, kur në tërë planetin të vendoset një klishe unike kulturore, të gjitha ato dallime, të cilat i quajmë se janë të pashlyeshme, dhe se përbëjnë njëfarë esence tonën të veçantë (nacionale, etnike, fetare), do të humbin shkallë-shkallë vetvetiu dhe imperializmi global do të bëhet realitet; 2. Traditat e ngurta kulturore dhe modelet qytetëruese janë pengesat kryesore për realizimin e kësaj ideje. Qytetërimi islam, duket e qartë, në mënyrën më të ngurtë u kthehet veçorive vetjake partikulare dhe së këndejmi, është më rezistent ndaj të gjitha orvatjeve për ndryshimet nga jashtë. Metoda që prej muslimanëve do të bëjë jo-muslimanë, prej të gjithë të tjerëve, nëse do të duhej, do të bënte pinguinë. Për këtë tehu i aksionit të qendrave më të fuqishme të botës sot është orientuar në përcaktimin e Islamit si pengesa kryesore për rendin e ri botëror (ky është kuptimi themelor i të gjitha shqyrtimeve për gjoja përplasjen e qytetërimeve, të nxitura me pamfletin tejet famëkeq të Huntington-it) dhe kërcënimi më i madh për paqen botërore – ndërsa detyrën që botën ta bindë në këtë pjesë të luftës kundër veçantive të Islamit e mori rrëfimi për *“terrorizimin islam” si fenomen global*.

Diversiteti kulturor, multikulturalizmi si ideal politik, barazia e të gjitha traditave kulturore, paprekshmëria e sovranitetit nacional, të gjitha këto rrëfime kanë përfunduar apo janë krejt fundit. Ka mbetur vetëm kreshta e Islamit. Kuptohet, këto procese janë të orientuara përjashtimisht ndaj ndryshimit të

atyre të tjerëve të cilët janë *ndryshe*. Ai i cili ndryshon prej gjithë të tjerëve, vetë mbetet i pandryshueshëm! *Lëvizësi i Palëvizshëm*. Gjuha e tij, institucionet e tij, vlerat e tij etike, standardet e tij estetike mbeten ashtu siç janë, sepse nuk janë *ndryshe*, por janë pikërisht të tilla siç *duhet të jenë!* Në atë gjuhë, në ato institucione, në ato vlera etike dhe standarde estetike, të gjithë të tjerët kanë fituar ideal të qartë dhe konkret. Do t'i orientojmë drejt këtij ideali, por një gjë duhet t'ju bëhet e qartë të gjithëve: ky ideal për ta do të mbetet amshueshëm ideal, i cili nuk do të mund të arrihet por amshueshëm do t'i afrohen atij. Njeriu është asimptot i Zotit, të globalizuarit janë asimptotë të globalizuesit!

Feja dhe identiteti

Fakti që aq shumë ngulmohet në integrimin dhe asimilimin e muslimanëve në sfondin shoqëror jo-musliman, është krejt e qartë se nuk është i rastit, as është i motivuar me shkaqe pragmatike. Përkundrazi, motivet pragmatike sugjerojnë pikërisht të kundërtën – që qytetarët e varfër jo-muslimanë në shtetet e BE, të njohur se kanë prirje të theksuar për forma kriminale të sjelljes shoqërore, t'i harmonizojnë me vlerat themelore të Islamit, nëse jo tashmë që të integrohen me muslimanët! Kur, përkundër të dhënës së konfirmuar në mënyrë empirike se përkushtimi ndaj vlerave të Islamit garanton imunitet jash-tëzakonisht të lartë të muslimanëve ndaj krimit, alkoolizmit, narkomanisë dhe devijimeve të tjera sociale, megjithatë ngulmohet në integrimin dhe asimilimin e muslimanëve, sikurse edhe në zmbropsjen sistematike të vlerave shpirtërore islame, praktikës së traditave dhe mënyrës tradicionale të veshjes, e kjo do të thotë vetëm një gjë: se problemi është i natyrës së pastër ideologjike, dhe se ka të bëjë me një lloj pakënaqësie dhe mos-

durimi psikologjik ndaj Islamit dhe muslimanëve! Dhe se synimi skajor i integritit dhe asimilimit të muslimanëve në fakt është de-islamizimi i tyre!

Përkushtimi i muslimanëve ndaj Islamit paraqet pengesën kryesore për të gjitha ambiciet që të kryhet de-islamizimi sistematik i muslimanëve. Nuk ka nevojë për mprehtësi (dinakëri) të madhe që të kuptohet se pikërisht ky është tehu i fshehtë i të gjitha rrëfimeve për domosdoshmërinë e integritit dhe asimilimit të muslimanëve, qytetarë të BE. Por, pikërisht për shkak të përkushtimit të tyre të jashtëzakonshëm ndaj Islamit, de-islamizimi i muslimanëve nuk është aspak punë e thjeshtë dhe e lehtë. Hulumtimet e kryera në Gjermani, Britani dhe në Francë gjatë vitit 2007, treguan se feja në jetën e përdishme të muslimanëve të këtyre shteteve është më shumë se dyfish e rëndësishme, sesa në jetën e qytetarëve mesatarë të këtyre vendeve.⁴⁵ Një anketë tjetër ka konstatuar se muslimanët e Europës veten e identifikojnë shumë më tepër nëpërmjet përkatësisë fetare, sesa nëpërmjet asaj nacionale, dhe kjo shumë më tepër e më shpesh sesa cilido grup tjetër etnik, nacional apo fetar në Europë.⁴⁶ Megjithatë, me një hulumtim anketues me vëllim më të madh është konfirmuar se përkushtimi ndaj Islamit nuk është pengesë, që muslimanët në BE të përcaktohen edhe si qytetarë të shtetit në të cilin jetojnë, gjë që dëshmon se përkatësia e tyre islame nuk e vë në pikëpyetje përkushtimin e tyre qytetar, por e thekson në mënyrë plotësuese.⁴⁷ Është vërejtur, gjithashtu, se edhe muslimanët të cilët nuk janë shprehimisht fetarë, zhvillojnë një ndjenjë të theksuar të identitetit islam si përgjigje ndaj ndjenjës së izolimit të tyre dhe sidomos, inferioritetit kundrejt

⁴⁵ Gallup poll, Annual Report 2007.

⁴⁶ PEW poll 2006.

⁴⁷ Anketa e cituar: Gallup poll, Annual Report 2007.

normave jo të qëndrueshme morale të Europës jo-islame. Edhe pse receptimi i termit “musliman”, për shumicën e jo-muslimanëve të Europës është njëkuptimor dhe negativ, duhet përmendur se përkatësia e përbashkët e Islamit nuk e përjashton dhe madje, nuk e kufizon përkatësinë e muslimanëve te grupe mjaft të ndryshme racore dhe etnike, me tradita kulturore, me ndarje gjuhësore. Ashtu si as nocioni “kristian”, i cili përndryshe funksionon si emërtues i përbashkët për të gjithë pasuesit e kësaj feje, nuk e përjashton ekzistencën e dallimeve dhe ndarjeve racore, etnike, nacionale, kulturore, e madje edhe doktrinare të thella, siç janë, për shembull, “katolikët”, “ortodoksët”, “protestantët”, “anabaptistët”, “evangjelistët” ... po ashtu edhe nocioni “musliman” markon emëruesin themelor të përbashkët të përkatësisë ndaj Islamit, duke mos i pakësuar dallimet racore, etnike, sociale, kulturore, gjuhësore dhe shumë të tjera, të cilat ekzistojnë ta themi, në nivel të *universit brenda-musliman antropologjik*.

Ky moment është shpjeguar dhe komentuar në mënyra dhe me ndjenja të ndryshme ndër jo-muslimanët, krahas përbërëses ideologjike me dozë të caktuar të neverisë ndaj Islamit, që sipas rregullit, gjithnjë është e pranishme. Kështu, ndërsa disa në këtë gamë të gjerë të popujve dhe kulturave, të cilat e kanë pranuar Islamin, shohin para së gjithash fleksibilitetin e lartë të Islamit që të sendërtohet nëpërmjet matricave mjaft të ndryshme sociale dhe qytetërimore, i cili hap mundësinë që muslimanët e Europës me kalimin e kohës të zhvillojnë në mënyrë autentike modelin e vet të Islamit, thelbësisht të ndryshëm nga *fundamentalizmi*, dhe gjithsesi ndjeshëm më i pranuar për modelet europiane të jetës, të tjerët shkojnë një hap më tutje. Me fjalë të tjera, në qoftë se me këmbëngulje dhe mjaftueshëm me shkathtësi, ngulmohet në dallimin ndërmjet *modelit europian të Islamit*, si *Islamit të mirë*, dhe *modelit jo-europian*, fun-

damentalist, ekstremist, terrorist, xhihadist e të tjera të Islamit, si *Islamit të keq*, kjo mund të shpjerë deri te së paku dy momente në Islam, dhe ajo që është veçanërisht e rëndësishme, të dy jo të favorshëm për të ardhmen e Islamit! Konfrontimet, mosmarrëveshjet, dallimet radikale brenda Islamit, në vijën e skajshme do të shpien deri te konflikti dhe çarja brenda kornizës tradicionale të fuqishme dhe kohezive gjeniaie të Islamit. Pasi të promovohet si forma më e lartë e qytetëruar dhe superiore e Islamit, *Islami europian* do ta distancojë veten nga të gjitha format e Islamit jashtë-europian, të Islamit më të ulët, primitiv, radikal, ekstremist, terrorist e në trajta të tjera të ngjashme, duke demonstruar gjatë kësaj një dozë të caktuar të mendjemadhësisë, arrogancës, kryelartësisë. Kuptohet që për një sjellje të tillë të tyre, pjesëtarët e Islamit europian do të presin një përkrahje të caktuar, mbrojtje dhe privilegje nga bashkëqytetarët e tyre europianë jo-muslimanë. Është e arsyeshme që një logjikë e tillë nuk do të mungojë, por gjithashtu është e logjikshme që do të kushhtëzohet me kërkesat për dëshmi shtesë të përkushtimit të vet nga ana e muslimanëve për identitetin kulturor europian, i cili përndryshe ata muslimanë nuk i njeh si europianë autentikë, as si të barabartë me veten, por, si për shkak të sjelljes së tyre të mirë ashtu edhe për shkak të zemërgjerësisë së tyre qytetëruese dhe mëshirës kristiane, megjithatë pranohen dhe u lejohet të qëndrojnë në Europë dhe ta praktikojnë *Islamin europian*, në pajtim me atë për çka paraprakisht janë marrë vesh!

Por ajo që është më e rëndësishmja vijon. Një varg analistësh me famë në mënyrë indirekte e zbulojnë anti-islamizmin e tyre të fshehtë aq sa lë gjurmë jargëzore, si kërmilli kur kalon nëpër kopsht, si nëpërmjet koncepteve të tyre, të cilat i paraqesin si *zhvillim të favorshëm të çështjes muslimane dhe pranisë së Islamit në truallin e Europës*, ashtu edhe në fjalë individuale

apo në formulime të tëra. Shpresat e tyre për atë, që ata e quajnë *zhvillim të favorshëm të çështjes muslimane*, ndërtohen mbi faktin se kultura dhe konteksti i përgjithshëm kulturor luajnë rol të rëndësishëm në mënyrën me të cilën muslimanët i qëndrisin ornamentet dhe larat e tyre islame në strumbullarin e jetës së përditshme. Kështu e përfundojnë përfaqësuesit e kësaj *teorie inkrementaliste për vdekjen e Islamit në Europë*, “duke jetuar në kontekstin e lartë të qytetëruar, juridikisht të rregulluar, kulturalisht të rafinuar dhe ekonomikisht të qëndrueshëm të Europës, ku gjithnjë e më shumë do të afrohen drejt standardeve më superiore të kulturës europiane.”⁴⁸ Optimizmin e këtij lloji e ilustron bukur thënia e një përfaqësuese së SHBA për bashkësitë muslimane në Europë, e cila ndër të tjera thotë: “Muslimanët e Europës përpiqen me të gjitha forcat që të mundësojnë arsimim maksimal për të gjithë pjesëtarët e të gjitha bashkësive, duke theksuar se synimi i tyre është arritja e harmonisë ndërmjet asaj që të jenë muslimanë/perëndimorë, e jo muslimanë apo perëndimorë.”⁴⁹ Sikurse edhe në tërë konceptimin inkriminues, ashtu edhe në këtë thënie dy gjëra bëhen të dukshme:

⁴⁸ Shih Farah Pandith, në “Americas’s Face to Muslims”, *Fletcher News*, June 18, 2010. Përndryshe, Farah Pandith është muslimane, me prejardhje nga India, e cila nga fundi i qershorit të vitit 2009 është emëruar për Përfaqësues special Të Stejt Departmentit për bashkësitë muslimane. Këtë tezë e përkrahin edhe rrymat më liberale në parlamentet e shteteve anëtare të BE, sikurse edhe organizatat jo-qeveritare të cilat veprojnë në shërbim të mbrojtjes së të drejtave njerëzore dhe lirive qytetare, duke mos vërejtur se sa tërë ky projekt i njëfarë Islamit evropian i ndryshëm nga Islami ortodoks jo-evropian, në thelb është thellë i kundërt me parimet bazore për të cilat ata angazhohen, sepse në fakt rrëgjohet në programin e de-islamizimit të muslimanëve dhe asimilimi i tyre i shkallërishtëm, i butë në kallëpet e traditës kulturore të Evropës jo-islame. Për shkak të insistimit të theksuar në ndërrimin afatgjat dhe të shkallë-shkallshëm të muslimanëve të Evropës nga Islami deri te transformimi i tyre përfundimtar në modelet kulturore të Evropës jo-muslimane, këto koncepte i kemi shënuar me emrin e përbashkët si *teori inkrementaliste për vdekjen e Islamit në Evropë*.

⁴⁹ Farah Pandith, U. S. Envoy to Muslim communities (2009).

1. Se nevoja e integritit të muslimanëve të Europës, me asimilimin e tyre në modelet kulturore të pjesës jo-islame të Europës, si fazën e fundit e këtij procesi, është aq e dukshme, e vetëkuptueshme dhe në tërësi, aq liberale, mirëdashëse, miqësore në motivet e tyre, sa që thjesht nuk duhet fare të përpunohet, argumentohet, as të shpjegohet;

2. Se propozimi eventual plotësues për nevojën e integritit dhe asimilimit paralel të jo-muslimanëve në Europë brenda modeleve kulturore të muslimanëve të Evropës, absolutisht i ka shtanguar po ata që këtë ua propozojnë muslimanëve, dhe se këtë propozim e konsiderojnë njëjtë absurd dhe të marrë, nëse propozimin e tyre e konsiderojnë të vetëkuptueshëm dhe logjik shembullor. Mirëpo, pikërisht kjo përjashtimësi absolute shpie në këtë përsiatje: njerëzit, grupet, popujt, shtetet, të cilët kanë të njëjtat rrethana jetësore, dhe njëherësh konsiderohen ndërsjelltas për të barabartë, i këmbëjnë qëndrimet, përvojat, dijet e tyre, duke mos tentuar t'ia imponojnë njëanshmërisht dhe përvokueshëm anës tjetër! Te miqtë, dashnorët, burri dhe gruaja, dy ekipe shkollore ... krejt njësoj reciprociteti është themel i komunikimit e jetës në shoqëri dhe kushti i përgjithshëm i vlefshëm në të gjitha format e bashkësisë. Mirëpo, kërkesa për integrim është absolutisht e njëanshme, pa kushte, imperative, e pakthyeshme. Kjo tregon qartë vetvetiu se edhe më tej ka mbetur në fuqi stereotipi negativ për Islamin si për një kulturë thelbësisht inferiore, dhe për muslimanët si individë jo mjaft të kultivuar, jobsimtarë, armiqtësorë (më së shpeshti që të tria së bashku!) me të cilët nuk mund të merresh vesh seriozisht, deri sa nuk lirohen edhe nga Islami, edhe nga muslimania e tyre. Nga ana tjetër, duke i konsideruar muslimanët inferiorë, përfaqësuesit e tezës mbi domosdoshmërinë e integritit dhe asimilimit të muslimanëve, klishe të tyre kulturore dhe veten e tyre

po ashtu domosdoshmërisht i konsiderojnë superiore në raport me Islamin dhe muslimanët, e për këtë arsye edhe as nuk mund ta imagjinojnë se çështja për integrimin e tyre në modelin kulturor islam, seriozisht as mund të shtrohet fare! Por gjithnjë sa të jetë ashtu, koha për dialogun e mirëfilltë dhe pranimin e së vërtetës për Europën si për kontinent të përbashkët të muslimanëve dhe jo-muslimanëve, kristianëve dhe jo-kristianëve, hebrenjve dhe jo-hebrenjve, do të jetë ende larg.

Kultura dhe demokracia, diskriminimi dhe paragjykimet

Shumë njerëz e quajnë se Islami si kulturë është joharmonik dhe madje edhe në konflikt me Europën në aspektin e temave, siç janë cenzura, liria e shprehjes, të drejtat e grave, ndarja e kishës nga shteti përkatësisht ndarja e aspektit klerikal dhe shekullar të jetës shoqërore. Çfarë hipokrizie mbreslënëse!! Nga një anë, sulmohet ashpërsisht cenzura e internetit në Kinë, ndërsa nga ana tjetër, të gjitha ato organizata joqeveritare, *Komiteti i Helsinkit*, *Freedom House*, *organizatat për të drejtat e njeriut (Human Rights Watch)*, mbeten të shurdhra në raportet e tyre, kur njëjtën e bëjnë SHBA, të cilat kërkojnë edhe të drejtën e fshehtësisë për një cenzurë të tillë, e madje edhe për mbylljen e plotë apo heqjen e përhershme të portalit për të cilin marrin vendim – dhe këtë jo vetëm për rrjetin e tyre vendës të internetit, por edhe për atë botëror, e madje edhe për rrjetet e të gjitha shteteve të tjera, për të cilat vendosin organet e cenzurës dhe shërbimet sekrete të SHBA, si instanca supreme edhe të monopolit të cenzurës! Agresioni i shpeshtuar luftarak dhe pushtimi i shteteve të pavarura, dhe ajo që është edhe më e dukshme, përjashtimisht antiislam, deri te precedenca e paparë në gjithë historinë e deritashme të botës, me fjalë të tjera kër-

kon që vendet e tjera të heqin dorë nga e drejta e tyre, që t'i ndjekin ligjërisht pjesëtarët e SHBA *çfarëdo krimi që të kenë bërë ata në territorin e tyre, duke përfshirë këtu edhe gjenocidin*⁵⁰ (domosdoshmëria absolute e kësaj kërkesë logjikisht implikon edhe të drejtën për mosdënim dhe ligjërisht të pasanksionuar të gjenocidit, e madje edhe holokaustit nga ana e shtetit udhëheqës të botës së lirë), e diskreditojnë çdo kuvendim të barabartë për raportin e Islamit ndaj këtyre temave dhe e bën plotësisht të fshirë, nëse nuk sillet një vlerësim objektiv për raportin dhe praktikën e deritashme historike të demonstruar të traditës joislame, konkretisht kristiane, evropiane, kulturore ndaj këtyre temave të njëjta!

Përçmimi dhe retorika e drejtpërdrejtë keqësuese janë bërë mënyrë tërësisht e rëndomtë, që mos të them *normale*, e të folurit publik për muslimanët, madje edhe në mediat e vendeve të cilat tradicionalisht i respektojnë rregullat e mirësjelljes madje edhe sot; në fakt, vetëm kur flasin në *nivel të barabartë*, që do të thotë, mes veti. Kërcënimi që Islami do të thotë për Europën, në të shumtën e rasteve, shihet para së gjithash, si kërcënim *i numrit të stërmadh dhe cilësisë tejet të ulët!* Këtë tezë e sintetizon qartë vlerësimi vijues objektivisht i intonuar i një gazetari të nderuar anglez, me dozën e pashmangshme të cinizmit helmues në llogari të Islamit dhe muslimanëve: “Europa gjendet e shtrënguar në gaviç bashkë me Islamin për shkak të numrit të madh të muslimanëve emigrantë, të pjesëtarëve të tij. Tash për tash, Islami është ana e fortë në këtë gaviç, pikërisht prej shkakut të qartë demografik, dhe nga shkakut më pak i qartë filozofik.”⁵¹

⁵⁰ Një nga nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje të pabesueshme me të cilën shteti nënshkrues e pranon rolin e partnerit mazokist në lojën sado-mazokiste pa rregulla dhe deri në vdekje, është, të përkujtojmë edhe Republika e Maqedonisë.

⁵¹ Christopher Caldwell, (2009) *Reflections on the Revolution in Europe: Immigration, Islam and the West*, Guardian book store, paper back, f. 11. Kristofer Kol-

Kristofer Koldvelli thekson nevojën që të përjashtohet ndikimi kulturor i Islamit mbi Europën, për shkak se shpie deri te një numër më i madh problemesh. Kështu, Islami praktikisht nuk dallon, nuk veçon, nuk e ndan shoqërinë në pjesën kishtarë dhe shekullare, por e vështron si bashkim organik të këtyre dy aspekteve, ndërsa Europa këmbëngul në ndarjen dhe veçimin gjithnjë e më të fortë të kishës nga shteti. Gjithashtu, aspiratat europiane për sa më shumë tolerancë kulturore dhe fetare, qenësisht e kufizojnë aftësinë e tyre ta kritikojnë Islamin sot, në mënyrën me të cilën dikur Islami e ka kritikuar kristianizmin. Si dëshmi dhe ilustrim të këtij pohimi Koldvelli cek ankesat gjithnjë e më të shumta të muslimanëve, të cilët u drejtohen ligjeve europiane mbi *ndalimin e gjuhës së urrejtjes (hate speech)*, që të mbrohen nga çdo kritikë, qoftë dhe e arsyeshme, duke i kthyer në shembuj të fyerjes së Islamit dhe muslimanëve. Njëkohësisht, shton gazetari Koldvell, rastet e dhunës së hapur dhe aktet kriminale siç ishte vrasja e regjisorit Teo van Gog, për shkak të trajtimit kritik të femrës në Islam në filmin *Nënshtrimi (Submission)*, konfirmojnë mostolerancën e muslimanëve ndaj të drejtës dhe lirisë së shprehjes!

Është interesante se Kristofer Koldvelli, sikurse edhe askush nga lexuesit e tij, nuk sheh se këtu nuk ka kurrfarë kundërtënieje. Përkundrazi, muslimanët të cilët në kulturën e tyre nuk e njohin qartë të *folurit fyes* si postulat në inventarin e komunikimit të lirë dhe të drejtën për lirinë e të shprehurit, parimisht, nga thellësia e traditës vetjake kulturore, protestojnë kundër të *folurit urrejtës*, duke iu drejtuar, si qytetarë të mirë, ligjeve ekzistuese, kurdo qoftë që është e mundur që problemi të zgjidhet

dvell përndryshe është kolumnist i njohur i gazetës *Financial Times*, përfaqësues i qëndrimit neokonservator të matur negativ ndaj Islamit dhe i qëndrimit të theksuar negativ ndaj muslimanëve emigrantë.

gjqësisht. Mirëpo, duke marrë parasysh faktin se zgjidhja gjyqësore ka munguar në rastin e ankesës kundër regjisorit Teo van Gog, pra është refuzuar pikërisht duke iu drejtuar lirisë së të shprehurit, i cili, në sytë e muslimanëve përfundimisht ka qenë fajtor pikërisht për aktin ligjor të përshkruar të të folurit urrejtës, në vendimin e tyre që vetë ta ndëshkonin shkelësin, nuk ka pasur asgjë kundërthënëse, sado që ka shumë gjëra që nuk janë të palejueshme dhe kontestuese në rrafshin e vlerësimit të peshës së vetë veprës! Kësaj i duhet shtuar edhe fakti, se po ato media të cilat deri sot nuk pushojnë të përkujtojnë në vrasjen e Teo van Gogut, e kanë heshtur apo mezi që e kanë theksuar vrasjen e muslimanes, “martires së therur”⁵² në gjykatoren e një gjykate gjermane, vetëm nga shkakun që ishte e veshur me burkë, sikurse edhe për burrin e saj, i cili është sulmuar vetëm nga shkakun që ia ka lejuar gruas së tij në pajtim me traditën islame, në vend që ta detyronte të vishet në mënyrën se si veshën jo-muslimanet, sulm të kryer nga një kristian fundamentalist dhe anti-islamist. Për këtë dallim të pabesueshëm të të gjitha mediave europiane pa përjashtim, në trajtimin e krimeve të bëra ndaj muslimanëve dhe krimeve të cilët i bëjnë muslimanët, më së miri flet fakti që askush nga redaktorët e atyre revistave apo emisioneve televizive, si edhe askush nga disa milionë qytetarë të Europës, të cilët e dinë se emri i njeriut të vrarë për arsye se ka fyer ndjenjat fetare të muslimanëve është Teo van Gog, me siguri të plotë nuk e dinë as emrin e musli-

⁵² Vëmendja dhe ashpërsia e reaksioneve të cilat mediat dhe disa politikanë ia kanë kushtuar përmbajtjeve kulturore simbolike, sikurse janë burka dhe minareja, kanë çuar deri te tëhuajësimi i mëtejme i muslimanëve nga bashkëqytetarët e tyre jo-islamë, si edhe te mosbesimi i rritur të po këtyre bashkëqytetarëve ndaj muslimanëve, konsiderojnë shumë analistë. Kësaj i ka ndihmuar ndjeshëm edhe fakti i standardeve të dyfishta të cilat mediat i kanë fuqizuar me rastin e vrasjes së Teo van Gogut dhe thaujse heshtjes së plotë në rastin e vrasjes së muslimanes dhe burrit të saj në gjykatoren gjermane.

manes së vrrarë në gjykatore vetëm për shkak se fytyra e saj ishte e mbuluar me perçe, sikurse edhe emrin e burrit të saj të vrrarë vetëm sepse ishte burri i saj! Pyeteni veten, lexues të respektuar, a mos i dini ju emrat e tyre!? Që në të ardhmen maksimalisht të zvogëlohet rreziku nga incidente të tilla, është e domosdoshme që nëpërmjet mediave në territorin e BE të theksohet fakti kulturologjik kyç: *Islami është kulturë në të cilën nuk tolerohet të folurit fyes*. Fyerja e cilitdo besim për muslimanët është rreptësisht e ndaluar në shumë vende në Kur'an, sikurse edhe në dhjetëra hadithe të ruajtura, pra tradita të dokumentuara nga jeta e pejgamberit Muhammed a.s.! Ashtu si muslimanët e kundërshtojnë çdo fyerje të feve të tjera monoteiste ndër popujt e të *katër librave*, e madje edhe përgojimin e njerëzve të cilët nuk janë të pranishëm, qoftë reciprokisht, qoftë nëpërmjet fyerjes dhe përgojimit të jo-muslimanëve, ashtu nuk tolerojnë as kur jo-muslimanët i fyejnë ata. Ky dallim në qasje kundrejt fyerjes së të gjithëve e sidomos ndjenjave fetare, e cila në Islam është përjashtuar nga kategoria e të drejtës dhe lirisë për të folur, është njëkohësisht dallim qenësor kulturologjik dhe antropologjik ndërmjet receptimit të aktit të fyerjes të muslimanët dhe të jo-muslimanët! Së këndejmi duhet sistematikisht dhe në çdo rast të vihet në dukje ky dallim kulturologjik, që jo vetëm të shmangen reagimet e skajshme dhe masive të muslimanëve, që i kanë nxitur Selman Ruzhdiu në librat e tij, autori i karikaturave të porositura në revistat daneze, regjisori Teo van Gog me filmin e tij, dhe shumë të tjerë, por që edhe të kuptohen saktë rrënjët e këtyre mosmarrëveshjeve dhe ngjarjeve jo të këndshme të bazuara mbi to!

Për fat të keq, duket se ende jemi shumë larg nga çfarëdo nismash serioze që tradita kulturore islame dhe jo-islame të përballen në dialog krijues dhe që të kuptohen nëpërmjet një

dialogu instruktiv dhe të hapur. Retorika e fyerjes, përçmimit dhe shpifjes kundër muslimanëve, sikur edhe praktika gjithnjë e më e zbatuar mediatike e përhapjes së shakave raciste dhe nacionaliste në kurriz të tyre, gjithnjë e më shumë po fiton popullaritet në disa pjesë të Europës.⁵³ Nëpërmjet kësaj, të folurit e fyerjes, përçmimit dhe urrejtjes ndaj Islamit dhe muslimanëve, gjithnjë e më shpesh hyn edhe në dyert e institucioneve politike e madje edhe të parlamentit të shumicës së shteteve europiane anëtare të BE, diçka që e tregon pa ekuivoke gazetarja e njohur Liza Bjurvald: *“Në vend që të legjitimohet si neo-nacist famëkeq, deri vonë Bering Brejviku anonim (i akuzuar për sulmet në Norvegji në vitin 2011) këtë herë thjesht ka pranuar ideologjinë, e cila përfaqësohet hapur në parlamentet tona, e madje edhe në kancelaritë e qeverive.”*⁵⁴ Që ky vlerësim i Liza Bjurvaldit, për fat të keq, thellë i vërtetë, dhe që qëndrimi anti-islam njëmend fuqishëm ka depërtuar në institucionet më të larta e edhe në judikaturë të Norvegjisë, e vërteton edhe formulimi skandaloz me të cilën është arsyetuar aktgjykimi i Bering Breivikut, në të cilën, ndër të tjera, thuhet: *“Shumë njerëz ndajnë me Breivikun teorinë e ployës, duke përfshirë edhe teorinë e Eurabisë. Megjithatë, gjykata konsideron që një numër mjaft i vogël prej tyre ndan idenë e Breivikut që kundër gjoja ‘islamizimit’ duhet të luftohet me terror.”* (Many people share Breivik’s conspiracy theory, including the Eurabia theory. The court fines that very few people, however,

⁵³ Këtë veçanërisht e thekson edhe EU’s Commission Report on Racism, June 2011.

⁵⁴ Lisa Bjurwald, gazetarja e gazetës stokholmiane, në kolumnën prej 11 shtatorit 2011. Njëkohësisht, ia vlen t’i kushtohet vëmendje në formulimin më se të kujdesshëm të vetë autores (të theksuar në kllapa me italik) i cili, edhe pas të vërtetës padyshim të konfirmuar, jo vetëm që nuk flet për Breivikun si për një *vrasës masiv*, por edhe vetë aktin e tij e cilëson skajshmërisht të përmbajtur dhe neutral si *sulm*, në pajtim me praktikën se askush nuk mund të shpallet për fajtor para se këtë gjykata ta zyrtarizojë!

share Breivik's idea that the alleged "islamization" should be fought with terror").

Vlerësimi i këtillë i gjykatës, dukshëm, e trimëron *shumicën e njerëzve* ta pranojnë teorinë e Breivikut për rreziqet, që për shkak të imigrimit islam, Europa do të bëhet Eurabi, por u jep këshillë juridike që është numër mjaft i vogël i atyre të cilët lejojnë terrorin si mjet të luftës kundër gjoja 'islamizimit' por megjithatë të cekur. Formulimi i arsyetimit të aktgjykimit kundër Breivikut se synimi i Breivikut ka qenë i arsyeshëm, mjeti i tij nuk ishte (??) në thelb jo vetëm që ta legalizojë qëndrimin anti-islam por edhe fton në luftë kundër imigrimit musliman në kontinentin e përbashkët historik dhe kulturor, Europën! Të përkujtojmë edhe në faktin se fushata kundër lejimit për ndërtime të minareve në Zvicër, gjatë vitit 2009, ka qenë aq ofenduese për muslimanët dhe aq hapur armiqësore ndaj Islamit, sa që posterët të cilët ftojnë për referendum, në shumë qytete është dashur të hiqen për shkak të porosive të tyre raciste në mënyrë eksplicite dhe zgjidhjeve artistike!

Manikeizmi kulturor i traditës jo-islame europiane

Ideologjia anti-islame nuk do të thotë se gjithnjë formulohet me retorikë fyese të hapur. Shembullin e ideologjisë së mbulluar, por aspak më pak helmuese anti-islame, raciste, shoviniste, paraqet libri *Turkey in Europe*, të cilin e ka botuar autori i fshehur pas pseudonimit "Odysseus".⁵⁵ I botuar në vitin 1900,

⁵⁵ Odysseus, *Turkey in Europe*, London, 1900. Hulumentimi i emrit civil të autorit i cili qëndron pas pseudonimit *Odysseus* më çuan deri te përgjigja mezi diç më pak enigmatike, e cila është Sir C. N. E. Eliot, në të cilin udhëzoi arkeologu dhe bibliofili i famshëm nga Shkupi, Dr. Kosta Balabaniajn. Duke gjykuar sipas posedimit të mirë të informacioneve për shumë hollësi të jetës në Turqi, sigurisht është fjala për diplomatin shumëvjeçar të Britanisë në Turqi.

ky libër i vëllimshëm prej 475 faqesh, e legjitimon autorin e saj si zotrinë tipik, kolonialist me gjak të pastër anglez, i cili njëson në vete rolet e iluministit zemërmirë dhe zotëriut mendjemadh. Dijen jo fort të vogël të tij autori e keqpërdor drejtpërdrejt, duke e vënë në shërbim të llojit më të keq të shovinizmit evropian, anti-islamizmit dhe arrogancës ultranacionaliste. I udhëhequr me këtë imazh kolonialist, të cilin e ka formuar për veten por edhe për Europën në tërësi, *Odiseu* ynë e konsideron si për detyrë të veten që lexuesve injorantë turq dhe në përgjithësi muslimanë t'u tregojë në vepër skrupulozitetin maksimal të shkencëtarit, i cili në mënyrë pedante citon dhe me korrektësi përmend burimet e të dhënave të cilat i shfrytëzon, duke demonstruar njëkohësisht pakrupulozitetin madhështor të urtarit që Zoti e ka begatuar, të cilit s'i vjen fare në mend t'i arsyetojë përfundimet e veta të kumtuara me fjali të intonua si aktgjykime të përvokueshme të gjykatës supreme, për të cilat nuk paska të drejtë ankese! Sepse, siç mendon dukshëm ky autor, ata (turqit, e me ta edhe të gjithë muslimanët e tjerë) janë të detyrueshëm të dëgjojnë dhe të mbajnë në mend fjalët e tij, kurse ai ndaj tyre nuk ka asnjë detyrim t'u shpjegojë, madje as t'u flasë! Por nëse tashmë u është dhënë ky nder i madh, le t'i hapin veshët. *Kështu grumbullohet lënda faktike!* – sikurse thotë ky i vetëquajtur “Albion/Odisej” i mbrapshtë - *Dhe kjo është ajo që edhe ju, orientalët kryetul, turqit dhe të gjithë muslimanët, sado qoftë përndryshe të jeni kokëtrashë, mund të mësoni nëse do të angazhoheni mirë! Dhe kështu komentohen, sepse të kuptuarit nuk u është dhënë juve. Në vendin tuaj, këtë do ta bëjmë ne, evropianët inteligjentë, të qytetëruar, në rend të parë, ne britanikët!* Rryma karakteristike njëkahëshe, tipike për të gjithë përfaqësuesit e shovinizmit kulturor, racor, nacional dhe fetar, rrjedh nëpër trutë e këtij eruditi të edukuar në mënyrë sistema-

tike por gjithashtu njëdrejtimësh, me aftësi hipertrofike për kritikë, dhe me aftësi plotësisht të gjymtuar për vetëkritikë. Pas njëqind herë të vlerësimeve/aktgjykimeve të përsëritura, *se turqit janë kokëtrashë, gjakpirës, të paaftë të merren me gjëra të larta*, që i vishet faktit se janë muslimanë, e me këtë gjithë qytetërimi islam degradohet në çdo rast dhe në të gjitha pikëpamjet e jetës sociale, aftësive intelektuale dhe virtyteve morale sa të jetë e mundur më shumë, ky Odysseus, alias C. N. E. Eliot, i denoncon drejtpërdrejt turqit si popull i cili nuk ka krijuar asgjë të veten dhe i cili, në këtë aspekt, gjendet në vetë fundin e shkallës së të gjithë popujve: “Kur njeriu mendon më mirë, turqit mezi që kanë diçka të veten, diçka që nuk është huazuar nga të tjerët. Feja e tyre është arabe; gjuha e tyre është gjysmë arabe e persiane, arti i tyre është persian apo bizantin ...”.⁵⁶

Është e qartë se atij as nuk i ka shkuar ndër mend që të pyesë se si qëndrojnë gjërat në këtë aspekt me anglezët, përkatësisht me britanikët. Sikur edhe sipërfaqësisht ta kishte vështuar, do të ballafaqohej me fakte, të cilat britanikët do t'i rrëzonin ndjeshëm më poshtë nivelit të popujve të cilët nuk kanë krijuar asgjë: *Sepse, kur njeriu të mendojë më mirë, sheh se britanikët, e sidomos anglezët, mezi që kanë diçka të tyre, që nuk është huazuar nga të tjerët*. Feja e tyre është semite; gjuha e tyre është 85% romane, latine dhe greke; arti i tyre është italo-francez; pasuria e tyre është arritur me shfrytëzimin e njerëzve nga kolonitë tejoqeanike dhe me grabitjen e pasurive natyrore të racave dhe popujve të tjerë; si popull ata janë më së paku britët dhe sasët autoktonë, kurse shumë më tepër ardhacakët dhe uzurpuesit, normanët dhe romanët; madje edhe çasti i tyre më i këndshëm – *tea time at five o'clock*, është mundësuar me çaj, një pije prej një bime nga Azia, e cila kurrë nuk është rritur në Angli!

⁵⁶ Odysseus, *Turkey in Europe*, London 1900, f. 94.

E megjithatë, ajo që është dëmi më i madh dhe dëm i përkompensueshëm i këtyre kritereve artificialisht të imponuara, të frymëzuara me epërsi ideologjike që të përçmohet ai Tjetri, në fakt është krijimi i një lloj astigmatizmi të përhershëm logjik dhe verbërie totale para fakteve! Me fjalë të tjera, çfarëdo qofshin në dritën e kritereve të *Odysseusit*, edhe turqit e Perandorisë Osmane, edhe britanikët, janë mu në krye të listës të popujve në bazë të arritjeve të mirëfillta në politikë, ekonomi, art, kulturë, në luftë dhe paqe! Për fat të keq, kjo verbëri dhe ky astigmatizëm tashmë kanë zënë rrënjë dhe kanë kaluar në sëmundje shumë të përhapur. Në këtë aspekt, shumë pak ka ndryshuar në raport me prodhimin shkencor jo-islam ndaj Islamit dhe muslimanëve nga koha e këtij studimi të botuar në vitin 1900 me pseudonimin *Odysseus*, deri te *Report Studies* bashkëkohorë. Emëruesi i përbashkët i të gjitha analizave të ngjashme, raporteve, projekteve shkencore-hulumtuese, si kurse edhe nismave politike të autorëve dhe institucioneve jo-islame, është kolonializmi i tyre kulturor i hapur. Eksplicit, sulmues, brutal; apo implicit, mbrojtës dhe i rafinuar – ky mentalitet kulturor kolonist përbën pa përjashtim pikën e tyre të përbashkët të referimit dhe e shënon kornizën e tyre të plotë konceptuale. Thelbi i mendësisë kulturore kolonialiste zbulohet në bindjen plotësisht të pakontestueshme, të promovuar në postulat, se në raportet e botëkuptimeve, vlerave dhe traditave islame dhe jo-islame, gjithnjë njëra anë është në të drejtë kurse tjetra në gabim, njëra superiore kurse tjetra inferiore, njëra përparimtare kurse tjetra e prapambetur, nëpërmjet së cilës vetvetiu nënkuptohet se *kjo e jona jo-islame* pa përjashtim dhe në çdo gjë ajo është korrektja, superiorja dhe përparimtarja, *kurse ajo e tyrja islame*, e gabuar, inferiore dhe e prapambetur.

Në këtë kontekst, manikeizmi kulturor i traditës europiane jo-islame, përbën jo vetëm emëruesin e përbashkët, por edhe konstanten e raporteve të përbërëses jo-islame të identitetit të Europës ndaj identitetit islam të Europës. Vetëm nga pikëpamja e postulimit jokritik të një parimi të këtyllë të ngurtë dhe dogmatik, i cili çdo gjë që është islame e klasifikon në kategori negative – dhe pa tjetër *më të ulët*, ka mundësi që injorimi i tillë kapital i fakteve antropologjike me peshë, e madje edhe kyçe, ka mundësi të krijohet pasqyrë e shoqërisë universale dhe në mënyrë *a priori* superiore kristiane, kurse inferiore islame, e sistemit të vlerave dhe botës shpirtërore! Vetëm në një optikë të këtyllë jokritike të astigmatizmit ideologjik, ka pasur mundësi të promovoheshin modele të kulturës dhe traditës vetjake në modelin e “vlerave universale njerëzore”, shoqërinë vetjake parrëvokueshëm ta ngrinte në modelin ideal “të realizimit autentik të lirisë dhe të drejtave njerëzore”, kurse standardet vetjake morale me autoritetin e parrëvokueshëm ta projektonte si meridiani zero, i cili në mënyrë kirurgjike ndan saktësisht “botën e së mirës” dhe “botën së të keqes”. Vetëm në këtë kontekst ka mundur të lindë paragjykimi i pafund arrogant, se identitetin e Europës e përbëjnë vetëm elementet kristiane, (krahas korrektimit shtesë, i cili është zgjeruar në shtojcën e imponuar *judeo-kristiane*), dhe ideja e cekët e marrë, që një komponent ashtu e fuqishme, imanente qytetërimore siç është qytetërimi islam, i cili identitetin evropian thelbësisht e ka trajtuar në vazhdimësi gjatë 14 shekujve të fundit dhe përfundimisht ka përcaktuar identitetin e tij aktual multiqytetëruës dhe multifetar, mund të eliminohet me veprimin foshnjarak të adoleshentit mburravec, i cili nga mllefi e pret fotografinë e vëllait të tij prej fotografisë së përbashkët!? Madje as dogmatikët bolshevikë nuk prisnin me gërshërë fotografitë, por përpiqeshin që së paku t’i retusho-

nin ashtu që të mënjanohej fytyra e ndonjë renegati të padëshirueshëm nga fotografia, ne të cilën përqafohej me tovarish Jozef Visarionoviç Stalinin!

Braktisja – *hic et nunc*, përfundimisht dhe përvokueshëm! – nga paragjykimi i manikeizmit kulturor, si postulat i brendshëm metodologjik i mendimit dhe praktikës europiane jo-islame politike, shkencore dhe mediale, përbën *conditio sine qua non* të perceptimit të identitetit autentik të Europës dhe sinergjinë e frytshme harmonike të të gjitha elementeve të cilat e përbëjnë këtë identitet! Gjithë puna është se ky moment jo vetëm që nuk është tash dhe këtu, përfundimtar dhe i përvokueshëm, por që atë tokë nuk mund ta shohë as marinari me shikimin më të mprehtë nga pika e vëzhgimit në drekun më të lartë të anijes, të kësaj anijeje të përbashkët në të cilën udhëtojnë në të ardhmen së bashku të gjithë europianët: muslimanët dhe jo-muslimanët, besimtarët dhe ateistët, të majtët dhe të djathtët, anti-semitët dhe anti-islamistët, ekstremistët dhe alternativistët, sionistët dhe neo-fashistët, kryqtarët dhe xhihadistët! Sepse, tash për tash ende duket i pamundshëm mënjanimi, madje edhe nga qasjet bashkëkohore, skajshmërisht asnjansë shkencore, i këtij motivi manikeist të rrënjosur thellë në tematizimin e aspekteve më të ndryshme të Islamit europian dhe muslimanëve europianë. Paragjykimet për modelin islam kulturor si “të gabuar”, kurse për muslimanët si “inferiorë” moralisht dhe intelektualisht, depërtojnë nga të gjitha anët, edhe nëpërmjet shtresave më të ngjeshura të objektivitetit shkencor. Është e mjaftueshme të vihet gishti te paralajmërimet e përhershme ndaj muslimanëve, se duhet t’i kuptojnë standardet europiane të mirësjelljes dhe vlerat europiane, sepse nuk kanë rrugë tjetër pos të harmonizohen me ta, pa marrë parasysh sa janë këto standarde të pranueshme për muslimanët dhe sa pajtohen këto

vlera me sistemin e tyre të vlerave. Pa marrë parasysh se a është fjala për konsumimin e alkoolit, apo për kostumet toples (pa pjesë të sipërme) në plazhet publike, për martesat e njerëzve të së njëjtës gjini, apo për praktikën e përhapur të përçmimit publik ndaj fesë, fakti se e tërë kjo është e papranueshme dhe madje rreptësisht e ndaluar dhe thellë në kundërshtim me kulturën islame, këto standarde të reja dhe në shumëllojshmëri të kontestueshme të mirësjelljes, të miratuara nga jo-muslimanët e Europës, pa kusht imponohen si normë edhe për evropianët muslimanë! Po ashtu pa kushte dhe pa kurrfarë debati thelbësor imponohen dhe pranohen *standardet e Bolonjës të arsimimit, ligji mbi ndalimin e pirjes së duhanit, ndeshjet e demave apo të qenve*, ndërsa njëkohësisht nëpër botë, sidomos në vendet të cilat këto dispozita paraprake i imponojnë si detyrim të përgjithshëm, me zhurmë të madhe lavdërojnë faktin që po rrënohen edhe bastionet e fundit të autonomisë së universiteteve, legalizohen drogat, lulëzon prostitucioni, fusin forma të reja të rrahjeve për para ekstremisht brutale të njerëzve gladiatorë, kurse ndotja industriale vazhdohet me refuzimin e ndotësve kryesorë botërorë që t'i nënshkruajnë protokollat për kufizimin e saj, ndonëse të gjithë duhanxhinjtë e botës së bashku, deri sot nuk kanë lëshuar në atmosferë përbërës kancerogjenë aq sa një fabrikë mesatare lëshon për një muaj apo sa prodhojnë për një ditë automobilat në ndonjë megapolis! Kjo anomali e dukshme në mirësjellje dhe absurde në gjykim bëhet, ndërkaq, krejtësisht e qartë kur të kuptohet se sjellja e atij që e dikton, njëkohësisht është yrneku (modeli) i përgjithshëm i racionalitetit, logjikshmërisë dhe dobishmërisë, pa marrë parasysh se faktet konfirmojnë pikërisht të kundërtën! *Nuk është e logjikhme dhe e mirë ajo që është e logjikhme dhe e mirë, por ajo që unë e bëj, pa marrë parasysh se ajo që e bëj unë a është apo jo e logjikhme*

dhe e mirë! – në këtë thënie imperative rrëgjohet tërë debati demokratik dhe arrihet konsensusi në marrjen e vendimeve me rëndësi për të gjitha vendet e botës.

Ashtu si sjellja dhe vlerat e shtetit më të fuqishëm të botës pa diskutim duhet të vlejné për vartësit dhe aleatët e tyre të drejtpërdrejtë si standard i mirësjelljes dhe detyrimeve që të pranohen pa kundërshtim, po ashtu mirësjellja dhe vlerat e europianëve jo-muslimanë, pa diskutim duhet të jenë orientuese e sipas të cilit harmonizohen mirësjellja dhe vlerat e europianëve muslimanë. Me këtë është rrumbullakësuar nënshtrimi, logjika e hierarkisë është sjellë deri në fund. Vëllai i madh është model për europianët jo-muslimanë, europianët jo-muslimanë janë model për europianët muslimanë. Europianët jo-muslimanë mësojnë nga europianët jo-muslimanë, europianët jo-muslimanë mësojnë nga Vëllai i Madh. Vëllai i Madh nuk mëson nga askush por për këtë të gjithë mësojnë nga ai! Në një studim të konceptuar metodologjikisht shkëlqyeshëm dhe të realizuar në mënyrë konsekuente këmbëngulet në qëndrimin se *ndër të gjithë europianët është e domosdoshme që të kuptohet saktësisht dhe të përcaktohet qartë vija ndërmjet kritikës dhe hipokrizisë*. Dhe menjëherë pas kësaj fjalie, e cila flet për të gjithë europianët, u drejtohet të gjithë muslimanëve, të cilëve me fjalë të zgjedhura me qëllim të mirë e në mënyrë pedagogjike u tregohet, se *duhet sa më parë të mësojnë që kritika është pjesë përbërëse e proceseve demokratike dhe se paaftësia e tyre (muslimane) ta dëgjojnë tjetrin, është problemi më i madh në debatin euro-musliman*.⁵⁷ Deri kur ky paternalizëm ndaj muslimanëve!? Deri kur do të jenë kjo dhënie leksioni dhe kujdestari!? Në debatin e europianëve muslimanë dhe europianëve jo-muslimanë (E jo në debatin e Europës dhe muslimanëve, sikurse, në pajtim me

⁵⁷ Jocelyne Cesari and Brookings' Vaisse, Report 2004.

praktikën e përhapur thonë gabimisht disa autorë, duke nënkuptuar se muslimanët nuk janë europianë, përkatësisht, se europianët nuk janë muslimanë!)⁵⁸ problemi i dialogut ekziston, por vetëm për arsyen se muslimanët nuk kanë mësuar që kritika është pjesë përbërëse e proceseve demokratike! Konkretisht, është e qartë se problemi qëndron që edhe muslimanët duan të kritikojnë dhe t'u përgjigjen kritikave, për çka nuk janë të aftë dhe për çka nuk kanë as të drejtë, në vend që të dëgjojnë kritikën dhe ta harmonizojnë sjelljen e tyre sipas atyre kritikave, sikurse është rendi nëse respektohet parimi manikeist i hierarkisë kulturore! Duke vënë në dukje se pas incidenteve me karikaturat e publikuara në Danimarkë në vitin 2005, të cilat fyejnë ndjenjat e tyre fetare dhe të cilat kanë nxitur protesta të ashpra të muslimanëve nëpër Europë dhe në shumë vende të botës, muslimanët gjithnjë e më shumë shfrytëzojnë mjetet legale që ta manifestojnë pakënaqësinë e tyre, Vaisse e nënvizon se kjo është shenjë e mirë, e cila konfirmon se muslimanët më në fund kanë filluar të besojnë në efikasitetin e institucioneve demokratike.⁵⁹ Mirëpo autorja nuk e komenton faktin që institucionet demokratike në çështjen konkrete të karikaturave daneze nuk e kanë miratuar asnjë vërejtje të muslimanëve, as nuk e kanë ndëshkuar autorin e karikaturave dhe redaktorët e revistave, të cilat e kanë botuar dhe përcjellë këto karikatura të inkriminuara fyese. Prandaj, të nxiten muslimanët që të kenë sa më shumë besim në *institucionet demokratike*, në rastin konkret është edhe që t'i nxisim ta pranojnë diskriminimin ekzistues,

⁵⁸ Është interesant se *astigmatizmi logjik* pengon që të shihet sa është në mënyrë elementare logjikisht i papranueshëm edhe vetë krahasimi *Islami dhe Evropa!* Me fjalë të tjera, islami është nocion teologjik, deri sa Evropa është nocion gjeografik! Ndarja e Islamit nga Evropa, paraqet mashtrim të palejueshëm logjik, i cili absolutisht më nuk duhet lejuar!

⁵⁹ Ibidem.

sepse në fakt kjo do të thotë të këshillohen muslimanët që të mos organizojnë kurrfarë protestash publike, por të shkruajnë ankesa të cilat institucionet demokratike edhe ashtu nuk do t'i miratojnë, ndërsa njëkohësisht për autorët e karikaturave të inkriminuara dhe ata të cilët pajtohen me praktikën e fyerjes së ndjenjave fetare të muslimanëve, vendimet e po këtyre institucioneve demokratike përbëjnë trimërimin e shprehur që ta vazhdojnë aktivitetin në këtë drejtim!

Diskriminimi i europianëve muslimanë dhe paragjykimet negative ndaj tyre

Përveç mashtrimeve të prodhuara në mënyrë sistematike, falsifikateve dhe miteve të destinuara për dëshmimin e tezës totalisht të pabazuar për identitetin ekskluzivisht kristian të Europës dhe identitetin jo-europian të muslimanëve, mjegullnajat e të cilës tashmë i kemi zbërthyer, qarqet anti-islame të nacionalistëve, shovinistëve dhe ekstremistëve europianë kultivojnë prej një kohe mjaft të gjatë edhe traditën e diskriminimit të muslimanëve në vepër, si të thuash, *in vivo!* Nga përndjekja e parë e madhe e muslimanëve dhe hebrenjve prej truallit europian në vitin 1492, nga Spanja dhe këtë pas tetëqind vjetësh të pranisë së tyre të vazhdueshme, së cilës i paraprinë masakrat e muslimanëve në ujdhesat Palma de Majorka, Korsikë, Sardenjë dhe sidomos përndjekja e egër në Sicili, dhe pas përndjekjes së 350.000 prej pasardhësve të tyre moriskosë të kristianizuar me forcë në vitin 1609, përndjekjet dhe diskriminimi i muslimanëve janë intensifikuar në Europë me emigrimin e tyre të rritur, sidomos nga fillimi i viteve shtatëdhjetë të shekullit XX. Të gjitha hulumtimet dhe anketat publike vërtetojnë qartë praninë dhe rritjen e vazhdueshme të diskriminimit ndaj muslimanëve

në të gjitha aspektet e jetës.⁶⁰ Kjo është lidhur sidomos me aspektet e rëndësishme jetësore, sikurse janë banimi, mundësitë e punësimit, kushtet e punës, qasja në arsimim, praktikimi i lirë e shprehive kulturore dhe detyrave fetare.

Një pjesë e hulumtuesve këtë rritje drastike dhe të vazhdueshme të presioneve diskriminuese mbi europianët muslimanë, përpiqet ta zbusë duke e lidhur me përkatësinë e tyre etnike dhe racore. Me fjalë të tjera, një pjesë e mirë e emigrantëve muslimanë, të cilët sot jetojnë si qytetarë të shteteve anëtare të BE, e përbëjnë të ashtuquajturit me ngjyrë, qoftë ky term i lidhur me muslimanët me prejardhje nga Azia, qoftë me muslimanët, rrënjët e të cilëve janë nga Afrika. Kjo është krejt e kuptueshme nëse merret parasysh fakti se Islami është shembull klasik i fesë universale, i cili përkatësinë e fesë e ngre lart mbi të gjitha përcaktimet e tjera kolektive, pa marrë parasysh a është fjala për përkatësinë racore, kulturore, etnike apo ndonjë tjetër. Mirëpo, po ashtu është e qartë se me këtë fakti i ekzistencës së praktikës intensive diskriminuese dhe paragjykimeve negative të jo-muslimanëve të Europës ndaj muslimanëve të Europës nuk është zbutur aspak, por përkundrazi është theksuar, kurse pozita e muslimanëve të cilët krahas kësaj edhe janë me ngjyrë, jo vetëm që nuk është lehtësuar por është vështirësuar qenësisht. Nëse nuk u mbahen vlerësimeve, të cilat sugjerojnë që *muslimanët po përballen me sfida më të rënda për shkak të përkatësisë racore, sesa për shkak të fesë së tyre*⁶¹ - sepse mbi ta kanë kaluar problemet e paragjykimeve të dyfishta, të cilat nuk përjashtohen reciprokisht por ngrihen

⁶⁰ Tregues të qartë në pasqyrën gjithnjë e më të keqe në aspekt të diskriminimit të muslimanëve paraqesin rezultatet e grumbulluara në BE Monitoring Center on Racism and Xenophobia Report 2006.

⁶¹ J.Caesary, Brookings-Vaisse. "... suggesting that Muslims are faring more serious challenges because of their racial rather than religious identity."

në katror⁶² - ashtu si as shpërfillja e forcës së stereotipave negative ndaj muslimanëve si faktorë të veçantë, me faktin që *dis-harmonia racore natyrisht e vështirëson integrimin, e për këtë arsye në fakt është i vështirë edhe integrimi i muslimanëve të Europës të cilët në shumicën më të madhe janë jo-të bardhë*,⁶³ siç pohon profesori për studime islame në Universitetin e Kembrixhit, Tim Winter.

Vlerësimi se jotoleranca, e madje edhe armiqësia e skajshme, shpesh është mjaft e theksuar përgjithësisht ndaj përkatësisë islame, pa marrë parasysh përkatësinë racore apo etnike, mund të ilustruhet qartë me një varg shembujsh madje edhe nga rajonet në të cilat muslimanët janë pjesëtarë të racës së bardhë, e krahas kësaj edhe europiane autoktonë, të cilët jetojnë aty prej vetë fillimit, si të thuash *ab ovo*. Në vitin 2001 shpërthimi i mostolerancës fetare burimisht të drejtuar mbi shqiptarët, i nxiti jo-muslimanët maqedonë në qytetin Manastir (ortodoksët maqedonë) të djegin dyqanet e muslimanëve torbeshë (përkatësisht goranë, të cilët janë pikërisht vetë ata që ua kanë djegur dyqanet dhe shtëpitë atyre që i konsiderojnë *maqedonë muslimanë*), ndërsa në Prilep, ku nuk jeton asnjë familje shqiptare, me këtë rast është djegur dhe deri më sot nuk është ringritur xhamia e shekullit XV, të cilën e ndërtuan turqit. Konfliktet e serbëve me shqiptarët në Kosovë në mars të vitit 2008, çuan te djegia e xhamisë së fundit në Beograd, Bajrakli Xhamia (shumë më herët para kësaj janë rrënuar dhe janë rrafshuar me tokën paraprakisht 249 nga gjithsej 250 xhami, sa ishin kur

⁶² Shumë herë kam pasur rast t'i dëgjoj muslimanët emigrantë nga vendet e Ballkanit, të cilët dëshmojnë se shpesh janë përballur me situatat në të cilat në vendet e BE iu kanë folur që *do ta kishin më lehtë t'i pranajnë sikur të ishin zezakë, se sa që janë muslimanë*, deri sa sërish muslimanët nga vendet e Afrikës qendrore, Indisë, Pakistanit dhe Bangladeshit, po këta njerëz i kanë bindur që *kjo që janë muslimanë nuk do të ishte problem, vetëm të mos jenë me ngjyrë*.

⁶³ Tom Winter, Report, 2007

pushteti osman e lëshoi Beogradin) dhe në Nish, pra në qytetet në të cilat shqiptarët as nuk kanë jetuar gjithnjë, as nuk kanë ndërtuar asnjë të vetme xhami. Përndjekjet, masakrat, gjenocidi të cilin serbët e kryen ndaj boshnjakëve, gjatë agresionit mbi Bosnjën dhe Hercegovinën në vitet 1991-1995, kur rrënuan edhe mbi një mijë xhami, janë paraqitur dhe janë arsyetuar nga krerët serbë si *hakmarrje ndaj turqve*, e jo si akt i urrejtjes ndaj muslimanëve dhe përkundër asaj, që të gjithë e kishin të qartë në mënyrë të përkryer, se Islami është lidhja e vetme me turqit, e boshnjakëve të vrarë dhe të përndjekur, dhe se pikërisht anti-islamizmi, pra fakti që edhe boshnjakët edhe turqit janë *muslimanë*, ishte edhe motivi i vetëm i krimeve në masë, i përndjekjeve dhe gjenocidit të kryer mbi boshnjakët. Vetëm anti-islamizmi ekstrem dhe irracional mund të merrte guximin, që vrasjet masive, gjenocidin dhe përndjekjen e përfaqësuesve të një populli të orvatej ta paraqiste si akt të hakmarrjes së drejtë kundrejt popullit tjetër, kështu që si një pohim të tillë absurd ta bënte koherent dhe të pranueshëm vetëm për islamofobët e përbetuar; për të cilët logjika e urrejtjes është logjika e vetme e vlefshme. Përndryshe, kërkimi i preteksteve më absurde që të arsyetohet fushata mediatike ose politike mbi muslimanët, apo aksioni konkret policor dhe ushtarak kundër muslimanëve e vendeve islame, tashmë është skemë e përvijuar dhe shabllon i përpunuar mirë si i përmasave lokale ashtu edhe ndërkombëtare. Orvatja e injorimit të plotë të shpërpjesëtimit të madh në pozicionimin ndërkombëtar, në potencialet ushtarake, sidomos në pikëpamje të armëve bërthamore, dhe ekspozimi ndaj përndjekjeve dhe agresionit të vërtetë, nga ana e shteteve islame dhe jo-islame, në dëm të atyre islame, sikurse edhe paaftësia që të kundrohesh ato shpërpjesëtime, disa komentues i quajnë *analiza korrekte*, të cilat me të njëjtin kut do t'i matin edhe

muslimanët edhe jo-muslimanët në raport me ekspozueshmërinë e tyre ndaj diskriminimit, sikurse edhe në mostolerancën së cilës ata ia ekspozojnë të tjerët. Ndër shumë prej tyre, po theksojmë shembullin e dekanit të Studimeve Islame, zotëri Akbar Ahmedin, i cili thotë se ... *pa marrë parasysh që mostoleranca nuk është rrëgjuar në vetëm një grup, muslimanët bëhen me lehtësi objektivi i saj për shkak të terrorizmit* (qartë që Akbar Ahmedi këtu nuk ka kurrfarë rezerve duke ia veshur terrorizmin vetëm një grupi dhe këtë pikërisht muslimanëve?!), *por nuk duhet hequr nga vëmendja as fakti që në Europë pa pushim vlon anti-semitizmi musliman.*⁶⁴

Aferim! As Bat Ye'or-i nuk do t'u bënte shërbim më të keq muslimanëve! Pra, nëse e përmbledhim atë që zotëri Chairman of Islamic Studies at the American University ka thënë me këtë, rrëfimi është krejt i thjeshtë: mostoleranca ekziston ndaj grupeve të ndryshme, por muslimanët janë me plot arsye objektivi kryesor. Për shkak të terrorizmit të tyre famëkeq të njohur dhe të pakontestueshëm. Dhe kjo nuk është e tëra! Këta muslimanë në Europë nuk pushojnë së ngrohuri kazanin në të cilin vlon anti-semitizmi! Nëse për ndonjë arsye edhe ua falim terrorizmin, anti-semitizmin assesi nuk duhet. Sepse është e ndaluar dhe këtë në mënyrë të shprehur, në të gjitha dokumentet përkatëse të OKB. Krejt e arsyeshme. Duke marrë parasysh atë që u kishin përgatitur Adolf Hitleri & Company, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Anti-islamizmi, ndërkaq, (ende) nuk është ndaluar me asnjë akt nga asnjë organizatë askund në botë dhe për këtë arsye çdokush, por edhe zotëri dekani për të cilin është fjala, mundet lirisht ta përhapë sipas qejfit! Madje edhe me firmën e objektivitetit shkencor dhe paanësisë ideologjike!

⁶⁴ Akbar Ahmed: *Journey into America: The Challenge of Islam*, Brookings Press, June 2010, f. 1.

Sigurisht treguesi më i papërshtatshëm në këtë tregim është fakti që Akbar Ahmedi krejt i sigurt vepron në pajtim me bindjen se po bën atë që është jo vetëm korrekte, por edhe më e mira për muslimanët, për integrimin e tyre social dhe kulturor, sikurse edhe tolerancën më të madhe të rrethit shoqëror jo-musliman ndaj muslimanëve. Kjo nga aspekti psikologjik është bindje krejtësisht e kuptueshme dhe e pritur. Ai i cili është më i dobët, sipas rregullit, dëshirat e tij i projektton sipas më të fuqishmit dhe beson që ky në tërësi me të i ndanë. Megjithatë, realiteti është krejtësisht i kundërt nga pritja e tyre. Fjala është për një fenomen të veçantë, për *paradoksin e mospajtueshmërisë kulturore*. Në Europën bashkëkohore, as integrimi, e as asimilimi nuk janë praktikisht të mundshëm ndërsa një grup i ruan manifestimet apo qoftë madje vetëm karakteristikat simbolike të identitetit të tij musliman! Madje edhe muslimanët e Ballkanit, të cilët janë banorë autoktonë të Europës, për shkak të statusit të tyre të grupit, objektivisht të diskriminuar, dhe të cilët më së shpeshti besojnë që bashkëqytetarët e tyre joislamë (kristianë lindorë dhe perëndimorë) do t'i pranojnë si të barabartë me ta, shpejt u bindën që vetëdija për dallimin kurrë nuk humbet. Dhe këtë madje si vetëdije të shënuar hierarkike për dallimin në të cilin faktori islam shënon versionin e identitetit inferior, të ulët, submisiv, joautentik, i cili autentitetin e tij të plotë e ka vetëm në versionin kristian perëndimor dhe lindor të identitetit shoqëror. Në praktikë, në çdo hap, konfirmohet se largësia, e madje edhe aversioni ndaj Islamit dhe muslimanëve, është aq i fortë që në asnjë rast të vetëm nuk është humbur as fshirë. Boshnjakët si popull autentik islam, në periudhë prej 1945-1992 masivisht kanë hequr dorë nga çfarëdo praktikimi të detyrave fetare, me qëllim që kështu ta eliminojnë atë momentin më të dukshëm të dallimit nga qytetarët e tyre serbë dhe

kroatë, (të cilët edhe në kohën e socializmit kryesisht edhe më tej rregullisht i janë përkushtuar traditave të tyre fetare, gjoja për shkak të zakoneve dhe traditave, e jo për shkak të bindjes), por edhe këta edhe ata i kanë përcaktuar si *muslimanë, jobesimtarë, heterodoksë, turq*, shkurtimisht, si *të huaj dhe armiq*. Ky qëndrim ka kulmuar gjatë natës në masakra masive, grabitje, dhunë dhe gjenocid mbi boshnjakët, vetëm për shkak që identiteti i tyre musliman për asnjë çast nuk është pranuar as për integrim, edhe më pak si faktor i asimilimit të (pa)mundshëm. Në formën shumë më të butë, edhe pse jo edhe beninje, vula e përkatësisë muslimane është treguar si faktor i pashlyeshëm kualifikues në rastin e *pomakëve, goranëve*, përkatësisht *torbeshëve*. Ata pjesëtarë të këtyre kolektiviteteve etnike, përkatësisht të këtyre popujve, të cilët kanë pranuar të deklarohen si *bullgarë, serbë*, përkatësisht, *maqedonas*, automatikisht e kanë pranuar etiketën e cila i ka vendosur në rend më të ulët të këtyre popujve, dhe kështu janë *bullgarë muslimanë, serbë muslimanë, maqedonë muslimanë*, ndërsa pjesëtarët kristianë kanë mbetur të privilegjuar si përfaqësues autentikë të këtyre popujve me emërimin pa etiketë: *bullgarë, serbë, maqedonas*.

Kjo mosfshirje e përkatësisë muslimane të shënuar qoftë vetëm nominalisht, e cila në sytë e bashkëqytetarëve kristianë perëndimorë apo lindorë nëpër Europë, në fakt është një lloj i vulës së inferioritetit, turpit dhe armiqësisë, është konstatuar edhe në shumë hulumtime sociologjike dhe socio-psikologjike. Si karakteristike do ta theksojmë mendimin i cili i përmbledh përfundimet e këtyre hulumtimeve, kurse i cili e thekson vlerësimin se muslimanët europianë janë *larg nga çfarëdo shansi serioz që të bëhet ndonjë kërcënim demografik për Europën*, sepse në thelb: “Muslimanët europianë jetojnë nga koha e huazuar, që do të thotë se në rast të ndonjë sulmi të madh terrorist në

Europë, duke iu falënderuar ‘shpirtligësisë së paçrrënjësor’ të evropianëve dhe asaj që quhet *tendenca historike në reaksionin e stërtheksuar në rastin e kërcënimit real*, po këta muslimanë evropianë do të jenë me fat nëse evropianët vetëm do t’i deportonin dhe dëbonin nga Europa.”⁶⁵ (Italiku, FM).

Vlerësimin që evropianët muslimanë, përkatësisht, të gjithë muslimanët e botës, nuk paraqesin kurrfarë kërcënimi real, qoftë kulturor, qoftë politik, qoftë demografik, për Europën, e theksojnë edhe hulumtuesit e tjerë të kësaj çështjeje. Duke polemizuar me shumë prej tyre, me Ralf Petersin dhe sidomos me tezat të cilat i përfaqëson Robert Leiken, profesori Liat Redcliff Ros në studimin *Muslimanët e ndarë të Europës*⁶⁶ teston parashikimet katastrofike për gjoja kërcënimin e Europës prej muslimanëve, duke i argumentuar argumentet e tij kundër me faktet reale demografike. Më së shumti hapësirë në këtë polemikë Ros i ka kushtuar qëndrimeve të shpjeguara në studimin e Robert Leiken *Muslimanët e zemëruar të Europës*⁶⁷, i cili ka hasur në përkrahjen e fuqishme të qarqeve ekstreme djathtë të anti-islamiste dhe ka nxitur polemika të rrepta në qarqet e specialistëve. Teza themelore e këtij studimi të Leikenit rrëgohet

⁶⁵ Peteres, Ralph (2007). *Wars of blood and faith: the conflicts that will shape the twenty-first century*. Stackpole Books, pf. 333-334. “Europe’s Muslims are living on borrowed time and in the event of a major terrorist attack in Europe, thanks to the ‘ineradicable viciousness’ of Europeans and what we perceives as a historical tendency to over-react to real or perceived threats, European Muslims will be lucky if they’re only deported.”

Fjalja përfundimtare e këtij citati është iluzion i drejtpërdrejtë, nëse jo edhe thirrje implicite për evropianët jo-muslimanë që qytetarëve të evropianëve muslimanë t’u përgatisin po atë fat të cilin mbreti i Spanjës Filipi III ua ka përgatitur muslimanëve dhunshëm të kryqëzuar – moriskosëve kur, para treqind vjetëve, një pjesë i ka vrarë e një pjesë e ka dëbuar, deri te i fundit, nga Gadishulli Iberik, e kjo do të thotë edhe prej Europës.

⁶⁶ Liat Redcliff Ross, “Europe’s divided Muslims”, *Foreign Affairs*, January/February, 2005.

⁶⁷ Robert Leiken, “Europe’s Angry Muslim’s” *Foreign Affairs*, July/August 2005.

në pohimin se muslimanët e Europës janë “grup i caktuar qartë, kompakt, koheziv dhe i zemëruar”. Në bazë të kësaj, Leiken përfundon që grupet terroriste islame nuk duhet krahasuar me grupet marginale terroriste europiane, për shkak se terroristët islamë kanë *bazë të fuqishme sociale nga e cila i fillojnë operacionet e tyre*. Implikimi i cili është më shumë se kaq, edhe pse nuk është as pohim krejtësisht i drejtpërdrejtë apodikтик, me fjalë të tjera se të gjithë muslimanët e Europës janë të përfshirë aktivisht në ato operacione terroriste, ose i përkrahin, mbeten porosia kryesore e këtij kontributi të Leikenit. Pasi ka konstatuar që Leikeni nuk ofron absolutisht kurrfarë argumentesh empirike, apo empirike të verifikueshme, Redklif Ros, i demonstroi qartë faktet që muslimanët europianë nuk janë as *qartë të caktuar, as kompaktë, as kohezivë, as grup i zemëruar*. Numrin shumë më të madh të muslimanëve europianë sot e përbëjnë muslimanët të cilët në Europë kanë emigruar pas Luftës së Dytë Botërore dhe pasardhësit e tyre, dhe këtë nga rajonet krejt të ndryshme sikurse janë Maroku, India, Indonezia, Turqia. Leiken plotësisht e ka shpërfillur faktin se sipas statistikave më të reja, muslimanët përbëjnë vetëm 2.7% të popullatës së përgjithshme britanike, dhe se për këtë arsye numri i tyre, llojllojshmëria e madhe kulturore e traditave të tyre, barrierat gjuhësore dhe prejardhja nacionale, përjashtojnë çdo mundësi që të paraqesin çfarëdo kërcënimi për Britaninë, Europën apo SHBA, përfundon Redklif Ros.⁶⁸

Terrorizmi: kërcënim, instrument, alibi

Gjatë disa dhjetëvjeçarëve të fundit, Islami gjithnjë e më intensivisht dhe me të gjitha mjetet ndërlihet me terrorizmin.

⁶⁸ Po aty. Liat Redcliffe Ross, St. Antony's College, Oxford.

Nuk kanë munguar rezultatet e kësaj fushate të orkestruar mirë nga ana e mediave më me ndikim dhe strukturave politike të shteteve më të fuqishme të botës. Sot këto dy nocione janë në asociacion automatik: thuajse nuk ka njeri i cili ndaj fjalës “terrorizëm” nuk do të reagoonte automatikisht me asociacionin të “Islami” dhe e kundërta. Shprehja “terrorizmi islam” – në zharqonin e përditshëm politik përbën një të vërtetë të rëndomtë, ngjitjen e pashkëputshme të Islamit dhe terrorizmit, dhe në këtë formë funksionon si sintagmë klasike. Do të mund të thuhet se ka vajtur në prag të tautologjisë së vetëkuptueshme, të zgjeruar pa nevojë, të tipit “nënëmadhja (fjalamane)”. Në disa anketa telefonike të kryera në Britani, Gjermani, Spanjë, Francë dhe Itali, 87% të të anketuarve janë të bindur se terrorizmi është fenomen i një date më të vonë, i futur në Europë nga ana e qarqeve militante islamiste fundamentaliste, dhe që të harmonizohet me vendimin e qendrave radikale që muslimanët të ndër marrin një lloj *të luftës së shenjtë* kundër të gjithë kristianëve, para së gjithash, kundër vendeve më të zhvilluara të Perëndimit, si përfaqësuese udhëheqëse të botës së përparuar demokratike!? Anketa të ngjashme në SHBA kanë treguar se përqindja e atyre të cilët e besojnë këtë të pavërtetë famekeqe historike madje arrin numrin prej 93%?? Kushdo qoftë që është përpjekur të njihet me historinë e terrorizmit, si taktikë dhe strategji e luftës politike, ka mundur të bindet sesa larg nga e vërteta është kjo lajthitje e përhapur! Edhe përkundër të gjithave, me këtë mosnjohje të pabesueshme të fakteve, nuk duhet as të çuditemi shumë. Thuajse të gjitha studimet bashkëkohore të kushtuara terrorizmit, praktikisht pa përjashtim, e trajtojnë terrorizmin pikërisht si shfaqje të viteve të fundit, gjatë të cilave si pikë më e shpeshtë referimi është lidhur me ndodhitë e 11 shtatorit 2001. Madje edhe njëri prej studimeve më të bazuara i datës së

vonë, libri i Ekatarina Stepanova, *Terrorizmi në konfliktin asimetrik*, e lë pas dore plotësisht historinë e terrorizmit, prejardhjen e tij dhe motivet, kurse që nga vetë fillimi përqendrohet në *terrorizmin famëkeq islam*.⁶⁹ Sikurse edhe shumica e shfaqjeve të tjera negative apo destruktive, të cilat u vishen muslimanëve, Islamit, *orientit*, si monopol i tyre ekskluziv dhe shprehje e “planeve të tyre të zjarrta”, dhe terrorizmi në fakt është monopol historik i Europës perëndimore, i cili është zgjeruar edhe në Rusi. Vëllezërit Babëfi, Luis August Blankia, Pisarevi, Neçajevi, Bakunini ... sikurse edhe tradita e gjatë dhe dramatike e lëvizjes anarkiste në Europë, paraqesin emrat e të parëve të terrorizmit dhe lëvizjeve politike të bazuara në përdorimin e tij, si forma të luftës politike të të shtypurve kundër regjimit tiranik të shtetit totalitar! Louis August Blankia (1801-1881), i cili konsiderohet themelues teorik dhe terrorist i parë i kohës së re, që i solli titullin *Apostull i terrorizmit*, e ka filluar aktivitetin e tij terrorist 170 vjet *para shënjesit të vendosur në studimet e reja në format e para të praktikës terroriste islame!*? Teoria e tij e luftës terroriste kundër shtetit si terroristi më i madh, është vendosur pikërisht mbi baza të *konfliktit asimetrik*! Sipas konceptimit themelor të këtij luftëtari kundër shfrytëzimit të pakufizuar të punëtorëve dhe për të drejta më të mëdha të punëtorëve, shteti totalitar, i cili është pakrahasueshëm më i fuqishëm nga qytetarët mbi të cilët bën terror të pandëshkueshëm, mund të dëmtohet seriozisht dhe të shtyhet të korrigojë sjelljen e vet, vetëm me goditje të projektuara mirë dhe të paparashikuara të grupeve të vogla të organizuara, të gatshme të sakrifikojnë jetën e tyre në emër të lirisë dhe dinjitetit! Në përpunimin e mëtejme

⁶⁹ Ekaterina Stepanova, *Terrorism in Asymmetrical Conflict; Ideological and Structural Aspects*, Oxford University Press (2008). (Libri mund të lexohet edhe në: <http://books.sipri.org/files/RR/SIPRIRR23.pdf>. (data: 23. 05. 2012 – përkthyesi).

të konceptimit të tij, Blankia tregon karakterin asimetrik të forcave të shtetit, si oponentë ndjeshëm më të fuqishëm, dhe kapaciteteve krejt të vogla por megjithatë jo krejt të pafuqishme të qytetarëve të shtypur! Shpërpjesëtimi në fuqi thjesht e imponon përgjigjen e vetme të mundur - e kjo është përhapja e frikës, pasigurisë, tmerrit (frëngj.: *terreure* = *tmerr*), si mjete për vendosjen e një barazie dhe zbutjen e asimetrisë ekzistuese të forcave. Ashtu si bleta, sado qoftë e vogël, hyn në konflikt asimetrik me ariun i cili do ta vidhte mjaltin e saj (apo me njeriun), me pickimin e paparashikueshëm dhe të dhimbshëm të thumbit helmues dhe megjithatë i mbanë sytë çelë, ashtu edhe punëtorët, djersën e të cilëve e vjedh ariu/shteti, i cili bëhet shumë më i kujdesshëm ndaj punëtorëve që kohë pas kohe japin pickime të dhimbshme me thumbin e tyre helmues! Dhe pa marrë parasysh që bleta e cila e pickon sulmuesin, zakonisht ngordh, trimëria e saj megjithatë ka pasoja të përhershme: çdo pickim e paralajmëron sulmuesin, e rrit sigurinë e bashkëqytetarëve të sulmuar, e zvogëlon numrin e sulmeve të qëllimshme mbi bletët e tjera, kudo në botë. Po ashtu edhe grupi terrorist i cili vdes apo gjykohet me vdekje, sipas Blankia-s, megjithatë nuk vdes së koti, por objektivisht vendos një lloj situatë të re, në të cilën frika nga pickimi i ri shpie deri te respektimi më i madh, qoftë edhe i imponuar të të drejtave të punëtorëve! Në bazën e konceptit të tij të terrorizmit, figuron bindja e Blankia-s se nuk ka asgjë moralisht kontestuese në të drejtën e të dobët që me të gjitha mjetet të luftojë kundër të fortit, i cili e kërcënon dhe e vë në pikëpyetje mbijetesën e tij. Në vetë burimet e tij, terrorizmi prej fillimit është pikëpamje *mbrojtëse* (defanzive) dhe *reaguese* (reaktive) e luftës, më së pari për shkak se mbrohet, e pastaj që të mbrohet nga sulmi paraprakisht tashmë i kryer prej armikut në mënyrë asimetrike më të fuqishëm, ndaj të cilit reagon!

Në këtë kontekst, është interesant injorimi sistematik dhe heshtja e historisë së terrorizmit, vendosja e tij ekskluzive buri-more europiane, si edhe karakteri i tij mbrojtës dhe reagues në luftë kundër armikut pakrahasueshëm më të fuqishëm, i cili tashmë prej një kohe të gjatë bën dhunë, kundrejt së cilës nuk mund të jepet përgjigje ndryshe, përveçse me organizimin e akcioneve terroriste, pa të cilat dhuna e më të fortit ndaj të dobtëve realisht kurrë nuk do të pushonte, as dhunuesi vetë nuk do ta korrjonte sjelljen e vet dhe as ta zbuste atë! Pa analizë të hollësishme të aspekteve historike, ideologjike dhe strukturore të terrorizmit, asnjë studim i të ashtuquajturit *terrorizëm islam*, thjesht nuk ka vlerë as të shkruhet, edhe aq më pak, po të shkruhet pa këto momente – as të lexohet! Së këndejmi është e domosdoshme të shqyrtohet hollësisht sa është i ashtuquajturi *terrorizmi islam* projekt autokton i ideologjisë islame dhe si i tillë, sa paraqet kërcënim real për sistemin e paqes në botë, i cili si i tillë, nuk paraqet kurrfarë rreziku për shoqëritë islame dhe nuk bën asgjë kundër shteteve islame; sa është instrument për udhëheqjen e strategjisë afatgjate globale dhe për realizimin e agjendës së fshehtë të shteteve më të fuqishme në duart e politikës globale anti-islame; sa është alibi për politikën e deritashme agresive denoncimi i Islamit dhe satanizimi i muslimanëve dhe për ndërmarrjet e ardhshme të ngjashme etj.!?

Në dritën e fakteve konkrete të cilat janë në horizont të opinionit europian dhe botëror (më saktë, të cilat janë zgjedhur që të gjenden në sytë e opinionit), nuk ka kurrfarë dyshimi se fokusi i debatit rreth emigracionit të rritur të muslimanëve në Europë dhe integritit të tyre në traditën kulturore dhe sistemin e vlerave janë të përcaktuara qenësisht nga frika gjithnjë e më e madhe dhe sistematikisht e prodhuar prej radikalizmit islam. Sulmet në Londër dhe Madrid këtë frikë e bënë bindëse

dhe realisht të arsyeshme në sytë e një numri më të madh qytetarësh europianë. Gjatë kësaj, sipas parimit “me të thatin digjet edhe i njomi”, roli i qengjit kurban shpesh u përket tërë muslimanëve, të cilët jetojnë në Europë, duke përfshirë edhe europianët-muslimanë autoktonë, sikurse edhe miliona muslimanë emigrantë, të cilët janë qytetarë të qetë të shteteve europiane në të cilat jetojnë dhe punojnë. Politika e mosbesimit ndaj muslimanëve në këtë mënyrë bëhet qëndrim i përgjithësuar, edhe pse përpunimi i tij në praktikë tregon një sistem trishkallësh të mosbesimit, nga e vogla kah e madhja dhe nga kontrolli i mbuluar deri te aksioni konkret, në pajtim me kategorizimin trishkallësh të muslimanëve në: *muslimanë në dukje të integruar dhe haptas joproblematikë (dyshimi i nënkuptuar gjithnjë mbetet); pengimi dhe ngadalësimi i rekrutimit të terroristëve potencialë nga radhët e ekstremistëve të identifikuar; me kapjen dhe arrestimin e operativistëve terroristë në të gjitha rolet dhe në të gjitha nivelet.*⁷⁰ Se fjala është për gjendjen të cilën K. G. Jungu e quan *deluzionet paranoike sekondare*, të lidhura me përkatësinë fetare të muslimanëve, e konfirmon aksioni i kontrollit sistematik dhe të vazhdueshëm praktikisht i të gjithë muslimanëve në truallin e Europës, i motivuar me mosbesimin e përgjithshëm të europianëve jo-muslimanë ndaj europianëve muslimanë, për të cilin nga qendra më e rëndësishme tekstualisht thuhet: “Në përgjithësi mund të jemi të kënaqur. Vendet europiane kanë bërë punë mjaft të mirë në përcjelljen dhe kontrollin e muslimanëve dhe të terroristëve potencialë.”⁷¹ Kontrolli dhe përcjellja e të gjithë muslimanëve nuk e harron asnjë kategori pa marrë parasysh në prejardhjen etnike, statusin social, gjininë,

⁷⁰ Julianne Smith, director of the Europe Program at CSIS, Introductory note to the 2007 Report .

⁷¹ Robert S. Leiken, director of Immigration and National Security Program for U.S. - Nixon Center, 2009.

moshën, profesionin, arsimimin, nëse një element i identitetit të tyre tregon në përkatësinë islame. Diversiteti i identitetit etnik, kulturor, gjuhësor i europianëve muslimanë shihet, jo si pasuri kulturore apo moment pozitiv në realitetin multikulturor të Europës, por para së gjithash si moment potencialisht i favorshëm, sepse e vështirëson komunikimin e tyre dhe harmonizimin rreth aksioneve terroriste dhe përkundër prirjes rreptësisht të theksuar ndaj radikalizmit.”⁷² Duke zbuluar se sa themelësisht dhe sistematikisht është kryer kontrolli i deritashëm i europianëve muslimanë, Robert Leiken, cek klasifikimin e bashkësive muslimane nga e tërë Europa, duke mos përjashtuar tekstualisht asnjë, dhe këtë sipas parimit të dallimit në shkallën e ekstremizmit të tyre (*nënkuptohet se të gjithë muslimanët janë ekstremistë, por megjithatë nuk janë të gjithë njësoj ekstremistë* – vërejtje e F.M.), duke theksuar se muslimanët britanikë shkaktajnë më së shumti brengosje nga të gjithë të tjerët.⁷³

Shihet më se qartë mosnjëjtësia dhe mosbarazia thelbësore e europianëve muslimanë dhe europianëve jo-muslimanë dhe në raportet nga këto dy aspekte! Le të mendohet për faktin se pa kurrfarë hutimi dhe shqetësimi citohen pjesë të shkëputura nga *Manifesti* i Anders Breivikut, në të cilat ky vrasës i përbindshëm nga Osloja, me gjithë zemër i lavdëron *serbët siç ishte Millosheviqi, që kishin për qëllim t'i dëbonin nga Kosova të gjithë shqiptarët dhe t'i mbytnin në Detin Adriatik! Për arsye se shqiptarët nga Kosova - janë muslimanë!* E për muslimanët nuk ka vend në Europë! Edhe prej kësaj deklarate del qartë, se pjesa më e madhe e opinionit jo-musliman europian ka më shumë mirëkuptim sesa është e gatshme qartas të gjykojë ushtrinë serbe, e cila ka shkaktuar eksodin dhe krime të shumta në

⁷² Nonpartisan U-S- funded Congressional Research Service Report 2005.

⁷³ Robert S. Leiken, ibidem.

Kosovë në vitin 1999 dhe këtë ndaj një popullsisë civile. Dhe sërish, për fat të keq, është krejt qartë përse. Fakti që viktimat kanë qenë civilë, do të mund të paraqiste problem, por meqë këto viktima kanë qenë muslimanë, atëherë jo vetëm që nuk është problem, por është një ndërmarrje që meriton lëvdatë. Sikurse edhe në shumë shembuj të tjerë, edhe këtu shihet në vepër tërë thellësia e paragjytimeve, të cilat jo-muslimanët evropianë i kanë ndaj muslimanëve evropianë. Mirëpo, jo edhe *vice versa*! Me fjalë të tjera, paragjykimet ndaj muslimanëve janë të rrënjosura aq thellë që jo vetëm jo-muslimanët, por as vetë muslimanët nuk mund as të mendojnë për ndonjë reciprocitet në paragjytime!? Jo-muslimanët kanë kultivuar mosbesim të pandarë ndaj muslimanëve. Me një varg institucionesh të specializuara shtetërore e përcjellin këtë mosbesim në të gjitha aspektet e jetës së përditshme dhe mbi të gjitha kategoritë e muslimanëve, ndërsa ata të cilët i konsiderojnë si aktivistë terroristë i përcjellin, i kontrollojnë, i shënjojnë si potencialisht të rrezikshëm, i arrestojnë. Të përpiqemi tash seriozisht ta kuptojmë fjalinë vijuese: *“Muslimanët e Europës, të cilët gjithashtu kultivojnë, apo mund të kultivojnë mosbesim ndaj evropianëve jo-muslimanë, nuk kanë absolutisht asnjë institucion shtetëror, i cili mbi baza reciprociteti, do të kontrollonte dhe përcillte, vendoste dhe arrestonte ata të cilët vetë i konsiderojnë të rrezikshëm!”* Ide paradoksale, absurde, e kotë, do të thoni? Edhe kush do ta lejonte këtë, kujt kjo mund t’i shkonte në mend!? Ashtu. Keni të drejtë. Por vetë fakti që ideja për reciprocitet ndërmjet muslimanëve evropianë me jo-muslimanët evropianë objektivisht përbën një absurditet të paparë, flet mjaft qartë për pabarazinë e thellë të tyre dhe diskriminimin thelbësor të muslimanëve!

Është interesant, në këtë kontekst të njëjtë, të theksojmë se imazhet si ato të James Bondit, janë shumëfishuar me progresi-

on geometrik në produksionin bashkëkohor filmik dhe televiziv, që mishërojnë mbrojtësin e guximshëm, magjepsës, të pathyeshëm të vlerave më të larta të Europës në luftë kundër armiqve djallëzorë, të errët, mjaft shpesh islamë, të çdo gjëje që është pozitive, janë pranuar krejt normalisht, të mos them, *natyrisht*, si nga jo-muslimanët ashtu edhe nga muslimanët në mbarë botën. Ndarja e roleve sikur është kryer përfundimisht dhe aty nuk ka më askush kurrfarë vërejtjesh. Nëse paraqiten në një rrëfim, muslimanët janë *djelmoshat e ligj*, ndërsa të gjithë *djelmoshat e mirë* pa përjashtim janë jo-muslimanët (në praktikë janë rrëgjuar në Bondin dhe procesionin e pafund të heronjve të SHBA, që është shenjë e qartë të ekzistencës së *intra-hierarkizmit*, nëse jo tashmë të *intra-diskriminimit* edhe në taborin e mbrojtësve të vlerave morale dhe qytetëruese); në realitet, muslimanët ndoshta edhe fitojnë ndonjë rol pozitiv, duke u dashuruar fort, por sipas rregullit, pa shpresë (më së shpeshti i vret bashkëfisasi i tyre, muslimani xheloz). Pas aventurës së detyrueshme dashurore, nëse mbetet e gjallë, muslimaneja e bukur pjesën e mbetur të jetës mallëngjehet dhe qan për heroin e saj të pafat jo-musliman, i cili i ka ofruar tërë atë për çka një femër ëndërron e që muslimanët kurrë nuk do të mund t'ia jepnin. Dhe kjo nuk është e rastit. Të sillet muslimania *back to England*, edhe të martohet! – kjo për James Bond-in do të ishte fundi dhe akti me të cilin do të zhgënjente totalisht shikuesit e tij jo-muslimanë. Për shikuesit muslimanë, një zhvillim i tillë përbën përbuzje të pastër dhe do të paraqiste më pak besueshmëri nga akrobacitë më të çmendura të Bondit dhe kërcimet pa parashutë nga aeroplanët! Kurse e kundërta nuk mund të ndodhë kurrë! Heroi negativ musliman (imagjinojeni zezakun, e edhe musliman, i cili dëshiron ta rrëmbejë Xhejnin nga Tarzani i saj, të sjellim ndër mend lordin e lindur Greys-

tock!?) – muslimanët as janë fare të aftë për ndjenja të tilla, sepse si parim te figurat filmike muslimane gjithnjë tregohet se fjala është për lakminë kafshërore të keqbërësit!

Në qoftë se dikujt kjo ligjëratë antropologjike i duket e panevojshme, respektivisht, se nuk tregon vetvetiu kurrfarë paragjykimi të Europës jo-muslimane ndaj Europës muslimane, vetëm le të pyesë se si kjo që deri tash nuk është bërë asnjë film me role krejtësisht të ndërruara. Filmi në të cilin ndonjë *James Bond* musliman, tërheqës, mendjemprehtë, magjepsës, i rrezikshëm për kriminelin, mbrojtës i të dobtëve, joshës për femrat, që ka plaçkitur nëpër Londër dhe Nju-Jork, i ka mposhtur me radhë djelmoshat më të rrezikshëm të Intelligence Service-it, ka depërtuar nëpër skuta të fshehta dhe burgje të thella, të cilat në mbarë botën i mban CIA, dhe i ka shkatërruar, i ka thyer rrjetet e agjentëve sekretë perëndimorë anti-islamë, ka hedhur në ajër kampe të tëra ushtarake, të cilat i kishin pushtuar vendet islame, dhe që nga të gjitha këto gjithnjë del i shëndoshë, i gjallë dhe i pangadhënyeshëm, ndërsa për të psherëtitjné bukuroshet nga qarqet më të larta të Britanisë, SHBA, Gjermanisë, Francës, të lëna në mëshirën dhe pamëshirën e burrave të tyre të paaftë për dashuri, të shqetësuar prej lakmisë shtazarake dhe xhelozisë shtazore – të cilën ai, muslimani, i ka dashur ashtu si këtë nuk do të dinte ta bënte askush tjetër.

Është e vështirë edhe të imagjinohet një film i tillë. Pajtohem. Dhe është e pamundur të imagjinohet se filmi i këtillë ka mundur të incizohet. Dhe me këtë pajtohem. Filmin e këtillë nuk do ta shikojmë, sepse nuk do të incizohet. Do të incizohen vetëm *ata* filmat *e tjerë*. Për James Bondin e vërtetë. Të vërtetin dhe të vetmin. I cili nuk është musliman, as kinez, as rus, madje as gjerman apo spanjoll. Që të dihet se çdo gjë mund të ndryshohet por që disa paragjykime duhet patjetër të mbesin të pa-

ndryshuara. Njëra nga paragjykimet e këtilla është paragjykimi për inferioritetin e muslimanëve. Sepse mbi këtë paragjykim, ashtu si në konstantën e amshueshme, për fat të keq edhe sot zë fill raporti i Europës jo-muslimane ndaj asaj muslimane, me të gjitha institucionet e saj, ligjet, rregullat dhe lajthitjet!

Përmbajtja e vendimeve politike dhe implikimet e tyre për realitetin social të Europës

Me problemet e lindura nga këmbëngulja kokëfortë në modelin e diskriminimit të muslimanëve dhe me ngurtësinë e paragjyqimeve të imponuara sistematikisht ndaj tyre përmes shekujve të gjatë, përballen edhe muslimanët, edhe jo-muslimanët e Europës prej kërkesës ngulmuese të aksionit të bashkërenduar në konceptimin dhe zbatimin e strategjisë krejt të re të bashkëpunimit. Sinergjia është instrumenti kyç në një projekt të tillë; ripërkufizimi i identitetit kulturor të Europës në pajtim me historinë reale policentrike, multi-fetare dhe multi-etnike të këtij kontinenti është synimi i tij themelor. Që edhe në këtë rast mund të zbatohet e vërteta e vjetër *“Ku është sëmundja, aty është edhe ilaçi; ku është rreziku, aty gjendet edhe shpëtimi”*, mund të përfundohet edhe nga paralajmërimet gjithnjë e më të shpeshta dhe më të zëshme se *“thelbi i mosmarrëveshjes së Europës me muslimanët, në fakt është pasojë e drejtpërdrejtë e mosmarrëveshjes së Europës me identitetin vetjak.”*⁷⁴ Muslimanët e Europës janë bërë njëkohësisht edhe sëmundja konkrete, edhe ilaçi potencial, edhe rreziku më i madh, edhe shpëtimi i vetëm! Nën presionin e ardhjes së vazhdueshme të një numri të madh emigrantësh, me ngjyrë të ndryshme të lëkurës, bashkë me shprehi kulturore tjetërfare,

⁷⁴ Jocelyne Cesari, of. cit.

me simbole të tjera, të cilët bëhen bashkëqytetarë të tyre dhe me të cilët fillojnë ta ndajnë hapësirën e përbashkët jetësore, për të cilën qysh moti është forcuar bindja se kanë të drejtën ekskluzive për zotërimin, qytetarët e vendeve europiane përëndimore domosdoshmërisht përjetojnë një lloj shoku kulturor! Duket sikur prej ndonjë kataklizme të qetë, pa dridhje të dukshme apo domosdoshmërisht, në sytë e tyre po rrenohet imazhi tradicional për Europën etnike, monolite, ekskluzive kristiane! Në rrethana të këtilla krijohet një hapësirë e madhe përplot mundësi të pabesueshme për realizimin si të projekteve destruktive, ashtu edhe konstruktive të përmasave më të mëdha dhe të ndërlkimeve të paparashikueshme!

Sikurse edhe në çdo gjë tjetër në këtë botë, edhe në këtë rast kapacitetet për shkatërrim janë pakrahasueshëm më të mëdha se ato konstruktive, sepse praktikisht çdo gjë është më lehtë të përdoret për shkatërrim sesa për krijim! Ky virtyt i superioritetit ontologjik të shkatërrimit ndaj krijimit, i cili është një konstante universale e botës njerëzore, konfirmohet në mënyrë sovranë edhe në gamën më të pasur dhe më të llojlojshme të skenarëve potencialisht shkatërrimtarë, katastrofalë, konfliktualë, luftarakë e të tjera të zhvillimit të ardhshëm për temën e raportit të kristianizmit dhe Islamit, përkatësisht, muslimanëve dhe jo-muslimanëve të botës, ndërsa ka *vetëm një të vetme mundësi* për zhvillimin e qetë dhe harmonik. Armiqësia ka disa fytyra, kurse lufta ka rrugë të shumta, me të cilat shkon drejt synimit të vet; miqësia ka vetëm një fytyrë – fytyrën e sinqeritetit, kurse paqja vetëm një rrugë – rrugën e vërtetë!

Njëri nga variantet më të lehta për përfshirjen e Europës dhe botës në një konflikt të përmasave globale është ai, i cili i keqpërdor bindjet më të thella, ndjenjat më intime dhe idealet më të larta shoqërore të njerëzve. Duke u përballur çdo ditë

dhe në rrethana më të ndryshme me gjithë ato fytyra të reja, rroba, gjuhë, mënyra sjelljeje, të cilat aq shumë dallohen nga ato me të cilat janë përshtatur dhe që tashmë sipas inercisë i konsiderojnë të *vetmen normale dhe korrekte, e së këndejmi edhe në mënyrë të qartë superiore*, në shumicën e rasteve i gjejnë vetes prehje në sindromën e ksenofobisë. Argumente për pranimin e këtij modeli psikologjik të sjelljes mbrojtëse ka shumë. “Emigrantët jo vetëm që nuk janë identikë siç jemi edhe ne, por me praninë e tyre në çdo aspekt na kërcënojnë drejtpërdrejt. Përkatësia e tyre racore është rrezik për përbërjen tonë racore, përkatësia e tyre etnike, gjuha e tyre, shprehitë e tyre kulturore, shpien deri në degradimin e standardeve tona etnike, gjuhësore dhe kulturore që i kemi kultivuar me shekuj!”

Kur kësaj i shtohet edhe fakti, se më të shumtët si numër ndër emigrantët janë pikërisht arabët dhe turqit, të cilët, me falsifikimin e historisë, në sytë e qytetarit mesatar të vendeve të BE, janë stigmatizuar si *aziatikë, orientalë, barbarë*, me çka përfundimisht u është mohuar e drejta që veten ta konsiderojnë *europianë*; dhe kur merret parasysh se po këta popuj janë edhe emigrantët më të shumtë, praktikisht qind për qind muslimanë, pra pjesëtarë të Islamit, kupa mbushet! Sepse po këto falsifikime të frymëzuar ideologjikisht, të cilat arabët dhe turqit i kanë shpallur për *orientalë primitivë*, e kanë përforcuar në po këtë mënyrë (pra me falsifikim) edhe paragjykimin se Islami është armiku vdekjeprurës i Europës kristiane! Nëse disa emigrantë, me ngjyrën e lëkurës së tyre, me zërat grykorë dhe të pakuptueshëm të gjuhëve të tyre, me ngjyrat e theksuara dhe me pamjen më shumë se jokonvencionale të kostumeve të tyre, kanë acaruar traditat e ngurtësuar kulturore të qytetarëve konservatorë të BE, të mësuar që nivelin e kulturave të tjera ta gjykojnë sipas shkallës së ngjashmërisë dhe ndryshueshmërisë

në raport me kulturën e tyre vetjake, ndërsa po këta qytetarë konservatorë, arabët dhe turqit praktikisht i kanë tmerruar! Tërë godina e madhe e stereotipave dhe paragjykimeve negative ndaj arabëve dhe turqve, ndaj Islamit dhe muslimanëve sikur është rrënuar përnjëherë mbi kokën e tyre. Të përshkuar me panik nën ndikimin e konstrukteve fiktive dhe miteve për muslimanët gjakpirës, të cilët janë *zotuar ta shkatërrojnë Europën kristiane*⁷⁵, me asyen të paralizuar prej rrëfimeve dhe libra-ve mbi projektet konspirative të muslimanëve që ta shndërrojnë Europën në koloninë e tyre Eurabi, kurse qytetarët e saj ose t'i dërgojnë në skllëveri, ose t'i kthejnë në *dhimmi*, ata kanë nxituar krejt seriozisht që në të gjitha institucionet e shtetit të BE ta kërkojnë shpëtimin prej kërcënimit në rritje musliman araboturk kundrejt mënyrës së tyre të jetës, lirive dhe vlerave të tyre!

Klima e ndrydhjes, dashaligësisë, frikës dhe armiqësisë, u ka ardhur për shtat shkëlqyeshëm projekteve më të llojllojshme të forcave rajonale, po sidomos globale, të cilat kanë filluar gjithnjë e më shumë ta bazojnë strategjinë e tyre në manipulimin me temën e muslimanëve emigrantë, duke e shtrirë në kontekstin global nën parullën *e luftës kundër terrorizmit islam*. Sado që të jetë moralisht e kontestueshme, kjo temë ka qenë edhe faktikisht edhe në aspektin strategjik një zgjidhje e shkëlqyeshme. Konfrontimi i disa miliarda njerëzish dhe ky në çështjen më të ndjeshme të identitetit shpirtëror – nuk mund të mendohet si diçka më e mirë për ata, të cilët kanë nevojë për një alibi, që të arsyetojnë sulmin mbi ata, të cilët janë aq të do-

⁷⁵ Ky është formulim mjaft i shpeshtë dhe madje zotërues në të gjitha pamfletet anti-islame e madje edhe në numrin më të madh, të teksteve historike dhe parahistorike, shkencore dhe kuazi-shkencore, të cilët deri në pavetëdije ndryshojnë dhe e përsërisin formulën *për muslimanët të cilët janë betuar me atë që e kanë më të shenjtë, janë zotuar me jetën e tyre* etj. Me fjalë të tjera, në Islam besimtarëve në mënyrë eksplicite iu është ndaluar betimi dhe zotimi pos në emër të Zotit.

bët sa nuk mund t'i rrezikojnë assesit! Sepse aty ku janë në pikëpyetje ndjenjat fetare dhe identiteti kolektiv kulturor, vendoset më me lehtësi kontrolli i plotë mbi të gjithë pjesëmarrësit. Po aq më e lehtë është të kontrollohet një konflikt i përmasave të këtilla, nëpërmjet epërsisë absolute tashmë të siguruar paraprakisht të mediave dhe të kontrollit total të informacioneve, ndërsa nga shumë shembuj tashmë është konfirmuar sesa lehtë mund të manipulohet me emocionet e të dy anëve të zhytura në psikologjinë e mosbesimit dhe mosdurimit të ndërsjellë! Efikasiteti i një metode të këtillë është konfirmuar me faktin se bota në pjesën më të madhe tashmë është shndërruar në *teatër kukullash*, kurse tërë popujt janë kthyer në kukulla me fije, të cilat i luajnë individët në qeveri, qendrat strategjike dhe bazat ushtarake në pajtim me fazat e agjendës tashmë qysh moti të planifikuar. Me dozim e stimujve pozitivë dhe negativë, përgatitet çasti që kjo situatë potencialisht shpërthyesë të arrijë deri te epilogu dramatik në atë moment, kur laku të mbyllet ndërsa ndaj armikut të pafuqishëm të ndërmerret gjuetia e përgjithshme përzgjedhëse.⁷⁶

Krahas hipotekës së gënjeshtrove monumentale dhe gjysmë të vërtetave të cilave, si literaturë detyruese, iu qenë nënshtruar shumë breza gjatë 14 shekujve të kaluar, pengimi i ske narit destruktiv përbën vërtet një detyrë herkuliane, më i rëndë se pastrimi i haureve të Augjiasit, dhe krahas kësaj, me aromë aspak të këndshme! Ndërsa riformulimi i identitetit europian është ende larg nga të gjitha planet, ndërsa spiranca e stereotipave negativë ende anijen e neveritshme të mosbesimit dhe armiqësisë ndaj muslimanëve e mban fort të ankoruar te fundi i errët i mitologjisë anti-islame, përpyekjet që të shmangët konfliktin i qartë tashmë paraprakisht i planifikuar hollësisht dhe të

⁷⁶ Se ky plan krejt seriozisht është duke u shqyrtuar qartë e konfirmon intervista e cituar me ish-sekretarin shtetëror të SHBA, Kisinxherin për CNN, mars 2012.

pamundësohet intensifikimi i mëtejme i mosdurimit kulturor e fetar rrëgjohen sot kryesisht në përcjelljen dhe pamundësimin e emigrimit ilegal, si edhe te ashpërsimi i dispozitave të cilat rregullojnë statusin e azilantëve. Konkretisht, ky është sektori më mbresëlënës i projektit ende jo krejt të formësuar të vendeve të BE, i cili vëmendjen dhe synimin e tij nga dallimet kulturore e shpërngul dukshëm në aspektet sociale dhe ekonomike, në pajtim me sugjerimet e disa ekspertëve për këto çështje.⁷⁷ Në këtë kontekst duhet theksuar propozimin sado i rrallë dhe madje unikal, po aq i vlefshëm, që në të gjitha shkollat e Europës të futet një lëndë, e cila do të studiojë kontributin historik dhe kulturor të Islamit në Europë siç është sot, si dëshmi se *Islami nuk është i huaj për Europën ashtu si e konsideron këtë shumica nëse jo edhe të gjithë*.⁷⁸ Gjithashtu, disa ekspertë të orientuar konstruktivisht paralajmërojnë për nevojën që të ulet toni i thirrjeve publike kundër muslimanëve, dhe që të braktiset tërësisht retorika mbizotëruese negative, ksenofobe dhe haptazi armiqësore, të cilën e përdorin disa media dhe politikanë kur flasin për Islamit dhe muslimanët si për një grup kulturor. Në pajtim me këtë nismë, OKB-ja jep edhe rekomandimin që nioni *terrorizëm* mos të përdoret kurrë me parashenjat nacionale, etnike apo fetare, diçka të cilën, për fat të keq, kur është fjala për sintagmën *terrorizmi islam* deri sot praktikisht nuk e respektojnë mediat e asnjë shteti në botë. Disa vende të BE, e para së gjithash Gjermania, nëpërmjet bashkëpunimit të universitetit me qeverinë apo qeverisjen lokale, fusin programe arsimuese për mësuesit fetarë të fëmijëve muslimanë si edhe për imamët në xhami, me qëllim që të njihen me historinë e Europës, kulturën europiane dhe vlerat e përshpirtshme europiane.

⁷⁷ Sidomos Vaisse dhe Mogahed, op.cit.

⁷⁸ Cesari, vepra e cituar.

Marifeti është që me përvetësimin e këtyre dijeve dhe vlerave të lehtësohet integrimi dhe në afate të gjata të mundësohet asimilimi i emigrantëve muslimanë, sidomos fëmijëve të tyre.

Se pikërisht ky është kuptimi i vërtetë i këtij aksioni, e konfirmon qartë komenti i një politologu gjerman, i cili thotë: “Në Gjermani kemi 2600 xhami, kurse unë nuk njoh as një të vetmin imam, i cili është arsimuar në Europë. Si munden ata t’i tregojnë muslimanëve, të cilët jetojnë këtu se si duhet të jetohet?”⁷⁹ Kjo thënie tregon qartë vetvetiu tororisjen dhe raportin përçmues ndaj muslimanëve, madje edhe kur është fjala për ekspertët me arsim të lartë nga fushat e shkencave shoqërore. Me fjalë të tjera, Bassam Tibi nuk ka pasur mundësi t’i njëjto të gjithë imamët prej 2600 xhamive sa janë në Gjermani, as që ka mundur t’i gjente kartelat e tyre personale, që të dinte sesa është e pasaktë thënia e tij! Domethënë, të gjithë imamët nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia – *to say the last* – të mos shkojmë më tej, janë arsimuar në Europë.

Nga ana tjetër, është krejt e qartë se njohja në thelb është proces i dykahshëm. Aq sa është e nevojshme që muslimanët (apo cilido grup tjetër) ta njohin mjedisin e ri, aq është më e nevojshme që edhe mjedisi i ri të përpiqet që t’i njohë më mirë muslimanët (apo cilindo grup tjetër), siç e ka propozuar krejt arsyeshem Jocelyne Cesari. Se nuk i intereson mirëkuptimi i ndërsjellë, Bassam Tibi e ka treguar me shpjegimin e shprehur, që synimi përfundimtar i propozimit të tij është asimilimi nëpërmjet integritit – do të mund të thuhej se deviza e tij *Per astra ad aspera!* – duke e marrë parasysh se gjendja e asimilimit kulturor është kurorë e mirëfilltë prej gjembash, sipas së cilës integrimi i dozuar lirshëm është parajsja yjore! Megjithatë, në shumicën e shteteve anëtare të BE vëmendja më e madhe në

⁷⁹ Bassam Tibi, interview for Deutsche-Welle, 08. 03. 2010.

sferën e politikës sociale ndaj muslimanëve edhe më tej i përkushtohet kontrollit sistematik nëpërmjet zhvillimit të rrjetit të gjerë të punëtorëve specialë të kualifikuar si socialë dhe edukatorëve me funksionin e informatorëve anonimë. *Synimi i tyre është të formojnë një shërbim informativ efikas për ndjekjen e radikalizmit islam, shërbim i cili do të marrë pjesë jo vetëm brenda grupeve muslimane, por edhe brenda grupeve islamiste, të cilët ata do të mësojnë t'i dallojnë me lehtësi, kurse disa prej tyre do të bëhen ekspertë edhe për luftën kundër terrorizmit islam.*⁸⁰

Trajtimi i muslimanëve si kategori njerëzish skajshëm e rrezikshme, ndaj të cilës kujdesi maksimal është qëndrimi i vetëm i arsyeshëm, ndërsa dyshimi *a priori* dhe mosbesimi i përgjithshëm është mënyra e vetme përkatëse e veprimit me ta, është bërë model i sjelljes dhe veprimit praktikisht të të gjitha institucioneve shtetërore të Europës dhe SHBA, aq e vetëkuptueshme sa edhe qëndrimi ndaj peshkaqenëve, shtazëve të egra apo sëmundjeve ngjitëse. Shumë stacione televizive në SHBA nëpërmjet spikerëve të tyre të dalluar paralajmërojnë rrezikun se terroristët islamë po futen në SHBA duke përdorur për këtë grupet e emigrantëve ilegalë, të cilët vijnë nga Meksika, si mundësi ideale që të mbeten të pazbuluar, përkatësisht të paregjistruar si terroristë, madje edhe në rastin e kapjes.⁸¹

Është e përhapur edhe propaganda e intonuar ideologjike, të cilën po e përmendim për shkak të mbështetjes së saj në naivitetin total dhe mosinformimin e shikuesve televizivë, si kartën e saj më të fortë nëse jo edhe argumenti i vetëm, ndërsa *e cila zbulon fshehtësinë e madhe, që Pentagoni zhvillon luftë në Lindjen e Afërme për t'i tërhequr rreth vetes të gjithë terroristët*

⁸⁰ Robert S. Leiken, op.cit.

⁸¹ Këtu paraprijnë sidomos Fox News dhe CNN, kurse më i zëshmi në këtë britmë paranoike është komentuesi Lou Dobbs.

islamë dhe kështu t'i largojë nga sulmi kundër Shteteve të Bashkuara!? Problem shtesë është bërë për nëpunësit gjithnjë vigjilentë nga Department of Homeland Security në Washington rrëmuja tashmë e mirëfilltë që krijojnë muxhahidët, të cilët infiltrohen lirisht në Shtetet e Bashkuara prej shteteve perëndimore europiane si qytetarë të të cilave nuk kanë nevojë për vizat që të udhëtojnë atje! Zgjidhja e thjeshtë për muslimanët, përkatësisht për të gjithë ata të cilët kanë emra muslimanë, pa marrë parasysh se nga cili vend vijnë, detyrimisht kërkon ta kalojnë procedurën e vizave, nuk është zgjidhje e përkryer, sepse muxhahidët islamë mund të rekrutojnë në radhët e tyre terroristë edhe europoperëndimore gjakpastër, emrat e të cilëve me asgjë nuk paralajmërojnë për mundësinë e rrezikut islam.

Kujdesi *a priori* i së ashtuquajturës *Europës Perëndimore* ndaj qytetarëve të vet muslimanë, në rastin e SHBA është bërë tashmë dyshimi *a priori* dhe siguria se të gjithë muslimanët janë terroristë aktivë apo të fshehtë. Këtë e tregojnë edhe raportet zyrtare për luftën kundër *terrorizimit islam*, të botuara apo të cituara si materiale, për të cilat diskutohet edhe në të gjitha nivelet më të larta të sistemit politik. Në to, ndër të tjera, fillohet nga postulati se *rrjeti xhihadist është shtrirë nga njëri skaj në tjetrin të Europës, nga Polonia deri në Portugali, dhe kjo për arsye se islamizmi radikal është ideologji e gjithëpranuar ndër punëtorët emigrantë të angazhuar të ndihmojnë për ndërtimin e çudisë ekonomike europiane të pasluftës ... Në kafenetë e tymo-sura të Roterdamit dhe Kopenhagës, në hapësirat e lutjeve dhe xhamitë e Hamburgut dhe Brukselit, në libraritë islame të Birminghamit dhe "Londonistanit", në burgjet e Madridit, Milanos e Marsejës, emigrantët dhe pasardhësit e tyre paraqiten si vullnetarë në xhihad kundër Perëndimit ... Një studim i Nixon Centre ka konfirmuar se nga numri i përgjithshëm prej 373 muxhahi-*

dësh të regjistruar ndërmjet vitit 1993 dhe 2004, ka pasur dyfish më shumë francezë sesa saudianë, dhe më shumë britanikë sesa sudanezë, jemenas, libanezë, libias ... një e katërta e plotë i këtyre xhihadistëve kanë qenë shtetas të vendeve euro-perëndimore – të gjithë me të drejtë të udhëtojnë pa viza në Shtetet e Bashkuara ...

Këto komunikata dhe raportet e ngjashme zyrtare, si në çdo gjë tjetër, sidomos në intonacionin anti-islam, janë kopje e librave që prodhojnë Bat Ye'or & Company. Do t'i citojmë disa prej tyre:

“Shfaqja e muxhahidëve të *kultivuar* (homegrown) në truallin e Europës, paraqet kërcënim si për Shtetet e Bashkuara, ashtu edhe për vetë Europën. Megjithatë, për këtë kurrë *nuk është folur asnjë fjalë* (tekstualisht, është përdorur një idiomë ndjeshëm më e ashpër: *It was the dog that never barked*, në kuptimin *ky qen nuk ka lehur kurrë*), e madje as në samitin euro-amerikan për afrimin e ndërsjellë. As kryetari George Bush, as sekretarja e shtetit Condolleza Rice nuk i kanë kush-tuar as vëmendjen më të vogël kësaj rrezikshmërie të ndërsjellë, edhe pse pikërisht kjo temë më së miri do t'i përqendronte pikëpamjet e përbashkëta dhe do të çonte deri te bashkëpunimi më i fuqishëm në Perëndim.” (Liot Redcliff Ross: *Europe's divided Muslims*).

Mosbesimi ndaj muslimanëve në tërësi dhe shpallja *a priori* i të gjithë muslimanëve në botë për armiqtë më të mëdhenj të shteteve të lira të Europës, qysh sot është bërë qëndrim gjerësisht i pranuar në qarqet e shumta të politikanëve dhe intelektualëve të po kësaj bote të lirë. Në atë se “... ekstremistët dhe terroristët islamë nuk paraqesin rrezikun më të madh për mbretërinë e lirisë së vendosur në shtetet kristiane perëndimore të Europës dhe në territorin e SHBA, por janë ata të ashtuquajturit kushërinjtë e tyre të matur, siç është, për shembull, Tariq

Ramadani”, flet në mënyrë eksplicite Paul Bermani në librin *Fight of the Intellectuals*, ndërsa këtë skemë e përpunon më tej libri *Veiled Truths* i Marc Lynch-it, i cili e plotëson edhe me mospëlqimet e brendshme të muslimanëve, (të cilët, që të mos krijohet ndonjë hutim, edhe për Lynch-in të gjithë pa përjashtim janë armiq të lirisë dhe demokracisë) dhe madje edhe me konfliktin e tyre të hapur, si në rastin e muslimanëve reformistë dhe selefi. Duke e shqyrtuar me vëmendje të gjitha strukturat e muslimanëve, këta *hulumtues të ideve muslimane*, theksojnë se përlësia e muslimanëve është aq e madhe, sa detyra më e rëndësishme madje edhe e grupeve të tilla radikale terroriste siç është Al-Qaeda dhe e disa të tjerave, *nuk është aq të kryejnë sulme terroriste, sesa me tërheqjen e vëmendjes mbi veten, t’u mundësojë veprim të papenguar kushërinjve të tyre jo të dhunshëm ideologjikë. Duke punuar në hije, këto organizata praktikisht të panjohura, sikurse është Hizbu’t-tahrir, edhe pse vetë nuk praktikojnë asnjë formë të dhunës, indoktrinojnë muslimanët me ideologji radikale. Të vendosura në zonën gri të legalitetit, këto organizata është vështirë të zbulohen, por edhe kur arrihet sukses për këtë, sipas rregullit nuk ka kurrfarë dëshmie konkrete për veprimtarinë e tyre. Është shumë e vështirë të kontrollohet puna e tyre për demokracinë liberale (e cila përndryshe është e njohur me atë që garanton liri të shprehjes për të gjithë qytetarët, përveç, natyrisht, për muslimanët të cilët të gjithë pa përjashtim janë terroristë potencialë, shënim i F. M.) – por pa marrë parasysh të gjitha vështirësitë, veprimtaria e tyre nuk duhet të injorohet dhe duhet të ndalohet në të gjitha rrethanat. Këtë interpretim të planeve dhe synimeve të fshehta të muslimanëve, të zhvilluar deri në hollësi, të cilat sikur janë përshkruar nga shënimet e psikoanalistëve të paranoikut të pashëruar, i ofron autori i njohur Zeyno*

Baran në librin *Duke luftuar përpleshjen e ideve (Fighting the War of Ideas)*.⁸²

Kundrejt listës praktikisht pa fund të gjatë të librave, të cilat i trajtojnë aspektet e ndryshme të numrit të rritur të emigrantëve muslimanë dhe të pranisë së tyre të përhershme në truallin e BE me qëndrim anti-islam implicit apo eksplisit, të fshehtë apo të hapur, janë skajshmërisht të rrallë librat objektive, të argumentuar dhe mirëfilli instruktive, të cilët këtë situatë e trajtojnë me mirëkuptim të plotë për të gjitha palët e përfshira. Një nga librat e tillë është studimi me titullin *Islam, Migration and Integration: The Age of Securitization*.⁸³ I bazuar në hulumtimin e vëllimshëm të kryer ndërmjet viteve 2003-2008, libri bën analizën sasiore dhe cilësore të aspekteve të ndryshme të muslimanëve emigrantë turq në Gjermani, Francë, Belgjikë dhe Holandë. I konceptuar si studim i disa prej problemeve më të mëdha të këtyre shteteve europiane, studimi i Ayhan Kaya-s i adreson problemet siç janë, për shembull *sekuritizimi, islamofobia dhe anti-islamizmi, diskriminimi, dhuna, stigmatizimi sistematik i Islamit dhe muslimanëve në mediat publike*, e të gjithë këto tema janë përqsaur me sjelljen e qendrave të vendimmarrjes, pra të vetë qeverive shtetërore dhe nacionale. Në bazë të një hulumtimi të këtillë, të kryer sistematikisht, Kaya arrin në përfundimin se studimet për migrimet dhe emigrimet në këto vende të Europës, nga projektet objektivist të orientuara për konstatimin e pikave qenësore të këtyre proceseve, sot tashmë janë kthyer (apo thënë më mirë, janë degraduar) në teknologji

⁸² Të gjitha citatat janë nga kontributi i njëjtë. Zeyno Baran, "Fighting the War of Ideas", *Foreign Affairs*, November/December, 2005. Pas publikimit, ky kontribut shprehimisht anti-islam shumë herë është ripublikuar duke nxitur reaksione të shumta dhe ndjeshëm të ndara.

⁸³ Ayhan Kaya, (2009) *Islam, Migration, and Integration: The Age of Securitization*, Houndmills Basingstoke.

të menaxhimit të emigrantëve muslimanë nga ana e shtetit “... për të cilët konsiderohet se paraqesin sfidë dhe kërcënim për unitetin kombëtar, shoqëror dhe kulturor.”⁸⁴ Këto qëndrime të shtetit ndaj muslimanëve në mënyrë të përgjithshme, e veçanërisht ndaj muslimanëve emigrantë të kombësisë turke, si kategori e cila është në qendër të vëmendjes së autorit, formulojnë koordinatat e hulumtimit të kufizuar nga një anë, me verifikimin kritik të politikës shtetërore dhe nacionale ndaj emigrantëve muslimanë, ndërsa nga ana tjetër, me projektet dhe veprimet konkrete të cilat qeveritë e këtyre shteteve i ndërmarrin lidhur me këtë çështje. Në këtë kontekst, refuzimin më të vogël në këtë pikëpamje e tregon Gjermania, në të cilën politika zyrtare është më afër realizimit konsekuent në praktikë, në terren. Edhe pse ata janë emigrantë muslimanë, të cilët nuk kanë pranuar ta përvetësojnë kulturën gjermane, historinë dhe identitetin social, si kushte të detyrueshme që të bëhen qytetarë me të drejta të plota të Gjermanisë, ende janë një lloj njerëzish të rangut më të ulët, si thotë Kaya, megjithatë kohët e fundit Gjermania ka shkuar më tej se të tjerët në braktisjen e modelit të segregacionit shoqëror dhe integritit konsiderueshëm më efikas.

Për fat të keq, politika franceze ndaj muslimanëve emigrantë po lëviz në drejtim të kundërt: nga integrimi drejt segregacionit! Në një shtet, i cili përkatësinë të qytetërimi francez e konsideron si kusht të mjaftueshëm që njerëzit të pushojnë së qeni ata që janë dhe të bëhen *francezë*, parimi i shumëlavrëduar i barazisë së plotë politike (*egalité*) të të gjithë qytetarëve, me lënien e muslimanëve, të papunëve dhe të rinjve të shoqërisë franceze jashtë sistemit politik, mbetet vetëm mit pa kurrfarë baze. Rezultati i këtij kategorizimi negativ është humbje jo vetëm për shkallën e barazisë politike në Francë, por para së

⁸⁴ Ayhan Kaya, op cit., f. 23.

gjithash për qytetarët e saj muslimanë. Kaya nënvizon se në Francë gjithnjë e më shumë po përhapet sindroma e ksenofobisë dhe qëndrimit anti-islam, i cili emigrantët muslimanë i trajton *a priori* si armiq të brendshëm: “E kur kësaj i shtohet edhe praktika gjithnjë e më e përhapur e përhapjes së gjithfarë lajthitjesh dhe të pavërtetash mbi muslimanët, nuk është e vështirë të imagjinohet se si ‘fqinji i cili jeton përballë derës’ shndërron në ‘armik të brendshëm’.”⁸⁵

⁸⁵ Ibid., f. 92.

III. HISTORIA E MARRËDHËNIEVE POLITIKE DHE KULTURORE TË SHTETEVE EUROPIANE ISLAME DHE KRISTIANE

III.1. Rasti studimor Al-Andalus

Etimologjia e toponimit Al-Andalus – kontesktualizimet ideologjike

Sikurse edhe për çdo gjë tjetër, kur është fjala për ndërveprimin e muslimanëve europianë dhe kristianëve europianë në kontekstin e historisë së shtetit të parë europian islam, edhe vetë etimologjia e emrit të tij është objekt i diskutimeve të ashpra. Përveç rivalitetit kristian dhe islam, sa i pashmangshëm aq edhe absurd, në këtë diskutim ndërlikohet edhe fakti që vetë termi, në periudha të ndryshme të historisë, ka pasur të bënte me kufijtë e ndryshueshëm territorialë. Atribuimi i parë i besueshëm i këtij toponimi është regjistruar në vitin 715 në monedhat prej ari të shtetit të parë musliman europian. Megjithatë, madje edhe kjo e dhënë “e ngurtë” është relativizuar kundrejt datës së saktë, sepse mbishkrimet në monedha janë dygjuhëshe – arabisht dhe latinisht, me vite të ndryshme. Fakti që muslimanët i llogarisin vitet nga data e shpalljes së Zotit dërguar Muhamedit a.s., kurse kristianët nga lindja e Jezu Krishtit, në parim nuk e vështirëson datimin e sigurtë me krahasimin e dy datave. Megjithatë, diskutimet kanë mbetur, pa marrë parasysh që nuk kanë kurrfarë rëndësie thelbësore për faktin se emërtimi i parë i shkruar i Andaluzisë (Al-Andalusit) shtrihej në të gjitha territoret, të cilat muslimanët i mbanin në truallin e

Europës jugore, dhe se pa dyshimin më të vogël gjendet në monedhat e shtetit të parë islam european.⁸⁶

Përpjekjen që të kontestohet gjuha arabe, përkatësisht prejardhja islame e emërtimit, linguistët euro-perëndimorë e bazojnë në supozimin se emërtimi *Andaluzi* është paraqitur para themelimit të shtetit të parë islam european, qysh në kohën menjëherë pas rënies së Perandorisë Romake. Analizat gjuhësore bashkëkohore e kanë hedhur hipotezën për shkak të mungesës së dëshmive me peshë, si edhe për shkak të shpjegimeve të papranueshme etimologjike. Një epilog i tillë nuk na habit, nga shkak se përfaqësuesit e kësaj teorie janë historianë nga profesioni e jo gjuhëtarë dhe se motivi i tyre është pa ekuivoqe i natyrës ideologjike e jo shkencore. Orvatja që toponimi *Andaluzia* të paraqitet si ndryshim gjuhësor i *Vandaluzia* (fjalë e prejardhur nga emërtimi i popullit gjerman të vandalëve, të cilët përkohësisht qenë vendosur në territorin e Gadishullit Iberik në periudhën prej vitit 407-429, dhe së këndejmi, të propozohet *Vandaluzia* si *Vendi i Vandalëve*), po ashtu nuk është pranuar në shkencë për shkak të mungesës së dëshmive historike të cilat do ta mbështesnin. Burimi i vetëm në të cilin mbështetet kjo hipotezë është libri i Rajnhart Dozit, historianit gjerman të shekullit XIX, i cili edhe vetë vë në dukje mungesat e dëshmive empirike në të mirë të një shpjegimi të këtillë, ndërsa vetë autori e rrëgjon territorin e Vandaluzisë hipotetike për-

⁸⁶ Në këtë na drejton qartë edhe Hoze de Kortazari, duke theksuar: "Para los autores árabes medievales, el término Al-Andalus designa la totalidad de las zonas conquistadas - siquiera temporalmente - por tropas arabo-musulmanas en territorios actualmente pertenecientes a Portugal, España y Francia" ("Sipas autorëve arabë mesjetarë Al-Andalus shënonte të gjitha territoret të cilat i kishin pushtuar – qoftë edhe përkohësisht – luftëtarët arabo-muslimanë në territorin e Spanjës, Portugalisë dhe Francës së sotme." Shih: José Ángel García de Cortázar, *V Semana de Estudios Medievales: Nájera*, 1 al 5 de agosto de 1994, Gobierno de La Rioja, Instituto de Estudios Riojanos, 1995, f. 52.

jashtimisht në limanin, nga i cili vandalët lundruan për Afrikë, duke pranuar se pozicioni i atij limani deri sot ka mbetur i panjohur.⁸⁷ Kompromis interesant ka synuar historiani spanjoll Valve, i cili, nga një anë ka pranuar burimin arab të toponimit *Andaluzia*, por nga ana tjetër ka mohuar lidhjen me themelimin e shtetit të parë musliman evropian, duke e zhvendosur termin prapa thellë në kohën para ardhjes së Islamit në këto pjesë të Afrikës. Sipas tij, fjala është për ndryshimin gjuhësor greko-romak të nocionit *Atlantis*, të cilin arabët dhe berberët lokalë e përvetësuan në formën *Andalus*, të cilën përndryshe e shënon një kronikë anonime arabe e shkruar arabisht dy deri tre shekuj pas themelimit të *Al-Andalusit*, shtetit të parë evropian islam. Teza se ky term për një kohë të gjatë ka qenë emërtim i një ishulli lokal, që më vonë u zbatua në tërë territorin e madh në të cilin ishte shtrirë shteti i parë musliman evropian *Al-Andaluzia*, vetvetiu është vështirë e besueshme, kurse mungesa e plotë e lëndës faktike, e cila do ta bënte së paku në mënyrë teorike të mundshme, ka ndikuar që edhe ky supozim të hidhet poshtë.

Fat të njëjtë ka përjetuar edhe propozimi mjaft i ndërlikuar dhe imagjativ i historianit bashkëkohor Hajnc Halmit, sipas të cilit rrënja e toponimit të Andaluzisë nxirret nga gotishtja **landahlauts* (sipas standardeve simbolike të pranuar nga gjuhëtarët, ylli përcakton formën gjuhësore, e cila është propozuar por jo edhe pranuar), e cila me imitimim fonetik në gjuhën arabe shndërron në një shenjë të ngjashme me *Al-Andaluzinë*. Pasi Halmi nuk paraqiti kurrfarë dëshmie historike apo gjuhësore se ka ndodhur një odise gjuhësore e ngjashme me atë të cilën ai e propozonte, edhe kjo hipotezë mbeti vetëm edhe një kureshti gjuhësore.⁸⁸

⁸⁷ Shih: Dozy, Reinhart: Paris, 1881. *Recherches sur l'histoire et la littérature des Arabes d'Espagne pendant le Moyen-Age.*

⁸⁸ Halm, Heinz. 1989. *Al-Andalus und Gothica Sors.* Der Islam 66:252–263.

III.2. Kronologjia e Europës Islame: Gadishulli Iberik dhe Europa juglindore

Koment i shkurtër hyrës

Al-Andaluzia (arabisht: الأندلس ; spanjisht: *Al-Ándalus*; portugalisht: *Al-Andalus*; katalanisht: *Al-Àndalus*), e njohur edhe si *Iberia Maure*, shënon shtetin europian musliman në tërë territoretin e Gadishullit Iberik, duke përfshirë Spanjën dhe Portugalinë aktuale, si edhe pjesët jugore të Francës, Italisë veriore dhe Zvicrës jugore, i cili ka ekzistuar në madhësi të ndryshueshme prej vitit 710 e deri më 1492.

Edhe pse termi “Al-Andalus” si emërtim i shtetit, nënkupton një tërësi integrale politike, karakteri i tij sintetik ka të bëjë vetëm me unitetin shpirtëror dhe kulturor të manifestuar nëpërmjet Islamit si ind koheziv dhe emërtues i përbashkët i një numri më të madh shtetesh dhe shteteve të vogla relativisht apo plotësisht të pavarura në aspektin politik. Fakti se as këto njësi politike islame nuk kanë qenë gjithnjë në aleancë, e as në marrëshënie të mira, por shpesh madje edhe kanë luftuar njëra kundër tjetrës, zbulon karakterin e mirëfilltë të shteteve të para europiane muslimane dhe natyrën e vërtetë të marrëdhënieve të tyre me shtetet fqinje europiane kristiane. Në territorin e Iberisë edhe kristianët, sikurse edhe muslimanët, gjatë shekujve kanë luftuar shpesh ndërmjet veti. Nuk ka qenë aspak gjë e rrallë që forcat e një shteti musliman dhe një kristian të bashkoheshin kundër një shteti të tretë, qoftë ai shtet islam apo kristian. Shembulli i heroit legjendar El-Sidit, i cili edhe pse si kalorës ka luftuar me vite besnikërisht në anën e muslimanëve kundër kristianëve, e pastaj sërish ka kaluar në anën e kristianëve që të luftonte kundër muslimanëve, nuk ka qenë kurrfarë përjashti-

mi. Konturet e konfliktit ndërftar dhe ndërkulturor i kanë marrë marrëdhëniet e muslimanëve europianë dhe kristianëve europianë vetëm pas tre shekujve nga formimi i shtetit të parë europian islam. Kësaj i kanë shkuar për shtati luftërat gjithnjë e më të theksuara për territore dhe epërsi rajonale ekonomike, në të cilat me të njëjtat të drejta dhe orekse kanë shkuar edhe këta edhe ata. Me shndërrimin e këtyre mosmarrëveshjeve lokale në luftë kryqtare ndërkombëtare, sunduesit e shteteve kristiane nga Gadishulli Iberik kanë mundur të llogarisin ndihmën e sunduesve kristianë nga pjesët e tjera të Europës, gjë që edhe ka ndodhur pas thirrjes së Papës nga Vatikani në emër të të gjithë katolikëve për ta bekuar një luftë të tillë.

As shtetet muslimane nuk qenë kursyer nga konfliktet e shpeshta dhe mjaft të rrepta ndërislame. Shkallë-shkallë janë krijuar shumë shtete të themeluara si dinastike, nga të cilat do t'i përmendim vetëm ato më të rëndësishmet. Fillimi shënohet me krijimin e Halifatit të Emevitëve, me halifin El-Velidin (711-750) në krye; e ka trashëguar Emirati i Kordobës (750-929); ky Emirat u rrit në Halifatin e Kordobës (929-1031); Halifati i Kordobës u shpërbë në shumë shtete të vogla - *taifa* - relativisht apo plotësisht të pavarura, të cilat në suaza mjaft të ndryshueshme kanë marrë trashëgiminë territoriale dhe kulturore të Halifatit të Kordobës. Në tërë periudhën e ekzistencës së tyre, shtetet europiane muslimane në truallin e Gadishullit Iberik përbënin bashkësitë e tolerancës së lartë fetare, këmbimit kulturor dhe bashkëpunimit aktiv të muslimanëve, kristianëve dhe hebrejve. Në kohën e Halifatit të Kordobës, Al-Andalusi përfaqësonte qendrën e shkencës dhe artit të tërë Europës, ndërsa vetë qyteti Kordoba në një periudhë ka qenë qendër qytetëruese e paprekshme e jetës ekonomike dhe kulturore të Mesdheut dhe të tërë Europës, si pjesës së saj islame, ashtu edhe kristiane.

Në periudhën vijuese, pushtetin mbi territoret e Al-Andalusit e morën dinastitë e berberëve, së pari të almoravidëve (murabitëve), e pastaj të almohadëve (muvahhidëve). Të fragmentuara në një numër më të vogël shtetesh, nga të cilat më i madhi ishte Emirati i Granadës, këto shtete të vogla pjesë-pjesë ranë nën sundimin e almoravidëve, të cilët së pari i mbrojtën ndaj sulmeve kristiane, sidomos gjatë kohës së sundimit të Alfonsit VI, kurse pastaj i kanë bashkangjitur si territore të tyre. Kjo situatë e pasigurt, e ndryshueshme dhe e paparashikueshme ka pasur pasoja negative mbi nivelin e atëhershëm të lartë të tolerancës kulturore dhe fetare, duke sjellë përndjekje të shpeshta të pakicave fetare dhe fuqizimin e puritanizmit dhe ekstremizmit fetar. Kjo ka shpënë drejt konfliktit më të ashpër të dy feve dominuese: Islamit dhe kristianizmit, të cilat e filluan luftën për epërsi në truallin e Europës. Goditja e parë e madhe kundër traditës politike dhe shtetërore të muslimanëve europianë dhe këtyre rrethanave të reja pasoi relativisht shpejt me rënien e qytetit të rëndësishëm të Toledos në vitin 1085. Rënia e Halifatit të Kordobës në vitin 1236 e rrëgoi këtë prani në kufijtë e Emiratis të Kordobës, shtetit të fundit musliman europian në Gadishullin Iberik. Në ndërkohë, në vitin 1249, Rekonkuista portugeze me pushtimin e qytetit Algavra shënoi fundin e pranisë shtetërore muslimane në truallin e Portugalisë. Përfundimisht, me dy janar 1492 kjo prani mori fund, kurse historia politike dhe shtetërore e muslimanëve në këtë pjesë të Europës ka përfunduar me dorëzimin e Granadës nga ana e Boabdilit, emirit Muhammedi XII, mbretëreshës kastiliane Izabelës I dhe mbretit aragonas Ferdinandit II. Megjithatë, kjo as për së afërmi nuk shënonte edhe fundin e vargut të pafund të ndikimeve pozitive shkencore, kulturore, filozofike, shoqërore, si edhe demografike të pranisë së muslimanëve europianë gjatë

plot tetë shekujsh ndikim, pasojat e të cilit janë të pashlyeshme deri sot.

Dramaticiteti i ndodhive dhe ndërlikimi i raporteve të ndërsjella politike, ekonomike e shpirtërore të qytetërimit islam dhe kristian, si identitete europiane, në periudhën e gjatë prej tetë shekujsh, më së miri mund të përshkohet nëpërmjet një kronologjie relativisht të hollësishme. Numri më i madh i figurave pittoreske, ndërmarrjet e shkëlqyeshme të karaktereve të jashtëzakonshme, kodi kalorësiak i nderit dhe historia e dinakërive luftarake, lajthitjeve të mëdha dhe të vërtetave të vogla por të rëndësishme, levërdia e pikëve të vogla të regjistruara në llogari të të parit, të dytit apo të tretit, dhe pasuria tepër e madhe e ruajtur në leksionet e pamësura të tolerancës dhe urtësitë e harruara të respektit të ndërsjellë, me peshë të rëndësishme vendimtare për zhvillimin bashkëkohor harmonik të tri feve të mëdha, si dhe e ardhmja e Europës si kontinent i tyre i përbashkët – të gjitha këto mund të kundrohen nëpërmjet pasqyrës kronologjike, të hartuar sipas fakteve objektivisht të njohura – *sine ira et studio*.

III.3. Pasqyrë kronologjike e historisë dhe e marrëdhënieve politike të Al-Andalusit, shtetit të parë evropian musliman, me shtetet krisitane europiane

Formimi i shtetit të parë evropian islam (710–756)

- 710 – Islami e zbulon Europën! Viti kyç në historinë e Europës multifetare. Formimi i shtetit të parë evropian musliman. Ushtria muslimane nën komandën e Tarik ibn Zijadit merr qytetin Tangjer në bregun afrikan të Gjibraltarit. Në këtë periudhë, pas përforsimit të pozicioneve në Tangjer, muslimanët ndërmarrin disa ekspedita në bregun

europian të rajonit Hispania Baetica (Andalusia bashkëkohore), pas të cilave, po atë vit, një njësi ushtarake muslimane më e madhe me Tarif ibn Malukun në krye, i cili ishte me prejardhje berbere, vendos praninë e parë të përhershme të muslimanëve në jug të Gadishullit Iberik. Gjatë kësaj nuk has rezistencë më të fuqishme, për shkak të konflikteve të sunduesve vizigotë nga rajoni, të cilët në atë kohë ishin në luftëra të përhershme të ndërsjella.

- 711 – Tarik ibn Zijadi, në cilësinë e komandantit të ushtrisë së Emirit nga Damasku el-Velidit I, udhëheq luftëtarët muslimanë të organizuar mirë me një forcë prej 7000 vetash dhe përparon thellë në brendi të Gadishullit Iberik. Kështu fillon epoka e sundimit të dinastisë së Emevitëve, kurse Islami hyn në Europë nga porta e madhe.
- Sunduesi i fundit vizigot, mbreti Roderik, thyhet rëndë nga Tarik ibn Zijadi në ndeshjen e njohur si *Beteja në lumin Guadeleti*. Menjëherë pas betejës, praktikisht pa pushim, Tariku me pjesën kryesore të ushtrisë vazhdon drejt qytetit Toledo, ndërsa një njësi të fuqishme, të cilën e udhëheq Mugit er-Rumiu, e dërgon në rrethimin e Kordobës. Të dy qytetet o morën me sukses.
- 712 – Guvernatori i Afrikës Veriore muslimane, Musa ibn Nusajri, kalon në truallin e Europës me përforsime dhe së bashku me Tarik ibn Zijadin marrin territoret dhe qytetet Medina-Sidonia, Sevilja dhe Mértola.
- 713 – Me vargun e aksioneve ushtarake të shkëlqyeshme, Abdulaziz ibn Musa, i biri Musa ibn Nusajrit, merr qytetet Jaén, Murcia, Granada, Sagunto.
- 714 – Fushatat e para të luftëtarëve muslimanë në rrjedhën e poshtme të lumit Ebro dhe në pjesët jugore të Gadishullit Iberik.

- Duke vazhduar aksionet e tij të rrufeshme, Abdulaziz ibn Musa mori qytetet Évora, Santarém dhe Koimbra.
- 715 – Gjatë këtij viti, praktikisht tërë pjesa jugore e Gadishullit Iberik është shtet kompakt musliman. Drejtimi i qe besuar Abdulaziz ibn Musait, i cili për rezidencë caktoi qytetin Sevilje. Nga fundi i po këtij viti Abdulaziz ibn Musai u vra në një atentat politik.
- 716 – Islami përhapet në Perëndimin e skajshëm të Europës. Muslimanët hyjnë në Lisbonë dhe ia bashkojnë shtetit të parë islam në Europë.
- 717 – Qyteti Kordoba bëhet kryeqyteti i ri i europianëve muslimanë. U mor Barcelona. Në këtë periudhë është i dukshëm forcimi i pranisë aktive të hebrenjve në punët diplomatike dhe këshilluese si te muslimanët ashtu edhe te kristianët. Ky do të jetë një nga pretekstet e kristianëve për përndjekjen e mëvonshme të hebrenjve nga Gadishulli Iberik.
- 718 - Pelajo, fisniku austriak i cili ka luftuar krah për krah me mbretin Rodrig në Betejën te lumi Guadalete, në të cilën qe mundur mbreti i fundit vizigot i Spanjës, arrin të forcohet në pjesën e Asturisë dhe që këtu ta shpall Mbretërinë e tij të Asturias. Njësitë muslimane e marrin me sukses këtë territor, por Pelajo arrin të largohet në rrëpirat malore me 300 luftëtarët e tij. Menjëherë pastaj vazhdon të organizojë forcat kristiane në luftë kundër ushtrisë muslimane.
- 719 – Muslimanët e zgjerojnë praninë e tyre sovraane në Europë. Pas pjesës së madhe të Gadishullit Iberik, hyjnë në Francën Jugore, ku ia bashkangjisin shtetit të tyre territore të tëra dhe ndërtojnë njësi të re administrative, e cila më vonë do të bëhet e njohur me emrin Languedok.
- 720 – Njësitë muslimane hyjnë në Barcelonë dhe Narbonë.

- 721 – Forcat e bashkuara të të gjitha shteteve fqinje kristiane, të udhëhequra prej trupave nga Akuitania dhe armata të shumta me dukën Odoakarin në krye (në histori më i njohur me emrin e shkurtuar Odo) nga Akuitania, në Betejën e Tuluzës në Francë, i shkaktojnë humbje të rëndë ushtrisë muslimane, të cilën e udhëhiqte es-Semh ibn Melik el-Haulani.
- 722 – Mbreti asturiak Pelajo, katër vjet pas humbjes në malet e Asturias, në krye të një ushtrie të madhe udhëheq Betejën te Kovadonga, në të cilën i thyen forcat numerikisht ndjeshëm më të dobëta të Emirit Munuz. Pas kësaj fitoreje organizon aleancën e Asturias dhe Kantabrisë, me të cilën fillon lëvizja e njohur në histori si “La Reconquista” – “Ripushtimi”. Vetë Pelajo kështu bëhet themelues i dinastisë iberike, e cila gjatë plot tetë shekujve, do të zhvillojë luftëra të gjata që t’i rimarrë sërish vendet iberike nga dora e europianëve muslimanë në duart e europianëve kristianë.
- 725 – Katër vjet pas humbjes nga frankët në Tuluz, ushtria e këndellur muslimane sërish depërton ngadhënjimtare nëpër Francën e Jugut dhe e merr territorin dhe qytetin Autun në pjesën franke të Francës.
- 729 – Në rajonin e Serdanisë, me nxitjen dhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të dukës Odo nga Akuitania, arrihet deri te kryengritja e armatosur e berberëve. Revolta u tejkalua me sukses, kurse ushtria të cilën e udhëhiqte duka Odo i Akuitanias, u mund.
- 732 – Ushtria akuitaniane sërish organizohet dhe kalon në ofensivë. Duka Odo i Akuitanias u mund nga luftëtarët muslimanë me tërë ushtrinë, të cilën e udhëheqte Abdu-rrahman el-Gafikî te lumi Garonë, pranë qytetit francez Bordo. Akuitania inkuadrohet në shtetin e parë musliman në truallin e Europës.

- Në vjeshtë të po atij viti ushtria franke nën komandën e Sharl Martelit (Charles Martel) i mundi muslimanët të udhëhequr nga Abdurrahman el-Gafikî, i cili në këtë betejë heroikisht vdiq. Kjo betejë shënonte fundin e përhapjes së mëtejme të shtetit të parë europian musliman drejt veriut të Francës.
- 737 – Forcat muslimane pas një vargu fitoresh, marrin me sukses qytetin Avinjon dhe pjesët jugore të luginës së lumit Rona.
- 739 – Përparimi dhe zgjerimi i mëtejme i shtetit të parë europian musliman u pamundësua prej kryengritjes së madhe të berberëve në rajonin e malit Atlas, në vijën ndërmjet Marokut dhe Algjerisë, si edhe në jug të Gadishullit Iberik.
- Berberët e rebeluar i shkaktojnë humbje ushtrisë së dërguar nga Siria për ta shtypur kryengritjen, me ç'rast vdiq edhe vetë komandanti Kulthum.
- Me urdhrin e mbretit të Asturias, Alfonsit I, muslimanët civilë u dëbuan nga e tërë Galicia. Ky ishte një precedent, i cili do të kishte pasoja të paparashikueshme për historinë e mëvonshme të Europës dhe marrëdhëniet e europianëve kristianë ndaj europianëve muslimanë. Modeli shumëkulturor dhe shumëfetar i shoqërisë, i cili qe nxitur dhe praktikuar në shtetin e parë europian musliman, nuk do të përhapet në pjesën kristiane të Europës. Në suaza të këtij shteti të parë europian musliman kanë jetuar të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh në identitetin e tyre etnik, kulturor dhe fetar. Prej asaj kohe përndjekja e muslimanëve do të bëhet paradigmë e sjelljes së kristianëve europianë ndaj europianëve muslimanë, e cila do të kulmojë në vitin 1492 dhe pastaj më 1616 me përndjekjen totale të të gjithë muslimanëve dhe hebrenjve nga territori i Gadishullit Iberik, dhe si e tillë do të mbetet deri më sot thelbësisht e pandry-

shueshme, gjë që është vërtetuar madje edhe në vetë fundin e shekullit XX, me agresionin, përndjekjen, pushtimin e territoreve, vrasjet masive, e madje dhe me gjenocidin, të cilin kristianët e armatës së Serbisë dhe ushtrisë së të ashtuquajturës Republikës Sërpska kanë bërë mbi muslimanët shqiptarë dhe boshnjakë.

- 740 – Kryengritja e re e madhe e berberëve kundër Hali-fatit të emevitëve, e motivuar me refuzimin e pagimit të detyrimitore tatimore.

- 741 – Pas humbjes nga berberët e rebeluar, ushtria siriane e Kulthumit të vrarë riorganizohet nën komandën e Thalebe ibn Seleme. Së pari iu hakmor me fitore berberëve për humbjen e mëparshme, e pastaj kaloi në territorin e shtetit islam në Europë. Rreth 10.000 luftëtarë u ngulën përgjithnjë në Kordobë dhe vetë Thalebe ibn Seleme, i cili ishte jordanez, bashkë me jordanezët e tij; kontingjenti nga krahina Homs në Sevilë; ushtarët nga vetë Damasku në Elvirë; kontingjenti nga Qinnasrini në qytetin Haen (Jaén), ndërsa palestinezët shkuan në Algesiras dhe në qytetin Medina-Sidonia. Kjo çoi deri te tensionet me bashkësinë muslimane. Shpejt shpërtheu lufta e mirëfilltë qytetare mes muslimanëve sirianë dhe iberikë, të cilëve më vonë u vjen në ndihmë një njësi më e madhe ushtarake e muslimanëve nga Afrika Veriore nën komandën e Abdurrahman ibn Habib-it.

- 742 – Lufta qytetare merr hov dhe zgjati plot katër vitet vijuese.

- 755 - Abdurrahmani I, sunduesi i dinastisë emevite para ofensivës së ushtrisë abasite tërhiqet nga Afrika Veriore (Maroku) dhe kalon në Gadishullin Iberik.

- 756 – Beteja më e madhe ndërmjet emevitëve dhe abasitëve ndodh në Kordobë. Abdurrahmani I nga dinastia e eme-

vitëve, i mundi abasitët nën komandën e Jusuf el-Fihriut, dhe me këtë krijoi kushtet për formimin e dinastisë vetjake në truall të Europës.

Emirati emevit në Kordobë (756–929)

- 756 - Abdurrahmani I, komandant i krahinës europiane islame Al-Andalus (*el-Endelus*), nga dinastia emevite të Emirit të Kordobës.
- 759 – Muslimanët e humbin qytetin e Narbonës (Narbonne, në Francë), ekspansioni i tyre më i largët dhe i fundit në territorin e Francës. Me marrjen e këtij qyteti mbreti Pipini i Vogël e ndërpreu përparimin e mëtejme të shtetit europian musliman në veri të Pirinejeve.
- 763 – Luftërat e ashpra të brendshme në shtetin europian musliman të Kordobës. Abdurrahmani I e qetëson me sukses rebelimin e berberëve.
- 764 – Me një aksion fitimtar, Abdurrahmani I merr qytetin Toledo nga sunduesi abasit Hisham ibn Urve.
- 766 – Koha e trazirave në shtetin e parë europian musliman. Kryengritja e madhe nën udhëheqjen e Said el-Matariut në qytetin Sevilje.
- 768-777 - Kryengritja e madhe e berberëve në pjesët qendrore të shtetit të parë europian islam. Lëvizja berbere e reformacionit tubon shumicën e nëpunësve lokalë dhe merr përkrahjen e pjesëve të tjera të banuara mbizotërueshëm me popullsi berbere. Lëvizja arrin suksese të konsiderueshme luftarake me marrjen e qytetit Meride dhe një varg qytetesh të tjera në veri nga Tagusi. Kryengritja u shtyp pas plot nëntë vitesh lufte shteruese qytetare.

- 771 – Sirianët ndjekës të abasitëve, të udhëhequr nga Abdulgaffari organizojnë kryengritje duke shfrytëzuar rebelimin e berberëve kundër pushtetit të emevitëve dhe drejtpërdrejt kundër Abdurrahmanit I, ndërsa pas sukseseve të para, pësojnë humbje të rëndë në betejën vendimtare në lumin Bembezar në vitin 774.
- 777 - Abdurrahmani I përfundimisht arrin ta shtypë kryengritjen abasite.
- 778 – Karli i Madh sulmon pa sukses qytetin musliman Saragosën. Pas ekspeditës së pasuksesshme, rrugës në kthim nëpër Pirineje, armata e Karlit të Madh më 15 gusht ra në një pritë, të cilën ia përgatitën baskët dhe pësoi humbje të mëdha, kurse me këtë rast është zënë pre e madhe. Kjo ngjarje njihet si Beteja në Grykën e Ronsevusë (Bataille du gorge Roncevaux). Historia e përmend sepse, ndër shumë kalorës të famshëm të ushtrisë së Karlit të Madh, me këtë rast vdiq Markgrof Hruotland, më i njohur me emrin Rolandi, përkatësisht, Rolando. Vdekjes së tij i është kënduar në poemën e njohur nga ajo kohë, si edhe në këngët e mëvonshme epike, nga të cilat më e njohura dhe për më tepër më me ndikim është ajo nga penda e autorit të famshëm Ludovik Ariosto me titullin *Orlando Furioso* (*Rolandoja i zemëruar*), sepse në versionin italian kjo figurë del me emrin Orlando). Poema e Ariostos ka frymëzuar praktikisht një varg të paimagjinueshëm poemash të minstrelëve për vdekjen heroike të Hruotlandit/Rolandit/Orlandit, ndërsa në letërsinë angleze ndikim sidomos të fuqishëm ka pasur autori skocez Xhejms Stjuart (James Stewart), i cili i frymëzuar prej poemës së Ariostos, ka botuar një vepër me temë të ngjashme në vitin 1565-1566. Ky shembull është absolutisht paradigmatic për fabrikimin sistematik të stereotipa-

ve negative për muslimanët, sidomos për muslimanët europianë nga ana e kristianëve europianë, të bazuar në fakte jo vetëm të paverifikuara apo të eksagjeruara, por në rrëfime plotësisht të trilluara. Me fjalë të tjera, në këto poema dhe libra që këndojnë vdekjen e këtij heroi, nga Danteja deri te Ariostoja, sikurse edhe në të gjitha poemat e trubadurëve dhe minstrelëve, Rolandin – Orlandin e vrasin muslimanët (*maurët, saracenët, muhamedanët*). Rolandi është treguar si luftëtar i madh dhe mbrojtës i kristianizmit kundër muslimanëve, të cilët janë paraqitur si jobesimtarë dhe armiq të më të mëdhenj të kristianizmit, edhe pse në këtë pritë në Grykën e Ronsevoit nuk ka pasur asnjë musliman të vetëm!? Përkundrazi, të gjithë pjesëmarrësit e kësaj masakre në këtë pritë kanë qenë pa përjashtim kristianët – si Karli i Madh dhe ushtria e tij, ashtu edhe baskët, të cilët, të regjur me luftërat në Pirinejet e vendlindjes së tyre, vunë atë pritë të shkathët! Edhe Rolandi/Orlandi i vrarë, edhe ata të cilët e kanë vrarë, kanë qenë të gjithë rresht kristianë. Përshkrimi i vdekjes së heroit të tyre më të famshëm nga ana e kristianëve, pikërisht prej muslimanëve, me çmimin e pasimit të gënjeshtëtrës famëkeqe, ka konotacionin e vet të qartë ideologjik dhe psikologjik, sikurse edhe synimin e padiskutueshëm të nxisë urrejtje dhe zemërim ndaj muslimanëve! As praktika e fabrikimit të gënjeshtreve, as synimi themelor i një praktike të këtyllë, për fat të keq deri më sot nuk janë braktisur; mosdurimi i europianëve kristianë ndaj europianëve muslimanë transmetohet sistematikisht nga brezi në brez me të gjitha mjetet e edukimit, arsimimit, me dezinformim mediatik, me përkufizimin politik dhe (kuazi)shkencor të muslimanëve si *armiq*. Kjo praktikë tashmë ka kapërcyer aq shumë çdo masë dhe objektivitet, sa që,

sado të dukej dhe të jetë kjo e krisur dhe e çrregulluar, në shumë media muslimanët janë shpallur në mënyrë implicite por edhe eksplicite madje edhe si fajtorët e mirëfilltë, për shkak të të cilëve norvegjezi A. Behring Breivik, ka vrarë 85 të rinj në Oslo, në korrik të vitit 2011.

- 781-881 – Praktikisht tërë ky shekull ka kaluar në luftëra të ndërsjella dhe kryengritje të kohëpaskohshme, sidomos në rajonin e Saragosës.
- 785 – Fillon ndërtimi i Xhamisë së Madhe në Kordobë. Kjo vepër e pakapërcyeshme e arkitekturës islame është përfunduar në vitin 976, pas 91 vjetësh ndërtimi të pandërprerë.
- 788 – Kaloi në ahiret (vdiq) Abdurrahmani I, themeluesi i dinastisë emevite dhe i emiratit të Kordobës. E trashëgoi Hishami I.
- 791 – Proklamimi i Alfonsit II për mbret të Asturias në Oviedo.
- Vala e re e përhapjes së shtetit të parë europian musliman, i cili sërish e përfshin në përbërjen e tij pjesë të Galicisë.
- 792 - Hishami I, Emiri i Kórdobës, thërret për xhihad kundër rrezikut që i kanoset nga shtetet fqinje kristiane, sidomos nga Franca. Pas sukseseve të rëndësishme të para, me ç'rast janë marrë territoret deri te qyteti Narbona (Narbonne), duke e përfshirë edhe vetë qytetin, ushtria muslimane u ndalua në Francën Jugore te Karkasona (Carcassonne).
- 794 – Beteja me trupat e Asturias me fat të ndryshueshëm për të dyja palët.
- 795 – Ushtria e Emirateve korr fitore të madhe dhe push-ton territorin e Astorgës me qytetin me po këtë emër.
- 796 – Ndërrim në fron. Pas vdekjes së Hishamit I, el-Hakemi I bëhet emir i Kórdobës.

- 798 - Alfonsi II mbreti i Asturias me ushtrinë e madhe depërton deri në Lisbonë por, pas rrethimit të gjatë të pasuksesshëm, u detyrua të tërhiqej i mundur.
- 799 – Në veriperëndimin skajor të Gadishullit Iberik në rajonin e Baskisë, baskët organizojnë një kryengritje të madhe dhe me sulm të befasishëm mbi qytetin Pamplon e vrasin guvernatorin e krahinës islame.
- 800 – Karli i Madh në krye të armatës së madhe depërton deri në Barcelonë dhe nga Papa Leu III fiton titullin e “Perandorit të Shenjtë Romak”, me kushtim që si këmbim të garantojë se do ta mbrojë Romën nga invadimi kërcënues i Lombardëve.
- 800 – Po atë vit, i trimëruar nga Karli i Madh, i cili premton ndihmë, shpërtheu kryengritja dhjetëvjeçare përgjatë tërë Al-Andalusit (në Lisbonë, Mérida dhe Toledo). Të tria kryengritjet në fund u mposhtën, kurse disa skalione të Karlit të Madh të dërguara për të ndihmuar kryengritësit, u shpartalluan plotësisht.
- 801 – Pas vitit 804 qyteti, të cilin europianët muslimanë e quajtën *Medina Barshaluna* sërish kalon në duar të evropianëve kristianë. Mbreti Luj i Devotshmi, i biri i Karlit të Madh, pushton Barcelonën.
- Krijohet zona asnjandëse ndërmjet Francës dhe Al-Andalusit, e quajtur *Marca Hispanica* (Kufiri spanjoll).
- 806 – Armata franke arrin ta pushtojë Pamplonin. Karli i Madh tubon një armatë të madhe, duke përgatitur sulmin mbi Kataluninë (Katalonjën).
- 808 – Sulmet franke thyhen në Tortozi.
- 809 – Pushtetin në Lisbonë e merrë Tumlusi, një musliman renegat deri atëherë anonim. Pas një beteje të rreptë

Lisbonën sërish e merr dinastia emevite, kurse Tumlusi u ekzekutua publikisht.

- 811- Shtetet kristiane i bashkojnë angazhimet ta dobësojnë shtetin e parë islam në Europë. Me ndihmën e tyre në para, armë dhe ushtarë, përgatitet kryengritja e madhe në rajonin e Toledos, e cila me ndërprerje zgjat plot tetë vjet.
- Fillon ofensiva e përgatitur gjatë kohës së Karlit të Madh. Frankët nën udhëheqjen e tij marrin kontrollin mbi tërë Katalunjën (Kataloninë), e cila mbetet “Kufiri i ri i Spanjës” deri në vitin 874.
- 819 – Rebelimi i madh kundër pushtetit frank në Pamplon shtypet pas luftërave të gjata.
- 822 - Abdurrahmani II bëhet emiri i ri i Kórdobës.
- 824 – Baskët në rajonin e Pamplonit sërish ngrihen kundër pushtetit të egër frank. Në betejën e dytë në Grykën e Ronsevos, pas asaj në të cilën Karli i Madh mezi e shpëtoi kokën, kurse kalorësi i vranë bëhet heroji më i madh i Europës kristiane saqë nga tërë tregimi pa të drejtë janë fshirë pjesëmarrësit e mirëfilltë, baskët, të cilët e mundën armatën e Karlit të Madh dhe vranë Ronaldin, dhe që po ashtu pa arsye në tregimin e frymëzuar në mënyrë islamofobike janë ndërruar me muslimanët (saracenët, maurët) të cilët aspak nuk kanë marrë pjesë në këtë betejë, armata franke u shkatërrua kurse baskët shpallën Mbretërinë e lirë të Pamplonisë.
- 827 – Kryengritja e banorëve muslimanë dhe gotë kundër sundimit të frankëve në Barcelonë, në të cilën përkohësisht është marrë tërë qyteti pos kështjellës. Komandanti i qytetit Bernat Septimania e përballon rrethimin e kështjellës dhe më vonë me ndihmën e forcave rishtas të ardhura, arrin t’i mund kryengritësit.

- 828 – Rebelimi i banorëve kristianë kundër sundimit musliman në qytetin Mérida mposhtet shpejt.
- 829 – Rebelimi i ri në qytetin Mérida, i nxitur nga frakët, shtypet shpejt.
- 839 – Mbreti i Asturias Alfonsi II organizon ushtrinë e tij dhe themelon armatën e fuqishme prej mercenarësh.
- 844 – Vikingët me barka lundrojnë në grykëderdhje të disa lumenjve në Galici (Portugalia e sotme). Pasi i grabitën dhe e dogjën një numër të madh vendbanimesh, fitojnë mbi ushtrinë e mbretit Ramirit I. Të trimëruar nga këto fitore, e sulmojnë Lisbonën dhe Seviljen, por armata muslimane e Kordobës i mundi rëndë në të dy betejat, i shpëtoi të dy qytetet, kurse vikingët e paktë të mbetur i dëboi përfundimisht nga Galicia.
- Beteja legjendare te vendi Klaviho (Clavijo). Mbreti Ramiri I, të cilin po atë vit e kishin mundur vikingët, kurse e kishte shpëtuar armata muslimane e Kordobës, sulmoi me trupa të freskëta ushtrinë e dobësuar muslimane. Edhe pse ndjeshëm më e dobët, ushtria muslimane ishte në prag të fitores së madhe, por fati luftarak në çastin e fundit u kthye kundër tyre. Prej atëherë tradita spanjolle këtë çudi ia vesh shenjtit të madh Sant Iagos, i cili i ndihmoi spanjollët të fitonin, rrjedh prej emrit hebraik Jakob, i cili në gjuhën angleze është shndërruar në James. Spanjollët këtë emër e përdorin edhe në formën sinonimike të emrit Diego. Legjenda e ka lidhur me çudinë e zbulimit të varrit të Jakobit të Shenjtë (Santiagos) (vdiq në vitin 44 të erës sonë në Jerusalem) në vitin 813 në afërsi të qytetit Kompostela, Spanja veriperëndimore. Santiago prej atëherë është shenjtori kryesor i spanjollëve dhe mbrojtësi i Spanjës. Qyteti prej atëherë quhet Santiago de Kompostela – sikurse edhe Santiago de Çile, Santiago de Kuba dhe shumë të tjerë.

- 852 – Vdekja e emirit Abdurrahmanit II.
- 852 - Muhammedi I bëhet emiri i ri i Kordobës.
- 855 – Mbreti Ordoño I pas rrethimit dymujor e merr qytetin León nga mbrojtësit muslimanë.
- 859 – Vikingët shfrytëzojnë mospraninë e ushtrisë muslimane në rajon. Në invadimin në bregun e Galicisë e ngadhënjëjnë armatën spanjolle, e harrojnë mbretin e Pomplonës García Íñiguez dhe e lirojnë vetëm pas një shpërblimi të madh.
- 871 – Forcat e bashkuara kristiane e marrin nga muslimanët qytetin Koimbro. Komandanti i kësaj armate Hermenegildo Mendes e ka marrë titullin Konti nga Koimbra.
- 873 – Vilfred Leshtori arrin të fitojë një shkallë të caktuar autonomie për Barcelonën nga pushteti i mbretërve frankë dhe vetes t'i sigurojë titullin e Kontit nga Barcelona. Kjo autonomi do të zgjasë 25 vitet vijuese.
- 886 - el-Mundhiri bëhet emir i ri i Kordobës.
- Situata politike në tërë territorin e Al-Andaluzisë shkallërisht stabilizohet deri në vitin 912.
- 888 – Pas vdekjes së befasishme të el-Mundhirit, emir i ri i Kodobës bëhet Abdullah ibn Muhammedi.
- 905 - Sancho I bëhet mbret i ri i Pamplonit, të cilin deri atëherë e mbanin baskët, pasi bëri puç me ndihmën e përbashkët të armatave kristiane të Alfonsit III, mbretit të krahinës León, Raymondit I, Kontit nga Pallarsa dhe Ribagorze, sikurse edhe me ndihmën e ushtrisë muslimane, të cilën e udhëhiqte Benu Kasijj.
- 912 – Titullin e emirit të Kordobës e merr Abdurrahmani III. Nën administrimin e tij Kordoba përjeton rilindjen e vet, kurse pozita e muslimanëve në tërë territorin përforcohet. Në ofensivat pranverore të forcave muslimane çdo vit kthehen territoret paraprakisht të humbura.

- 913 - Ordoño II, mbreti i ri i krahinës León, e pushton qytetin Évora (arabisht,Talavera) dhe i zgjeron kufijtë e krahinës së tij.
- Po atë vit qyteti kryesor i mbretërisë së Asturiasë transferohet nga Oviedo në Leon, kurse krahina Leon bëhet shteti Mbretëria Leon.
- 916 – I entuziazmuar me këto suksese, Ordoño II, mbreti i shtetit León, me një ushtri të madhe fillon sulmin mbi Emiratin e Kordobës. Pas disa humbjeve të njëpasnjëshme në beteja më të vogla, Ordoño II u mund rëndë nga ushtria muslimane, të cilën e udhëhiqte në betejën legjendare të Valdehunkuoeri (Valdejuquera).
- 917 – Ordoño II tubon armatë të re. Tek vendi San Esteban de Gormaz has në ushtrinë numerikisht mjaft më të dobët të Emirit Abdurrahmanit III dhe fiton kundër saj.
- 918 – Në betejën e re të madhe të qyteti Evora (Talavera) ushtria muslimane nën udhëheqjen e Abdurrahmanit III ndeshet me pjesën kryesore të armatës, të cilën e udhëheq mbreti Ordoño II dhe i shkakton një humbje të rëndë armatës numerikisht shumë më të fuqishme.
- Që t'i bashkojë të gjithë kristianët e Gadishullit Iberik Papa Huani X (Gjoni, Ivani, Jovani) me edikt pranon ortodoksinë dhe legjitimitetin e Liturgjisë Vizigote, e cila sillet sipas mënyrave të ritualeve të lutjeve maure/arabe.
- 920 – Sunduesit kristianë i bashkojnë forcat e tyre dhe me një armatë të madhe sulmojnë Emiratin e Kordobës. Në betejën e re të Valdehunkuoerës (Battaille de Valdejuquera), armata të cilën sërish e udhëheq Abdurrahmani III u shkakton një humbje edhe më të rëndë armatave kristiane të Mbretërisë Leon.

- 920 – Me ofensivë ngadhënjyese armata muslimane edhe një herë kalon Pirinejet, depërton nëpër Gaskonjë duke pushtuar rrugës të gjitha qytetet në këtë zonë dhe arrin deri te muret e Tuluzës. Bie kështjella Muez, e cila quhej e pamposthur, kurse ushtria muslimane rrethon edhe qytetin Pamplon, duke e nënshtuar sërish Mbretërinë Pamplone.
- 923 – Pas rrethimit të gjatë dhe luftërave të ashpra, forcat muslimane e pushtuan edhe qytetin e Pamplonit.

Halifati i emevitëve (929–1031)

- 929 – Valën e fitoreve të mëdha të muslimanëve të Europës ndaj kristianëve të Europës që i korri Emiri Abdurrahmani III, e pengoi kërcënimi i invadimit të armatës së Fatimitëve nga Bagdadi. I ballafaquar me kërkesat e pushtetit qendror nga Bagdadi që ta lëshonte pushtetin, Emiri i Kordobës i ndërpreu zyrtarisht të gjitha raportet me Bagdadin dhe u shpall sundues suprem dhe i pacenueshëm i muslimanëve të Kordobës me titullin Halif i Kordobës. Që të sigurohej nga sulmi i pritur i pushtetit qendror të Fatimitëve, e ndërpreu ofensivën në veri të Pirinejeve dhe e ktheu armatën e tij në truallin e Gadishullit Iberik. Në kohën e sundimit të halifit të Kordobës, Abdurrahmanit III, e arrin kulmin e fuqisë dhe të shkëlqimit shteti i parë musliman i Europës.
- 930 – Gjatë 20 viteve vijuese, duke i shfrytëzuar luftërat e Kordobës me fatimitët, Ramiro II mbreti i Leónit, ndërmoi disa ofensiva kundër shtetit musliman, të cilat edhe pse me fat të ndryshueshëm, megjithatë përfundojnë pa sukses.
- 933 – Beteja te vendi Osma (Bataille de Osma), në të cilën u bashkuan armatat e Kastiljes dhe Leonit, nën koman-

dën e Fernán Gonzálesit nga Kastilja, arrijnë një fitore me rëndësi ndaj ushtrisë së dobësuar muslimane.

- 939 – Pas disa fitoreve të muslimanëve europianë ndaj kristianëve europianë, të cilat sërish e vendosën baraspeshën e rrënuar, në betejën te Simanke (Bataille de Simancas) Ramiro II mbreti i shtetit León u shkakton humbje muslimanëve të cilët në këtë betejë i udhëheq en-Nasiri.

- Madridi për herë të parë nga pushtimi sërish u kthye në duar të kristianëve. Luftërat e ashpra të Mbretërisë Leon dhe Halifatit emevit për territorin qendror të gadishullit Iberik dhe sidomos qytetin Madrid, zhvillohen me fitore dhe humbje të njëpasnjëshme. Në betejën e madhe në ngushticën e Simankes (arabisht, Shant Mankus), së pari mbreti Leon i shkakton humbje të rëndë ushtrisë muslimane, me ç'rast vetë Abdurrahmani III për pak, vetëm falë heroizmit personal, e shmangu vdekjen. Megjithatë, në vitin vijues (940), armata e Halifatit Emevit të Abdurrahmanit III, e fiton betejën kyçe kundër Mbretërisë së Leonit pranë Madridit dhe kështu sërish merr Madridin dhe kontrollin mbi Iberinë qendrore.

- 953 – Në periudhën vijuese, fuqia e Halifatit Emevit sërish rivendoset. Perandori Oto I (Otto I) dërgon përfaqësuesit në Kordobë me lutje për halifin Abdurrahmanin III, që t'i ndërpresë sulmet e njësive muslimane, të cilat i kontrollonin kalimet nëpër Alpe në rrugë për Zvicër dhe Itali.

- Ekspedita e re e madhe e muslimanëve në Galici përfundon me fitore të plotë, me rivendosjen e sërishme të kontrollit mbi tërë krahinën.

- 955 – Mbreti i ri i Mbretërisë, Ordoño III sulmon Lisbonën por, pas humbjeve të mëdha, u detyrua të kthehej.

- 961 – Vdiq halifi Abdurrahmani III. Pas vdekjes së tij, halifi i ri i Halifatit Emevit bëhet el-Hakemi II.

- 974 – Kryengritja e madhe e kristianëve në Sevilje, e ndihmuar me trupa të fuqishme të shteteve kristiane fqinje. Ushtria e Halifatit Emevit e dërguar nga Kordoba, me luftëtarin e njohur në krye, Ibn Tumlusin, arriti fitore të madhe dhe sërisht vendosi pushtetin e ligjit në tërë territorin e Halifatit.
- 976 – Vdiq halifi el-Hakemi II. *De facto* pushtetin e mori el-Mansuri, edhe pse *de jure* në emër të halifit të ri Hishamit II., el-Mansuri vendosi një lloj diktature ushtarake. Duke e shfrytëzuar kaosin, konfuzionin dhe kryengritjet në Halifat, forcat kristiane të shteteve fqinje organizojnë sulme të shpeshta, djegin qytetet dhe grabisin popullin. Që t’i pengojë, el-Mansuri i shpërngul ekspeditat ushtarake në territoret e sulmuesit. Grabitjet dhe djegiet e qyteteve këmbëhen në fillim thuajse me reciprocitet të plotë.
- el-Mansuri godet në vetë zemrën e sulmuesit, goditje e cila e shkretoi Barcelonën dhe tërë territorin përreth.
- 977 - el-Mansuri vullnetarisht pranon ta udhëheq ushtrinë e kalifatit të Kordobës kundër fqinjve kristianë, të cilët nuk i pushojnë sulmet. Në një varg betejash, el-Mansuri ngadhënjën njëri pas tjetrit mbi katër ushtri kristiane.
- 981 - el-Mansuri e shkatërron ushtrinë e mikut të tij të dikurshëm Galibit (Ghalib) në betejën e madhe vendimtare të Atience (Atienza). Në anën e Galibit luftojnë trupat nga Andaluzia të rebeluara kundër pushtetit qendror, sikurse edhe kontingjenti i madh i ushtarëve kristianë nga Kastilja, të udhëhequr nga ana e luftëtarit të njohur, konti Garsia Fernandezi. Gjatë rrjedhës së luftës u vranë edhe konti Garsia Fernandezi, edhe udhëheqësit e trupave të rebeluar muslimanë.
- Mbreti i shtetit León, Ramiri III, po atë vit u mund nga el-Mansuri në betejën legjendare të vendi Rueda, kështu që

u detyrua ta pranonte pozitën e vasalit dhe t'i paguante një tatim të madh Halifatit të Kordobës.

- 983 – Fitorja e el-Mansurit jehon deri në Bagdad. Udhëheqësi i berberëve Zavi ibn Ziri, me prejardhje nga gjaku mbretëror runian, së pari ngriti kryengritje në tërë Magrebin, i cili pas shtypjes së kryengritjes u rebelua; tuboi ushtri të madhe të përbërë nga kalorësit e njohur Sanhaja, dhe u nisur drejt Gjibraltarit me synim që t'i bashkoheshin el-Mansurit. Megjithatë Halifati i Bagdadit, duke kontrulluar të gjitha anijet në kalimin e Gjibraltarit, e pamundëson në mënyrë të përhershme planin e tij.
- 985 – I biri njëzetvjeçar i el-Mansurit kryen një seri sulmesh të suksesshme mbi kështjellat kristiane dhe qytetet në rajon.
- 985 - el-Mansuri ndërmerr një sulm të madh, në të cilin sërish e shkatërroi Barcelonën.
- 986 – Sulmet të cilat i udhëheq el-Mansuri gjatë këtij viti, ngjallin panik të vërtetë; organizohen grupet për rezistencë dhe shtohen thirrjet për ndihmë vendeve kristiane në rajonin përgjatë Europës.
- 987 - el-Mansuri i shkakton humbje të thellë armatës së bashkuar kristiane te vendi Koimbre.
- Pasi i pushtoi të gjitha kështjellat dhe fortifikatat në veri të lumit Douro, el-Mansuri arrin deri te qyteti Santiago de Compostela, në të cilën gjendet varri i mbrojtësit të Spanjës Shën. Jakobit (Santiago, San Diego, anglisht St. Xhejms). Pasi banorëve u lejoi ta braktisin qytetin, el-Mansuri e rrënoi deri në themel dhe i dogji fortifikatat e qytetit.
- el-Mansuri kthehet nga ekspedita e fitores dhe sjell dyert e bazilikës, kambanat e kishës dhe arkën në të cilin gjendej

Santiago de Compostela, dhe i përcjell të paprekura në xhaminë kryesore të Kordobës.

- 988 – Beteja e re e madhe dhe fitorja e re. el-Mansuri e thyen armatën e bashkuar të kristianëve, të cilën e udhëheq mbreti i Leonit, e pastaj e rrafshon Leonin me tokën. Në kthim i pushton edhe qytetet Zamora dhe Sahagun.
- 989 - el-Mansuri e sulmon qytetin Osman, në të cilin tubohen trupa të reja kristiane dhe e pushton, kurse ushtrinë e gjetur e shpartallon.
- 994 – Vit relativisht i qetë, pa konflikte më të mëdha ushtarake të europianëve muslimanë dhe europianëve kristianë.
- 995 – Familja e fuqishme Beni-Gomez tubon ushtrinë e vet; iu bashkohen ushtritë e kalorësve nën komandën e dukëve kristianë të qyteteve Saldaña, Liébana, Carrión dhe Zamora. el-Mansuri i sulmon me kalorësinë e tij. Duke i mundur fuqishëm, e pushton kryeqytetin Santa Maria de Carrion dhe e rrënon në themel fortifikatën e tyre familjare mbi qytet.
- 997 – Ekspedita e madhe luftarake nën komandën e el-Mansurit, në të cilën ushtria muslimane pushton territore të mëdha në veri të Kordobës.
- 998 – Sllavi që kishte pranuar Islamin, me emrin Vadih (Wadih), i cili së pari i dallua si luftëtar i pathyeshëm, e pastaj si komandanti më i mirë në ushtrinë e el-Mansurit dhe në tërë Andaluzinë, e kalon Gjibraltarin dhe në sulmin faktikisht të shkëlqyeshëm e pushton qytetin e Fesit në Marok, të cilin e quanin praktikisht të papushtueshëm.
- Njësitë muslimane e vendosin garnizonin e tyre në qytetin Zamora, të cilin për një kohë të shkurtër e patën pushtuar tre vjet më parë.

- 1000 – Mbreti i Navarës Sanço III (Sancho III) me ushtri të madhe përgatit kundërofensivë në territoret muslimane.
- 1000-1033 – Në këtë periudhë, edhe pse nuk arrin t'i pushtojë vendet muslimane në truallin e Iberisë, megjithatë me sukses i mban nën kontroll territoret e Navarës, Aragonit dhe Kastiljes dhe i bashkon në një mbretëri. Në shtetërat e vdekjes së rish e ndan mbretërinë në tri pjesë, duke ia lënë Navarën djalit të tij Garsisë III nga Pamploni (García III de Pamplona), Kastiljen djalit të dytë Fernandit I, kurse Aragonën e fiton i biri i tretë, Ramiro I.
- 1002 – Ekspedita e fundit e el-Mansurit. I pushton disa këshqjella në rajonin La Rioja (La Rioja).
- Kalorësi i madh el-Mansuri vdes në shalë të kalit në hyrjet e fshatit Salem.
- Në gjendjen e ndër-mbretërimit, në shtetin e parë evropian musliman Andaluzi (el-Endelus) sundojnë grupet joformale të fisnikërisë së vjetër arabe, elitat ekonomike të tregtarëve berberë dhe trupat ushtarake në masë të madhe të përbëra nga sllavët, pasues të komandantit Vadih, i cili edhe vetë ka prejardhje sllave.
- 1002-1008 – I biri i el-Mansurit el-Mudhafferi e vazhdon traditën e babait me disa aksione të suksesshme ushtarake kundër fqinjëve kristianë.
- 1003 – Ushtria muslimane i shkakton humbje armatës kristiane. Qyteti Leon u shkatërrua.
- 1004 – Kalorësia muslimane e udhëhequr nga el-Mudhafferi depërton nëpër Francën jugore dhe Italinë veriore, hyn në qytetin e Pizës dhe e grabit. Kthehen në Al-Andaluzi me pre të madhe.
- 1008 – Befasisht vdes el-Mudhafferi. Vendin e tij e zë Abdurrahman ibn el-Mansuri, i biri i dytë e komandantit

të pathyeshëm el-Mansurit, dhe bëhet sunduesi jozyrtar. Në dimër ndërmer një ekspeditë të suksesshme në shtetet fqinje kristiane.

- Muhammedi II – stërnipi i Abdurrahmanit III – i zë vendin halifit Hishamit II dhe duke e shfrytëzuar mungesën e tij, e rrënon kompleksin e madh të pallatit el-Madinetu'z-Zehra në afërsi të Kordobës.
- Muhammedi II el-Mehdiu u shpall Halif i Halifatit emevit të Kordobës.
- Lufta e ndërsjellë e dy halifateve muslimane sjell periudhën e anarkisë të gjatë plot 23 vjet, gjatë së cilës formohen 25 shtete të vogla (taifa) të disa familjeve të dalluara muslimane dhe berbere.
- 1009 – Muslimanët e shtetit të parë evropian musliman shkallë-shkallë këndellen dhe sërish bashkohen. Pas një fitoreje kundër ushtrisë së mbretërisë Leon sërish e shkatërrojnë kryeqytetin León.
- Ushtria berbere shpartallohet. Berberët e dëbuar nga Kordoba vendosin bazën e tyre të re ushtarake në vendin Kalatrava. Gjeneralët e tyre emërojnë një pasardhës të Abdurrahmanit III – Sulejman el-Mustainin si halif paralel të Kordobës.
 - Sulejmani lidh aleancë ushtarake me armatën kristiane të kontit Sanço Garsia nga Kastilja (El Conte Sancho García de Castilla) dhe fillon luftën kundër halifit emevit Muhammedit II. Forcat e tyre të bashkuara numerikisht më të fuqishme i thyjnë rojet andaluziane të Muhammedit II dhe e shkatërrojnë qytetin e Kordobës.
 - Halifi berber Sulejman el-Mustaini e rrëzon Muhammedin II dhe shpallet halif i ri i Halifatit emevit të Kordobës me titullin Sulejmani II.

- Taifa – mbretëria e pavarur autentike arabe në Badahoz (Badajoz) shpallet halifat i pavarur jashtë jurisdiksionit të Halifatit të Kordobës dhe i forcon kufijtë e saj në territorin ndërmjet Koimbrës dhe Alentehut verior (Coimbra dhe Alentejo del Norte).
- 1010 – Nën kërcënimin e rrethimit, halifi i rrëzuar Muhammedi II e lëshon Toledon. Lidh aleancë ushtarake me Ramon Borellin, kontin nga Barcelona dhe Urgela (Conte de Barcelona y Urgel). I bashkon ushtritë e muslimanëve arabë dhe të armatës katalonase dhe i shkaktoi dy humbje të njëpasnjëshme armatës berbere të halifit Sulejmani II së pari te Akabet el-Bekar (Aqabat al-Baqar), e pastaj te lumi Gvadiaro në afërsi të qytetit Ronde.
- Mohammedi II e pushton Kordobën, i ndihmuar me trupat sllave të komandantit el-Vahid. Në hyrje në qytet, Muhamedin II e vranë në atentat.
- Hishami II shpallet halif të Halifatit emevit të Kordobës, me veprim të drejtpërdrejtë të ushtrisë së el-Vahidit.
- 1012 – Vrasja e pasqaruar e komandantit el-Vahid. Ushtria sllave shpartallohet. Duke i tubuar trupat e tyre, berberët me Sulejmanin II në krye sërish hyjnë në Kordobë. Sipas urdhrit të tij, gjysma e meshkujve të rritur të Kordobës u ekzekutuan.
- Sulejmani II sërish e vendos emrin zyrtar të Halifatit Emevit të Kordobës. Armata e vetme zyrtare shtetit bëhen trupat e tij berbere.
- 1013 – Elita ushtarake berbere e vendos sundimin e terrorit. Halifin e robëruar Hishamin II, të rrëzuar paraprakisht nga berberi Sulejmani, publikisht e ekzekutojnë në Kordobë.
- Berberët ia mohojnë nënshtrimin halifit të tyre Sulejmanit II. I pafuqishëm që t'u kundërvihet, për arsye se vetë

paraprakisht i kishte shpallur berberët për ushtrinë e vetme të ligjshme të Kordobës, Sulejmani II u detyrua ta pranojë *ofertën prej xhentellmenësh* të komandantëve berberë, t'ua lëshonte sundimin në të gjitha provincat e shtetit dhe t'i zbatonte urdhrat e tyre.

- Me kërkesë të komandantëve berberë, urdhërohet dëbimi i hebrenjve nga Halifati emeviti i Kordobës.
- Filozofi dhe poeti i madh hebraik Jehuda Halevi (1075-1141) ikën nga Kordoba në Malagë që ta shpëtojë jetën.
- Halevi emërohet vezir i Emirit nga Granada, e diç më vonë edhe i biri i tij Jozefi (Jehoseph) Ha-Nagid. Të trimëruar me këto respekte të larta të bashkëqytetarëve të dalluar, shumë hebrenj kërkojnë dhe gjejnë strehim të sigurtë në Granadën muslimane.
- Fillon shpartallimi i Halifatit të Kordobës. Shumë mbretëri të vogla arabe (taifa) mbijnë në territorin e tij si kërpuhat pas shiut.
- 1014 – Shpërthejnë lufta qytetare dhe luftimet dinastike në truallin e shtetit të parë evropian musliman. Kryepari i berberëve Zavi ibn-Ziri, anëtar i familjes mbretërore tuniziane, vihet në krye të ushtrisë së konfederatës Sanhaja dhe hyn në Granadë për t'u shpallur si Emir i ri i Granadës.
- 1015 - Emiri Deniu (Denia) në ujdhesat Baleare, Muxhahid el-Amiri (Mujahid al-Amiri), me flotën prej 125 anijesh niset në ekspeditë në Sardenjë.
- I trimëruar nga rrënimi në Kordobë, Ali ibn Hammudi, Emiri i Seutës (Ceuta), e shfrytëzon rastin që ta shpallë veten halif dhe niset për pushtimin e Kordobës. Komandantët berberë, të cilët qenë bezdisur diskutimi me figurën marionetë, halifin Sulejmanin II, e heqin nga fronti dhe e ekzekutojnë publikisht, duke i prerë kokën në tregun e Kordobës.

- Muxhahid el-Amiri e ndërpret invadimin e Sardenjës për shkak të sulmit të flotës së bashkuar të anijeve të Gjenovës dhe Pizës, të cilat e detyrojnë që të tërhiqet.
- 1018 – Halifi i ri i vetëshpallur i Kordobës, Ali ibn Hammudi u vra nga një atentat. Vendin i zë vëllai i tij el-Kasimi, edhe pse për një kohë të shkurtër, sepse së shpejti përjeton të njëjtin fat. Ushtria e Granadës e mund armatën e Andaluzisë të udhëhequr nga Abdurrahmani IV el-Mutad – pretendentit të ri në titullin vdekjeprurës të halifit të Kordobës.
- Taifa e krahinës Algarve shpall pavarësinë e vet.
- 1021 – Abdurrahmani IV tubon një ushtri të re dhe këtë herë arrin ta marrë selinë si halif i Halifatit emevit të Kordobës, edhe pse atje nuk arriti të qëndronte as një vit të tërë.
- Jahjai (Yahya), i biri i mëkëmbësit të deriatëhershëm, me ndihmën e berberëve, e shpall Malagën shtet të pavarur.
- 1022 – Pas shkarkimit të Abdurrahmani IV, titullin e halifit të Kordobës e merr Abdurrahmani V, me ndihmën e komandantëve atëherë të pamënjaueshëm të berberëve.
- Krijohet taifa e re e pavarur arabe me seli në Lisbonë. Po atë vit i bashkëngjitet taifës së Badahozës (Badajoz).
- 1023 - Muhammedi III bëhet halif i ri i kalifatit emevit të Kordobës, sërish me ndihmën e trupave të aleancës luftëtare të berberëve.
- Emiri abasit i Seviljes, Ebu el-Kasim Muhammed ibn Abbadi, shpall pavarësinë nga Muhammedi III, halifi emevit i Kordobës.
- 1025 - Ebu el-Kasim Muhammad ibn Abbadi, emiri abasit i Seviljes, pushton dy kështjella në Alafoesë (Alafões), në veriperëndim të Kordobës.
- 1027 - Hishami III bëhet halif i ri emevit i Kordobës.

- 1028 - Alfonsi V, mbreti i Asturisë dhe Leonit, ndërmerr rrethimin e Vizoit por vritet në luftime.
- Halifati musliman-arab i Kordobës e humb pavarësinë.

Copëtimi politik i shteteve iberike (1031-1130)

- 1031 – Halifati i Kordobës, pas pavarësisë të humbur tre vjet më parë, shkatërrohet përfundimisht.
- Hishamit III, halifit të fundit të halifatit emevit të Kordobës i humbet çdo gjurmë.
- 1033 - Taifa Mértola shpall pavarësinë.
- 1034 – Ushtria e mbretërisë Leon i thyen njësitë e sunduesit të Seviljes Ismail ibn Abbadi. Ismail ibn Abbadi shpëton duke ikur në Lisbonë.
- Fillimi i marrjes përfundimtare të territoreve portugeze nga ana e kristianëve europianë. Magnati relativisht anonim Gonsalvo Trastemires (Gonçalo Trastemires) e merr me sulm kështjellën Montemor me fjalën e Mondegos, me të cilin deri atëherë kanë sunduar muslimanët europianë.
- Gjatë tri dekadave vijuese (më saktë 28 vjet) mbreti i Leonëve, Ferdinandi I León, e pushton qytetin Coimbra (Coimbra), kurse me kërcënimin e armëve i detyron muslimanët e Toledos, Seviljes dhe Badahozës (Badajoz), që t'i paguajnë haraç. Para vdekjes edhe ai ia ndanë mbretërinë e tij tre djemve, Kastiljen e fiton Sanço II, Leoni i përket Alfonsit VI, ndërsa Galicia shkon në duar të Garsiut II.
- 1040 – Taifa e re muslimane në rajonin e Silvesës shpall pavarësinë.
- 1043 – Qytetet muslimane Saragoza dhe Toledo luftojnë për territore rreth qytetit Guadalahar. Toledoja nuk ka ushtri të mjaftueshme dhe paguan kristianët nga Nevara të

sulmojnë në territoret e Saragozës; po për këto shkaqe Toledoja paguan të njëjtët ushtarë kristianë nga Nevara ta sulmojnë Toledon. Muslimanët nuk i pengon gjë që të njëjtët kristianë t'i paguajnë për të sulmuar fqinjët e tyre muslimanë. Kristianëve nuk u pengon gjë që të pranojnë dyfish para për t'i sulmuar muslimanët, duke përfshirë edhe ata që tashmë i kanë paguar t'i sulmojnë muslimanët e tjerë e jo ata. Pasioni për pushtim shpesh ndodh ta përjashtojë jo vetëm mendjen, por edhe instinktin e mbijetimit.

- Në qytetin e Burgosit u lind Rodrigo Diaz Vivar, trimi i njohur i ardhshëm, të cilin muslimanët do ta quajnë *Nga-dhënjes në beteja*, kurse spanjollët do ta pranojnë dhe do ta përkthejnë atë si "El Cid Campeador".

- 1044 - Abadi III el-Mu'temidi, i biri i emirit abadit nga Sevilja, Abadit II el-Mu'tadidit, sërish e pushton Mértolin, i cili më parë ishte në përbërje të emiratit, kurse më 1033 kishte shpallur pavarësinë.

- 1051 - Jusuf ibn Hudi, i quajtur "Benu Hud", emiri i qytetit Sevilje, merr hua ushtrinë kristiane katalonase që ta mbrojë nga familja e tij vetjake prej Saragoze.

- Emiri i Seviljes përfshin në përbërje të territorit të tij edhe taifën Algarve.

- 1053 – Emiri i Seviljes Abadi III el-Mu'tadid fiton në betejën me njësitet e fuqishme berbere dhe i dëbon nga ata nga tërë territori, duke i marrë qytetet Arkos, Morón dhe Ronda.

- 1054 – Beteja te Atapuerka. Armata e Ferdinandit I mbretit të Kastiljes e mundi armatën e të vëllait, Garsías IV, mbretit të Navarës. Një numër i kalorësve të pakënaqur nga Nevara iu bashkuan para betejës kastiliane, kurse një prej tyre e vrau Garsian IV. Princi Sanço, i biri i Mbretit Garsiut IV gjatë rrjedhës së betejës shpallet për mbret dhe vazhdon

lufta e këtyre dy shteteve kristiane, të cilat i kanë qeverisur dy vëllezër.

- 1055 – Emiri i Seviljes Abadi III el-Mu'tadidi konfirmon aftësitë e tij luftarake me fitoren e re ndaj klanit ushtarak të berberëve dhe pushton qytetin Algesiras.
- 1056 – Në ndërkohë, në truallin e Afrikës veriore në skenën historike hyjnë dinastia e al-moravidëve (berberisht: el-Murabitun). Kjo dinasti e fuqishme berbere do të qeverisë me Afrikën veriore dhe Iberinë thujtë tërë shekullin vijues – deri në vitin 1147.
- 1057 - Emiri Abadi III el-Mu'tadidi nga qyteti Sevilje mbetet i pangadhënjeshëm pas fitores së shkëlqyer kundër ushtrisë së Almoravidëve, të cilën e dëbon nga qyteti paraprakisht e pushtuar Karmona.
- Mbreti i Kastiljes-Leonës merr qytetin Lamego nga muslimanët.
- 1058- Emiri el-Mudhaffer el-Aftas (emri i plotë: Abu Bekr Muhammad al-Mudaffar - Modafar I de Badajoz, Dinastia e Aftidëve) u paguan kristianëve një sasi të madhe parash që ta lëshojnë Badahosën (Badajoz), që mbreti i Kastiljes-Leonit, Ferdinandi I e pranon.
- 1060–1063 – Sinodi i Madh Ekumenik në qytetin Santiago de Kompostela.
- 1060 – Një degë e berberëve, të cilët nuk e kanë pranuar Islamin, të njohur si berberët Berghouata, themelojnë taifën e tyre në qytetin Seutë, në Marok, por pas luftërave të ashpra përfundimisht i dëbojnë forcat e Almoravidëve.
- Mbreti Ferdinandi I i mbretërisë së Kastiljes-Leonit u imponon taksën vjetore muslimanëve të Saragozës. Emiri i Saragozës el-Muktedir ibn Hudi thyen administrimin ushtarak, të cilin e kishin vendosur paraprakisht luftarakët

sllavë në qytetin Tortosa, dhe i dëbon duke e përfshirë Tortosën në përbërje të Saragosës.

- 1062 – Vazhdojnë sukseset e mbretit Ferdinandit I, kurse arka e tij nuk pushon së mbushuri. Pasi me armatën e tij të madhe e pushtoi Toledon muslimane, mbreti e detyroi emirin el-Me'munin ta pranonte detyrimin e pagesës së taksës vjetore Kastiljes. Ferdinandi I pastaj me të njëjtën armatë të tij të madhe u nis për vizitë miqësore në qytetet muslimane Badahosë dhe Sevilje, të cilat shfaqen të njëjtën gatishmëri që t'i paguajnë haraç mbretit të fuqishëm.

- 1063 – “Gjaku i keq” i parë ndërmjet europianëve pjesëtarë të dy feve të mëdha botërore. Mbreti i Aragonës, Ramiro I në pranverë me një ushtri të madhe e rrethon qytetin musliman Graus, në territorin e emiratit të Saragozës. Emiri nga Saragoza el-Muktediri me ushtrinë e tij u nis në ndihmë të muslimanëve të Grausit. Deri te beteja (Bataille de Graus) vjen para mureve të qytetit, më 8 maj 1063. Pas luftimeve të gjata e të vështira, armata aragonase u mund rëndë, kurse mbreti Ramiro I dhe shumë fisnikë e kalorës të shquar vdiqën në fushëbetejë. Që të hakmerrej për këtë humbje të kristianëve katolikë, dhe ta forconte ndikimin ndër katolikët në Europë e sidomos në Spanjë, Papa Aleksandri II tuboi një ushtri të madhe nga shumë vende dhe e dërgoi në Spanjë. Krahas aleatit të tij më besnik, Viljamit nga Montroja (William de Montreuil), këtij kontingjenti të madh i bashkohen mijëra kalorës nga Italia, udhëheqësit normanë, Robert Krespini dhe baroni i Normandisë, aristokratët francezë duka i Poatjesë dhe duka i Akuitaniaes (Conte de Poitiers i Duke de Aquitaine), si edhe një numër i madh fisnikësh me ushtrinë e tyre nga tërë Iberia kristiane. Në fillim të korrikut të vitit 1063 ushtria e madhe kris-

tiane hyri në territorin e emiratit të Leides dhe rrethoi qytetin Barbastro. Emiri i Leides, vëllai i emirit të Saragozës, el-Muktediri, fituesi ndaj armatës së mbretit Ramirit I në betejën e madhe te Grausi, nuk ka ushtarë të mjaftueshëm që t'u kundërvihet sulmuesve. Rrethimi i Leides zgjat 40 ditë. Qyteti mbetet pa ujë kur rrënimet e mureve e mbulojnë pusin e vetëm në qytet. Muslimanët e rrethuar dorëzohen duke iu dhënë fjala se do të kursehen. Krerët kristianë nuk e respektojnë fjalën e dhënë dhe me masakrën deri atëherë më të madhe, sipas burimeve kristiane, janë masakruar rreth 50.000 banorë të qytetit, ndërsa ata më të aftët dhe më të shëndoshët janë marrë si skllëvër. Konti Ermengoli II nga Urgeli u vendos guvernator i qytetit në emër të mbretit të Aragonës, Sanço Ramirezit. Qyteti musliman Sevilja, mjaftueshëm i fuqishëm që për një kohë të gjatë t'i bënte ballë rrethimit, pranon zgjidhjen e kompromisit: t'u paguajë haraç të madh sulmuesve në këmbim të heqjes dorë nga rrethimi. Masakrimi i muslimanëve në qytetin Barbastro, njëkohësisht masakra e parë e përmasave të tilla në luftërat e shumta të muslimanëve evropianë dhe kristianëve evropianë, prej atëherë do të mbetet simbol i keq i konfliktualitetit të tyre të papajtueshëm në truallin e gadishullit Iberik. Ndjenja e fajit për dhjetëra mijëra civilë të vrarë në Barbastra, do të shkallëzohet deri te imperativi që të gjithë muslimanët dhe të gjithë hebrenjtë (ndër banorët e masakruar të Barbastrës ka pasur edhe disa mijëra hebrenj) të dëbohen përgjithmonë dhe të largohen prej syve të fajtorëve. Mund të thuhet se masakra në Barbastra në vitin 1063 ka qenë motiv psikologjik i dëbimit të muslimanëve dhe hebrenjve në vitin 1492 dhe i dëbimit të mëvonshëm përfundimtar të pasardhësve të tyre dhun-

shëm të kristianizuar moriskosëve (muslimanëve) dhe maranosëve (hebrenjve) në vitin 1609.

- Taifa e Sevilyes bashkon në përbërjen e tij taifën e Silves.
- 1064 - Ferdinandi I mbreti i León-Castiljes merr qytetin musliman Koimbros pas plot gjashtë muaj rrethim (prej 20 janarit 1064 deri më 9 korrik 1064). Ende nën stresin e masakrës së paparë në qytetin Barbastro, kryengritësit këtë herë e respektuan kodin kalorësiak të luftës dhe fjalën e dhënë. Komandantëve muslimanë iu lejua ta lëshonin qytetin me familjet e tyre dhe me pasuritë e luajtshme, 5000 njerëz u mbajtën si skllëvër, kurse të gjithë muslimanët u dëbuan nga territori portugez përtej lumit kufitar Mondego.
- Gjenerali arab kristian Sisnando Davides, i cili kishte komanduar rrethimin e Koimbros, merr titullin e kontit të Koimbrës.
- Coimbra shkallë-shkallë shndërrohet në qytet krejtësisht kristian me rrënimin e të gjitha objekteve kulturore, të cilat i kishin ndërtuar muslimanët.
- 1065 – Lufta qytetare në shtetin Kastilja-León. Duke e shfrytëzuar dobësinë e kundërshtarëve të tij el-Muktediri nga Saragoza rrethon qytetin Barbastro të shkretuar dy vjet më parë, tash të populluar me kristianë. Në përpjekje që të shpëtojë duke ikur nga qyteti i rrethuar, u vra komandanti i qytetit dhe guvernatori i krahinës Urgel, Konti de Ermen-gol II, bashkë me përcjellësit. Qyteti bie disa ditë më vonë. Ushtarët e kapur të garnizonit iberik dhe francez u therën deri te i fundit në shenjë hakmarrjeje për masakrën e parë të madhe etnike dhe fetare, që ndaj banorëve të Barbastrës ishte bërë sipas urdhrit të papës Aleksandri II. Ndërkohë, shpërtheu konflikti ndërmjet aleatëve të deriatëhershëm, emirit el-Muktedirit dhe mbretit të Kastiljes, Ferdinandit I.

Mbreti e organizoi ushtrinë dhe mori qytetin Alkezar, pastaj rrethoi edhe Valencien. Edhe pse formalisht vasal i Kastiljes, emiri i Toledos el-Me'muni me ushtrinë i vjen në ndihmë dhëndrit të tij, emirit të Valencies, Abdulmelikut. Ushtria e bashkuar e muslimanëve të Toledos dhe Valencies arrin fitore kundër armatës kristiane të Kastiljes, kurse mbreti Ferdinandi I, i sëmurë rëndë, mezi shpëton kokën duke u arratisur në Leon. el-Me'muni e largon nga fronti dhëndrin e tij, Abdulmelikun dhe e përfshin Valencien në përbërje të mbretërisë së Toledos. Mbreti Ferdinandi I vdiq në qytetin León më 28 dhjetor të vitit 1065, duke ia lënë mbretërinë tre bijve të tij: Sancho II qeveris me Kastiljen; Alfonsi VI bëhet mbret i Leónit, kurse Garsia fiton Galicinë.

- 1066 – Hebraiku Joseph ibn Naghrela, i biri i vezirit hebraik Samuel ibn Naghrela Ha-Nagida, në pajtim me emirin e vjetër të Granadës, e fton emirin e Almerisë el-Mu'tasimin që të marrë sundimin në Granadë. Klani ushtarak berberian i Zirid Sanhasë, e pengoi planin me sulmin në Granadë duke kryer dhunë ndaj hebrenjve në qytet.
- Joseph ibn Naghrela dhe shumë hebrenj të tjerë të dalluar të Granadës u vranë nga dhuna e kryer mu në fund të këtij viti – më 20 dhjetor 1066, ndërsa shpëtuan vetëm ata që arritën të shmangen nga qyteti.
- 1067 – Mbreti i Kastiljes, Sanço II, me armatë të madhe e rrethoi emirin el-Muktedir në Saragozë. Ndër sulmuesit ishte edhe *Alferezi* (titull në rang gjenerali) Rodrigo Díaz de Vivar – tashmë i njohur si El-Sidi. Rrethimi u hoq vetëm pasi emiri el-Muktediri pagoi shpërblim të madh dhe premtoi se do të paguante taksën rregullisht. Ndërmjet tre mbretërve kristianë me të njëjtin emër Sanço, të cilët sun-

dojnë me shtetet Aragonë, Navara dhe Viana, shpërthen luftë e ndërsjellë e përgjakshme i të gjithëve kundër të gjithëve. Epilogu u shty, kurse lufta u ndërpre me sulmin e valiut të Saragozës dhe Hueskut, i cili me sulm të befasi-shëm pushtoi pjesët jugore të mbretërisë së Aragonit.

- 1068 - Alfonsi VI, mbreti i Leónit udhëheq ekspeditën kundër muslimanëve të Badahosës, por është detyruar që të tërhiqej, kur ndërhyri me ushtri emiri i Toledos, Me'mun ibn Dhinnun.

- Diç më vonë vdiq emiri i Badahosës, kurse në mesin e bijve të tij vjen deri te konflikti rreth marrjes së titullit dhe pozitës.

- 1069 - Koha e luftërave të brenda fetare dhe ndërfetare të europianëve. Mbreti kristian i Leonëve, Alfonsi VI merr Badahosën në fillim të vitit. Muslimanët e Seviljes e marrin Kordobën muslimane.

- 1071 – Beteja te vendi Pedroso, në të cilën mbreti kristian i Galicisë, Garsia II shuan kryengritjen e portugezëve të udhëhequr nga konti portugez Nuno Mendes, konti i fundit nga shtëpia e famshme bujare e Vímar Peresit. Në këtë betejë vdiq konti Nuno Mendes, kurse mbreti i Galicisë, Garsia II e shpall veten për mbret të Portugalisë. Këtë pozitë mbreti i ri Garsia II nuk e mbajti gjatë, sepse menjëherë më vonë (18 janar 1071) e robëroi vëllai i ij, mbreti i Galicisë, Sancho II (nuk është konfirmuar saktësisht se a është bërë gjatë vetë betejës në Santaremë, apo me mashtrim pas vetë betejës) dhe e lëshoi kundrejt një shpërblimi të madh vetëm në maj të po atij viti. Pas lëshimit ish mbreti Garsia II, e tash thjesht Garsia, shkoi në pallatin e vasalit të tij të dikurshëm, Abadit III el-Mu'temidit në Sevilje. Galicia u nda ndërmjet vëllezërve të tij, Sançës dhe Alfonsit.

- 1073 - Muslimanët dhe kristianët europianë bashkohen kundër muslimanëve europianë. Me fjalë të tjera, emiri i Granadës refuzon të paguajë taksën, të cilën ai kërkonte Kastilja kristiane, por emiri i Seviljes, Abbadi III el-Mu'temidi, vullnetarisht u ofrua dhe e pagoi këtë shumë në këmbim të aleancës ushtarake me Kastiljen me synim që bashkërisht ta sulmojnë emirin e Granadës. Rezultati i parë i kësaj aleance është ndërtimi i përbashkët i fortifikatës së fortë të Beliljos, me një garnizon të fortë ushtarak, i cili kryen sulme në territorin e Granadës.
- 1074 - I forcuar nga aleanca me Kastiljen, emiri i Seviljes, Abadi III el-Mu'temidi i dëbon Almoravidët (murabitët) nga qyteti i Haenës (Jaén).
- 1075 - Muslimanët e Toledos lidhin aleancë të fshehtë me Kastiljen kristiane (e cila është aleate publike e Seviljes muslimane) dhe me forca të përbashkëta e marrin Kordobën muslimane, e cila ishte në përbërje të Seviljes.
- 1076 - Emiri Ahmed el-Muktediri i dëbon njësitë e fundit të klanit ushtarak të sllavëve nga qyteti Denije. Ferdinandi I, mbreti i León-Kastiljes i sulmon muslimanët dhe i merr qytetet e Korijas dhe Badahosës. Pas vdekjes së emirit të Toledos, Sevilja shfrytëzon rastin dhe sërish e merr pushtetin në Kordobë, duke e përndjekur të birin e emirit, el-Kadir, i cili e vendos pushtetin e tij në Valencie.
- 1078 - Ibn Ammari formalisht e përfshin Mursinë në përbërje të Seviljes, por faktikisht vendos pushtetin e vet. Pas kësaj, Sevilja merr edhe Valencien, kurse emiri el-Kadir, më parë i dëbuar nga Toledami, detyrohet të ikë edhe nga Valencia, e cila bie në duar të emirit të Badahosës, el-Mutevekkilit, si mëkëmbës i emirit të Seviljes. Edhe pse dy vite më herët e kishin humbur Haenin, Almoravidët

morën Tangjerin në bregun afrikan të Gjibraltarit, ndërsa Seuta ende mbahej falë ndihmës, të cilën ia ofronte nga deti flota e berberëve, që arrin ta mbrojë këtë pikë rezistence të fundit të klanit të tyre ushtarak të Zanatit.

- 1079 - Beteja te Kabreja, në të cilin mbreti Rodrigo Dijazi i mundi forcat e përbashkëta të emirit të Granadës dhe kontit kastilian të Garsisë, Ordonjezit.

- 1079 - Beteja te Koriya. Mbreti i ri i Kastiljes së bashkuar dhe Leonës, Alfonsi VI thërret ushtrinë kundër emirit të Badahosës, el-Mutevekkilit, i cili në ndërkohë merr Toledon dhe e vendos për emir dy herë el-Kadirin e përndjekur.

- 1081 – Heroi më i lavdishëm kristian El-Sidi, pasi e përndoqi mbreti i Kastiljes Alfonsi VI, bëhet mercenar në shërbim të sunduesit musliman të Saragosës, el-Mu'teminit, dhe mbetet në pozitë të njëjtë edhe te trashëgimtari i tij, el-Mu'temini.

- 1082 – Beteja e re, në të cilën luftojnë forcat e përbashkëta të europianëve muslimanë dhe europianëve kristianë, kundër trupave të përbashkëta të europianëve muslimanë dhe europianëve kristianë, e njohur me emrin Beteja tek Almenari. Nën komandën ushtarake të Rodrigo Díaz de Vivarit, tashmë të njohur me emrin El-Sid, armata e emirit të Saragozës u shkakton humbje të rënda forcave të përbashkëta të el-Mundhirit, sunduesit të Valencias; el-Haib, sunduesit të Leides, Sança Ramirezit, mbretit të Aragonës; Berenguer Ramonit II, kontit nga Barcelonës, i cili edhe u zu rob, e shpërblimin për lirimin e tij e pagoi emiri el-Mu'temidi, emiri i Seviljes.

- 1083 – Forca e Almoravidëve rritet. Në qershor ushtria e tyre mori përfundimisht qytetin liman dhe fortifikatën e rëndësishme Seutën, vendi i rezistencës së fundit të klanit

ushtarak berber të Zanatit. Udhëheqësi i klanit, el-Muizz in Sukut u ekzekutua publikisht. Mbreti i Kastiljes, Alfonsi VI, mori Madridin.

- 1084 – Ushtria muslimane të emiratit të Saragosës, në radhët e së cilës lufton edhe heroi më i lavdishëm kristian, El-Sidi, e thyen rëndë armatën kristiane të Aragonës.
- 1085 – Armata kristiane e Alfonsit VI merr qytetin musliman Salamankën.
- Alfonsi VI, mbreti i Kastiljes, shpallet *mbret i të gjithë spanjollëve*, pas një rrethimit të gjatë merr qytetin musliman Toledo.
- 1086 – Një vit mjaft i trazuar. Disa europianë, emirë muslimanë, e ftojnë komandantin almoravidas Jusuf ibn Tashefinin⁸⁹, që t’ju ndihmojë në luftë kundër Alfonsit IV. Po atë vit, diç më herët, Jusuf ibn Tashefini e kaloi gjirin tek Algesira dhe e theu rëndë armatën kristiane në betejën legjendare të Az-Zalaka (Bataille de az-Zallaqah, në veri të qytetit Badahosa. Për shkak të betejës së madhe berbere në Afrikën veriore, Jusuf ibn Tashefini që detyruar personalisht të kthehej dhe t’u kundërvihej kryengritësve ashtu që nuk mundi t’i vilte frytet e kësaj fitoreje të madhe, as të pranonte thirrjen e muslimanëve europianë për ndihmë.
- Duke shpresuar në mungesën e gjatë, e mbase edhe humbjes së Jusuf ibn Tashefini, Alfonsi IV i fton sundue-

⁸⁹ Në çdo gjë i jashtëzakonshëm, Jusuf ibn Tashefini, i lindur në vitin 1005, erdhi në krye në almoravidëve në vitet e pjekurisë më 1061, kur tashmë i kishte 56 vjet, dhe sundoi deri në vitin 1106, pra edhe 46 vjet, ndërsa vdiq në vitin 102 të jetës. Është ruajtur e dhëna se para betejës në Al-Zalaka, Jusuf ibn Tashefini i ofroi mbretit Alfonsit IV të zgjidhte a dëshironte ta pranonte Islamin, ta paguante tak-sën apo të dorëzohej. Orvatjet e disa historiografëve që ta paraqesin se luftëtarët kristianë ishin në numër shumë më të vogël, e hedh poshtë vetë emri i vendit ku u zhvillua beteja, i cili zuri vend vetëm pas betejës: “ez-Zeleka” në gjuhën arabe do të thotë “truallin e rrëshqitshëm”, sepse pas betejës nuk mund të kalohej nëpër truallin e rrëshqitshëm, të mbuluar me gjakun e të vrrarëve.

sit e Europës kristiane që ta ndihmojnë në luftë kundër muslimanëve europianë. I pari arrin Rejmond Burgundi, i biri i Viliamit I, sunduesit të Burgundisë, me trupa të mëdha, shoqëruar prej disa dukëve nga Franca.

- Në pranverën e hershme, duke tubuar forca të mëdha ushatarke, kastiljanët nën udhëheqjen e mbretit Alfonsit VI, e sulmojnë qytetin musliman të Saragozës, por prej lajmit për zbarkimin e Jusuf ibn Tashefinit, i cili e shtypi shpejt rebelimin e berberëve, e ngritën rrethimin dhe u tërhoqën në panik. Në muajin qershor njësia prej 500 kalorësish almoravidas nën udhëheqjen e Jusuf ibn Tashefinit, e merr me lehtësi qytetin Algesira. Pak më vonë arrin në truallin spanjoll edhe pjesa kryesore e trupave almoravide prej 12-15 mijë ushtarësh. Për të futur përçarjen ndër muslimanët dhe të nxisë luftën e tyre të brendshme, mbreti Alfonsi VI e vendosi el-Kadirin për emir suprem të Valencias.

- Ushtria e almoravidëve, praktikisht pa rezistencë përparon në Iberi, nëpërmjet Granadës dhe Lusenës. Armata e mbretit Alfonsit VI vazhdimisht rritet. Përparimi i saj nga veriu i shtyn emirët e Granadës, Seviljes dhe Badahosës, të kërkojnë ndërhyrje urgjente të Jusuf ibn Tashefinit. E premtë, 23 tetor 1086 – dita e betejës deri atë atëherë më të madhe në truallin e Iberisë, e njohur si Beteja te Az-Zalaka (Bataille de az-Zallaqah). Armata muslimane prej 12-20.000 luftëtarësh, e përbërë prej luftëtarëve të Jusuf ibn Tashefinit dhe kalorësve muslimanë të Andaluzisë, nga emiratet muslimane të Seviljes, Granadës, Malagës dhe Badahosës, ngriti fushimin te vendi Sagrahasa (Sagrajas)⁹⁰, në

⁹⁰ Emërtimi arab „ez-zeleka“ është dhënë pas betejës, për shkak të rrëshqitshmërisë së tokës në fushëbetejë, të mbushur me gjakun e dhjetëra mijërave luftëtarëve të vvarë.

verilindje të Badahosës. Në anën e kundërt, nën komandën e Alfonsit VI, i cili diç më herët është dekoruar me titullin e Mbretit të të gjithë spanjollëve, armata kristiane pjesën kryesore të të cilëve e përbënin kalorësit e Kastiljes dhe Leonit, me trupat nga Aragona, Italia, Franca, si edhe me njësitë e fuqishme hebraike, numëron rreth 60-70.000 ushtarë me përvojë dhe të armatosur shkëlqyeshëm.⁹¹ Beteja, të cilën shumë libra shkollorë e theksojnë si luftë të udhëhequr në mënyrë të shkëlqyer strategjike dhe taktike, përfundon me fitoren e armatës muslimane tri deri tri herë e gjysmë më të dobët. Humbja e armatës kristiane nën komandën e mbretit Alfonsi VI është aq e tmerrshme, sa që humbjet e ushtrisë kristiane, sipas vlerësimeve të bashkohësve, arrijnë numrin prej më së paku 40.000 njerëzish, ndaj jo më shumë se 2.000 luftëtarëve muslimanë të vrarë. Përshkrimet e hollësishme të kësaj beteje konfirmojnë në tërësi vlerësimet më të larta të ekspertëve ushtarakë, të cilat i kanë dhënë për çdo veprim të komandantit, Jusuf ibn Tashefinit. Beteja përfundoi në muzg të asaj dite, kur luftëtarët muslimanë, pasi pjesa kryesore e ushtrisë muslimane që thyer plotësisht, goditën në vetë qendrën e saj dhe e zbrapsën Alfonsin VI me ushtarët e tij të zgjedhur me parzmore në një bregore. Duke e lënë pjesën kryesore të gardës së tij që të vdiste në mënyrë heroike (burimet nga ajo kohë pohojnë se përgjithësisht kanë shpëtuar gjithsej rreth 500 fisnikë), vetë mbreti Alfonsi VI e shfrytëzoi natën që me një grup fisnikësh të ikte nga përndjekësit dhe të gjente shpëtim në mbrojtjen e fortesës Toledo. Edhe pse el-Mu'temidi dhe udhëheqësit e tjerë europianë muslimanë

⁹¹ Sipas vlerësimeve kompetente, ka qenë kjo armata bindshëm më e madhe, të cilën sunduesit kristianë e kanë tubuar deri atëherë në truallin e Iberisë.

propozuan që ndjekja menjëherë të vazhdonte (si e cek një burim musliman “... ende dëgjohej kumbimi i patkonjve kur mbreti Alfonsi VI dhe kalorësit e fundit të mbijetuar u tretën në errësirën e natës”), në vend që t’i vriste dukët kristianë dhe ta kapnin vetë mbretin Alfonsin VI, Jusuf ibn Tashefini vendosi që ndjekja të ndërpritej me fjalët: ”Dita e kësaj beteje mbaroi.” Vetëm disa ditë pas betejës, u kthye sërish në truallin afrikan, sepse vdiq mëkëmbësi i tij në Marok, kurse shpërtheu rebelimi i berberëve, posa u dëgjua zëri se Jusuf ibn Tashefini ka shkuar të luftojë në Spanjë. Gjatë asaj ka lënë vetëm 3000 ushtarë të tij t’i mbronin kufijtë lindorë të Al-Andalusisë.

- 1087 – Pas humbjes së tmerrshme të Az-Zalaka, mbreti i dëshpëruar Alfonsi IV u detyrua ta gëlltiste krenarinë e tij dhe ta tërhiqte urdhrin e tij për përndjekjen e El-Sidit, duke e ftuar në pallatin e tij, si shpresën e fundit që t’i kundërvihej me sukses Jusuf ibn Tashefini.
- 1090 – Plot katër vjet më vonë Jusuf ibn Tashefini shkeli në truallin e Europës për herë të tretë. Me një mësyerje të shpejtë kthen mbretëritë e Granadës dhe Malagës në pronësi të muslimanëve europianë, që në shtator sërish të kthehet në Afrikë. Megjithatë, këtë herë e lë nipin e tij, Sir ibn Ebi Bekrin të vazhdojë me pushtimet. Për vetëm nëntë ditë (prej 30 prillit deri më 8 maj), sunduesi musliman el-Mutevekkili, emiri i Badahosës, i lejon trupave kristiane t’i marrin qytetet Santarem, Lisbonë dhe Sintrën, në këmbim për detyrimin e tyre që ta mbrojnë prej almoravidëve.
- Jusuf ibn Tashefini, sunduesi i almoravidëve, me një sulm të rrufeshëm e pushton Granadën.
- 1091 – Në fillim të vitit, luftëtarët e almoravidëve nën udhëheqjen e Muhammed ibn al-Hajjin me përvojë, nipit

të Jusuf ibn Tashefinit, pushtojnë Kordobën dhe tërë fu-shëgropën përgjatë lumit Guadalkivir. Këtu i pretë me ar-matën numerikisht superiore të kastilianëve kalorësi Alva Fanjez (Alva Fañez), njëri nga të mbijetuarit prej grupit, i cili me mbretin Alfonsin VI mezi shpëtoi kokën duke ikur natën pas katastrofës të Az-Zalaka, me ndihmën e ushtrisë të emirit të Seviljes el-Mutemidit, por edhe këtë herë pëson një humbje të frikshme. Në shtator, ushtrisë së almoravidëve nën komandën e Muhammed ibn Bekrit, i dorëzohet shpejt edhe Sevilja. Në po këtë kohë garnizoni i tretë i almoravidëve merr qytetet Aledo dhe Almeria, e vetëm pak më vonë komandanti el-Garur pushton qytetin Ronda, të cilin deri atëherë e sundonte er-Radi, i biri i emirit të Seviljes el-Mu'temid.

- Taifa Mértola pas luftës së rreptë u dorëzohet luftëtarëve fitimtarë të al-moravidëve.
- 1092 – Ushtria e Ibn Jahafës nga Valencia, e ndihmuar nga njësia e vogël e kalorësve al-moravidas, ngadhënjën mbi garnizonin e Kastiljes. Emiri el-Kadiri (al-Qadir) ekzekutohet publikisht. Ibn Jahafi e shpall veten për emir të ri dhe negocion edhe me El-Sidin, edhe me njësinë almoravidase që këtë pozitë edhe ta mbajë.
- Qyteti i Toledos bie para ushtrisë së rimëkëmbur të *Re-konkvistës* (Reconquista) dhe përfundimisht kalon nga duart e europianëve muslimanë në duart të europianëve kristianë. Fillojnë shenjat e para të terrorit të europianëve kristianë ndaj europianëve muslimanë në këtë qendër tradicionalisht multietnike dhe multifetare të tolerancës kulturore dhe politike.
- 1093 – Armata e almoravidëve, e udhëhequr nga Ebu Bekr ibn Ibrahim, e përgatit rrethimin e Valencias. Arma-

ta e almoravidëve në krye me Sir ibn Ebi Bekrin merr Badahosën nga el-Mutevekkili dhe kjo shënon fundin e *taifës* së Badahosës, por e merr nga duart e kristianëve edhe Lisbonën, të cilën ai tri vjet më parë ua kishte lënë kristianëve që ta mbronin nga al-moravidët.

- El-Sidi pranohet si sundues i Valencias dhe i rripit të madh përgjatë bregut të Mesdheut. Shteti i ri vetëm nominalisht e pranon pushtetin e mbretit Alfonsit VI, por është shtet plotësisht i pavarur. Ky qytet bëhet paradigmë e jetës së përbashkët të evropianëve në shtetin multietnik dhe multifetar, në të cilin të gjithë qytetarët janë të barabartë, sikurse edhe të gjitha fetë, ndërsa armatën e tij e përbëjnë edhe kristianët, edhe muslimanët, edhe hebrejtë.
- Al-moravidët nga Maroku e rrethojnë pa sukses Valencien. Forcat e përbashkëta të kristianëve, muslimanëve dhe hebrejve nën komandën e El-Sidit të pranuar barabar nga të tria bashkësitë, e përballojnë me sukses, kështu që ushtria e al-moravidëve heq dorë nga rrethimi pa kryer punë.
- 1095 – Ushtria almoravidase kthehet drejt Santaremës dhe e pushton.
- 1097 – Ushtria e bashkuar kristiane, muslimane dhe hebraike me El-Sidin në krye, fiton kundër një garnizoni të Almoravidëve, të cilin komandonte Ali ibn el-Haxhi në afërsi të Valencias.
- Kalorësia almoravidase nën komandën e Muhammed ibn el-Haxhit e mundi rëndë armatën e Kastiljes, të cilën e udhëheq mbreti Alfonsi IV, te vendi Konsuegra. Në betejë vdiq don Diego, i biri i El-Sidit, i cili luftonte në anën e mbretit Alfonsi IV.
- Ushtria almoravidase e udhëhequr nga i biri i Jusuf ibn Tashefinit, Muhammed ibn Aishe, u shkakton një humbje

të re kalorësve kastilianë nën komandën e Alva Fanjezit, për të cilin kjo ishte humbja e tretë e njëpasnjëshme, por edhe këtë herë e shpëton jetën me ikje. Almoravidët e pushtuan tërë rrethinën e Valencias.

- Jusuf ibn Tashefini, i cili mbushte 92 vjeç, fiton titullin *Sundues i Muslimanëve (Emiru'l-muslimin)*.

- 1099 – Luftëtarët e Almoravidëve fillojnë sulmin vendimtar mbi qytetin e Valencias dhe mbi mbrojtësit nën komandën e El-Sidit legjendar. Qysh në ditët e para të rrethimit, 10 korrik 1099, i qëlluar me shigjetë në zemër, në vitin e 56 të jetës vdiq *Alferez* Rodrigo Alvarez Diaz de Vivar, i njohur me emrin legjendar të El-Sidi Kampeador. Valencia dorëzohet. Al-moravidët i kursyen kryengritësit dhe qytetin me banorët e tij.

- 1102 – Pas disa trazirave, pasuesit e El-Sidit e braktisin Valencien me garanci për sigurinë e tyre. Premtimi u mbajtë, kurse pushteti musliman i al-moravidëve zgjerohet deri në Saragozë.

- Dhjetë vjet pas pushtimit të Toledos *Rekonkuista* e ndërpret tërësisht traditën e tolerancës kulturore dhe fetare. Xhamia kryesore u shndërrua në kishë qendrore, xhamitë e tjera u rrënuan, kurse popullsia muslimane u dëbua nga Toledoja.

- Pushteti i Valencias zgjerohet edhe më tej. Vetëm taifat e shtetit të Saragozës, Majorkës dhe Albarasinit e ruajnë pavarësinë formale.

- 1103 – Vëllai i Muhammed ibn el-Haxhit, administruesit almoravidas të Granadës, vdiq në betejën me armatën kastiliane në Talavere.

- 1105 – Në skenën historike dalin Almohadët (muvehhidët), të udhëhequr nga Ibn Tumerti. Si reagim ndaj episo-deve gjithnjë e më të ashpra të mostolerancës fetare, te një

pjesë e muslimanëve europianë shfaqet lëvizja puritaniste ekstremisht fanatike. Objektivi i parë i Almohadëve ishin të gjitha format e antropomorfizmit në artin figurativ. Trashëgimtari i Ibn Tumertit, Abd el-Mu'mini, u kthye pastaj edhe kundër kristianëve e hebrenjve, me përndjekje sidomos të ashpër të muslimanëve, të cilët nuk u pajtuan me një fanatizëm të tillë.

- 1106 – Komandanti i famshëm dhe i pamposhturi e sunduesi i Almoravidëve, Jusuf ibn Tashefini vdiq në moshën 102 vjeçare. I biri i tij, Aliu mori drejtimin e shtetit të Almoravidëve.

- 1108 – Në krye të Almoravidëve vjen Temim ibn Jusuf ibn Tashefini, i vëllai i Jusuf ibn Tashefini. Vëllai tjetër i Muhammed ibn Fatime-së, rrethoi fortifikatën Ukles (Uclés) në lindje të Toledos. E ndërtuar majë shkëmbinjsh të pjerrët, fortifikata e vogël i përballoi mjaft gjatë sulmet, derisa mbreti Alfonsi VI dërgoi armatën kristiane kastiliane me detyrë ta shpëtonte fortifikatën dhe ta thyente rrethimin musliman. Edhe këtë herë, ushtrinë kristiane e komandon po ai Alvar Fanjez (Alvar Fañez), po që tashmë e kishte shpëtuar kokën nga tri humbje të mëdha prej luftëtarëve muslimanë të Almoravidëve. Rezultati edhe i kësaj beteje nuk ndryshoi asgjë në traditën e deriatëhershme; armata kristiane e Kastiljes pësoi një humbje të thellë, Alvar Fanjezi sërisht mbeti gjallë, por vdiqën shumë fisnikë dhe aristokratë të dalluar të shtetit Kastilje–Leon, ndër të cilët edhe Sançoja, i biri i vetëm dhe trashëgimtari i Alfonsit VI, i lindur nga martesë me Zaiden, një princeshë muslimane. Pas betejës fitimtare, ushtria almoravidase u tërhoq, që gjatë natës të kthehej dhe me një sulm të papritur e pushtoi qytetin, në të cilin mbrojtësit tashmë festonin, duke menduar se tërheqja

ishte me të vërtetë fundi i rrethimit. Pas kësaj fitoreje të dyfishtë, kristianët e Kastiljes pa luftë ia dorëzojnë ushtrisë muslimane edhe dy qytete fqinje – Kuenkon dhe Hueton.

- Temim ibn Jusuf ibn Tashefini e merr edhe qytetin Talavera, në perëndim të Toledos. Pastaj i merr edhe territoret në veri dhe jug të Toledos, e cila mbetet e rrethuar nga të gjitha anët. Megjithatë, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të luftëtarëve, pas një muaj ditë rrethimi të gjatë, Temim ibn Jusuf ibn Tashefini heq dorë nga mësymja vendimtare.

- Ndërmjet 29 qershorit dhe 1 korrikut 1109, në moshën 69 vjeçare, vdes Alfonsi VI, *Victoriosissimo rege in Toletu, et in Hispania et Gallecia*, mbreti legjendar i Leonit dhe Kastiljes.

- 1110 – Emiri i Saragozës, el-Mustaini, udhëheq ekspeditën kundër qytetit Valtiere, por vdes në betejën e parë. I biri i tij, Imaduddini, nuk arriti ta përgatiste me kohë mbrojtjen e qytetit, kështu që një njësi e fuqishme ushtarake e Almoravidëve e pushton Saragozën më 30 maj të vitit 1110.

- 1111 – Ekspeditat fitimtare të Almoravidëve vazhdojnë: nën komandën e Sir ibn Ebi Bekrit depërtojnë deri në Lisbonë, e pastaj në po këtë sulm, pushtojnë Lisbonën dhe Santaremin dhe aty vendosi kufirin me Portugalinë.

- 1112 – Ushtria e Almoravidëve me Ibn el-Haxhin në krye, pushton një pjesë të madhe të territorit të Aragonës dhe depërton deri në shpatet jugore të Pirinejeve.

- 1114 – Ushtritë e bashkuara almoravidase të Al-Haxhit nga Saragoza dhe të Ibn Aishes nga Valencia, thyen ushtrinë katalonase dhe pushtuan disa qytete. Në kthim bien në një pritë në të cilën vdesin të dy komandantët almoravidas. Flota katalonase nën udhëheqjen e Ramon Berengarit III e shfrytëzon vdekjen e emirit të Majorkës, Mubeshshir ibn Sulejmanit dhe merr Ujdhesat Baleare.

- Taifa-shteti i Bejas dhe Évoras shpall pavarësinë.
- 1115 – Sunduesi i ri i Saragozës almoravidase, Ebu Bekr ibn Ibrahim ibn Tifivit, e rrethon 20 ditë Barcelonën. Rrethimi u ndërpre, kur në ndihmë të të rrethuarve arriti armata e madhe e Ramon Berengarit III, i cili pikërisht që kthyer nga ekspedita e suksesshme në Majorkë. Ekspedita almoravidase e shfrytëzon mungesën e tij dhe sërish i kthen Ujdhesat Baleare paraprkasht të pushtuara. Viti i humbjeve personale të almoravidasve. Në betejën kundër ushtrisë së madhe kastiliane, vdiqën Mazdali ibn Tilankan, zotëria i Granadës dhe i biri i tij, Muhammedi, sunduesi i Kordobës.
- 1117 – Ekspedita e emirit të almoravidëve, Ali ibn Jusufit e merrë Koimbron, por është e detyruar ta lëshojë pas disa ditëve për shkak të sulmit të kristianëve mbi Granadën.
- 1118 – Mbreti i Aragonit, Alfonsi I, me një ushtri të madhe merr Saragozën. Rrethimi zgjat plot tetë muaj, nga 22 maji 1118 deri më 18 dhjetor të të njëjtit vit. Mbrojtja epike e muslimanëve la përshtypje të madhe edhe te sulmuesit kristianë. Guvernatori i Valencies dërgoi më tre dhjetor një njësi të vogël në ndihmë të qytetit të rrethuar, por ata me sulmet e tyre heroike mbi kundërshtarin shumëfish më të madh, e shtynë vetëm për një kohë rënien e qytetit. Në duart e muslimanëve, në këtë pjesë të Gadishullit Iberik, mbetet vetëm qyteti Leida.
- 1120 – Fitorja e armatës së mbretit të Aragonës, Alfonsit I në betejën te Kutande, ndaj një njësie më të madhe të ushtrisë almoravidase dhe vullnetarëve kastilianë.
- 1121 – Qyteti i Kordobës bën një kryengritje të madhe kundër almoravidëve. Komandanti i qytetit dhe trupat e tij u dëbuan. Nga Afrika arrin emiri Ali ibn Jusuf ibn Tashefini. Qytetarët e Kordobës e pranojnë ofertën që ta dorëzoj-

në qytetin pa luftë në duart e almoravidasve, që të shmanget gjakderdhja.

- 1125 – Mbreti Alfonsi I aragonas, në shtator ndërmerr një ekspeditë të madhe në bregun lindor të Iberisë, por nuk arriti të merrte asnjë qytet, edhe pse e shkretoi tërë territorin. Në dhjetor kthehet i sigurt në Kadiks (Guadix), pa një konflikt më të madh.

Dobësimi i muslimanëve europianë dhe rënia e shkallëshkallshme nën sundimin kristian (1130–1481)

- 1130 – Edhe pse i dobësuar ndjeshëm, Tashefin ibn Ali ibn Jusuf (i biri i emirit almoravidas) merr me sulm kështjellën Akesa (Aceca), në jug të Toledos. Administruesi i Valencies në krye të ushtrisë muslimane almoravidase i shkakton humbje armatës së Aragonës. Në betejë vdiq Gastoni IV nga Béarni, i cili ka luftuar në anën e aragonasëve.

- 1133 – Një grup i ushtarëve kristianë nga Toledoja, të maskuar si tregtarë muslimanë, hyjnë në qytetin musliman të Seviljes. Pasi e vranë mizorisht administruesin almoravidas të qytetit Ebu Hafs Umer ibn Ali ibn el-Haxhi, vazhdojnë me vrasjen e qytetarëve dhe tentojnë ta djegin qytetin. Ndërhyrja e shpejtë e kalorësve me Tashefin ibn Ali ibn Jusufin me krye, e shpëton qytetin. Të gjithë sulmuesit u vranë.

- 1134 – Ushtria almoravidase nën udhëheqjen e Tashefin ibn Ali ibn Jusufit, ndërmerr një ekspeditë të suksesshme ndëshkuese në rrethina të Toledos, deri te territori i Kaseresit (Caceres).

- Mbreti i Aragonisë, Alfonsi I, rrethon qytezën muslimane Fraga. Ushtria almoravidase nën udhëheqjen e komandantit Jahja ibn Ali ibn Ganije, i vjen në ndihmë dhe e

thyen plotësisht ushtrinë e sulmuesit. Në përpjekje të ikë në Leida, u shkatërrua edhe skuadroni i shpurës së mbretit, kurse vetë mbreti i Aragonës, Alfonsi I, i plagosur rëndë, vdiq dy ditë më vonë.

- 1135 – Lindi Rabbi Moses Ben Maimoni (filozofi i njohur edhe si "Rambam", respektivisht, Moses Maimonides).
- 1136 – Ushtria almoravidase me komandantët në krye Jahja ibn Ali ibn Ganijen dhe Sa'd ibn Mardanishin, e kthen një pjesë të madhe të territorit në duar të muslimanëve me fitoret kundër ushtrisë kristiane të Mekvინenca (Mequinenza) dhe të lumi Ebro.
- 1137 – Ushtria e Tashefin ibn Ali ibn Jusufit i mundi rëndë kastilianët të vendi Alkazar de San Huan (Alcazar de San Juan) dhe e rrënoi kështjellën e Eskalonit në veri të Tagusit.
- Mbreti i Portugalisë Alfonsi I rrethon pa sukses Lisbonën, që pas humbjeve të mëdha të kthehet në shtëpi i humbur.
- 1139 – Beteja të Urike (Bataille de Ourique) ndërmjet portugezëve të udhëhequr nga mbreti Alfonsi I dhe almoravidëve të cilët i udhëhiqte Ali ibn Jusufi, përfundon me fitoren e almoravidëve.
- 1140 – Është shkruar poema *Mio Cid*.
- Mbreti i Portugalisë Alfonsi I me një ushtri të madhe sërish tenton të pushtojë Lisbonën nga duart e muslimanëve të almoravidëve, dhe sërish mundet.
- 1144 – Kryengritja e *Muridunëve* (Muridun - "nxënësit"), të cilët i udhëheq Ebul-Kasi (Muridun Ebu'l-Kasim Ahmed ibn el-Husejn el-Kasi), renegat nga Algarva. Dy pasardhës të Ibnu'l-Mundhirit, dhe administruesi i qytetit të Behës (Beja), Sidraj ibn Veziri, më 12 gusht, duke mashtruar e pushtuar kështjellën e Monhikës, vranë ushtarët e garnizonit, sikurse edhe të gjithë 70 ushtarët në kështjellën

Mertola. Disa ditë më vonë edhe administruesi i Andaluzisë, Jusuf ibn Ahmed el-Bitruxi, shpallet si *Muridun*. Vetëm me ardhjen e njësive almoravide me Jahja ibn Ali ibn Ganijen në krye u thyen *muridunët* nga Sevilja, ndërsa Sidraj ibn Veziri u nda nga *muridunët* e tjerë.

- 1145 – Grusht shteti në Kordobë. U ndërrua Emiri i Kordobës, Almoravid, kurse në vendin e tij u vendos Hamd ibn Muhammed ibn Hamdini si emir i ri. Pas disa ndryshimeve, para fundit të po atij viti për emir i Kordobës u vendos Ibn Lijadi.
- Shteti-taifa e Badahosës sërisht shpall pavarësinë dhe përfshin në përbërjen e saj Mertolën.
- 1146 - el-Mustansiri e pranon titullin e sunduesit të Valencias dhe Mursisë, të cilin ia jep Ibn Lijadi. Një muaj ditë më vonë, në betejën te Albasete kundër ushtrisë së Kastiljes, vdes el-Mustansiri. Ibn Lijadi sërisht merr titullin e emirit. Në rrethana të pasqaruara, po atë vit vdes edhe vetë Ibn Lijadi, kështu që titullin e emirit e merr Muhammed ibn Sa'd ibn Mardanishi.
- Shteti-taifa e Mértolës, shpall pavarësinë nga Badahosa.
- 1147 - Alfonsi VII nga Kastilja merr Calatravën.
- Flota e madhe e kristianëve i bashkohet mbretit Alfonsi I dhe rrethimit të Lisbonës muslimane. Pas shtatë muajsh luftërash të ashpra, Lisbona bie në duart e kristianëve. Thujse të gjithë muslimanët u vranë në masakrat e mëdha, kurse qyteti u shkretua nga kristianët.
- Qytetet muslimane Almada dhe Palmela, në afërsi të Lisbonës, bien para sulmeve të portugezëve.
- 1148 – Forcat almohade të muslimanëve e kthejnë Seviljën në duar të muslimanëve.
- 1149 – Aragonasit marrin qytetet Leidën dhe Fragën.

- Dinastia e re berbere e almohadëve, e udhëhequr nga emiri Abdulmu'min el-Kumi, e pushton pjesën më të madhe të Afrikës veriore dhe shpejt pastaj kalojnë në pushtimin e territoreve në Gadishullin Iberik.
- 1150 – Almohadët përparojnë. Në sulmin e parë u pushtuan territoret e shteteve-taifave Badahosa dhe Évora.
- 1151 – Muslimanët almohadë i marrin territoret e dinastisë muslimane të almoravidëve, e cila shkallë-shkallë zhduket nga skena historike, me pushtimin e shtetit me rëndësi në aspektin strategjik të Almerisë.
- Mbreti kristian i Portugalisë, Alfonsi I u mund nga muslimanët te qyteti Alcácer do Sal.
- Shteti-taifa Mértola u pushtua nga ushtria e Almohadëve.
- 1155 – Në fushatën fitimtare, Almohadët pushtojnë Granadën nga Almoravidët.
- Shteti-taifa fortë i konsoliduar i Silves, u dorëzohet Almohadëve.
- 1157 – Almohadët u shkaktojnë humbje të rëndë gjenovianëve dhe pushtojnë tërë territorin e Almerisë.
- 1158 – Me forcat e rimëkëmbura mbreti i Portugalisë Alfonsi I, sërisht merr Alcácer do Sal, të humbur shtatë vjet më parë.
- 1159 – Qytetet Évora dhe Beha, të pushtuara nga muslimanët nëntë vjet më parë, sërisht merren nga portugezët me mbretin Alfonsin I në krye.
- 1160 – Filozofi hebraik, Rabbi Maimonidesi dhe familja e tij largohen nga përndjekjet, të cilat armata kristiane i bënte ndaj hebrenjve dhe gjen shpëtim në qytetin musliman Fes, në Marok.
- 1161 – Qytetet e Évorës, Behasë dhe Alcácer do Sal, me një sulm të ashpër sërisht kthehen në duar të muslimanëve.

- 1162 – Mbreti i Portugalisë, Afonsi I, sërish pushton qytetin Beha (Beja).
- 1163 – Vdes halifi almohadas Abdulmu'min el-Kumi; vendin e tij e zë Ebu Ja'kub Jusufi I.
- 1169 – Mbreti i Portugalisë, Alfonsi I, ua lejon fisnikëve tempullarë të tretën e plaçkës nga muslimanët pas pushtimit të shtetit-taifës së Alentehos. Në betejën e Badahosës, mbreti i Portugalisë, Alfonsi I, u rrëzua nga kali dhe u plagos, pastaj e kapi rob mbreti i Leonës dhe Kastiljes, Ferdinandi II. Për pagën e lirimit të tij u desh të ktheheshin thujtë të gjitha territoret të cilat i kishte pushtuar në Galici, sikur edhe vetë Badahosa.
- 1170 – Për kryeqytet të tyre Almohadët e caktojnë Seviljen.
- 1171 – Filloi ndërtimi i Alkazarit – pallatit të njohur dhe kryeveprës së arkitekturës europiane muslimane të Almohadëve.
- 1172 – Almohadët sërish e kthejnë në duart e tyre Murzinë e menjëherë pastaj edhe Valencien.
- 1190 – Mozes Maimonidesi ka shkruar dy veprat e tij kryesore filozofike, të cilat do të bëhen përcaktimet themelore të filozofisë mesjetare hebraike: *Udhëzime për të hutuarit (Moreh Nebukhim)*; *Trembëdhjetë qëndrime për fenë (Shloshah-Asar Ikkarim)*.
- 1195 - Beteja te Alarkosi në të cilën Almohadët korrin fitore ndaj kastilianëve dhe e kthejnë këtë territor në zotërim.
- 1203 - Flota e Almohadëve merr Majorkën nga Almoravidët.
- 1205 – Vdiq Mozes Maimonidesi në Egjipt.
- 1212 – Beteja te Toloza (Battaille de Las Navas de Tolosa), në të cilën armatat e bashkuara të mbretit të Kastiljes, Alfonsi VIII, mbretit të Navarës, Sança VII, mbretit të Ara-

gonës, Pedros II, mbretit të Portugalisë, Alfonsit II, krahas trupave të tubuara nga mbretëritë dhe principatat e Europës Perëndimore, si edhe dukëve nga radhët e tempullarëve, hospitalierëve, Santiagos dhe Kavatravës – deri atëherë armata më e madhe e parë në historinë e Iberisë, e përbërë prej 100.000 këmbësorësh dhe 10.000 kalorësish me mburoja, e thyen ushtrinë katërfish më të dobët të Almohadëve, të cilën e udhëhiqte halifi Muhammed en-Nasiri. Koha e Jusuf ibn Tashefinit nuk mund të kthehej më.

- Pas kësaj humbjeje fillon shkatërrimi i Almohadëve, si në Spanjë ashtu edhe në truall të Afrikës.
- 1213 - Ebu Ja'kub Jusufi II zgjidhet halif i ri i Almohadëve.
- 1217-1252 – Periudha e dobësimit të shpejtë të shtetit të muslimanëve europianë në Gadishullin Iberik. Mbreti i Kastiljes dhe Leonës, Fernandi III, në 35 vitet vijuese i merr me radhë Kordobën, Mursinë, Haen dhe Seviljën. Granada mbetet mbretëria e vetme e pavarur e muslimanëve europianë.
- 1247 – Kryengritja e madhe e muslimanëve të Valencias, të udhëhequr nga Al-Azraqu, kundër sundesve kristianë, të cilët kryenin dëbimin sistematik të muslimanëve.
- Kryengritësit muslimanë nga Valensia vendosin territorin e tyre të lirë, në të cilin marrin tetë kështjella në fushëgropën e Alkalës. Shpejt pushtojnë edhe disa kështjella dhe bëjnë luftë të suksesshme guerile.
- 1248 – Pas plot 16 muajsh rrethimi, armata e madhe kristiane e forcave të bashkuara, të udhëhequra nga mbreti i Kastiljes, Ferdinandi III, pushton qytetin musliman Seviljen. Pashojnë përndjekjet e mëdha të popullsisë civile muslimane.
- Në ditën e 4 dhjetorit të po atij viti, mbreti Alfonsi X pushton Alikanten dhe ia bashkuan Kastiljes.

- 1249 – Viti në të cilin mbreti i Portugalisë, Alfonsi III, e merr fortifikatën e fundit të muslimanëve europianë në truallin e Portugalisë, me çka është përfunduar Rekonkuishta portugeze.
- Muslimanët e riorganizuar të Granadës e përballojnë me sukses ofensivën e madhe të mbretit të Aragonisë, Diego I, duke i shkaktuar humbje të rënda.
- 1252-1284 – Gjatë 32 viteve pasuese mbreti Alfonsi X i Urtë, ndërmerri një varg pushtimesh të suksesshme të territoreve të muslimanëve europianë. Suksesi i plotë ia pamundëson kryengritja e madhe e muslimanëve të Andaluzisë dhe Murcisë. Me leje të papës, mbreti Alfonsi X i Urti, në vitin 1257 shpallet *Perandor i Perandorisë së Shenjtë Romake*. Skicon *Kartën e njohur de las Lejes*, në bazë të të cilës më vonë do të bëhen ndarja e Iberisë në gjashtë pjesë (*Siete Partidas*).
- 1256 – Përtërihen sulmet e kristianëve aragonas kundër muslimanëve nga territoret e lira të Valencisë.
- 1258 – Mbreti i Aragonit, Diego I, pushton kështjellën kryesore të Al-Azrakas, pas së cilës kryengritja e muslimanëve të Valencisë, pas praktikisht 11 vjet liri u shtyp. Grupe më të vogla muslimanësh edhe disa vjet vazhdojnë me luftë guerile.
- 1266 – Forcat kristiane në mënyrë të përhershme i pushtojnë qytetet muslimane Lorka, Mursia, Purhena dhe Segura.
- 1276 – Kryengritje e re e muslimanëve në Valencie.
- 1309 – Mbreti i Kastiljes, Ferdinandi IV sulmon Gjibraltarin.
- Forcat kristiane të Rekonkuistës pushtojnë qytetin musliman të Algesiras.
- 1310 – Ushtria e Kastiljes pushton Gjibraltarin.
- 1312-1350 – Mbreti i Kastiljes kristiane, Alfonsi XI, fillon luftën e gjatë kundër Granadës muslimane.

- 1319 – Fitorja e madhe e muslimanëve të Granadës mbi kristianët e Kastiljes të udhëhequra nga mbreti Alfonsi XI; u ndërpre në sulmet e mëtejme të Kastiljes për disa vite me radhë.
- 1324 – Armata e Katalonjës pushton Sardenjën muslimane. Pason njëra prej gjakderdhjeve më të mëdha mbi popullsinë civile, në të cilin nuk u la i gjallë asnjë musliman në gadishull.
- 1325 – Mbreti Alfons me një numër të madh aleatësh dhe me një ushtri të madhe e sulmon Granadën që të hakmerret për humbjen e vitit 1319. Ushtria shumëfish më e vogël e muslimanëve të Granadës me emirin Muhammedin IV në krye, korri fitore në fushëbetejë, por për shkak të epërsisë numerike të shumëfishtë të kundërshtarit, nuk ndërmori sulmin vendimtar. Mbreti Alfonsi XI tërhiqet i sigurt, i vendosur fort të tubojë ushtri të re për luftë kundër Granadës.
- 1333 – E trimëruar edhe me fitoren e dytë të madhe, ushtria muslimane e Granadës e merr Gjibraltarin nga kastilianët.
- 1340 – Tetë vjet pas humbjes së dytë të madhe nga muslimanët të Granadës, mbreti i Kastiljes Alfonsi XI, i ndihmuar nga armata e mbretit të Portugalisë Alfonsit IV, dhe nga shumë mbretëri dhe principata të tjera të vogla nga pjesët e tjera të Europës, përfundimisht korr fitore mbi ushtrinë muslimane të Granadës në betejën në lumin Salado. Fitorja megjithatë nuk ka peshë të mjaftueshme ta rrezikojë mbijetimin e Granadës, kështu që ekspedita ushtarake ndërpritet. Në shtatëdhjetë vitet vijuese shteti evropian musliman i Granadës është relativisht i sigurt. Në dy aksione më të vogla ushtarake Granada madje i kthen disa qyte të humbura më parë.
- 1410 – Pas disa dekadave të rrethimit rraskapitës dhe presioneve ekonomike mbi muslimanët e Granadës, mbre-

ti i Aragonës, Ferdinandi, ndërmorri një sulm të ri mbi Granadën me forca të mëdha të kristianëve të bashkuar të Europës. Granada e përballon me sukses, por është humbur qyteti i fortë i Antekuerës. Ky sukses konsiderohet fitorja më e madhe e kristianëve ndaj muslimanëve të Granadës, prej fillimit të luftës kundër Granadës nga viti 1312, e cila, me ndërprerje, ka zgjatur thuajse tërë një shekull.

- 1415 – Armata e mbretërisë së Portugalisë merr qytetin musliman Seuta në truallin e Afrikës, brenda mbretërisë së Marokut.
- 1462 – Pas 129 vjet, armata kristiane e Kastiljes sërisht merr Gjibraltarin musliman.

Rënia e Granadës, shtetit të fundit evropian musliman në Gadishullin Iberik (1481–1491)

- 26 Dhjetor 1481 – Një nga fitoret e fundit të muslimanëve të Granadës kundër ushtrisë kristiane të Iberisë. Një njësi më e madhe nën komandën e emirit Ebu'l-Hasan Aliut, korri fitore në ndeshjen me ushtrinë kastiliane dhe e pushtoi qytetin Zahara.
- 1482 – Me kurorëzimin e mëhershëm të mbretit të Aragonës, Ferdinandit II dhe mbretëreshës Izabela I, sundueses së Kastiljes, arrihet të aleanca e këtyre dy shteteve më të fuqishme kristiane në Gadishullin Iberik. Armatat e bashkuara të Kastiljes dhe Aragonës, tubohen më 25 shkurt të qyteti Marçena. Në krye gjendet heroi i lavdishëm Rodrigo Ponce de Leon. Ditëve vijuese i kalojnë malet Alzerifa, dhe në sulmet befasuese të natës me furtunë më 28 shkurt e pushtojnë qytetin strategjik vendimtar të Alhamës (arabisht *el-Hammam*, burimet termale minerale mbi të cilët musli-

manët kanë ndërtuar hamame madhështore dhe të shumta). Ebu'l-Hasani tenton ta vërë qytetin në rrethim, të cilin e fillon me 5 mars. Mbreti Ferdinandi u dërgon përforcime ushtarëve të rrethuar, por luftëtarët e Ebu'l-Hasanit me përpjekje të fundit e dëbojnë. Armata e riorganizuar, e përforcuar me regjimente të reja arrin më 30 prill deri te muret e Alhamës. Përfundimisht, më 14 maj, luftëtarët muslimanë ia dorëzojnë edhe formalisht Alhamën mbretit Ferdinandit II.

- Rrethimi i qytetit Loha (Loja). Pas pushtimit të Alhamës mbreti Ferdinandi II, më 1 korrik të po atij viti rrethon qytetin Loha, i cili i përkiste Granadës. Përkundër epërsisë numerike të shumëfishtë të ushtrisë kristiane, qyteti lufton heroikisht, kurse komandanti Ibrahim Ali el-Attari, me një sulm të guximshëm, e thyen plotësisht rrethimin, kështu që mbreti Ferdinandi II u detyrua që të tërhiqej në kryeqendrën e tij, në Kordobë.

- 1483 – Mossuksesi te qyteti Loha, me një kthesë të çuditshme është treguar vendimtar për rënien përfundimtare të Granadës. Vëllai i Ebu'l-Hasanit, ez-Zagali (az-Zaghall), i cili pati nderin t'i korrite disa fitore të fundit të muslimanëve europianë kundër kristianëve europianë, fiton edhe në betejën te Malaga, duke e mundur thellë armatën e Kastiljes. Ndërkaq, më 14 maj të vitit të mëparshëm, po atë ditë kur ra Alhama, u rebelua i biri i Ebu'l-Hasanit, Boabdili, dhe u shpall emiri Muhammedi XII. Në betejën e tij të parë kundër kristianëve te vendi Aksarkia (Axarquia), Boabdilin - alias *Muhammedin XI e zënë rob* kastilianët - duke u bërë sunduesi i parë musliman i robëruar nga kristianët në truallin e Gadishullit Iberik! Edhe pse mbreti Ferdinandi II dhe mbretëresha Izabela I para kësaj nuk kishin për synim ta pushtonin tërë Granadën, duke e konsideruar edhe më

tej si kundërshtar të fortë, robërimi i Boabdilës i ndryshoi synimet e tyre. Në letrën Izabelës I, mbreti Ferdinandi II shkruan: "... Që ta fitojmë Granadën dhe përfundimisht ta shkatërrojmë, kemi vendosur ta lirojmë Boabdilën Ai (Boabdili), *Muhammedi XII* na ka premtuar fort se do të luftojë kundër babait të tij." Dhe vërtet, vazhdoi në Kordobë lufta qytetare, gjatë së cilës Boabdili merr ndihmë të rëndësishme nga mbreti Ferdinandi II dhe mbretëresha Izabela I. Prandaj, një kronist musliman, bashkëkohës dhe dëshmitar i këtyre ngjarjeve, ka shkruar se *robërimi i Boabdilit ka qenë shkak i mirëfilltë i shkatërrimit të atdheut tonë, Granadës.*

- 1484 – Armatat e bashkuara të Kastiljes dhe Aragonës, të udhëhequra nga mbreti Ferdinandi II, me ndihmën e Boabdilit dhe pasardhësve të tij, në pranverë ndërmarrin ofensivë të madhe kundër Kordobës. Pasi i kanë shkatërruar qytetet Álora, Koín, Kazabonela, Almahia, Kartama, Pupiana, Alhendrina dhe Senetili dhe kanë kallur fushat e pëllëshme të Granadës, kthehen në Kordobë.

- 1485 – I ndihmuar prej aleatëve kristianë, Boabdili (Muhammedi XII) vendosi që vetë të nisej në sulm, por xhaxhai i tij (vëllai i babait të tij, Ebu'l-Hasanit) e mundi thellë tek Almeria, prandaj kërkoi shpëtim (dhe e gjeti) duke ikur në Kordobë te aleati i tij, mbreti Ferdinandi II. Në ekspeditën e re Ferdinandi II rrethoi Koinin dhe Kartamin, të cilat i kishte shkatërruar një vit më parë, i vendosur tash t'i fuste në dorë. Ndërsa ez-Zagali tubon në shpejtësi ushtrinë që t'u ndihmojë qyteteve të tij, Koina bie më 27 prill, kurse Kartama më 28 prill. I dëshpëruar nga tradhtia e të birit, emiri Ebu'l-Hasani dobësohet shpejt dhe kah fundi i muajit vdes. Pushtetin e mori vëllai i tij, ez-Zagali; në fillim të qershorit ez-Zagali i shkaktonte humbje të thellë së pari një njësie të

fortë ushtarake të kastilianëve, kurse menjëherë pastaj e shkatërron edhe tjetrën, e cila kishte nxituar në ndihmë. Në shtator ez-Zagali korri edhe dy fitore të shkëlqyeshme kundër ushtrisë kristiane dhe sërish e pushtoi Moklinin. Duke iu shmangur konfliktit të drejtpërdrejtë me ez-Zagalin, ushtria kristiane i merr kështjellat e pambrojtura të Albaharit dhe Zaleas, në rajonin larg luftëtarëve të ez-Zagalit.

- 1487 – Luftëtarët e fundit të ushtrisë së vogël muslimane vdesin duke e mbrojtur deri në fund qytetin Malaga, e cila kështu kaloi në duar të Rekonkuistës.

- 1489 – Me respekt dhe me të drejtë ta mbajnë tërë pasurinë personale, kuajtë dhe armatimin, u dorëzuan luftëtarët e fundit me ez-Zagalin në krye. Krahas së drejtës së ruajtur për lëvizje të lirë, disa prej tyre u kthyen në Granadë, kurse vetë ez-Zagali me një grup të vogël të miqve luftëtarë shkoi në qytetin Fes në Marok, ku dy vite më pas u zgjodh sundues i këtij qyteti të pasur dhe të zhvilluar musliman në Marok, në të cilin, në atë kohë tashmë pesëqind vjetësh ekzistonte edhe universiteti i parë në botë në historinë e arsimimit botëror. Qyteti musliman Kadisi (Gua-dix), bjen në duar të kristianëve.

- 1491 – Muslimanët europianë e dorëzuan Granadën, qytetin e tyre të parafundit në Iberi, në duar të kristianëve europianë. Ky rol i takoi Boabdilit, alias Ebu ‘Abdullah Muhammedit, emirit të fundit të Granadës, po atë të cilin kronistët e kohës së tij dhe bashkëqytetarët, me arsye apo pa të, e kanë konsideruar fajtorin kryesor për këtë shkatërrim të shpejtë. Dorëzimi u rregullua me nënshkrimin e Kontratës për Granadën.

Sthurja dhe fundi i tolerancës kulturore në Gadishullin Iberik (1492–1616)

- 2 janar 1492 – Çifti martesor, mbreti i Aragonës, Ferdinandi II dhe mbretëresha e Kastiljes Izabela I, marrin Granadën muslimane shumëkulturore, shumetnike dhe shumëfetare dhe e shndërrojnë në territor monokulturore, monoetnik dhe përjashtimisht katolik.
- 1492-1507 – Programi i abrogimit total të të gjitha formave të tolerancës kulturore dhe fetare, fillon me Dekretin për dëbimin e të gjithë muslimanëve dhe hebrenjve, sikurse edhe i arabëve dhe berberëve, nga Gadishulli Iberik. Ata pjesëtarë të këtyre kategorive, të cilët dëshirojnë të mbesin, duhet të kalojnë në katolicizëm. Muslimanëve dhe hebrenjve, qytetarë të qyteteve Abarán, Ulea, Ejes, Rikote iu dha urdhri që me forcë të hiqnin dorë nga feja e tyre dhe të kryqoheshin në katolikë. Mbreti Ferdinandi II urdhëron që të gjitha xhamitë të shndërrohen në kisha. Njëkohësisht, mbreti e lut papën Juliusin II, përndryshe kushëri i papës Sikstusit IV, ta pranojë aktin e kryqëzimit të dhunshëm dhe t'i pranojë të kryqëzuarit nën mbrojtjen e *Kishës së Shenjtë Nënë*. Muslimanët e kryqëzuar fitojnë emër përbuzës *moriskos* (moriscos).
- 1496 – Të gjithë muslimanët dhe hebrenjtë të dëbuar nga Portugalia nuk pranohet të mbeten qoftë edhe të kryqëzuar në katolikë.
- 1502 – Të gjithë muslimanët dhe hebrenjtë u dëbuan dhunshëm nga Granada. Rreth gjysmë milioni muslimanë dhe afër 100.000 hebrenj, të cilët parapakisht u kryqëzuan dhunshëm, mbesin si qytetarë të rendit të dytë me emrin *moriskos* (muslimanë) dhe *maranosë* (hebrenj).

- 1516 – Nipi i mbretit Ferdinandi II dhe i mbretëreshës Izabela I, merr fronin e mbretërive të bashkuara të Kastiljes dhe Aragonës si mbreti Karlosi I. Me këtë fillon formimi i kombit bashkëkohor spanjoll.
- 1519–1522 – Në mbretërinë kristiane të Valencies shkatërrimet masive dhe kryqëzimi masiv i muslimanëve, qytetin i cili në kohën e El-Sidit shquhej me tolerancë fetare dhe karakter multikulturor, e shndërrojnë në simbol të dhunës deri atëherë të paparë dhe dëbimit në bazë etnike, kulturore dhe fetare.
- 1526 – Pas thirrjes së këshillit, i cili i shqyrtoi këto krime të tmerrshme mbi muslimanët dhe hebrenjtë, mbreti Karlosi I merr vendimin, me të cilën përgjegjësit e krimeve lirohen nga fajësia, kurse veprat e tyre janë në pajtim me fenë dhe ligjin, në bazë të faktit se muslimanët dhe hebrenjtë e kryqëzuar të mbijetuar (duke llogaritur edhe femrat dhe fëmijët) mund të zgjidhnin vdekjen në vend të kryqëzimit.
- 1568 – Kushtet e papërbalueshme dhe presionet e përhershme sollën deri te kryengritja e moriskosëve në Alpuharas (Alpujarras). Urdhri i mbretit Filipi II, që të ndalohen të gjitha format e kulturës muslimane, duke përfshirë edhe gjuhën, ushqimin e tyre tradicional e madje edhe muzikën, solli deri te kryengritja e moriskosëve, nën udhëheqjen e Aben Humejës. Kryengritja u shtyp me ndihmën ushtarake të mbretit të Asturisë, Johanit, përndryshe gjysmëvëlla i Filipit II, kurse të gjithë moriskosët e mbijetuar dhunshëm janë shkapërderdhë në veri të Gadishullit Iberik, në malet e shkreta të Pirinejeve.
- 1609 – Në prill të vitit 1609, mbreti Filipi III sjell Aktin për përndjekjen totale të të gjithë moriskosëve të mbetur.

- 1614 – Urdhri mbretëror zbatohet. Të gjithë evropianët pasardhës të muslimanëve të kryqëzuar dhunshëm, deri te i fundit u dëbuan nga territori i atdheut të tyre, Spanjës, apo u vranë nga bashkëqytetarët e tyre evropianë katolikë. Në Gadishullin Iberik, duke përfshirë edhe Portugalinë, u fshi tërë popullata e evropianëve muslimanë.

IV. AL-ANDALUSI - MËSIM PËR EUROPËN MODERNE

Mësimi i parë: Kordoba, e largët dhe e vetme⁹²

Të gjitha përparësitë e pranisë së lirë dhe të njëkohshme të kulturës hebraike, kristiane dhe islame në një vend të përbashkët në Europë, dhe të gjitha mangësitë e këmbimit të jetës së tillë tolerante, me totalitarizmin kulturor dhe ekskluzivizmin fetar, më qartë se kudo në ndonjë vend tjetër në Europë, e sigurisht edhe në botë, janë konfirmuar në Europë! Me fatin e qytetit të Kordobës mund të kuptohet përsosurisht thelbi i problemit dhe drama e identitetit kulturor në Europë, po ashtu mund të perceptohet qartë edhe mënyra përsosurisht efikase për zgjidhjen e këtij problemi, si dhe metoda, e cila çoi besnikërisht në shthurjen e kënaqshme të kësaj drame traumatike, e cila zgjat tashmë plot pesëmbëdhjetë shekuj.

Kur në vitin 711, në qytetin deri atëherë monokulturor dhe ekskluziv erdhën muslimanët, takuan një qytezë tipike, ashtu si në Europën e mesjetës së hershme kishte me qindra. Pa kurrfarë infrastrukture, pa kurrfarë plani urbanistik, pa ujësjellës dhe kanalizime, pa edhe gjurmën më të vogël të punës sistematike kulturore e aq më pak shkencore, Kordoba ishte vendbanim moçalik, plot me erën e keqe të urinës dhe fekaleve të cilat hidheshin për dritare nëpër rrugë, ndërsa jeta e njerëzve të pearsimuar dhe analfabetë ishte brutalisht e pakuptimtë, e mjerë dhe e shkurtër.

Tashmë në vitin 716, për shkak të pozitës së favorshme, Kordoba ishte bërë kryeqytet i provincës nën administrimin e

⁹² Vargu i poetit të madh Federik Garsija Lorkes.

halifatit të Damaskut, i njohur me emrin arab *Kurtuba*. Vetëm pesëdhjetë vite më vonë, në vitin 766, Kordoba tashmë ishte kryeqyteti i emiratit të pavarur Al-Andalus, i cili më vonë do të rritej në halifat. Disa tregues interesantë i ilustrojnë mjaft qartë proporcionet spektakolare të zhvillimit të qytetit sipas gjithë parametrave dhe konfirmojnë mjaft bindshëm tezën për amalgamën multikulturore të muslimanëve, kristianëve dhe hebrejve si faktor themelor të lulëzimit të një qyteti, për të cilin e kemi të vështirë të gjejmë diç të ngjashme në tërë historinë botërore. Në kohën e lavdisë më të madhe, kur fuqia e halifatit të Al-Andalusit ishte në kulm, kurse të gjitha potencialet jetike të qytetit e kishin arritur pikën kulmore, qyteti i Kordobës ishte qyteti më i madh në botë. Sipas vlerësimeve të historianëve dhe demografëve kompetentë, qyteti ka mund të numëronte madje edhe afër 1.000.000 banorë, kurse ky numër në Kordobë për një kohë të gjatë ka mbetur mbi 500.000 banorë. Gjatë pothuajse dy shekujve të tërë (shekulli X e XI), Kordoba ishte edhe kryeqendra joformale e botës, si qyteti më i zhvilluar në botë, përbënte pa dyshim qendrën kulturore, shkencore, artistike, ekonomike, financiare dhe politike të Europës dhe Afrikës veriore.

Për Kordobën është folur, për Kordobën është kënduar dhe ëndërruar. Të gjitha rrugët e zbulimit e fshehtësive më të thella, hulumtimet e dijeve më të larta, barabar si edhe kërkimi për liri personale, pasuri dhe lavdi, çonin në Kordobë. Nga tërë Europa, Lindja e Afërt dhe Afrika Veriore, të gjithë ata të cilët lakmonin të gjenin diçka që askund nuk mund të gjendej, nise-shin për Kordobë. Filozofët atje i gjenin veprat e Platonit dhe Aristotelit, mistikët islamë, kabalistët dhe ezoteristët kristianë kanë pasur vendstrehimin e tyre të sigurt, poetët shkonin për frymëzim, artistët në Kordobë kërkonin idealin e bukurisë, kurse shkencëtarët të vërtetën, Kordoba u bë e dëgjuar edhe në me-

sin e kristianëve të pjesëve më të largëta të Europës. Për këtë, krahas qindra referimeve të drejtpërdrejta, dëshmon qartë në mënyrën e vet edhe citati vijues nga pena e njërit prej njohësve të jashtëzakonshëm të Spanjës muslimane: “Lavdia e Kordobës ka jehuar në tërë botën e njohur dhe ka depërtuar edhe deri në pjesët më të largëta të Gjermanisë: Murgesha saksonase Hrosvita, e njohur me poemat dhe dramat e saj në gjuhën latine në gjysmën e dytë të shekullit X, Kordobën e quan *Margaritar të tërë botës*.⁹³ Në kohën e halifit el-Hakemit II, Kordoba ka pasur me dhjetëra pallate të shkëlqyera, infrastrukturën më së miri të rregulluar në botë, ujësjellësin me mbi 1500 çezma publike, 900 hamame (banja publike, veçan për femra dhe për meshkuj), pesëdhjetë spitale, kopshtet më të bukura në të cilat pa ndërprerë gurgullonin shatërvanët dhe lulëzonin trëndafilat, bibliotekën më të madhe në botë me rreth 1.000.000 libra, afër 3.000 xhami duke përfshirë edhe Xhaminë e Madhe të njohur deri larg Kordobës. Qytetin e stolisnin edhe faltoret kristiane dhe hebraike, shpesh në afërsi me xhamitë. Sipas të dhënave të ruajtura, në kohën e shkëlqimit më të madh, Kordoba muslimane multietnike europiane ka pasur rreth 260 kisha katolike dhe mbi 80 sinagoga. Por, sikurse mbi lulëzimin e ekonomisë, shkencës dhe arkitekturës së qyteteve multikulturore ndikojnë për keq heqja e tolerancës kulturore dhe futja e dhunshme e klisheve monokulturore të jetës, efekt negativ të barabartë mund të kenë edhe luftërat e ashpra politike për pushtet. Pas rënies së halifatit në vitin 1031, Kordoba edhe një farë kohe lulëzoi si seli e një lloji të republikës së pavarur – taifës, të cilën, pas një jete të shkurtër, e pushtoi el-Mu’temid ibn Abadi, emiri i Sevilyes, administrimin e saj, diç më vonë, por jo pa luftëra të përgjakshme, e mori push-

⁹³ Dozy, Reinhart F. 1881. *Recherches sur l'histoire et la littérature des Arabes d'Espagne pendant le Moyen-Age*, reprints, Paris 1973.

teti i almoravidëve, të cilëve, diç më vonë, sërish nëpërmjet luftërave ndërfetare të muslimanëve, ua zunë vendin almohadët.

Gjatë sundimit të almohadëve, filloi rënia e këtij qyteti të lavdishëm, kurse kryeqyteti i shtetit musliman europian të Al-Andalusit u transferua nga Kordoba në Seviljë. Pas një rrethimi të gjatë prej disa muajsh, më 29 qershor 1236, qyteti Kordoba përfundimisht ra në duar të mbretit të Kastiljes, Ferdinandit III, ndërsa kjo ishte një fitore e madhe e planeve të Rekonkuishtës, të orientuara në dëbimin e muslimanëve europianë nga Europa, por njëkohësisht edhe fundi i traditës multietnike të Kordobës. Të gjitha xhamitë u rrënuan. Të gjitha sinagogat u rrafshuan me tokën. Prej rreth 3.000 vendeve të shenjta muslimane, pjesa më e madhe u rrënuar, ato më të bukurat u shndërruan në kisha, ndërsa në bukurinë e vet madhështore ka mbetur vetëm Xhamia e Madhe e Kordobës, e cila gjithashtu u shndërrua në kishë. U rrënuan thujse edhe të gjitha hamamet, kopshtet e gërmuara, u shkatërruan gati të gjitha kopshtet në të cilat heshtën ujërat e kthjellëta të shatërvanëve dhe u venitën trëndafilat e fundit, kurse biblioteka më e madhe e botës së atëhershme në pjesën më të madhe u shkatërrua, ndërsa qindra mijëra libra u dogjën në stivë drush publikisht.

Gjatë Mesjetës Kordoba do të shkatërrohet me shpejtësi, dhe aq shpejt sa, vetëm dy shekuj më vonë, në kohën e lulëzimit të Renesansës së njohur si *Cinquecento*, degradoi në një qytet të parëndësishëm provincial me mezi 20.000 banorë. Rehabilitimi i qytetit të lavdishëm, mjaft i ngadalshëm dhe përplot vështirësi, ka filluar vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX.⁹⁴ Tërë zona e gjerë e Kordobës së dikurshme, sot e quajtur

⁹⁴ Historia e dokumentuar hollësisht dhe e përshkruar saktësisht e këtij rehabilitimi të Kordobës, është ekspozuar në librin e autorit dhe udhëtarit anglez, Xherald Brenan, *Fytyrat e Spanjës* (Gerald Brenan, *Faces of Spain*, London, 1950).

Kordoba Metropolitene Territor, me Kordobën si kryeqytet të rajonit dhe qytetet Vilafranka, Obejo, La Karlota, Vilaharta, Vilaviqioza, Almodavar del Rio, dhe Gvadalkazari, sot, plot 1.000 vjet pas kohëve më të shkëlqyeshme, numëron rreth 350.000 banorë. Për shkak të përmendoreve të veta të jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore, Kordoba më 18 dhjetor 1984 është shpallur qytet nën mbrojtjen e organizatës së UNESCO-s.

Kordoba e tolerancës së mirëfilltë kulturore, etnike dhe fetare prej para një mijë viteve, edhe sot përbën udhërrëfyes të qartë për Europën për perceptimin e identitetit vetjak si shumë të të gjitha rrjedhave kulturore dhe qytetëruese, të cilat e ndërtojnë këtë identitet, sikurse *in actu* konfirmohet mundësia e prosperitetit të plotë të të gjithë qytetarëve të vet, të cilët u përkasin rrjedhave të tilla, dhe së këndejmi nuk mundet dhe nuk duhet të mbetet *e largët dhe e vetme*.

Mësimi i dytë: Rasti i Valencies së El-Sidit: eksperimenti europian i bashkësisë judeo-kristiane-islame

Mënyra në të cilën në histori, në letërsinë popullore, në seritë televizive dhe në film⁹⁵ është paraqitur heroji legjendar, i njohur me nofkën luftarake *El-Sid*, përbën një ilustrim mbresëlënës të njëanshmërisë, shtrembërimit të vetëdijshëm dhe fshehjes së qëllimshme të të dhënave më të rëndësishme, që përkufizojnë figurën historike.

Tregimi për El-Sidin, përkatësisht të dhënat e tij biografike, janë të njohura deri në hollësitë më të imta. Lindi në vitin 1043 në qytezën e Kastiljone de Vivar, nga e cila u përcaktua

⁹⁵ Filmi gjithsesi më i njohur është "El-Sid", me regji të Entoni Manit (Anthony Mann) me Charlton Hestonin (Charlton Heston), Sofia Lorenin (Sophia Loren) dhe Raf Valonen (Raff Vallone) në rolet kryesore, i bërë në vitin 1961.

edhe pjesa fundore e emrit të tij: Rodrigo Diaz de Vivar. U vra më 1099 në Valencie. Nofka luftarake e plotë është *El-Sid Campeador* dhe përbëhet nga kombinimi i gjuhës arabe dhe spanjolle (*El-Sidi* – metatezë e fjalës arabe *es-sejjid*, *Zotëri*; *Campeador* – spanjisht, *Luftëtar*) dhe në përkthim të lirë do të thotë *Luftëtari i pamposhtur, Zotëri i luftës*. Së pari ka shërbyer si kalorës në pallatin e Sanços II, mbretit të Kastiljes, ku qe pranuar tashmë për 15 vjet jo të plota. Në vitin 1057 u shqua me trimëri dhe fuqi në disa dyluftime, dhe u bë kampioni zyrtar i dueleve i mbretit Sanço II. Kur në vitin 1072 u vra në atentat Sanço II, dyshohej se i kishte futur duart vëllai i tij Alfonsi. El-Sidi, me grupin e kalorësve të dalluar, e detyroi Alfonsin që solemnisht të betohej tri herë se në asnjë mënyrë nuk ishte i lidhur me atentatin. Pas këtij rasti u bë mbreti Alfonsi VI. El-Sidi mbeti në shërbimin e tij deri në vitin 1080, kur u dëbua nga pallati i Alfonsit VI. Rrethanat e kësaj ndarjeje nuk janë sqaruar tërësisht, por edhe nuk janë të rëndësishme për këtë tregim. Vetë akti i dëbimit është me rëndësi vendimtare. Me fjalë të tjera, edhe pse ishte i njohur si luftëtar i ashpër kundër muslimanëve, me të cilët deri atëherë kishte luftuar tërë shekullin e tij luftarak, El-Sidi shërbimet e veta ia ofroi emirit të Saragozës, Jusuf el-Mu'temen ibn Hudit. Në Saragozë, ardhja e tij nuk u pranua si rast që të likuidohej kundërshtari më i ashpër i muslimanëve, i cili personalisht kishte vrarë disa luftëtarë muslimanë dhe i kishte udhëhequr kristianët në disa beteja, në të cilat muslimanët qenë thyer. Duke i vlerësuar lart si luftëtar i jashtëzakonshëm, El-Sidi ka qenë i respektuar edhe si kalorës i mirëfilltë pa aspak fodullëk, luftëtar i cili nderin e kishte në rend të parë. Luftëtarët muslimanë i kanë vlerësuar këto dy cilësi të El-Sidit dhe me entuziazëm e kanë pranuar ofertën e tij. Përshkrimet e pritjes së tij dhe trajtimit në Saragozë na kujtojnë mjaft reporta-

zhet gazetareske për pritjen e futbollistit të shquar, që prej Barcelonës ka kaluar në Real Madrid ose e kundërta!

Por edhe El-Sidi me të njëjtën simpati i është përgjigjur kësaj pritjeje. Duke luftuar në anën e emirit të Saragozës, ka arritur disa fitore të rëndësishme kundër ushtrisë kristiane dhe fitoi famë të madhe ndër muslimanët. Pas vdekjes së emirit Jusuf el-Mu'temen ibn Hudit, El-Sidi pranoi ofertën e trashëgimitarit të tij, el-Mustainit II, dhe ka udhëhequr ushtrinë muslimane edhe në disa beteja fitimtare kundër kristianëve. Vetëm kur armata më e madhe kristiane deri atëherë e tubuar me Alfonsin VI në krye u mund rëndë nga i pamposhturi Jusuf ibn Tashefin, te Saragoza (më vonë e riemërtuar në toponim arab Az-Zalaka, për shkak të sasisë së madhe të gjakut të derdhur në këtë humbjen më të madhe kristiane), mbreti Alfonsi VI, i cili mezi e shpëtoi kokën duke ikur në terrin e natës, në fund të betejës e pa shkelur fjalën mbretërore e ftoi (madje *e luti*) El-Sidin që të kthehej në pallatin e tij si komandant suprem. Kështu El-Sidi u kthye nga Barcelona sërish në Real Madrid (ose e kundërta) – sidoqoftë në *klubin e tij amë*. Doli se mbreti kishte gabuar, sepse shpaguesi i tij, luftëtari i vjetër Jusuf ibn Tashefini, menjëherë u kthye në Marok të rregullonte gjendjen e brendshme, prandaj ftesa për ndihmë drejtuar te El-Sidi si shpresa e fundit për shpëtim, në fakt nuk ishte as e nevojshme.

Ndërprerjen e rrezikut të drejtpërdrejtë, që u shënua me largimin e Jusuf ibn Tashefini nga Gadishulli Iberik, e shfrytëzoi El-Sidi jo vetëm në dobi të tij, por edhe për dobinë e shumë njerëzve të tjerë, kurse mund të thuhet pa teprim, edhe për mësimin e amshueshëm dhe më të rëndësishëm për të gjithë europianët deri sot! Me fjalë të tjera, duke vërejtur gjendjen kaotike dhe luftërat qytetare, të cilat për një kohë të gjatë e kishin tronditur Valencien, duke e vënë në rrezik serioz mbijetimin e këtij

qyteti të madh, El-Sidi ndërhyri t'i pajtonte palët e armiqësua dhe sërish të vendoste paqen në qytet. Në këtë pati sukses aq mirë, saqë shpejt u zgjodh sundues i Valencias. Edhe pse në mënyrë dominuese musliman, e në masë të konsiderueshme edhe qytet hebre, me popullsinë kristiane pakicë, El-Sidi u zgjodh njëzëri si sundues. Duke luftuar edhe në njërën, edhe në anën tjetër, me njohje jashtëzakonisht të mirë të virtyteve dhe mangësive të popullsisë së parë, të dytë dhe të tretë, duke mësuar rrjedhshëm edhe gjuhën arabe e hebraishten, El-Sidi i kuptoi shkaqet e luftimeve të përhershme dhe urrejtjes së ndërsjellë të të tria feve, të cilat atëherë përbënin identitetin e qytetarëve të Iberisë. Shkaku i parë ishte dëshira për epërsi, hegjemoni, përpjekja që një komponent e identitetit të ndërlikuar të imponohet mbi të gjithë të tjerët. Shkaku i dytë rridhte nga i pari dhe lidhej me trajtimin jo të barabartë, përkatësisht me diskriminimin e të dy feve të tjera, atje ku sundonte feja e tretë.

Kur i analizoi qartë këto dy shkaqe kyçe, El-Sidi vendosi në Valencie barabarësinë e plotë për të tria fetë, sikurse edhe barazinë e plotë të gjithë qytetarëve të Valencias para ligjit - gjithashtu pa marrë parasysh në përkatësinë e tyre fetare. Të gjitha zakonet dhe të gjitha traditat lidhur me aspektet e jetës shoqërore qenë plotësisht të lira në praktikimin e tyre. Nuk ka pasur kurrfarë orvatjeje as për integrim, as për asimilim. Përveç kësaj, El-Sidi futi edhe një risi rë rëndësishme. Përkundër zakonit islam që kristianët dhe hebrenjtë të kursehen nga shërbimi ushtarak, El-Sidi në Valencie, e cila ishte me shumicë të madhe muslimane, vendosi detyrimin e përgjithshëm ushtarak për të gjithë qytetarët e saj të aftë për shërbimin ushtarak: muslimanët, kristianët dhe hebrenjtë. Kjo u tregua më shumë se zgjidhje e shkëlqyeshme. Sepse, ndërsa kristianët dhe hebrenjtë, të cilët në shtetet islame jetonin të liruar nga shërbimi ushtarak,

nuk i konsideronin këto shtete si *të tyret*, meqë për to as nuk kanë vdekur, as kanë derdhur gjak, kurse tash të gjithë së bashku e mbronin qytetin e tyre heroikisht nga të gjitha sulmet. Kurse qytetin e sulmonin edhe kristianët edhe muslimanët. Ndërsa një prej atyre sulmeve, ushtrisë së Jusuf ibn Tashefinit nuk i qeshi fati që me shigjetën vdekjeprurëse ta godiste drejt në zemër trimin! Qyteti ra, por mbeti e vërteta e pashlyeshme se Valencia, gjatë sundimit të El-Sidit, u bë sigurisht qyteti i parë dhe gjithsesi i vetëm autentik multietnik dhe multifetar në Europë e edhe në botë! Kjo vetvetiu është e shkëlqyer. Por, kjo sigurisht nuk ka mbetur edhe deri sot dhe kjo nuk është aspak e shkëlqyeshme!

Ky eksperiment me sukses i vendosur nga El-Sidi i bashkësisë judeo-kristiane-islame i qytetarëve plotësisht të barabartë, njëkohësisht është edhe mësimi kryesor i këtij tregimi të dytë për leksionet, të cilat duhet mësuar dhe mbajtur mend nga historia e Al-Andalusit. Leksioni i dytë, nga i cili nuk duhet marrë mësim, por nuk duhet harruar, lidhet me faktin se në paraqitjet historike, librat shkollorë, biografite e romanizuara të jetës së El-Sidit, deri sot nënvizohet vetëm lufta e tij kundër *saracenëve*, *maurëve*, *jobesimtarëve*, *muhamedanëve*, ndërsa për kodin kalorësiak, i cili e ka sjellë ndër muslimanët dhe pastaj e ka ngritur deri te themeluesi i shoqërisë së parë politike multietnike, multikulturore dhe multifetare, heshtet me urtësi, ose flitet krejt pak dhe në mënyrë shterpe.

Në lidhje me këtë ndryshim selektiv të historisë, do të përkujtojmë edhe falsifikimin e madh historik që e bëri Ariostoja në poemën e tij për *Rolandin e xhindosur*. Poema flet lidhur me betejën e famshme në grykën Ronsevo (Renceveaux) në vitin 778, në të cilën ushtria e Karlit të Madh, gjatë tërheqjes nga Spanja dhe kthimit në Francë, ra në kurth, me ç'rast u vranë shumë kalorës të shquar e ndër ta edhe Rolandi. Sikurse edhe një kronikë e mëhershme nga shekulli XI, ashtu edhe poeti i

famshëm i renesancës Ariostoja, sulmin (*tradhtisht dhe poshtërsisht*) ndaj kalorësve (*trima dhe heronj*) të Karlit të Madh, si edhe vdekjen e heroit kryesor, Rolandit ia ka veshur sulmeve (*të furishme dhe të ligshita*) të muslimanëve (*saracenëve, maurëve, jobesimtarëve, muhamedanëve*), edhe pse në atë betejë historike nuk ka marrë pjesë asnjë i vetmi musliman, por përjashtimisht vetëm baskët, dhe këtë të gjithë me radhë kristianë!? Nëse poezia si mjet, krahas famës së poetit të madh Ariostos, lejojnë që fjala adekuate por edhe akuzuese “falsifikim”, të ndërrohet me nocionin “liria poetike”, kjo gjithsesi nuk mund as edhe të mendohet kur është fjala për paraqitjet historike dhe studimet kulturologjike. Megjithatë, të gjitha përkthimet dhe rishtypjet e poemës së Ariostos, për të cilat di, deri sot këtë të pavërtetë historike nuk e komentojnë me as një fjalë! Është e qartë përse. Por e qartë është se edhe kështu nuk mund të vijohet më!

IV.1. Pasqyrë e shkurtër e trashëgimisë qytetëruese të Al-Andaluzisë, të pranishme në identitetin e Europës

Parimi i tolerancës shoqërore

Se koncepti i tolerancës shoqërore si karakteristikë qytetëruese e Europës moderne në tërësi është trashëgimi e faktorit islam, në këtë nuk mund të ketë kurrfarë dyshimi. Universi shoqëror i Al-Andaluzisë në parim ka qenë i bazuar në themelet e multikulturalizmit. Kjo përbënte një kundërshtim të drejtpërdrejtë ndaj konceptit monokulturor të modelit tipik kristian të organizatës shoqërore dhe për më tepër, përfaqësonte një risi të plotë për traditën e deriatëhershme europiane. Filozofia e inkluzivizmit konsekuent e shtetit të parë european islam, kish-te të bënte si me dallimet etnike, ashtu edhe fetare, që natyrisht

ka nxitur një tronditje të mirëfilltë kulturore për modelin tradicional të shoqërisë europiane kristiane, të bazuar në ekskluzivizmin e ngurtë fetar, të bazuar në parimin e njohur *cuius regio eius religio* – *i kujt është pushteti, e tij është edhe feja*. Nga vetë fillimi, Al-Andaluzia përfaqësonte bashkësinë organike të të tri feve të mëdha: islame, kristiane dhe hebraike. Kësaj i duhet shtuar edhe fakti se edhe vetë muslimanët, edhe pse unik si grup fetar, në fakt përbënin një amalgamë të ndërlikuar të numrit të madh të identiteteve të ndryshme etnike, para së gjithash të arabëve dhe berberëve. Por, madje as këtu nuk ka qenë fundi i kësaj lidhshmërie të thellë, në të cilën identitetet e njëjta etnike u përkisnin traditave të ndryshme fetare. Kështu Mozarabët, përndryshe arabë etnikë, qenë kristianë të cilët, edhe përkundrajt faktit se një kohë të gjatë kishin jetuar në suaza të shtetit islam, e kishin ruajtur lirshëm fenë, gjuhën e tyre, sikurse edhe identitetin e tyre kulturor, edhe pse gjatë jetës së përbashkët kanë përvetësuar edhe një pjesë të ndjeshme të traditave islame dhe arabe, sikurse edhe arabët islamë kanë përvetësuar një pjesë të shprehive të tyre kulturore. Në të gjitha qytetet e mëdha, sikurse edhe në tërë territorin, të gjitha grupet etnike dhe fetare kanë pasur bashkësi të tyre të veçanta, në të cilat kanë zhvilluar pa pengesa jetën në pajtim me parimet e tyre tradicionale. Siç tregon Tomas Glik në studimin e tij, gjatë shekullit X, kur një pjesë e konsiderueshme e popullsisë kristiane të Gadishullit Iberik ka pranuar vullnetarisht Islamin (të cilët ishin të njohur me emrin *muladije*), përqindja e popullsisë islame në Al-Andaluzi ka arritur maksimumin e tyre, me rreth 80% muslimanë, pjesëtarë të të gjitha kolektiviteteve etnike.⁹⁶ I njëjti autor kon-

⁹⁶ Glick, Thomas (1999). "Islamic and Christian Spain in the Early Middle Ages: Comparative Perspectives on Social and Cultural Formation". [http://libro. uca. - edu/ics/emspain.htm](http://libro.uca.edu/ics/emspain.htm).

sideron se ky numër atëherë ka mundur të jetë maksimalisht 5.6 milionë muslimanë në tërë territorin e shtetit të atëhershëm europian të Al-Andaluzisë.⁹⁷ Këtë të dhënë sidomos e theksojmë për shkak se vetëm 400 vjet më vonë në po këtë territor nuk ka mbetur asnjë musliman, as hebre!?

Në suaza të këtij shteti mjaft tolerant multikulturor, multi-etnik dhe multifetar, berberët, në pajtim me shprehitë e tyre jetësore, janë vendosur të banojnë kryesisht në zonat malore të Portugalisë së sotme dhe Spanjës qendrore, ndërsa arabët kanë jetuar në jug dhe në luginën e lumit Ebro në verilindje të Gadishullit. Hebrenjtë kanë qëndruar kryesisht në qytete, duke përbërë shtresën më të arsimuar të Gadishullit. Sferat e tyre të veprimtarisë ishin shkenca, tregtia, diplomacia, kontrolli financiar dhe administrimi i shtetit, kurse numri i tyre i përgjithshëm llogaritet në rreth 5% të popullsisë. Në këtë aspekt nuk ka kurrfarë dyshimi se vlerësimet të bazuara faktografike, sipas të cilave Al-Andaluzia në Mesjetën e hershme përfaqësonte qendrën më të rëndësishme të jetës së hebrenjve, shtetin në të cilin ata kanë sendërtuar bashkësinë deri atëherë më të lulëzuar, më të qëndrueshme dhe më të pasur me një numër të madh filozofësh, shkencëtarësh, liderësh fetarë, autorësh dhe ndërmarrësve

⁹⁷ “Ritmi i pranimit të Islamit ka qenë tejet i ngadalshëm deri në shekullin X (gjithsesi, më pak se një e katërta e numrit të përgjithshëm të njerëzve të cilët e kanë pranuar Islamit); periudha eksplozive e kalimit vullnetar në Islam pajtohet me periudhën e sundimit të Abdurrahmanit III (912-961); procesi është përfunduar rreth vitit 1100 dhe ka mundur të përfshijë 40% të të gjithë banorëve të Al-Andaluzisë. Kurba statistikore lejon vlerësimin real të distribuimit të të gjithë banorëve të Gadishullit Iberik në atë periudhë. Me supozimin se në vitin 711 në tërë Gadishullin ka pasur rreth 7 milionë banorë hispo-romakë, dhe se ky numër ka mbetur i pandryshueshëm gjatë shekullit XI, atëherë në vitin 912 ka mundur të jenë rreth 2.8 milionë popullsi indigjene islame (*muvel-ledun*), plus arabët dhe berberët. Në këtë pikë kohore, numri i kristianëve ende larg e ka tejkaluar numrin e muslimanëve. Megjithatë, rreth vitit 1110 numri i muslimanëve indigjenë (në territorin e tërë shtetit të Al-Andaluzisë, vërejtja e F.M.) ka mundur të arrijë numrin prej 5.6 milionë.” (Glick 1999, Chapter 1: At the crossroads of civilization)

të rëndësishëm.⁹⁸ Për karakterin tolerant të shoqërisë islame të manifestuar në shtetin e parë islam evropian të Al-Andaluzisë, flet mjaft edhe fakti se shumë autorë, duke përfshirë edhe shkencëtarët hebrej, pa dyshim pranojnë dhe madje e radikalizojnë pikëpamjen se “... toleranca ka qenë aspekti inherent i shoqërisë së Al-Andaluzisë ... në të cilën hebrejtë dhe kristianët kanë gëzuar të gjitha të drejtat kulturore dhe fetare, dhe ndonëse me të drejta më të vogla sesa muslimanët, megjithatë kanë jetuar pakrahasueshëm më mirë dhe me më shumë liri sesa pakicat kulturore në cilëndo pjesë kristiane të Europës.”⁹⁹

Dallimin dramatik në shkallën e tolerancës kulturore dhe fetare ndërmjet Al-Andaluzisë si shtetit të parë evropian islam dhe shtetit kristian, i cili e ka ndërruar këtë në të njëjtën hapësirë, e ilustron më se tmerrshëm faktet se për disa vjet janë rrënuar të gjitha xhamitë dhe sinagogat, bibliotekat dhe hama-

⁹⁸ Përveç Bat Ye'orit tashmë e njohur si paradigmatiche, e cila përkundër fakteve shumë mirë të njohura, me këmbëngulje flet për mostolerancën e shoqërisë islame mesjetare (sikurse përndryshe edhe moderne) në raport me hebrejtë, është interesant edhe shembulli i historianit dhe sociologut të njohur hebre Bernard Luis. Edhe pse, nga një anë, pohon se shoqëria tradicionale islame *nuk ka qenë tolerante, as që është shtirë se është e tillë*, ... sepse kjo do të ishte edhe absurd ideologjik edhe logjik, megjithatë i shtyrë me argumente të pathyeshme empirike, i njëjti autor pranon: “Marrë në mënyrë të përgjithshme, për popullin hebraik ka qenë e lejuar ta praktikonte lirisht religjionin e vet dhe të jetonte në harmoni me ligjet e veta dhe dispozitat e bashkësisë së vet. Gjithashtu, kufizimet të cilave hebrejtë u qenë të nënshtuar më shumë kanë qenë sociale dhe simbolike, sesa kanë pasur njëfarë ndikimi praktikë në jetën e tyre. Kjo do të thotë se këto dispozita parimisht kanë shërbyer që të përkufizohej raporti ndërmjet dy bashkësive (islame dhe hebraike, vërejtja e F.M.), e jo të bëhej ndonjëfarë represioni ndaj popullit hebraik.” Shih: Lewis, Bernard W. (1984). *The Jews of Islam*, f. 4.

⁹⁹ Në qasjen jashtëzakonisht korrekt të intonuar, specialisti i njohur për literaturën spanjolle, Maria Menokal qartë e afirmon tezën për Al-Andaluzinë si për shtetin e parë evropian multikulturor, në çka na çon drejtpërdrejt edhe titulli i studimit të saj. Shih: Menocal, Maria Rosa. 2002. *Ornament of the World: How Muslims, Jews, and Christians Created a Culture of Tolerance in Medieval Spain*. Shih edhe: Alfonso, Esperanza, 2007. *Islamic culture through Jewish eyes: al-Andalus from the tenth to twelfth century*. New York, NY: Routledge.

met, se janë grabitur pasuritë e të gjithë jokristianëve, dhe se prej 500.000 muslimanëve dhe 30.000 hebrenjve sa patën mbetur në Granadë pas rënies së shtetit islam, pushteti kristian në afatin më të shkurtër ka vrrarë rreth 100.000, ka dëbuar 200.000, kurse 200.000 të tjerë të mbetur me dhunë i ka konvertuar në katolicizëm. Madje edhe vetë Boabdilit, më i njohur si emiri i fundit i Granadës, Muhammedi XVI, bashkëpunimi i të cilit solli deri te rënia e shpejtuar e Granadës, mbretëresha Izabela I dhe mbreti Alfonsi III i ndanë si shpërblim pronë në zonat e shkreta malore të Alpuhaves (Alpujarra), me disa përfaqësues të elitës muslimane, të cilëve u qe lejuar të mbeteshin, sepse gjithashtu kishin bashkëpunuar me pushtuesit e Granadës, pas pak kohësh morën fund, sepse jeta nën pushtetin kristian ishte e papërballueshme, dhe shumë shpejt kaluan në Afrikën Veriore.¹⁰⁰

Kultura

Në klimën e tolerancës së përgjithshme shoqërore që ka mbretëruar në shtetin e parë europian islam Al-Andaluzi, nuk është kurrfarë çudie që ka lulëzuar një kulturë veçanërisht e fuqishme në të gjitha zonat, duke përfshirë arsimin, filozofinë, shkencën, artin dhe fenë e të tri bashkësive kryesore fetare – muslimanëve, kristianëve dhe hebrenjve. Gjithashtu, nuk duhet aspak të na befasojë fakti se në Al-Andaluzi arsimimi ka qenë në nivel shumë më të lartë në raport me të gjitha shtetet e atëhershme europiane. Raportin ndaj arsimit, shkencës, artit, shkurtimeisht, raportin ndaj dijes në rrethin e atëhershëm islam, më

¹⁰⁰ Më hollësisht për dëbimet e para mbi muslimanët dhe hebrenjve, menjëherë pas pushtimit të Granadës, ashtu edhe për mostolerancën e pushtetit kristian ndaj praktikave të tyre kulturore, të cilat kanë përfshirë madje edhe veshjen, simbolet, mënyrën e të ushqyerit, shih: Henry Kamen, *Spain 1469-1714 A Society of Conflict*, (Third edition, pf. 37–38).

së miri i ilustron fakti se madje edhe në kohën e luftës ndërmjet emevitëve dhe abasitëve, pra ndërmjet Halifatit të Kordobës dhe Halifatit të Bagdadit, njerëzve të shkencës, dijetarëve dhe priftërinjve u ishin të lejuara udhëtimet e papenguara nga njëri shtet në tjetrin. Rivaliteti ndërmjet këtyre dy shteteve të mëdha islame, i cili në njërën anë ka rrezikuar jetët njerëzore dhe ka sjellë në rrezik mbijetimin e vetë këtyre shteteve, nuk është shfaqur në sferën e arsimit dhe shkencës, por përkundrazi e ka bërë më vitale dhe më të fuqishme shkencën dhe artin në to. Kordoba, përkundër luftërave me Bagdadin, ka tentuar ta ndërtojë bibliotekën më të madhe në botë (e cila deri atëherë kishte qenë në Bagdad), hap në të cilin pasur sukses, sikurse edhe edukatorët më të zotë dhe institucionet edukative më efikase, që gjithashtu i kanë shkuar për dore. Kjo praktikë e pazakonshme, jashtë shembujve të këtyre dy shteteve islame, e tolerancës kulturore, ka sjellë deri te paradoksi unikal në tërë historinë, se filozofia, shkenca dhe arsimimi kanë lulëzuar dhe janë zhvilluar pa pengesa madje gjatë luftës të këtyre dy halifateve. Në kontekstin e një rivaliteti të këtyre kulturor dhe efekteve të tyre pozitive, duhet gjithsesi të theksohet edhe fakti se universiteti i parë dhe më i vjetër në botë është themeluar pikërisht në truallin e shtetit islam, dhe ky në Marok, në qytetin Fes, i cili gjendet në komunikimin intensiv gjeografik, demografik dhe kulturor me Gadishullin Iberik.¹⁰¹

Filozofia

Është e njohur mirë se arsimit dhe shkenca – shkurt dija! – përfaqëson zanafillën e Islamit, i cili daton pikërisht nga fillimi i përcjelljes së *Shpalljes (Kur'anit)* dhe vazhdon deri sot si

¹⁰¹ Universiteti i el-Kajrevanit (ar. *el-Karavijjin*), është universiteti i parë në botë, i themeluar në vitin 859.

karakteristikë e tij kyçe dhe detyrim konstant. Për më tepër, është krejt e kuptueshme përse, në periudhën më të shkëlqyer të Al-Andaluzisë, halifët islamë i kanë përkrahur bujarisht, e kanë ndihmuar dhe miratuar zhvillimin e shkencës dhe të gjitha formave të tjera sistematike të dijes. Në Kordobë kësaj praktike të tillë pozitive, vulë veçanërisht të fuqishme i ka vënë halifi Abdurrahmani III, sidomos në lidhje me mjekësinë dhe shkencat e vjetra (astronominë dhe matematikën). Në gjysmën e dytë të shekullit X, rreth vitit 955, halifi Hisham el-Hakemi II ka themeluar në Kordobë Universitetin, i cili njëkohësisht padrejtësisht është lënë anash si universiteti i parë dhe më i vjetër në Europë,¹⁰² sikurse edhe bibliotekën e madhe e cila pastaj do të bëhej biblioteka më e madhe në botë, duke shtuar filozofinë në regjistrin e disiplinave të përkrahura nga arka shtetërore, krahas mjekësisë, astronomisë dhe matematikës. Ky zhvillim i fuqishëm i shkencës, filozofisë dhe artit, u ndërpre përkohësisht për shkak të aktivitetit të autoritetit shpirtëror el-Mansur ibn Ebi Amirit, i cili nuk ka lejuar astronominë as hulumtimet shkencore, e gjithashtu vendosi edhe censurën e fuqishme të librave filozofikë. Megjithatë me vdekjen e tij (1002), lulëzimi i dijes ka vazhduar me forcë të veçantë dhe ashtu drejtpërdrejt ka përgatitur shfaqjen e *Renesansës*, duke u parapritë manifestimeve të saj më të hershme (*Trecento dhe Quattrocento*) për rreth 280-350 vjet.

Në këtë periudhë shfaqet një numër i madh mendimtarësh, të cilët, në pajtim me zakonet e epokës, merren me filozofi dhe me shkenca të tjera, sidomos natyrore. Ndikim të madh ka ushtruar vepra e Ebu Uzman ibn Fatunit me titull alegorik *Druri i dijes*, pastaj Mesleme ibn Ahmed el-Mexhriti, sidomos

¹⁰² *Universiteti më i Vjetër në Evropë*, të cilin titull zyrtarisht e mban Universiteti i Bolonjës, i themeluar më 1088, në fakt është universiteti i dytë në truallin e Evropës, i ndërtuar 125 vjet pas Universitetit në Kordobë, dhe 221 vjet pas Universitetit islam të el-Kajrevanit, universitetit të parë në botë, të themeluar në qytetin Fes në Marok.

libri e tij *Synimi i të urtëve (Gajetu'l -Hakim)*, i cili përbën një lloj sinteze origjinale të platonizmit dhe filozofisë hermetike, të përshtatura ideve të misticizmit islam. Më vonë ndikimi i tij ka rënë ndjeshëm, sidomos nga shkakun se libri është shkruar në vargje, por pikërisht kjo gjë e bëri atë të popullarizuar në qarqet e filozofëve sufi, të cilët këtë traditë të shkrimit në vargje e ruajtën edhe në veprat e filozofëve sufi më të shquar nga territoret e shtetit osman, sikurse janë Xhelaluddin Rumi, Junus Emre dhe Omer Hajami. Njëri nga nxënësit dhe pasuesit më të dalluar të tij ka qenë Ebu el-Hakem el-Kirmani, i cili i ka zhvilluar idetë e mësuesit të tij në shkollën vetjake, sidomos nëpërmjet nxënësit të tij Ebu Bekr ibn es-Saig, më të njohur me nofkën Ibn Baxhe (Ibn Bajjah). Në suaza të traditës filozofike të Al-Andaluzisë gjithësesi vend të veçantë zë figura kolosale shpirtërore e Ibn Rushdit (Ebu el-Velid Muhammed ibn Ahmed ibn Rushd 1126-1198), të transkriptuar në gjuhën latine si Averroesi. Pas një vargu sulmesh që deri atëherë mbi filozofinë e kishin bërë si elita kristiane ashtu edhe ajo islame, ka pasuar goditja e el-Gazaliut (Al-Ghazzali, 1158-1111), njërit prej filozofëve më të shkëlqyer dhe më ndikues të kësaj kohe. Al-Gazaliu ka vdekur vetëm 15 vjet para se të lindte Ibn Rushdi, kurse kritika e tij radikale e filozofisë si e papajtueshme me shpalljen po aq fuqishëm ka përcaktuar qëndrimet zyrtare dhe të teologëve islamë e kristianë. Në këtë detyrë të vështirë për ta mbrojtur dhe sërish për ta afirmuar vendin e lartë, të cilin filozofia e ka në historinë e vetëdijes njerëzore, Ibn Rushdi me komentet e tij të shkëlqyera dhe interpretimet origjinale të filozofisë së Aristotelit, së pari e ripërtëriu interesin e fikur për këtë filozof të madh, dhe këtë në masë të tillë sa që drejtpërdrejt nga harresa e ktheu në qendër të interesit filozofik të tërë filozofisë europiane. Pas kësaj e ka verifikuar në mënyrë kritike kinse tensionin e papaj-

tueshëm ndërmjet filozofisë dhe teologjisë, përkatësisht fesë si Shpallje të Zotit, duke iu kundërvënë drejtpërdrejt traditës anti-filozofike, të cilën në Islam e inauguroi, nëse jo edhe e filloi, pikërisht vetë el-Gazaliu i madh. Ky tekst pati ndikim jash-tëzakonisht të madh, dhe këtë aq të madh saqë, krahas interesit plotësisht të ripërtërirë për filozofinë, menjëherë pastaj ka pasuar formimi i një drejtimit të tij filozofik, të ashtuquajturit *averroizmi*. Me ekspertizën e përmbajtjes së *ajeteve* relevante nga Kur’ani, ky filozof i madh islam dhe europian ka demonstruar legjitimitetin e filozofisë si njërit prej tri rrugëve që shpiten deri te të vërtetat më të larta fetare, me çka në mënyrë parimore ka kontestuar kërkesat që filozofia të ndalohej. Me ndërmarrjen e tij në mënyrë të ndritur e të konceptuar dhe themelësisht të argumentuar, Ibn Rushdi pa dyshim ka treguar se pa hulumtimin kritik dhe filozofik të fesë jo vetëm nuk mund të depërtohet deri te kuptimet më të thella dhe porositë më të lartësuar të përmbajtura në porositë e Zotit, por ato domethënie dhe porosi mund të kuptohen gabimisht dhe të humbasin krejtësisht. Me këtë ka ushtruar ndikim thelbësor në tërë mendimin europian iluminist, i cili është përmbledhur në Rilindje, kurse shumë më tepër sesa mundet edhe të mendohet në bazë të paraqitjeve të deritashme të filozofisë islame, ka kryer pikërisht tradita filozofike e Al-Andaluzisë nga periudha e saj më e shkëlqyer, pra tashmë në shekullin XI dhe XII. Po ashtu rrallë vihet në dukje fakti se Ibn Rushdi i pari e ka formuluar dhe hollësisht në mënyrë filozofike ka zhvilluar tezën se “ekzistenca i ka paraprirë esencës”, e cila përndryshe i vihet filozofit francez të ekzistencializmit Zhan-Pol Sartrit (Jean-Paul Sartre).¹⁰³

¹⁰³ Një pasqyrë hollësisht e zhvilluar e këtij koncepti të Ibn Rushdi gjendet në: Irwin, Jones (Autumn 2002), "Averroes' Reason: A Medieval Tale of Christianity and Islam", *The Philosopher*, LXXXX (2)

Ndikim të madh në filozofinë dhe letërsinë euro-perëndimore ka pasur filozofi andaluzian Ebu Bekr Ibn Tufejlil me romanin Haj ibn Jakdhan (*Hayy ibn Yakdhan – i Gjalli, i biri i të Zgjuarit / Alive, son of Awake*). Është botuar në vitin 1175 në Kordobë, heroin e tij nga titulli i librit Haj ibn Jakdhan, e ka shëtitur nga Damasku deri në Firencë¹⁰⁴ dhe nga Madridi deri në Londër, duke u kthyer dhe duke lënë gjurmë të përhershme në Oksford, Masaçusets, Haleb, barabar ndër muslimanët, katolikët, protestantët, kuakerët. Ky roman për herë të parë është përkthyer në gjuhën latine me titullin *Filozofi autodidakt në vitin 1671 në Oksford*, kurse e ka përkthyer Eduard Pokoku i ri (Edward Pococke junior). Njëri pas tjetrit kanë pasuar përkthimet *Hajj Kueker (Hayy the Quaker, 1674)*; *Hajj Anglo-katolik (Hayy the Anglo-Catholic, 1686)*; e pastaj *Haj Autodidakti, njeriu i cili e arriti dijen e mirëfilltë por Zotin dhe dijen për shpëtimin, pa kurrfarë mësimi (Hayy the Autodidactus..., 1708)* duke ushtruar ndikim të sigurtë edhe mbi filozofin më të njohur empirik anglez Xhon Llokun (John Locke); diç më herët, në vitin 1700 përkthimi ka dalur në Boston, Masaçusets; në Londër, Daniel Defoja /Daniel Defoe), autori i romanit të famshëm *Robinson Kruso*, e kthen Haj ibn Jakdhanin në figurë tipike të protestantit anglez (1719); që në vitin 1761 një autor anonim do ta paraqiste Haj ibn Jakdhanin si prift katolik, kurse në vitin 1810 në Haleb Xhon Luis Burkhart (John Lewis Burckhardt) e ktheu Haj ibn Jakdhanin në figurën e Sherif Jusufit, i cili qëndron i vetmuar në ishullin e shkretëtë. Paraqitje e shkëlqyeshme e udhëtimeve të jashtëzakonshme të kësaj figure, Ibn Tufejlil nga shekulli XVII, janë dy studime të Eduard Saidit, në të cilat ndi-

¹⁰⁴ I impresionuar si me idetë e këtij romani, ashtu edhe nga virtytet e heroit kryesor të romanit të Ibn Tufejlil, Piko dela Mirandola në vitin 1494 në Valencie ka botuar librin në të cilën Hajj ibn Jakdhani është paraqitur si përfaqësues i përkryer i njeriut evropian të Rilindjes.

qet se si një tekst letrar apo filozofik, duke e lënë kontekstin e vet burimor dhe duke shkuar në gjuhë, fe dhe kultura të reja, e ndryshon edhe konceptin e vet themelor të vlerave, duke u dobësuar apo duke u forcuar, duke fshirë apo duke përshkruar ide krejt të reja.¹⁰⁵ Thelbin e këtyre ndryshimeve ndërkulturale nëpër të cilat kalon Haj ibn Jakdhani, saktësisht e përcakton Nabil Matari, kur thekson se: “Në fakt, Hajji ka udhëtuar nga Islami deri te judaizmi dhe pastaj deri te kristianizmi, nga Damasku deri në Firencë, nga Londra deri në Haleb, duke ripërtërirë udhëtimin heroik të njeriut në kërkim të Zotit, *er-rahman*, *er-rahim*, gjithëmëshirshmit, mëshirëplotit.”¹⁰⁶

Në këtë kontekst, vlen të theksohet edhe zhvillimi i fuqishëm i filozofisë hebraike, e cila pikërisht në shtetin e parë evropian islam në Al-Andaluzi, ka përjetuar epokën e vet të artë. Kalimi i shkallëshkallshëm i hebrenjve nga Lindja e Afërt drejt Gadishullit Iberik, të tërhequr nga toleranca fetare dhe kulturore, e cila mbizotëronte në Al-Andaluzi, si edhe me proceset intensive ekonomike dhe stabilitetin e këtij shteti islam, shpejt Kordobën dhe qytetet e tjera i kanë shndërruar në një qendër të aktiviteteve ekonomike dhe jetës intelektuale të hebrenjve nga tërë bota. Shumë poetë të rëndësishëm, sikurse Dunash ben Labrati (920-990) dhe diç më vonë i famshmi Judah Halevi (1086-1145) jo vetëm që e kanë ngritur letërsinë hebraike të kësaj epoke, por kanë ndikuar fuqishëm edhe në zhvilli-

¹⁰⁵ Said Edward W. (1983) *Travelling Theory: The World, the Text, and the Critic*, Harvard, Mass.; Said Edward W. (2000) *Travelling Theory reconsidered*, Harvard, Mass.

¹⁰⁶ Studimi i Matarit, i botuar para do kohe, instruktiv sa edhe inspirues, hap një varg horizontesh jo vetëm në lidhje me Ibn Tufejlën dhe romanin e tij filozofik, por edhe në kontekst të proceseve ndërkulturale, të cilët kanë mbetur pak të njohura, kurse e kanë trajtësuar fuqishëm edhe identitetin modern multikulturor të Evropës. Shih: Nabil Matar (2011), “*The Journeys of Hayy ibn Yaqdhan*”, *Arches Quarterly*, volume 4, spring/summer 2011, pf. 56-62.

min e prodhimit poetik arab dhe kristian. Në filozofi, nëpërmjet lidhjeve të afërta dhe këmbimit të ideve me rrjedhat filozofike islame, i ka fituar konturet e veta edhe filozofia origjinale hebraike me Mozes Maimonidesin (1086-1145) si përfaqësuesin më të rëndësishëm.

Shkenca

Në kohën e lulëzimit të shtetit të parë evropian islam, edhe shkencat ekzakte kanë përjetuar afirmimin e vet maksimal. Të njohur praktikisht me të gjitha rezultatet e filozofisë dhe shkencës antike, sidomos shkencave natyrore, mendimtarët muslimanë të kësaj periudhe kanë pasur, krahas kushteve të favorshme shoqërore, edhe këtu përparësi që t'i këmbëjnë pa pengesa rezultatet e hulumtimeve të veta me kolegët e tyre në hapësirën e madhe nga Bagdadi deri në Kordobë, nga Damasku deri në Fes, nga Kajroja deri në Granadë. Përveç kësaj, edhe pse shkencëtarët evropianë muslimanë nuk kanë qenë të mirëseardhur në vendet evropiane kristiane, shkencëtarët evropianë kristianë kanë mundur të vinin lirisht në Al-Andaluzi, duke mundur komunikimin intensiv shkencor, në të cilin pjesa kristiane e Europës ka mundur hollësisht ta njihet me zhvillimin e shkencës në pjesën islame të Europës. Në këtë zhvillim, njëra nga shkencat më intensivisht të hulumtuara të Mesjetës së hershme në Al-Andaluzi ka qenë:

Astronomia

Nga fundi i shekullit X, astronomi i njohur Ibn el-Hejthemi, i ftoi kolegët astronomë të tentojnë të ndërtojnë një model alternativ të sistemit diellor, i cili do t'i mënjanonte gabimet e

pranishme në modelin atëherë dominues dhe në fakt të vetëm të Ptolemeut. Astronomët e kanë pranuar këtë sfidë shkencore dhe gjatë periudhës vijuese dyshekullore kanë ofruar një varg zgjidhjesh jashtëzakonisht të rëndësishme. Ndër të parët ishte shkrimi i njohur i autorit anonim *Rekapitulimi i sistemit të Ptolemeut (el-Istidrak ala Batlamjus)*, me listën e hollësishme të të gjitha gabimeve, të cilat rrjedhin nga ky sistem, dhe me vërejtjet në dobësitë teorike të këtij modeli. Kështu filloi periudha e frytshme e zhvillimit të astronomisë, e njohur si “Kryengritja andaluziane”, me aludim në kryengritjen kundër komentimit atëherë dominues të Ptolemeut.¹⁰⁷ Nga fundi i shekullit XI astronomi i njohur *ez-Zerkali* (në variantin e latinizuar të shndërruar në *Arzachel*), ka vërtetuar se orbitat e planetëve në sistemin diellor nuk janë qarqe të përkryera, por elipsa të rregullta, edhe pse edhe më tej ka mbetur në Modelin e Ptolemeut, për të cilin deri atëherë nuk ishte ofruar ndonjë alternativë e pranueshme. Për kritikën substanciale të sistemit të Ptolemeut nuk është dashur të pritet një kohë e gjatë në atmosferën shkencore virulente dhe me gjallëri frenetike të Kordobës. Me fjalë të tjera, filozofi i njohur, i cili ka qenë edhe njëri prej astronomëve kryesorë të kohës së tij, Ibn Rushdi e hodhi poshtë hipotezën e Ptolemeut për sferën ekscentrike dhe epiciklike, e cila përbënte postulatit vendimtar të sistemit të tij, me vërejtjen se *supozimi për ekzistimin e sferave ekscentrike kundërshtohet me parimet e natyrës*. Një objeksion të njëjtë ndaj Ptolemeut, me rastin e rezultateve të Ebu Bekr ibn Baxhes, të cilat me kalkulime kishin konfirmuar hipotezën për sferat ekscentrike, e ka drejtuar

¹⁰⁷ Për këtë lëvizje të rëndësishme dhe ndikimin e saj në zhvillimin e mëtejshëm të astronomisë, më hollësisht shih në: Sabra, A. I., "The Andalusian Revolt Against Ptolemaic Astronomy: Averroes and al-Bitrûjî", in Mendelsohn, Everett, *Transformation and Tradition in the Sciences: Essays in honor of I. Bernard Cohen*, Cambridge University Press, pf. 233–253.

edhe filozofi dhe astronomi hebraik Mozes Maimonides, përndryshe edhe bashkëkohës i Ibn Rushdit, duke theksuar se përputhja e llogarive astronomike me vëzhgimet astronomike, ende *nuk mund të konsiderohet për dëshmi se cilat cilësi i kanë sferat, por vetëm se përputhen me teorinë cirkulare të lëvizjes së planetëve, që gjithsesi nuk është e njëjtë.*¹⁰⁸

Ibn Baxhe (Ibn Bajjah) ka qenë i pari i cili e ka formuluar hipotezën se Rruga e Qumështit, në fakt është galaksia e përbërë nga miliona yje e jo një brez i shkëlqyeshëm i vazhdueshëm në qiell, siç besohej deri atëherë. Nxënësit e tij dhe pasuesit e Ibn Tufejlit dhe Nuruddin el-Betruxhit (në versionin e latinizuar (*Alpetrugijs*), kanë ndërtuar modelin e parë teorik konsistent planetar pa orbita epiciklike dhe ekscentrike. Në këtë periudhë, më të gjatë se dy shekuj, zhvillimi i astronomisë e ka pasur qendrën e vet europiane dhe botërore pikërisht në Al-Andaluzi.

Hulumtimet e planetit Tokë dhe të biosferës

Trashësinë e mbështjelljes atmosferike të Tokës, të cilën shkencë bashkëkohore e ka përcaktuar me hulumtimet satelitore dhe me teknologji më të zhvilluar, thajse me saktësi të përkryer e ka llogaritur në shekullin XI optikani nga Kordoba Ibn Maudhi (Ebu 'Abdullah Muhammed ibn Ma'udh), dhe për këtë paraqiti një trajtesë shkencore, të përkthyer në gjuhën latine me titull *Liber de crepisculis*. Në njërin prej vargjeve më inteligjente deduktive, Ibn Maudhi ka vërejtur shmangie të lehtë të këndit të rrezeve diellore në agim dhe në muzg, që ia ka quajtur pranisë së lagështisë, e cila barabar e mbështjell Tokën (ekzis-

¹⁰⁸ Për të dy citatet, sikurse edhe studimin e vëllimshëm të astronomit rreth cirkularitetit dhe ekscentricitetit të lëvizjes së planetëve të asaj kohe në Al-Andaluzi shih te: Bernard R. Goldstein (March 1972).

tenca e atmosferës atëherë ende nuk ka qenë e njohur), dhe në bazë të këtij supozimi ka llogaritur trashësinë më të sigurt të kësaj mbështjelljeje, në bashkërendim me devijimin e këndit diellor gjatë lindjes dhe gjatë perëndimit të Diellit. Llogaritjet e tij kanë arritur deri te një numër, i cili gati se në mënyrë të përkryer përputhet me rezultatet e hulumtimeve moderne.¹⁰⁹

Lidhur me hulumtimet e biosferës, të cilat janë zhvilluar me tempo deri atëherë të paimagjinueshëm, nga bollëku i rezultateve mjaft të rëndësishme thuhet në të gjitha fushat e biologjisë, do të tregojmë vetëm në një shembull mbresëlënës. Fjala është për studimin e njohur botanik të Ebu el-Abbas en-Nebatit, i cili është pa dyshim libri i parë shkencor për botanikën dhe ka shërbyer si bazë thuhet për të gjitha studimet dhe doracakët e ngjashëm të mëvonshëm. Sidomos bën përshtypje fakti se en-Nebati e ka zhvilluar pavarësisht metodën vetjake shkencore, e cila deri sot ka mbetur në thelb e pandryshueshme. Në bazë, metoda përbëhej nga zhvillimi i teknikave empirike dhe eksperimentale të verifikimit (testimit), përshkrimit dhe identifikimit të cilësive farmaceutike dhe efekteve medicinale të bimëve, gjatë të cilave me kujdes janë ndarë dhe veçanërisht janë klasifikuar raportet e paverifikuara, nga njohuritë e vërtetuara me teste dhe kundrime. Kështu është formuar njëra prej përmbledhjeve më të mëdha të këtij lloji me rreth 1.400 lloje bimësh, ushqimesh dhe pijesh, e cila, në pajtim me standardet metodologjike, është përcjellë me besnikëri në këtë kompendium botanik, farmaceutik dhe medicinal, botuar më 1277. Libri me shekuj ka mbetur autoriteti suprem si për grumbulluesit e bimëve, ashtu edhe për ekspertët farmaceutikë e medicinalë,

¹⁰⁹ "Theory and Observation in Medieval Astronomy", *Isis* 63 (1): 39–47 [40–41]. *Sabra, A. I.* (Spring 1967), "The Authorship of the Liber de crepusculis, an Eleventh-Century Work on Atmospheric Refraction", *Isis* 58 (1): 77–85 [77],

respektivisht për autorët e librave të ngjashëm, kurse në të për herë të parë janë identifikuar, përshkruar dhe verifikuar cilësitë e më shumë se 300 bimëve deri atëherë plotësisht të panjohura në farmakope. Në pjesën islame të Europës së atëhershme, libri ka qenë i njohur me titullin burimor *Kitab el-Xhami fi el-Edvija el-Mufrede*. Qysh në fillim të shekullit XV, është përkthyer në pjesë disa herë në gjuhën latine, ndërsa botimi integral në gjuhën latine është botuar në vitin 1758, duke u bërë kështu doracaku më ndikues i botanikës dhe i farmaceutikës në truallin e Europës.

Gjeografia dhe kartografia

Madhësia e territoreve në të cilat muslimanët kanë mundur të lëviznin lirisht gjatë Mesjetës së hershme, në epokën e ngritjes së Al-Andaluzisë, në çdo aspekt ka sjellë një njohje të mirë të veçorive topografike dhe përpilim të saktë të hartave. Njeriu është i lidhur thelbësisht me konceptin e *Rrugës*, kurse rëndësia e saj metafizike dhe filozofike në mënyrë komplementare është plotësuar me traditën të jetës së theksuar nomade dhe me tregtinë mjaft të zhvilluar. Krahas të gjitha këtyre, detyra e haxhit, kishte kuptimin se muslimanët një herë në vit vendosin të udhëtojnë për në Mekë, pa marrë parasysh ku jetojnë, kurse kjo, me fjalë të tjera, kishte kuptimin e mijëra kilometrave larg. Tregtia e botës muslimane qysh më herët qe vendosur edhe me Indinë, Kinën e praktikisht me tërë Europën, larg nga kufijtë e shtetit të tyre europian të Al-Andaluzisë. Në këtë aspekt gjithashtu duhet vënë në dukje kontributi i madh, të cilin muslimanët e kishin dhënë në fushën e hartografisë për rrugët e tyre detare. Në këtë pikëpamje, krahas hartave të shumta të Mesdheut, bregut lindor të Afrikës, Indisë dhe Gjirit Per-

sik, të cilat i kanë vizatuar detarët muslimanë, deri sot ka mbetur plotësisht e paqartë saktësia e habitshme e zonave hartografike të Amerikës Jugore dhe Antarktikut në kartat e detarit osman Piri Reisit, të cilat në atë kohë kanë qenë plotësisht të panjohura për Europën kristiane!¹¹⁰ Gjithashtu, ekspertët detarë pajtohen se karavelat portugeze, anijet të cilat me konstruksionin e tyre kanë mundësuar udhëtime përtej deteve dhe përtejoqeanike, kurse të cilat kanë shërbyer edhe në të tri udhëtimet e Kolumbit deri në Trinidad, përkatësisht në Kubë, në pjesën më të madhe janë frymëzuar me lëndën e anijeve *qariban*, e me to kanë lundruar në udhëtimet e tyre të largëta tregtarët dhe hulumtuesit nga Europa islame qysh në fillim të shekullit XIII.

Mjekësia

Dijet mjekësore, karakteristike për popujt nomadë, kanë qenë të zhvilluara mjaft te muslimanët qysh në kohën e theme-limit të shtetit të parë european musliman. Udhëtimet e përherëshme, luftërat, sëmundjet infektuese, e kanë fuqizuar nevojën për dije të tilla në mënyrë plotësuese. Në kohën e jetës së qëndrueshme dhe të organizuar mirë, këto dije janë plotësuar në spitale të shumta, dhe janë transmetuar në doracakë dhe libra të shumtë, të cilët me shekuj janë shfrytëzuar në tërë Europën si burime të sigurta të dijes dhe në diagnostikë e në terapi të shumë sëmundjeve. Autorët më të njohur të këtyre doracakëve të tillë në periudhën e shekullit XII-XIII, kanë qenë ez-Zehravi

¹¹⁰ Përmbledhja e hartave detare të Piri Reisit, me titull *Kitab-i Bahrije*, sikurse tashmë kemi thënë, plotësisht e pashpjeguar deri tani, ka frymëzuar deri sot autorët të ngrenë hipotezën për vizitorët jashtëtokësorë, që për herë të parë ka propozuar Erih fon Deniken. Sidoqoftë, ekspertët e qendrës NASA, janë pajtuar se harta e Antarktikut në këto harta është aq e saktë sikur të jetë incizuar nga sateliti prej lartësisë 20.000 km.

(Ebu el-Kasim ez-Zehravi, në përkthimet latine i transkriptuar si Abulkasis), i cili ka shkruar *Kitab et-Tasrif*, enciklopedia mjekësore në 30 vëllime (e cila në përkthimin latin menjëherë në tërë Europën u bë burim i pazëvendësueshëm dhe i detyrueshëm i informacioneve në të gjitha institucionet mjekësore), si kurse edhe Ibn Zuhejri (latinisht Avenzoar), i cili bëri një hop të fortë në përparimin e dijeve nga kirurgjia.

Psikologjia dhe sociologjia

Më i njohuri sipas dijeve të tij për anatominë e trupit njerëzor dhe ndërhyrjet inovative në kirurgji, për ç'arsye edhe është quajtur *babai i kirurgjisë moderne*, ez-Zehravi (Abulkasis) ka kryer edhe një varg zbulimesh mjaft të rëndësishme në neurologji, kurse njëkohësisht ka disejnuar instrumente speciale dhe ka zhvilluar teknikat e ndërhyrjes, të cilat edhe sot përdoren në neurokirurgji. Edhe kolegu i tij kirurg, Ibn Dhuhri (Avenzoar) ka dhënë ndihmesë sa në mjekësinë moderne, aq edhe në psikologjinë bashkëkohore. Në veprën e specializuar nga fusha e fiziologjisë së njeriut, Ibn Dhuhri ka dhënë përshkrimin e parë të saktë të çrregullimeve neurologjike, dhe këtë për diagnozat e rënda sikurse janë meningiti, tromboflebiti, tumoret mediastinale të qelizave, krahas kontributit të rëndësishëm edhe në neurofarmakologjinë bashkëkohore. Averroesi, edhe pse filozof dhe astronom, gjithashtu ka çuar përpara edhe dijet mjekësore dhe psikologjike. Ai i pari e ka përshkruar simptomatologjinë dhe ka propozuar që të futet në regjistrin e sëmundjeve të njohura gjendja e cila sot quhet Sëmundja e Parkinsonit, ndërsa në fiziologji në mënyrë eksperimentale ka dëshmuar kapacitetin fotoreceptiv të retinës. Filozofi hebre i asaj kohe, Mozes Maimonides, ka shkruar edhe për çrregulli-

met neuropsikiatrike, sikurse i ka përshkruar saktë fazat e tërbimit dhe të helmimit me beladonë.¹¹¹

Në fushën e sociologjisë, njëri nga emrat e parë në historinë e saj dhe nga vetë fillimi, gjithsesi me të drejtë i përket Said el-Endelusiut (1029-1070). Ky sociolog natyrisht i talentuar, ka vërejtur se njerëzit, edhe pse i përkasin gjinisë unike të qenieve të gjalla, megjithatë dallojnë mjaft qartë sipas disa përcaktimeve konstante, sikurse janë zakonet, morali, gjuha, dhe se këto dallime duhen përshkruar *sa dallimeve nga terreni dhe klima në të cilën jetojnë, aq edhe dallimeve në raportet e tyre shoqërore*. Këtë vrojtim të tij të theksuar sociologjik, el-Endelusi u ka zhvilluar në një lloj teorie për gjenezën sociale dhe historike të arabëve të Afrikës, duke sugjeruar se ata janë pasardhës të Ibrahimit (Abrahamit, Avramit) dhe Haxheres (Hagare), të dalë nga i biri i tyre Ismaili, të cilët më vonë nëpërmjet Sudanit dhe Egjiptit, janë përhapur edhe në pjesët veriore të Afrikës, e gjithashtu edhe në Gadishullin Iberik në Al-Andaluzi.

Agrikultura

Kontribut sidomos të rëndësishëm shoqërisë moderne europiane, shteti i parë islam evropian i ka dhënë botës në fushë e agrikulturës, dhe këtë si tërthorazi në kontakt të gjerë, ashtu edhe drejtpërdrejt në kuptimin pragmatik dhe special. Me fjalë të tjera, Al-Andaluzia është vendi i parë evropian, i cili i pari ka futur sistemin thelbësisht të ri bujqësor në suaza të jetës ekonomike të një shteti, sipas të cilit janë ndërtuar edhe sistemet bujqësore të të gjitha shteteve moderne në Europë dhe botë. Me

¹¹¹ Martin-Araguz, A.; Bustamante-Martinez, C.; Fernandez-Armayor, Ajo V.; Moreno-Martinez, J. M. (2002). "Neuroscience in Al-Andalus and its influence on medieval scholastic medicine", *Revista de neurologia* 34 (9), pf. 877-892.

fjalë të tjera, risia bëhej në riorganizimin radikalisht të ri dhe shumë më efikas të modelit të mëparshëm të trashëguar nga romakët. Ndërhyrja ka filluar me futjen e zekatit, me çka shkallë-shkallë është thyer sistemi i pronave të mëdha në mënyrë monopolistike, të kontrolluara nga fisnikëria feudale, i cili me shekuj ka bllokuar zhvillimin e ekonomisë rurale.¹¹² Në nivel të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në teknikat tradicionale të bujqësisë, në këtë shtetin e parë musliman europian, është shfrytëzuar me të madhe sistemi i zhvilluar i ujitjes, i bazuar në njohjen e shkëlqyeshme dhe shfrytëzimin e shkathët të ligjeve të hidraulikës dhe hidrostatikës, i cili zonat deri atëherë të shkreta dhe jopjellore të kësaj pjese të Europës shpejt i ka shndërruar në sipërfaqet më të bukura pjellore të punuara nën drithëra dhe me perimet e llojlojshme me shumicë, me pemishtet më të mira të rregulluara në botë, ku vjeleshin frytet më cilësore, nga të cilat disa nuk mund të gjendeshin në asnjë vend tjetër në Europë. Shkalla shumë e lartë e përpunimit të tokës ka dhënë rendimente jashtëzakonisht të larta, në çdo rast shumë mbi mesataren europiane, që shpejt do të sillte deri te krijimi i prodhimit të parë europian kontinental. Prodhimet e bujqësisë së Al-Andaluzisë janë eksportuar jo vetëm në të gjitha anët e halifatit, por edhe në të gjitha zonat e Europës Perëndimore, në të cilën prodhimet bujqësore qenë rrëgjuar kryesisht në drithëra, përbri rendimenteve përpjesëtimisht shumë më të ulëta se sa në pjesën e saj islame.

Krahas llojeve tashmë të njohura të pemëve dhe perimeve, nga ky shtet europian islam në pjesën e mbetur të Europës janë eksportuar lloje të panjohura deri atëherë të perimeve dhe

¹¹² Më hollësisht shih në studimin klasik të ekonomisë politike: Adam Smith (1776) *The Wealth of Nations*, Book 3, chapter 2: "Of the Discouragement of Agriculture in the Ancient State of Europe after the Fall of the Roman Empire". Këtu është theksuar botimi i vitit 1963, London, UK.

pemëve, sikurse janë kallami i sheqerit, orizi, limoni i ëmbël, mandarinat, pjeshkat, kajsitë, pambuku, shafrani dhe të tjera. Një pjesë të këtyre bimëve bujqësore të cilat në truallin e Europës i sollën muslimanët e Al-Andaluzisë, më vonë kolonizatorët spanjollë i mbollën në Botën e Re. Edhe themelimi i industrisë së mëndafshit, sikurse edhe zhvillimi i saj i shpejtuar në truallin e Europës, përdorimi i lirit dhe kultivimi i disa lloj frutash të egra, disa me shartim e disa me përzgjedhje në kultivim, janë rezultate për të cilat e falënderojmë këtë shtet islam evropian. Ky proces nuk ka qenë as i lehtë, e në shumë raste as i parrezikshëm. Disa kultura kanë qenë rreptësisht të mbrojtura dhe nën kërcënimin e dënimeve serioze ndalohej të mbilleshin jashtë territoreve të caktuara. Nga ana tjetër, shumë nga këto kultura të reja kanë mundur të pranohen dhe zhvillohen vetëm falë nivelit mjaft të lartë të teknologjisë bujqësore që zotëronin bujqit e atëhershëm prodhues. Gjithashtu, disa lajthitje laikisht të bazuara në *“bazën pa themel”* që mund të thuhet, sikurse është pohimi se *“muslimanët e Spanjës e kanë çrrënjosur hardhinë, për ndalimin e përdorimit të verës”*, siç mund të hasen në librat e shumë të shkruar në mënyrë diletante nga historia dhe në doracakë të popullarizuar, jo vetëm që njëmendësisht nuk kanë kurrfarë bazash reale, por realiteti është pikërisht i kundërt. Në kohën e shtetit islam të Al-Andaluzisë, vreshtaria në Spanjë ka përjetuar lulëzim të mirëfilltë! Ushqimi tejet cilësor dhe më ushqyes, nga të dyja anët, ka pasur efekt jashtëzakonisht të favorshëm për ngritjen e nivelit shëndetësor dhe të aftësisë së tyre shumë më të madhe punuese, që ka ndikuar mjaft favorshëm edhe në nivelin e përgjithshëm të vitalitetit të popullsisë të kësaj pjese të Europës.

Trashëgimia kulturore

Arkitektura

Për veçoritë dhe cilësitë e arkitekturës islame është shkruar mjaft, e këtu duhet pasur parasysh se arkitektura islame e Al-Andaluzisë zë vend të veçantë. Në vijat më të shkurtra, fjala është për arkitekturën mjaft funksionale, estetikisht të pëlqyeshme dhe të rafinuar, me elementet e akcentuara të përkatësisë kulturore dhe fetare. Çiltërsia dhe toleranca e Islamit kanë çelur hapësirë edhe për sinteza krijuese në të cilat e kanë gjetur vendin e vetë edhe shumë ndikime dhe tradita të tjera kulturore, nëse kjo ndërtuesve u dukej e përshtatshme. Pikërisht për këtë arsye, arkitektura islame karakteristike për shtetin e parë islam të Europës, unifikon shumë elemente të ndërtimtarisë tradicionale arabe, por përfshin gjithashtu edhe elemente të rëndësishme të traditës së ndërtimtarisë bizantine dhe vizigote. Në këtë mënyrë është zhvilluar një lloj ndërtimi i veçantë, origjinal, i cili ka mbetur i pranishëm në Spanjë edhe pas rënies së shtetit islam, kurse është ruajtur në shumë elemente dhe hollësi deri më sot. Për fat të keq nga ai janë ruajtur godina të pakta origjinale, sikurse janë Xhamia e Madhe e Kordobës dhe pallati Al-Rustafa, ndërsa mijëra godina të jashtëzakonshme janë rrafshuar me tokën pas fitores së Rokonkuistes. Stili arkitektonik islam i zhvilluar në truallin e Spanjës dhe Portugalisë së sotme ka ndikuar fuqishëm edhe në ndërtimin e kishave katolike dhe sinagogave hebraike, sikur edhe të pallateve, kështjellave dhe sarajeve të mbretërve e bujarëve kristianë. Është quajtur mosarabik (*mosarabic*), kurse virtytet e tij specifike janë mungesa e dekorimeve të jashtme, llojllojshmëria e planeve të dhomave të brendshme dhe planeve të oborreve, harqeve në stilin karakte-

ristik islam, sikurse edhe kolonadat me arkitrarë të zbukuruar me motive lulesh dhe bimësh, me përdorimin intensiv të arabeskave dhe figurave gjeometrike në tavane.

Kuzhina

Krahas dhjetëra lloje specialitetesh gatimesh, dhe po aq lloje erërash dhe përbërjesh në gjellë, tradita gastronomike e Al-Andaluzisë ka futur drejtpërdrejt në traditën europiane dhe ka standardizuar drekën klasike trepjesëshe, e cila sot zbatohet që nga drekat familjare deri te ato më solemne shtetërore kudo në botë. Sipas kësaj recete, dreka e mirëfilltë duhet të shërbehet në tri sekuenca: së pari supa, gjella kryesore dhe në fund ëmbëlsira. Të gjitha variacionet e mëvonshme me aperitivë, djathëra, kafe apo me disa digjestivë të tjerë, vetëm janë plotësime të kësaj shujte klasike të përbashkët si sinonim të intimes familjare dhe komunikimit social, që në shekullin IX në Kordobë e ka vendosur njëfarë Zirjabi, kurse sot gjithsesi është zakoni më i shtrirë kulinar në botë.¹¹³

Gjuha dhe literatura

Nga vargu i veprave të rëndësishme letrare dhe poetike të letërsisë islame nga koha e Al-Andaluzisë, do t'i veçojmë vetëm dy më të njohurat. I pari është romani filozofik tashmë i theksuar i Ibn Tufejlit, *Hajj ibn Jakdhan*. Në pajtim me teorinë të cilën i pari e ka formuluar Ibn Sinai (Avicena), për vetëdijen njerëzore si një lloj *faqeje të bardhë (tabula rasa)*, Ibn Tufejli ka

¹¹³ Për elementet kulinarike por edhe shumë të tjera të trashëgimisë kulturore të shtetit të parë evropian islam, shih: Salma Khadra Jayyusi and Manuela Marin (1994), *The Legacy of Muslim Spain*, Brill Publishers, f. 117.

shkruar romanin për djaloshin, i cili rritet plotësisht i vetmuar në ujdhesën e shkretë, i izoluar nga të gjitha ndikimet shoqërore, dhe megjithatë arrin njohjen në thelbin e ekzistimit dhe vlerës më të lartë të jetës njerëzore. I përkthyer në gjuhën latine në vitin 1671 nga Edvard Pokoku (Edward Pocock Junior), me titullin *Philosophus Autodidactus*, ky roman e ka frymëzuar drejtpërdrejt Xhon Lokun (John Locke) të formulonte teorinë e tij mbi empirizmin gnoseologjik, të zhvilluar dhe të paraqitur në veprën e tij kryesore *Diskutimi për të kuptuarit njerëzor* (*An Essay Concerning Human Understanding*), e cila më vonë ka ndikuar fuqishëm në qëndrimet filozofike të Xhorxh Berklejit (George Berkeley) dhe Dejvid Hjumit (David Hume), me çka ka përcaktuar zhvillimin e mëtejshëm në Europën Perëndimore, duke e nxitur shfaqjen e Iluminizmit edhe në ujdhesën britanike, edhe në Europën kontinentale.

Vepra e dytë e letërsisë islame nga koha e Al-Andaluzisë, të cilën do ta theksojmë, i përket zhanrit të romancave romantike, e cila sigurisht për herë të parë edhe ka lindur pikërisht në truallin e kësaj kulture dhe shumë shpejt nëpër tërë Europën nëpërmjet trubadurëve, ministrelëve, këngëtarëve popullorë dhe autorëve më të llojlojshëm të epëve dhe poemave. Fjala është për veprën anonime nga fillimi i shekullit XIII, të lindur në Kordobë, me titull *Tregimi për Bajadin dhe Rijaden* (*Hadith Bajad ve Rjad*), kurse personazhet kryesore janë i biri i ri dhe tërheqës i tregtarit nga Damasku, Bajadi, i cili me babanë qëndron në Kordobë, dhe Rijada, vajza tejet e bukur dhe mjaft e arsimuar në pallatin e njëfarë veziri. Me sa dihet, ky dorëshkrim është vepra e vetme e ruajtur e ilustruar nga tërë prodhimi letrar gjatë tetë shekujve të ekzistimit të këtij shteti evropian islam.

Përkthimet

Toleranca kulturore e shoqërisë islame, si shenjë e saj dalluese, ka hapur gjerësisht dyert e përkthimit të veprave të kulturave të tjera dhe këtë në një vëllim absolutisht të paimagjinueshëm deri atëherë. Si shkolla më e njohur, është dalluar Shkollja për përkthime dhe përkthyes e Toledos, e themeluar më 1085 në qytetin Toledo (arabisht Tulejtuh), me çka shumë vepra të filozofëve, shkencëtarëve dhe autorëve islamë janë bërë të kapshme për shkencëtarët dhe opinionin intelektual në pjesët e tjera të Europës. Duke marrë parasysh faktin se mendimi shkencor dhe filozofik, sikurse edhe prodhimi letrar, ka qenë shumë më i zhvilluar në pjesën muslimane të Europës së atëhershme, është e qartë se pjesa dukshëm më e madhe ka përfshirë veprat e autorëve muslimanë dhe hebrenj në gjuhën arabe dhe hebraike, të cilat nga gjuha arabe janë përkthyer në gjuhën latine. Është ruajtur emri i njërit prej përkthyesve më produktivë dhe më të gjallë të kësaj shkolle. Ishte ky Gerardi nga Kremona, i cili ka përkthyer madje 87 vepra nga gjuha arabe në gjuhën latine që prej studimeve astronomike, matematike, algjebrike, optike deri te ato nga kimia, mjekësia, botanika dhe filozofia. Me rënien e shtetit të fundit islam në këtë pjesë të Europës, (Emiratit të Granadës në vitin 1492), mendimi islam filozofik dhe shkencor, sikurse edhe të arriturat teknologjike në të gjitha fushat, nga agronomia deri te astronomia, kanë qenë tashmë thellë të mbushura dhe asimiluara nga pjesa kristiane e Europës, dhe kjo aq mirë saqë shpejt gati krejtësisht është harruar prejardhja e tyre e mirëfilltë.¹¹⁴

¹¹⁴ Për këto procese hollësisht shih te: *Edward Grant* (1996), *The Foundations of Modern Science in the Middle Ages: Their Religious, Institutional, and Intellectual Contexts*, Cambridge: Cambridge University Press.

Muzika

Konsiderohet se zëri i më se njëzet instrumenteve muzikore deri atëherë të panjohura në Europë, të cilat janë përdorur në Al-Andaluzi, qoftë ka ardhur me banorët e parë të këtij shteti evropian, apo gjatë pranisë së tyre me shekuj janë ndër-tuar në truallin e tyre, e për herë të parë janë shfaqur në Evropë, pikërisht me meritën e tyre. Për këto instrumente ekzistojnë studime të shumta jashtëzakonisht kompetente¹¹⁵, ndërsa është fakt përgjithësisht i njohur se flamengoja spanjolle në të gjitha elementet instrumentale dhe koreografike-vallëzuese në masë të madhe është frymëzuar nga arti performativ që kanë vepruar në traditën e artistëve islamë andaluzianë.

Vorbëria (poçaria)

Me sa dihet, zmallti metalik i qeramikës për herë të parë është zbuluar në shekullin VIII në qytetin e Basrës, në halifatin e atëhershëm të Bagdadit. Nga Iraku kjo teknikë shkallëshkallë është përhapur drejt lindjes, së pari në Persi, e pastaj drejt perëndimit, në Egjipt, prej nga arriti në truallin e Europës nëpërmjet shtetit të parë evropian islam të Al-Andaluzisë. Pas pak kohësh (në fillim të Rilindjes së hershme), nëpërmjet tregtarëve dhe zejtarëve, është përhapur në Itali, e prej këtu në Çeki (Bohemi), Holandë, Angli, Francë, Gjermani dhe vendet e tjera evropiane. Veçantia e qeramikës nga trualli spanjoll, e quajtur *Hispano-Morescque*, të zbuluar në Kordobë në shekullin XI, dallohej nga qeramika e pjesëve të tjera të Europës, si me më pak elemente teknike në prodhim dhe në rezultatin final, ashtu edhe në karakterin e dekoracionit. Veçoritë teknike (shkëlqimi

¹¹⁵ Sidomos rekomandojmë librin tashmë të përmendur të Edvard Grantit (1996).

sidomos i lartë) dhe teknologjike të kësaj mënyre të prodhimit të qeramiks së cilësisë më të lartë, më vonë nëpërmjet Al-Andaluzisë janë përcjellë në Malagë, prej nga kanë arritur në Itali, ku prodhimi më tipik i kësaj mënyrë të punimit të lëndëve qeramike janë *albarello*, shishet (bocelat) prej qeramike të farmacisë dhe enët nga majolike, të cilat edhe sot konsiderohen të pazëvendësueshme për ruajtjen dhe depozitim të përhershëm të ilaçeve dhe preparateve të tjera farmaceutike, do të përcillen në Evropë në shekullin XV nga tregtarët muslimanë.

Trashëgimia teknologjike

Rëndësia kyçe e ujit për kulturën islame është fakt i mirënjohur. Obligimi i muslimanëve për të mbajtur higjienën e përditshme, që përfshin pastrimin ritual, abdestin, pesë herë në ditë, para çdo lutjeje, përbën një ilustrim të mjaftueshëm të vendit të lartë që uji zë në jetën e tyre. Në sociologji, për shoqëritë islame madje është farkuar term i veçantë: *Shoqëritë e bazuara në parimin e ujit - Les societe hidralique*. Së këndejmi, nuk duhet të na habisë kontributi i madh që muslimanët dhanë në përdorimin e ujit, respektimin e higjienës dhe energjisë së ujit.

Ndër risitë më të njohura teknologjike që Europa kristiane i ka pranuar nëpërmjet shtetit evropian islam të Al-Andaluzisë, gjithsesi bëjnë pjesë të gjitha llojet e mullirit. Këtu janë mullinjtë me ujë, të cilët përdorin rënien natyrore me ujë të rrjedhshëm, pastaj mullinjtë me erë (të zbuluar për herë të parë në qytetin Sistan, në Afganistan, ndërmjet shekullit VII dhe IX), të vënë në lëvizje me fuqinë e erës, si dhe mullinjtë që kanë përdorur rënien e ujit në kuadër të urave më të mëdha, po ashtu mullinjtë për imtësimin dhe bluarjen e shkëmbinjve të pasur me xehe, deri te mullinjtë për bluarjen e rafinuar të arit si pluhur ari.

Gjithashtu, një numër më i madh llojesh të pendave të ujit, (arabisht: *damdam*, prej nga ka hyrë në anglisht “dam” – “penda”), sistemet ujitëse dhe rrjeti i ujësjellësit në qytete, kanë përjetuar lulëzim të mirëfilltë dhe ringjallje teknologjike në kohën e Al-Andaluzisë. Madje edhe sot në disa pjesë të Europës, në të cilat kultura islame ka qenë më gjatë e pranishme, sikurse janë Sicilia, Andaluzia, Aragona, Valencia dhe Granada, është ruajtur i njëjti sistem i ujitjes si dukshëm më racional dhe më efikas. Në Ujdhesat e Kanarieve, sikur edhe në Teksas, New Mexico, Meksiko, Peru dhe Kili, edhe sot zbatohet sistemi ujitës i Al-Andaluzisë, të cilën spanjollët e kanë përhapur në të gjitha pjesët e botës.

Qyteti i Kordobës ishte qyteti i parë në botë, i cili e futi sistemin e tërësishëm të ujitjes, me nyje sanitare, banjo publike, shatërvanët, çezmat me ujë të pijshëm, tualetet private dhe publike, madje edhe qyteti i parë me kuzhinë publike për mbeturina dhe hedhurina, sikur edhe me shërbimin e parë për hedhjen e mbeturinave dhe hedhurinave. Krahas faktit se Islami i pari e solli sapunin në Europë, kurse në Kordobë të asaj kohe bëheshin sapunët më të mirë dhe më aromatikë në botë (vlen të theksohet: dhe askund në tjetër vend në Europë!), mund të kuptohet krejtësisht entuziazmi dhe tmerrin e udhëtarëve të ardhur nga qytetet e tjera të Europës së atëhershme, pa kanalizim, pa nevojtoje si publike ashtu edhe private, pa ujësjellës të qytetit, me grumbuj mbeturinash, të ballafaquar me atë qytet të pastër përplot ujë të kthjellët në çdo hap.

Aeronautika

Sipas përshkrimit të një bashkëkohësi, në vitin 852 në Kordobë një djalosh i guximshëm, me emrin Abas ibn Firnas, ka shpikur dhe për herë të parë ka përdorur një lloj parashuti. Ka kërcyer

nga kulla më e lartë në Kordobë dhe me sukses është lëshuar në tokë me lëndime të lehta.¹¹⁶ Po ky Ibn Firnasi e ka bërë edhe fluturimin e parë të kontrolluar, (fluturimet para kësaj të regjistruara në Kinë, nuk kanë mundur të kontrollohen) kështu që ka punuar me dy dorëza për kontrollimin e lartësisë dhe ndryshimin e drejtimit. Sipas dëshmisë së bashkëkohësve Ibn Firnasi në fluturim të pandërprerë është kthyer me sukses në vendin nga i cili ka fluturuar, edhe pse gjatë uljes fatkeqësisht e ka humbur jetën. Makina e tij fluturuese i ka sjellë *titullin e njeriut të parë në histori, i cili ka kryer orvatje fluturimi shkencërisht të bazuar*.¹¹⁷

Trashëgimia gjenetike e shtetit të parë evropian musliman

Ekzistojnë studime të shumta të gjenetikanëve të cilët vënë në dukje praninë gjenetike të popullatës arabe dhe hebraike dhe gjeneve të spanjollëve dhe portugezëve modernë. Si studimi më i themeltë i punuar dhe më i vëllimshëm konsiderohet studimi nën udhëheqjen e Kapellit (Capelli), i përfunduar në vitin 2009, i cili drejtpërdrejt e konfirmon praninë e haplogrupeve mashkullore karakteristike për arabët e Afrikës Veriore, sidomos E1b1b1b (E-M81), E1b1b1a-b (M78 kromozomeve të derivuara të cilët e detektojnë ekzistimin e kromozomeve të rralla DYS439 allele 10, përkatësisht E-V65) si në subsnop J1 (M267 i derivuar), mesatarisht i pranishëm me 7-8% të popullsisë së sotme mashkullore të Gadishullit Iberik.¹¹⁸

¹¹⁶ Theks të zgjeruar të këtij dëshmimi shih te: John H. Lienhard, *The Engines of Our Ingenuity*. Houston. 2004.

¹¹⁷ Shih: Poore, Daniel. *A History of Early Flight*. New York: Alfred Knopf, 1952, sikurse edhe: Smithsonian Institution. *Manned Flight*. Pamphlet 1990.

¹¹⁸ Sipas: Capelli, C; Onofri, V; Brisighelli, F; Boschi, I; Scarnicci, F; Masullo, M; Ferri, G; Tofanelli, S et al. (Jun 2009). "Moors and Saracens in Europe: estimating the medieval North African male legacy in Southern Europe". *European Journal of Human Genetics* 17 (6): 848–52.

Pasqyra e historisë së pranisë të DW afrikane në Gadi-shullin Iberik, (Capelli, 2009)

Gjendja	N	E1b1b1b (M81)	E1b1b1a-b (V65)	J1 (nëngrupi)	gjithsej %
Spanja	717	5.2	1	1.5	7.7
Portugalia	659	5	0.3	1.8	7.1
Iberia	1376	5.1	0.7	1.7	7.4

Bibliografia themelore

1. Alfonso, Esperanza, 2007. *Islamic culture through Jewish eyes: al-Andalus from the tenth to twelfth century*. New York, NY: Routledge. ISBN 978-0-415-43732-5
2. Al-Djazairi, S.E. 2005. *The Hidden Debt to Islamic Civilisation*. Bayt Al-Hikma Press. ISBN 0-9551156-1-2
3. Bossong, Georg. 2002. Der Name *Al-Andalus*: Neue Überlegungen zu einem alten Problem. In David Restle and Dietmar Zaefferer, eds, *Sounds and systems: studies in structure and change. A festschrift for Theo Vennemann*. Berlin: Mouton de Gruyter. pp. 149–164. (In German) Also available online: see External Links below.
4. Cohen, Mark. 1995. *Under Crescent and Cross: The Jews in the Middle Ages* Princeton University Press. ISBN 0-691-01082-X
5. Collins, Roger. 1989. *The Arab Conquest of Spain, 710–797*, Blackwell. ISBN 0-631-19405-3
6. Glick, Thomas (1999). "*Islamic and Christian Spain in the Early Middle Ages: Comparative Perspectives on Social and Cultural Formation*".
7. Marín, Manuela et al., eds. 1998. *The Formation of Al-Andalus: History and Society*. Ashgate. ISBN 0-86078-708-7
8. Netanyahu, Benzion. 1995. *The Origins Of The Inquisition In Fifteenth Century Spain*. Random House ISBN 0-679-41065-1
9. Omaar, Rageh. 2005. An Islamic History of Europe. video documentary, BBC 4, August 2005.
10. Roth, Norman. 1994. *Jews, Visigoths and Muslims in Medieval Spain: Cooperation and Conflict*. Leiden: Brill. ISBN 90-04-06131-2

V. ISLAMI NË BALLKAN

Identiteti islam i Europës sot është fakt i pamohueshëm. Kultura, të gjitha format e përshpirtshmërisë, ekonomia, politika, institucionet politike, struktura demografike, shkurtimisht tërësia e jetës shoqërore dhe tërë realiteti i Europës, janë të përshkuara thellë me Islam, kështu që shpesh është e pamundur të dallohen nuancat kristiane, islame dhe hebraike, organizisht të rritura në strukturën e saj. Proceset e formimit të identitetit islam të Europës kanë filluar së pari në juglindjen e skajshme të kontinentit, konkretisht në territorin e Gadishullit Iberik, të Francës jugore, Italisë veriore dhe në pjesë të Zvicrës jugore, si dhe në ishujt e mëdhenj në tërë Mesdheun, kurse nëpërmjet institucioneve të shtetit të organizuar islam kanë zgjatur prej vitit 711 deri më 1492, pra plot 781 vjet. Rajonin e dytë të madh të ardhjes masive të qytetërimit islam në truallin e Europës e përbën Gadishulli Ballkanik në tërësi. Edhe pse shteti osman pa dyshim është faktori më i rëndësishëm në proceset e përvetësimit sistematik të Islamit në identitetin kulturor të Europës në këto hapësira, megjithatë, madje edhe në qarqet shkencore, është rrënjësor thellë lajthitja për koincurrencën kronologjike të fillimit të këtij shteti të fuqishëm të Europës mesjetare dhe fillimit të përhapjes së Islamit në Ballkan! Hulumtimet më të reja pa mëdyshje kanë vërtetuar se Islami ka filluar të lëshojë rrënjë në mesin e popullatës së Gadishullit Ballkanik qysh gjatë shekullit VIII¹¹⁹, pra pesë shekuj para konstituimit të shtetit osman si shtet europian me rezidencë në qytetin Edrene, në juglindjen e skajshme të kontinentit.

¹¹⁹ Shih për këtë: Džavid Haverić, vepra e cituar, sikurse edhe një varg hulumtimesh të reja.

Fakti se Islami ka qenë i pranishëm në këtë pjesë të Europës thuhet në po atë kohë kur është formuar shteti i parë evropian islam në jug të Gadishullit Iberik, në mënyrë shtese fiton në rëndësi shpjeguese, kur lidhet me faktin se në Lindjen e skajshme të Europës, në viset e Kaukazit, Islami e ka ndërtuar shtetin e tij të parë qysh në gjysmën e dytë të shekullit VII (rreth vitit 660). Në dritën e këtyre të dhënave bëhet e evidente se Islami është pjesë imanente jo vetëm e historisë së Europës gjatë 13 shekujve të fundit në një pjesë të territorit të saj, por se është fakt i vazhdueshëm dhe vendimtar i po kësaj historie në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në hapësirën e madhe prej Gjibraltarit në juglindjen e skajshme deri te rrjedha e mesme e lumit Volga në veri dhe Kaukazit në lindje.

Hulumtimi sistematik dhe paraqitja objektive e pranisë së Islamit në historinë e Europës dhe efekteve të tij në konstituimin e identitetit modern evropian gjithsesi paraqet një prej detyrave urgjente dhe urdhrave të drejtpërdrejtë të historisë e shkencave të ngjashme shoqërore. Domethënia e hulumtimeve të këtilla i tejkalon mjaft larg suazat e drejtpërdrejta shkencore dhe drejtpërdrejt ndikon për respekt më të madh të ndërsjellë dhe për zbutjen e tensioneve fetare, etnike dhe ideologjike ndërmjet popullsisë joislame dhe islame si në Europë, ashtu edhe në botë! Në suaza të këtij studimi është bërë përpjekje që, nëpërmjet analizës fragmentare, ta pasqyrojë realitetin e identitetit islam të Europës në truallin e Gadishullit Ballkanik. Gjatë kësaj theksi është vënë në radhë të parë te demontimi i mitit dashakeq për islamizimin e dhunshëm, të konstruktuar në ideologjinë e anti-islamizmit të skajshëm, diskriminimit fetar dhe etnik, me synim realizimin hegjemonist të aspiratave të strategjisë nacionaliste. Përgënjeshtrimi i këtij falsifikimi ideologjik është imperativ absolut i epokës dhe çastit historik, si për tërë

Europën, ashtu së pari për vetë Gadishullin Ballkanik, si pjesë kyçe e kulturës, historisë dhe perspektivave të ardhshme të saj! Në një botë në të cilën gjenocidi fizik, e sidomos kulturor dhe fetar, thuhet se është praktikë rutinore e shteteve-pushtuese, e cila për disa dekada ka fshirë qytetërime, popuj, gjuhë dhe tradita të kontinenteve të tëra, është vetvetiu mahnitës fakti se pikërisht Ballkani është i vetmi territor në botë, në të cilin pushteti politik i shtetit-pushtues, gjatë tërë pesë shekujve ka lënë liri të plotë të zgjedhjes dhe praktikimit të identitetit fetar, gjuhësor dhe kulturor për të gjithë popujt, pa marrë parasysh në numrin e tyre!

Pikërisht për këtë duhet (dhe madje është e domosdoshme), në çdo rrethanë, sërish dhe sërish të kujtojmë, se pas largimit të shtetit osman islam nga pjesa më e madhe e Gadishullit Ballkanik, thuhet se gjithë, e edhe popujt më të vegjël, të cilët ishin nën sundimin e tij, kanë mbetur me fenë e tyre, me kulturën, gjuhën, me tempujt e tyre, kishat, manastiret, sinagogat, me shkollat e tyre, traditat, tregimet, mitet, këngët, shkurt, me mënyrën e tyre të plotë të paprekur të jetës. Duhet të jepet qartë e vërteta! Aq më tepër sepse është falsifikuar në mënyrë sistematike, ndërsa ky falsifikim ka krijuar shtresime të mëdha të mosmarrëveshjeve të thella dhe armiqësive të paarsyeshme ndaj muslimanëve autoktonë të Europës në territorin e Ballkanit! Toleranca, edhe si ide edhe si praktikë shoqërore dhe politike shtetërore, në Europë ka ardhur me Islamin! Tradita e jetës multikulturore, multifetare, multietnike e bashkësive me respekt të ndërsjellë dhe tolerancë të lartë, karakteristike për Ballkanin, në tërësi është rezultat i pranisë shumëshekullore të shtetit islam në këtë pjesë të Europës! Kjo traditë është krijuar falë shtetit osman të konceptuar mbi parimet e Islamit, dhe jo kundër tij! Miti tejet famëkeq i mosmarrëveshjeve dhe armiqë-

sive ballkanike, është rezultat i konflikteve, të cilat popujt ballkanikë i kanë filluar menjëherë pas ikjes së shtetit islam nga pjesa më e madhe e Ballkanit! Toleranca dhe respekti i bashkësive të ndryshme etnike, fetare dhe kulturore në Ballkan edhe sot është më e theksuar në rajonet në të cilat shteti islam osman ka qëndruar më së gjati. Praktika e de-islamizimit dhe asimilimit kulturor, nëpërmjet përndjekjes sistematike, kryqëzimit të dhunshëm dhe më shumë e episodeve të shpeshta të zhdukjes fizike të muslimanëve, të cilat herë-herë kulmonin në gjenocid, është karakteristikë pa përjashtim vetëm për shtetet jo-islame të Ballkanit, dhe absolutisht mungon nga praktika e shtetit islam osman!

Së këndejmi, në suaza të këtij studimi, vëmendje e veçantë u është kushtuar, pikërisht motiveve të pranimit vullnetar, por edhe mospranimit të Islamit të popujve autoktonë europianë, të cilët jetojnë në Gadishullin Ballkanik, sidomos shqiptarëve dhe boshnjakëve, si popujve të parë europianë të cilët e kanë pranuar Islamit në shumicë të konsiderueshme. Motivet vendimtare që një pjesë e popullsisë, e ballafaquar me mundësinë e përzgjedhjes plotësisht të lirë, të vendosë që të mos pranojë Islamit, sado kjo të duket e çuditshme, deri më sot nuk kanë qenë objekt i asnjë të vetmi shqyrtim shkencor!? Kuptohet se konstatimi i lëshimit kështu sistematik të përhershëm dhe krahas kësaj në mënyrë metodologjike të palejueshme, vetvetiu ka qenë arsye e mjaftueshme që këtij problemi t'i qasemi seriozisht dhe me vëmendje të plotë. Synimi themelor i qasjes së kështillë ka qenë i qartë. Nga konstatimi i parimeve themelore të vepërimit të shtetit osman, si forma të shtetit islam të vendosura në Europë, raportit të tij ndaj pjesëtarëve të feve, kulturave dhe etnive të ndryshme, sikur edhe trajtimit të të gjithë banorëve të cilët nuk i përkisnin profilit kulturor, etnik dhe fetar të këtij shteti, sidomos në shembullin e shqiptarëve dhe boshnjakëve, do të

rindërtohet karakteri autentik i procesit të pranimit dhe mospranimit të Islamit, dhe me këtë, në bazë të lëndës objektive empirike, formulohet e vërteta historike. Afirmimi i kësaj të vërtete do të ketë karakter si shkencor, pra rigorozisht teorik, ashtu edhe shoqëror, në mënyrë parësore efekt pozitiv në përmirësimin rrënjësor të raporteve kulturore, fetare dhe etnike (nacionale) ndër popujt e Ballkanit dhe në respektimin e tyre të ndërsjellë!

V.I. Shqiptarët dhe boshnjakët – popujt autoktonë europianë islamë

V.I.1. Shqiptarët

Frika nga sprovat e afërsisë

Për shqiptarët dhe boshnjakët nuk mund të flitet sikurse për *popujt e islamizuar*. Fakti se edhe hebraizmi, edhe kristianizmi edhe Islami janë fe të lindura jashtë truallit europian, automatikisht e heq të drejtën për secilin nga këto tre fe që të ngrihet, qoftë kronologjikisht, qoftë politikisht, mbi dy të tjerat. Me fjalë të tjera, pa marrë parasysh se cilën fe e pranojnë sot, të gjithë popujt europianë, e prandaj edhe Europa në tërësi, në kuptimin e rreptë të identitetit të tyre aktual, e kanë arritur me aktin e pranimit të njëres prej tri feve joeuropiane, dhe se, për më tepër, të gjithë dikur janë të *judeizuar*, *kryqëzuar*, *islamizuar*. Tashmë është thënë mjaft për këtë temë dhe duke kujtuar edhe një herë faktin se pranimi i Islamit për popujt europianë në asgjë nuk është thelbësisht ndryshe nga pranimi i fesë hebraike apo kristiane, dhe se për këtë arsye, nuk përbën kurrfarë përjashtimi, as mëkat, t'i qasemi përkatësisë islame të popujve europianë autoktonë shqiptarëve dhe boshnjakëve si fakt historik të po atij rangu, sikurse që do t'i qaseshim katolicizmit të

italianëve dhe spanjollëve, apo protestantizmit të gjermanëve dhe anglikanizmit të anglezëve.

Me këtë rast, natyrisht, për asnjë herë nuk kemi harruar se një trajtim i këtillë i barabartë të të tria religjioneve dominuese (e sidomos, kristianizmit dhe Islamit) nga shumica e lexuesve nuk do të pranohet pa probleme, por përkundrazi, do t'i ballafaqojë me problemet serioze që së paku vetëm hipotetikiisht ta pranojnë këtë barabarësi burimore në statusin e të tria feve për identitetin kulturor dhe spiritual të Europës. Pikërisht për këtë arsye duhet në çdo rast të përsëritet dhe të nënvizohet, se asnjëra nga këto tri fe nuk është as më shumë as më pak europiane nga dy të tjerat, sado qoftë kjo në kundërshtim me llomitjet ideologjike totalisht të paargumentuara për *Europën kristiane dhe kristianizmin europian*, si antipode të *Europës jo-islame dhe Islamit jo-europian*.

Frika paranoike nga ngjashmëria shpirtërore dhe forca tërheqëse e pashmangshme e hebraizmit dhe Islamit, e ngritur në shkallë të fanatizmit fetar, i ka shtyrë sunduesit katolikë të Spanjës mesjetare t'i dëbonin të gjithë hebrenjtë dhe të gjithë muslimanët, të cilët nuk deshën të hiqnin dorë nga feja e tyre. Thua jse gjysmë milioni njerëz të pasardhësve të tyre, të cilët janë katolicizuar me dhunë, por edhe stigmatizuar si *moriskos* (muslimanë), gjatë 117 viteve vijuese (1492-1609) kanë pësuar nënçmime, diskriminim, dëbime, ndalesa të të gjitha llojeve, duke përfshirë madje edhe muzikën e tyre dhe mënyrën tradicionale të ushqimit, që në fund pjesërisht të vriten e pjesërisht të dëbohen deri te njeriu i fundit. Fakti që ishin *katolicizuar* qysh prej brezit të tretë, nuk u ndihmoi; ndërsa fakti që gjyshërit e tyre kanë qenë muslimanë është konsideruar "mëkat" i pafajshëm, me një vulë e cila nuk fshihet. Po kjo frikë paranoike nga forca tërheqëse të njerëzve shpirtërisht më të afërt, sot i

bren ata evropianë, të cilët këtë tërheqje e ndiejnë më së fuqishmi dhe e shohin më së qarti!

Sprova e afërsisë së Islamit po qarkullon nëpër Europë! Përfaqësuesit bashkëkohorë të anti-islamistëve evropianë përpiqen ta çrrënjosin Islamin nga Europa për shkak të të njëjtave arsye, të cilat i kanë shtyrë fanatikët fetarë të Spanjës mesjetare, që t'i përndiqnin nga kjo pjesë e Europës të gjithë hebrenjtë dhe të gjithë muslimanët, sikurse edhe pasardhësit e tyre me forcë të kryqëzuar, të cilët mbetën aty edhe plot 117 vjet! Për shkak të njohjes përsosurisht të qartë se Islami i tërheq thellë, se i tërheq thellë aq fuqishëm sa thjesht nuk do të mund t'i përmbahen *sprovës së afërsisë së Islamit*, nëse do të vazhdonte kjo afërsi edhe një kohë! Islami vërtet është një lloj rreziku për ta! Por ata e dinë mirë se ky rrezik nuk vjen nga Islami si fakt konkret shpirtëror dhe shoqëror, por nga ndjenja e forcës tërheqëse, të cilën Islami e ka për ta, kurse ata duan ta fshehnin sa prej të tjerëve, aq edhe më shumë prej vetvetes. Bat Ye'or dhe Anders Behring Breivik, Françesko Speroni dhe Pamela Geler, sikurse edhe të gjithë ata të cilët e ndajnë me ta frikën neurotike nga Islami, në fakt janë konvertitë potencialë! Mbi të gjitha, ata druajnë se nuk do të mund edhe shumë kohë të përballojnë sprovën e theksuar të afërsisë së Islamit, dhe për këtë arsye përpiqen me tërë forcën që këtë sprovë ta mënjanojnë nga afërsia e tyre, që ta dëbojnë sa më larg të munden nga sytë, nëse tashmë nuk po mund ta largojnë nga zemra! Kjo drojë neurotike, përveç me bazën e saj psikologjike, është kushtëzuar dhe me faktin sociologjik dhe politik, se Islami si formë e jetës barabar ka të bëjë me të gjitha aspektet e shoqërisë. Pranimi eventual i modelit islam kulturor do t'i ndryshonte rrënjësisht shumë karakteristika të paradigmës shoqërore për të ashtuquajturat *shoqëri bashkëkohore perëndimore*.

Fakti se në zemrën e Europës më shumë se një milenium¹²⁰ shqiptarët dhe boshnjakët, dy popuj të lashtë autoktonë europianë¹²¹ jetojnë në Islam me shumicën absolute të muslimanëve në strukturën demografike, sot vetëm i thekson këto sprova të afërsisë së Islamit. Për anti-islamistët ekstremë, identiteti islam i dy popujve të lashtë europianë është thjesht i palejueshëm! Ky qenka një skandal, i cili nuk duhet të tolerohet, blasfemi e cila duhet të çrrënjohet! Përveçse kanë pasur privilegj të jenë krahasimisht ndër popujt e parë të Europës të cilët erdhën në kontakt me Islamin, shqiptarët dhe boshnjakët kanë pasur edhe simpati diç më të madhe të fatit në anën e tyre, për aq sa, edhe pse deri sot halë në sy të qarqeve jotolerante djathtiste dhe përkundër përndjekjeve të shpeshta të kryqëzimit dhe gjenocidit shumë herë të përsëritur për shkak të identitetit të tyre mbizotërues islam, megjithatë kanë arritur të shmangin kryqëzimin e plotë dhe dëbimin total nga vatrat e tyre të lashta prej mijëvjeçarësh. Edhe pse muslimanët e parë, tregtarët dhe marinarët, janë vendosur në mënyrë të përhershme në truallin e tyre qysh nga mesi i shekullit VIII, shqiptarët kanë filluar të pranojnë Islamin në masë më të madhe në fillim të shekullit XIV. Procesi i pranimit të Islamit, plotësisht vullnetar dhe i lirë, ka zgjatur gati dy shekuj. Në këtë periudhë, shqiptarët kanë pranuar Islamin sunit, ndërsa në shekullin XVIII kanë

¹²⁰ Siç tashmë kemi theksuar, Islami në truallin evropian ka arritur ndjeshëm më herët sesa dëshirohet të tregohet zakonisht. Emirati i parë islam në truallin evropian, siç kemi theksuar tashmë, është formuar qysh rreth vitit 668 në Kaukaz, ndërsa në Ballkan, e edhe në truallin e Shqipërisë, Islami ka arritur kah mesi i shekullit VIII, vetëm disa dekada pas ardhjes së Islamit në Gadishullin Iberik.

¹²¹ Rrënjët e shqiptarëve dhe boshnjakëve shkojnë thellë në kohën para erës sonë. Në rastin e shqiptarëve, mund të flitet madje për një popullatë prej më të lashtave në aspektin demografik relativisht stabile në tërë Evropën! Ngjashmëria, e madje edhe rrënja e përbashkët e shqiptarëve dhe boshnjakëve, në kohën më të re është konfirmuar si me teste komparative të ADN-së, ashtu edhe me hulumtimet onomastike dhe paleografike.

filluar masivisht të kalojnë në rendin dervish bektashit, dhe këtë më së shumti në pjesët jugore të Shqipërisë. Duke ndërtuar identitetin e tyre modern nacional mbi themelet e përkatësisë islame kulturore, shqiptarët kanë pasur ndikim të madh mbi historinë jo vetëm të rajonit por edhe tërë Europës, sikurse edhe në pjesët e Azisë dhe Afrikës veriore. Me fjalë të tjera, krahas numrit të madh të komandantëve të dalluar ushtarakë dhe administruesve të cilët kanë vepruar në kuadër të shtetit osman, atëherë fuqisë së madhe botërore, shqiptarët kanë dhënë edhe 42 vezirë të mëdhenj, të cilët drejtpërdrejt kanë bërë historinë e kohës së tyre! Ndër emrat më të mëdhenj janë Davud Pasha, Hamza Kastrioti, Iljaz Hoxha, Nezim Frakulla, Qypri (Köprülü) Mehmed Pasha, Ali Pasha, Ed'hem Pasha, Haxhi Shehreti, Ali Pashë Gucia, Ibrahim Pashë Beratasi, Qypri (Köprülü) Fazëll Ahmedi, Muhammaed Ali Pasha egjiptiani, Kara Mahmud Bushatliu, Ahmet Kurt Pasha dhe shumë të tjerë.

Fanatizmi fetar, i cili gjatë dekadës së fundit manifestohet si anti-islamizëm, pa dyshim paraqet pozitën e dukshme, nëse jo edhe qendrore në listën e rrymave politike të Europës. Është e kuptueshme, së këndejmi, se valët e kësaj ekspedite të re kristiane me sulmin e tyre psikologjik dhe politik anti-musliman e kanë tronditur edhe Shqipërinë, shtetin europian me rreth 90% muslimanë. E në kundërshtim me atë që do të ishte e logjikshme të pritej, madje edhe në një mjedis të tillë me shumicën e madhe të popullsisë muslimane, retorika e rreptë anti-muslimane nuk ka heshtur, por përkundrazi ka treguar brutalitet befasues dhe mungesë të respektit minimal të ndjenjave të qytetarëve të tij muslimanë. Si pohim më i ri i kësaj strategjie të qëndrimit anti-islam në Shqipëri, mund të ceket reaksioni i disa mediave shqiptare, gazetarëve dhe blogerëve, pas masakrës në të cilën anti-islamisti A. B. Breivik me gjakftohtësi ka vrarë mbi

80 bashkëqytetarë të tij, që kështu të *alarmojë Europën nga rreziku i muslimanizimit të Europës* (??). Prej motivesh padyshim moralisht të ulëta, pjesërisht fitimprurëse, e gjithsesi edhe politike, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Ligës Veriore të radikalitetit neo-fashist Françesko Speroni, në mediat shqiptare mund të lexoheshin lavdërime për Breivikun, lëvdata masakrës me vlerësimin se ky ka qenë “*akt u domosdoshëm dhe njëmend heroik ... i orientuar kundër terrorizimit ... akt korrekt i qytetarit korrekt evropian, i cili mbron vlerat korrekte europiane... apel i drejtuar qytetarëve që kryeministri i Norvegjisë të demaskohet si kuisling i pushtuesve muslimanë, të cilët synojnë ta shndërrojnë Europën në Eurabi...* Përveç deklaratave totalisht absurde, jo vetëm oksimorone por edhe shembullore morone (sikurse për shembull, pohimi se vrasja sadiste terroriste e dhjetëra të rinjve duarzbrazët – akt antiterrorist??), këto vlerësime pa dyshim marrin edhe retorikën e Bat Ye’orit, Pamela Gelerit, të ndjerës Falaçi dhe konvertitëve të fshehtë potencialë në Islam. Kjo nuk na befason, sepse rritja e muslimanëve të deklaruar në Shqipëri, pas rënies së regjimit socialist të Enver Hoxhës është pikërisht spektakolare. Është vështirë t’i rezistohet një prirjeje shoqërore aq dominante, përveç nëse nuk kalohet publikisht në anën e armiqve më radikalë të Islamit dhe muslimanëve, dhe kështu t’i digjen të gjitha urat e kthimit nga vetja. Në këtë kontekst, krahas motivit përfitues, rol të madh luajnë edhe motivet nga fusha e psikopatologjisë, nga ekzibicionizmi i sëmurë, deri gjithashtu te format patologjike të ksenofobisë kulturore dhe fetare. Themelin e tyre të përbashkët, financimin dhe sigurimin e hapësirës për ekspozim publik dhe të pasanksionuar të qëndrimeve, të cilat janë pjesëza të ligjërimit të shkumëzuar nga urrejtja, të pështyra në fytyrën e qytetarëve shqiptarë, dhe në fytyrën e çdo mirësjelljeje dhe morali, gjithsesi kanë pikërisht

qendrat e veprimit anti-islam, të cilat e financojnë edhe Breivikun dhe e popullarizojnë edhe në universitetet e famshme me një varg fushatash të falsifikateve Bat Ye'or-et diletante, duke i paraqitur punimet e tyre për *kontribute objektive dhe të argumentuara të shkencës së historisë*.

Për paskrupulozitetin e tyre total dhe fyerjen e qëllimtë, keqdashëse të ndjenjave të muslimanëve, si të asaj shumicës së madhe nga Shqipëria, ashtu edhe të miliona muslimanësh nga rajoni, para së gjithash atyre nga Bosnja dhe nga Kosova, flet edhe e dhëna e pabesueshme për paturpësinë e një autori, i cili haptazi e lavdëron gjenocidin mbi boshnjakët muslimanë në Srebrenicë dhe propozon dëbimin në Turqi të të gjithë shqiptarëve muslimanë, si nga Shqipëria ashtu edhe atyre nga Kosova. Fantazma e krimit të bërë para 400 vjetësh ndaj moriskosëve dhe maranosëve në Gadishullin Iberik, përsëri qarkullon nëpër Europë dhe kjo mbi muslimanët e Gadishullit Ballkanik! Përsëri nëpër Europë qarkullojnë bisedat për rrezikun nga afërsia tejet e madhe e Islamit dhe numrit tejet të madh të muslimanëve, sërish lëshohen tezat për nevojën e *domosdoshme të pastriimit fetar të Europës kristiane nga jobesimtarët islamë!* Edhe pse është e qartë se në pyetje është një autor nga Shqipëria, (dhe ky dukshëm i pashërueshëm!), megjithatë nuk është aspak e rastit që autori i këtyre kotësive dhe poshtërsive morale nënshkruan me emrin dhe mbiemrin e plotë, kurse shkrimet e tij megjithatë mbesin të pasanksionuara. Si të shpjegohet ndryshe ky fakt, përveç me daljen në dukje të burimit evident të njëjtë të këtyre teksteve dhe të atyre të Breivikut, i cili gjithashtu ka propozuar dëbimin e muslimanëve nga Ballkani në Turqi dhe ndarjen e territoreve të Shqipërisë muslimane ndër fqinjët kristianë të Greqisë dhe Malit të Zi, edhe pse gabimisht i ka shpallur Greqinë dhe Malin e Zi për *shtete kristiane* (kështu duke përfshirë

edhe emigrantët, në Greqi jetojnë mbi 400.000 muslimanë, ndërsa në Malin e Zi muslimanët përbëjnë rreth 20% të popullsisë së përgjithshme), edhe vrasësi masiv Breivik dhe anti-islamisti, pamfletisti papagall nga Shqipëria (Kastriot Myftaraj), është e qartë nuk i shkruajnë tekstet e tyre, por i marrin të njëjtat tekste të shkruara në vend tjetër, që me emrin e tyre më tej t'i popullarizojnë.

Këtë pohim në mënyrë plotësuese e vërteton edhe intensifikimi evident i debateve në TV (talk show), sikurse edhe polemika nëpër mediat publike, duke i përfshirë, në rend të parë, gazetatat ditore dhe javore me tirazhin më të madh, në të cilat drejtpërdrejt denoncohet karakteri islam i identitetit të numrit më të madh të shqiptarëve, si fajtori kryesor *për prapambetjen historike të Shqipërisë dhe mbetjen e saj jashtë rrjedhave kryesore të qytetërimit europian*. Gjatë gjithë kësaj fushate, që të forcohet bindja e tyre, këto ide inkuadrohen në thëniet e figurave zyrtare politike nga shtetet lidere europiane, që BE nuk është në pozicione të afërta me idenë që në BE të pranohet shteti me shumicën muslimane, pa marrë parasysh që fjala është për shtetin europian dhe njërin prej popujve më të vjetër europian. Synimi i këtyre debateve është plotësisht i qartë: të sfidohet imazhi tradicional i shqiptarëve për veten si një komb me tri fe. Edhe pse shumë më tepër i përfaqësuar në mesin e shqiptarëve të Shqipërisë, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë, sikurse edhe Greqisë (numri i saktë i shqiptarëve etnikë muslimanë në pjesët verilindore të Greqisë, para së gjithash në zonën e Epirit, nuk është i njohur por gjithsesi nuk është për shpërfillje), me këtë dhe me të gjitha mjetet e tjera punohet në de-islamizmin e shqiptarëve. Vizioni i shqiptarëve si komb me fe monolite kristiane, tashmë me tërë zhurmën promovohet publikisht nga përfaqësuesit eminentë politikë dhe kulturorë të neo-fashizmit

ndër shqiptarët. Me moskokëçarje të pabesueshme flitet për traditën islame të shqiptarëve si për një *handikap dhe gabim historik*, por si për handikabin i cili mund të mënjanohet dhe gabimin i cili mund të përmirësohet!? Suksesi i deritashëm i këtij projekti fashist nuk duhet përçmuar! Vetë fakti se propozime të tilla skandaloze gjithnjë e më shpesh po vendosen dhe se kanë arritur të drejtën e votës me pretekst të të drejtës për liri të mendimit dhe të shprehurit, konfirmon se është bërë ai hapi i parë dhe më i rëndësishëm: heqja e dallimit ndërmjet idesë së të mirës dhe të keqes, drejtpërdrejt hap rrugën drejt relativizmit të tyre psikologjik dhe amnistimit të plotë të krimit të bërë ndaj muslimanëve, në emër të heqjes së të ashtuquajturit “rrezik të përgjithshëm”. Pikërisht kjo ka ndodhur me gjenocidin, vrasjet masive, përndjekjet e muslimanëve, grabitjen e territoreve në të cilat muslimanët kanë jetuar me mijëra vjet, me konfiskimin e padrejtë të pronave të tyre, me rrënimin e xhamive, djegien e shtëpive dhe plaçkitjen e pasurive të tyre! Të konsiderohet pas gjithë asaj çka ka ndodhur dhe çka po ndodh, që fati i muslimanëve në Gadishullin Iberik kurrë më nuk mund të përsëritet në Europë, do të thotë plotësisht të përçmohen leksionet historike dhe logjika e fanatizmit religjioz. Aty ku njëherë ka ndodhur diçka, pikërisht është më se e besueshme se tërë kjo mund të ndodhë përsëri!

A mos është e rastit që Europa e zgjedhi ta ngrejë deri në reputacion internacional si autorin më të rëndësishëm bashkëkohor në gjuhën shqipe Ismail Kadarenë – pikërisht atë Ismail Kadare i cili reputacionin e tij të lartë e përdor që ndër shqiptarët ta promovojë idenë radikale fashiste se *pranimi i Islamit përbën gabimin më të madh historik për shqiptarët, sepse Islami është i huaj për Europën dhe i papranueshëm për identitetin dhe vlerat e saj kristiane??*

Por synimi skajor i fyerjeve të këtilla nuk është që te shqiptarët muslimanë, te bashkëqytetarët e tyre, të nxisë vetëm dhimbjen e thjeshtë për shkak të *gabimit historik* të cilin e përbëka pikërisht fakti që janë muslimanë, mbi të cilën do të vajtojnë të pafuqishëm. Pas kësaj vërejtjeje helmuese kadareane fshihet ideja delikate dinake që gabimi të shndërrohet në mëkat, që mëkati të shfajësohet sikurse të gjitha mëkatet që mund të pendohen, dhe që në fund të fundit të përmirësohet edhe ky gabim si *gabim historik*! Si mund të përmirësohet ky gabim? Përgjigjja tashmë qysh moti është përgatitur dhe është e njohur në ato kërkesa, të cilat gjithnjë e më shpesh po përsëriten në opinion dhe përhapen nëpërmjet të gjitha mediave. Thelbi i këtyre dy debateve publike për përmirësimin e gabimit historik rrëgohet në propozimin i cili u bëhet shqiptarëve, që të heqin dorë nga identiteti i tyre islam dhe që ta zëvendësojnë me atë romak-katolik, i cili sipas Kadaresë korrespondon në tërësi me identitetin modern europian dhe vlerat europiane (??). Është përpunuar receta sa e thjeshtë aq edhe efikase, se si të përmirësohet gabimi historik: ajo që në fillim është shënuar si gabim historik dhe *njollë e mëkatit (macula peccata)*, tash do të paraqitet si krimi më i madh dhe mëkati i vdekjes (*magna crimen* dhe *culpa maxima*)! Dhe ashtu si shqiptarët kanë gabuar në mënyrë kolektive dhe fytyrën e tyre e kanë ndyrë me atë *njollën e mëkatit* kur e pranuan Islamin, po në këtë mënyrë kolektive do të duhej ta hiqnin nga shpina e tyre barrën e krimit më të madh dhe ta përmirësonin *culpa maxima – mëkatin e vdekjes së tyre – duke hequr dorë nga Islami dhe me pranimin e kristianizmit, çfarëdo qoftë ai por megjithatë sidomos atë romak-katolik!* Ismail Kadare dhe përkrahës të ngjashëm të këtyre aberracioneve morale dhe koncepteve shkencore devijuese, të përballur me faktin se flasin për mbi 90% të bashkëqytetarëve të tyre muslimanë,

natyrisht që kanë qasje relativisht të përmbajtur. Tash për tash, prej tyre nuk kërkojnë të pamundurën – që brenda një nate – *ad hoc* dhe *hic et nunc* – menjëherë, këtu dhe tash, të gjithë ta mohojnë të kaluarën e tyre dhe identitetin e tyre islam. Në këtë çast, nga ana e tyre do të mjaftonte një lloj e mimikrisë ideologjike. Disa dëshmi të pendimit, disa demonstrime të dukshme të turpit për shkak të identitetit islam do të mjaftojnë: përkrashja e qartë e ndalimit të *ezanit* – thirrjes publike për lutje; harmonizimi me veshjen dhe modën normale euro-perëndimore, përvetësimi i të gjitha standardeve të tyre morale dhe kulturore, vetëm aq sa mos t'ua zënë sytë e europianëve me përkatësinë e tyre muslimane!

Është interesante se autorët e pastër kristianë të emancipuar tregojnë shumë më tepër vetëdije realiste për vlerat e identitetit kolektiv dhe për synimet e mirëfillta të të djathtës ekstreme europiane, sesa të gjithë këta renegatë muslimanë së bashku! Që ta konfirmojmë këtë do të kujtojmë vrojtimit inteligjente dhe të thella të Maria Todorovës, e cila në librin e saj të njohur *Imagining the Balkans* (Ballkani imagjinar), qorton se të këtilla qëndrime të politikanëve dhe autorëve të dalluar shqiptarë, të cilët me aq entuziazëm e shpallin besimin e tyre të pakufishëm në aleancë me vlerat kristiane dhe *europiane*, njëkohësisht janë dëshmi edhe e naivitetit të tyre total, i cili i shtyn që aq lehtë të bien në kurth para ligjëratës pluraliste të qarqeve nacionaliste dhe ekskluziviste të Europës, dhe vërtetim i ambicieve të tyre personale për ta ruajtur pozicionin e tyre, duke u mbyllur në gëzhhojen nacionaliste retorike dhe duke e shmangur universalizmin dhe pluralizmin e mirëfilltë.

Për fat të keq, në këtë çast duket se të këtilla qortime të arsyeshme të shumë politikanë shqiptarë dhe përfaqësues të shquar të jetës së kultit, kanë hasur në veshë të shurdhër. Ekzistojnë

shumë simptoma, se elita të Shqipërisë dhe Kosovës punojnë në përgatitjen e imazhit, i cili Europës kristiane do t'ia paraqiste shqiptarët nëpërmjet identitetit të theksuar e madje edhe ekskluziv katolik. Sado që me këtë gjendje nuk duhet të çuditemi së tepërmi, duke e pasur parasysh situatën politike, sikurse edhe instancën të mishëruar nëpërmjet *rastit të Ismail Kadaresë*, megjithatë intensiteti me të cilin po punohet e që më së paku bie në sy është i pashije, duke marrë parasysh atë se vetëm rreth 5% të shqiptarëve në Shqipëri janë pjesëtarë të kishës romake katolike. Një numër i madh i organizatave muslimane, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, kanë një kohë të gjatë që protestojnë haptazi kundër asaj që ata e quajnë *imponimi i sponsorizuar shtetëror i katolicizmit të shqiptarëve*. Dhe siç kemi thënë tashmë, jo pa arsye të forta. Kështu, në mars të vitit të kaluar përfaqësuesit e Forumit të Rinjve Muslimanë të Kosovës, duke iu drejtuar karakterit shekullar të shtetit të tyre, kërkonin nga pushteti në Kosovë që ta hiqnin fotografinë e Nënë Terezës (*motra e nderit* katolike e cila për një kohë të gjatë ka punuar në Kalkutë, Indi, më vonë fituese e Çmimit Nobel për paqe) nga institucionet shtetërore. Deri sot, mezi duhet të thuhet, asnjë fotografi e saj nuk është mënjeluar nga institucionet shtetërore të Kosovës. Gjithashtu, kanë protestuar për shkak të refuzimit të dhënies së lejes që të ndërtohet xhamia e re në Prishtinë, të cilën e kërkojnë prej plot trembëdhjetë vjetësh, kurse qysh moti ka qenë një domosdoshmëri praktike¹²², duke e marrë parasysh se, nga ana zyrtare, çdo gjë që është e lidhur me Islamin, sistematikisht shikohet si simbol i prapambetjes dhe pengimit të ndërtimit të një shteti bashkëkohor evropian.

¹²² Gjatë muajit qershor të vitit 2011, një numër i madh muslimanësh e kanë falur xhumanë (lutjen e së premtes), në rrugë që të demonstrojnë mungesën e hapësirës për lutje për vete.

Ky paragjykim totalisht i pabazuar, i cili injoron tërë historinë e Europës dhe plotësisht e mohon identitetin e saj thelbësor multikulturor dhe multikonfesional, në veçanti *i ngacmon sytë*, por këtë herë popullsinë muslimane të Kosovës, e cila është në shumicën dërrmuese prej më se 93%¹²³, sepse në vendin për të cilin është kërkuar leja për ndërtimin e xhamisë, është rrënuar madje edhe shkolla ekzistuese aktive, që të ndërtohej katedralja e re katolike, për më pak se 1% katolikë!?

Edhe pse kërkesat e këtyre protestave muslimane nuk përmbajnë në vete asgjë që do të ishte e kontestueshme prej ligjit, me një aksion sistematik të mediave satanizohet çdo përpjekje e muslimanëve që me mjete legale të arrijnë respektim të plotë të të njëjtave të drejta, të cilat u garantohen të gjithë qytetarëve, dhe të ndërpritet praktika e favorizimit të cilitdo religjion në llogari të tjetrit. Ata i nënshtrohen përbuzjes publike, etiketohen si *talebanë, muxhahidinë, vehabistë, transversalja e gjelbërt, spiunët turko-iranianë*, e kështu kërkesa e tyre për respektimin e të drejtës në diversitet, inkluzivitet, pluralizëm, të drejtave njerëzore, parimit shekullar të ndarjes së kishës nga shteti, refuzohet në parim, pa shqyrtim dhe më së shpeshti, pa përgjigje në të gjitha ankesat dhe sugjerimet. Mëtimi i tyre që ata si muslimanë në vendin e tyre, me popullatën me përqindje aq të lartë autoktone e europiane muslimane, kanë më pak të drejta se muslimanët në shtetet dominuese kristiane të Europës Perëndimore, nuk është, për fat të keq, aspak i ekzagjeruar. Pikërisht vlerat demokratike, krahas prosperitetit demokratik, i kanë bërë ato vende jo vetëm tërheqëse, por i kanë shndërruar në simbole të shoqërive të drejta dhe të lira. Nuk duhet harruar se, krahas pasigurisë ekonomike dhe krizës që i ka goditur ato vende, dhe

¹²³ Duke i përfshirë këtu edhe boshnjakët, turqit, goranët, romët, ashkallitë dhe egjiptianët.

ndikimi gjithnjë e më i fuqishëm i pikëpamjeve ekstremisht djathtiste, i cili rezulton në armiqësi të hapur ndaj muslimanëve dhe përhapjes sistematike të qëndrimit anti-musliman, rrezikohen thelbësisht parimet e demokracisë dhe të drejtave njerëzore, kurse pozita e muslimanëve bëhet gjithnjë e më e vështirë për shkak të diskriminimit të vazhdueshëm.

Turqia europiane – Osmanlı Devleti

Vërejtje: Për ndikimin që ka pasur shteti osman në tërë Europën dhe në formimin e identitetit europian janë shkruar shumë vëllime. Sidomos janë përpunuar aspektet politike, ekonomike, kulturore, artistike, shpirtërore dhe të tjera të jetës shoqërore, e megjithatë, kjo trashëgimi e madhe as për së afërmi nuk është mjaft e njohur. Autori i këtij libri tashmë prej një kohe të gjatë punon për një studim të veçantë kushtuar parësisht analizës së ndikimeve filozofike dhe estetike, të cilat letërsia e sidomos poezia osmane, i ka ushtruar në literaturën europiane dhe mendimin estetik. Për nevojat e këtij libri, është veçuar vetëm një segment i fenomenit jo fort të vërejtur të formimit të një identiteti të posaçëm trans-etnik dhe trans-gjuhësor të muslimanëve të Ballkanit, i formuar drejtpërdrejt mbi themelet e praktikës politike dhe shoqërore të shtetit osman, gjatë shekujve të sundimit të tij në këtë territor. Duke i përfshirë në aspektin nacional, kulturor dhe gjuhësor shumë popuj mjaft të nduarnduartë, të cilët jetojnë në rajonin e Gadishullit Ballkanik, efektet kohezive të trashëgimisë islame, të konkretizuara nëpërmjet klishesë specifike shpirtërore, kulturore dhe administrative të Osmanlı Devletit, gjatë shekujve kanë formuar një identitet të ri, i cili përkundër të gjitha dallimeve të theksuara, paraqet një bashkësi të dalluar të integruar me fije të padukshme të afërsisë shpirtërore. Pikërisht në kontekstin e veçantisë së tij kemi ven-

dosur për një paraqitje paraprake të këtij fenomeni kulturor, i cili në fakt deri tash as nuk është regjistruar shkencërisht në specificitetin e tij, sikurse edhe një kontribut i çmueshëm, por jo mjaft i ekzaminuar i këtij shteti të rëndësishëm europian islam, i cili e ka vendosur vulën e tij të pashlyeshme në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Europë, dhe qenësisht ka ndërhyrë në proceset e individualizimit të identitetit modern europian.¹²⁴

V.I.2. Boshnjakët

Vërejtje: Fenomeni i Bosnjës, e cila gjatë Mesjetës ka qenë me shekuj shtet feudal, dhe banorëve të saj autoktonë, themelesve, sunduesve boshnjakë, njërit prej popujve më të vjetër autoktonë të Europës, në kontekstin e pranimit, ruajtjes dhe transmetimit të identitetit islam shpirtëror dhe kulturor, është ende larg objektivitetit elementar në qasje, ndërsa për gatishmërinë që të miratohen faktet e pathyeshme, të cilat në tërësi e hedhin poshtë mitin ideologjikisht të vazhdueshëm për anarkinë dhe dhunën e përhershme të cilat, gjoja, shteti islam i ka kryer në këtë pjesë të Europës, për fat të keq, thjesht ende nuk ka kurrfarë fjale. Ndërkaq, llamba e të vërtetës ndriçon nga vaji i mashtrimeve të djegura. Sa më shumë vaj të tillë të hedhin, duke tentuar ta asfiksojnë, vetëm sa e rrisin shkëlqimin e saj!

¹²⁴ Një pasqyrë të shkëlqyeshme të vëllimit, llojlojshmërisë, efekteve dhe përmbajtjes së ndikimit të përhershëm të cilin Osmanlı Devleti si forcë interkontinentale por edhe si shtet evropian islam, e ka pasur në formimin e identitetit evropian, ofron studimi monumental *The Great Ottoman-Turkish Civilization*, Editor in Chief: Prof. Kemal Çiçek; Chief of the Editorial Board: Prof. Dr. Halil İnalcık (I-IV, *Politics; Economy, Society; Philosophy, Science, Institutions; Culture and Arts*), Ankara 2000. Kjo sipërmarrje botuese shumëvjeçare, e botuar me më shumë se 3.500 faqe të formatit enciklopedik, përbën një hyrje të shkëlqyeshme për një-rëzit me interesim të përgjithshëm, dhe një burim mjaft instruktiv të besueshëm me informacione pak të njohura, shpesh edhe krejtësisht të reja për specialistët.

Fakte historike për Bosnjën

Në studimin hermeneutik klasik “E vërteta dhe metoda” Gadameri qorton praninë e dosmodoshme të paragjykitimit në çdo perceptim të botës, i cili pretendon njëjtësinë, sidomos në shkencë, dhe veçanërisht në fushën e hulumtimeve historike (Hans-Georg Gadamer, *Warheit und Methode*, Freiburg 1961). Nëse paragjykimi edhe është pjesë përbërëse e çdo të vërtete (e cila është domosdoshmërisht edhe personale, përveç që duhet të jetë edhe faktografikisht korrekte), lajthitja është gjithsesi pengesë e të vërtetës, pikërisht, kundërshtimi i së vërtetës, antipodi i saj.

Me fatin e boshnjakëve është i lidhur, dhe madje për një pjesë të madhe edhe faktori i tij determinues, një gabim i cili qysh moti është pranuar jo si paragjykim por si një e vërtetë e kulluar, e pakontestueshme, për secilin dhe për të gjithë (gjoja) e mirënjohur. Ky është absurdi për kuptimin dhe arsyet e pranisë së Islamit në Bosnjë. Dhe më konkretisht, mashtrimi për identitetin e boshnjakëve dhe motivet e pranimit prej tyre të Islamit.

Së pari, duhet nënvizuar pikërisht këtë formulim: *pranimi i Islamit*. Edhe pse fjala *islamizim* qysh moti ka hyrë në përdorim të përgjithshëm, ndërsa në mënyrë jokritike dhe për inerci e përdorin edhe pjesëtarët bashkëkohorë të Islamit, të pavetëdijshëm që paragjykimi është ngritur në bindje, dhe mashtrimi është shpallur për të vërtetë, nuk ka vend për vetë termin (edhe më pak për nocionin), i cili pranimin e Islamit e përcakton si *islamizim*. Duhet thënë aty për aty dhe qartë: nuk ka pasur kurrfarë islamizimi, as të dhunshëm as të padhunshëm! Ky është qëndrim i cili duhet të respektohet dhe absolutisht të zëvendësohet teza krejtësisht e papranueshme për njëfarë islamizimi.

Në rrafshin teorik është krejt e qartë që “islamizim” të dhunshëm nuk ka pasur sepse:

1. Është i papranueshëm sipas dispozitave themelore të Islamit. Së paku tre ajete nga Kur'ani në mënyrë eksplicite e ndalojnë çfarëdo detyrimi në çështjet e fesë. Nëse kjo megjithatë ka ndodhur, nuk do të mund të pranohej sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë ndeshet me parimet më të larta të tërë kësaj klišeje kulturore, etike dhe juridike, gjatë së cilës ai i cili e ka zbatuar forcën, do të trajtohej si mëkatbërës, ndërsa ai mbi të cilin është zbatuar forca, sipas po asaj logjike konstitutive të Islamit, automatikisht do të shlyhej, lirohej nga mëkati;

2. Sepse nuk ka asnjë shembull të vetëm të dokumentuar për veprimet e tilla! Sfida të cilën autori i këtyre rreshtave ua drejtoi historianëve të Ballkanit në një konferencë të mbajtur në Shkup në vitin 1996, që ta paraqesin së paku një shembull të vetëm të dokumentuar të islamizimit masiv të dhunshëm, ka mbetur deri sot pa përgjigje.

Së pari, duhet nënvizuar qartë: Islamizim të dhunshëm apo çfarëdo qoftë si të tillë nuk ka pasur, sepse edhe nuk mund të kishte. Theksi për një veprim të këtillë domosdo do të mund të vendosej *jashtë* individit, për të cilin do të mund të supozohej në mënyrë hipotetike se i ka qenë nënshtruar islamizimit. Konkretisht, vullneti i tij do të duhej ose të shpërfillej apo marginalizohej, që vetë procesi të mund të quhej islamizim! Përkundrazi, nga pikëpamja islame, kalimi në Islam është legjitim vetëm nëse është përjashtimisht akt i vendimit personal, në qoftë pra se theksi është vënë te vetë protagonistin e këtij akti! Akti i përzgjedhjes vetjake, qysh në përkufizim përjashton formën pasive gramatikore. Vetë akti i pranimit të Islamit është krejtësisht i thjeshtë dhe kjo thjeshtësi organizativisht dhe në mënyrë dramaturgjike, i është përkushtuar totalisht afirmimit të vullnetit të lirë të individit. Veprimi rrëgjohet në bindjen lirshëm dhe qartë të shprehur (dëshmimi, shehadeh) në prani të dësh-

mitarëve të caktuar. Nuk ka kurrfarë ritualesh, nuk ekziston asnjë formë e testimimit, as kualifikimit, as që dikush tjetër mund të dëshmojë në emër të tij; thjeshtë dëshmohet, si e vërtetë personale dhe e pranuar lirshëm për njësinë dhe unikalitetin e Zotit (Allahut xh. sh.), sikurse edhe bindja në të vërtetën se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Zotit dhe me këtë tërë veprimi është përfunduar.

Krahas të gjitha këtyre, duhet theksuar edhe një moment psikologjik thelbësor. Njerëzit ndodhen përpara presionit. Nëse janë të detyruar, çdo gjë do të bëjnë që ta shpëtojnë kokën. Ashtu ajri i pompuar me dhunë në tullumbace, apo sikurse gota e derdhur në gotë, do të mbesin edhe ata të mbyllur, derisa tullumbacja nuk pëlçet dhe derisa gota nuk thyhet. Po atë çast kur kjo të ndodhë, ajri do të fluturojë, uji do të rrjedhë. A mund të imagjinohet që ajri nga tullumbacja dhe uji nga gota do ta ruajë formën edhe kur tullumbacja të pëlçet dhe gota copëtohet në njëqind copëza? E pikërisht kjo ka ndodhur me ata të cilët e kanë pranuar Islamin! Ata kanë mbetur në Islam edhe kur modeli social, politik dhe fetar i cili i ka formësuar, ka pushuar së ekzistuari në botën e tyre. Sikur të ishin *islamizuar me dhunë*, mezi do ta prisnin çastin e parë dhe do të ngarendnin prapa në atë gjendje, në të cilën kanë qenë para Islamit. Cili i burgosur nuk do të vraponte në liri posa të hapeshin dyert apo të hiqeshin hekurat në qelinë e tij!? Por, vendimi i zgjedhur i cili ka dalur nga motivet më të thella të gjurmimit njerëzor për të vërtetën dhe Absolutin, pra, nga motivi i fetarësisë në kuptimin më të gjerë, krejt logjikisht mund ta sqarojë këmbëngulësinë me të cilën mbrohet dhe ruhet identiteti i përzgjedhur islam! Pikërisht sepse ka qenë i zgjedhur lirisht!

Të përfundojmë: është e qartë se nuk ka pasur kurrfarë islamizimi, sepse është e qartë që akti i detyrimit në fakt do to

thoshte domosdoshmërisht mohimin e vetë Islamit. Çdo fe në rrafshin psikologjik është emocion, pra, dashuri ndaj Zotit. Kurse të duash nën detyrim, kemi thënë, nuk është e mundur! Kushdo që me dhunë është detyruar ta pranojë ndonjë fe, ka mohuar drejtpërdrejt parimin më të lartë të çdo feje: dashurinë!

Përveç kësaj, akti i detyrimit është mohim i integritetit subjektiv, mohimi i lirisë dhe vetëdijes së individit. Në aktin e pranimit të Islamit nuk ka veprim mbi subjektin pasiv. Në veper është vendimi personal i pranimit, për të cilën garancia e vetme e kërkuar është vetëm fjala vullnetarisht e shqiptuar, pas së cilës duhet të qëndrojë bindja e fuqishme. Kjo bindje nuk i nënshtrohet as dyshimit, as verifikimit. Garantuesi i kësaj i vetëm është Allahu xh. sh. dhe vetëdija e atij i cili ka dëshmuar! Domethënë, në Islam hyhet, në Islam kalohet, ndërsa nuk i nënshtrohemi Islamit, as që mund të islamizohet ndonjë!

Prandaj, në vend që, sikurse deri tash dhe në të gjitha rastet, të flitet për procesin e islamizimit në Bosnjë (apo kudo qoftë në vend tjetër), nga tash duhet ditur, e së këndejmi edhe ashtu të flitet, se aty fjala është për vendimin personal të njerëzve që ta pranojnë Islamin si fe të veten dhe që nëpërmjet këtij modeli të besimit ta realizojnë nevojën e tyre universale për përvojë fetare. Krahas vërejtjes se fetarësia është nevojë universale e njerëzve të të gjitha epokave, kulturave, racave dhe popujve, edhe pse, e kuptueshme, jo edhe e të gjithë njerëzve individualisht.

Që ta neutralizojmë tërë këtë shtresim të madh paragjykimesh ndaj atyre njerëzve nga këto hapësira, të cilët e kanë pranuar Islamin, është e domosdoshme qetësisht dhe objektivisht të zbatohet një qasje për çështjen kyçe: përse ata, në rastin konkret, përse disa banorë të Bosnjës kanë vendosur ta pranojnë Islamin, ndërsa të tjerët njëkohësisht kanë zgjedhur që këtë mos ta bëjnë? Kësaj pyetjeje i duhet dhënë përgjigje pa kurrfarë

paragjykimesh ideologjike apo teologjike dhe skualifikuese, të cilat pashmangshëm do të paraqiteshin nëse do të harrohej konteksti në të cilin është marrë një vendim i këtillë.

Së pari, duhet pasur parasysh se kjo ishte kohë shprehimisht fetare, karakteristike për nevojën pasionante që në fe të gjendet siguria dhe themeli i jetës vetjake. Në këtë kuptim, është e arsyeshme të pranohet se motivi i parë i atyre të cilët e pranuan Islamin, ka qenë i përcaktuar prej arsyes e devotshmërisë: pranimi i Fjalës së fundit të Zotit dhe të pranohet Pejgamberi i Tij i fundit, është vendim i cili ka pasur rëndësi aq më të madhe sa më i devotshëm që ishte njeriu. Ata ndër të devotshmit, të cilët duke e dëgjuar këtë lajm, kanë ndier siguri të brendshme, siguri personale, ndriçim shpirtëror, e kanë pranuar si të vërtetë të gëzueshme. Para syve të tyre shpirtërore është hapur hapësira e pafund e privilegjit të madh që të dëshmohet ajo Fjala e Fundit e Zotit dërguar njerëzve dhe që jeta në tërësi t'i nënshtrohet përcaktimeve të Tij përfundimtare!

Të lartësohesh! Të ngrihesh edhe një shkallë në fe, ta bësh edhe një hap në dorëzimin e pakufizueshëm Vullnetit të Tij, ka pasur kuptimin të dëgjohet zëri më i thellë i ndërgjegjes njerëzore. Krahas këtij privilegji, sigurisht më të madh të njeriut, privilegjit që synon drejt lartësive, që synon drejt përsosjes vetjake, për ata të cilët i janë përgjigjur këtij zëri dhe këtë privilegj e kanë zgjedhur në formën e tij konkrete, pra nëpërmjet Islamit, shkonin edhe detyra të reja të shumta.

Ata të cilët këtë Shpallje nuk e kanë pranuar, pra ata të cilët këtë nevojë të tyren e kanë realizuar pa dilema qenësore në nivelin shpirtëror të doktrinës vetjake, nuk kanë pasur as arsye as nxitje të brendshme ta ndryshojnë kornizën vetjake fetare, por njëkohësisht me këtë qenë të liruar edhe nga të gjitha detyrimet konkrete, praktike të cilat akti i pranimit domosdoshmërisht i imponon.

Motivi i dytë ka qenë i natyrës parësore praktike. Duhej të mendohej mirë, me mençuri të merreshin parasysh të gjitha përparësitë dhe mangësitë e veprimit të tillë, të mateshin me kujdes dhe vetëm atëherë të vendosej. Edhe këtu është e domosdoshme të thyhet një mashtrim thellë i rrënjosur: *jeta e ortodoksëve, katolikëve dhe hebrenjve (dhimmive) në kuadër të Osmanli Devletit (pra, të shtetit të bazuar në konceptin e vlerave të përbashkësisë shpirtërore, si anticipim i qartë i Commonwealth-it britanik), nuk ka qenë as më e vështirë, as më e pasigurtë, sikurse që këtë përndryshe besohet, shkruhet dhe pohohet, por në shumë aspekte ka qenë më e lehtë dhe më e sigurtë sesa jeta e muslimanëve!*

Së pari dhe më e rëndësishmja është se njerëzit të cilët kanë zgjedhur të dëshmojnë të vërtetën e Islamit, kanë pranuar edhe detyrimin që këtë të vërtetë ta mbrojnë me jetën e tyre. Edhe ata, edhe fëmijët e tyre meshkuj automatikisht janë bërë të detyruar ushtarakë të shtetit. Nuk duhet mënjanuar nga mendja që në këtë kohë ky shtet ka qenë në ekspansion, dhe për këtë arsye ka zhvilluar praktikisht luftëra të vazhdueshme në hapësirat gjithnjë e më të mëdha. Afati i shërbimit ushtarak në kohë të caktuara ka zgjatur edhe 15 vjet, kurse boshnjakët dhe shtëpitë e atyre të cilët ktheheshin të gjallë, nuk kanë mundur të përparojnë shumë për shkak të mungesës shumëvjeçare të meshkujve më të aftë!

Ata që, duke mbetur në fenë në të cilën i ka hasur pushteti i ri, pra, të cilët qoftë në mënyrë implicite e kanë mohuar të vërtetën e Islamit, në të njëjtin shtet kanë qenë të liruar ta kryejnë ushtrinë dhe nuk kanë shkuar në luftë. Dhe është krejt e kuptueshme, dhe barabar ashtu ndërsjellsisht në mënyrë konsekuente; sepse as nuk do të kishte kuptim që ata të vdisnin në emër të idealit, të cilin vetë nuk e kanë pranuar dhe në emër të së vërtetës të cilën nuk e kishin quajtur të veten, as që për

këto ideale dhe për këtë të vërtetë do të ishte e pranueshme që t'i mbronin ata të cilët nuk besojnë në to!

Pra, nuk ka kurrfarë dyshimi se ka pasur edhe shkaqe njaft thelbësore, madje në mënyrë vitale të rëndësishme pragmatike në lidhje me pranimin dhe mospranimin e Islamit; ndërkaq, përkundër paragjykimit gjerësisht të pranuar dhe mashtrimit të përhapur, ka qenë shumë më e dobishme, më pragmatike, *të mos pranohet Islami, sesa të pranohet!* Kështu, kushdoqoftë që e ka pranuar Islamin në rrethana të tilla reale shoqërore, mund të kuptohet vetëm me praninë e motivit të rangut më të lartë, pra të atyre të cilët kanë pasur forcë t'i zmbropsin edhe arsyet më të forta praktike dhe ta fusnin njeriun në sferën e vendimit autonom moral.

Edhe bogomilët boshnjakë, edhe ortodoksët boshnjakë, edhe katolikët boshnjakë, edhe hebrenjtë boshnjakë, me ardhjen e shtetit islam u ballafaquan me përzgjedhjen e qartë: të bëhet edhe një hap në fenë dhe nënshtrimin Zotit, por me këtë të merret mbi vete edhe detyrimi që kjo fe të mbrohet me jetën e tyre; apo mos të bëhet ky hap, por me këtë të garantohet siguria e jetës! Në themel, kjo përzgjedhje nuk përfaqësonte asgjë më shumë se sa dilemën e amshueshme të konkretizuar në mënyrë sociale, politike dhe administrative të çdo qenieje njerëzore.

Ky është çelësi i vërtetë dhe më i rëndësishëm për perceptimin e Islamit në Bosnjë! Dhe pikërisht aty mund të shihet qartë dallimi etik, aksiologjik, përfundimisht, njerëzor, pra antropologjik i botës së Islamit në raport me vendet joislame. Vetëm për ilustrim, afro-amerikanët (edhe ky një eufemizëm ideologjik) përbëjnë rreth 29% të popullsisë së përgjithshme të SHBA, edhe pse përfaqësojnë më pak se 12% të popullsisë së përgjithshme. Ndërkaq, kjo përqindje shtohet në mënyrë të madhe nëse do të ndiqet me shifrat për ushtarët amerikanë të vrarë

apo të plagosur, gjë që konfirmon qartë faktin se në pozicionet më të rrezikshme më së shumti dërgohen pikërisht ata, të cilët janë të përfaqësuar më së pakti si protagonistë të ëndrrës amerikane në shtresat e fragmenteve të saj më të mira! Kështu, vetëm një i vetmi kongresmen amerikan e ka djalin që lufton në Irak, dhe asnjë nga përfaqësuesit e oligarkisë amerikane!? Kjo e dhënë i ka alarmuar madje edhe vetë gazetarët amerikanë, ndërsa armatën e SHBA në Irak e kanë quajtur “Armata e një ushtari”.¹²⁵ Përkundrazi, nga historia e Bosnjës është e njohur se edhe bijtë e bujarëve më të lartë, sikurse edhe vetë bujarët, duke përfshirë edhe sulltanin, kanë shkuar në luftë, ndërsa ushtarakisht kanë qenë të aftë, atje kanë qëndruar më shumë kohë, kanë dalë në vijën e parë dhe logjikisht, kanë vdekur në përqindjen më të madhe. Dhe ndërkohë, tërë këtë e kanë quajtur sa për detyrë të tyre, aq edhe privilegj dhe çështje nderi!

Krahas këtij konteksti më dramatik, rezultati i vendimit në llogari të së vërtetës së Islamit, ose mohimi i saj qoftë edhe implicit i manifestuar me mospranim, ka pasur edhe pasoja të tjera konkrete. Dhe edhe njëherë: jo gjithnjë më i favorshëm për ata të cilët kanë zgjedhur privilegjin të dëshmojnë në favor të Islamit! Kështu, edhe boshnjakët ortodoksë e katolikë kanë pasur për obligim të jepnin haraxh. Ndërkohë, toka mbetej në pronësinë e tyre, përkatësisht edhe *de facto* e *de iure* ka qenë pronë e tyre! Me këtë rast, haraxhi është *sasi fikse* në natyrë, përkatësisht në prodhime të cilat kultivohen në tokën e caktuar. Për vite të tëra ky parim i ka lejuar pronarit të ndajë shumë më tepër për vete, nëse edhe e ka pasur të vështirë ta plotësonte sasinë e kërkuar kur viti ishte i keq. Muslimanët bujq, ndërkaq, kanë paguar *10% nga të ardhurat e përgjithshme*, që do të thotë

¹²⁵ Shih Sheryl G. Stolberg, “Senator’s Sons in the War: Army of one soldier” (Bijtë e senatorëve në luftë: Armata e një ushtari), *New York Times*, March 22, 2003, f. B10.

që në vite të mira kanë dhënë sasi shumë më të madhe sesa zakonisht, ndonëse ajo ka qenë më e pakët në vitet e këqija.

Në raport me atë që sot quhet sferë e të drejtave njerëzore dhe lirisë qytetare, duhet të theksohet se në fakt vetëm në territorin e shtetit islam ka qenë i lejuar predikimi i lirë i fesë tjetër, ndërtimi i objekteve fetare, përdorimi i gjuhës amtare dhe hapja e shkollave në gjuhën vetjake. Për këtë ekzistojnë shumë të dhëna treguese statistikore (sikurse për shembull ai se në Vilajetin e Manastirit në territorin e Selanikut në vitin 1900 ka pasur më shumë shkolla në gjuhën greke, serbe dhe bullgare sesa ato në gjuhën turke!) në këtë aspekt me tonin e tij të pakusht liberal është interesant sidomos traktati i sulltan Mehmedit II Fatihut, drejtuar françeskanëve në Bosnjë dhe Hercegovinë, i dhënë më 28 maj 1463, në të cilin, ndër të tjera, thuhet:

“Askush mos t’i pengojë dhe shqetësojë kishat e tyre ... as Lartëmadhëria ime, as vezirët e mi, as zyrtarët e mi, as nënshtetasit e mi, as askush nga banorët e Perandorisë sime, mos t’i ofendojë dhe mos t’i shqetësojë as ata, as jetën e tyre, as pasurinë e tyre, as kishat e tyre.”

Përndryshe, sesa është i pabazuar mashtrimi në mënyrë sistematike i futur edhe nëpërmjet letërsisë, edhe nëpërmjet filmave dhe librave shkollorë, për përndjekjen e priftërinjve dhe rrënimin e kishave në kohën e sundimit islam në Ballkan, më së miri dëshmojnë faktet se në kryeqendrën e botës islame, pra, në Stamboll, Patrikana e Përgjithshme e botës ortodokse mbeti në funksionin e plotë gjatë tërë periudhës së sundimit osman, deri sot, me të gjitha kishat e saj të cilat kanë mbetur të paprekura, sikurse edhe që në tërë hapësirën e Perandorisë së dikurshme, ende qëndrojnë kishat edhe para ardhjes së këtij pushteti, sikurse edhe ato të cilat janë ngritur gjatë tërë kësaj periudhë.

dhe, duke marrë automatikisht fermanin e sulltanit për mbrojtjen absolute nga çdo dhunë!

Në dritën e fakteve, bëhet pakthyesëm qartë e tërë paarsyeshmëria, absurditeti i plotë, thellësia e errët e lajthitjes për njëfarë konteksti etik superior dhe etik inferior, përkatësisht me implikimet e pranimit dhe mospranimit të Islamit në Bosnjë, në Ballkan apo në cilindo vend tjetër! Si në shuplakë tregohet tërë marrëzia dhe boshllëku i tregimit për mbrojtjen e *Qytetërimit Perëndimor* nga invadimi i disa “*barbarëve islamë*”! Përnjëherë bëhemi të vetëdijshëm për dezinformimin total, konfuzionin shpirtëror, vetëmashtrimin somnambulist të një të mjerit Mesha (të lindur Mehmed) Selimoviq, i cili flet për disa *faje*!

Ka lejuar që ta mashtrojnë, i mjeri dhe i ngrati Mesha, ka lejuar ta bindin se është fajtor për diçka për çka para njerëzve nuk mund të jetë assesi fajtor, që t’ia hedhin tregimin për heroinjtë, të cilët u rezistuan presioneve dhe përndjekjeve dhe nuk e ndërruan fenë, dhe frikacakët të cilët nga frika e shkretëtë “e kthyen qyrkun prapthi” dhe “lejuan që me forcë t’i islamizojnë”! Si ka mundur, i ngrati Mesha, në përgjithësi të shpresojë që me mohimin e së vërtetës më të thellë të tij, në sytë e atyre të cilët kurrë nuk e kanë pranuar, do të bëhet diç tjetër veç konvertit shpirtëror!? Ky tregim i fabrikuar, i trilluar nga A deri në Zh, ajo gënjeshtër famëkeqe të cilën as qeni me gjalpë nuk do ta hante, ka sjellë më shumë pësime dhe dëme për njerëzit në Ballkan, e sidomos në Bosnjë dhe më së shumti pikërisht për boshnjakët, nga të gjitha doktrinat politike në këto hapësira!

Jo, boshnjanët – bosanacët – boshnjakët e mi të mirë, sikurse edhe ju shqiptarë muslimanë, edhe goranë, edhe torbeshë, edhe pomakë: të parët tuaj nuk ishin as të dobët, as të lëkundshëm kur e kanë pranuar Islamit! Por, dijeni, kanë pasur arsyet e tyre. Ata as nuk janë “turqizuar”, as blerë, as nuk e kanë

kthyer “qyrkun prapthi”. Duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se çdo njeri ndaj fesë sillet nga brendia e qenies së tij, që pikërisht aty, ku e përkufizon raportin e tij ndaj absolutit, fjalën kryesore ua jep motiveve më fisnike për të cilat është i aftë shpirti njerëzor. Së këndejmi është e domosdoshme të kihet parasysh, të kuptohet, se për një vendim të tillë këta njerëz kanë synuar lartësitë, se kanë qenë të frymëzuar me mendimin më të bukur dhe më fisnik për të cilin qenia njerëzore është e aftë, dhe se realizimin e spiritualitetit të tyre e kanë gjetur pikërisht në Islam! Kanë synuar përsosurinë e shpirtit, i kanë dhënë tërë përparësinë detyrimit të lartësisë, mbi çdo siguri të kësaj jete dhe kësaj bote, dhe këtë e kanë konfirmuar me vdekjen e shumtë heroike për të vërtetën vetjake! Kurrfarë faji këtu nuk ka pasur, as që ndokush ka të drejtë t’ia bëjë ndonjë fjalë kujtdo qoftë në çështjet e fesë, sepse në çështjet e fesë secili është përgjegjës vetëm për vendimin e vet, dhe vetëm para Zotit!

Që kjo të harrohet dhe të abuzohet edhe sot, në emër të shovinizmit agresiv militant fetar dhe nacional, duke e pervertuar këtë akt thellësisht personal, absolutisht privat të vendimit, do të thotë në mënyrë sistematike dhe të planifikuar të degradohet tërë një popull, të mohohet integriteti i tij moral, të infektohet vetëdija e tij historike, përhershëmërisht të ngarkohet ndërgjegjja e të gjitha brezave të ardhshëm. Ata të cilët kanë fabrikuar këtë klishe bardhë e zi, e kanë promovuar vetveten në statusin e hyjnisë së vrazhdë, të cilit me arbitraritetin e tyre ultimativ i përshkruajnë ndëshkimin e amshueshëm për mëkatet, gabimet dhe mallkimet e ashtuquajtura siç janë “mëkati stërgjyshor”, “fajet historike”, “mëkati i turqizimit”, “mallkimi i muslimanëve” ... dhe trillime të ngjashme ideologjike të fabrikua sistematikisht tërë një shekull, me synimin e qartë dhe të vetëm që të hidhet mallkimi i rëndë mbi boshnjakët dhe të ana-

temohet secili që vetëm emrin ua përmend. Kështu, në emër të fesë së vetë, këta inkuizitorë nacionalistë vetë kanë kryer mëkatin më të madh ndaj fesë: kanë ndaluar dhe kanë përndjekur lirinë e besimit të boshnjakët, ua kanë mohuar të drejtën në bindje fetare!

Dijeni se asnjë vendim për raportin ndaj fesë, zgjedhjes së besimit dhe përkatësisë fetare, kurrë nuk përfshin kurrfarë motivi të fajit! Dhe veçanërisht, që secila nga këto çështje paraqet vendim absolutisht privat, intim në të cilin askush nuk ka të drejtë të përzihet, as të ndikohet. Ky fakt merr të drejtën për statusin e gjykatësit për secilin njeri të vdekshëm në të gjitha çështjet e fesë dhe zgjedhjes fetare! Pa marrë parasysh a është fjala për individin, popullin apo shtetin! Prandaj, kurrë më askujt mos i jepni llogari për atë përse je ai që je, dhe mos lejoni më që dikush kurdoherë të kërkojë që për besimin tuaj t'i jepni llogari. E nëse dikush megjithatë i jep të drejtë vetes ta masë barrën e njëfarë gjoja faji tuajit, le të mendojë mirë me cilat arsye do ta qortojë atë i cili ka zgjedhur privilegjin dhe detyrimet e lartësisë, duke ua nënshtruar edhe jetën e vet, dhe si do ta lavdërojë atë i cili ka vendosur për garanci të mbiekzistencës dhe jetë të këndshme, duke hequr dorë nga lartësia!

Vetëm me të vërtetën mundemi ta çrrënjoshim këtë lajthitje të thellë, mjaft të thellë të rritur për Bosnjën dhe boshnjakët, të përmirësohet padrejtësia shekullore, e cila në mënyrë sistematike i bëhet edhe sot, dhe vetëm nëpërmjet çrrënjoshjes së saj mund të krijohen kushtet për dialog të mirëfilltë tolerant ndërnacional dhe multifetar të njerëzve, popujve dhe kulturave në Ballkan.

**MITI PËR EUROPËN KRISTIANE DHE ORIENTIN ISLAM
– BOSNJA SI PARADIGMË HISTORIKE
DHE KULTURORE E EUROPËS**

Identiteti evropian i boshnjakëve

Përmbledhje

Përkundër tezës në mënyrë jokritike të pranuar, Bosnja nuk është vendi në të cilën takohen Europa kristiane dhe Orienti islam! Burimi i këtij mashtrimi të përhapur, në mënyrë të paarsyeshme të promovuar si e vërtetë aksiomatike, e vetëkuptueshme, gjendet në postulatit për karakterin immanent evropian të kristianizmit dhe barabar për karakterin immanent joeuropian të Islamit, nga i cili pastaj nxirret përfundimi logjikisht i paarsyeshëm se Europa është kontinent përjashtimisht kristian. Faktet, ndërkaj, pakundërshtueshëm tregojnë që Europa nuk e ka fenë e saj autoktone, dhe se, në pajtim me këtë, nuk është, nuk mund të jetë, në mënyrë imanente kontinent kristian apo islam. Përkundrazi, edhe kristianizmi dhe Islami janë fe, të lindura jashtë trullit të Europës, të cilat banorët e Europës gjatë shekujve, i kanë pranuar, i kanë internalizuar dhe i kanë pranuar si elemente të identitetit vetjak shpirtëror. Në bazë të fakteve objektive historike, të cilat në mënyrë substanciale e konfirmojnë paqëndrueshmërinë e pikëpamjes me të cilën operon teoria e deritashme dominuese për identitetin përjashtimisht kulturor kristian të Europës, ky punim në mënyrë të argumentuar e afirmon pohimin se Europa në tërësi është kontinent multifetar dhe se edhe Bosnja në thelb ka qenë dhe mbetet vend evropian, në të cilin takohen,

ekzistojnë paralelisht dhe zhvillohen në mënyrë të njëkohshme kristianizmi evropian dhe islami evropian.

Fjalët kryesore: *Bosnja, Boshnjaku, Europa, kristianizmi, Islami, identiteti*

Hyrje

Një ndër mashtrimet kyçe të historiografisë tradicionale të Europës është akti i konfrontimit rutinor të kristianizmit si traditë autentike evropiane fetare, shpirtërore dhe kulturore, me Islamin si traditë autentike joevropiane (e më së shpeshti, si e njohur antieuropiane) fetare, shpirtërore dhe kulturore. Mjafton të kujtohen dy fakte historike, që drejtpërdrejt të kundrohën edhe pabazueshmëria e plotë e këtij mashtrimi, edhe proporcionet monumentale të veprimit të tij korroziv (brejtës) në vetënjohjen autentike të identitetit vetjak shpirtëror të Europës, përkatësisht, autopercptimin e tij faktografik korrekt. Së pari, duhet pasur parasysh e dhëna, e cila sistematikisht harrohet apo injorohet, kurse edhe vetë është e mjaftueshme ta rrënojë tezën themelore për identitetin imanent dhe ekskluziv kristian, se Europa nuk është vend i lindjes për asnjërën nga të tria fetë e mëdha monoteiste, pra as i kristianizmit; së dyti, përhapja e kristianizmit dhe Islamit në truallin e Europës është zhvilluar me dinamikë mjaft të çrregullt, kështu që Islami në shumë rajone evropiane ka arritur dy e më shumë shekuj para kristianizmit¹²⁶, prandaj, sipas parimit të prioritetit, do të duhej folur për

¹²⁶ Për shembull, me halifatin e emevitëve dhe abasitëve, përkatësisht, me konsituimin e Andaluzisë në truallin e Gadishullit Iberik, të mishëruar nëpërmjet institucioneve të shtetit tërësisht të organizuara, pothuaj në *dyer të mëdha*, Islami arriti në Evropë në vitin 711, ndërsa kristianizmi në pjesën më të madhe të Evropës veriore dhe qendrore, tërë Skandinavinë, sikurse edhe në Ukrainë dhe Rusi, ka filluar të pranohet vetëm nga fundi i shekullit X dhe në fillim të shekullit XI.

identitetin autentik islam të Europës, ndërsa kristianizmi, në të njëjtin nivel, do të mund të konsiderohej si sfidë kristiane dhe kontrapunkt i Europës islame!

Identiteti judeo-kristian-islam shpirtëror dhe kulturor i Europës

Miti për Europën kristiane dhe kontinentin islam është njëri prej stereotipave më së thelli të ngulitur, barabar në mënyrë jokritike i përvetësuar edhe në rrafshin e komunikimit të përditshëm, si edhe në nivelin më të lartë të shkencave shoqërore historike. Ky mit ideologjikisht i krijuar dhe po ashtu ideologjikisht i përjetësuar, është shkaku kryesor që Europa, sidomos në pjesët me traditën kryesisht kristiane, sot ka probleme serioze me identitetin vetjak. Këto probleme arrijnë edhe nivelin e dizinformimit, konfuzionit dhe harresës së plotë. Viteteve të fundit gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më zëshëm jehon pyetja: “A do të dëshirojë Europa kristiane të lejojë të bëhet edhe kontinent i muslimanëve!?” Konferencat e shumta, simpoziumet, debatet publike, diskutimet në TV, e xhirojnë këtë çështje në të gjitha variacionet, nga ato ekstreme djathtiste dhe haptazi anti-islame, deri te modelet e buta të tolerancës multikulturore, në të cilat theksohet e drejta e Tjetrit (ashtu edhe të muslimanëve), të pranohet nga europianët, pa marrë parasysh faktin që ai Tjetri (pra muslimanët), nuk është europian. Plotësisht është shpërfillur fakti që Europa nuk mund të jetë në mënyrë imanente kristiane, thjesht për arsye se kristianizmi nuk është në mënyrë imanente fe europiane. Jezu Krishti nuk lindi në Europë, as që ka predikuar në Europë. Asnjë nga Pejgamberët e Zotit të tri feve monoteiste nuk ka qenë europian, as që ka predikuar në truallin e Europës. Ka nevojë të

theksohet fakti që kristianizmi thjesht nuk është *fe europiane*, sikurse nuk janë judaizmi, as Islami, por *njëra nga fetë e Europës*, sikurse janë edhe judaizmi dhe Islami! Së këndejmi, qysh me këtë arsye është e domosdoshme në tërësi të refuzohet sintagma e *Europës kristiane*, me të cilën sugjerohet identiteti ekskluziv dhe autentik kristian i Europës. Me këtë rast do ta lëmë anash historinë e gjatë, intensive dhe mjaft të ndërlikuar të përhapjes dhe pranisë së judaizmit në truallin e Europës dhe vetëm shkurtimisht do të kundrohesh kronologjia, dinamika dhe topografia e përhapjes së kristianizmit dhe Islamit në truallin e Europës.

Shumica e europianëve sot me rezervë e pranon të dhënë se në shumë vise të Europës Islami ka arritur herë-herë madje edhe dy shekuj para kristianizmit, e madje edhe më shumë, dhe se, pra, në ato pjesë të Europës për aq kohë më shumë është i pranishëm nga kristianizmi!¹²⁷ Për shembull, edhe pse përhapja e kristianizmit në truallin e Danimarkës së sotme ka filluar në vitin 820, me misionin e Ansgarit nga Amiena, territori i Skandinavisë nuk e ka pranuar kristianizmin para fundit të mijëvjeçarit të parë të erës së re dhe në fillim në shekullin XI; përafërsisht në të njëjtën kohë kur kristianizmi përhapet në Europën lindore dhe qendrore. Kështu Vladimiri, princi i Rusisë së Kievit, e pranoi kristianizmin në vitin 988, thajse në *përputhje* të

¹²⁷ Džavid, Haverić, *Islamization of Bosnia: Early Islamic influence on Bosnian society*, Deakin University, Victoria, 2004. Kjo tezë përfshin një spektër të gjerë referencash dhe materiale bibliografike arkivore, me analizë të hollësishme historike të rrethanave shoqërore të asaj kohe. Përkundër praktikës së përhapur në shkencë, e cila në mënyrë jokritike, e ka mundësi edhe në mënyrë tendencioze, shfaqjen e Islamit në Gadishullin Ballkanik në mënyrë rigorozë e lidh me fillimin e shtetit osman, duke i injoruar kështu dëshmi të shumta të cilat flasin për përhapjen dukshëm më të hershme të Islamit në Evropën juglindore, konkretisht në kufijtë e Bosnjës. Haveriqi në mënyrë të dokumentuar i lëviz këta kufij disa shekuj më herët – madje në mes të shekullit VIII! – që sërish do të thotë se Islami është i pranishëm në Bosnjë plot 12 shekuj dhe se po aq gjatë ka ndikuar në formimin e identitetit të Bosnjës dhe të boshnjakëve!!

përkryer me misionin e vëllezërve Cirili dhe Metodi, të cilët perandori bizantin Mihaili III i dërgoi në zonën e Moravisë, kur kristianizmi depërton në rajonet veriore të Gjermanisë dhe Polonisë së sotme, ndërsa në Hungari kristianizmi zyrtarisht është pranuar në vitin 1001, me dekretin mbretëror.

Dhe ndërsa kristianizmi, me përjashtim të Perandorisë Romake, përhapet nëpër Europë kryesisht nëpërmjet ndikimeve misionariste, apo me pranimin nga ana e shtetit, i cili deri atëherë nuk kishte qenë kristian, Islami në Europë hyn si shtresim kulturor dhe klishe dominuese shpirtërore, në të cilën janë bazuar tre shtete të mëdha, të fuqishme dhe jashtëzakonisht të organizuara. Nga halifati i emevitëve dhe abasitëve, i cili qysh në vitin 711 qe forcuar në truallin e Europës, së pari në Gadishullin Iberik, që më vonë të përhapet në pjesët jugore të Francës së sotme, Zvicrës, sikurse edhe praktikisht në të gjitha ujdhesat e Mesdheut perëndimor. Shkëlqimi i shtetit të ri europian ka tërhequr mendimtarët, shkencëtarët, poetët, matematikanët, artistët udhëheqës kristianë të asaj kohe, që pikërisht atje, në filozofinë islame, në politikë, shkencë dhe art t'i përhapin dituritë e tyre, kurse të perceptuarit e tyre ta thellojnë. Kështu Europa në këto pjesë e ka formuar identitetin e vet *in continuo* plot 781 vjet, prej vitit 711 deri në vitin 1492. Në verilindje të Europës, Islami ka ndikuar në formimin e identitetit europian shpirtëror dhe kulturor, dhe madje thelbësisht e ka përcaktuar nëpërmjet 550 vjetëve të traditës shtetërore të Hordhive të Arta, përkatësisht, Hanatit të Krimit, Kazanit dhe Astrahanit në periudhën prej vitit 1236 deri në vitin 1783. Në juglindje të Europës Islami (duke e përjashtuar periudhën e shembujve sporadikë të përhapjes spontane, të cilët, siç kemi parë, datojnë qysh nga shekulli VIII), e ka konstituuar dhe forcuar praninë e tij në Europë, të legjitimuar me shtetin e ri, vital dhe të fuqishëm

Osman. I pranishëm në truallin e Europës prej fillimit të shekullit XIV, shteti osman qysh në vitin 1365 mori edhe kryeqytetin e saj europian Edirnenë /Jedrenen, Hadrianopolin antik, që në vitin 1453 ta transferojë në Stamboll, që do të thotë se prej atëherë e deri sot, tashmë 750 vjet (më saktë 746), Islami aktivisht ka vepruar në formimin e identitetit të Europës teksualisht në të gjitha sferat e jetës shoqërore, prej fesë dhe filozofisë, nëpërmjet artit, politikës, ekonomisë, deri te kulinaria, traditat zejtare dhe veçanësitë gjuhësore. Nëse tubohen vetëm këto tri epoka monumentale historike të pranisë së Islamit në truallin e Europës nëpërmjet shtetit të bazuar në parimet dominuese islame, përftohet numri më shumë se mbresëlënës prej më se 2100 vjetësh!

Identiteti europian i Bosnjës dhe i boshnjakëve

Pikërisht në këtë kontekst të së vërtetës historike për Europën, të nxjerrë nga faktet objektive, duhet vendosmërisht dhe përfundimisht të refuzohet shablloni i përgjithshëm për *kinse* përplasjen, e *kinse* Europës kristiane dhe *kinse* Islamit anti-europian. Po ashtu, duhet hequr dorë nga shablloni komod por totalisht fiktiv për Bosnjën si për vendin në kufijtë e të cilit më së ashpri është shfaqur rrëfimi për përplasjen *kinse* kulturologjike dhe qytetëruese, të *kinse* Europës progresive kristiane nga një anë, dhe *kinse* kërcënimit barbar destruktiv musliman-oriental anti-europian, të mishëruar në Islam, nga ana tjetër! Minorizimi këmbëngulës i boshnjakëve, ndjenja që *atyre thjesht nuk u takojnë të njëjtat të drejta sikurse edhe popujve të tjerë europianë, dhe kjo vetëm nga arsyeja që janë boshnjakë me radhë muslimanë*, duket edhe sot, madje edhe në qendër të Sarajevës, i vetëkuptueshëm, aq sa ai që do të provonte ta dëshmonte pa-

arsyeshmërinë e paragjykit të tillë, rrezikon të mbetet plotësisht i pakuptuar. Çdo ditë përballemi me dhjetëra shembuj, të cilët konfirmojnë se identiteti kulturor i boshnjakëve krejtësisht spontanisht dhe thuasje *natyrisht* në fakt perceptohet si shenjë e vlerës së ulët kulturore, kurse Islami madje konsiderohet për handicap social, hipotekë e trashëguar nga stërgjyshërit e paarsyeshëm, apo në njëfarë mënyre, si tatuazh i papërshtatshëm, së tepërmi i dukshëm, i cili do të ishte më mirë të fshihej sesa të tregohej, ndërsa gjesti i theksimit të qëllimshëm të Islamit si *tatuazh*, tashmë është kalim në sferën e përgjithësimin publik dhe sjelljes jo të përshtatshme! Gjithashtu, pranohet si krejt normale dhe e arsyeshme ndarja në kombe dhe fe më korrekte, normale dhe progresive, anasjelltas të gabueshme, të përdredhura, të marra, të prapambetura, ndërsa opsioni negativ në të gjitha variantet është rezervuar përjashtimisht për dy kategori: boshnjakët dhe muslimanët. Kurse në shembullin e boshnjakëve, për ta është tautologji e pafavorshme! Sepse pozita e tyre shoqërore, në shkallën e variacioneve nacionale dhe fetare, është, të bëhemi krejt realistë – në përparjen më të ulët. Inferioriteti i tyre a priori i theksuar në receptimin dominues si në Bosnjë ashtu edhe jashtë Bosnjës (ashtu *edhe diç më shumë*, të bëhemi të saktë) konstatohet në të drejtën të cilën secili ia vesh vetes që të polemizojë me boshnjakun për statusin nacional të boshnjakëve dhe që me krenari të refuzojë të gjitha përgjigjet e tij si marrëzi të dukshme. Vetëm me boshnjakun, keni kujdes – dhe me askënd tjetër! Gjithashtu, të gjitha fetë e tjera qenkan gjëra private të besimtarit, vetëm Islami qenka gjë publike si e ateistëve, ashtu edhe besimtarëve, por gjithsesi jo-muslimanëve, dhe vetëm muslimanët duhet të turpërohen apo së paku, të ndiejnë pakënaqësi që janë muslimanë!? Në po këtë çelës në të cilin boshnjakëve (e përbri kësaj edhe muslimanëve)

u është ndarë roli i grupit sub-kulturor shoqëror të perceptuar në mënyrë inferiore, në mediat publike dhe në tryezat e rrumbullakëta të kritikëve të filmit, kritikohet Angjelina Zholi, që në këtë filmin e saj¹²⁸ të gjitha viktimat janë boshnjakët, kurse të gjithë kriminelët serbë?? Pas një mijë filmave në të cilët të gjitha viktimat janë hebrenjtë dhe të gjithë kriminelët gjermanë, si kjo që askujt nuk i ka rënë në mend ta bëjë të njëjtën vërejtje!? Mbase nuk është vonë? Mbase dikush thjesht nuk është kujtuar, nuk ia ka vrarë syrin!? Por vetëm tash u kujtuan, kur boshnjakët, të cilët gjithnjë ishin vetëm *ata* të cilët duhet të ulen, të heshtin, në mënyrë debile të qeshin me barcoletat ofenduese kundër tyre, dhe rregullisht të fitojnë menjëherë në sytë e dikujt, vlerësimi i të cilit nuk mund të injorohet, janë trajtuar njësoj si trajtohen popujt e barabartë dhe të mirëfilltë!? Shih, shih, ç'paska dëshiruar kjo Angjelina Zholi, që boshnjakët t'i bëjë të barabartë me *ne*! E kjo, me *ne*, këta janë të gjithë të tjerët, sepse ose të themi, e njëjta vërejtje, tipike e poetit boshnjak në leximin publik të poezisë (të cilat, krahas kësaj, i transmeton edhe TV) që në poezitë e veta vajton vetëm boshnjakët, duke kujtuar: “Po nuk janë vrarë vetëm boshnjakët. Janë vrarë edhe serbët!” Kush ndonjëherë ka bërë vërejtje përse *Stojanka Majka Knezhpoljka*, ka vajtuar mbi bijtë e saj Srgjanin, Mrgjanin, Mllagjanin (të kujtojmë se këtë poezi e ka shkruar Skender Kulenoviç, poet i mirëfilltë dhe zotëri i vërtetë, i cili në këtë poezi ka heshtur *Halidin, Hasanin dhe Hamzën* e vrarë), dhe përse nuk ka lejuar që edhe Fra Hilde të vajtojë për *Frankun, Ernestin dhe Klausin* e vet, të cilët gjithashtu janë vrarë, dhe pikërisht

¹²⁸ *Toka e gjakut dhe mjaltit*. Titulli i filmit pa dyshim është huazuar (pa leje natyrisht!) nga autori i librit F. M. i cili sintagmën etimologjike *Ballkan*, e ka shpjeguar me fjalët turke “Ball” + “Kan” = “Mjaltë” + “Gjak”, pra Ballkan = *Vendi i gjakut dhe mjaltit*. Teksti me këtë zbërthim etimologjik është botuar në vitin 2002.

në Kozarë dhe në Knezhpolje!? Ose si ndodh që askush, kurrë, në asnjë kritikë apo paraqitje gojore nuk e ka qortuar Nënë e Jugoviqëve, që vajton vetëm nëntë djemtë e saj dhe *të dhjetin*, Jug-Bogdanin e vjetër!? Si ndodh që madje askush nuk u gjet të qortonte që kjo nënë heroike, nuk i vajton edhe fëmijët e tjerë, të themi, përse nuk e vajton fatin e ndonjë *Jusuf-beu të vjetër* dhe *nëntë Jusufëve të tij të vegjël*, të cilët kanë mundur, së paku në lirinë poetike, të emërtoheshin kështu, kurse janë vrarë edhe ata sigurisht! Sepse, nuk duhet as të flitet për faktin se edhe në Kosovë dhe në betejat e tjera në të cilat kanë fituar turqit, janë vrarë jo vetëm të humburit kushdo qofshin ata, por edhe fituesit, turqit. Gjithashtu, do të ishte gjithsesi origjinale e sigurisht edhe estetikisht jashtëzakonisht efektive, që në ndonjë poemë apo ndonjë vepër letrare artistike të shfaqej personazhi i nënës, e cila vajton edhe rininë e vrarë të palës kundërshtare, së cilës i kanë vrarë bijtë e saj para se vetë të jenë vrarë. Por do të ishte në këtë diç njëmend e prishur, e përmbysur, një çarje në dijen themelore të thellë të brendshme, në siguri dhe vetësiguri të asaj dijeje, urtësisë sociale dhe të mirësjelljes *se duhet të mbetet e drejtë e pacenueshme për të gjithë që secili t'i vajtojë të vetët!*

Jo! Edhe njëqind herë – jo! Kjo pallavër për kërcënimin musliman-oriental, anti-europian të mishëruar në një popull ashtu të zbutur dhe të matur, aq të qetë dhe me prirje për kontemplim siç janë boshnjakët, është çelësi i mosmarrëveshjes, ajo është burimi i armiqësisë religjioze, gjenerator i përjetësimit të paragjyqimeve kulturologjike, motiv i të gjitha përplasjeve dhe alibi për çdo gjenocid të kryer ndaj evropianëve-muslimanë në truallin e Europës! Nëse do ta shikojmë agresionin mbi boshnjakët në vitet 1992-1995, të gjitha krimet masive, përndjekjet, gjenocidet, a nuk duket vallë *shqetësuese* për popullin e *butë* që asnjë i vetmi përfaqësues i tij, në mllefin e drejtë,

në dhembjen shpirtërore për miqtë e vvarë, fëmijët, farefisën, nuk e ka kaluar Drinën, apo Unën për të kryer ndonjë diversión, ta ketë vvarë dikë, qoftë të ketë gjuajtur që shpirtit t'i jepte pak qetësi!? Çfarë kërcënimi mund të jetë populli i cili vërtet, por vërtet, vetëm mbrohet dhe nuk ndërmerr kurrfarë sulmesh në territore të huaja – sepse këtë nuk ia lejon ndërgjegjja e tij kulturore!? Edhe më shumë, kërcënim për Europën? Nëse do t'i shikojmë faktet, do të shohim se Europa kristiane pakrahasueshëm më gjatë ka luftuar me vetveten sesa me Europën muslimane. Luftërat brenda-fetare, sidomos brenda-kristiane, zënë më shumë se 92% të kohës së përgjithshme të cilën Europa e ka konsumuar në luftëra!? Dhe kjo nuk është pak kohë! Vetëm një luftë ndërmjet Anglisë kristiane dhe Francës kristiane, në të vërtetë, lufta më e gjatë, ka zgjatur 114 vjet. Nëse kihën parasysh luftërat të cilat i kanë zhvilluar Franca dhe Spanja, Gjermania dhe Franca, Spanja dhe Italia, Polonia dhe Rusia, Suedia dhe Polonia, Ukraina dhe Rusia, Polonia dhe Ukraina, do të fitohet një pasqyrë shumë më e saktë e historisë moderne europiane, kurse përqindja e dukshme e theksuar do ta fitonte shpjegimin e vet logjik. Me përjashtim të Kryqëzatave, Europa, duke folur prerazi, kurrë nuk ka luftuar kundër ndonjë kontinenti tjetër – konkretisht, të themi, kundër Azisë, e cila është burimi i përbashkët i tri feve të mëdha monoteiste: edhe judaizmit, edhe kristianizmit edhe Islamit! Nga ana tjetër, as halifati emevit, përkatësisht, abasit në truallin europian, as Komonvelli Osman¹²⁹, kurrë nuk kanë luftuar kundër kurrfarë unioni fantazmë, i cili do të mund ta identifikonte veten arsyeshëm me emërtues të përbashkët si Europa, por gjithnjë kun-

¹²⁹ Ky është përafërsisht përkthimi më i saktë i sintagmës “Osmanlı Devleti“, pra emërtimit zyrtar të shtetit, të konceptuar si *Bashkësia Osmane e Popujve*, e cila pa të drejtë dhe në mënyrë jopërkatëse identifikohet si *Perandori*.

dër këtij apo atij shteti kristian, sikurse ka ndodhur edhe e kundërta.¹³⁰ Luftërat në Europë shumë më shpesh janë zhvilluar si brenda-fetare,¹³¹ si brenda segmentit kristian, ashtu edhe brenda segmentit islam, sesa si konflikte brenda-fetare. Po ashtu, në truallin e Bosnjës, gjatë tërë kohës së ekzistimit dhe brenda kufijve të shtetit osman, si organizatë e themeluar mbi parimet e Islamit, praktikisht nuk është zhvilluar asnjë konflikt më serioz ndër-fetar në vijën muslimanë-kristianë, sikurse përndryshe në tërë territorin e Ballkanit, ku konfliktet e para më të mëdha

¹³⁰ Sunduesit feudalë të Evropës intensivisht kanë angazhuar njësi luftarake të muslimanëve si ushtri mercenare në luftëtat e brendshme qysh prej shekullit XI e deri në fund të shekullit XVII. Në territorin e Bosnjës, kur ushtritë e bashkuara të Hungarisë, Venedikut, sikurse edhe ushtria e Dubrovnikut, e kanë sulmuar Stjepan Kosaçin, ndihmë dhe shpëtim u solli ushtria muslimane e udhëhequr nga Barak-beu dhe Isa-beu, bijtë e Is'hak beut. Një nga shembujt më të njohur është ndihma të cilën Gazi Orhani i ofroi mbretit bizantin Kantakuzenit për ta mundur kundërshtarin e vet të fuqishëm, të mbështetur nga ushtria superiore serbe dhe bullgare, më 26 tetor 1241. Nga ana tjetër, sunduesit kristianë, vasalët evropianë të shtetit osman, në periudhën prej shekullit XIV deri në fund të shekullit XVI, i kanë ofruar përkrahje të fuqishme ushtarake muslimanëve osmanë në luftërat, si kundër kristianëve ashtu edhe kundër kundërshtarëve muslimanë. Instanca më e njohur por asesi edhe e vetmja e këtij bashkëpunimi të shtrirë të shfrytëzimit të ndihmës ushtarake të luftëtarëve të fesë tjetër, në luftë kundër kundërshtarëve të fesë vetjake, përbën vdekja heroike e Mark Kraljeviqit në Rovinë më 1393, i cili vdiq duke luftuar në anën e osmanlinjve kundër dukës vllah Mirçetës. Është interesante të theksohet se duka i dytë vllah më 1411 drejtpërdrejt i ka ndihmuar të birin e Bajazitit, Musa Çelebiun, që ta kthente qytetin të humbur më parë, Bursën, sikurse edhe luftërat në të cilat, si aleat i ushtrisë osmane, si kundër kundërshtarëve kristianë ashtu edhe muslimanë, ka marrë pjesë despoti Stevan Lazareviq (përndryshe i biri i princ Llazarit, i cili vdiq në Betejën e Kosovës në vitin 1389), sidomos lufta e tij e njohur heroike në vijën e fundit të mbrojtjes së Sulltan Bajazitit, kundër Tamerlanit (Timur-Lengut, pranë Ankarasë në vitin 1402.

¹³¹ Të kujtojmë luftërat katolike, protestante dhe të kristianizmit ortodoks lindor, të disave kundër të tjerëve, por po ashtu edhe luftërat reciproke të shteteve të vogla brenda secilës të këtyre opsioneve kristiane; gjithashtu, kryengritjet fshatare, luftërat qytetare dhe sidomos, luftërat më të mëdha të Napoleonit, Luftën I dhe II Botërore, Evropa jo-islame i motivon dhe i arsyeton plotësisht në mënyrë të pavarur nga kontrapunkti kinse vendimtar i konfrontimit qytetërues-kulturor të kristianizmit dhe Islamit.

shpërthyen vetëm në fillim të shekullit XIX, të frymëzuara prej interesave strategjike të monarkisë Austro-Hungareze e Rusisë dhe drejtpërdrejt të ndihmuara fillimisht nga këto dy vende, e pastaj edhe nga Britania. Përkundër kësaj, Bosnja, gjatë kësaj kohe, ka mbajtur mend disa konflikte serioze brenda-fetare në Bosnjë, ndërmjet feudalëve-muslimanë boshnjakë dhe pushtetit qendror të shtetit osman, Portës së Lartë në Stamboll!

Kur është fjala për shtetin osman si shtet evropian dhe pjesës së mbetur të Europës, duhet folur për luftën e shtetit ekspansionist, të fuqishëm evropian, kundër vargut suksesiv të një apo më shumë shteteve të Europës. Komonvelti Osman ishte shtet evropian para vargut të shteteve të tjera europiane, kurse Turqia e sotme ka traditë shumë më të gjatë të shtetit nga shumë shtete europiane të cilat ekzistojnë sot. Transferimi i kryeqytetit nga Bursa në Anadollin, thellë në truallin evropian, në Edirne, Jedrene, këtë fakt e ka shënuar drejtpërdrejt dhe pakontestueshëm! Të mbrohet ky shtet në kufijtë e tij evropianë, për të gjithë banorët e saj muslimanë, nuk e kishte më kuptimin të mbrohej, përkatësisht, të sulmohej shteti joevropian nga Europa, por pikërisht të mbrohej apo të sulmohej një shtet evropian nga shteti tjetër evropian /shtetet e tjera europiane! Ashtu si Bosnja gjithnjë ka qenë dhe deri sot ka mbetur po aq rajon evropian, sikurse janë edhe Normandia, Bavaria apo Toskana, kështu edhe boshnjakët gjithnjë kanë qenë dhe deri më sot kanë mbetur evropianë, sikurse këtë janë edhe francezët, gjermanët apo italianët!

Së këndejmi është plotësisht e paarsyeshme të këmbëngulet në tezën, sa faktikisht të gabueshme, aq fatkeqe sipas implikacioneve, se boshnjakët, si popull i cili e ka pranuar Islamin, *e kanë mbrojtur Shtetin Osman kundër Europës dhe fqinjëve evropianë, dhe se kjo ka shpënë deri te profilizimi i boshnjakëve si*

popull i cili identitetin e vet e ka kundruar në kundërshtim me vlerat europiane. Pikërisht kjo tezë ideologjikisht e fabrikuar dhe në mënyrë flagrante e pavërtetë ka sjellë më vonë deri te stigmatizimi i Bosnjës si ujdhesë aziatike në truall të Europës dhe shpalljen e boshnjakëve për popull oriental të prapambetur, të kthyer kundër rrjedhave progresive europiane, që ka rezultuar me praktikën sistematike të denacionalizimit të boshnjakëve me të gjitha mjetet (mos disi, nga ata do të ndaheshin *europianët e vërtetë*), e cila, deri më sot, nuk ka humbur aspak nga kolonializmi dhe prozelitizmi i saj!

Kuriozitet të veçantë paraqet edhe pohimi, i pranuar sipas parimit *copy-paste*, se Bosnjën gjatë tërë kohës së Shtetit Osman, nga pjesët e tjera të Ballkanit, e ka dalluar njëfarë strukture specifike demografike, thelbësisht e ndryshme sipas përbërjes së vet fetare dhe etnike. Duhet ditur se përbërja etnike dhe fetare e popullsisë ka qenë mjaft e ngjashme, deri në atë shkallë, e cila dallimet ekzistuese i ka margjinalizuar deri te faktori plotësisht indiferent, praktikisht në tërë territorin e Bosnjës, Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë, e madje edhe Bullgarisë. Pikërisht ky fakt, dhe orvatja e neutralizimit të tij energjik, ka qenë shkaku kryesor i politikës sistematike të gjenocidit, përndjekjes, me një dinamikë e cila e ka pasuar kronologjinë e pavarësimit të secilit nga këto territore të veçanta, dhe kryqëzimit të dhunshëm të popullsisë muslimane në këto territore, me dinamikën e cila ka ndjekur kronologjinë e pavarësimit të secilit nga këto territore veç e veç nga pushteti i Shtetit Osman! Sikur, në pajtim me pohimin e theksuar, në territoret të cilat kufizohen me Bosnjën, e para së gjithash në Serbi dhe Mal të Zi, tashmë paska ekzistuar një përbërje thelbësisht e ndryshme demografike, dhe se boshnjakët, përkatësisht muslimanët atje kanë përbëkan një përqindje të parëndësishme të popullsisë kompakte kristiane, krahas

kësaj edhe etnikisht qartë të diferencuar, të gjitha ato masa të politikës brutale të gjenocidit demografik dhe kulturor, të cilat kanë filluar të zbatohen nga çasti i parë i përshtatshëm, do të ishin jo vetëm të panevojshme, por edhe praktikisht të pamundur. Sepse, cilët boshnjakë do të mund t'i shpërngulnin dhe kryqëzonin, çfarë *hulumtimi të poturicave (turkoshakëve - përkthyesi)* do të mund t'u drejtoheshin, kë do të mund ta vrisnin dhe përndiqnin, nëse nuk do të kishte boshnjakë muslimanë!? Dhe nëse kanë qenë një *grusht njerëzish*, si do të mund të likuidoheshin tinëzisht, natën, pa dëshmitarë dhe pa trumbetim me një tullumbace me të cilën është përkrahur përhapja e urrejtjes ndaj boshnjakëve dhe Islamit!? Është trumbetuar me ato tullumbace, sepse atëherë kishte boshnjakë dhe muslimanë, po ashtu sikurse edhe sot trumbetohet edhe në Bosnjë, edhe në Europë, sepse ende ka edhe boshnjakë edhe muslimanë! Së këndejmi, çdo kundërvënie e kristianizmit dhe Islamit dhe rrëgjimi i raportit të tyre në rezistencë të Europës progresive ndaj invadimit të orientalëve primitivë, përkatësisht, në konflikt të papajtueshëm të Europës kristiane dhe Orientit islam, zbulon aty për aty në thelbin e vet ideologjik të prodhimit të mitologjisë së intonuar në mënyrë nacionaliste dhe të falsifikateve historike të përmasave më të mëdha, në shërbim të politikës së anti-islamizmit të pakompromis!

Mirëpo, pikërisht (për standardet e pushteteve të orientuara anti-islame), përqindja tepër e lartë e boshnjakëve dhe muslimanëve në strukturën demografike dhe fetare të shteteve të porsaformuara fqinje, para së gjithash Serbisë dhe Malit të Zi, qe keqpërdorur si alibi e ashtuquajtur për nevojat e politikës së përndjekjes së tyre të pamëshirshme, që të tregoheshin pasqyra e atillë demografike, etnike dhe fetare, si u duhej pushteteve të shteteve të vogla të reja në Ballkan, të cilat në këtë mënyrë për-

gatitën argumentet për planet e tyre hegjemoniste të okupimit të Shqipërisë, Bosnjës, Sanxhakut, Kosovës, Maqedonisë, Thra-kies dhe Greqisë veriore, të cilat deri në luftërat ballkanike, më 1912, ende gjendeshin jashtë pikarritjes së tyre, nën kontrollin e Portës së dobësuar. Nëse merret parasysh e dhëna se, për shembull, në Beograd në vitin 1809, kanë jetuar rreth 92% boshnjakë (muslimanë, të cilët pa të drejtë janë identifikuar si *turq*, sepse vetëm rreth 15% të të gjithë muslimanëve të banuar në Beograd kanë qenë turq etnikë), atëherë lehtë mund të përfundohet se pikërisht kjo ka sjellë deri te masakra e tmerrshme masive dhe kryqëzimi i dhunshëm i popullsisë të këtij qyteti po atë vit, të cilat e shtynë Leopold Fon Ranken që të protestonte ashpër dhe me pezmatim t'i gjykonte aksionet e këtilla të kryengritësve të Karagjorgjit! Për përndjekjet dhe likuidimin masiv të boshnjakëve nga Mali i Zi, si nga zonat bregdetare ashtu edhe nga zonat e Podgoricës, Nikshiqit, Zhabljakut, Prijepoljes, Shahoviqit, Bjello Poljes, dëshmojnë shumë dokumente, kurse politika e përndjekjes së boshnjakëve, është vazhduar intensivisht me vrasjen e disa mijë civilëve nga ana e çetnikëve serbë dhe malazezë gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe sikurse është e njohur, është ripërtërirë në gjithë territorin e Bosnjë-Hercegovinës, si edhe në disa pjesë të Malit të Zi, edhe në periudhën 1992-1995.

Fakti që struktura etnike dhe fetare e popullsisë në Bosnjë ka mbetur relativisht e qëndrueshme, dhe nuk ka pësuar ndërrime drastike në raport me periudhën përfundimtare të pranisë osmane në Ballkan, i detyrohet aneksimit të Bosnjës nga ana e Austro-Hungarisë. Sado qoftë kjo paradoksale, pikërisht okupimi i Bosnjës i shpëtoi boshnjakët si segment musliman të popullsisë së saj, nga fati mjaft i besueshëm i shfarosjes dhe përndjekjes totale fizike. Ky skenar i këtillë i dhunshëm duket aq

më real, kur kihet parasysh fakti se Serbia dhe Mali i Zi, menjëherë pas arritjes së pavarësisë edhe formale, e në realitet edhe më herët, kanë filluar me realizimin e ndërrimit strategjik të planifikuar radikal të strukturës etnike dhe fetare, me të gjitha mënyrat, e para së gjithash me mjete të dhunshme, duke rrëgjuar në mënyrë drastike proporcionin e boshnjakëve muslimanë, me përndjekjen e tyre, vrasjen masive dhe kryqëzimin e dhunshëm. Logjika e akullt e kësaj politike të dhunshme, në mënyrë plotësuese vërtetohet nëpërmjet përcjelljes së zonës të intensiteteve të ndryshme të presionit mbi popullsinë boshnjake dhe përgjithësisht, mbi popullsinë muslimane në rajon. Pasi Bosnja ra nën kontrollin e Habsburgëve, boshnjakët dhe popullsia muslimane mbetën jashtë pikërritjes së ambicieve gjenocidale të Serbisë dhe Malit të Zi. Formalisht, pushteti i Portës, sado kjo e dobët dhe pa forcë të vërtetë, ka qëndruar edhe 33 vjet në zonat e Shqipërisë, Sanxhakut, Kosovës, Maqedonisë, Greqisë veriore dhe Thrakies, dhe kështu në tërë rajonin ka penguar goditjen e parë të politikës gjenocidale të shteteve të posaformuara të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë, të cilat tashmë pamëshirshëm e kanë praktikuar brenda kufijve të tyre të drejtpërdrejtë. Vetëm falë këtij fakti, popullata boshnjake ka mbijetuar dhe ka ruajtur identitetin e vet pikërisht në ato rajone. Kufijtë brenda të cilëve deri sot është ruajtur përqindja shumë më e lartë e boshnjakëve dhe përgjithësisht, të muslimanëve, ku deri sot gjendet numri shumë më i madh i xhamive, teqeve, medreseve dhe objekteve të tjera të ruajtura të arkitekturës islame, sikurse janë hanet dhe hamamet, bezistanet, çarshitë, si të thuash me milimetër përputhen me kufijtë e kësaj zone. Sa për ilustrim, mjafton të krahasohet fakti se, deri te tërheqja e shtetit osman nga këto hapësira, Serbia perëndimore, nga Shabaci deri në Uzhice, ka qenë e banuar me popullatën

shumicë boshnjake, përkatësisht muslimane, e cila, në qytetin Uzhice arrinte thuhetse 98%, e që për më pak se dy vjet më vonë, boshnjakët tashmë kanë qenë pakicë, deri sa në vetë Uzhice mezi se ka mbetur ndonjë boshnjak, me faktin se, në të gjitha rajonet brenda zonës së theksuar të ndikimit të shtyrë mbrojtës të shtetit osman, përqindja e popullsisë muslimane është ndryshuar më pak për këto njëqind vjet nga luftërat ballkanike deri sot, sesa në dhjetë vitet e para, në cilëndo pjesë të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë, që mbeti jashtë kësaj zone! Këtu është momenti i duhur që, sado qoftë në mënyrë sipërfaqësore dhe në vija të trasha, edhe të shikohet karakteri shprehimisht antiislam i politikës së shteteve europiane kristiane perëndimore dhe lindore (katolike dhe ortodokse) ndaj boshnjakëve muslimanë. Edhe pse boshnjakët paraqisnin grupin etnik/nacional qartë të përcaktuar, kompakt dhe koheziv, tërheqja e shtetit osman solli deri te dërrmimi nacional i boshnjakëve dhe diskriminimi i ashpër ndaj boshnjakëve muslimanë. Qysh nga mesi i shekullit XIX boshnjakët kanë paraqitur bashkësi etnike kompakte dhe unike – *një popull me tri fe* – mund të pohohet në bazë të shumë fakteve. Gjithsesi, njëri ndër faktet më kryesore paraqet *Naçertanja*, libërthi prej 3.000 fjalëve, të cilën e shpalli Ilija Garashanin. Edhe pse themelues i hegjemonizmit dhe nacionalizmit modern serb, krijuesi i idesë për Serbinë e Madhe, Ilija Garashanin krejt qartë i emërton banorët e Bosnjës dhe Hercegovinës si boshnjakë, të cilët ndahen në boshnjakë të fesë ortodokse, boshnjakë të fesë katolike dhe boshnjakë të fesë ‘muhamedane’. Nëse madje edhe një serb padyshim nationalist ekstremisht i orientuar shkruan qysh në vitin 1844, që në Bosnjë jetojnë vetëm dhe të vetmit boshnjakët dhe këtë boshnjakët muhamedanë/muslimanë; boshnjakët ortodoksë, duke mos i theksuar serbët as me emër; boshnjakët katolikë, me ç’rast as

kroatët nuk i thekson as me emër¹³², atëherë është krejt e qartë që fshirja e boshnjakëve, krahas shndërrimit paralel të boshnjakëve ortodoksë në serbë, dhe të boshnjakëve katolikë në kroatë, është pjesë e programit të madh ideologjik të planifikuar dhe me jotolerancë fetare të frymëzuar të shteteve europiane kristiane perëndimore dhe lindore. Synimi ka qenë të hiqen të gjitha gjurmët e pranisë autoktone të Islamit në truallin e Europës të cilët në pjesën më të madhe gjendeshin në atë kohë në truallin e Bosnjës; të fshihen, depërtohen apo vriten të gjithë muslimanët autoktonë europianë, pjesa më e madhe e të cilëve në atë kohë ishin pikërisht boshnjakët në tërë territorin e Ballkanit, sikurse edhe shqiptarët, është dëshmi e drejtpërdrejtë se shtetet europiane kristiane perëndimore dhe lindore, të cilat me shpirt dhe në çdo rast i ndihmonin kryengritjet e ortodoksëve dhe katolikëve, banorë të shtetit osman, drejtpërdrejt refuzuan të ndihmojnë të dyja kryengritjet kundër shtetit osman, të cilat i patën organizuar edhe boshnjakët dhe shqiptarët. Shkaku është i qartë dhe i thjeshtë, edhe pse deri sot nuk është publikuar nga motivet e qarta ideologjike dhe për shkak të censurës së rreptë, e cila edhe sot është në shërbim të falsifikimit apo fshehjes së të dhënave të cilat mundësojnë që të arrihet imazhi i saktë i pranisë së muslimanëve në përbërjen e popujve autoktonë europianë, dhe efekteve pozitive kulturore, politike dhe qytetëruese të Islamit në historinë europiane.

Siç është e njohur, me përfundimin e luftës ruso-turke, e cila solli Paqen e Edrenesë, e lidhur më 14 shtator 1829, shtetet europiane e detyruan shtetin osman t'i dorëzojë, ndër territoret e tjera, edhe gjashtë nahi të cilat ishin edhe në mënyrë adminis-

¹³² Konvertimi i boshnjakëve katolikë në kroatë, do të ndodhë në vitin 1901, në Koncilin e Madh të mbajtur në Zagreb, kur Kisha Katolike drejtpërdrejt do të ndikojë në transformimin etnik.

trative, edhe në mënyrë territoriale, edhe në mënyrë etnike historike pjesë të Bosnjës. Ato pjesë iu ndanë Serbisë, e cila arriti edhe statusin e autonomisë në suaza të shtetit osman. Kështu, nën presionin e fuqive ortodokse dhe katolike, pjesë të territoreve të boshnjakëve muslimanë u përcollën në pronësi të serbëve kristianë dhe këtë brenda, qoftë formalisht, një shteti të njëjtë. Po këto shtete, sidomos Austria dhe Rusia, me gjithë shpirt dhe me të gjitha mjetet i ndihmonin kryengritësit serbë kundër shtetit osman, si gjatë Kryengritjes së Parë në vitin 1804, ashtu edhe gjatë Kryengritjes së Dytë në vitin 1815. Mirëpo, kur Husein kapiten Gradashçeviq nga fundi i dhjetorit 1830 në Gradaçac, sikurse edhe gjatë janarit dhe shkurtit në Tuzëll, ka përgatitur e pastaj edhe ka përgatitur dhe ka realizuar kryengritje të organizuar në mënyrë të shkëlqyeshme kundër administratës osmane, asnjë shtet ortodoks as katolik nuk deshi ta ndihmojë. Edhe pse Husein Gradashçeviq korri dy fitore të mëdha¹³³, edhe pse me këtë ndjeshëm e lehtësoi punën në luftë për rënien përfundimtare të shtetit osman, kryengritja e tij nuk mori absolutisht kurrfarë ndihme nga ana shteteve katolike, përkatësisht ortodokse të Europës, të angazhuara në konflikt. Kërkesat e tij që në përbërjen e Bosnjës të kthehen gjashtë nahi, të cilat historikisht i përkisnin, të cilat u ishin marrë boshnjakëve muslimanë dhe u ishin ndarë serbëve ortodoksë, që të miratohet autonomia e Bosnjës, sikurse që në të njëjtën kohë është miratuar autonomia e Serbisë, krahas obligimit që Bosnja edhe më tej të paguajë kontributin vjetor ndaj shtetit osman, nuk i përgjigjeshin planeve që Islami tërësisht të çrrënjoset nga trualli i Europës ndërsa muslimanët të vriten, kryqëzohen dhe dëbohen.

¹³³ Të parën në Betejën te Travniku, më 26 mars 1831, në aleancë me Mustafa Shkodra-pashën, udhëheqësin e luftëtarëve shqiptarë për autonomi, të dytën më 18 korrik në Kosovë kundër vetë vezirit të madh, pas së cilës Husein kapiteni edhe e mori nofkën "Dragoi nga Bosnja".

Qëndrimi i njëjtë negativ është marrë edhe ndaj kërkesave për formimin e shtetit autonom shqiptar, në kontekstin e lëvizjes të njohur si *Lidhja e Prizrenit*, me detyrë të mbrojtjes së të drejtave të popullit shqiptar, të filluar gjithashtu në çastin e përshtatshëm për Rusinë, Serbinë dhe Malin e Zi, si aleatë në luftë kundër shtetit osman të zhvilluar në vitin 1878. Mundësia që shqiptarët, si populli shumicë muslimane, ta fitojë shtetin e vet, ishte plotësisht e papranueshme për të tria këto shtete tradicionalisht anti-muslimane, sikurse edhe për fuqitë katolike europiane.

Prandaj, të gjitha zonat e Ballkanit në tërësi, e jo vetëm territorin e Bosnjës, brenda kufijve të shtetit osman, deri në vetë fundin e ekzistimit të tij, kanë prezantuar shembullin tipikë të shoqërisë shprehimisht multietnike dhe multifetare. Përndjekja masive dhe sistematike e boshnjakëve dhe muslimanëve nga territoret në të cilat janë formuar shtetet e para të pavarura pas largimit të shtetit islam, është motivi kyç psikologjik i armiqësisë ndaj boshnjakëve dhe të gjithë muslimanëve (shqiptarëve, turqve, pomakëve, torbeshëve/goranëve), e cila deri sot sundon fuqishëm në këto shtete (Serbi, Mal të Zi, Greqi, Bullgari); pikërisht efikasiteti dhe lehtësia relative e dëbimit thuajse total të muslimanëve jashtë kufijve të territorit në të cilën janë formuar këto shtete, ka sjellë deri te frustrimi patologjik dhe pakënaqësia që boshnjakët dhe muslimanët në territorin e Bosnjës, Sanxhakut, Kosovës dhe Shqipërisë ende janë aty, që mbijetuan në një përqindje, e cila është lart mbi atë që zanafillisht qe planifikuar!

Duke e parë qartë se çfarë u ka ndodhur vendasve të tyre, boshnjakëve dhe të gjithë muslimanëve në territoret nga të cilat shteti osman është tërhequr, duke kuptuar se nga fati i tillë i ruante ende vetëm prania e Portës, sado që ishte e qartë se tashmë ishte duke dhënë frymën e fundit, është plotësisht e qartë përse muslimanët e këtyre territoreve kanë konsideruar

se për ta ikja dhe shkatërrimi i Osmanlı Devletit, do të ishte i barabartë me një katastrofë! Shpesh boshnjakëve u mbahen leksione historike, politike, pragmatike por edhe morale, sepse, sikurse edhe kristianët, bashkatdhetarët e tyre dhe bashkëqytetarët e tyre shumëshekullorë në tërësi të shtetit të përbashkët, me kohë nuk nisën luftën për çlirimin e tyre nacional dhe kështu ta *zinin rendin* për njohje nacionale dhe shtet nacional!? Lufta për çlirim të plotë nacional të boshnjakëve, sipas shembullit të shteteve fqinje, për boshnjakët, objektivisht asnjë çast nuk merrej parasysh, as atëherë as tash (mjafton të kujtohet se si, pas shpartallimit të RSFJ, është pritur vendimi legjitim i qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës për formimin e shtetit të pavarur, të manifestuar me shumicën dërrmuese në referendum, para 20 viteve, dhe aq është në pikëpyetje emancipimi i tyre i plotë nacional madje edhe sot)¹³⁴, sepse ishte krejt e qartë që mbijetimi i boshnjakëve muslimanë nuk ishte në duart e tyre dhe se formimin e shtetit të tyre nacional, nuk do ta lejonte asnjë prej shteteve fqinje, të cilat edhe sot mezi presin që nga Bosnja të grabisin çkado që mund të grabisin. Shkurt, rrënimi i shtetit osman, përkatësisht, largimi i tij përfundimtar nga tërë territori i Bosnjës, i ballafaqoi bosh-

¹³⁴ Fakti se referendumi për pavarësimin e Malit të Zi, edhe pse me përqindje shumë më të ulët të votave për një vendim të këtille, në Serbi është pranuar vetëm me llomotitje, por pa edhe një të vetmin incident të armatosur! Fakti që pas vendimit të referendomit për krijimin e shtetit të pavarur të Bosnjës dhe Hercegovinës, opinioni i Serbisë dhe Malit të Zi, sikurse edhe të gjitha partitë e tyre politike pa përjashtim, ka kërkuar aksion ushtarak me arsyetimin se *serbëve as-kush nuk mund t'ua imponojë në cilin shtet do të jetojnë*. Është e qartë se ky përcaktim universal negativ është pikërisht lidhur me boshnjakët, kurse prezente është edhe inercia historike sipas së cilës serbët kanë legjitimitet t'u imponojnë vullnetin e vet boshnjakëve, sepse serbët janë *popull kristian*, kurse boshnjakët janë *muslimanë*. Pikërisht ashtu si në bazë të po këtij paragjykimi negativ, shumica e kristianëve evropianë konsiderojnë se kanë të drejtë t'ua imponojnë vullnetin e vet muslimanëve evropianë, në bazë të hierarkisë së thjeshtë kulturore!

njakët me situatën skajshmërisht dramatike, të cilën e përkufizojnë vargjet e R. M. Rilkes:

Tash kush mund të flasë për fitoren?

Tash mjafton për të mbijetuar!

Kurse ajo që tek i priste boshnjakët, nuk premtonte madje as këtë minimum: që të mbeteshin gjallë!

Por, rastin e vërtetë për emancipim nacional e morën pikërisht kristianët e Bosnjës, pra, ortodoksët dhe katolikët, të cilët, në themele të kishave përndryshe të centralizuara në mënyrë shtetërore dhe nacionale fuqishëm të organizuara (si kisha ortodokse, e cila në këto hapësira vepron, si të thuash *by default*, si serbe, ashtu edhe katolike, e cila në këto hapësira gjithashtu *by default* konsiderohet si kroate) praktikisht pa përjashtim, veten shumë shpejt, dhe menjëherë pas aneksimit në vitin 1878, në aspektin nacional e kanë identifikuar si serbë, përkatësisht si kroatë. Është mjaft e rëndësishme të hidhet poshtë paragjykimi i përhapur se boshnjakët, si të thuash, për fajin e tyre, nga pakujdesia, në çdo rast, me gabim vetjak, e refuzuan rastin e shkëlqyeshëm ta ndiqnin këtë shembull dhe që gjithashtu ta identifikonin veten nacionalisht e jo fetarisht. Kjo është me rëndësi vendimtare së paku për dy shkaqe, të cilat deri sot, nëse duhet thënë – plotësisht pa arsye!?! – shfrytëzohen kundër boshnjakëve.

I pari, boshnjakëve nuk u është lënë kurrfarë rasti që të deklarohen kombëtarisht si boshnjakë, por të deklarohen si serbë, përkatësisht si kroatë dhe kështu pak a shumë vullnetarisht të anojnë drejt denacionalizimit vetjak përfundimtar. Madje edhe vetë termi *boshnjak* zyrtarisht është tabuizuar në atë masë, që ky emërtim burimor, i vjetër më shumë se një mijë vjet (Dobri Boshnjani-Boshnjanët e Mirë), tërësisht është zhdukur nga përdorimi në territorin e Bosnjës dhe Hercego-

vinës.¹³⁵ Boshnjakëve u qe lënë vetëm mundësia të pranohe-shin si *muslimanët tanë* (që do të thoshte *serbë*, përkatësisht *kroatë*,¹³⁶ varësisht nga ajo se cila popullatë kristiane është më e shumtë në ato pjesë, ortodokse apo katolike). Kjo u bë plotësisht e qartë kur për boshnjakët u fut zëri *I papërcaktuar*, e cila qartë qe konceptuar për një kohë krejt të shkurtër, dhe në fakt vetëm në implikim ka mundur korrektësisht të lexohet si: *Tash për tash, edhe një kohë, i papërcaktuar*, por së shpejti do të duhet që të përcaktohet ose si serb (i turqizuar) apo si kroat (i islamizuar), gjatë së cilës në çdo gjendje në mënyrë të përhershme do të stigmatizohen për shkak të fesë së tyre! Ndërkaq nuk duhet harruar se plani për denacionalizimin total të boshnjakëve dhe përgatitjen e asimilimit të tyre përfundimtar në korpusin nacional të serbëve dhe kroatëve, ka qenë në mënyrë plotësuese i fuqizuar me ndalimin zyrtar të përdorimit publik të sintagmës *gjuha boshnjake*. Kuptohet, në tërë territorin e BH edhe më tej flitej pikërisht *gjuha boshnjake*, sikur edhe sot flitet, por domethënia e kësaj ndalesë është e qartë: të fshihet nga vetëdija e boshnjakëve edhe kujtimi për emrin e vet, gjuhën e vet, traditën dhe kulturën e vet, shkurt, vetë vetëdijen për identitetin vetjak;

¹³⁵ Vetë autori i këtij teksti është befasuar dhe gati u ndie i ofenduar, kur, për herë të parë në jetë, në Maqedoni e kanë quajtur *boshnjak!* Në Bosnjë dhe Hercegovinë, sikurse edhe në Mal të Zi dhe Serbi, emri nacional i boshnjakëve plotësisht qe çrrënjësuar, ashtu që edhe sot krijon konfuzion të caktuar e edhe pakëndshmëri në këto shtete, sikurse edhe ndër boshnjakët nga territori i Bosnjës dhe Hercegovinës, ku ende ka efekt negativ në vetidentifikimin e boshnjakëve të këtyre zonave në regjistrimet e popullsisë. Deklarimet si *musliman*, *malazez musliman*, *meqedonas-musliman*, e madje edhe si rajon, sikurse *saxhakli*, *pillavian* e të tjera, paraqesin aberracione reziduale deri te të cilat ka sjellë ndalesa sistematike dhe totale e përdorimit të emrit nacional të boshnjakëve në këto zona. Nga ana tjetër, në Maqedoni, në Kosovë, në Shqipëri, sikurse edhe në Bullgari, pra atje ku nuk ka ekzistuar mundësia reale e asimilimit të boshnjakëve, emri tradiconal nacional i boshnjakëve është ruajtur deri sot.

¹³⁶ Për serbët, boshnjakët janë “renegatë serbë” (srpski otpadnici), kurse për kroatët ata janë “lule kroatë” (hrvatsko cvijeće) – Përkthyesi.

I dyti, pamundësia objektive që në themele të barabarta të deklarohen nacionalja dhe fetarja, vetvetiu (madje edhe sikur të ishte lëshim i boshnjakëve, kurse e pamë se nuk ishte) nuk ka pasur ndikim në planet tashmë qysh moti të përgatitura dhe të përpunuara hegjemoniste të fqinjëve që Bosnjën dhe Hercegovinën ta përvetësojnë, ta grabisin, përkatësisht ta ndajnë sikurse që plaçkitësit e ndajnë prenë e tyre. Këto plane jo vetëm që nuk e merrnin parasysh ç'do të thonë dhe ç'do të bëjnë boshnjakët, por me realizimin e tyre boshnjakëve u është mbyllur goja dhe u janë lidhur duart pikërisht që asgjë as nuk do të thoshin, asgjë as nuk do të bënin, derisa në tërësi, qoftë zyrtarisht, *në letër*, nuk do të asimiloheshin. Reforma agrare e pamëshirshme me të cilën iu mor baza themelore e mbijetimit të boshnjakëve si grup shoqëror relativisht i organizuar, këtë e bëri praktikisht të pashmangshme. Ruajtja e identitetit nacional, kulturor, gjuhësor dhe fetar të brezave të rinj të boshnjakëve, në ato rrethana ashtu u reduktua në detyrë të cilën mund ta merrnin vetëm edhe loket dhe nënat e tyre! Dhe këtë vetëm ndërsa fëmijët nuk rriten. Para se t'i marrë klisheja e jetës shoqërore, armiqësore edhe ndaj emrit të tyre, edhe ndaj kulturës së tyre, dhe sidomos, ndaj fesë së tyre!

Se këtë detyrë, në kushtet pikërisht të pamundura, e kanë kryer në mënyrë shembullore, e kanë vërtetuar ngjarjet në fillim të themelimit të shtetit të pavarur të Bosnjës dhe Hercegovinës, anëtare të barabartë të Kombeve të Bashkuara. Edhe pse shenjat e fundit të identitetit nacional kulturor dhe fetar të boshnjakëve atëherë tashmë qenë dobësuar krejtësisht dhe dukej sikur boshnjakësia është në grahamat e fundit, ndjenja nacionale u zgjua befasisht nga koma vetëm kur filloi orvatja e drejtpërdrejtë dhe maksimalisht e organizuar e përndjekjes dhe shfarosjes fizike të boshnjakëve dhe shkatërrimit total të

të gjitha shenjave të identitetit të tyre nacional, kulturor, fetar dhe historik!

Përfundim

Gjithnjë ndërsa stereotipi sundues ideologjik për kristianizmin evropian dhe Islamin joeuropian/anti-islam në tërësi nuk hiqet nga përdorimi dhe këtë në të gjitha nivelet e komunikimit, nuk do të jetë e mundur që të kundrohet e vërteta e thjeshtë edhe e pamohueshme që:

1. Europa nuk është përjashtimisht kontinent kristian, por po aq edhe islam, ndërsa duhet pasur parasysh se as kristianizmi, as Islami nuk kanë prejardhje nga Europa, kështu që as njëri as tjetri besim nuk kanë të drejtë as në identitetin immanent evropian, as në autoktoninë evropiane;

2. Bosnja është vend integral evropian, kurse boshnjakët janë popull autokton, qysh moti dhe birvaktile evropian;

3. Fakti se boshnjakët e kanë mbrojtur aktivisht një shtet islam në përbërje të të cilit ka hyrë Bosnja, është e bazuar në faktin se me shumicë të madhe e kanë pranuar Islamin. Sikurse është e njohur, kristianët dhe qytetarët e tjerë të shtetit osman të cilët vendosën të mos e pranonin Islamin, kanë pasur privilegj të madh që të mos kryenin ushtrinë, përkatësisht, qenë të liruar nga detyrimi ushtarak;

4. Duke luftuar për shtetin e tyre në përbërje të të cilit kanë jetuar 400 vjet, boshnjakët e kanë mbrojtur Bosnjën si vend evropian, boshnjakët si popull evropian, Islamin si fe evropiane, gjuhën boshnjake si gjuhë evropiane, traditën dhe kulturën e tyre si traditë dhe kulturë evropiane;

5. Miti për Europën kristiane dhe Islamin anti-evropian, më së qarti zbulohet si stereotip ideologjikisht i fabrikuar pikë-

risht në truall të Bosnjës. Shekujt e jetës harmonike të besimtarëve kristianë, muslimanë dhe hebrenj, nga një anë më së fuqishmi ndriçojnë faktin se, sikurse edhe Bosnja, edhe tërë Europa, në fakt ka rast të papërsëritshëm të bëhet vend i jetës së përbashkët, ndërveprimit dhe harmonisë së këtyre tre feve të mëdha monoteiste. Dhe me tërë të kaluarën e kohës së re, dhe me potencialet të cilat i bartë ne vete si model multikulturor i së ardhmes, Bosnja është paradigmë e mirëfilltë qytetëruese, historike dhe kulturore e Europës *at its best*, pra me imazhin e saj më të mirë! Kjo është ajo e vërtetë të cilën drejtpërdrejt e vërtetojnë të gjitha faktet dhe të cilën, si të tillë, duhet ta pranojnë dhe respektojnë, përkundër të gjitha tentimeve ideologjike të motivuara që Islami, Bosnja dhe boshnjakët të përjash-tohen nga Europa dhe historia europiane.

Literatura

1. Abdullah, M. Salim. 1995. Muslims in Germany. In *Muslim Minorities in the West*, eds. Syed Z. Abedin and Ziauddin Sardar. London: Grey Seal.
2. Abedin, Syed Z., and Ziauddin Sardar, eds. 1995. *Muslim Minorities in the West*. London: Grey Seal.
3. Amiraux, Valerie. 1996. Turkish Islam in Germany. In *Political Participation and Identities*, eds. W.A.R. Shadid and P.S. Koningsveld. Kampen, NL: Kok Pharos.
4. Baumgartner, Frank R., and Beth L. Leech. 1998. *Basic Interests: The Importance of Groups in Politics and in Political Science*. Princeton: Princeton University Press.
5. Hippler, Jochen, and Andrea Lueg, eds. 1995. *The Next Threat: Western Perceptions of Islam*. Trans. Laila Friese. London: Pluto Pres.
6. Hodgson, M.G.S. 1974. *The Venture of Islam: Conscience and History in a World Civilization*. 3 vols. Chicago: University of Chicago Press.
7. Huntington, Samuel P. 1993. The Clash of Civilizations? *Foreign Affairs* 72 (3): 22–49.
8. Hussain, Dilwar. 2003. The Holy Grail of Muslims in Western Europe: Representation and their relationship with the state. In *Modernizing Islam. Religion and the Public Sphere in the Middle East and Europe*, eds.

9. Karakasoglu, Yasemin, and Gerd Nonneman. 1996. Muslims in Germany with special reference to the Turkish-Islamic community. In *Muslim Communities in the New Europe*, eds. Gerd Nonneman et al. London: Ithaca Press.
10. Kettani, M. Ali. 1996. Challenges to the organization of Muslim communities in Western Europe: The political dimension. In *Political Participation and Identities of Muslims in Non-Muslim States*, eds. W.A.R. Shadid and P.S. van Koningsveld. Kampen NL: Kok Pharos, 14–35.
11. King, Russell, ed. 1993. *The New Geography of European Migrations*. London: Belhaven Press.
12. Klausen, Jytte. 2005. *The Islamic Challenge*. Oxford: Oxford University Press.
13. Lewis, Bernard. 1982. *The Muslim Discovery of Europe*. New York: Norton. 1993. *Islam and the West*. New York: Oxford University Press.
14. Nielsen, Jorgen. 1992a. *Muslims in Western Europe*. Edinburgh: Edinburgh University Press. - 1992b. *Religion and Citizenship in Europe and the Arab World*. London: Grey Seal.
15. Noiriel, Gerard. 1988. *Le Creuset Français. Histoire d'Immigration XIX-XX Siècles*. Paris: Seuil.
16. Pedersen, Lars. 1999. *Newer Islamic Movements in Western Europe*. Aldershot: Ashgate.
17. Shadid, W.A.R., and P.S. van Koningsveld, eds. 1996a. *Muslims in the Margin: Political Responses to the Presence of Muslims in Western Europe*. Kampen, NL: Kok
18. Soysal, Yasemin Nuhoglu. 1994. *Limits of Citizenship: Migrants and Postnational Membership in Europe*. Chicago: University of Chicago Press.
19. Syed Muhammad Naquib al-Attas, (1995) *Prolegomena to the Metaphysics of Islam*, Kuala Lumpur, ISTAC.
20. Tanovic, Bakir, *Historija Bosne u okviru Osmanskog carstva*, Svjetlost, Sarajevo, 2010.
21. Taspinar, Omer. 2003. Europe's Muslim Street. *Foreign Policy* 135 (March-April): 76–7.
22. Ternisien, Xavier. 2002. *La France des Mosques*. Paris: Albin Michel.
23. "Religion and the Political Organization of Muslims in Europe" by Carolyn M. Warner and Manfred W. Wenner, *Perspectives on Politics*, September 2006.

IDENTITETI NACIONAL SI MOTIV KYÇ PËR PRANIMIN APO MOSPRANIMIN E ISLAMIT NË BOSNJË

Si u ruajt, pas fundit të tij *fizik*, shteti i Bosnjës si *koncept*, i cili gjatë katër shekujsh e gjysmë është sendërtuar pa shtet vetjak, kurse me pak apo aspak shpresë se sërish prapë do të ishte, e ka lidhur dhe integruar vetëdijen nacionale dhe kulturore të boshnjakëve në një paradigmë unike politike, e cila ka mbijetur deri sot dhe solli deri te krijimi i shtetit bashkëkohor, të pavarur dhe sovran të shtetit të Bosnjës dhe Hercegovinës? Cilat motive thelbësisht kanë përcaktuar kalimin vullnetar në Islam të shumicës së boshnjakëve? Dhe një pyetje po aq e rëndësishme, paralele, të cilën deri sot askush nuk e ka shqyrtuar: Cilat motive ishin vendimtare në zgjedhjen vullnetare të shumicës jo-boshnjake, pjesëtarë të popujve të tjerë në territorin e Bosnjës, që mos ta pranojnë Islamin? Çfarë roli ka luajtur modeli ekonomik, politik dhe kulturor i Islamit në formësimin konkret të vetëdijes nacionale dhe identitetit kulturor të boshnjakëve bashkëkohorë?

Teza 1: Boshnjakët menjëherë e pranuan Islamin që ta ruanin identitetin e vet të rrezikuar nacional dhe e kanë ruajtur legjitimitetin e vet të krijimit të shtetit, të arritur me themelimin e shtetit të Bosnjës dhe konstituimin e pushtetit shtetëror në territorin e Bosnjës, të cilin me vendosjen e pushtetit osman e kishin humbur në kohë të pacaktuar.

Pyetja 1. Si ndodhi kjo, që disa popuj fqinjë, përveç shqiptarëve (bullgarët, grekët, maqedonët, serbët, malazeztë), sikurse edhe serbët dhe kroatët e Bosnjës, nuk e bënë të njëjtën gjë, përkatësisht nuk e kanë pranuar menjëherë Islamin?

Përgjigja 1. Identiteti i tyre nacional dhe kulturor nuk ishte i rrezikuar. Ata të cilët e kanë deklaruar veten dhe mbijetuan si serbë dhe kroatë, kanë jetuar në kufijtë e shtetit mesjetar të Bosnjës, nga një anë, gjithashtu nuk janë rrezikuar në aspektin nacional dhe kulturor me ardhjen e shtetit osman islam, ndërsa nga ana tjetër, synimi i tyre skajor ka qenë përvetësimi i territoreve të shtetit të Bosnjës. Me fjalë të tjera, ndërsa boshnjakët nuk kishin kurrfarë *shteti rezervë* jashtë kufijve të shtetit të vet, Bosnjës, këta banorë të Bosnjës shtetin e tyre amë e lidhnin për Serbinë dhe Kroacinë, kurse identitetin e tyre nacional e përjetonin si përkatësi të serbëve, përkatësisht kroatëve, që do të thotë se për ta edhe shteti i Bosnjës dhe boshnjakët si pronarë legjitimë të shtetit, janë perceptuar në kontekst të dyfishtë: Bosnja si territor mbi të cilën qysh moti e kanë hedhur shikimin, duhej përvetësuar në rastin e parë të përshtatshëm; boshnjakët si pengesa kryesore në realizimin e këtij synimi, ishin një pengesë e cila, në rastin e parë të përshtatshëm, duhej hequr!

Në raport me territoret e shteteve të sotme të Greqisë, Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi, mbi të cilët sovranitetin e vendosi shteti osman, pushteti islam as atje nuk ka kryer kurrfarë presioni mbi identitetin nacional dhe kulturor të këtyre popujve. Fakti që në kufijtë e dikurshëm të këtyre shteteve, pasi qenë marrë nga Perandoria Osmane, popujt shumicë kryesisht nuk e kanë pranuar Islamin, ndërsa, dhe këtë në shkallë të lartë, Islamin e kanë pranuar ata, identiteti i nacional dhe kulturor i të cilëve, nën presionin e pikërisht atyre popujve të njëjtë shumicë, kishte mbërritur në fund të mbijetimit, e vërteton këtë qartë. Bashkësitë e sotme etnike praktikisht qind për qind muslimane, siç janë torbeshët, goranët - në truall të Maqedonisë dhe Kosovës; pomakët në Bullgari, boshnjakët në pjesë të Malit të Zi dhe Serbisë, përkatësisht në territorin e Sanxhakut, në të cilat gjithnjë kanë jetuar,

ndërsa në një periudhë kanë qenë madje në përbërje të shtetit të Bosnjës – përbëjnë edhe një ilustrim shembullor dhe dëshmi substanciale! Me saktësi të përkryer mund të ndiqet vija sipas së cilës logjika e rrezikshmërisë së drejtpërdrejtë nacionale, thuhetse *përpikërisht* pajtohet me vijën e pranimi të Islamit në Ballkan dhe me praninë e bashkësive muslimane në tërë territorin e tij! Fakti se këto bashkësi kanë qenë të rrezikuara, mund të ketë vetëm një kuptim, duke pasur parasysh rrethanat të cilat e kanë përcaktuar një status të këtillë në këtë periudhë: praktikisht pa përjashtim, këto kanë qenë të gjitha bashkësi të vetë bogomilëve! Në rastin e boshnjakëve, krahas këtij momenti të përbashkët të përkatësisë dominuese bogomile, si faktor i fuqishëm plotësues në favor të pranimi të Islamit, rol të veçantë ka luajtur fakti i ekzistimit të shtetit vetjak. Me këtë strategji *e mbijetimit për shkak të rimëkëmbjes së shtetit nacional*, është rrumbullakësuar në imperativin: Ruaje dallimin prej të tjerëve dhe bëhu ai që je, sepse vetëm ashtu mundesh ndonjëherë sërish ta kthesh atë që është e jotja! Edhe pse shqiptarëve, të cilët u qenë ekspozuar presioneve dhe përndjekjeve të fuqishme nga ana e Bizantit, e pastaj prej normanëve dhe shteteve sllave, për shkak të veçanësive të tyre të theksuara etnike dhe gjuhësore nuk iu qe rrezikuar identiteti nacional, pranimi i Islamit edhe për ta, pa kurrfarë dyshimi, ka paraqitur shpëtim të idesë së popullit shtetformues.

Identiteti i atyre të cilët kanë vendosur që mos ta pranojnë Islamin, nuk është rrezikuar në asnjë variant, pa marrë parasysh a kanë qenë popull shumicë apo demografikisht popull më i vogël brenda shteteve të dikurshme ballkanike. Përkundrazi, me ruajtjen e lirë të përcaktimit fetar jo-islam (në numrin më të madh të rasteve ortodokse apo katolike) në mënyrën më të mirë është garantuar ruajtja e përhershme dhe manifestimi i papenguar social i të gjitha elementeve të atij identiteti, dhe

këtë duke pasur parasysh dy faktorët kryesorë: i pari, pranimi i Islamit ka qenë çështje e zgjedhjes personale dhe për vendimin që ky opsion të mos pranohet nuk kanë pasuar kurrfarë sanksionesh; e dyta, e sipas rëndësisë larg në vend të parë, të gjithë ata që mbeten në statusin e jo-muslimanëve, ishin të liruar nga detyrimi ushtarak, sikurse është thënë më parë! Popujt e tjerë të cilët jetonin në territorin e Bosnjës nuk e pranuan Islamin sepse Bosnjën nuk e ndienin si shtetin e tyre amë, por në të shihnin si një territor, i cili duhej grabitur, plaçkitur prej atyre të cilëve u përket, kur për këtë të trokasë çasti i vërtetë.

Teza 2. Jo-boshnjakët me shumicë nuk e kanë pranuar Islamin, që, ruajtjen e identitetit fetar, mungesën e së drejtës për shtetin e Bosnjës ta amortizojnë me statusin e *popullit të robëruar kristian (katolik dhe ortodoks), i cili është liruar nga robëria islame.*

Pyetja 2. A do të thotë kjo që popujt e tjerë nga territori i shtetit mesjetar të Bosnjës, të cilët nuk qenë rrezikuar (para së gjithash serbët dhe kroatët), nuk e kanë pranuar Islamin, sepse për këtë nuk kanë pasur kurrfarë motivesh strategjike?

Përgjigjja 2. Pikërisht kjo! Ata Bosnjën nuk e kanë pranuar si shtetin e tyre, përkatësisht, si shtetin në të cilin do të mund të manifestonin ambicie të barabartë siç e kanë pasur themeluesit e tij dhe banorët autoktonë qysh moti - boshnjakët. Pranimi i Islamit për ta do të ishte vetëm humbje e pamotivuar e përparësisë së rëndësishme në projektin e përvetësimit të territorit të Bosnjës në bazë të statusit të popullit të nënshtruar, kur ndonjëherë Perandoria Osmane të tërhiqet dhe t'ua dorëzojë këto territore shteteve kristiane. Nuk kushton asgjë, kurse do të sjellë shumë! Tash apo më vonë! E meqë gjërat qëndronin mirë për të gjithë kristianët në Perandorinë Osmane dhe duke i marrë parasysh pessimet nëpër të cilat kanë kaluar muslimanët, shumë shpejt u bë e qartë: sa më vonë aq më mirë! Popujt *kristianë (katolikë dhe or-*

todoksë) në territoret e Bosnjës, pikërisht vetëm në statusin e jo-muslimanëve kanë mundur të prezantojnë apo prezantonin pararojën e të gjithë hegjemonistëve të ardhshëm, prej atyre serbo-mëdhenj dhe kroatomëdhenj, deri te ata jugosllavë, si mbretërorë ashtu edhe socialistë, të maskuar në “çlirues të vëllezërve të tyre kristianë (*katolikë dhe ortodoksë*)”, të vendosur dhe me të vërtetë që mëtojnë ta fshijnë çdo gjurmë të boshnjakëve, ta shkatërrojnë ndjenjën për shtetin Bosnjë dhe që më në fund, pas asaj pritjeje të madhe, t’i përvetësojnë territoret e saj!

Që ta verifikojmë konsistentësinë e këtyre tezave me fakte, sikurse edhe me veprime, të boshnjakëve dhe joboshnjakëve në territorin e Bosnjës, duke përcjellë ndodhitë të cilat kanë pasuar, do të përpiqemi, që në vija themelore ta rikonstruojmë të vërtetën e ngjarjes historike në periudhën prej pesë shekuj e gjysmë, si një lloj rikonstruksioni të historisë autentike nacionale të Bosnjës dhe boshnjakëve, të shtruar nëpërmjet veprimit të *fuzionit të horizonteve* (në kuptimin që kësaj sintagme ia jep Hans-Georg Gadamer-i), dhe shenjës së saktë të kontureve të shtresave arkeologjike të pjesës së historisë së Ballkanit dhe Bosnjës.

Dy fakte janë thelbësore për perceptimin e kësaj çështjeje deri tash të pasqaruar dhe madje të injoruar! Fakti i parë është lidhur me Islamin si përkatësi fetare e boshnjakëve/boshnjanëve, e cila pas tërheqjes së pushtetit islam nga këto territore dhe marrjes së pushtetit nga ana e popujve kristianë, ka shërbyer si alibi për përndjekjet dhe sulmet sistematike shekullore të shteteve dhe popujve fqinjë ortodoksë dhe katolikë (të cilët me numër më të vogël gjithashtu kanë qenë të vendosur në truallin e shtetit të Bosnjës, para së gjithash, serbët dhe kroatët) mbi boshnjakët dhe shtetin e tyre, Bosnjën. Fakti i dytë thelbësor është se në kohën e ardhjes së Perandorisë Osmane boshnjakët tashmë kishin pasur një traditë të gjatë të shtetit nacional. Bosnja, e cila në një periudhë ka qenë

madje shteti-mbretëri më i fortë në rajon, atëherë, pos kufijve të tanishëm, përfshinte praktikisht edhe tërë Dalmacinë, nga Zara deri në Herceg-Novii, përveç Peljeshacit dhe Mljetit, duke futur edhe ujdhesat Braç, Hvar dhe Korçullë. Në kohën e ardhjes së Shtetit Osman, Bosnja tashmë ishte krejtësisht e dobësuar, e rras-kapitur me luftërat e gjata të pushtuesve ortodoksë dhe katolikë, të cilët i pengonte bogomilizmi boshnjak dhe *Kisha boshnjake*. Të dy këto fakte kanë ndikuar vendosmërisht në raportin e boshnjakëve ndaj Islamit dhe thelbësisht kanë përcaktuar kalimin e tyre në Islam. Serbët, nën ndikimin e fuqishëm të kishës serbe ortodokse dhe shtetit serb, e shihnin Bosnjën si territorin, i cili në të ardhmen duhej t'i *ngjitej* Serbisë, pjesërisht si territor i pushtuar, e pjesërisht si territor i kolonizuar, në të cilin tashmë qenë vendosur enklavat e popullsisë së ortodoksizuar dhe serbizuar. Konkretisht, këto aspirata më së fuqishmi kanë qenë të përqendruara pikërisht përgjatë zonës së ndarjes historike të Bosnjës dhe Serbisë, sidomos gjatë lumit Drina deri te Gryka e tij në Savë, sikurse edhe në territorin e Bosanska Krajines, ku pushteti osman i ka vendosur serbët (vllëhtë) si kufitarë ndaj perandorisë habsburgase, të cilët në këtë mënyrë qenë bërë një lloj i enklavës ortodokse serbe, të ndërtuar nga pushteti islam i Perandorisë Osmane, për t'i ruajtur kufijtë e saj. Në mënyrë të njëjtë, ambiciet kroate që ndonjëherë në të ardhmen të liroheshin nga raporti gjysmë-vasalë ndaj monarkisë austro-hungareze dhe të realizonin ëndrrën shekullore për shtetin e pavarur, janë bazuar si në realizimin e sovranitetit të plotë shtetëror të vetë Kroacisë, ashtu edhe në aneksimin e të gjitha zonave kufitare të Bosnjës, duke filluar nga zonat bregdetare të Dalmacisë dhe passhpinës dalmatine, duke futur edhe pjesë të Bosnjës rreth bregdetit dhe përgjatë malit Dinara në jug përbri lumit Neretva, përkatësisht në veri të Bosnjës në zonën e Posavinës dhe teposhtë, gjatë lumit Bosnja deri në Sarajevë. Katolicizimi i fuqishëm i po-

pullsisë së këtyre zonave, me shekuj e përforcuar intensivisht me të gjitha mjetet nga ana e Vatikanit dhe shteteve fqinje katolike, para së gjithash Hungarisë, Venedikut dhe dinastisë harbsburgase, ka zhvilluar te kroatët ndjenjën e një lloji të së drejtës parësore në ato territore, nëse jo si kroate, atëherë gjithsesi si zona në të cilat Kroacia e quan se ka të drejtë më të madhe, duke marrë parasysh përbërjen e popullsisë shumicë.

Edhe për Serbinë edhe për Kroacinë, ruajtja e përkatësisë ortodokse përkatësisht katolike të këtyre banorëve të ortodoksuar, përkatësisht të katolicizuar në truallin e shtetit të Bosnjës, ishte me rëndësi shumë të madhe, së pari si kusht i formimit dhe ruajtjes së veçanësisë së tyre nacionale si serbë dhe kroatë, e pastaj edhe sepse me këtë është ruajtur baza historike kulturore dhe demografike e aspiratave të planifikuara për aneksimin e këtyre pjesëve të shtetit të Bosnjës dhe përfshirjes së tyre në tërësinë e shteteve nacionale të Serbisë, përkatësisht të Kroacisë. Kjo, jashtë çdo dyshimi, ka qenë dhe deri sot ka mbetur synimi më i lartë, përfundimtar i politikës nacionale të Serbisë dhe Kroacisë ndaj Bosnjës, synim i cili e ka përcaktuar thelbësisht edhe zgjedhjen e popullsisë ortodokse, përkatësisht katolike të Bosnjës, që mos ta pranonte Islamin. Një vendim i tillë atyre u shkonte shumë për dore për shkak se, në kushtet e tolerancës së lartë fetare të Perandorisë Osmane, nuk ka qenë e lidhur me kurrfarë ndikimesh, as me keqësimin e dukshëm të kushteve të jetës për shkak të mbajtjes së përcaktimit ortodoksë, katolikë. Përkundrazi, fakti se në shtetin osman të gjithë banorët jo-muslimanë kanë qenë të liruar nga detyrimi ushtarak, u ka siguruar jetën e tyre të qetë dhe ekzistimin biologjik dhe i ka vënë në pozitë pakrahasueshëm më të përshtatshme kundrejt bashkëqytetarëve të tyre kristianë në suaza të shteteve kristiane! Përparësia e madhe e këtij lëshimi ka kontribuar

drejtpërdrejt jo vetëm në mbijetimin e qëndrueshëm dhe rritjen e përhershme të popullsisë kristiane në kufijtë e Perandorisë Osmane, konkretisht në Bosnjë, por edhe në rritjen e saj demografike periodikisht spektakolare në territorin e Perandorisë Osmane, veçanërisht në truallin e Bosnjës, ku, pikërisht në kohën e shpërthimeve të tilla demografike, lulja e popullatës boshnjake muslimane, e rekrutuar në ushtrinë osmane, ka vdekur me mijëra dhe është sakatosur në mënyrë sistematike në luftërat e përhershme të cilat i ka zhvilluar perandoria. Të dhënat krahasuese demografike për të njëjtat rajone në Bosnjë, sidomos nga mesi i shekullit XVI deri në fund të shekullit XVIII, tregojnë se boshnjakët si popullatë, kanë kaluar nëpër ngurtësime të gjata demografike dhe periudha të përkohshme jashtëzakonisht negative të rritjes së popullsisë, që në disa rajone të Bosnjës kanë vënë në pikëpyetje edhe mbijetimin e tyre fizik.

Pra, për popullsinë ortodokse dhe katolike banuese në territorin e shtetit mesjetar të Bosnjës, ruajtja e përkatësisë së pandryshueshme fetare gjatë tërë periudhës së sundimit islam, ka sjellë shumë më tepër dobi sesa dëme të drejtpërdrejta ekonomike, që shkaktoheshin nga dallimi në madhësinë e tatimit (edhe ashtu minimal), dhe u ka siguruar privilegje shumë më të mëdha, për të cilët pranimi i rolit pasiv shoqëror nga fakti se shërbimin dhe funksionin aktiv shtetëror në Perandorinë Osmane mund ta kryenin vetëm muslimanët, ka qenë më shumë se çmim i volitshëm! Si e para, statusi i jo-muslimanëve u ka garantuar jetë të qetë dhe të sigurtë si individë, ndërsa, si popuj (serbëve dhe kroatëve), njëkohësisht u ka mundësuar rritje demografike, me mundësitë optimale që pa pengesa të zhvillohej potenciali i tyre biologjik. Si e dyta, edhe pse si më e rëndësishmja dhe e para në suaza të strategjisë nacionale, ruajtja e statusit të jo-muslimanëve ka pasur rëndësi thelbësore politike! Rënia e Perandorisë

Osmane mund të parandihej. Shpartallimi i shtetit osman, ka sjellë drejtpërdrejt edhe humbjen e territoreve, sidomos në Ballkan dhe veçanërisht në Bosnjë. Gjithashtu, krejt logjikisht mund të parashihej se deri te kjo humbje do të vihej nën presionin e vendeve kristiane *katolike dhe ortodokse* të Europës.

Me fjalë të tjera, që pas dëbimit të osmanlinjve nga territori i Ballkanit, fuqitë e mëdha, si vende kristiane, do t'i japin autonomi politike popullsisë kristiane (*katolike dhe ortodokse*) e assesi popullsisë muslimane, kjo ka qenë edhe më lehtë dhe e sigurtë të parashikohej. Në këtë aspekt, vendimi që të ruhej përkatësia fetare kristiane *katolike dhe ortodokse*, në çdo aspekt i shkonte për dore popullsisë jo-boshnjake, pa marrë parasysh që gjithashtu ishte e qartë se do të duhej durim dhe se do të zgjaste, derisa të arriheshin kushtet për realizimin e planit që, krahas fitimit të shtetit vetjak, të grabiteshin edhe territoret e Bosnjës! Ruleti ishte kurdisur, kokrra e vogël tashmë kërcente dhe vringëllonte; pos kohës dhe durimit kurrfarë investimesh të reja nuk kanë qenë të nevojshme, kurse fitimi ka qenë i garantuar paraprakisht. Dhe ky ishte fitim i madh! Nëse jo e tëra, atëherë gjysma e shtetit të huaj!! Gjysma e Bosnjës ortodoksëve, gjysma e Bosnjës katolikëve dhe *Bosnja mbetej e qetë*. Kuptohet, boshnjakëve, për arsye se janë muslimanë, asgjë! As deri atëherë, ndërsa Perandoria Osmane ishte në fuqi të plotë, jo-muslimanët askund, e ashtu as në truallin e Bosnjës, nuk i ishin ekspozuar kurrfarë presioni ta pranonin Islamin, as qenë detyruar që me ndonjë mënyrë ta ndërronin fenë e tyre; tash, kur prej perandorisë më të fuqishme në botë, kishte mbetur vetëm *i sëmuri i Bosforit*, për ndonjëfarë presioni as që mund të bëhej fjalë. Për këtë arsye, sado të zgjaste, gjendja e pritjes ishte plotësisht e përbalueshme; dhe në fund, çasti qartas më i rëndësishëm ka qenë ekzistimi i tyre i garantuar fizik dhe rritja demografike, ndërsa në këtë kontekst zgjatja e shpartallimit të Perandorisë

Osmane ishte sidomos e çmueshme pikërisht për kristianët *katolikë dhe ortodoksë*, dhe madje drejtpërdrejt u shkonte për shtat synimeve të tyre! Përgjatë më së paku tre shekujve, ndërsa boshnjakët muslimanë kalonin nëpër sprova duke luftuar me mijëra kilometra larg Bosnjës (sprova të cilat, për fat të keq, deri sot nuk janë hulumtuar sistematikisht edhe pse, për ngushëllim, janë kënduar në këngët epike heroike popullore të boshnjakëve me bukurri dhe vlera estetike artistike të pakapërcyeshme) - popullsia jo-muslimane dhe kristiane *katolike dhe ortodokse* e Bosnjës ka pasur privilegj të papërsëritshëm të gëzonte të mirat në *Pushimin e kombit*, të mundësuar me gjakun e fqinjëve të tyre, boshnjakëve muslimanë, në vendin e të cilëve qysh moti e kishin hedhur shikimin. *Pushimi i kombit* është rast krejt i rrallë, *bingo* i mirëfilltë në historinë e çdo populli. Nuk ka dyshim se popujt ballkanikë kurrë nuk do të njiheshin, sikur mos të ishte fati kyç i rrethanës –Perandorisë Osmane, e cila i lejonte liri çdo feje, të gjitha gjuhëve, të gjitha kulturave, kurse ata nënshtetas të cilët nuk dëshironin ta pranonin Islamin, i shpërblente në mënyrë plotësuese, duke i kursyer nga ushtria dhe luftimet! Dhe vërtet, humbjet shumë më të mëdha demografike edhe të serbëve edhe të kroatëve do të pasojnë pas largimit të osmanlinjve, të cilët kishin qenë drejtpërdrejt dhe pa mëdyshje *mbrojtësit* e tyre, kështu që kjo periudhë e sigurisë u ka mundësuar që këto humbje t'i përballonin, që kur të vinte koha të përfundonte dhe *pushimi* i tyre i gjatë *i kombit*.¹³⁷

Në dritën e të gjitha këtyre rrethanave, për banorët e Bosnjës të cilët kanë qenë kristianë (ortodoksë apo katolikë), ruajt-

¹³⁷ Në këtë tregon edhe domethënia e termit burimor arab *dhimmi* - *i mbrojtur*, klient i shtetit islam, i përdorur për popullatën jo-muslimane në vendet e posapushtuara. Në pajtim me ligjet të futura sidomos nga halifi Omer Ibn el-Hattabi, *dhimmitët* kanë mbajtur pronat e tyre tokësore, kanë pasur lirinë e tyre të plotë të predikimit dhe praktikimit të fesë së tyre, kanë qenë të barabartë para ligjit (lidhur me rigorozitetin për të cilin ky parim është dashur të respektohet janë ruajtur anekdota të shumta nga ajo kohë), dhe janë *liruar nga shërbimi ushtarak dhe luftimi*.

ja e statusit të tyre kristian *katolikë dhe ortodoksë* ka qenë imperativ absolut, që në bazë të këtij statusi t'i ruante argumentet për realizimin e strategjisë nacionale të aneksimit të territoreve të shtetit të Bosnjës në përbërje të shteteve nacionale të Serbisë, përkatësisht Kroacisë, kur ndonjëherë të piqeshin rrethanat historike për konstituimin e tyre. Taktika e tyre ishte pritja, sepse koha punonte për ta. Në mënyrë plotësuese, dy gjëra kanë qenë të domosdoshme. E para, duhet pa tjetër maksimalisht të shfrytëzohet toleranca e Perandorisë Osmane, që të përhapet dhe forcohet prania ortodokse dhe katolike në truallin e Bosnjës, e me këtë në mënyrë shtesë të vërtetohen edhe aspiratat nacionale shtetërore për ato territore; e dyta, ka pasur nevojë të përgatitet terreni për denacionalizim dhe më vonë, për asimilim të boshnjakëve në "serbë" dhe "kroatë", përkatësisht, për përndjekjen e të gjithë atyre boshnjakëve të cilët e refuzojnë këtë, me arsyetimin se janë "turq" dhe se duhet të shkojnë me turqit e tjerë. Me ta, themeluesit e dikurshëm dhe pronarët e vetëm legjitimë të shtetit të Bosnjës, diçka duhet të bëhej, sidoqoftë. Llogaria ishte e thjeshtë, kurse rezultati mund të parashikohej pagabueshëm: sa më shumë kohë që kalon, mundësia e asimilimit të plotë të boshnjakëve në "serbë", përkatësisht në "kroatë" (me kryqëzimin e tyre, pra kalimin në fenë ortodokse / katolike) bëhet gjithnjë e më e madhe, kurse shpartallimi i domosdoshëm i Perandorisë Osmane këtë mundësi do ta shndërrojë në proces dramatik të shpejtuar, në të cilin shtetet e porsaformuara Serbia dhe Kroacia, do t'i kenë duart e lira të bëjnë çka u do qejfi me boshnjakët, aq më tepër që feja e tyre islame, në rrethanat e reja dhe thelbësisht të ndryshuara, do të bëhet barrë, njollë e pashlyeshme kulturore dhe handikap i pashmangshëm për afirmimin e identitetit nacional, sepse si muslimanë, do të trajtohen ose si *turq*, ose si *serbë dhe kroatë të turqizuar*.

Mbi këto baza janë ndërtuar strategjitë nacionale për themelimin e shteteve të ardhshme të pavarura të Serbisë dhe Kroacisë, dhe mbi këto premisa është planifikuar aneksimi i pjesëve të shtetit të Bosnjës, përkatësisht abrogimi i saj përfundimtar dhe ndarja e plotë e territoreve të tyre ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë. Sa kanë qenë me kujdes të planifikuara këto strategji dhe largpamëse sipas efekteve të tyre dhe efikase në realizim, vërtetojnë praktikisht të gjitha veprimet e mëvonshme ndaj boshnjakëve. Të gjitha vendimet politike në raport me shtetin e Bosnjës janë ndërmarrë nga ana e elitave politike dhe qarqeve sunduese të nacionalistëve serbë dhe kroatë, në periudhën nga shenjat e para të dobësimit të Perandorisë Osmane, ndërsa me vazhdimësi prej vetë fillimit të Bosnjës si shtet, deri sot e kanë ruajtur thelbin e tyre plotësisht të pandryshueshëm. Synimi i tyre i përbashkët ka qenë dhe ka mbetur i pandryshueshëm: mohimi i paskrupull i identitetit nacional të boshnjakëve dhe përvetësimi i territoreve të shtetit të Bosnjës, që përfundimisht t'i përfshijë në përbërje të Serbisë dhe Kroacisë.

Nga ana tjetër, boshnjakët, të cilët në histori tashmë e kanë pasur shtetin e tyre sovran të pavarur, Bosnjën, janë përballur me dy imperativa strategjikë. I pari, të ruhet identiteti i tyre nacional boshnjak, e me këtë edhe statusi i trashëguesve legjitimë dhe trashëgimtarëve kulturorë të shtetit të tyre nacional të Bosnjës. I dyti, të shpëtohet shteti i tyre, Bosnja, si territor dhe të ruhet si popull në kufijtë tradicionalë të territorit të shtetit të Bosnjës. Të dyja synimet kanë qenë, dukshëm, diametralisht të kundërt me synimet e fqinjëve të tyre serbë dhe kroatë, të cilët kanë ëndërruar abrogimin përfundimtar të shtetit Bosnje dhe aneksimin e territoreve të saj, kurse në lidhje me këtë, kanë punuar sistematikisht për mohimin e identitetit nacional të boshnjakëve, si pronarë legjitimë të shtetit të Bosnjës. Me praninë e osman-

linjve dhe me vendosjen e Perandorisë Osmane, synimi i parë për boshnjakët pjesërisht qe lehtësuar, kurse pjesërisht qe vështirësuar qenësisht dhe madje në një segment, qe pamundësuar. Momenti lehtësues ishte fakti se Perandoria Osmane e kishte vendosur sovranitetin e saj mbi tërë territorin e shtetit mesjetar të Bosnjës, që në mënyrë afatgjatë e garantonte integritetin e tij dhe e pengonte copëtimin dhe pushtimin e Bosnjës, si nga ana e ortodoksëve, ashtu edhe nga ana e shteteve-fqinje katolike. Ashpërsia, trimëria dhe suksesi me të cilat pikërisht vetë boshnjakët më së gjalli i mbronin kufijtë e shtetit të Bosnjës, vërteton qartë se ruajtja e Bosnjës si territor ka qenë imperativ strategjik i boshnjakëve gjatë tërë periudhës, në të cilën Bosnja ka qenë në përbërje të shtetit osman.

Por gjithashtu duhet pasur parasysh se po ky shtet osman, i cili me fuqinë e vet ka garantuar dhe thelbësisht ka lehtësuar ruajtjen territoriale të Bosnjës, në mënyrë dramatike ka rënduar mundësinë e kthimit të autonomisë politike të Bosnjës, duke e bërë praktikisht të pamundur. Domethënë, pavarësia politike e Bosnjës ka përfunduar në vitin 1463 dhe çfarëdo tentimi i autonomisë, qoftë të pjesshme politike brenda Perandorisë Osmane, do të trajtohej si kryengritje kundër pushtetit suprem dhe do të përfundonte me luftë të pashmangshme kundër tërë shtetit osman, sikurse ka ndodhur madje edhe më 1831-1832, me lëvizjen e Husein-kapetan Gradashqeviqit, në kohën kur shteti osman tashmë ishte dobësuar krejtësisht, dhe si i tillë, u detyrua të lëshonte pjesë-pjesë nga territori i saj në Gadishullin Ballkanik.

As me imperativin e dytë strategjik nuk ka qenë aspak më lehtë. Identiteti nacional i boshnjakëve është çuar në vetë skajin e mbijetimit dhe kjo në bazë të dy gjërave. E para, boshnjakët, nga vetë fillimi i shtetësisë së tyre, pra qysh nga Kulin Bani, kanë qenë të ekspozuar ndaj presioneve të të gjitha llojeve, duke përfshirë edhe ekspeditat ushtarake të fqinjëve, me synim që të

ktheheshin nga kisha e tyre vetjake (Kisha boshnjake), sikurse edhe nga bogomilizmi, i cili gjatë më së paku tre shekujve, përbënte përcaktimin dominues fetar të boshnjakëve në truallin e shtetit të Bosnjës. E njohur prej vetë formimit si halë në sy të fqinjëve ortodoksë dhe katolikë, Bosnja me enciklikë papnore është stigmatizuar si *Refugium hereticorum*, kurse popullsia e Bosnjës në pjesën më të madhe, në çdo rast të volitshëm, dhunshëm apo nën kërcënim, i është ekspozuar ortodoksizimit dhe katolicizmit. Boshnjakët me tërë forcën, me sa mundën dhe atje ku mundën, u kanë rezistuar presioneve që ta pranonin si opsinonin ortodoks ashtu edhe atë katolik, sepse kjo do të shpinte në denacionalizim, kurse me barazimin e identitetit fetar me identitetin nacional edhe te serbët edhe te kroatët, do të përfundonte me asimilimin e tyre të shpejtë në “serbë” apo në “kroatë”. Kjo, natyrisht, do të thoshte edhe akt i mohimit të shtetasve nga shteti i tyre, kurse konkretisht do të përbënte humbjen përfundimtare të legjitimitetit nacional të boshnjakëve mbi Bosnjën si shtetin e tyre, dhe me këtë, në fund të fundit, përbënte fundin e çdo shprese që të ruhej apo rilindej shteti nacional. Ardhja e osmanlinjve dhe pushtimi i tërë Ballkanit, ka sjellë ndryshime të fuqishme në Bosnjë, por përmbajtja e tyre nuk ka mundur deri në fund të zgjidhte enigmën e karakterit të volitshëm apo të pavolitshëm, shpëtues apo fatkeq. Sado që mund të duket si fikja përfundimtare e identitetit nacional të boshnjakëve, po aq ishte e qartë se shteti i ri i fuqishëm, i cili e bashkoi Ballkanin nën sundimin e një ligji, hapi edhe mundësinë për shpëtimin dhe ruajtjen e idesë për rimëkëmbjen e tij në të ardhmen.

Përparësi e veçantë dhe rrethanë lehtësuese që u shkante në favor shpresave të këtilla të boshnjakëve, ishte fakti që toleranca fetare e shtetit osman ka nënkuptuar edhe tolerancën kulturore dhe nacionale. Pranimi i Islamit nuk do të thoshte për boshnjakët

dhe pranimi i identitetit osman dhe turqizim, as që ka përfshirë detyrimin e lëshimit të identitetit vetjak kulturor dhe etnik. Sikur të ishte e kundërta, pranimi i Islamit, sado të ishte autentikisht i lirë dhe vullnetar, do t' i shpinte boshnjakët në të njëjtën situatë, në të cilën do t' i sillte edhe pranimi i kristianizmit ortodoks, përkatësisht katolik, me fjalë të tjera, do të thoshte denacionalizimin e tyre përfundimtar, pra do të shpinte deri te ajo gjendje, kundër së cilës boshnjakët, për arsye të njëjta, me aq këmbëngulje dhe zemër kanë luftuar. Me pranimin e Islamit, i cili ishte feja e shtetit osman, si fe të veten vetjake, boshnjakët arritën disa synime vendimtare, të cilat të gjitha drejtpërdrejt kanë qenë të lidhura edhe me ruajtjen e identitetit nacional, edhe me ruajtjen e kufijve të shtetit nacional dhe ambicieve për konstituimin e tij të sërishëm. Së pari, si muslimanë, përfundimisht janë çliruar nga të gjitha presionet e kryqëzimit detyrues, ndërsa Perandoria Osmane përfaqësonte shtetin e përbashkët të të gjithë popujve ballkanikë. Identiteti i tyre nacional ka mbetur i ruajtur, po ashtu si ka mbetur e ruajtur edhe gjuha e tyre boshnjake. Pranimi i Islamit ka pasur edhe pasoja mjaft të rëndësishme për ruajtjen e aspiratave legjitime për shtetin e vet. Me fjalë të tjera, duke e marrë parasysh se prania e Perandorisë Osmane në Ballkan ka zgjatur thuajse pesë shekuj, boshnjakët, sikur në çdo gjë subjekt i barabartë i shtetit, e kanë ruajtur edhe shtetin e përbashkët Osmanlı Devlet, edhe Bosnjën, si shtet amë të tyre, i cili ishte në kufijtë e Perandorisë Osmane. Ndikimi i tyre politik ka qenë gjatë tërë kohës i madh, dhe kjo si në suaza të tërë shtetit osman, ashtu edhe brenda kufijve të Bosnjës, ku drejtpërdrejt dhe aty për aty kanë qeverisur me dekret të sulltanit. Në këtë aspekt, boshnjakët e kanë ruajtur qartë edhe vazhdimësinë e vet konkrete politike me vendimet me rëndësi për ruajtjen e Bosnjës si tërësi politike, kulturore dhe shtetërore, sikurse e kanë mbajtur vetëdijen e qartë psikologjike për kons-

titucionalizmin e vet dhe për Bosnjën si shtet të boshnjakëve. Në këtë mënyrë, ndarja në boshnjakë dhe në ata që nuk ishin, është fokusuar thelbësisht si dallim në raport ndaj Bosnjës. Vija themelore ndarëse e saj është theksuar pikërisht në sfondin e pranimin dhe mospranimin të Islamit. Ndërsa në rrafshin psikologjik, te boshnjakët është pajtuar me përjetimin e Bosnjës si shtet nacional vetjak, i cili së pari duhet ruajtur, e pastaj edhe në kontinuitet të mbrohej, ndërsa në rastin e jo-boshnjakëve ka rezultuar me ndjenjën e distancimit nga Bosnja e boshnjakët dhe afrimin me identitetet e tyre amë, me pritjen e rastit të vërtetë që territori i Bosnjës, si shtet jo-amë, të grabitej dhe t'i aneksohej Serbisë, përkatësisht Kroacisë, të cilat përjetohehin si vende amë!

Sipas të gjitha gjasave, identiteti nacional dhe kulturor i banorëve të Bosnjës në kohën e Perandorisë Osmane, ka qenë motivi kyç dhe kriteri kryesor për pranimin vullnetar, përkatësisht gjithashtu për mospranimin vullnetar të Islamit. Edhe njëri edhe tjetri vendim ka qenë i bazuar në vlerësimet dhe planet racionale, edhe pse diametralisht të kundërta të veprimit kolektiv, thelbësisht të lidhura me raportin ndaj perspektivave të ruajtjes së Bosnjës si shtet: boshnjakët, që ta ruajnë Bosnjën; jo-boshnjakët, që Bosnjën ta shpërbëjnë dhe t'ia bashkojnë vetes!

Edhe sot është po ashtu. Por, ekziston edhe një dallim i madh në raport me kohën kur Bosnjën e përvetësonin dhe copëtonin, kur boshnjakët i kanë grabitur. Sot dihet qartë e vërteta! Sot boshnjakët ia kanë dalë, sepse kanë përmbushur dy zotimet e tyre historike. Kanë ruajtur identitetin e tyre nacional, kulturor dhe gjuhësor, dhe pas shekujve të ndalesave, sërish e kanë vendosur edhe emrin e tyre nacional, edhe identitetin e tyre shpirtëror dhe gjuhën e tyre nacionale! Me këtë e kanë legjitimuar të drejtën e tyre në tokën e stërgjyshërve, në vendlindjen e tyre, Bosnjë!

VI. TURQIA EUROPIANE – OSMANLI DEVLETI

Turqia europiane – Osmanlı Devleti

Vërejtje: Perandoria Osmane u largua nga historia, por mbeti te njerëzit dhe te popujt! Ky shtet i fuqishëm ka qenë pesë shekuj vend i përbashkët dhe amë për të gjithë popujt ballkanikë. Popujt ballkanikë qysh moti nuk jetojnë më në shtetin e tyre të dikurshëm të përbashkët, por ky shtet i përbashkët ende jeton në secilin dhe në të gjithë popujt ballkanikë, dhe edhe shumë kohë do të mbetet te ata. Sepse çdo popull ballkanik ka qenë një kohë të gjatë në përbërje të shtetit osman, sesa që e ka pasur shtetin vetjak! Pesë shekuj në shtetin e përbashkët lënë gjurmë të cilat vështirë mund t'i fshijë madje edhe pesë shekuj të tjerë. Dhe për këtë Perandoria Osmane ka mbetur te njerëzit dhe popujt e Ballkanit. Ka mbetur e dallueshme në traditat e tyre, e dukshme në mënyrën me të cilën ata sillen ndaj botës, të mishëruar në atë që ata e mendojnë dhe në fjalët të cilat i përdorin ndërsa flasin për të; e mbushur si kujtesë e dikurshme, e cila nuk fshihet në atë që është e këndshme dhe në atë që e shmangin, në atë që dëshirojnë ta zbulojnë në botë, dhe në atë që dëshirojnë botës t'ia tregojnë prej tyre! Për ndikimin të cilin shteti osman e ka ushtruar mbi tërë Europën dhe në formimin e identitetit europian janë shkruar shumë vëllime. Veçanërisht janë përpunuar aspektet politike, ekonomike, kulturore, arkitekturore, gjuhësore, muzikore, artistike, shpirtërore dhe të gjitha fushat e tjera të jetës shoqërore, e megjithatë, kjo trashëgimi e madhe ende vetëm për një pjesë të vogël është hulumtuar shkencërisht, kurse spektri i tij i plotë i ndikimit të

ruajtur në amplitudën e pafund nga pëshpëritjet e relacioneve më intime emotive, nëpër zakonet kolektive deri te aromat dhe shijet më të afërta, deri te ndërmarrjet intelektuale dhe reflektimet e gjurmimeve metafizike, që skicojnë kufijtë e padukshëm të këtij *komonuellti* të madh, dhe *bashkësisë unike të popujve*, dhe tërë shekullit pas ikjes së saj nga historia, as për së afërmi ende nuk është hulumtuar sa duhet, as e njohur, as e kuptuar.¹³⁸ Në pajtim me dijen dhe mundësitë e tij modeste, autori i këtij libri tashmë një kohë të gjatë punon në studim të veçantë kushtuar parësisht analizës së ndikimeve filozofike dhe estetike, të cilat letërsia osmane, e sidomos poezia, ka ushtruar në literaturën europiane dhe mendimin estetik. Për nevojat e këtij libri, është veçuar vetëm një segment i fenomenit jo mjaft të vrojtuar të formimit të një identiteti të veçantë, trans-etnik dhe trans-gjuhësor të *muslimanëve të Ballkanit*, të krijuar drejtpërdrejt mbi themelet e praktikës politike dhe shoqërore të shtetit osman, gjatë shekujve të sundimit të saj në këtë territor. Duke përfshirë në aspektin nacional, kulturor dhe gjuhësor më shumë popuj të llojllojshëm të cilët jetojnë në rajonin e Gadishullit Ballkanik, efektet kohezive të trashëgimisë islame, të konkretizuara nëpërmjet matricës specifike të praktikës shpirtërore, kulturore dhe administrative të Osmanlı Devletit, gjatë shekujve kanë formuar një identitet të ri, i cili përkundër të gjitha dallimeve të theksuara, paraqet një bashkësi të dalluar, të integ-

¹³⁸ Edhe pse dominojnë pamfletet ideologjike, traktatet kuazi-historike pretencioze të shkruara nga perspektiva e "Orient-Oksident" si simbol semiotik për relacionin "Barbarizmi-Qytetërimi", sikurse edhe paraqitjet e gjysmëromanizuara përplot diskualifikime, me të vërteta të gjymta dhe gënjeshtër të qarta, duhet theksuar se gjithashtu ka një vistër studimesh shembullore mjaft cilësore të shkëlqyeshme. Sipas dijes sonë, një prej ndërmarrjeve më të mira dhe më komplekse sistematike në këtë thesar të pafund të osmozës dhe komunikimit ndërkulturore të cilën e ka nxitur Perandoria Osmane, edhe më tutje e paraqet ndërmarrja enciklopedike *The Great Ottoman – Turkish Civilization*, Ankara 2000, Vol. I – IV.

ruar në fije të padukshme të afërsisë shpirtërore. Pikërisht në kontekst të veçanësisë së tij kemi vendosur që për paraqitjen paraprake të këtij fenomeni kulturor, i cili në fakt deri tash as nuk është regjistruar shkencërisht në veçanësinë e tij, sikur edhe një kontribut të çmueshëm por jo mjaft i hulumtuar i këtij shteti të rëndësishëm evropian islam, i cili ka lënë vulë të pashlyeshme në të gjitha aspektet e jetës shoqërore të Europës, dhe thelbësisht ka ndërhyrë në proceset e individimit të identitetit modern evropian.¹³⁹

¹³⁹ Një paraqitje të shkëlqyeshme të vëllimit, llojlojshmërisë, efekteve dhe përmbajtjes së ndikimit të përhershëm, të cilin Osmanlı Devleti si paradigme qytetëruese, si mega-fuqi ndërkontinentale, por edhe si shtet evropian islam, ka pasur në formimin e identitetit evropian, ofron studimi monumental *The Great Ottoman-Tutkish Civilization*, Editor in Chief: Prof. Kemal Çiçek; Chief of the Editorial Board: Prof. Dr. Halil Inalcık (Vol. I-IV, *Politics; Economy, Society; Philosophy, Science, Institutions; Culture an Arts*, Ankara 2000). Kjo sipërmarrje shumëvjeçare botuese, e realizuar në më shumë se 3.500 faqe të formatit enciklopedik, përbën një hyrje të shkëlqyeshme në botën e qytetërimit osman për njerëzit me interesim të përgjithshëm si dhe një burim mjaft instruktiv autentik të informacioneve pak të njohura, shpesh dhe krejt të reja për specialistët.

MOTIVET THEMELORE PËR PRANIMIN DHE MOSPRANIMIN E ISLAMIT NË BALLKAN NË KOHËN E OSMANLI DEVLETIT

*“S’ka shtrëngim në fe se me të vërtetë
është dalluar e drejta nga e shtrembëta!”*

(Kur'an: *El-Bekare*, 256)

Vërejtje hyrëse

Pas largimit të shtetit islam nga tërë Gadishulli Ballkanik, pos pjesës e cila edhe sot është në përbërje të Republikës së Turqisë, kah fundi i shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, shtetet e porsaformuara: Bullgaria, Greqia, Serbia, Mali i Zi, si edhe Monarkia Austro-Hungareze, e cila e bëri aneksimin e dhunshëm të Bosnjës dhe Hercegovinës, filluan programin e dëbimit të ashpër të popullsisë muslimane në tërë këtë hapësirë. Synimi kryesor: ndryshimi radikal i strukturës demografike, që në praktikë do të thoshte reduktimin maksimal të popullsisë muslimane, është shpallur haptazi madje edhe në dokumente, të cilat paraqisnin programet strategjike afatgjate.¹⁴⁰ Problem themelor

¹⁴⁰ Shembull karakteristik, por assesi jo edhe përjashtim në raport me shtetet e tjera në Ballkan, përbën „Naçertanija“ e Ilija Garashaninit, (*Projekti Rastko*). I shkruar si projekt i qeverisë në vitin 1844, në kohën ndërsa Serbia si principatë formalisht ende ishte vasale e Perandorisë Osmane, ky dokument zbulon se qysh atëherë përgatitej programi nacionalist i konstitiimit të Serbisë së Madhe, të cilin Serbia tentoi ta realizonte madje edhe me agresion mbi Bosnjën dhe Hercegovinën më 1992-1995, dhe nga i cili, sipas të gjitha gjasave, as sot nuk ka hequr dorë. Synimi themelor i këtij *Projekti* është rimëkëmbja e Serbisë si perandori, në të cilën të gjithë popujt të cilët jetojnë në kufijtë e saj do të shpallen për serbë, dhe pastaj me dhunë do të serbizohen, ndërsa muslimanët do të vriten, dëbohen apo dhunshëm do të kryqëzohen. Synimi ishte që Serbia të shtrihej në pjesë të Bullgarisë, Maqedonisë, Shqipërisë, në pjesë të Greqisë, Malit të Zi dhe Bosnjës e

demografik përbënte përqindja e lartë e popullsisë autoktone muslimane, me përfaqësimin shumë më të vogël të popullsisë me prejardhje turke. Shkaqet e programit të këtyllë qenë po ashtu të qarta, sikurse edhe metodat të parapara për realizimin e tij efikas; alibi për marrjen më të lehtë të pronave tokësore, pasurive, shtëpive, sikurse edhe “dëshmia” se tërë ky ka qenë vendi i *stërgjyshërve* të tyre (kristianë), përbënin motivet themelore; shpërngulja (përndjekja), kryqëzimi i dhunshëm dhe likuidimi i përfaqësuesve të padëgjueshëm dhe më të dukshëm, nuk e shterojnë listën e metodave më brutale të fshirjes së të gjitha gjurmëve të pranisë së myslimanëve, të cilët në këto hapësira kanë jetuar në fenë e tyre me qindra vite, disa madje edhe më gjatë se tërë një mijëvjeçar. Kështu shpjegohen rrënimi sistematik i të gjitha objekteve sakrale dhe objekteve publike të arkitekturës islame, sikurse janë hamamët, pazaret, hanet e të tjera, si edhe përvetësimi i disa prej këtyre objekteve me tregime të trilluara për “ndërtuesit” e tyre “kristianë”¹⁴¹, me ndryshimin administrativ të toponimeve dhe me riemërimin e vendeve të banuara.

Megjithatë, në kuadër të këtij projekti, kujdesi më i madh i qe kushtuar fabrikimit të mitologjisë shprehimisht anti-islame,

Hercegovinës, me okupimin e territoreve të tyre, kurse në mënyrë eksplicite është nënvizuar: *“Nga kjo dije rezulton plani dhe themeli i politikës serbe, se ajo nuk kufizohet në kufijtë e sotëm të saj, por synon t’ia bashkojë vetes të gjithë popujt serbë të cilët e rrethojnë”*.

Përndryshe, në tërë tekstin e *Naçertanijes*, I. Garashanini për banorët e Bosnjës dhe Hercegovinës (*Ercegovina*) askund nuk i përdorë nocionet “Muslimanët”, “Serbët”, “Kroatët”, por vetëm dhe përjashtimisht: „Boshnjakët“. Prandaj, pikërisht atë përcaktues të njëjtë nacional të cilin trashëgimtarët bashkëkohorë të këtij projekti shtetmadh dhe nacionalist, me këmbëngulje tentojnë ta paraqesin si “term të trilluar pa mbështetje historike”.

¹⁴¹ Ilustrim tragjikokomik paraqet shembulli i të ashtuquajturës “Urës së Car Dushanit”, përkatësisht “Urës së Dushanit” në Shkup. Historiografia serbe ia ka quajtur këtë objekt të arkitekturës tipike turke carit serb Stefan Dushanit të Fuqishmit, edhe pse ai ka vdekur së paku 60 vjet më herët para se pushteti osman ta ndërtonte këtë urë.

shprehimisht nacionaliste (më së shpeshti e maskuar si anti-turke, që në sytë e opinionit lokal dhe më gjerë europian, të paraqitej si “luftë kundër okupatorit”). Dramaturgjia e kësaj krijese kuazi-historike, ka qenë e përqendruar rreth tregimit për të ashtuquajturin “islamizim të dhunshëm të banorëve kristianë”. Është e qartë se, në mungesë qoftë edhe të një shembulli të vetëm të dokumentuar, ky falsifikat monstruoz është dashur të përkrahet me të gjitha mjetet e manipulimit me opinionin publik, që shpejt do të jepte rezultate shkatërruese për raportet ndëretnike dhe ndërftare, me krijimin e acarimit të madh psikologjik të urrejtjes ndaj muslimanëve dhe në mënyrë të përgjithshme, ndaj Islamit. Paskan dëbimet, përndjekjet, vrasjet dhe plaçkitjet e popullsisë paqedashëse muslimane, gjatë të cilave u vranë disa mijëra muslimanë civilë, ndërsa pasuria e tyre u grabit, kurse pronat tokësore u morën dhe u përvetësuan nga popullsia lokale kristiane. Pas disa valëve rrënuese, kjo urrejtje irracionale, e bazuar në propagandën sistematikisht të gjeneruar dhe intensive, shpërtheu si një bombë bërthamore, gjatë shpartallimit të planifikuar me kujdes të RSF të Jugosllavisë, së pari me likuidimin e mbi 100.000 boshnjakëve muslimanë në Bosnjë dhe Hercegovinë, e pastaj edhe më 1999, me dëbimet mbi mijëra shqiptarë muslimanë në Kosovë.

Synimi i parë i këtij kontributi është që me argumente të hedhë poshtë falsifikimin monstruoz për praktikën shekullore të “islamizimit të dhunshëm”, së cilës i janë drejtuar nga koha e Naçertanijes famëkeqe, kurse i drejtohen edhe sot me ashpërsi të pazvogëlur, programet nacionaliste të krijimit të “Serbisë së Madhe”, por gjithashtu edhe regjimet e shteteve të tjera në Ballkan, të krijuara pas largimit të shtetit osman nga skena historike. Realizimi i këtij synimi është imperativ, i cili thjesht nuk ka alternativë si kusht për çlirimin e popullsisë jo-muslimane të

Ballkanit nga ky mashtrim thuajse i paçrënjësor për “islamizimin e dhunshëm”, të cilit, kinse, të parët e kristianëve të sotshëm ”me heroizëm i kanë rezistuar”, kurse të parët e muslimanëve të sotshëm (poturicave feshkelës) “kanë lëshuar pe si frikacakë”. Synimi i dytë, jo më pak i rëndësishëm është që, me afirmimin e së vërtetës historike për konvertimin vullnetar dhe me analizën e motiveve të cilët kanë ndikuar në përzgjedhjen që të pranohet apo mos të pranohet Islami në Ballkan, shkallë-shkallë të bëhet qasja drejt rrëzimit përfundimtar dhe total të mitologjisë të krijuar nacionaliste, deri te fshirja e saj përfundimtare nga të gjitha librat shkollorë, nga shkenca, nga programet dhe retorika politike, si dhe nga vetëdija e brezave të ardhshëm të Ballkanit, që të njihen me të vërtetën, e cila do të mundësojë konstituimin e komunikimit normal dhe bashkekzistencës së të gjitha bashkësive, të cilat jetojnë në mozaikun multi-etnik, multi-kulturor dhe multi-fetar, i cili sipas virtyteve të tij thelbësore paraqet një imazh të ashpërsuar të tërë Europës.

Rrëzimi i makinës diabolike; parimi i fesë së lirë si e vërtetë historike

Sikur është thënë tashmë, largimi përfundimtar i shtetit osman nga Ballkani, e diç më vonë edhe nga skena historike, për banorët autentikë europianë të fesë islame ka shënuar fillimin e golgotës, e cila deri më sot nuk ka përfunduar, kurse nga vetë fillimi e deri më sot, është i motivuar me një mashtrim të madh historik, i cili, i menduar që kështu të jetë, vërtet edhe paraqet *makinën diabolike* të llojit më të keq, të kurdisur, me synimin ta shkatërrojë popullsinë muslimane dhe t’i fshijë të gjitha gjurmët e kulturës islame në Ballkan. Kjo hile historike, fillimisht e planifikuar dhe e përgatitur nga krerët nacional-

shovinistë të principatës së Serbisë, e fuqizuar në mënyrë sistematike me të gjitha mjetet e disponueshme dhe me të gjitha format e propagandës së vazhdueshme ideologjike, me kohë u rrit në një tumor të shëmtuar malinj, një gungë infektive ideologjike, e cila tashmë u përcillet brezave dhe jo vetëm që nuk tentohet të pengohet, por stimulohet me të gjitha mënyrat. E shënuar fuqishëm si një tregim bardhë e zi, e intonuar në mënyrë patriotike, e vendosur me përkrahjen e plotë të të gjitha institucioneve arsimore, politike dhe shkencore, si “e vërtetë historike”, përrallëza ideologjike për *islamizimin e detyrueshëm* është kristalizuar në një stereotip të polarizuar, të cilin universi demografik ballkanik në mënyrë manikeike e ka konfrontuar me “*besimdrejttë*” (të gjithë kristianët, si ortodoksët ashtu edhe romako-katolikët, pa marrë parasysh në përkatësinë etnike), dhe “*besimshtrëbërit*” (të gjithë muslimanët, po ashtu pa marrë parasysh përkatësinë etnike), që në praktikë kishte kuptimin, por edhe sot e ka këtë kuptim, në “*të mirë*” dhe “*të këqij*”, në “*fitues*” dhe “*të mundur*”, në “*luftëtarë për liri*” dhe “*robërues*”. Triumfalizmi i të parëve në mënyrë komplementare është plotësuar me ndjenjën e humbjes historike të të tjerëve; krenaria e të parëve, me kompleksin e fajit historik dhe turpërimit social të të tjerëve. Krahas mëkatit të të lindurve të parë, nga i cili nuk mund të lirohen dhe të cilin në ndërgjegje e kanë të gjithë njerëzit, muslimanëve autoktonë të Ballkanit u është ngarkuar një mëkat edhe më i rëndë, dhe po ashtu i pashlyeshëm: “*tradhtimi i fesë së stërgjyshërve*”. Edhe më shumë, për arsye se mëkati zanafillor është bërë nga mosdija, ndërsa kalimi në Islam është bërë “*vetëdijshëm dhe nga interesi*”. Prapavija e këtij trillimi ideologjik ka qenë dhe ka mbetur, ndërkaq, mjaft pragmatik dhe është rrëgjuar në synimin e krerëve me qëndrim shtetmadh të politikës së Serbisë, që të përvetësohet territori në të

cilin kanë jetuar boshnjakët muslimanë, i cili është përputhur kryesisht me territorin e shtetit mesjetar të Bosnjës, dhe ta inkuadrojë në përbërje të Serbisë (krahas planeve paralele nga ana e Kroacisë, që kjo të bëhet gjithashtu). Në një skenar të këtillë, dallimi në kristianë, *si autoktonë dhe pronarë legjitimë të këtyre territoreve, të cilët aty kanë qenë gjithnjë edhe para ardhjes së osmanlinjve* (në semantikën ideologjike propagandistike, të këmbjera me nocionin *turq*), dhe në *turq e poturicë, të cilët kanë ardhur më vonë si të ndërfutur dhe pushtues*, ka shërbyer si ideali që të gjitha dhunat mbi boshnjakët, shqiptarët, goranët, torbeshët, pomakët, romët, si edhe mbi pasardhësit e turqve të shpërngulur me qindra vite më herët, të paraqiten si *hakmarrje plotësisht e ligjshme e drejtë dhe plotësim i borxhit historik*. Kurse diapazoni i dhunës së cilës i qenë nënshtruar muslimanët e Ballkanit, është mbresëlënëse si për nga morbiditeti i formave të saj, ashtu edhe për nga intensiteti dhe vazhdimësia me të cilën kryhet deri më sot. Nga kërkesat eksplicite që të çrrënjosen deri te i fundit (shembulli më morbid është *“hulumtimi i poturicave”*, të cilin në vargje e ka lënë si testament të vetin dhe zotim vendasve të tij dhe të gjithë kristianëve, sunduesi, vlladika dhe poeti malazez Njegoshi¹⁴²), prej mohimit të

¹⁴² Petar II Petroviq Njegosh, gjatë jetës i njohur si *peshkopi Rade* (i lindur Rade Tomov Petroviq; 1 nëntor 1813 - 10 tetor 1851), autor i poemës ekstremisht islamofobike *Kurora e Maleve (Gorski vijenac)*, i cili, me fuqinë e cilësisë artistike, këtë ideologji e ka ngulitur thellë në universin mendor të kristianëve malazez dhe serbë. Ky sundues-poet i impresionon edhe sot serbët dhe malazezët me qëndrimin anti-islamist si me *ligjërimin poetik* të urrejtjes, ashtu edhe me aplikimin konsekuent të *poetikës së urrejtjes* në praktikën e sunduesit. Pas humbjes së ushtrisë malaziaze në Grahovë më 1836 – me ç’rast vetë Smail-agë Çengiqi në luftë ka therur 7 nga gjithsej 9 Petroviq të vrarë – Njegoshi një kohë të gjatë ka përgatitur hakmarrjen. Së pari, në vitin 1840, duke e mashtruar e joshi Smail-agë Çengiqin, me fjalën e dhënë se kurrfarë mashtrimi nuk do të ketë, e atëherë u dërgoi lajm njerëzve të tij t’i vinin pritë, në të cilën Smail-agë Çengiqi do të vritet së bashku me njerëzit e tij më 1840. Disa vjet më vonë, sërish, duke ua dhënë

veçanësisë etnike, gjuhësore, kulturore dhe shpirtërore të të gjithë muslimanëve në këto hapësira, deri te fuqizimi i motiveve të frymëzuara nga urrejtja ndaj Islamit, kjo klishe dominuese e përhapjes së armiqësisë ndaj Islamit dhe e organizimit të fushatës mbi muslimanët e Ballkanit, ka shërbyer si alibi psikologjike, juridike dhe morale për të gjitha dëbimet, krimet, vrasjet masive dhe gjenocidin të bëra ndaj popullsisë islame në këtë rajon. Masakrat e bëra nga kryengritësit e Karagjorgjit nëpër Serbi, sidomos ajo e bërë në Sjenicë më 1809, për të cilën tregojnë edhe burimet serbe si krimin më të turpshëm në historinë serbe deri atëherë, kur, të liruar *me besë*, janë sulmuar tinëzisht dhe poshtërsisht dhe u therur qytetarët civilë, duke përfshirë edhe gratë e fëmijët, kurse kokat e tyre janë vënë në hunj shelgu “...mezi kemi gjetur aq sa ka pasur koka të prera, nëse një ka munguar nga tre mijë”,¹⁴³ në Shahoviq më 1924, në Bosnjën

fjalën ftoi në Cetinje krerët boshnjakë bejlerët dhe agallarët, nga 67 prej tyre i preu 66, ndërsa boshnjaku i 67 në çastin e fundit shpëtoi, kështu që u kthye nga rruga në Cetinje, sepse kishte një ëndërr profetizuese. Në të dy rastet, poeti i madh ka mbjellë kokat e prera të mysafirëve të tij në hunj të kështjellës cetinjane.¹⁴³ Rrethimin e Sjenicës e filloi Karagjorgje në pranverë të vitit 1809 me 8.000 ushtarë serbë, deri sa ushtarë turq dhe boshnjakë të aftë për armë kishte rreth 600. Rrethimi i kështjellës në të cilën qe strehuar tërë popullsia civile nga qyteti dhe rrethina, ka zgjatuar mbi një muaj ditë. Meqë të rrethuarve nuk u erdhi ndihmë, kurse sulmuesit nuk arritën ta thyejnë rezistencën e mbrojtësve, u dakordua dorëzimi i qytetit. Dorëzimin e qytetit në fund e bëri Ali-bej Çoviqi “të cilit krerët serbë iu betuan me besimin e tyre të fuqishëm se do ta lejojnë popullsinë pa pengesa të tërhiqet nga kështjella.” Për këtë akt të turpshëm dhe qyqar, drejtpërdrejt flet edhe dëshmitari i kësaj ngjarjeje Antonije Protiqi, në një shënim të shkruar më 23 prill 1809, në të cilën thotë se serbët e kanë shkelur fjalën e dhënë dhe “pas dorëzimit të qytetit, njerëzit vullnetarisht të çarmatosur, gratë dhe të paafitit duarthatë, me batore i kanë vrarë menjëherë pas daljes nga qyteti, kurse kokat ua kanë ngulur në hunj shelgu (“nëse ka pasur një më pak se 2500 ...”). Më shumë autorë përmendin numrin prej rreth 3.000 të vrarë në këtë akt, turpin e të cilit nuk do ta lajnë as shekujt. Për probabilitetin dëshpërues që ky numër më i madh mund të jetë i saktë, dëshmon edhe plotësimi i shënimit të sipërm: “...kanë mbetur edhe shumë koka, por nuk kishte më hunj shelgu.” (Antonije Protić: “Povesnica od početka vremena vožda srpskog Karađorđa”, Spomenik Srpske

Lindore, Malin e Zi Verior, Maçvë dhe Uzhiçë në Serbi, e pas-taj krimet çetnike në rajonin e Vishegradit, Foçës, Rudos, kur janë vrarë mbi 9.000 civilë në këto qytete dhe në fshatrat malore, deri te elitocidi në Prijedor prej masakrës në Kozarac më 1992, bombardimit katërvjeçar të Sarajevës me mbi 12.000 të vrarë, nga të cilët 1.600 fëmijë dhe gjenocidit në Srebrenicë, krahas përsëritjes së disafishtë të përndjekjeve dhe krimeve të bëra ndaj shqiptarëve të Kosovës, të cilat kanë kulmuar me eksodin masiv në vitin 1998-1999.

Me analizën e motiveve të cilat kanë anuar që *me vullnetin e lirë të shprehur*, të merret vendimi mbi (mos)pranimin e Islamit, përfundimisht duhet komentuar kjo makinë diabolike e mitit ideologjik, që këtë akt e paraqet si krim moral dhe tradhti nacionale! Përveç që me këtë do të përmirësohet një e pavërtetë historike, do të mënjanohet edhe gjeneratori kryesor i urrejtjes ndaj muslimanëve të Ballkanit. Krijimi i mitit për gjoja “*robërinë turke*”, i cili me tërë fuqinë ka vepruar qysh në gjysmën e parë të shekullit XIX, nga vetë fillimi deri sot ka përfshirë thjesht të gjitha potencialet e shteteve rishtazi të krijuara kristiane në

Kraljevske Akademije XIX, Beograd, 1892 godine). Edhe vetë Vuk Stefanoviq Karaxhiq është tmerruar nga masakra e Sjenicës dhe ka shkruar: “*Më me dëshirë këtë turp do ta fshihja nëse disi do të mundja. Nuk është detyrë e historianëve ta fshehin nga populli turpin e tij por që, si vërtetëdashës, ta zbulojnë me synim të refuzimit të së kaluarës së tillë.*” Për shkak se në mënyrë të vërtetë i ka paraqitur keqbërjet dhe mungesën e nderit me rastin e dhënies së fjalës dhe respektimit të marrëveshjes (burrërisë), të cilat kryengritësit në krye me Karagjorgjin në krye i kanë bërë mbi popullsinë boshnjake sjenicase, Vukun e kanë gjykuar shumë ultra-nacionalistë serbë të maskuar me historinë. Vuk Karaxhiq fjalë për fjalë ka shkruar edhe deklaratën e vet Karagjorgjit, të cilën, ia ka përcjellë Gajo Panteliqi për shkaqet kryesore të mossaksesit të Kryengritjes së Parë Serbe: “*Ne nuk do të humbim, as nuk do t’i pezmatonim turqit (në fakt boshnjakët), sikur mos ta vrisnim pashanë, të kryqëzonim turqit (boshnjakët), t’ua mernim gratë dhe vajzat dhe të shkonim në Sjenicë.*” (V. S. Karadžić, *Istorijski spisi* II, Beograd 1964, fq. 481-486). Shih gjithashtu edhe V. Radunović në: “Upad Srba u Sandžak 1809 godine”, Glasnik jugoslovenskog profesorskog društva, XIV/6, Beograd, 1934, fq. 514-524.

Ballkan! Kontributin maksimal të tyre e kanë dhënë mësuesit dhe priftërinjtë, gazetarët dhe autorët, producentët filmikë dhe televizivë, ambasadorët, ministrat, institucionet shkencore, profesorët universitarë, akademitë nacionale të shkencave dhe të artit. Pikërisht për shkak të një të pavërtete të këtillë, të rrënjosur thellë për *robërimin turk dhe turqizimin (islamizimin) e dhunshëm*, shumëfish të vërtetuar me autoritetin e të gjitha institucioneve edukative, politike, fetare dhe shkencore, fshirja e saj e plotë dhe ndërrimi me të vërtetën mbetet kusht i domosdoshëm i integritimit të mirëfilltë dhe barabarësisë së të gjitha bashkësive etnike, kulturore dhe fetare në Ballkan.

Koordinatat metodologjike të mitit për “islamizimin e dhunshëm”

Historiografia është përplot falsifikime. Nëse nuk është rezultat i dëshirës patologjike për lavdi të historianit-individ, falsifikimi i fakteve historike është projekt lartë i organizuar profesional në shërbim të interesave nacionale dhe programeve ideologjike strategjike. Një ilustrim të shkëlqyeshëm për projektin jashtëzakonisht të suksesshëm të ekzekutuar, kurse sipas pasojave të pangadhënyeshme të falsifikimit të historisë, në të cilin harmonikisht ka marrë pjesë tërë kombi, paraqet miti për të ashtuquajturin “*islamizimi i dhunshëm*”, të cilin gjoja e ka kryer pushteti i shtetit osman gjatë sundimit të tij shumëshekullor në këto hapësira të Europës. Këto pasoja, për fat të keq, kanë qenë ekstremisht negative për viktimat, të cilat ky falsifikat kolosal i ka goditur, por për këtë arsye kanë qenë jashtëzakonisht fitimprurëse për palën, e cila e ka trilluar këtë shpifje, e ka zbatuar dhe e fuqizon me të njëjtat shkaqe edhe sot. Në këtë kontribut, detyra themelore është demontimi i këtij falsifikimi

sistematikisht të planifikuar dhe të zhvilluar, kurse kujdesi i veçantë është përqendruar në vendosjen e lëshimeve vendimtare metodologjike, lëshimeve logjike (apo mashtrimeve të qëllimshme), dhe vendosja e të pavërtetave faktografike me pretekst të vërtetave të njohura famëkeqe.

Së pari, për *shkaqet* të kinse *islamizimit!*

E para: Nuk mund të flitet për kurrfarë *islamizimi!*

E dyta: Nuk mund të flitet për kurrfarë *shkaqesh.*

E treta: Si akt i përzgjedhjes së vetëdijshme dhe thelbësore të lirë, pranimit i Islamit si fe e re, ka qenë i përcaktuar prej motivesh, të cilat kanë anuar në llogari të vendimit të tillë, po ashtu si motivet kanë vendosur për vendimin e vetëdijshëm dhe të lirë që Islami të mos pranohet.

Për arsye se, *Ad 1.* Kalimi në Islam është akt vullnetar i lirë i pranimit të Islamit si fe të zgjedhur vetëdijshëm, e jo akt i krezimit, jo veprim i *baptizimit*, *kryqëzimit*, *pagëzimit*, në të cilin rituali kryhet *mbi* anëtarin e ri. Për këtë arsye, duke e respektuar këtë dallim mund të flitet për *pagëzimin* (edhe kur ky është akt i zgjedhur lirisht, edhe kur bëhet dhunshëm), por jo edhe për *islamizimin* (sepse, madje edhe nëse kryhet *mbi* dikë, është jolegjitim, pikërisht për shkak të mungesës së ritualit, të cilit besimtari i ri i *nënshtrohet*, ashtu si dallohet veprimi i *vaksinimit*, nga akti në të cilin individi *e merr* ilaçin! Vetëm ky është shkak i mjaftueshëm që nga përdorimi publik, dhe këtë në të gjitha nivelet, përfundimisht të eliminohet nocioni “*islamizimi*”, sepse përbën një pallavër ideologjike, së cilës nuk i përgjigjet kurrfarë përmbajtjeje reale. Këtu duhet përkujtuar se nuk ekziston asnjë i vetmi dokument historik me autenticitet të konfirmuar të vlefshëm, për kalimin e dhunshëm në Islam.¹⁴⁴ Sikur

¹⁴⁴ Një veprim i këtillë në Islam edhe praktikisht është mjaft i vështirësuar, për shkak të veçanësisë dhe thjeshtësisë së skajshme të vetë aktit të pranimit të Isla-

politika shtetërore e Komonueltit Osman të ishte njëfarë “*islamizimi i detyrueshëm*” dhe “*turqizim i detyrueshëm*”, madje edhe ritëm statitikiisht krejt të parëndësishëm prej vetëm 1% në vit, ky proces do të ishte 100% i mbaruar për njëqind vjet, kështu që të gjithë banorët do të ishin muslimanë, me turqishten si gjuhë të tyre amtare, kulturat e tyre do të fshiheshin, gjuhët e tyre do të ishin harruar, ndërsa për 500 vjet sa kanë sunduar në mënyrë të pacenueshme në këto hapësira, popullsia ballkanike do të përbëhej gjithsej nga vetëm *muslimanët e pesëfishtë* dhe *turqit e pesëfishtë*, gjegjësisht muslimanë të vërtetuar me nga pesë vula! Në vend të kësaj, Osmanlı Devleti mundet me plotë të drejtë të lavdërohet se është shteti i vetëm në histori, i cili pas pesëqind vjetësh sundim, ka lënë çdo gjë, e edhe popujt me numër më të vogël i ka lënë me kulturat e tyre autentike, gjuhët e tyre, fenë e tyre, shkollat e tyre, traditat, krijimet shpirtërore popullore, tempujt, zakonet, shkurt, me identitetin plotësisht të ruajtur nacional! Sa është e saktë kjo çudi qytetëruese e tregon edhe fakti se madje edhe sot, në vendet e Europës Perëndimore, SHBA dhe Australi, në të cilat nuk ekziston kurrfarë aksioni i

mit në pajtim me dispozitat islame, që nuk kanë çfarëdo elementesh rituale apo ceremoniale. Të kujtojmë se akti i pranimit të Islamit konsiderohet i vlefshëm kur ai që dëshiron ta pranojë Islamin, para dy dëshmitarëve dhe hoxhës e vërteton se lirshëm dhe me vullnetin e tij të lirë ka vendosur për këtë veprim dhe pasi tri herë ta përsërisë *shehadetin*, pra fjalinë (formulën) me të cilën besimtarët e vërtetojnë bindjen e tyre se Zoti është një (se nuk ka Zot tjetër pos Allahut) dhe se Muhammedi a.s. është i dërguari e Tij. E në qoftë se dikush megjithatë detyrohet ta bëjë këtë, nga pushteti apo nga një person privat, me shantazh apo ndonjë kërcënim tjetër, dhe kjo merret vesh, besimtari në këtë mënyrë i pranuar lirohet nga detyrimi që të konsiderohet musliman, ai apo ata të cilët e kanë detyruar bartin përgjegjësi, kurse vetë akti i kalimit në Islam prishet. Nëse detyrimi apo shantazhi kryhet por kjo nuk merret vesh, atëherë në atë botë ky akt do të prishet, kurse protagonistët të cilët kanë bërë presion do të bartin për këtë përgjegjësi. E themeluar si Shtet i Islamit, Perandoria Osmane assesi nuk ka guxuar t'i lejojë vetes injorimin e Kur'anit, si autoritet suprem shpirtëror dhe botëror, edhe më pak shkeljen e ndalesës së tillë eksplicite të formuluar si është theksuar në Kur'an për moslejimin e detyrimin në fe.

organizuar i emigrantëve, qysh nga brezi i dytë e humb gjuhën e vet, sikurse edhe shumicën e virtyteve kryesore të kulturës së vet amë. Pasardhësit e atyre të cilët kanë emigruar në këto vende para vetëm 100 viteve, sot nuk kanë ruajtur më asgjë nga identiteti amë kulturor, përveç eventualisht, kujtesës për tregimet e gjyshërve të tyre dhe ndonjë fotografi të zverdhur.

Pra, është plotësisht e qartë që në fakt nuk ka nevojë për kurrfarë presioni, aq më pak detyrim, që bashkësitë e vogla kulturore të asimilohen mjaft shpejt në indin e modelit dominues kulturor dhe t'i përvetësojnë shembujt e funksionimit të tyre. Enigma sociologjike është pikërisht, se si ka qenë e mundur që kjo nuk ka ndodhur në hapësirat e shtetit të dytë të madh europian islam – Perandorisë Osmane!? Dhe vetëm atëherë kur këtë çështje ta vendosim si duhet, vetëm kur të pushojmë, pra, thjesht të marrosemi me tregimet për *islamizimin* dhe *turqizimin e dhunshëm*, do të përballemi me faktin se në këtë shtet duhej të ekzistonin institucionet, mjaft vepruese dhe efikase, të cilat në fakt *e kanë penguar asimilimin, pra, institucionet të cilat e kanë ruajtur identitetin nacional dhe fenë e bashkësive më të vogla dhe me këtë e kanë vështirësuar islamizimin, pa marrë parasysh a ka mundur ky të vinte spontanisht apo me aksion të organizuar të njerëzve arbitrarë lokalë!* Vetëm në dritën e këtyre fakteve të pathyeshme, mund të shpjegohet se si thjesht të gjitha këto bashkësi kanë mundur t'i ruajnë identitetet e tyre kulturore, thënë ashtu, t'i konservojnë me shekuj dhe të presin largimin e perandorisë aq të fuqishme, përkundër ndikimeve të fuqishme dhe afërsisë së përhershme të kulturës së tyre të fuqishme, e kjo do të thotë pikërisht me ekzistimin e sistemit të dispozitave institucionale dhe masave administrative, të cilat ato identitete i kanë mbrojtur dhe kanë stimuluar ruajtjen e tyre. Kjo kureshti sociologjike dhe kulturologjike

vetvetiu është mjaft interesante si temë hulumtimi, por në këtë kontekst është e mjaftueshme të tregojmë praninë e saj të diskutueshme si dëshmi mjaft bindëse dhe e pranueshme pozitive për mosekzistimin e çfarëdo procesesh të islamizimit të dhunshëm dhe turqizimit (*turkizimit*, e thënë me gjuhë më dinjitoze të shkencës), krahas të dhënës tashmë të theksuar se nuk ekziston as një e vetmja dëshmi e ruajtur dhe e vlefshme për detyrim që të kalohet në Islam, në tërë hapësirën e Ballkanit! Siç kemi theksuar tashmë më herët, hulumtimet më të reja vërtetojnë se konvertimet e para të lira dhe vullnetare të popullsisë lokale të Ballkanit në Islam, mund të datojnë qysh në gjysmën e parë të shekullit VIII, që do të thotë se fjala është për një periudhë të gjatë, në të cilën ka mundur të kishte me qindra përjashtime, e megjithatë vetë rregulli për asnjë çast të mos mund të vihet në pyetje. Por, sikurse kemi thënë, madje as përjashtime të tilla nuk ka, kurse krijuesit e falsifikimit për *islamizimin e dhunshëm*, megjithatë edhe më tej pa u penguar po përhapin infeksionin e kësaj gënjeshtre monstruoze, që ta ruajnë armiqësinë ndaj muslimanëve dhe ta forcojnë qëndrimin anti-islam në mënyrë të përgjithshme.

Ad 2. Shtrohet pyetja e rëndësishme, e njëkohësisht, krejtësisht e shpërfillur, (e neglizhuar, e injoruar, qëllimisht e heshitur?): Cilët faktorë luajtën rolin vendimtar që, në atmosferën aq të çlirët të tolerancës më të madhe, kulturore, etnike dhe fetare, disa vendosën ta pranonin, e disa të mos e pranonin Islamit. A thua vetëm sepse disa kanë qenë më të përkushtuar ndaj fesë së tyre se disa të tjerë, apo kanë qenë në lojë edhe motive të tjera konkrete, pragmatike, të cilët mund të shkojnë në llogari si të pranimit, ashtu edhe të mospranimit të Islamit!? Praktikisht, tërë prodhimi i vëllimshëm shkencor për këtë temë tregon subjektitivitetin e pazakonshëm ideologjik dhe cektësinë metodologjike.

Subjektiviteti ideologjik shfaqet në faktin se përjashtimisht interesi i hulumtuesve përqendrohet në përparësinë e pranimit të Islamit, duke injoruar qoftë teorikisht mundësinë e hapur se edhe mospranimi i Islamit mund të sillte përparësi të caktuara dhe të ishte me dobi të konsiderueshme; kurse cektësia metodologjike është e dukshme në qasjen e pazakonshme të theksuar metodologjike, sipas së cilës për të gjitha vendimet e protagonistëve të këtij procesi, kanë qenë përgjegjëse disa *shkaqe*. Plotësisht është shpërfillur fakti që, në mënyrë rreptësisht metodologjike, kategoria e *shkaqeve (causa)*, thjesht nuk funksionon në sferën e jetës shoqërore! Në këtë kontekst, kategoria e *shkakësisë* shënon relacionin në të cilin një gjë dhe ndodhia e njëjtë (*shkaku*), gjithnjë dhe domosdoshmërisht shpie kah rezultatet (*pasojat*) e njëjta. Tashmë vetë fakti, që në rrethana të njëjta disa e kanë pranuar Islamin, deri sa të tjerë këtë nuk e kanë bërë, logjikisht e përjashton relacionin e shkakësisë!

Në pyetjen laike, si të shpjegohen fenomenet shoqërore nëse në to nuk veprojnë shkaqet e domosdoshme, ligjërata serioze shkencore përmend ndërhyrjen metodologjike kyçe, të cilën filozofia¹⁴⁵ qysh moti ia ka dhuruar sociologjisë: *që në analizat e fenomeneve të përdoret nocioni i “motivit”, në vend që si ndonjë nomatisje dogmatike përsërit nocionin e “shkakut”*. Si kurse është e njohur mirë, edhe në nivelin individual edhe në nivelin kolektiv, njerëzit së pari, në bazë të përvojës dhe probabilitetit, gjykojnë implikimet e mundshme të synimeve dhe veprimeve të veta, e vetëm pastaj marrin vendimin final. Të pajisur me kapacitetin thelbësor që të përzgjedhin lirisht se si do të veprojnë në situatën e dhënë, dhe madje, a do t'i nënsh-

¹⁴⁵ Mjafton të kujtojmë analizat kritike të Hjumit për nocionin e *shkakësisë*. Shih: David Hume, *A Treatise of Human Nature*, (New York: Dover, 2003 edition, botimi i parë 1736).

trohen diktatit të rrethanave apo do ta injorojnë plotësisht, edhe individët, edhe partitë politike, edhe kryetarët e shteteve me ekipet e këshilltarëve, kalkulojnë, gjejnë, nga një pikë-pamje e cila u ofron zgjidhje, kurse nuk veprojnë në mënyrë të verbër, si bilat e bilardos, rrugët e të cilave janë pasoja domosdoshmërisht të caktuara, të goditjes së shkopit, gravitacionit dhe veçorisë së tavolinës në të cilën rrotullohen! Konkretisht, të ballafaquar me dilemën që të përzgjedhin lirisht duan apo nuk duan ta pranojnë Islamin, nënshtetasit e shtetit osman janë udhëhequr para së gjithash me aspiratat e tyre, vlerësimin strategjik të pasojave të mundshme apo probabiliste për një vendim të këtyllë apo të atillë, kanë marrë parasysh përparësitë dhe mungesat, edhe të përgjigjes pozitive edhe negative, shkurt, kanë zgjedhur! Për këtë arsye, çdo diskutim kompetent për pranimin apo mospranimin e Islamit në Ballkan në kohën e pushtetit osman, thjesht duhet të flasë për *motivet*, assesi jo edhe për shkaqet e këtij fenomeni!

Kjo hap drejtpërdrejt temën *Ad 3*. Edhe pse tërë qëndrimet dhe veprimet njerëzore në vijën e fundit janë një lloj i përzgjedhjes ndërmjet disa alternativave të vlerësuara në dritën e asaj që do të mund të sillnin apo merrnin, fakti se në çështjen e pranimit dhe mospranimit të Islamit në Ballkan, praktikisht nuk ekziston asnjë studim apo tekst, të cilin e kanë marrë parasysh dhe vlerësimin e motiveve për shkak të të cilave një pjesë e popullsisë ka vendosur të mos e pranojë Islamin, përbën një skandal të llojit të vet sociologjik dhe historikisht kulturologjik. Perceptimi i tij, është e qartë se nuk mund të nisët nga supozimi për njohjen e pamjaftueshme të këtij fakti në përgjithësi të njohur, por përgjigjja duhet të kërkohet në labirintet e vetëdijes ideologjike të rregulluar me paragjykime dhe stereotipa. Të gjitha studimet shkencore, ideologjike, historike apo sociologjike, fla-

sin për “shkaqet” (ne flasim në mënyrë më adekuate për arsyet) prej të cilave paraardhësit e muslimanëve të sotëm evropianë, e kanë pranuar Islamin”, ndërsa as një i vetmi nuk përmend as shkaqet, as arsyet, as motivet e atyre të cilët kanë vendosur të mos e pranojnë Islamin!? Në çdo analizë të sjelljes sociale, në të cilën verifikohen përcaktimet, përpunohen motivet dhe përgjigjet “Pro”, sikurse edhe përgjigjet “Kundër”, si detyrim i vetëkuptueshëm metodologjik. Në çdo analizë përveç asaj të motiveve të cilat kanë vendosur për motivet e atyre që kanë vendosur që mos ta pranojnë Islamin!? Duke rrezikuar të hyjmë në klishe ideologjike, mund të veçojmë frikën nga mundësia se krahas mospranimit të Islamit shkonin edhe përparësi të caktuara, të cilat në disa aspekte mund të ishin madje edhe më të mëdha se mangësitë, dhe madje më të favorshme edhe nga tërë ajo që ofronte pranimi i Islamit! Në qoftë se kjo hipotezë do të tregohet e pranueshme, do të binte në ujë tërë miti i konstruktuar ideologjik për gjoja bigëzimin moral dhe konfrontimin patriotik, i cili ka shërbyer që akti i pranimi të Islamit të trajtohet si tradhti nacionale dhe fetare nga motive të ulëta, ndërsa vendimi i kundërt është shpallur për akt patriotizmi dhe i fortësisë morale, i cili ka kërkuar viktime të mëdha dhe ka qenë i lidhur me presionet e vazhdueshme! Njëkohësisht, me këtë të gjitha kërkesat për shpërngulje të popullsisë autoktone muslimane dhe marrjen e territoreve e pasurisë së tyre, si satisfaksion historikisht i arsyeshëm dhe moralisht i drejtë për gjoja prapësitë e bëra dhe vendin e marrë, do të tregoheshin krejtësisht të paargumentuara dhe të paarsyeshme, e ashtu edhe tërë projekti nationalist në grabitjen e territorit të popujve fqinjë, do të komprometohej në thelbin e tij të dhunshëm.

Mirëpo, faktorët objektivë të cilët, gjatë vendosjes për apo kundër pranimi vullnetar të Islamit, i kanë pasur popujt e ha-

pësirave ballkanike të përfshirë në përbërje të Perandorisë Osmane, si shtete të reja islame europiane, tregojnë se ka qenë me të vërtetë e vështirë të merret vendimi, sepse edhe njëri edhe tjetri opion kanë pasur edhe përparësi edhe mangësi, përkatësisht, disa anë padyshim të favorshme, sikurse edhe disa anë gjithashtu pa dyshim të pafavorshme. Në suazën e vlerësimit të atmosferës së përgjithshme shpirtërore të asaj kohe, sipas rregullit, edhe studimet më serioze e shpërfillin klimën e fetarisë së thellë dhe të sinqertë, për të cilën ka bollëk dokumentesh dhe dëshmish. Kjo është me rëndësi për shkak se me këtë shpërfilllet çasti mjaft i rëndësishëm i entuziazmit, të cilin Islami e ka bartur me vete si fe e re, e cila krahas kësaj përfaqësonte edhe një lloj sinteze të feve ekzistuese monoteiste dhe filloi si faza përmbyllëse e zhvillimit të tyre, duke e legjitimuar në mënyrë eksplicite veten si *Fjalën e Tretë dhe të Fundit të Zotit*, gjatë së cilës Muhamedi a.s., në pajtim me këtë, është identifikuar si *Pejgamberi i fundit i Zotit*. Pabazueshmëria dhe sipërfaqësia e “shpjegimit” të pranimit të Islamit në truallin european me gjoja “presionet, kërcënimet dhe detyrimin” e pushtetit osman, (që, siç kemi treguar tashmë, janë një trillim më ordiner), hidhet poshtë në rrënjë nga fakti se përhapja më spektakolare e Islamit ka ndodhur në hapësirat, mbi të cilat nuk ka qenë vendosur kurrfarë pushteti osman dhe deri te të cilat osmanlinjtë kurrë nuk arritën! Shtetet më të mëdha në botë, përkatësisht shtetet me numrin më të madh të muslimanëve janë Indonezia, Bangladeshi, Pakistani, India e madje edhe Kina, pra pikërisht shtetet në të cilat pranimi i Islamit ka ecur me proces spontan të entuziazmit të sinqertë fetar për fenë e re dhe për *të vërtetat e fundit, të cilat Zoti ua zbuloi njerëzve*. Kjo që edhe numerikisht dhe në përqindje shumë më tepër muslimanë e kanë pranuar Islamin në këto shtete, të cilat kurrë nuk kanë qenë në kuadër

të Perandorisë Osmane, përbën një fakt të pakontestueshëm, për të cilin duhet të mendohen thellë të gjithë ata, të cilët pranimin e Islamit në kuadër të Perandorisë Osmane si shtet evropian islam, e sjellin në lidhje me *detyrimin e hekurt dhe kërcënimet vdekatare*. Dhe pikërisht po ky fakt vërtetohet në mënyrë shtesë tezën tonë, se shteti osman ka pasur në dispozicion masat administrative, të cilat jo vetëm që nuk kanë ushtruar presion që të pranohej Islami, por kanë kthyer dhe penguar një numër të madh njerëzish me aspirata që të kalonin në Islam. Përveç kësaj, përzgjedhja e fesë, në situatën në të cilën paraqitet një opsion fetar i ri, vital, i bartur me forcën e shtetit të organizuar dhe të fuqishëm siç ka qenë Perandoria Osmane në shekujt e parë të historisë së tij evropiane, në kohën ashtu të theksuar fetare, vetëm e ka potencuar faktin se zgjedhja e përcaktimit fetar gjithnjë është akt thellësisht intim, vendim i vlerës dhe përzgjedhje aksiologjike. Asnjë analizë serioze shkencore, sociologjike, historike apo socio-psikologjike, nuk guxon ta injorojë këtë fakt, edhe më pak është e lejueshme që pranimi i fesë së re sikurse edhe refuzimi që feja e re të pranohet, të vulgarizohet dhe të thjeshtëzohet përjashtimisht te niveli i veprimit të disa faktorëve jashtë-psikologjikë, objektivë, apo, në rastin më të mirë, të lakmisë, ambicies dhe jomoralitetit të disave, krahas theksimit të fortësisë, konsekuencës dhe moralitetit të të tjerëve!

Mundësia e zgjedhjes së lirë që vullnetarisht ta pranonin, apo, po ashtu, që vullnetarisht të mos e pranonin Islamin, sikurse tashmë është thënë, i ka ballafaquar banorët e këtij shteti evropian islam me disa përparësi dhe mangësi të rëndësishme në të dy variantet e përgjigjes së mundshme. *Anët e mira* të përgjigjes pozitive ishin të dukshme: përshtatja me modelin dominant të jetës dhe me rrjedhat qendrore të proceseve shoqërore. Kanalet e promocionit vertikal në shtresimin shoqëror i kanë

pasur të hapura, ndërsa mobiliteti i tyre ka qenë plotësisht i lirë në kufijtë e shtetit të madh. Kjo ka pasur kuptimin e mundësisë së bërjes së karrierës në shërbimin shtetëror, qoftë nëpërmjet karrierës ushtarake apo administrative. Herë-herë kjo mundësi ka shpënë deri te pozita mjaft të larta, dhe kështu edhe boshnjakët dhe shqiptarët kanë dhënë me dhjetëra funksionarë të lartë dhe më të lartë shtetërorë, vezirë të mëdhenj, vezirë, pashallarë dhe komandantë ushtarakë. Kuptohet, shpesh shtresimet e mëdha kanë mbetur të paplotësuara dhe në rastin më të mirë nga shërbimi shtetëror ka mbetur vetëm ndonjë funksion krejt i parëndësishëm. Ata të cilët duke e pranuar Islamin kanë mbetur në vendin e tyre, kanë qenë thelbësisht të varur vetëm nga puna vetjake në pronën e vet, njësoj sikurse edhe ata të cilët Islamin nuk e kanë pranuar. Përgjigjja negative, sipas logjikës së kundërshtimit, këtu ka pasur *anën e saj negative*, sepse mbajtja e fesë kristiane në shtetin islam do të thoshte mbetje në skajet e jetës shoqërore dhe largim në periferi të ndodhive kryesore shoqërore. Rrugët e promocionit vertikal në shtresimin shoqëror për ta kanë qenë të mbyllura, kurse mobiliteti i tyre shoqëror është rrëgjuar ekstremisht.

Edhe pse rëndom sipërfaqësisht dhe krejtësisht në mënyrë joshkencore dhe me llafe është theksuar si *shkaku kryesor* i kalimit në Islam, në zgjedhjen përfundimtare *dimensioni ekonomik* në fakt ka qenë në fund të shkallës motivuese. Tatimet e përgjithshme për muslimanët dhe jo-muslimanët, përkundër ekzistimit të disa dallimeve të caktuara, në fakt, në baza të ndryshme, janë marrë thuajse në sasi të njëjtë. Bujaria feudale kristiane në fillim gjithsesi ka parë *njërën prej shkaqeve*, por assesi edhe shkaku më të rëndësishëm për pranimin e Islamit. *Ana e keqe* e kalimit vullnetar në Islam, e cila absolutisht është shpërfillur dhe për habi në mënyrë sistematike ka munguar

nga të gjitha studimet në këtë temë, përbënte një fakt të qartë, të imponuar në mënyrë imperative për *ndryshimin total të mënyrës së jetës*. E para, në mënyrë drastike ka ndryshuar themeli i jetës ekonomike dhe mënyra e ushqimit, sidomos në rastet ku kultivimi i derrave ka qenë degë e rëndësishme e mbijetimit ekonomik; prodhimi i rakisë dhe verës, gjithashtu degë e shtrirë dhe e rëndësishme e ekonomisë së popujve ballkanikë, gjithashtu u desh të mënjanohet plotësisht. Shprehitë jetësore, zakonet, festat familjare, festat fetare, kontaktet e rregullta me priftërinë e cila përbënte bazën e të gjitha ndodhive të rëndësishme shoqërore dhe familjare, e me këtë drejtpërdrejt lidhje ndërprerja e shkallë-shkallëshme apo e përnjëshershme e lidhjeve familjare dhe miqësore, fafesisnore dhe joformale me rrethin në të cilin deri atëherë është jetuar, hyrja në kontekst të ri dhe përballja me përmbajtje shoqërore të panjohura, largimi nga shtëpitë e ikonave familjare, ndryshimi i ritmit jetësor i lidhur me detyrimin që të kryheshin pesë lutjet ditore, marrja e abdes-tit, leximi i lutjeve në një gjuhë plotësisht të panjohur, arabe, të gjitha këto paraqesin vetëm një pjesë të problemeve të mëdha dhe vështirësive serioze me të cilat janë përballur të gjithë ata, të cilët e zgjodhën pranimin e Islamit si vendimin e tyre të fatit.

Pikërisht të gjitha këto përmbajtje paraqisnin *anën e mirë* të vendimit, që Islami mos të pranohej. Mbetja në fenë e vet nuk kishte kuptimin e ekspozimit ndaj kurrfarë rreziku e as presioni, sepse vetë zgjedhja ishte plotësisht vullnetare dhe e lirë. Sikur pranimi i Islamit përbënte transformimin themelor të sistemit tradicional të vlerave dhe mënyrës së jetës, ashtu edhe vendimi që Islami të mos pranohet, kishte kuptimin e vazhdimit të papenguar të mënyrës tradicionale të jetës, pa kurrfarë lëshimesh, kompromisesh apo ndryshimesh. Baza e ushqimit ka mbetur mishi i dërrit, familjet fshatare e kanë ruajtur struk-

turën e tyre ekonomike, konsumimi i alkoolit, si element mjaft i rëndësishëm i traditës kulturore dhe komunikimit social në hapësirat ballkanike, gjithashtu është mbajtur pa pengesa, tradita fetare është respektuar dhe janë mbajtur pa kurrfarë pengesash gjuha kombëtare, zakonet, rrethi i gjerë dhe i ngushtë i lidhjeve sociale ka mbetur plotësisht i ruajtur dhe ka funksionuar pa pengesa. Në dritën e këtyre fakteve, është e qartë se vendimi nuk ka qenë aspak i thjeshtë dhe se, madje, shumë më tepër dhe më fuqishëm janë shtrirë në anën e vet të përparësisë së mosndërrimit të fesë mbi mangësitë e një vendimi të tillë. Gjithashtu, në nivel të këtij vlerësimi, atyre të cilët kanë vendosur që megjithatë ta ndërrojnë Islamin, u është dashur ta kishin të qartë se të gjitha përparësitë e një vendimi të tillë qenë *vetëm potenciale dhe të projektuara në të ardhmen e pasigurtë*, ndërsa mangësitë e tij qenë *krejtësisht konkrete dhe drejtpërdrejt të lidhura me të tashmen*. Njerëzve të cilët, padyshim dhe bashkërisht kanë shqyrtuar zgjedhjen e mundshme *pro et contra*¹⁴⁶, u është dashur ta kishin të qartë në këtë shkallë të vlerësimit, se pranimi i Islamit shtronte shumë më tepër kërkesa dhe ka qenë i lidhur me ndërrime shumë më të rënda dhe më dramatike, sesa vendimi që Islami mos të pranohej. Dhe ndërsa refuzimi që të pranohej Islami ka qenë jo vetëm krejt i lirë dhe nuk ka nënkuptuar absolutisht kurrfarë sanksionesh nga ana e pushtetit, ky vendim gjithashtu ka lejuar që ndryshimi i pushtetit shtetëror (humbja e pavarësisë shtetërore) të amortizohej pa kurrfarë kompromisi serioz prej mënyrës tradicionale të jetës dhe pa rrezikimin e identitetit nacional dhe kulturor.

¹⁴⁶ Është e njohur mirë se në marrjen e vendimit përfundimtar sipas rregullit kanë diskutuar tërë bashkësitë fshatare, mjaft shpesh vëllezërit e lindur, shtëpia-kët me familje të formuara, dhe se një vëlla apo vëllezërit kanë vendosur për një, kurse tjetri vëlla/vëllezër për tjetrin, pikërisht për t'i rritur shansat e veta dhe suksesin shoqëror dhe ruajtjen e fisit në cilindo variant.

Megjithatë, rolin vendimtar në zgjedhjen përfundimtare e ka pasur fakti i cili, në të vërtetë ka vendosur për vetë jetën dhe vdekjen. Dhe pikërisht në këtë fakt konsistonte momenti administrativ, ligjor i cili edhe i ka penguar nga pranimi i Islamit, kurse praninë e të cilit e shpjegon e dhëna që edhe pas pesë shekujve të pranisë së shtetit osman europian islam, pranimi i Islamit në shumë hapësira të Ballkanit dhe ndër disa popuj është zhvilluar aq ngadalshëm dhe joharmonikisht, duke mos arritur atje as disa përqindje! Ky institucion, përkatësisht kjo masë administrative, ligjore quhej *nidhamije*. Fjala është për faktin se ata, të cilët e kishin mbajtur fenë e vet kristiane apo hebraike, pra në mënyrë të përgjithësuar, jo-muslimanët, *kanë qenë të liruar nga shërbimi ushtarak!* Të shkosh në luftë, shpesh së bashku me bijtë e rritur, nuk ka qenë aspak e thjeshtë për shtëpiakun/babanë, i cili ende edhe vetë quhej i aftë ushtarakisht. Mundësia që të jesh *rehat* nga një detyrim i tillë, ka qenë përparësi aq më e madhe meqë krahas shërbimit ushtarak në ushtrinë osmane ka shkuar edhe barra e pashmangshme e rrezikut të madh që nga lufta të mos kthehesh i gjallë. Mënyra legale që ky rrezik të shmanget, sa elegant aq edhe shpëtues, krahas përparësive krahasuese, të cilat tashmë i kemi treguar, praktikisht zgjedhjen e mëtejme e ka bërë plotësisht të panevojshme. Kjo mënyrë ishte që të shfrytëzohej mundësia e dhënë e zgjedhjes së lirë dhe thjeshtë të refuzohej pranimi i Islamit. Thjeshtë, lehtë dhe më: nuk kushton asgjë dhe sjellë çdo gjë! Sjell garanci për vetë jetën e të gjithë anëtarëve meshkuj! Për të gjitha kohët deri sa të ekzistojë shteti islam! Fenomeni që edhe përkundër kësaj popuj, sikurse shqiptarët dhe boshnjakët, megjithatë e kanë pranuar Islamin, sikurse tashmë e kemi parë, shpjegimin e vet mund ta gjejë në faktin se kjo ishte mënyra e vetme me të cilën ata kanë mundur ta ruajnë veçanësinë e

tyre nacionale, dhe kështu në bazë të identitetit të vet, ta ruanin dhe të drejtën legjitime në shtetësi në kufijtë e shteteve të tyre, përkatësisht të territoreve në të cilat përbënin popullsinë shumicë, autoktone, kur ndonjëherë të përfundonte pushteti i osmanlinjve.

Përndryshe, që të pastrohet prej vërejtjeve të mundshme për subjektivitet: për privilegjin e madh dhe vitalisht të rëndësishëm të liritimit nga shërbimi ushtarak, jo-muslimanët kanë qenë të detyruar të paguanin tatim. Ky tatim ishte, gjatë shumicës së kohës së pushtetit osman, *një qengj për vit për njeri – obliguesin e liruar – në para apo naturë!!* Sa ka qenë ky çmim i parëndësishëm për praktikisht privilegjin më të madh të mundshëm, mund të kuptohet nga dy fakte. I pari, në kohën e shtetit osman, afati ushtarak ka zgjatur prej 6, mbi 8 e madje deri në 12 vjet. Së këndejmi kanë lindur të gjitha këngët popullore për nuset, të cilat burrat e porsamartuar i kanë lënë vetëm pas natës së parë martesore *sepse u kishte ardhur thirrja për ushtrinë perandorake*, dhe për gratë e reja të cilat vetë i rrisnin fëmijët e tyre duke pritur me vite (vetë ato burri tashmë i kishte harruar, kurse për fëmijët babai ishte krejtësisht i panjohur) që të kthehej nga ushtria perandorake, këto këngë janë kënduar vetëm për muslimanet dhe asnjëherë për kristianet, sikurse tregohet me këmbëngulje! Të ishte musliman në këtë shtet evropian musliman, nënkuptohej që pashmangshëm të braktisej shtëpia nga *dora e mashkullit*, të mbetej shpesh edhe pa shtëpiakun dhe djemtë, vetëm me gjyshin e plakur dhe fëmijët e vegjël, dhe këtë për disa vjet, pa lajme për ta. Të ishte në po këtë shtet islam evropian jo-musliman, përfundimisht dhe për të gjitha kohët ishin privuar njerëzit nga kjo detyrë dhe të gjitha brengat dhe rreziqet të cilat ajo i ka sjellë. Dhe të gjitha këto vetëm për *një qengj në vit, për kokën të gjallë!*

I dyti, pakkush e ka ruajtur kokën të gjallë nga ata të cilët shkonin në ushtri. Shteti osman, duke e zgjeruar territorin e tij, praktikisht ka luftuar pa ndërprerje. Kufijtë e tij shtriheshin në tri kontinente, kurse shërbimi ushtarak vlente për të gjithë muslimanët. Kështu prej Bosnjës, e cila në atë kohë ishte pjesa e rrezikuar e shtetit osman, gjatë tërë kohës së ekzistimit të saj, të detyruarit ushtarakë boshnjakët kanë shkuar në luftë. Sipas të dhënave për vitin 1558, nga territori i Sarajevës në ushtri kanë shkuar 5640 rekrutë, kurse tetë vjet në vonë, nga ata të gjallë janë kthyer rreth 400, përkatësisht, rreth 7%, që do të thotë se të vrarë kanë qenë afër 94%. Duke e pasur parasysh faktin se gjatë këtyre shekujve vetë Ballkani përbënte njëzën prej zonave më të qeta dhe më stabël të Europës, për ç'arsye edhe është shënuar në histori si periudha e *Pax Ottomanica*, bëhet e qartë se si ka ndodhur që pikërisht në këtë periudhë kristianizmi dhe hebraizmi, përkatësisht popullsia përgjithësisht jo-islame në kuadër të një shteti islam europian, siç ka qenë Perandoria Osmane, ka përjetuar shpërthimin më të madh demografik, pa precedent në historinë e tërë Europës dhe tërë shteteve kristiane europiane!

Nëse përmbledhim, do të shohim se në vendimin skajor në raport me pyetjen e konvertimit të lirë në Islam, banorët e Ballkanit kanë shijuar përparësi shumë më të mëdha dhe në mënyrë vitale më të rëndësishme në rastin që këtë mund ta refuzonin, ndërsa pranimi i Islamit sillte hyrjen në vargun e detyrimeve dramatike dhe madje obligimeve të reja më të rrezikshme. Këto përparësi kanë qenë:

1. Siguria e garantuar dhe ekzistimi fizik, duke e ruajtur mënyrën tradicionale të jetës;

2. Ruajtja e identitetit kolektiv nacional, të traditës kulturore, e drejta e garantuar për gjuhën vetjake, praktikimi dhe respektimi i papenguar i fesë së vet dhe arsimimi në gjuhën e vet;

3. Në fund, gjithsesi përparësia krahasimisht më e rëndësishme e mospranimit të Islamit në këtë shtet europian islam, ka qenë lirimi nga detyrimi i shërbimit ushtarak dhe mbrojtja e shtetit! Pikërisht ky moment, sado qoftë përndryshe të jetë në pajtim me modelin tradicional të trajtimit të popullsisë joislame në kuadër të shtetit islam, ka qenë edhe faktori më i rëndësishëm për perceptimin e lehtësisë dhe gatishmërisë me të cilën subjektet jo-muslimane të shtetit osman, janë kthyer kundër tij pas shekujve të mbrojtjes së plotë të sigurisë së tyre, pa-surisë dhe të gjitha të drejtave të cilat po ky shtet ua kishte ofruar! Me fjalë të tjera, në situatën në të cilën qe kursyer të derdhte gjakun e vet për vlerat e shtetit në të cilin ka jetuar dhe begatitë e të cilit i ka shfrytëzuar, popullsia jo-muslimane thjesht këtë shtet kurrë as nuk e ka pranuar si *shtet të saj*. Në vend të përkushtimit, tek ata është zhvilluar pritja e rastit të parë të volitshëm që këtë shtet ta sulmonin dhe që, në rrënojat e tij, ta rimëkëmbnin shtetin e vet qysh moti të humbur dhe që edhe ta zgjeronin në të gjitha territoret, në të cilat jetonin muslimanët, pa marrë parasysh që ato territore kurrë nuk kanë qenë të tyre – për shembull Bosnja dhe Hercegovina!

Një shembull për respektimin e ligjit: Rasti Muslibegoviç kundër kryepleqve ortodoksë më 1687

Europa nuk guxon të pësojë më nga *kujtesa e shkurtër*. Nëse edhe kemi harruar se pjesa më e qetë e Europës me shekuj ka qenë ajo në të cilën shtrihej shteti europian islam, Perandoria Osmane, si shteti më stabil dhe më tolerant i Europës, assesi nuk mund të lejojmë përmbysjen e plotë të fakteve dhe të pranojmë imazhin në mënyrë morbide të shtrembëruar, sipas të cilit ky shtet europian islam është paraqitur si madje edhe *më*

pak tolerant nga shtetet europiane kristiane të kohës së tyre!?
 Një nga mitet e përhapura i cili Islamin përgjithësisht, e muslimanët veçanërisht, i tregon në dritë negative, është miti për anarkinë, e cila gjoja ka qenë e përhapur në territorin e Perandorisë Osmane, sikurse edhe për arbitraritetin e bejlerëve, agallarëve, subashëve dhe bujarëve të tjerë muslimanë, të cilët kinsë, krahas të gjitha vështirësive të tjera që shteti ua kishte imponuar, edhe si krye në vete në mënyrë plotësuese kanë bërë kër-di, pa u ndëshkuar, duke e shkelur rajën kristiane. Që feudalët kristianë kanë shkelur bujkrobërit dhe kanë ushtruar arbitraritetin e vetë nën mbrojtjen e kushërinjve të tyre me grada më të larta të fuqisë shoqërore, ekziston numër i madh studimesh të shkëlqyeshme dhe sistematike.¹⁴⁷ Megjithatë, bie në sy sa rrallë theksohen shembujt e tillë në prodhimin letrar të autorëve jo-muslimanë, sidomos në Ballkan, në çka sidomos tejkalojnë autorët prozaikë serbë, të cilët si në një shirit të pafund *hartojnë romane historike* (??) përplot dhunë turke mbi rajanë kristiane, pa edhe një të vetmin argument të vlefshëm historik.¹⁴⁸ Përkundër kësaj, për rastin e dokumentuar të kontestit juridik të beut të pasur dhe bujkrobit të fesë ortodokse në Mostar, i cili me saktësi të habitshme ilustron thuajse rendin e përkryer dhe respektimin e të drejtave në truallin e shtetit osman, deri sot nuk është botuar asnjë i

¹⁴⁷ Si shembull i monografive konceptuale të bazuara me konsistencë, të mbështetura në lëndën empirike qeveritare dhe burimet arkivore, mjafton të kujtohen vepra e Johan Hojzingut *Vjeshta e Mesjetës*, si edhe hulumtimet rezultatet e të cilave i ka komunikuar në veprat e veta Mishel Fuko, ndërsa nga letërsia tekstet paradigmatiche *Kryengritja fshatare* e August Sheno, sikur edhe Mihael Kolhas, Hajnrih fon Klajst. Është interesante se dhuna e feudalëve mbi kmetët në disa pjesë të Evropës kristiane, në prodhimin letrar të autorëve kristianë tregohet si përjashtim (e cila sipas rregullit ndëshkohej, sikurse në baladën për Robin Hudin apo romanet e Valter Skotit), ndërsa në paraqitjen e jetës së shtetit osman, anarkia dhe arbitrariteti tregohet i rregullit.

¹⁴⁸ Romani *Hajnesha në haremë* (*Hajdućica u haremu*) e Dushan Baraninit përbën shembull paradigmantik.

vetmi rresht. Rasti vlen të theksohet sepse i qorton plotësisht të gjitha stereotipat negativë për anarkinë në shtetin osman, dhe njëkohësisht, ndriçon në mënyrë plotësuese një sferë aktuale juridike, e cila drejtpërdrejt prek në të drejtat ekologjike të qytetarëve.

Ja ky tregim në vija të shkurtra: Kur familja e Musli Bej Muslibegoviqit të pasur e të fuqishëm në vitin 1687 nga Herceg-Novi kaloi në Mostar, pasi Venediku e pushtoi këtë qytet të ndërtuar nga Bosnja mesjetare, beu bleu një shtëpi me tre kate, në një vend të bukur me pamje të bukur. Familja Muslibegoviq kishte pasuri të mëdha në rrethinën e Mostarit dhe pasuria dhe fuqia e tyre shpejt e radhiti në rendin e familjeve bujare më të famshme dhe më ndikuese në Mostar dhe rrethinën më të gjerë. Beu deshi t'i mbindërtonte edhe dy kate, që nga çardaku në katin e pestë, të mund të kënaqej me pamje edhe më të bukur, e cila do ta kapte edhe tërë Urën e Vjetër dhe ujin e pastër të gjelbër të Neretvës. Dhe këtu fillojnë befasitë, si për të paudhëzuarit, ashtu edhe për numrin më të madh përndryshe të njohësve të udhëzuar mirë të kësaj periudhe, të cilët në mënyrë rutinore kanë pranuar mitet negative si të vërteta për këtë kohë, hapësirë dhe popull. Me fjalë të tjera, së pari plani i hollësishëm arkitektonik për mbindërtim edhe të dy kateve, duhej dërguar në Stamboll për shikim dhe eventualisht për leje! Ndërkohë, fqinji i parë i beut, shtëpiza e të cilit ishte afër shtëpisë së Muslibegoviqit, e kontestoi të drejtën për të ndërtuar këto dy kate të parashikuara. Kujdes, fjala është për bujkrobin e varfër, ortodoks, i cili në kohën e fuqisë më të madhe të Perandorisë Osmane, ia konteston të drejtën beut të fuqishëm, të pasur dhe të famshëm, që t'i ndërtonte dy kate në shtëpinë e tij të lindjes? Si do të ndodhte nëse ndonjë varfanjak, punëtor, i cili sot do të tentonte t'ia kontestonte po këtë të drejtë industrialistit të fuqishëm në fabrikën e të cilit është punësuar, apo ndonjë nje-

riu me ndikim politik lokal, i cili *e tund* tërë qytetin? A ekziston një shembull i tillë, apo së paku i ngjashëm, në tërë historinë juridike të feudalizmit kristian në truallin e Europës!? Do të isha shumë mirënjohës për çdo informacion, i cili do ta vërtetonte këtë. Sidoqoftë, fshatari-bujkrob është ankuar se dy katet shtesë të shtëpisë së beut, e cila është aq afër shtëpizës së tij modeste, *do t'i bënin hije tërë pranverës dhe vjeshtës shtëpisë së tij*, e kjo do të thoshte se do t'ia hiqte dritën e drejtpërdrejtë të diellit gjatë gjysmës së vitit!? Pas një diskutimi të gjatë, gjykata në Stamboll mori vendimin e kushtëzuar që Muslibegoviqi mund ta ngrinte vetëm edhe një kat e jo dy, dhe edhe këtë me pajtim të fqinjit bujkrob dhe me dëmshpërblim, për të cilin ata do të merreshin vesh në seancë private dhe do ta rregullonin para gjykatës!

Cili shtet sot kujdeset për të drejtën e qytetarëve të vet lidhur me dritën e diellit!? Kush duke iu drejtuar kësaj të drejte, do të bënte gjyq kundër një bujari lokal, në një seancë të cilën do ta niste fqinji i varfër!? Tërë dokumentacioni origjinal i këtij rasti mund të shihet në shtëpinë e Muslibegoviqit, e cila sot është shndërruar në hotel, një hotel i cili në vitin 2010, në konkurrencë me më shumë se 1.200 hotele nga tërë bota, ka zënë vendin e tetë sensacional! Vetë kjo ndodhi e pabesueshme mbresëlënëse, me romuzin e vet të lartësuar për të drejtën e njëjtë të të gjithë njerëzve lidhur me dritën e diellit, e ndriçon me shkëlqimin e veçantë të të vërtetës sundimin e të drejtës në Perandorinë Osmane, atij shteti atëherë aq të fuqishëm europian islam, dhe pret penën e vet letrare, e cila këtë tregim të shkëlqyeshëm do ta rrëfejë në mënyrë të mirëfilltë që nuk do të harrohet.

Kjo është edhe më e rëndësishme nëse kihet parasysh se gjatë tërë kësaj periudhe, deri sa shtetet kristiane europiane ishin thuajse në luftë të përhershme njëra kundër tjetrit, dhe ndërsa pjesën kristiane të Europës e kanë shkatërruar luftërat fetare dhe

dëbimet sektare, kurse nga Spanja, në vitin 1492, qenë dëbuar të gjithë muslimanët dhe hebrenjtë (dëbimi i hebrenjve nga Anglia ka pasuar diç më vonë), ndërsa deri në themele rrënohet çdo gjë që e kishin ndërtuar muslimanët në truallin e Spanjës dhe Portugalisë pas gati 800 vjet pranije të gjatë, sikurse edhe në truall të Sicilisë, Sardinisë, Korzikës, Kretës dhe gadishujve të tjerë mesdhetarë, për këtë kohë, Europa islame, e mishëruar në shtetin osman, dhe këtë pikërisht në Ballkan, kënaqej me begatitë e tolerancës së garantuar multi-kulturore, multi-gjuhësore, multi-fetare, në një shoqëri në të cilën pikërisht gjoja janë nënshtruar jo-muslimanët (dhe vetëm ata!), kurse krahas të gjitha të drejtave të tjera, qenë liruar madje edhe nga obligimi ushtarak!¹⁴⁹

¹⁴⁹ Si ilustrim, le të shërbejë e dhëna se, gjatë ikjes nga Budapesti, qeveria osmane ka lënë në qytet rreth 220 xhami, duke llogaritur edhe të gjitha kishat e gjetura kur 160 vjet më parë, pas fitores së madhe në Mohaç në vitin 1526, e pushtuan Hungarinë, sikurse edhe shumë kisha të ndërtuara në qytet gjatë sundimit islam në këtë periudhë. Mirëpo, pushteti kristian, i cili e mori Budapestin, qysh në vitin vijues 1687 nuk e la asnjë xhami vetëm për një vit, duke i rrënuar të gjitha me themel. Bie në sy se kjo e dhënë mbi rrënimin e mbi 200 xhamive vetëm për një vit, nga ana e pushtetit kristian në Budapest, praktikisht rrallë apo aspak nuk theksohet në shumicën e studimeve të kësaj periudhe, njësoj sikurse shpërfillet edhe e dhëna e kundërt për detyrimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së objekteve kishtare, përkatësisht, të të gjithë tempujve të feve jo-islame të shtetit osman! E njëjta histori u përsërit edhe në Beograd, si praktikisht edhe në të gjitha territoret në të cilat pushtetin evropian islam e zëvendësoi pushteti evropian kristian: shteti islam kudo i ka lënë të paprekur tempujt fetarë të popullsisë jo-muslimane nën jurisdiksionin e vet, si katedralet dhe kishat kristiane ashtu edhe sinagogat hebraike, ndërsa pushteti joislam thajse pa përjashtim në vend i ka hyrë rrënimin të pamëshirshëm të objekteve fetare muslimane. Kjo praktikë nuk ka ndërruar madje as në fund të shekullit XX, kur njësitë ushtarake serbe në agresionin mbi Bosnjën dhe Hercegovinën, kanë rrënuar mbi 1.000 xhami, duke llogaritur edhe objektet me status të përmendoreve kulturore nën mbrojtje strikte të ligjeve të aplikueshme, nga të cilët shumica kanë më të vjetra se 550 vjet. Pikërisht këto fakte historike, si lëndë e pakontestueshme, duhet pasur parasysh dhe të afirmohen në çdo rast, që të afirmohet e vërteta historike dhe njëkohësisht, që të hapet rruga drejt fshirjes së stereotipit negativ dhe plotësisht të gabueshëm për karakterin e këtij shteti dhe kulture islame dhe kështu të hapet rruga drejt përbaljes me ndikimin e saj vendimtar pozitiv në futjen e zhvillimit të idesë së tolerancës kulturore e fetare dhe praktikës përkatëse në truallin e Evropës!

Nëse mund të flitet për ndërmarrjen shpirtërore dhe morale në situatën në të cilën qe lënë zgjedhja e lirë e përkatësisë fetare, atëherë kjo duhet kërkuar atje ku rreziku për jetën ka qenë më i madh e jo më i vogël, në vendimin i cili ka qenë i lidhur me rrezikun më të madh dhe ka kërkuar viktimë më të mëdha, sepse fitorja pa rrezik është edhe triumf pa lavdi! E pikërisht i tillë ka qenë vendimi që lirisht, sipas vullnetit të vetë dhe në pajtim me thirrjen e shpirtit vetjak, të pranohej Islami!

Koment mbi historinë si shkathtësi të falsifikimit

Historianët gjithnjë kanë qenë të ballafaquar me problemin e objektivitetit. Ekspozimi i tyre sfidave të subjektivitetit, vështirësitë e tyre t'i rezistojnë të keqes së gënjeshtres dhe tundimit të fshehjes së të vërtetës, janë të njohura mirë dhe si të tilla nuk paraqesin asgjë të re në psikologjinë e shkencave shoqërore. Fati i tyre praktikisht i pashmangshëm që të krijojnë mite të frymëzuara ideologjiksht dhe t'i shpërfillin faktet objektive, megjithatë është i kufizuar me faktin që një dozë të caktuar të realitetit duhet ta respektojnë, duke marrë parasysh atë se rrëfimet e tyre domosdoshmërisht nënkuptojnë model të caktuar konkret shoqëror të interpretimit - shtetin, epokën, popullin! - shkurtimisht, kontekstin në të cilin nuk është ndërprerë krejtësisht lidhja me realitetin, prandaj impulsit të tyre të lindur që të trillojnë pandalshëm, i duhet vënë fre i fortë! Kup-tohet, realizimi i synimit të këtillë, sado kjo të duket paradoksale, në shkencën e historisë është vetëm *desideratum* aproksimativ, duke pasur parasysh faktin se rrëfimet historike domosdoshmërisht bazohen në modelet konkrete të interpretimit të përkufizuar me praninë e fuqishme të imperativave ideologjikë. Të dyja këto çaste sipas logjikës së gjërave, shpien në redukti-

min e evidencës së madhe historike dhe lëndëve arkivore, në një model unikal dhe të thjeshtëzuar të tregimit ideologjik të pranueshëm. Në tërë këtë, normat dominuese shoqërore, synimet politike dhe idealet etike, të shprehura në formën e miteve nacionale, luajnë një rol më shumë të rëndësishëm. I njohur sipas mohimit të tij irracional dhe të ashpër të arritjeve kulturore dhe përmbajtjeve me vlerë të Islamit¹⁵⁰, Ernest Renani megjithatë ka pasur ndërgjegje të mjaftueshme shkencore që në fjalimin e tij të njohur, të mbajtur në vitin 1882 në Universitetin e Sorbonës të nënvizonte karakterin universal të këtij devijimi metodologjik të historisë si shkencë, me fjalët se “*shtrembërimi i vetëdijshëm dhe i qëllimshëm i historisë vetjake përbën një pjesë të rëndësishme të krijimit të çdo kombi*”.

Miti për gjoja “*islamizimin e dhunshëm*” në Ballkan, gjithsesi paraqet një shembull të veçantë në shtrembërimin drastik të historisë vetjake të një populli dhe zëvendësimin e saj me mitin e bazuar mbi falsifikime, fiksione dhe konstruksione të privuara nga çfarëdo argumentesh të vlefshme empirike, pikërisht me synim krijimin e kombit vetjak. Shtrembërimi i historisë reale, i shpënë deri te paroksizmi dhe zëvendësimi i saj me një mit ideologjikisht të fabrikuar, veçanërisht në mënyrë eksplicite është bërë në historiografinë serbe, duke filluar nga gjysma e parë e shekullit XIX, deri sot, dhe këtë pikërisht me paraqitjen e gjoja “*islamizimit të dhunshëm*” në Ballkan. Ky mit, i filluar në veprën poetike letrare të vlladikës malazez Petar Petroviq II – Njegosh, ndërsa është zhvilluar në opusin e prozës të romancierit Ivo Andriq, edhe sot përbën pjesën integrale të vetëdijes nacionale serbe, të implantuar me të gjitha mjetet dhe

¹⁵⁰ Ernest Renan: *Oeuvres complètes*, Vol. II, Paris, 1948, pf. 332-333, sikurse edhe në: Ernest Renan, *Histoire generale de systeme compare du langues semithique*, Paris, 1955, pf. 145-146.

rrugët e mundshme: nga tradita gojore, nëpërmjet edukimit në të gjitha nivelet, prej kopshteve deri te studimet pas-doktorature, dhe me të gjitha mjetet mediatike! Thujse kurrfarë pengese askujt nuk i paraqet fakti se për këtë besim të përhapur, nuk është theksuar asnjë i vetmi burim i verifikuar historik!? E dhëna se burimi i parë për “*islamizimin*” ka ardhur nga pena e një gazetari, në fakt nuk është kurrfarë *burimi*, aq më pak argument shkencor, i është e njohur vetëm rrethit të ngushtë të specialistëve dhe nuk theksohet praktikisht kurrë. Me fjalë të tjera, puna është për raportin të cilin në vitin 1827 e ka shkruar Gjorgjije Magarasheviqi,¹⁵¹ kur fuqia e Perandorisë Osmane në Ballkan tashmë qe thyer, kurse procesi i pranimit të Islamit tashmë qysh moti qe përfunduar si në Serbi, atëherë principatë e cila vetëm formalisht ende mbetej subjekt i shtetit osman, ashtu edhe në tërë Ballkanin. Në këtë raport, Magarasheviqi, ndër të tjera, shkruan:

“Çfarë veprimi të tmerrshëm kanë bërë (turqit – vër. e F. M.) mbi vëllezërit tanë! Plotësisht ua kanë ndryshuar fenë! Ata nuk duan as të dëgjojnë se janë serbë, as ndonjë gjë tjetër për vëllezërit e tyre sllavë. Ata janë sikurse degët e thata e të rëna nga trungu i sllavëve. Të parët e tyre *nën forcën e armës janë detyruar ta pranojnë fenë e re*. Me këtë ata kanë mohuar preardhjen e tyre. Serbët e islamizuar, të verbër nga fanatizmi, janë shumë më të këqij edhe nga turqit.”

Në këtë tekst plotësisht të trilluar, përveç që qartazi nuk ofron asnjë dëshmi, Magarasheviqi madje me vetëdëshirë boshnjakët i shpall për serbë. Ky është mohim krejtësisht i pazakonshëm të identitetit nacional të boshnjakëve, duke pasur parasysh se madje edhe vetë Ilija Garashanini në *Naçertanijen* e tij (1844) edhe më tej për të gjithë banorët e Bosnjës dhe Hercegovinës, pa marrë parasysh përcaktimin e tyre fetar, ka përdorur

¹⁵¹ I njohur si themelues i *Letopis matice srpske*, gazetës letrare serbe.

ekskluzivisht përcaktimin nacional “boshnjakët”.¹⁵² Dhe ç’të thuhet për tërë tregimin për “*islamizimin e dhunshëm*”, i cili nuk bazohet në “dëshminë” e këtillë, çfarë është ky vajtim i Magarasheviqit, pos që për ideologjinë nacionaliste argumentet nuk luajnë kurrfarë roli!? *Kur nuk ka mish, e mirë është edhe çorba!* Çorbë të ngjashme pa argumente dhe me pasoja të njëjta katastrofike ka gatuar edhe autori i njohur serb Sima Millutinoviç – Sarajlija, i cili ka shkruar poezinë për gjoja martirizimin e njëfarë *dhiaku Avakum* (për të cilin nuk ekzistojnë kurrfarë të dhënash!?), të cilin turqit së koti tentonin me dhunë ta konvertojnë në Islam, dhe në fund, pas një mundimit të tmerrshëm, e kanë vrrarë! Ky tregim i trilluar, ndërkaq, ka pasur efektet e veta mjaft konkrete dhe reale. Së pari, ka frymëzuar vetë Njegoshin të shkruante *Kurorën e Maleve* të tij, në të cilën me tërë fuqinë fton për zhdukjen e të gjithë muslimanëve (në *hulumtimin e poturicave*), për të cilën për fat të keq me entuziazëm iu përgjigjën mijëra vullnetarë, që pasoi gjithashtu me mijëra viktima civile ndër muslimanët e kësaj pjese të Ballkanit. Vrasjet masive, dëbimet, plaçkitjet shpejt sollën deri aty sa shumë qytete të populluara me muslimanë, mbetën pa muslimanë. Ajo që është edhe më shqetësuese, është fakti se po këto vargje jepnin frymëzim dhe “arsyetim” për masakrat serbe mbi popullsinë civile në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 1992-1995, duke përfshirë edhe gjenocidin në Srebrenicë!¹⁵³

¹⁵² Për një analizë të shkëlqyeshme të nxitjes sistematike të qëndrimit anti-musliman nëpërmjet përhapjes së organizuar të falsifikimit, shih studimin instruktiv të Bojan Aleksov: “Perceptions of Islamization in the Serbian national discourse”, *Southeast European and Black Sea Studies*, Volume 5, Issue 1, 2005, Pages 113–127, sikurse edhe në kontributin e autorit të njëjtë: “Adamant And Treacherous: Serbian Historians On Religious Conversions”, në antologjinë: Dennis Washburn, A. Kevin Reinhart (eds.), *Converting Cultures. Religion, Ideology and Transformations of Modernity*, Leiden, Brill, 2007, 81-111.

¹⁵³ Për prodhimin sistematik të urrejtjes ndaj Islamit dhe muslimanëve, mezi të fshehur me përdorimin e nocioneve *turqit* dhe të *turqizuarit*, sikurse edhe për

Fjala është për programin e përpunuar nacional, kështu që edhe një shkencëtar serioz siç ka qenë Jovan Cvijiqi i është nënshtruar mitit për islamizimin e dhunshëm. Ai në mungesë të çfarëdo të dhënash autentike dhe të argumentuara se një islamizim të tillë të dhunshëm e ka bërë pushteti turk, ka paraqitur *tezën* se islamizimin e kanë kryer paraprakisht serbët e islamizuar (?). Çedomil Mitrinoviqi, përndryshe nxënës i Jovan Cvijiqit, ka publikuar librin për karakterologjinë e popullsisë myslimane, në të cilin ata janë përshkruar si të *paafitë*, fatalistë, keqbërës, ndërsa rënien e tyre demografike (të shkaktuar nga dëbimet e pamëshirshme dhe vrasjet masive) e shpjegon me “*prostitutum, alkoolizëm, perversionet më të llojllojshme, para së gjithash homoseksualitetin e përhapur*”, duke injoruar plotësisht faktin se muslimanët, sidomos në atë kohë, nuk kanë pirë alkool, kurse jetën e bashkëshorteve, motrave dhe fëmijëve femra të tyre e kanë kontrolluar rigorozisht me sistemin e ndalesave dhe kufizimeve më të rrepta fetare! Një kureshti të llojit të vet paraqet edhe e dhëna se shumë formulime, e edhe pasazhe të tëra që Mitrinoviqi tekstualisht i ka sjellë në disa libra dhe tekste, të cilat nuk i përmend, madje as si referenca, kurse mund të gjenden si paradigma të stereotipave ekstremistë kulturorë dhe fetarë kundër Islamit e musli-

pasojat e atij projekti aktual permanent shih: Michael Sells, *The Bridge Betrayed: Religion and Genocide in Bosnia*. Berkeley: University of California Press, 1993 and 1998; Norman Cigar, *Genocide in Bosnia, The Policy of Ethnic Cleansing*. College Station: Texas A&M University Press, 1995; Branimir Anzulović, *Heavenly Serbia: From Myth to Genocide*. New York: New York University Press, 1999. Edhe pse shumë më e rezervuar në kualifikime të dëbimeve masive ndaj boshnjakëve muslimanë, deri te krimi i bërë më 9-10 korrik 1995 në Srebrenicë, të kualifikuar me vendimin e gjykatës ndërkombëtare si gjenocid, në të cilën janë vrarë mbi 8370 boshnjakë muslimanë, Keti Karmajkl gjithashtu shenon me gisht në veprat e Njegoshit dhe Ivo Andriqit si gjeneratorë të fuqishëm të sindromit anti-islam të popullsisë kristiane në Ballkan. Shih: Cathie Carmichael (chapter “Mountain Wreaths: Anti-Islam in Balkan Slavonic Discourses”), në librin e saj *Ethnic Cleansing in the Balkans* (London: Routledge, 2000), pf. 21-38.

manëve, dhe në mënyrë të përgjithshme, “orientalëve”, në faqet e studimit klasik të Edvard Saidit *Orientalizmi*.

Historianët bashkëkohorë serbë të brezit të ri, e kanë zgjeruar këtë repertor të ligjërimit ideologjik të urrejtjes ndaj muslimanëve të Ballkanit, duke përfshirë shqiptarët muslimanë nga Kosova, sikurse edhe *torbeshët* nga Maqedonia dhe vetë maqedonët e fesë ortodokse, krahas ndikimit të ashpër të njëjtë të nacionalizimit ndaj kroatëve, dhe këtë sidomos intensiv në vitet e 80 të shekullit XX, në kuadër të përgatitjeve për krijimin e Serbisë së Madhe në procesin e shpartallimit të RSF të Jugosllavisë, duke ndjekur pikë për pikë programin e Naçertanijes së Ilija Garashaninit dhe adaptimin e tij të modernizuar të formuluar nga Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve (SANU- përkthyesi). Maqedonët aty janë trajtuar si “serbët e jugut”, të cilët nën ndikimin e propagandës bullgare egzarkiste kanë harruar apo kanë shpërfillur *prejardhjen e vet serbe*. Përqindja e lartë e popullsisë islame në Maqedoni, gjithashtu është komentuar si *dëshmi* se aty më herët kanë jetuar “serbët e islamizuar”. Përkatesia e veçantë etnike (nacionale) e *torbeshëve* është refuzuar drejtpërdrejt, ndërsa prania e tyre është shpjeguar me hipotezën skandaloze se këta janë *pasardhës të shqiptarëve të cilët janë martuar me serbe të islamizuara, në kuadër të programit të shqiptarëve që t’i përvetësojnë vendet e lashta serbe në Maqedoni* (??). Në bazë të fantazmagorive të këtilla të privuara nga çdo bazë dhe kuptohet, pa kurrfarë dëshmish të ofruara, janë “të shpjeguara” edhe migrimet e *shqiptarëve të islamizuar* gjatë shekullit XVII në Kosovë, në ç’gjë sidomos ka paraprirë historiani Miodrag Petroviqi. Faktin se nuk ekziston as një e vetmja dëshmi e vlefshme për njëfarë *islamizimi të detyrueshëm*, tërësisht e ka injoruar edhe historiani Batakoviq, sikurse edhe Radovan Samarxhiqi, edhe pse ata tentuan që procesin e *isla-*

mizimit ta reduktonin vetëm në renegatë feshkelës, duke e përjashtuar në mënyrë eksplicite mundësinë se cilido serb vullnetarisht është përcaktuar për Islamin gjatë tërë periudhës së ekzistimit të shtetit osman.¹⁵⁴ Njëkohësisht, në monografitë e tyre nuk ka asnjë fjalë për masakrat mbi myslimanët, të cilat janë kryer në mënyrë sistematike në çdo rast të përshtatshëm. Kështu, asnjëherë nuk është përmendur masakra e madhe dhe kryqëzimi i dhunshëm i disa mijë muslimanëve në Beograd në vitin 1807, për çka ka raportuar edhe vetë Leopold Ranke, duke e alarmuar opinionin europian me qëllim që të ndërmerreshin masa dhe të pengohej një dhunë e tillë në të ardhmen, sikurse janë heshtur edhe masakra në Sjenicë në vitin 1809, në Shahoviçi më 1924, dhe kryqëzimi masiv i dhunshëm i muslimanëve në Mal të Zi nga viti 1825-1857.¹⁵⁵

Me falsifikimin e qëllimshëm, më mirë të themi të keq-qëllimshëm të karakterit të procesit të pranimit të lirë të Islamit në Ballkan dhe konstituimit të popullit musliman, si identitete të reja në periudhën e ekzistimit të shtetit osman në këto procese, historianët serbë janë shembull paradigmatic i keqpërdorimit të shkencës në interes të krijimit të mitit nacional. Ky proces stërtheqsohet me përmbajtje dhe nënçmohet me vëllim, me synimin e qartë që në mënyrë të rreptë të vihet kufi ndërmjet “serbëve konsekuentë në aspektin moral dhe fetar, të cilët, përkundër të gjitha presioneve, mbeten besnikë ndaj qenies së tyre nacionale dhe fetare” nga një anë, dhe “tradhtarëve dredhacakë dhe renegatëve serbë, të cilët e tradhtuan edhe kombin e vet edhe fenë serbe”, krahas përfundimit se këta të fundit së këndejmi

¹⁵⁴ Radovan Samardžić, ed., *Istorija srpskog naroda, II* Beograd: Srpska književna zadruga, 1982, f. 14

¹⁵⁵ Analiza të hollësishme të këtyre ngjarjeve, krahas lëndës së pasur dokumentare arkivore, jep monografia e shkëlqyer: Šerbo Rastoder, *Bošnjaci/Muslimani Crne Gore između prošlosti i sadašnjosti*, Alamanah, Podgorica, 2010.

nuk meritojnë as të konsiderohen serbë, dhe si të tillë, nuk meritojnë as të jetojnë!? Shqiptarët gjithashtu duhen dëbuar nga territoret e tyre të tanishme, sepse “i fituan si shpërblim për pranimin e Islamit”. Së këndejmi, kështu e paskan humbur të drejtën të jetojnë në ato territore, se *burimisht edhe ata kanë qenë serbë*, pa marrë parasysh se a janë *turqizuar, katolicizuar apo bullgarizuar!*?

Përfundim

Miti për *islamizimin (turqizimin) e dhunshëm*, paraqet projektin nationalist të krijuar me qëllim të argumentimit të pretendimeve të paarsyeshme territoriale, të bazuar në programin e fshirjes nga vetëdija historike e tërë popujve, identitetit të tyre, historisë së tyre dhe të kulturave të tyre! Si i tillë, ky mit hesht dhe fsheh kontributin vendimtar të Islamit në Europë dhe botë, të realizuar nëpërmjet praktikës shumë të lartë tolerante të Perandorisë Osmane si shtet autentik evropian! Pikërisht *Osmanlı Devleti* i përket nderi i merituar se është shteti i parë evropian, i cili me aktet e tij më të larta juridike, ka abroguar vlefshmërinë e formulës deri atëherë të pacenueshme *cuius regio, eius religio!* (I kujt është shteti e tij është edhe feja!) si fakt historik i padiskutueshëm! Pikërisht kjo tolerancë kulturore, etnike dhe religjioze e lartë dhe deri atëherë me vëllim të tillë të panjohur në histori ka rezultuar gjithashtu në një fenomen unikal! Pas largimit përfundimtar nga skena historike, shteti osman është i vetmi shtet jo vetëm evropian por edhe botëror, në të cilin të gjithë, e edhe popujt më të vegjël, e kanë ruajtur identitetin nacional dhe kulturor, gjuhën e vet, zakonet e veta, fenë e vet dhe tempujt fetarë!! Mbi parimet e përcaktimit plotësisht të lirë fetar, të bazuar në parimet burimore të Islamit, të formuluara në *Kushtetutën e Medinës* nga viti 622,

shteti osman është shteti i parë evropian, i cili të gjithë popujve nën juridiksionin e tij (njëjtë islam dhe joislam), u ka mundësuar që legalisht të ruajnë identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, dhe këtë në bazë të vetëpërcaktimit të lirë e zgjedhjes personale. Kjo do të thotë se muslimanët evropianë jo vetëm që nuk janë “*pasardhës kulturorë dhe qytetërimorë të stërgjyshërve dhunshëm të islamizuar*”, por janë pasardhës të qytetarëve të parë, të cilët e shfrytëzuan privilegjin e zgjedhjes së lirë të identitetit vetjak shpirtëror në historinë e shteteve evropiane! Përkundër shembullit të këtij inovacioni liberal qytetëruës, të cilin e futi Perandoria Osmane si shtet i fuqishëm islam evropian, shtetet e tjera evropiane në të njëjtën periudhë, pra sidomos ndërmjet 1492-1609, e kanë filluar dhe përmbaruar përndjekjen më masive të banorëve të vet, bazuar në mostolerancën e plotë fetare, kulturore, etnike dhe gjuhësore! Për fat të keq, duhet shikuar në sy e vërteta, se kjo armiqësi irracionale ndaj Islamit dhe ekskluzivizmi i ngurtë monokulturor, nuk kanë pushuar deri sot ta trondisin këtë dhe Europën e këtillë, të kthyer kundër vetes së vet. Kjo është një arsye më tepër që gjithnjë rishtazi të kujtojmë edhe në atë anën më të ndritshme të traditës evropiane të tolerancës kulturore me shekuj të gjatë dhe të pasur me rezultate, me shtetin osman si shembull multi-kulturor, multi-fetar dhe multi-gjuhësor të bashkësisë së popujve! Njëkohësisht, ky edhe është shkakun që t’i kushtohemi përmirësimit të padrejtësisë së madhe historike për “*islamizimin e dhunshëm*”. Fshirja e këtij miti të bazuar në falsifikimin e dimensioneve epike nga vetëdija e brezave të ardhshëm të qytetarëve evropianë, paraqet kushtin *sina qua non* për respektin reciprok, tolerancën, bashkëpunimin dhe barazi të mirëfilltë të të gjitha bashkësive në kontekstin multi-etnik dhe multi-konfesional të Ballkanit dhe të tërë Europës.

VII. TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE OSMANE SI BAZË E PËRBASHKËT E IDENTITETEVE MUSLIMANE NË BALLKAN

Në dekadën e fundit të mijëvjeçarit të kaluar, para jo plot 14 viteve, Turqia ka kremtuar 700 vjetorin e themelimit të shtetit osman (*Osmanlı Devleti*), dhe nga atëherë deri sot nuk janë ndalur diskutimet e ashpra, as kanë heshtur interpretimet e kundërshtuara të efekteve, ndikimeve dhe rëndësisë së përgjithshme historike të ekzistimit dhe veprimit të tij të gjatë. Kundërshtitë për karakterin objektiv të trashëgimisë demografike, kulturore dhe shpirtërore të kësaj krijese të madhe ushtarake, politike, ekonomike, kulturore dhe shpirtërore, e cila në skenën historike ka mbijetuar më shumë se gjashtë shekuj, shpesh duke luajtur rolin kryesor në dramën e historisë europiane, nuk pushojnë as sot, kurse vlerësimet e çdo sekuence individuale të rëndësisë së tij, më së shpeshti janë diametralisht të kundërshtuara.

Megjithatë, do të ishte e gabueshme të përfundohej se këtu është fjala për konfliktin e intelektualëve turq dhe opinionit publik turk, nga njëra anë, dhe interpretimeve perëndimore-europiane, në rastin më të mirë, apo për tregimin e vjetër për luftën e amshueshme të *Orientit dhe Oksidentit*, nëse jo madje edhe konfliktin në vijën e perspektivës islame dhe kristiane, në kuadër të pallavrës ideologjikisht të prodhuar e paraqitur në mënyrën më të përciptë në pamfletin e njohur të Samuel Huntingtonit! Sado që kjo mund të duket e çuditshme, në çështjen e receptimit të përgjithshëm të domethënies dhe trashëgimisë historike të Perandorisë Osmane, pozicionet janë të konfrontuara ashpër madje edhe në vetë Turqinë, përkatësisht, ndër vetë europianët muslimanë. Një numër i intelektualëve turq me

influcencë kanë marrë qëndrim radikal, duke pohuar se edhe vetë akti i *kremtimit* të themelimit të Osmanlı Devletit (në vend të *shënimit* të kësaj date dhe këtë rigorozisht me qëndrim negativ), në kundërshtim të drejtpërdrejtë dhe të ashpër me arritjet e Revolucionit Turk dhe përcaktimet e tij themelore, duke pohuar se Republika e re Turke është mohim total i shtetit osman në të gjitha aspektet e tij. Ky grup ka shkuar aq larg në radikalizmin e tij, sa i ka dërguar letër Kryetarit të atëherëshëm të Republikës së Turqisë, duke protestuar kundër festimit dhe duke kërkuar që kremtimi të anulohet në çastin e fundit.

Përkundër kësaj, është e qartë se logjika e përgjithshme e ndodhisë historike, sikurse edhe argumentet e evidencës empirike, përkatësisht të analizës teorike, nuk i përkrahin vlerësimet e këtilla ekstremisht negative, as e arsyetojnë polarizimin lidhur me këtë çështje. Me të drejtë mund të pohohet se argumentimi objektiv, i bazuar në fakte, shumë më tepër shkon në favor të përfundimit, i cili e afirmon tezën për vazhdimësinë e pandërprerë historike, e jo për shkëputjen në historinë e Turqisë, dhe si në tërësinë specifike kulturore e nacionale, edhe si shtet. Kjo vazhdimësi vërtetohet në shumë veçanti shpirtërore, filozofike, demografike, si edhe në një varg cilësish konkrete administrative dhe organizative, të cilat e lidhin në tërësi unike kohezive jo vetëm historinë turke dhe popullin turk, por edhe theksojnë faktin e unitetit kulturor, i cili deri sot është ruajtur thuasje në tërë territorin e saj të madh të dikurshëm. Gjithashu duhet pasur parasysh edhe fakti i një vargu rezultatesh thelbësisht të rëndësishme pozitive, të cilat përbënin elementet kyçe të praktikës shoqërore të Perandorisë Osmane, kurse kanë mbetur të gërshetuara në arritjet përparimtare të shoqërisë bashkëkohore europiane, edhe pse prejardhja e tyre osmane është perceptuar pamjaftueshëm dhe edhe më pak e pranuar.

Pa dyshim, ligjëratën ideologjike kështu të theksuar, e krahas kësaj edhe me distancën e mbingopur ndaj çdo gjëje që bart parashenjën e islames, shpesh dhe haptazi të intonuar anti-islame, e trimëron mjaft edhe fakti se autoritetet më të larta shtetërore të Turqisë, veçanërisht duhet theksuar edhe vetë kryetari i atëhershëm turk, Sulejman Demireli, pa hezitim e ka përkrahur këtë solemnitet dhe ka afirmuar qëndrimin se vlerat themelore të Perandorisë Osmane dhe Republikës së Turqisë, nuk qëndrojnë në kurrfarë kundërshtie të domosdoshme. Veçanërisht trimëruese vepron e dhëna, se edhe armata turke, e cila nuk ka marrë pjesë në debatin publik, ka qenë në vetë ceremoninë, që ka ndikuar pozitivisht në qëndrimin e përgjithshëm dhe ka pasur efekt të favorshëm në opinionin publik. Përndryshe praktika deri atëherë e përhapur e distancimit sistematik dhe madje demonizimit të së kaluarës vetjake osmane, e përcjellë me konfrontimin e pabazuar me të gjitha elementet e realitetit të tanishëm, këtë herë jo vetëm që nuk ka dominuar, por është zbrapsur dhe ka heshtur. Me këtë qasja objektive, e bazuar në argumentimin shkencor ka marrë një nxitje të re, ndërsa parimi i tolerancës ka hapur rrugën e vetëperceptimit më real të Turqisë moderne në raport me kohën kur përbënte forcën e rendit të parë planetar, sikurse edhe të vlerësimit më real të trashëgimisë, të cilën shteti osman i ka lënë në Ballkan dhe *në tërë Europën e mbetur*.

Ta nënvizojmë pjesën përfundimtare të fjalisë paraprake, që edhe një herë të kujtojmë në stereotipin e përhapur për Ballkanin si për rajonin i cili nuk i përket Europës. Arsyeja kryesore për një kotësi të këtillë, është pikërisht fakti se pjesa europiane e shtetit osman me shekuj ka përfshirë praktikisht tërë Gadishullin Ballkanik, në të cilin Republika e Turqisë, përndryshe, në një pjesë gjendet edhe sot. I ndotur me konstruktin ideo-

logjik të konfrontimit polar *Lindje-Perëndim*, i cili për fat të keq është ruajtur deri sot, ky stereotip e ka ngushtuar gjeografikisht kontinentin e Europës, ashtu që prej tij ka shkëputur tërë Gadishullin Ballkanik, me arsyetimin se ky territor është infektuar me orientalizëm, është rrethuar me Islam dhe se nuk i përket Europës. Është propozuar, pa kurrfarë dyshimi dhe është futur pa hezitim, krejt hapur, edhe *kordoni sanitar* special politik dhe ekonomik, një lloj karantine për Ballkanin, e cila ende është në fuqi në pjesën më të madhe të tij dhe që ka të bëjë madje me gjashtë shtete evropiane, të cilët gjenden në këtë pjesë të Europës. Ky tregim bajat për *Perëndimin e përparuar* dhe *Orientin e prapambetur*, i cili për bazë ka mitin për *Europën kristiane*, krejtësisht në mënyrë konsekuente, (pra në pajtim me trillimin apo lajthitjen, mbi të cilën e ndërton tregimin e vet skizoid) teshun e padurimit të vet e drejton parimisht në drejtim të Islamit, si *fe jo-evropiane*. Nuk është as problemi kryesor, as më i rëndësishëm i ideologjizimit të këtyre fakti që pa kurrfarë baze të arsyeshme merret një pjesë e saj, pra Ballkani. Problem shumë më i rëndësishëm dhe shumë më i madh për-bën fakti që me këtë, qoftë simbolikisht dhe politikisht, por gjithsesi edhe në vetëdijen e miliona qytetarëve të vet, Europa nga vetja cungon *burimin e vet më të rëndësishëm shpirtëror dhe pjesën më krijuese të kulturës vetjake kulturore, politike, filozofike dhe çdo historie tjetër*.

Mbajtja dhe madje fuqizimi i këtyre konotacioneve negative të theksuara fuqishëm, krahas toponimit “Ballkan”, sado të jetë absurde e pabanueshme, dhe sado të qëndronte diametralisht në kundërshtim me evidencën dhe faktet historike, pa dyshim është fuqizuar nga ato qarqe me ndikim të Europës, të cilat edhe më tej u kundërvihen të gjitha fakteve, dhe e kanë problem psikologjik ta pranojnë të vërtetën e sigurtë për iden-

titetin e Europës, si dhe për unitetin kulturor dhe shpirtëror të faktorëve dhe ndikimeve qytetëruese judeo-kristiano-islame. Përveçse praktikisht tërë energjia shpirtërore, shkencore, filozofike, politike, artistike e Europës ka zënë fill, ka lindur dhe është zhvilluar së pari dhe pikërisht në Ballkan, Ballkani mbi 200 vjet në vazhdimësi përbënte tërësi unike, në të cilën janë formuar elementet ilire-thrake-kelte-gote-helene-romake, sllave, krahas thuajse shtatëqind vjet shtesë të pranisë së vazhdueshme të shtetit osmano-turk i cili vijon deri sot. Orvatjet që toponimi i lashtë “Ballkani”, të zëvendësohet me pallavrën përshkruese “Europa jug-lindore” janë të pabaza dhe aq më tepër të paarsyeshme, sepse jo vetëm që e shformësojnë Ballkanin dhe e privojnë nga historia e veçanësia kulturore e tij, por në fakt përbëjnë ofendim të drejtpërdrejtë kulturor.¹⁵⁶

Një pjesë e ndjeshme e argumenteve substanciale kundër receptimit negativ të trashëgimisë historike dhe kulturore të shtetit osman dhe përdorimit të përhapur të retorikës keqësuese në adresë të Ballkanit, është përfshirë në fjalimin të cilin kryetari Sulejman Demirel e ka mbajtur në Kuvendin e Madh Popullor të Turqisë më një tetor 1999, kur, ndër të tjera, ka theksuar:

“Perandoria Osmane, themelues dhe trashëgimtarë të së cilës jemi ne, dhe shtatëqind vjet të së cilës i festojmë këtë vit,

¹⁵⁶ Për nevojën që të riafirmohet e vërteta për Ballkanin si për burimin e mirëfilltë të kulturës evropiane e cila drejtpërdrejt historikisht në mënyrë të falsifikuar paraqitet si prodhim i Evropës Perëndimore, nëpërmjet sintagmave në mënyrë të vetëdijshme sistematikisht të theksuara të tipit të Filozofisë perëndimore-evropiane; Kultura perëndimore-evropiane; Arti perëndimor-evropian në të gjitha rastet në të cilat fjala është pikërisht për frytet, të cilat kanë mbirë në Ballkan, sikurse edhe për imperativin që të ndërkrehet përdorimi i tij negativisht i konotuar, autori (F. M.) ka publikuar dhjetëra punime gjatë 25 viteve të kaluara. Një pjesë e atij regjistri mund të shihet në internet. Lidhur me analizën në mënyrë kritike të intonuar dhe në mënyrë bindëse të argumentuar të keqpërdorimit të toponimit “Ballkan”, gjithashtu shih në kontributin Prof. Dr. Ilber Ortaylı: “The Balkans and the Ottoman Inheritance”, in *The Great ottoman-Turkish Civilization*, Ankara 2000, Vol. III, pf. 241-245.

ka pasur rolin vendimtar në formimin e mjedisit kulturor mesdhetar dhe europian të tërë 624 viteve. Fakti që ne jemi trashëgimtarë të perandorisë botërore, e cila ka sunduar në hapësirat e tre deteve, në tri kontinente dhe ka përfshirë traditat më të llojllojshme kulturore, ka efekt të drejtpërdrejtë si në të kaluarën, ashtu edhe për të ardhmen tonë. Për këtë arsye është detyrë jona ta kuptojmë historinë tonë vetjake dhe të zëmë në historinë botërore vendin i cili na përket.¹⁵⁷

Me këto karakteristika hyrëse, por të domosdoshme, tema jonë themelore fiton në qartësi dhe arsyeshmëri. Vetë titulli pa dyshim e përkufizon temën, nëse jo edhe tezën qendrore, dhe këtë nëpërmjet dy pikave:

1. *Identiteti ballkanik musliman* është i përbërë prej shumë identitetesh, të cilat kanë një apo më shumë veçori të përbashkëta thelbësore, që shpien në përfundimin e pranueshëm që kjo/këto veçori të shfaqen si faktori, nëpërmjet të cilit këto identitete integrohen në një lloj të identitetit shoqëror dhe/apo kulturor;

2. Që, me mënyrën e organizimit të saj, strukturën shoqërore dhe praktikën e drejtpërdrejtë historike, trashëgimia osmane ka qenë pikërisht ai faktor, i cili e ka frymëzuar dhe përfunduar këtë integrim në një identitet të ri.¹⁵⁸

¹⁵⁷ Website of the presidency: www.tccb.gov.tr

¹⁵⁸ Në kundërshtim me stereotipin e përhapur për rezistimin kundrejt çfarëdo ndryshimesh shoqërore, shteti osman gjatë tërë historisë së tij ka kaluar nëpër proceset e reformave intensive politike, ekonomike dhe strukturale, sidomos gjatë 120 viteve të fundit. Reformat e shpejta dhe radikale i ka filluar sulltan Mahmudi II (1808-1839). Tërë projekti ka përfshirë reformat e ushtrisë, marinës, arsimit, futjes së shtypit, operës, promovimit të gjuhës frenge në gjuhën e komunikimit të shtresave të arsimuara dhe të larta, reformën administrative, regjistrimin e popullsisë, dhënien e pasaportës së Osmanlı Devletit, reformën e madhe shoqërore dhe ekonomike. Gjithashtu edhe *Tanzimati* përbënte reformën e madhe të shtetit dhe shoqërisë osmane, në të gjitha aspektet e jetës, sikurse edhe reforma tokësore nga viti 1858. Gjatë kohës së sundimit Abdulhamidit (1876-1909), më 23 dhjetor 1876, është themeluar parlamenti i parë, i cili ka garantuar

Lidhur me pikën e parë, ka nevojë të vihen në dukje shkaqet prej të cilave përbërja multi-kulturore, multi-etnike, multi-fetare e popullsisë në tërë territorin të Perandorisë Osmane, të paktën, në hapësirat e Ballkanit, nuk e ka penguar formimin e kohezionit të ri shoqëror dhe kulturor, ndërmjet një numri të caktuar të bashkësive të ndryshme, të cilat kanë ndarë bazamentin e përbashkët shoqëror dhe kulturor, mbi të cilin shkallë-shkallë është krijuar bashkësia *e identiteteve të reja të muslimanëve ballkanikë*. Kur është fjala për pikën e dytë, është e domosdoshme të lidhet krijimi i identiteteve ballkanike muslimane, me praktikën konkrete shoqërore, politike dhe kulturore të shtetit osman.¹⁵⁹ Gjatë kësaj është detyrë kyçe verifikimi i pohimit se shteti osman, si shtet european islam, vërtet zotëronte instrumente të mjaftueshme (administrative dhe legislative), por nuk i dekurajonte, as i pengonte proceset e një integrimi të këtillë joformal të bashkësive të ndryshme në një identitet të ri, por edhe i nxiste proceset joformale të integritit shoqëror në nivel më të thellë edhe pse joformal, që ka mundur të sjellë dhe përfundimisht ka sjellë deri te formimi i identiteteve të reja në Ballkan. Fakti që shqiptarët etnikë, boshnjakët, malazeztë, kroatët, romët, serbët, goranët, pomakët, torbeshët, në Ballkan sot jetojnë në një territor të përbashkët, duke u dalluar si formë e identitetit të veçantë, dhe këtë pikërisht nëpërmjet faktit se i lidh Islami si pjesë e trashëgimisë osmane shpirtërore dhe kulturore, në mënyrë evidente e konfirmon tezën e parë *via facti*. Lista komplete e instrumenteve të cilat i kishte në dispozicion shteti osman për zhvillimin e ndjenjës së identitetit të përbash-

të drejtat dhe liritë themelore qytetare, duke përfshirë edhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit, parlamentin dyvëllimësh, kuvendin zgjedhor dhe senatin, anëtarët e të cilit emëroheshin.

¹⁵⁹ Gjerësisht për këtë temë shih: Ferid Muhić, "Roots of Balkan Muslim Identities", *Arches Quarterly*, Spring/Summer 2011, pf. 64-74.

kët, përfshin një numër të madh veprimesh, metodash dhe mjetesh administrative të veçanta, të cilët në parim të gjitha kanë vepruar në fuqizimin e kohezionit të shoqërisë, në relativizimin e izolimit dhe zvogëlimin e distancës shoqërore të kategorive dhe grupeve të ndryshme, sikurse kanë qenë të konceptuara ta intensifikonin ndjenjën e ndonjë lloji të përkatësisë së përbashkët të identitetit, i cili i tejkalon suazat e përkatësisë së drejtpërdrejtë etnike, kulturore dhe gjuhësore. Do t'i klasifikojmë, për arsye të pasqyrës më të mirë dhe ekspozimit më të thjeshtë, në tri grupe kyçe.

Ligjet administrative:

I themeluar mbi parimet e të drejtës islame, bazuar edhe në *Kushtetutën e Medinës* (në vitin 622), shteti osman ka futur në legjislacion dhe praktikën e shteteve europiane pa hezitim një risi kyçe, të panjohur për shoqëritë joislame, konkretisht kristiane. Kjo risi ishte toleranca e plotë racore, etnike, kulturore dhe fetare, si bazë e politikës shtetërore në raport me të gjitha bashkësitë etnike dhe pjesëtarët e të tria feve monoteiste: hebraizmit, kristianizmit dhe Islamit. Sipas strukturës demografike, shteti osman me ardhjen në Ballkan ka gjetur një përqindje shumë të lartë të popullsisë jo-muslimane, konkretisht ortodokse dhe katolike. Përqindja e hebrenjve është rritur me shpejtësi nga viti 1492 e tutje, shteti osman atyre ua ka hapur dyert e veta për së gjeri, pas përndjekjeve të mëdha të hebrenjve nga vendet katolike, para së gjithash nga Spanja dhe Portugalia, e më vonë edhe nga Anglia dhe pjesët e tjera të Europës kristiane. Në këtë strukturë të këtitillë të diversifikuar, procesi i integritimit social, përndryshe imperativ i çdo shteti, është tre-guar mjaft i ndërlikuar dhe pretendues. Gjatë kohës është tre-

guar se praktika e lartë tolerante kulturore dhe gjuhësore nuk i shkon në favor integritit, por më tepër e ruan veçanësinë e bashkësive etnike dhe gjuhësore, edhe pse nuk e pengon domosdoshmërisht komunikimin e tyre. Sikurse është e njohur, kane lin kryesor të integritit shoqëror të popullsisë së këtillë të llojllojshme në kuadër të shtetit të përbashkët e përfaqësonte Islami. Mirëpo, meqë nuk ka pasur kurrfarë presionesh nga ana e shtetit në raport me identitetin etnik dhe kulturor, që gjithashu ka qenë precedent në praktikën e shteteve europiane, të cilat radhazi me të gjitha forcat kanë punuar në konstituimin e modelit monokulturor të shtetit sipas parimit: *Një popull, një shtet, një fe!*, të cilin shteti osman, për shkak të karakterit të tij islam, nuk ka mundur vetes t'ia lejonte, madje as konversion të planifikuar dhe sistematik, sepse me Kur'anin, si aktin më të lartë ligjor dhe autoritetin suprem shpirtëror, shprehimisht është i ndaluar konvertimi i dhunshëm. Si shteti lider islam botëror, territori i të cilit shtrihej në tri kontinente, Perandoria Osmane në pjesën e saj europiane, pra si shtet europian, ka lënë lirinë e plotë të zgjedhjes, si në aspekt të identitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor, ashtu edhe në raport me përkatësinë fetare. Modeli themelor, kriteri sipas të cilit të gjithë banorët i përkisnin thelbësisht së njëjtës kategori, ka qenë kategoria e *mil-letit*. Në Anadoll Islami është përhapur nga fundi i shekullit të dhjetë dhe në fillim të shekullit të njëmbëdhjetë, edhe drejtpërdrejt, nëpërmjet turqizimit spontan, ka mundur integritin e shpejtuar kulturor të bashkësive të ndryshme fisnore, duke sjellë deri te homogjenizimi i tyre dhe krijimi i identitetit të ri. Mirëpo, kjo ka qenë e mundur jo vetëm për shkak të afërsisë së fiseve të cilat e ndanin të njëjtin territor, por edhe për shkak që ende nuk ka qenë e formuar superstruktura mbresëlënëse politike, legislative dhe administrative e shtetit të ardhshëm osman.

Kur ky pushtet është vendosur në Ballkan, Islami tashmë ishte i njohur, e pjesërisht edhe ishte shtrirë në disa pjesë, sidomos në bregdetin e Shqipërisë, Dalmacisë dhe në brendi të Bosnjës, por nuk mund as të flitej për aksion të planifikuar të shtetit që popullsia lokale të kalonte në Islam, nga shkak i sipërtheksuar i ndalimit rigoroz të dhunës në fe, aq më pak për ndonjëfarë fushate të dhunshme. Kalimi në Islam, në të gjitha rastet autentike të dokumentuara, ka qenë përjashtimisht çështje e zgjedhjes, akt vullnetar individual dhe familjar, herë-herë edhe i përbashkët i grupeve më të mëdha të të afërmeve apo i popullsisë demografikisht dhe kulturalisht kompakte, por kurrë nuk ka përfshirë edhe *turqizimin*, kurse rastet e tilla, sërish plotësisht vullnetare, kanë qenë skajshmërisht të rralla. Shqiptarët, boshnjakët, torbeshët, goranët, pomakët, romët, paraqesin shembuj, të cilët vërtetojnë qartë faktin për mënyrën e zakonshme të pranimit vullnetar të Islamit, pa *turqizim*, pra pa ndërrimin klisheve kulturorë të jetës, përbri ruajtjes së gjuhës, traditës dhe zakoneve vetjake.

Në epokën e fuqisë më të madhe Perandoria Osmane ka qenë njëra nga shoqëritë më stabël të kohës së vet. Kjo sidomos që e theksuar në kufijtë e saj europianë, pra pikërisht në Ballkan, sikurse edhe në hapësirat e Hungarisë, Rumanisë së sotme, dhe në pjesët e Sllovakisë, Polonisë, Bjellorusisë dhe Ukrainës, ku historianët kanë vërtetuar se pati një paqe stabël në një periudhë më të gjatë se një shekull, saqë e kanë quajtur “Pax Ottomanica”, që në këtë mënyrë më së miri të përshkruhet jeta shoqërore e qetë dhe e rregulluar e *miletit* osman, në të cilën bashkërisht kanë jetuar muslimanët dhe jo-muslimanët, kristianët romako-katolikë dhe kristianët ortodoksë, e po ashtu edhe hebrenjtë, sikurse edhe dhjetëra popuj të tjerë të ndryshëm, të cilët të gjithë kanë ruajtur gjuhën, kulturën dhe zakonet e tyre,

kurse shumica e tyre edhe fenë. Për tolerancën e lartë flet bindshëm e dhëna, se qendra shpirtërore gjatë tërë kohës së ekzistimit të Perandorisë Osmane, me prijësin suprem të botës ortodokse në krye, ka mbetur në Stamboll, ku gjendej edhe në vitin 1453, kur qyteti, i cili atëherë quhej Konstantinopolis, kaloi në duar të muslimanëve, pa pengesë, duke kryer të gjitha funksionet e tij! E transformuar në *fetvanë* (dekretin) e njohur të Mehmetit II – Çliruesit, në të cilën, ndër të tjera, transmetohet edhe qëndrimi i tij i qartë i barazisë së të drejtave të tri feve monoteiste “*Dëshiroj që në tërë mbretërinë time, t’i shoh muslimanët në xhami, kristianët në kisha dhe katedrale, hebrenjtë në sinagoga. Për mua ndër ta nuk ka dallim. Unë të gjithë i dua njëllor dhe drejtësia ime është e barabartë për të gjithë ata. Të gjithë ata për mua janë sikurse edhe fëmijët e mi*”, - një tolerancë e këtillë në shtetin europian islam, në mënyrë dramatike dallohej nga shtetet europiane kristiane, në të cilat pikërisht në atë kohë ka shpërthyer një varg luftërash fetare, kryengritjesh fshatare dhe ekspeditash pushtuese. Numri i përgjithshëm i viktimave të konflikteve brenda-kristiane në Europën e atëhershme, e ka tejkaluar shumëfish numrin e viktimave të konfrontimit ndër-fetar ushtarak të këtij vendi islam europian dhe shteteve të tjera europiane kristiane!!

Kuptohet se, përkundër këtyre, kanë mbetur shumë dallime të konstatuara edhe në legjisllacionin e këtij shteti europian islam. Legjisllacioni osman ka dalluar tri kategori të qytetarëve të tij, në pajtim me përkatësinë e tyre fetare. Dallimi themelor i ka ndarë muslimanët nga jo-muslimanët, edhe pse i ka trajtuar brenda të njëjtës kategori, si *Popuj të Librit*, sadoqoftë të ishin në aspektin racor, etnik dhe kulturor. E drejta islame të gjithë muslimanët i ka trajtuar si entitet unik; jo-muslimanët (hebrenjtë, kristianët, zoroastrianët) përbënin nën-kategorinë e të

mbrojturve (klientëve) të përkufizuar si nocion juridik *ehlu'dh-dhimme*, nga ka rrjedhur termi dhimmitë, temë për të cilën është diskutuar gjerësisht në pjesën paraprake të këtij libri. Kristianët, më tej, qenë kategorizuar në dy grupe të mëdha: katolikë (me pesë nëngrupe) dhe jokatolikë (ortodoksët, gregorianët po ashtu pesë nëngrupe). Paganët, përkatësisht ata të cilët e kanë adhuruar zjarrin, yjet, diellin apo ndonjë parim tjetër kozmik, janë quajtur *sabiinë*. Edhe pse kristianët përfaqësonin një pjesë të madhe (në shumë pjesë edhe pjesën më të madhe) të popullsisë, më aktivët në pikëpamje ekonomike, diplomatike dhe shkencore kanë qenë hebrenjtë. Në truallin e tërë shtetit osman dalloheshin njëzet grupe muslimane. Në Europë, përkatësisht në Ballkan, në kohën të shënuar si “Pax Ottomanica”, grupi më i shumtë etnik i muslimanëve kanë qenë boshnjakët, me rreth 90% muslimanë, pastaj shqiptarët me rreth 80%.¹⁶⁰ Është me rëndësi të kujtohet se në shoqërinë e tillë aq të ndërlikuar multi-etnike, multi-gjuhësore, multi-fetare, e cila ka qenë larg nga monoliteti, komunikimi infrastrukturor, ekonomik dhe kulturor përbënte një imperativ pragmatik. Ky synim është sendërtuar kryesisht nëpërmjet institucioneve, të cilat kulturën dominuese islame e kanë përdorur si armaturë, që e lidhte jetën e shteteve në tërësi unike, duke mos penguar funksionimin e pavarur të disa kulturave, në segmentet në të cilat kjo nuk është kundërshtuar me parimin e tërësisë.

Faktori i ekonomisë: Ndikimi i tatimit të ndryshëm sipas përkatësisë fetare (*haraxh/xhizje*) në parim stërtheqsohet në shumicën e studimeve të funksionimit shoqëror dhe veçanërisht ekonomik të këtij shteti evropian islam. Harrohet se edhe

¹⁶⁰ Për hollësi të shihet studimi instruktiv: Yavuz Ercan: “Non-Muslim communities under the Ottoman Empire (Millet system) in *The Great Ottoman-Turkish Civilization*, II, pf. 381-392.

muslimanët gjithashtu paguanin të njëjtin tatim themelor, kurse ishin të detyruar të paguanin zekatin – tatim fetar vjetor në lartësi prej 2 % mbi tërë kapitalin, i cili nuk ishte drejtpërdrejtë i zënë në prodhim apo tregti (*kapital i vdekur*). Marrë në përgjithësi, tatimet në truallin e Europës, në shtetin osman, si për muslimanët ashtu edhe për jo-muslimanët, kanë qenë shumë më të ulëta sesa ato mesatare, edhe sesa tatimet më të ulëta në shtetet e tjera europiane kristiane të asaj kohe. Shumë historia-në e shohin këtë si shkakun kryesor të përhapjes relativisht të lehtë të Perandorisë Osmane, në çdo rast shumë më tepër sesa nën ndikimin e sulmit të drejtpërdrejtë ushtarak. Popullsia nga zonat ushtarake të shteteve fqinje, e tërhequr prej jetës më të mirë, me më pak anarki dhe arbitraritet të disa feudalëve (të cilat kanë shkaktuar deri te kryengritjet dhe rebelimet e shpeshta të fshatarëve, sikurse në rastin e rebelimit të madh fshatar të Matija Gubecit, në rrethinën e Zagrebit, si edhe nëpër Europë)¹⁶¹ kalonte pa dyshim kufirin apo drejtpërdrejt ia hapte rrugën pushtetit osman, duke e ftuar që t'i shpëtonte nga shkeljet e papërbalueshme prej feudalëve dhe aristokratëve të tyre vetjakë.¹⁶²

Faktori i tretë – Islami

I organizuar rigorozisht dhe plotësisht në pajtim me vlerat kulmore të Islamit, realiteti shoqëror i shoqërisë europiane osmane i bazonte të gjitha premisat e tij më sistemin islam

¹⁶¹ Ndërsa kryengritja e Matija Gubecit përshkrimin e saj realist dhe të dokumentuar letrar e ka gjetur në veprën e autorit kroat August Shenoa-s, *Kryengritja fshatare*, kryengritja e madhe e Gjermanisë qendrore, nga koha e Martin Luterit, është përjetësuar në veprën jashtëzakonisht ndikuese të autorit gjerman Hajnrih fon Klajstit (Heinrich von Kleist) në veprën *Mihael Kolhas*.

¹⁶² Për analizën e saktë të përbërjes demografike, etnike dhe religjioze të banorëve të Perandorisë Osmane, gjatë tërë ekzistencës së saj, shih Yunus Koç: "The Structure of Population of the Ottoman Empire (1300-1900)". Po aty, II, pp-531-549.

shpirtëror dhe juridik, prej filozofik deri te politik, ekonomik dhe administrativ. Mendja e kësaj shoqërie, sikurse edhe trupi i saj, idealet dhe logjika e saj, fryma dhe vullneti i saj, karakteri dhe kujtesa e saj, të tëra këto janë konceptuar, formësuar dhe respektuar me saktësi në kontekstin e postulateve bazë të Islamit. Të kuptuarit e asaj që është e lejuar dhe që është e ndaluar dhe dallimi i tyre; nocionet e krenarisë dhe turpiti; bukurisë dhe të shëmtuarës; kriteret e së vërtetës dhe gënjeshtërisë; synimet fundore të shkencës: shkaqet e arsimimit - shkurtimisht, çdo aspekt i realitetit shoqëror dhe perceptimit subjektiv të botës dhe jetës, të çdo individi dhe shoqërie në tërësi, kanë qenë të përcaktuara me pikëpamjen islame mbi botën. Nëse merret parasysh që gjatë ekzistimit të vet të gjatë, shteti osman më së paku pesëqind vjet ka qenë shteti më i fuqishëm islam në botë dhe krahas kësaj, që gjatë tërë kësaj kohe ka qenë edhe njëri prej shteteve më të fuqishme europiane, do të bëhet e qartë për ç'arsye jo vetëm muslimanët dhe turqit, por edhe të gjithë europianët e kanë për detyrë paraqitjen e mirëfilltë dhe shpjegimin objektiv të efekteve të cilat Islami, nëpërmjet paradigmes së shtetit osman europian, ka pasur në konstituimin e identitetit shpirtëror dhe shoqëror të identitetit bashkëkohor të Europës, sikurse edhe për historinë botërore të epokës moderne.

Të gjykohet realisht gjerësia, llojllojshmëria dhe pasuria e përmbajtjes së trashëgimisë islame në Ballkan, së këndejmi, paraqet vetëm hapin e parë të domosdoshëm, të cilin shkencat shoqërore duhet ta marrim që jo vetëm më saktë ta kuptojnë shtresimin e identitetit shpirtëror të Europës dhe më adekuatësisht ta shpjegojnë tërë ndërlikueshmërinë e raporteve kulturore në të, por edhe më shumë dhe ajo që ka më rëndësi, që përfundimisht Europa të lirohet nga ngushtësia e vet, e rezultuar prej vetëdijes së saj të copëtuar, skizofrenike, të helmuar me

ideologjinë për anën *besimdrejtë dhe besimshtrembët* të irrealitetit të saj. Asgjë që paraqet prodhim historik të realitetit evropian, nuk qenka jo-europiane dhe për këtë nuk bën as të trajtohet si e tillë! Edhe më pak janë të arsyeshme proklamimet e cilësdo nga përmbajtjet e këtilla historikisht të formuara si trup i huaj, si ndërfutje dhe kërkesat për përndjekjen e tyre nga Europa dhe fshirjen nga historia evropiane! Sepse, Europa, jo ndryshe nga asnjë shoqëri dhe asnjë bashkësi njerëzore në botë, nuk është një ide platonike, e cila i paraprin realizimit të vet! Asnjë shtet nuk është koncept i përkryer – *Nocioni dhe Thelbi Ideal* – në të cilin njerëzit përpiqen të derdhen në kallëpet e realitetit, sa më besnike modelit burimor! Europa është proces; Europa është rezultat në krijim të përhershëm; Europa është, sikurse edhe çdo shoqëri tjetër, dhe si jeta e çdo njeriu individual, përmbledhja e asaj që i ka ndodhur dhe që vetvetiu ka bërë nëpërmjet çdo çasti të ekzistencës së tij! Ja, kjo duhet kuptuar! Kjo duhet pasur parasysh që të kuptohet tërë padrejtësia dhe gabueshmëria thelbësore e qasjes, e cila bëhet kur cilado pjesë e identitetit të vet tentohet të refuzohet! Kur dëshirohet të ekskomunikohet, anatemohet, sepse refuzimi nga cilado pjesë e tij apo tërësia e tij, është mohim nga tërë vetja, prej vetes i cili je, ashtu çfarë je! Duke e shpallur Islamin për fe jo-europiane, kurse muslimanët për jo-europianë, do të thotë të gjymtohet një pjesë e madhe e historisë evropiane, të priten gjymtyrë të tëra dhe organe vitale, punë e mirëfilltë kasapi, pas së cilës nga Europa mbetet vetëm një krijesë trishtuese, përbindësh, si e ka krijuar doktor Frankenshtajni në romanin me këtë emër të Meri Shellit!

Revizioni i qëndrimit dominues të pjesës kristiane të Europës ndaj trashëgimisë së saj vetjake islame, si ndaj diçkaje radikalisht ndryshe prej vetes dhe madje, si diç që është e huaj dhe që nuk i përket Europës, është i domosdoshëm si për shkak të

përmirësimit të historisë përgjithësisht të gabueshme, të falsifikuar, siç e diktojnë motivet ideologjike dhe interesat pragmatike, edhe zëvendësimit të saj me qasje objektive shkencore në pajtim me faktet historike, sikurse edhe për shkak të përmirësimit të padrejtësisë me të cilën një pjesë e Europës me shekuj i shkakton padrejtësi integritetit vetjak dhe sidomos, europianëve muslimanë, që gjithnjë rishtazi kthehet në falsifikimin ideologjik për *Islamin jo-europian* dhe *kristianizmin europian*, duke nxjerrë prej tij një përmbajtje për dizinformimin e brezave të rinj nëpërmjet sistemit të arsimit, aq edhe për shkak të nevojës së pajtimit të Europës me vetveten dhe vetëperceptimin e saj. Në gjendjen e tanishme, ky imperativ afatgjatë, në mënyrë vitale i rëndësishëm, më së miri mund të sendërtohet nëpërmjet ndryshimit të raportit ndaj Turqisë. Si shtet europian islam, i cili në pjesën më të madhe të historisë moderne ka luajtur rolin kyç në formësimin e Europës së tanishme, Turqia sot gjithashtu është shtet europian, me përqindjen më të lartë të popullsisë muslimane, e cila e ka vendin e vet në Europë dhe e cila aktivisht merr pjesë në proceset politike, ekonomike dhe kulturore të Europës. Të ndryshohet nga themeli raporti ndaj Islamit, vendit të tij në Europë, sikurse edhe rolit të tij në formimin e historisë europiane dhe identitetit europian, domethënë të zëvendësohet lajthitja me të vërtetën, armiqësia me dashamirësinë, fanatizmi me tolerancën. Sado që kjo të jetë e domosdoshme për vetë Europën, jo më pak e rëndësishme është edhe për Turqinë. Sërish të vendoset respekti i plotë ndaj historisë vetjake islame, për Turqinë bashkëkohore do të thotë sërish të vendoset vetërespekti, të pranohet identiteti i vet i mirëfilltë, të përfundohet individuizimi i ndërprerë social, sërish të vendoset integriteti i vet. Turqia bashkëkohore nuk mund të bëjë asgjë më mirë pos ta riafirmojë të kaluarën e vet vetjake

islame, me çka aspak nuk do ta rrezikojë karakterin shekullar të tanishmërisë së vet, sepse Islami edhe përndryshe nuk qëndron në kolizion me vlerat themelore të shoqërisë bashkëkohore, as i kundërvihet thelbit të idealeve historike të njerëzimit. Me këtë akt Turqia vetëm do t'i rrisë kapacitetet e veta që të përballet me sfidat e botës bashkëkohore, do ta mprehë vetëdijen vetjake, do t'i sigurojë Turqisë moderne vendin të cilin ajo e meriton – do t'ia kthejë shkëlqimin dhe domethënien e forcës autentike kulturore dhe politike me rëndësi globale!

Nga ana tjetër, raporti i vendeve europiane, me popullsinë kryesisht kristiane, ndaj Turqisë, si ndaj vendit autentik europian me popullsinë kryesisht muslimane, dhe raporti i Republikës së Turqisë si shtet shekullar ndaj të kaluarës vetjake si perandori islame Osmanlı Devleti, do të ketë rezultate të mëdha politike, ekonomike, kulturore dhe psikologjike për zhvillimin e raporteve të mëtejme të mirëkuptimit dhe tolerancës në Europë, siç që në të shumtën do të përcaktojë edhe të ardhmen e bashkëpunimit të shteteve ballkanike dhe karakterin e raporteve politike, nacionale dhe fetare në Ballkan. Fakti se shteti islam i Osmanlı Devletit me idealet e veta islame humaniste dhe vlerat etike, deri më sot ka shënuar sistemin shpirtëror dhe aksiologjik të të gjithë muslimanëve në Ballkan, e thekson rëndësinë e këtij fakti në mënyrë plotësuese.

Në kontekst të raporteve të Europës jo-islame ndaj asaj islame, këtu duhet prekur edhe një moment me rëndësi teorike. Me fjalë të tjera, harrohet (qëllimisht apo joqëllimisht), apo shpërfillet, një specificitet i Islamit, përkatësisht dallimi thelbësor ndërmjet Islamit dhe kristianizmit, përkatësisht të të gjitha feve të tjera. Kur thuhet: “*Islami dhe shoqëria*”, kjo assesi nuk është e njëjtë sikur të jetë thënë: “*Feja dhe shoqëria*”. Nocioni “Islami” assesi nuk është sinonim për nocionin “fe”. Thënia

“Feja dhe shoqëria” në parim nënkupton binomin, dysinë, në kohën më të re sipas rregullit shpesh edhe disjunkcionin, raportin e tendosjes ndërmjet dy elementëve të cilët luftojnë për supremaci dhe të cilët qëndrojnë në një lloj të raportit inteherent antagonist. Nga ana tjetër, thënia “Islami dhe shoqëria” thelbësisht nuk nënkupton as relacionin, as binomin, përkatësisht dysinë, sepse këto nocione në traditën e Islamit, pajtohen plotësisht. Raporti ndërmjet tyre nuk është raport i tendosjes por në fakt raport i barabarësisë, përmbushjes së brendshme dhe harmonisë, ndërmjet tyre nuk ka kurrfarë lufte për dominim, edhe më pak antagonizmi inherent. Kjo i ka borxh një vargu hollësish në karakterin themelor të doktrinave teologjike, të cilat, në rastin e Islamit, kryesisht rrëgjohen në të kuptuarit specifik të nocionit kyç të “fesë”, për të cilën, sipas inercionit, përdoret nocioni islam “Din”. “Religjioni” sipas karakterit bisedor, është “feja” (shpjegimi standard udhëzon në rrënjën latine *Religare; lidhja në një*), kurse “Dini është më afër nocionit të *fetarisë* si një lloj i gjendjes specifike dhe universale të shpirtit njerëzor, ndjenjës psikologjike e cila ngrihet në raport metafizik sipas burimit vetjak kozmik. Kësaj gjendjeje mendore në fakt i përgjigjet modeli i brendshëm i organizuar i shoqërisë, të orientuar në koordinim, integrim dhe harmonizim të të gjitha aspekteve të jetës shoqërore në tërësi, me Islamin si paradigmën e tij funksionale dhe alibinë aksiologjike. Me fjalë të tjera, ndërsa nocioni ”Religjioni”, nga rrënja e tij etimologjike na shpie në *mënyrën e lidhjes* së grupit të njerëzve apo tërë popujve dhe njerëzisë, *në po këtë mënyrë*, si të thuash, siç janë të *lidhur me lidhjen e njëjtë*, nocioni “Din” parësisht shënon *përmbajtjen e përjetimit të fetarisë*, e cila sipas përkufizimit është thellësisht personale dhe individual,e por në bazë gjithashtu edhe universale dhe e paçrënjosur si qëndrim metafizik ndaj

botës. Bashkësinë e atyre të cilët i bashkon ky përjetim, prandaj, thelbësisht i përcakton domosdoshmëria dhe universaliteti i tij psikologjik, e cila përbëhet nga orientimi i të gjitha kapaciteteve të veta në adhurimin e asaj që është burim i kësaj ndjenje. Si derivat nga gjuha arabe “Dîn”, ky nocion ka katër konotacione mjaft komplementare, të cilat të gjitha rrëgohen në ndjenjën e borxhit absolut për ekzistim të burimit të të gjithë ekzistueses, *in ultima linea* – Zotit! Këto kuptime janë: 1. Ndjenja e borxhit; 2. Nënshtrimi; 3. Pranimi i të gjitha pasojave të cilat e përkufizojnë raportin e detyrimit të borxhliut ndaj huadhënësit; 4. Animi apo tendenca natyrore që të pyetemi për atë të cilit ia detyrojmë çdo gjë, edhe jetën vetjake.¹⁶³

Ky dallim na bën borxhli në dy momente, të cilat janë detyruese në çdo diskutim kompetent mbi Islamin, qoftë si për fenomenin europian apo jashtë-islam. Këto janë: 1. Që konotacioni i nocioneve “religjioni” dhe “Islami” nuk është identik dhe që së këndejmi raportet, të themi, të fesë, arsimimit dhe shoqërisë në vendet kristiane nuk mund të jenë paradigmatiche si paralele për raportin e Islamit, arsimimit dhe shoqërisë në vendet muslimane; 2. Që ndarja standarde e organizimit shoqëror dhe politik në *teokratike* dhe *shekullare*, si në dy tipa themelore, universalisht të vlefshëm të shoqërive, nuk funksionin kur janë në pyetje shoqëritë të bazuara në vlefshmërinë e Islamit. “Konkretisht, kjo do të thotë se në shoqërinë jo-islame mund të ndahen “feja” dhe “shoqëria”, si dy mënyra të ndryshme të lidhjes institucionale, e krahas kësaj që të ruhet funksionimi i të dy komponentëve, ndërsa ndarja e “fesë” nga “shoqëria” në kontekstin social islam, në fakt do të thotë shfuqizim i autenticitetit dhe identitetit si të

¹⁶³ Për diskutim të hollësishëm, intrinsist filozofik të specifikitetit të Islamit në raport me fetë e tjera monoteiste, e po ashtu edhe të aspekteve të nocionit *Din*, shih: *Din* në: Syed Muhammad Naquib al-Attas: *Prolegomena to the Metaphysics of Islam*, Kuala Lumpur 1995, pf. 41-91.

njërit, ashtu edhe tjetrit komponent, dhe kështu domosdoshmërisht shpie në mohimin e unitetit të tyre burimor organik.

Problemi që të vërehet dhe respektohet ky dallim, i ka shtyrë shumë autorë, përndryshe njohës të mirë shkencave shoqërore, t'i stërtheksojnë dallimet e shtetit “teokratik” dhe “shekullar”, veçanërisht në Islam, duke përfunduar krejtësisht pa arsye, që shoqëria shekullare nënkupton fshirjen e plotë të të gjitha gjurmëve të fesë, sidomos nëse fjala është për Islamin. Meqë kanë harruar faktin se kuptimi burimor i fesë në Islam buron nga nocioni “dîn”, i cili na drejton sa në përjetimin individual, aq edhe universal metafizik të fetarisë, dhe për këtë arsye është jo vetëm më shumë nga mënyra e organizimit shoqëror, por në thelb, është plotësisht i paçrrenjosur, pa marrë parasysh a ekzistojnë apo jo format institucionale për rregullimin e tij shoqëror. Duke mos e vërejtur këtë anë të Islamit, teoricieni bashkëkohor turk Zija Gokalp (Ziya Gökalp) ka përfunduar se në Turqinë bashkëkohore jo vetëm që nocionet “turke” dhe “islame” qëndrojnë në raport antagonist, por që madje edhe nocionet “turke” dhe “osmane” përjashtohen si kundërshti polare, duke theksuar transnegacionet se “... çdo gjë që ka të bëjë me shembullin e Turqisë, është e mirë dhe e bukur, ndërsa çdo gjë që i përket modelit osman, është e keqe dhe e shëmtuar!”¹⁶⁴

Një nga pasojat e qasjeve të këtilla ideologjike të turbulluara dhe shumë të tjerave, të ngjashme me këtë, ka qenë edhe pranimi i pohimit plotësisht të gabueshëm se nocionet “turke” dhe “osmane” sipas konotacionit të tyre me të vërtetë reciprokisht përjashtohen, nga ana e një pjese të konsiderueshme të opinionit në Turqinë bashkëkohore, që ka sjellë edhe te ndarje të caktuara të brendshme, krejt të panevojshme dhe të krijuara vërtet vetëm nga perceptimi jo i plotë dhe njohja e pamjaftu-

¹⁶⁴ Ziya Goekalp: (1923) *The Principles of Turkism*, Istanbul, f. 23.

eshme e kategorive kyçe të këtyre relacioneve. Trashëgimia osmane edhe sot është ruajtur në pjesën më të madhe të Ballkanit, sidomos ndër të gjithë muslimanët e Ballkanit.¹⁶⁵ Fakti që Republika e Turqisë në mënyrë eksplicite e ka pranuar veten si trashëgimtare të asaj trashëgimie të madhe dhe të rëndësishme, për shumë arsye duhet të përshëndetet. Proceset e amalgamimit të gjatë historik të bashkësive të ndryshme etnike dhe kulturore në Ballkan, në një identitet të ri, të lidhur me përkatësinë në Islam, do të thotë se trashëgimia e shtetit osman edhe në këtë kontekst është fakt demografik, i cili e formon atë pjesën islame të identitetit evropian. Kjo sidomos për arsyen që Perandoria Osmane ka prezantuar edhe bashkësinë shpirtërore, pra konkretisht, shtetin islam, i cili, nëpërmjet sistemit të institucioneve shoqërore, ka ushqyer unitetin shpirtëror të njerëzve, të cilët vullnetarisht i kanë pranuar vlerat më të larta të Islamit dhe synimet e tij të fundit. Së këndejmi, është e nevojshme të theksohet rëndësia pozitive e trashëgimisë osmane në Europë, sidomos në Ballkan, që të ulen tensionet politike dhe shoqërore në mënyrë sistematike dhe të përjetësuar nga satanizimi i Islamit dhe periudha e pranisë osmane në Europë, në një periudhë më të gjatë se pesë shekuj. Nëse e respektojmë synimin dhe imperativin shkencor që ta afirmojmë integritetin e vetëdijes objektive historike, si të vërtetë të fakteve, atëherë pa dyshim duhet t'i braktisim aberracionet dhe shtrembërimet e kësaj të vërtete historike, dhe t'i zëvendësojmë me të kuptuar korrekt dhe produktiv të efekteve reale, të cilat prania e shtetit evropian Osmanlı Devletit i ka pasur në këtë periudhë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe influencuese të historisë evropiane, konkretisht, historisë së Ballkanit.

¹⁶⁵ Për strukturën kulturologjike, sociale dhe politike të muslimanëve në Bosnjë dhe Hercegovinë shih: *Encyclopedia of Global Religion*. Volume I. 2011. Jürgensmeyer Mark and Wade Clark Roof (Eds.) Maja Muhić, pf. 153, kurse në Maqedoni, po aty, Maja Muhić, f. 724.

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

Qytetërimet pa konflikte

Për Europën është tejet e vështirë të flitet në mënyrë objektive. Së pari, Europa është i vetmi kontinent, i cili sipas kritereve rigorozë shkencore nuk është kontinent, por në fakt vetëm pjesë (dhe këtë shumëfish më i vogël!) e masës më të madhe kontinentale në planet, të cilën e përbëjnë Azia dhe Europa së bashku. Në këtë kontekst, përkufizimi i Europës nga vetë fillimi është i përshkruar me elementet mitologjike dhe alegorike të tregimit të cilën Europa e rrëfen për veten e vet. Në mënyrë rigorozë, gjatë tërë historisë së vet Europa krijon mitin vetjak për identitetin e vet. Nocioni i Europës në mënyrë parësore është vendosur brenda suazës referente kulturologjike dhe politike, gjatë së cilës momenti më i dukshëm paraqet tentimin e largimit nga identiteti real objektiv. Në po këtë kontekst, Europa përpiqet veten ta paraqesë parësisht si realitet qytetëruar dhe demografik, i cili veten e ka ndërtuar sipas një plani thuajse paraprakisht të përcaktuar. Në kinse të gjitha diskutimet për “identitetin e Europës” dominon teza për njëfarë ideali a prior, të postuluar kulturor dhe demografik, të cilin Europa përpiqet ta ndërtojë dhe realizojë gjatë historisë së vet. Në këtë mënyrë paraqiten tregimet më të ndryshme për Europën e cila ishte “shpikje e Karlit të Madh”, e konceptuar nga fundi i shekullit të tetë dhe fillimi i shekullit të nëntë, gjatë së cilës teza qendrore është se burimi i Europës moderne në fakt është identik me idealet e *kristianizmit europian*. Mirëpo, kjo dhe të gjitha teoritë e ngjashme, plotësisht e shpërfillin apo mohojnë faktin që

kristianizmi nuk është burimisht fe europiane por aziatike, përkatësisht, që procesi i kryqëzimit të Europës është proces i gjatë dhe i paharmonizuar, i cili në shumë pjesë të tij është vonuar edhe për disa shekuj pas përhapjes së Islamit. Për më tepër, si drejtpërdrejt e kundërt me faktet dhe rrjedhat reale historike, absolutisht është e papranueshme tendenca e refuzimit shprehimor që të pranohet karakteri autentik islam i identitetit evropian, sikurse edhe tentimet që Europa të paraqitet si tërësi homogjene politike dhe kulturore.

Përpjekjet që *lindja e Europës moderne* të vendoset në mënyrë kronologjike në kohën e Mesjetës së hershme (pra, që të harmonizohet me rënien e Perandorisë Romake), si "... proces kozmopolit i shkrirjes dhe përzierjes etnike, e cila ka krijuar në mënyrë demografike popullatë europiane relativisht monolite çfarë ajo është sot"¹⁶⁶, janë të privuara nga çdo bazë. Së pari, për arsye që përzierja dhe shkrirja e popullatës europiane ka filluar mijëra vjet më herët, qysh nga neoliti, me migrime të mëdha të cilat kanë krijuar atë që demografia moderne e *korpus indoevropian*, e pastaj edhe për arsye që përzierja intensive etnike e popullsisë europiane nuk ka pushuar pas rënies së Perandorisë Romake, por me intensitet edhe më të madh gjatë tërë historisë ka vazhduar deri sot. Po ashtu, janë të papranueshme edhe këmbënguljet që Europa identitetin e saj e ka kalitur në kohën e zbulimit të Botës së Re, kur: "... e ka krijuar egon e saj të unifikuar të orientuar në hulumtim, pushtim dhe kolonizim të Tjetrit."¹⁶⁷ Sidoqoftë, problemi kryesor i qasjeve të tilla

¹⁶⁶ Shih Davis, Norman, *Europe: A History*, New York, 2007, f. 217.

¹⁶⁷ Dussel Enrique, "Europe, Modernity and Eurocentrism", *Nepantia: Views from South*, 1.3 (2000). Përndryshe këtë përkufizim simbolik dhe strikt teorik (që mos të themi abstrakt) të identitetit evropian, krahas injorimit tipik të fakteve historike, e përfaqësojnë në shumë autorë të *orientimit të ashtuquajtur pastmodernist*. Vetëvetiu kuptohet se qasjet e tilla, sado qoftë që përndryshe kanë qenë

është që Europën e trajtojnë si koncept paraprakisht i dhënë e madje si historikisht i dhënë i cili ndërtohet nëpërmjet opozitës dhe mohimit të ndikimeve të ndryshme dhe të tjera (Azisë, Islamit, Orientit), pra, kjo që Europën si kontinent dhe tërësi të ndërlikuar qytetëruese, e fragmentojnë dhe rrëgjojnë në vetëm një pjesë të saj (Europa Perëndimore) përpiqen ta ndajnë nga ndodhitë objektive historike të cilat, si faktorë të drejtpërdrejtë, direkt kanë krijuar identitetin modern të Europës! Vlera e tyre themelore në parim ndërkaq nuk është e kontestueshme, deri sa të kihet parasysh se fjala është për alegoritë të cilat zbulojnë sendimente të thella të dialogut por edhe mosmarrëveshje të kulturave të lashta, konfrontimin por edhe bashkëpunimin intensiv të traditave shpirtërore. Në këtë kontekst, dhe vetëm në këtë kontekst, Europa mund të kuptohet edhe si ide, edhe si status, edhe si projekt eskatologjik, përkatësisht, si *skicë politiko-kulturore*, një lloj i prodhimit sistematik i modeleve sistematike, i modeleve heterogjene kulturore dhe tradicionale, të cilat shpesh çojnë në transkulturalitet si rezistencë ndaj dominimit të një modeli kulturor.¹⁶⁸

Dhe pikërisht në suaza të kësaj qasjeje *tregimi hyrës për tre vëllezërit*, i frymëzuar me intuitën autentike dhe iluminuese të qartë të lindur në shtresimet e thella të përvojës kolektive njerëzore, në dritën e 14 shekujve të komunikimit turbulent ndër-qytetërues të tri feve të mëdha në truallin e Europës, kontinentit të tyre të përbashkët, ka marrë shkëlqimin e errët të alegorisë së lashtë dhe forcën paralajmëruese të parashikimit të formave arketipe, hulumtimit të të cilave ia ka kushtuar të gjitha

frymëzuese për disa lloje të tjera të analizave, janë krejtësisht të papërdorura në shkencat metodologjikisht ndryshe të konceptuara çfarë janë historia, sociologjia, demografia, kulturologjia dhe politikologjia.

¹⁶⁸ Instanca frymëzuese e qasjes së këtillë është realizuar në veprën: Dainotto, M. Roberto, *Europe (in Theory)*, Durham, 2007.

forcat e veta intelektuale dhe shpirtërore Karl Gustav Jungu. Sado të duken të mjegulluara, as alegoria për *Tre vëllezërit*, as vizionet dhe ëndrrat hermetike dhe shpesh fantazmagorike të Jungut, të transformuara në teorinë për burimin e përbashkët të shpirtit të njerëzisë, për autorin aspak nuk kanë humbur në forcë gjatë hulumtimit dhe shkrimit të këtij libri. Përkundrazi, njëfarë *penumbra* padyshim reale – dritë e shkapërderdhur e megjithatë e shfaqur qartë u paraqit si vërtetim i këtyre shqyrtimeve të përgjithshme sintetike antropologjike dhe pikërisht në to ka dalluar vërtetimin e vet, si vizion të brendshëm, si *shndritje e evidencës* dhe këtë në vetë finalen, kur materiali tashmë i tëri ka qenë para syve, kurse rezultatet janë përmbledhur. Them *pikërisht në to*, që ta nënvizoj faktin se nga pikëpamja e interesave të thata strategjike dhe planeve inteligjente të konkuistadorëve militantë dhe të *real politikës* së udhëhequr përjashtimisht nga motivet fitimprurëse të fuqisë dhe pasurisë kaluese, të privuar nga parimi i moralit dhe humanitetit, atë që dhjetëra milionë të qenieve njerëzore të pajisur me arsye dhe vetëdije për vlerat e amshueshme, i kanë bërë 14 shekuj njëritjetrit pikërisht duke iu drejtuar atyre vlerave të amshueshme shpirtërore - *thjeshtë nuk ka qenë e mundur në mënyrë koherente as të lidhet, edhe aq më pak të perceptohet dhe shpjegohet!*

Jungu e quan si shqyrtimin e vet më të thellë pikërisht njoftimin për karakterin unik të natyrës njerëzore, i cili vërtetohet nëpërmjet luftës së përhershme të 1. *Erosit*; 2. *Synimit drejt fuqisë*, dhe përpjekja që *psikika njerëzore e tronditur prej një përvoje të këtyllë numinoze të konfliktit të brendshëm*, të kthehet në gjendje; 3. *Nirdvandva-s*, lirisë burimore të shpirtit nga kundërshtimi, që *fija për të cilin mbahemi të mos ndërpritet*. Të gjitha këto tri impulset më të fuqishme të Jungut drejtpërdrejt na kujtojnë në *bijtë-renegatë të një babai të njëjtë*. Te Frojdi, te

babai i tij i pafat shpirtëror (ofertën e drejtpërdrejtë të Frojdit të bëhej trashëgimtari i tij shpirtëror Jungu e refuzoi)¹⁶⁹ Jungu ka dalluar pasuesin dogmatik të tezës për *të drejtat ekskluzive vetëm të një djali*, pra për të drejtat në epërsi të vetëm njërës nga nevojat tona bazore, duke i privuar *dy bijtë* e tjerë nga të gjitha të drejtat e tyre dhe gjithëfuqia e *Babait*. Për këtë Jungu jep shpjegime të hollësishme. Shembull tipik është reaksioni i tij ndaj hipotezës së Frojdit, se faraoni Amenofisi IV ka shkatërruar dekoret në monumentet me mbishkrimin e babait të vet dhe se në prapavijë të themelimit të tij të besimit monoteist, në fakt fshihet *kompleksi i babait*. Jungu ishte tmerruar nga ky shpjegim i njëanshëm dhe skajshmërisht i thjeshtëzuar i Frojdit. U orvat të mbronte qëndrimin se Amenofisi ka qenë personalitet krijues dhe thellësisht fetar, *veprimet e të cilit nuk mund të shpjegohen me mosdurimin ndaj babait*. Përkundrazi, ka theksuar Jungu, ky faraon me frikë-respekt është sjellë ndaj babait të vet, kurse zjarri i tij rrënues ka qenë i orientuar kundër atyre monumenteve, të cilat i qenë kushtuar zotit Amon, zotit suprem në kalendarin politeist të egjiptianëve të lashtë.¹⁷⁰ Të shpallët lufta si parim kulmor i jetës, domethënë t'u merret e drejta të drejtave të tjera po aq të rëndësishme të nevojave të jetës, siç janë dashuria dhe kontemplimi, qetësia, baraspesha dhe harmonia. Kjo do të thotë të legjitimohet lufta në të gjitha format, edhe lufta deri në zhdukje, të eliminohet çdo diskutim substancial për të drejtat e njëjta dhe të çlirohet *fituesi* jo vetëm nga çdo përgjegjësi, por edhe nga vetë ideja për fajin e tij të mund-

¹⁶⁹ “Vërtetë është e dukshme se po atë natën e njëjtë kur formalisht Ju kam adoptuar si birin tim më të vjetër, duke ju krezmuar për trashëgimtarin tim dhe princin e fronit - *in partibus infedilium* – se pikërisht atje dhe atëherë më keni privuar nga dinjiteti im prindëror...” Letra e Frojdit për Jungun, 16 prill 1909.

¹⁷⁰ Gjerësisht: Karl Gustav Jung, *Sećanja, snovi, razmišljanja*, Budva, 1989, fq. 156-160.

shëm! Dhe vërtet, kush ka dëgjuar se ndonjë fitues në luftë është shpallur për fajtor!? Pafajësia e Fituesit si prezumim universal është një nga vërtetimet e tmerrshme se historia jonë qysh moti nuk i do që *të tre fëmijët e saj barabarësisht!* Por pikërisht fitorja ishte çdo fitore, kurse fitorja në luftë sidomos, do të duhej t'i nënshtrohej një verifikimi mjaft të hollësishëm! Sepse, a nuk e kemi trilluar për këtë arsye atë frazën e thellë morale se *në luftë çdo gjë është e lejueshme!* Kësaj i kemi shtuar se edhe në *dashuri çdo gjë është e lejueshme*, që vetëm e vësh-tirëson situatën tonë, sepse dukshëm edhe dashurinë e kemi degraduar në nivel të dhunës, e cila është një lloj ekspedite luf-tarake me vetëm një epilog të pranueshëm: me fitoren tonë. Po. Në realitet, dhe *me humbjen e kundërshtarit.*

Gjendja reale dhe aspektet konvulsive të realitetit historik european gjatë pesëmbëdhjetë shekujve të fundit, sidomos në dritën e luftërave rreth *ortodoksisë së fesë vetjake dhe joortodok-sisë së të gjitha feve të tjera*, duhet shpjeguar në një masë të madhe jo vetëm me faktorët ekonomikë dhe politikë, e as rigo-rozisht kulturorë dhe fetarë, por në masë të madhe pikërisht me theksimin e rëndësisë së momenteve psikiatrike dhe soci-ale-psikologjike. Europa është ballafaquar me ndryshimet e vazhdueshme të përjetimit të identitetit vetjak, në konkurren-cën e tre *bijve të refuzuar*, të cilët luftojnë për statusin e trashë-gimtarit të vetëm legjitim, legal, *ortodoks* të Zotit të përbashkët! ... Domosdoshmëria e shpalljes së dy pretendentëve për bij-re-negatë, domosdoshmërisht shpie edhe drejt shpalljes së për-kohshme të dy *vëllezërve* të tjerë për *bete noire*, edhe më shpesh si rrezik për pozicionin e saj të princit trashëgimtar, e së kën-dejmi, njësoj logjikisht, edhe drejt bashkimeve të dy *vëllezërve* kundër të tretit! Epilogu potencialisht i qetë dhe konstituimi i baraspeshës psikologjike të Europës, janë të mundur vetëm

nëpërmjet ndërprerjes së luftës për pushtet absolut të njërit dhe pranimi i legjitimitetit dhe i të drejtave të njëjta të të tre vëllezërve, krejt njësoj në mënyrë alegorike, apo konkretisht, si afirmim i plotë i diversitetit kulturor dhe rajonal – pra, nëpërmjet pajtimit të vetëdijshëm dhe pranimi të barabarësisë së të drejtave të tre *vëllezërve*. E kjo konkretisht dhe drejtpërdrejt do të thotë, nëpërmjet *shmangies së skajshmërive*.

Arsyet për brengë

Nga gënjeshtria mund të jetohet fare mirë, kurse jeta mund të jetohet vetëm – për *të vërtetën*! Është krejt e qartë se saldot me brengat e Europës bashkëkohore janë pakrahasueshëm më të mëdha, sesa monedha e imtë e shpresave optimiste. Dogma e dominimit ekskluziv (të një kulture, një feje, një modeli politik, një politike monetare) nuk është e panjohur për Europën. Për më tepër, Europa është, nëse jo vendi i lindjes, së paku fidanishtja dhe kopshtari, i cili këtë bimë e ka kultivuar më me kujdes dhe më mirë se kushdo tjetër dhe e ka përhapur si lulen e saj të dallueshme nëpër tërë botën!

Të tregohet ky diskriminim i shprehur, kur është në pyetje komponenti fetar në të gjitha rrethanat, e madje edhe kur është fjala për kriminelët e krimeve masive, të flitet për shembujt e okupimit dhe okupatorit, dhe në termat e viktimave dhe kriminelëve, assesi nuk ndodh të hedhësh benzinë në zjarrin e mos-tolerancës fetare. Përkundrazi, heshtja, fshehja, minorizimi i këtyre komponenteve përbën pikërisht të hedhësh benzinë në po atë zjarr! Sepse, vërtet jo vetëm që nuk mund të jetë i rastit, por absolutisht nuk mund të tolerohet fakti se praktikisht në të gjitha mediat europiane pa përjashtim, nga një anë, të gjithë bërësit e krimeve të ngjashme janë *terroristë islamikë*, ndërsa

asnjë i vetmi nuk është *terrorist kristian*!? I tillë nuk është madje as anti-islamisti i konfirmuar dhe vrasësi i njohur i 77 të rinjve paqësorë bashkëqytetarë të vet, Anders Behring Breivik¹⁷¹, nuk qenka as ushtari anonim i cili vrau dhe dogji nëntë fëmijë dhe nënat e tyre vetëm për arsye se ishin muslimanë, nuk janë kështu as ushtarët të cilët e kanë djegur Kur'ani Kerimin, as ata të cilët kanë urinuar mbi muslimanët e vrarë në Afganistan! Ku mund të çojë një diskriminim i këtillë drastik në paraqitjen e identitetit të vepruesit, nuk është vështirë të zbulohet: pikërisht në këtë që ka sjellë! Çon te satanizimi i muslimanëve, përhapja e qëndrimit antiislam, miratimi i paragjykimeve negative për Islamin dhe muslimanët, nga një anë, dhe animi dhe simpatia *a priori* ndaj të gjithë atyre të cilët përndjekin, sulmojnë apo përhapin të pavërteta për Islamin dhe muslimanët. Njoftimi i të dhënave për identitetin fetar të vepruesve dhe theksimi i tyre publik, assesi nuk mund të jetë akt i njëanshëm, por patjetër duhet ose plotësisht të hiqet apo të paraqitet në të gjitha rastet pa përjashtim! Tregimi i qartë në këtë fakt do me thënë paralajmërim i qartë për aksionet e ardhshme ushtarake apo për krimet, që opinioni botëror zëshëm të dëshmojë përkatësinë fetare të pjesëmarrësve, si të vendeve të agresorit, ashtu edhe të

¹⁷¹ Pikërisht ndërsa po e shkruaj këtë shënim sot, 16. IV. 2012, fillon gjykimi në të cilin në fjalën hyrëse është theksuar se ai është *qenie e mashtruar njerëzore e cila pa marrë parasysh meriton të pranohet si qenie njerëzore dhe të trajtohet si qenie njerëzore! Dhe t'i jepet shansi, që i përket çdo qenieje njerëzore, që lirisht t'i shpjegojë motivet dhe t'i arsyetojë qëndrimet e veta!* E lartësuar, e fisnikëruar, në kuptimin më të mirë, edhe humanist, edhe moral edhe religjioz. A kemi dëgjuar diç të ngjashme në gjykimin e muslimanëve, të cilët vetëm e kanë shkrepur në vend publik? A e kemi dëgjuar këtë për nipërit minorë të kryetarit Sadam Husein, apo vajzën e kryetarit Muamer El-Gadafi dhe fëmijët e tij prej 3,5 dhe 7 vjet, të vrarë pa gjykim, dhe me dëshmi triumfaliste të sëmurë sikurse kanë qenë fotografitë, të cilat e vërtetonin identitetin e nipërve minorë të vrarë të kryetarit Sadam Husein? Përfundimisht, a është menduar sadopak *që shansi që i përket çdo qenieje njerëzore, t'i ofrohej edhe Osama bin Ladenit?*

vendeve viktima të agresionit, dhe me më shumë gjasa, që në të ardhmen aksionet e këtilla nuk do t'i komentojë ndryshe pos si dhunë të vetëdijshme, të motivuar me motive fetare dhe urrejtje. Vetëm vetëdija e plotë për identitetin edhe të viktimave të dhunës së organizuar shtetërore dhe vepruesit e dhunës së këti-llë para syve të opinionit, i cili edhe më tutje merr si pretekst të shtiret se nuk di apo nuk e ka parë ashtu, mund t'i vetëdijësojë protagonistët dhe t'i shtyjë që t'i kthehen modeleve të bashkëpunimit kulturor dhe të vetëkuptuarit ndërmjet feve, që është hapi i parë, sa qenësor dhe aq edhe i mjaftueshëm që të shmanget konflikti ndërfaqetar planetar dhe të shpëtohet bota dhe të gjitha qytetërimet e saj.

Duke folur për qytetërimin: i pashmangshëm si një mik pafund i bezdisshëm, por më i bezdisshëm dhe aspak i padjallëzuar, libri *The Clash of Civilizations (Përplasja e qytetërimeve)* titullin e vetë oksimoron ua hodhi përkrahësve të luftës dhe nënshtrimit të të dobtëve si argument kulmor të arsyeshmërisë të ideve dhe planeve të tyre të çmendura. Sepse, *qytetërimi* sipas përkufizimit është gjendja e kultivimësisë së shoqërisë njerëzore. Sjellja e qytetëruar e ruan krejtësisht qartë këtë kontekst etimologjik, sepse madje edhe ngritja e zërit, për britma dhe gjestikulim të duarve të mos flasim, me të drejtë shpallet për *sjellje jo të qytetëruar*. Dy njerëz që rrihen në rrugë, e madje as dy boksier që grushtojnë në pajtim me dispozitat, megjithatë askush nuk do t'i shpallë protagonistë të njëfarë akti të qytetëruar. Gromësitja dhe përplasja e buzëve me zhurmë rreth tavolinës, turfullimi në façoletë apo rrëmimi i dhëmbëve pas ushqimit, gjithashtu nuk meritojnë epitetin e sjelljes së qytetëruar. E ja libri i cili, pothuajse, nga titulli shpreh bindjen se qytetërimet e mëdha janë në konflikt të përhershëm, në luftë deri në shfaqje, pra në aksion sipas të cilit tërë ato britma, tundime duarsh,

fryrje hundësh dhe rrahjesh rrugore, janë kulme subtile të etiketimit më të rafinuar në mënyrë të përsosur të harmonizuar me standardet e sjelljes së qytetëruar!? Libri, autori i të cilit, pos që *bërtet* dhe *tund duart*, nuk ofron as një të vetmen dalje për atë që i dallon nocionet e qytetërimit dhe barbarizmit. Mbi të gjitha, qëndrimet e tij të paraqitura në këtë libër drejtpërdrejt kundërshtojnë të gjitha faktet, Huntingtoni nuk është përpjekur ta fshehtë synimin e vërtetë të ndërmarrjes së tij ideologjike; si do të thuhej me zhargonin e boksierit, ka *telefonuar* kë do ta godasë dhe ku planifikon që këtë goditje ta drejtojë. Fjala është për goditjen e drejtpërdrejtë në fytyrë të Islamit, kurse synimi është që nëpërmjet kësaj t'i demonstrohet botës sa është në fakt Islami i rrezikshëm dhe sa është me mend të kemi frikë nga kjo. Thënë krejt thjesht¹⁷², libri i shpall planetit lajmin e tmerrshëm dhe të rrezikshëm, *Po, është e vërtetë! Kini frikë! Fantazma endet nëpër botë, fantazma e islamizmit!* Islami dhe kristianizmi janë në një konflikt të amshueshëm, i cili nuk pushon, e sot, kur Islami është më i rrezikshëm se kurdoherë më parë, duhet të jemi të gatshëm për *hesapet e fundit*. E kemi dëgjuar ç'flet? Tash t'i hapim sytë dhe të shikojmë! 1. Askund në planet nuk janë në luftë qoftë një shtet islam me atë kristian, përkatësisht, jo-islam; 2. Vendet më të mëdha islame siç janë Indonezia dhe Pakistani, Turqia, sikurse edhe Arabia Saudite dhe Emiratet, gjithsesi më influencueset për shkak të qyteteve të shenjta Mekës dhe Medinës, janë aleatë të vendeve kristiane, përkatësisht të SHBA; 3. Asnjë vend islam nuk ka sulmuar atë jo-islam, por dy shtete islame janë nën okupim të atyre joislame

¹⁷² Nga shkak i ekonomisë së këtij teksti, e pastaj edhe nga shkak i autor dhe libri i tij më i njohur nuk janë temë e drejtpërdrejtë e shqyrtimit tonë, analizën e hollësishme kritike të librit *The Clash of Civilization*, të Semjuel Hantigtonit, do ta paraqesë, sigurisht së shpejti, libri i ri i Dr. Ferid Muhiqit.

dhe një i tretë është shkatërruar si shtet sovran me bombardim ajror; 4. Fuqia e përgjithshme e zjarrit (krahas rezervës, që dallimet në armatim nuklear dhe raketor thjesht nuk mund të krahasohen, sepse nuk ka kuptim ky raport të paraqitet si mundësi që një anë –joislame – totalisht t’ia rrënojë anës tjetër – islame – të gjitha objektet dhe ta vrasë tërë popullsinë, të themi 3.500 herë, kurse kjo asaj, sërish të themi 0.25 % herë dhe këtë vetëm një herë!?) e të gjitha shteteve islame praktikisht është diku rreth 0:10.000; 5. Teknologjike; 6. Mediatike; 7. Ekonomike ... si do të shikohet. Të gjithë parametrat relevantë shkojnë shumëfish në llogari të botës jo-islame e në dëm të botës islame. Nëse kjo shihet seriozisht dhe me mendje të shëndoshë, është e pakuptueshme se si kjo që bota islame nuk trumbeton me të gjitha boritë e botës për rrezikshmërinë që i kanoset nga vendet jo-islame, të cilat janë njëqind fish dhe më shumë se njëqindfish më të fuqishme në çdo gjë që është kërcënuese, e kobshme, vdekjeprurëse! Madje asnjë anëtar i Këshillit të Sigurimit të OKB nuk është shtet islam, ndërsa të gjithë së bashku, me të gjithë 1.8 miliardë banorët e vet, nuk e kanë përfaqësuesin e tyre! Gjatë kësaj kohe, një shtet jo-islam me 60 milionë dhe tjetri me rreth 70 milionë banorë, janë bërë anëtarë të këtij trupi dhe kanë të drejtë vetoje! Disproporcioni katastrofik në forcat reale dhe kapacitetet e forcës politike dhe destruktive të vendeve joislame, i cili është i vetmi me peshë nga pikëpamja e dëshimit se si ato, mijëra herë më të dobëta, paraqesin kërcënimin më të madh për pjesën jo-islame të botës, e bën çdo tregim të këtillë në pikënisje qesharake. E megjithatë, ky tregim *pi ujë*, pranohet si real, me të kalkullohet në vlerësimet strategjike dhe operon në elaborime të gjendjes globale politike dhe gjeostrategjike?? Si është e mundur kjo? Njëmend si? Lexuesi ka të drejtë të godasë vetëm njëherë! E keni qëlluar! Po, pikërisht kjo

është përgjigjja për synimin e skajshëm dhe burimin e mirëfilltë të tregimit për *Clash-in / Përplasjen e Qytetërimeve!*

Një arsye shtesë e njëmendët për brengë është edhe fakti se me tezën për gjoja “antagonizmin e papajtueshëm fetar” mjaft rrezikshëm stimulohet ideja e njëfarë hakmarrjeje, e cila nuk parashkruhet kurrë dhe e cila është trans-historike! Tregimi mitologjik *Shtatë vetë kundër Teje*, në të cilin bijtë e shtatë mbretërve të vdekur janë quajtur epigonë, marrin detyra mbi vete, të cilat etërit e tyre nuk mundën t’i përfundonin, jetojnë vetëm që qyteti Teba të rrënohet. *Struktura epigonike e vetëdijes* është lehtë e dallueshme në ftesat bashkëkohore irracionale që të hakmerren Kryqëzatat, humbja në Kosovë më 1389 ... dhe që në emër të tyre, sot, me qindra vjet pas këtyre ngjarjeve, të ndërmerren fushata të reja kristiane kundër muslimanëve, të kryhen vrasje masive, të arsyetohen përndjekjet, gjenocidet dhe të gjitha llojet e diskriminimit ndaj muslimanëve.

Europa ka të gjitha parakushtet e nevojshme, rëniet në humnerën e barbarizmit dhe ngjitjet në sferat më të larta të qytetërimësisë, britmat pas viktimave të shumta të krimeve më të tmerrshme dhe odën më të lartësuar të kënaqësisë ndaj parimeve të multikulturalizmit, dhe për këtë arsye sot është për Europën shansi historik, që në tërësi ta internalizojë dhe nga zemra ta pranojë të vërtetën për identitetin e vet sa jo-islam, aq edhe islam, dhe që botës t’i dëshmojë të vërtetën për ekzistimin pa konflikte, si e vetmja mënyrë në të cilën qytetërimet e konfirmojnë esencën e vet qytetëruese. Kur këtë ta kuptojë dhe të bëhet mjaftueshëm e pjekur ta pranojë si opsionin e vetëm të dinjitetshëm për njerëzit, Europa veten do ta vërtetojë *in actu et in toto* – në vepër dhe në tërësi, si kontinent qytetërimesh pa konflikt, me respekt të ndërsjellë dhe me vetërespekt të traditave të mëdha kulturore dhe shpirtërore mbi të cilat është rritur!

Më në fund

Pesëmbëdhjetë shekuj të shtetësisë europiane islame dhe mbi 2.800 vjet të tubuara në traditën e shteteve europiane islame të Al-Andaluzisë, Osmanli Devletit, të Hanatit të Krimesë, Kazanit dhe Astrahanit. Zonja dhe zotërinj, ky është investim, depozitim dhe legat me të cilën Europa me plotë të drejtë kërkohet! Në kuadër të perceptimit autentik të identitetit europian fetar, duhen kujtuar edhe një herë disa fakte kyçe (sipas rregullit të lëshuara, të harruara, të injoruar, qëllimisht të heshtura, gjithsesi) nga të gjitha shpjegimet, të cilat insistojnë në karakterin autentik kristian të Europës dhe në karakterin jo-europian të Islamit.

1. Në raport me përcaktimin e kategorisë “popullsia autoktone europiane”: teoria e vlefshme demografike flet për prejardhjen *indo-europiane* të popullsisë së Europës. Pra gjoja autoktonë, europianët me shumicë janë me prejardhje nga Azia e mesme, India, nga rrafshnaltat iraniane që drejtpërdrejt domethënë që në fakt nuk janë autoktonë! (Për ilustrim: sa ka sot banorë autoktonë në Zvicër dhe si quhen ata, çfarë statusi shoqëror kanë ata?). Në të njëjtin kontekst, kjo do të thotë që popujt ugro-finë, bullgarët, hungarezët, gjermanët, sllavët, romët e të tjerë *nuk* janë aspak më shumë popuj autoktonë europianë, sesa janë, për shembull, turqit, sepse të gjithë ata, sikur edhe shumë popuj të tjerë “autoktonë” europianë, kanë ardhur nga e njëjta pjesë e botës?

2. Në raport me “karakterin autokton europian të kristianizmit” dhe “karakterin jo-europian (oriental) të Islamit”, thajse është qesharake të kujtohet se të tri fetë e mëdha monoteiste janë *jo-europiane sipas prejardhjes së tyre*, dhe së këndejmi, asnjëra nuk mundet pa mohimin flagrant të fakteve, ta shpallë

veten për më shumë europiane se dy të tjerat, sidomos pasi të tria kanë lindur në të njëjtën pjesë të botës dhe nga e njëjta rrënjë, plotësisht jo-europiane, pra si emanacione semite *abrahamiane-avraamiane-ibrahimiane*.

3. Në raport me praninë e kristianizmit dhe Islamit në truallin e Europës: Nuk ka arritur kristianizmi në tërë Europën para se të arrinte Islami. Pranimi i shkallë-shkallshëm i kristianizmit ka qenë aq i pabaraspeshuar, saqë pjesë të mëdha të Europës tashmë kanë pasur traditë të ekzistimit të shteteve europiane më të vogla apo më të mëdha islame (prej Emiratit në Kaukaz të themeluar në vitin 658, nëpërmjet emiratit në Kretë, Sicili dhe gadishuj të tjerë të mëdhenj të Mesdheut, deri te Al-Andaluzia, e cila, krahas tërë Iberisë, herë pas here është shtrirë edhe në pjesë të Francës, Italisë, Zvicrës), më gjatë se plotë tre shekuj, para se Skandinavia, Rusia, pjesë të Gjermanisë dhe Polonisë, Ukraina, Hungaria, kanë ardhur në kontakt me misionarët e parë kristianë dhe filluan ta pranonin kristianizmin. Islami, *in continuo* dhe këtë i riparaqitur nëpërmjet ekzistimit të shteteve europiane islame, në truallin e Europës është i pranishëm tashmë mbi 13 shekuj. Nëse tashmë qysh moti, qoftë në qarqet shkencore, qoftë në mediat masive, nuk flitet për karakterin “joautokton” të 97% të popullsisë të cilët sot jetojnë në tri Amerikat, përkatësisht në Australi, dhe “joautoktoninë” e kristianizimit, i cili atje është promovuar në feja zyrtare, para diç më shumë se tre shekujsh (në pjesën më të madhe të territorit të këtyre kontinenteve), as përmend mënyrat e depërtimit të tij të dhunshëm dhe metodat e shfarosjes sistematike dhe ndalimit të praktikimit të feve të popujve autoktonë të këtij territori të madh, atëherë është çasti i fundit që të pushohet së diskutuari për gjoja njëfarë “karakterit joeuropean të Islamit”, për më

tepër që përhapja e tij ka qenë përjashtimisht akt i zgjedhjes së lirë?¹⁷³

4. Është evidente pra, se çdo diskutim i orientuar në kontestimin e identitetit autentik multikulturor, multietnik dhe multifetar të Europës moderne, është i motivuar ideologjikisht dhe jo i bazuar faktikisht, dhe se identiteti islam i Europës është një e vërtetë e pamohueshme shkencore dhe element immanent i realitetit të saj, i cili duhet falënderuar për disa nga të arriturat më të mira dhe më fisnike të Europës moderne dhe botës! Pranimi i kësaj të vërtete njëherit shënon edhe rrugën e vetënjohjes dhe detyrimin e përgjegjësisë, dhe privilegjin e njeriut evropian sot!

¹⁷³ Edhe pse aspekti i padyshimtë historik i tolerancës së përkushtuar dhe sistematike fetare, kulturore, etnike dhe gjuhësore të shteteve islame, sidomos Perandorisë Osmane (Osmanlı Devleti) një kohë të gjatë dhe në mënyrë sistematike jo vetëm që është injoruar por drejtpërdrejt edhe mohuar, në kohën më të re janë shfaqur një numër gjithnjë e më i madh i studimeve të cilat këtë temë e trajtojnë në pajtim me faktet objektive historike. Shih, për shembull: Benjamin Braudel & Bernard Lewis, eds., *Christians and Jews in Ottoman Empire: The Funxtionig of a Plurtal Society*, New York, 1982.

INDEKSI

11 Shtator, 114, 163

A

Abdurrahmani I, 198-200, 202
 aberracioni kolektiv, 53
 Abulkasis, 279
 Adam Keleri, 67-8
 Adi Shvarc, 65
 ADN-ja shpirtërore, 12
 Afganistani, 43, 288, 440
Al-Andalusi, 189-90, 192
 Ali Pashë Gucia, 301
 AlmoHADËt, 192, 234, 241-2, 256
 almoravidët, 192, 226, 228-9, 231-2, 234, 237, 239, 241-2, 256
 amerikanë joautentikë, 15
 Andaluzia, 22, 187-90, 206, 210, 212-3, 217, 229, 240, 244, 262-6, 268-9, 272-3, 275, 277, 280-5, 287-9, 326, 445-6
 Anders Behring Breivik, 48, 105, 115, 144, 299, 440
 antiamerikanizmi, 81
 anti-islamisti, 142, 378
 anti-islamizmi ultrasionist, 61
 anti-islamizmi, 10, 19, 37, 39, 59, 61, 67, 71, 146, 294, 338
 Ariostoja, 201, 261
 Aristoteli, 254, 269
 arkitektura, 202, 242, 255, 283, 340, 374
 asimilimi, 20, 35, 37, 39, 96, 104, 115-6, 120, 123, 127-8, 130, 133-4, 138, 159-60, 178, 296, 347, 363, 366, 384
 astronomia, 268, 273-5, 286
 Austria, 343
 Avenzoar, 279
averroizmi, 270
 Ayhan Kaya, 183
 Aziatikët primordiale, 14

B

B. F. Skinnerit, 23
 Babëfi, 164
 Bakunini, 164
baptizimit, 382
 Bashir Gemajel, 70
 Bassam Tibi, 178
 Bat Ye'or, 59-60, 62-9, 71, 74-5, 78-83, 85, 88-91, 97, 99, 101, 113, 158, 181, 299, 303
 BE, 44, 46-7, 85, 91, 99, 105-7, 109, 114-6, 121-4, 126-8, 133-4, 137, 143-4, 155-6, 174, 177-8, 183, 304
 berberët, 189, 197-8, 214-6, 220, 264
 Boabdili (Muhammedi XII), 248
 bogomilët, 318, 355
 boshnjakët, 15, 36, 56, 96, 157, 160, 198, 297, 300, 303, 309, 311-2, 317-9, 321-3, 328, 330-3, 336-50, 353-7, 360-8, 378-80, 391, 394, 396, 404, 406, 417, 420, 422
 boshnjakët katolikë, 341
 boshnjakët ortodoksë, 341
 Bosnja dhe Hercegovina, 43, 106, 178, 397
 Bosnja, 36, 40, 56, 95, 106, 157, 178, 303, 311-2, 315, 318-21, 323, 325-6, 328, 330-1, 335-40, 343-50, 353-7, 359-62, 364-8, 373-5, 378-9, 396-7, 399, 404-5, 420, 431
 Bullgaria, 95, 337, 340, 344, 347, 354, 373
burka, 57, 142

C

CIA, 171
 Condolleza Rice, 181
 CSIS, 107-8, 167

Ç

Çedomil Mitrinoviqi, 406

D

Dalmacia, 358, 420
 Daniel Defoe, 271
 Daniel Pipes, 100
 David Hume, 285
 de-islamizimi, 134
deluzionet, 167
demagogjia raciste, 68
 devijimi metodologjik, 403
dhimmitude, 5, 59-60, 65, 69, 71, 73-5, 79-82, 88
diskriminimi ekonomik, 122
 dogmatikët bolshevikë, 149
 Don Melvin, 109
 Dunash ben Labrati, 272

E

Ebu Bekr Ibn Tufejli, 271
Edouard Drumont, 67
 Eduard Saidi, 271, 407
 Edward Pococke, 271
 Ekatarina Stepanova, 164
 el-Gazaliu, 269-70
 elitocidi, 380
 El-Sidi, 53, 224, 227-8, 233-4, 258-61
 emigracioni, 109, 166
 Emil Durkheimi, 94
 empirizmi gnoseologjik, 285
 EMU, 56
 Ernest Renani, 403
 Ester Pan, 109
 Eurabia, 20, 54, 56, 65-6, 68, 70, 81, 83, 87, 89-90, 99-100, 114, 144-5, 175, 302
Europa anti-semite, 83
 Europa anti-xihadike, 63
Europa e pastër, 44
 Europa jug-lindore, 415
Europën islame, 31
 Europa, 9-21, 23, 25-9, 313, 35, 40-1, 45-9, 52-61, 63, 67-70, 75, 78, 81-3,

85-7, 90-1, 93-4, 97, 100-3, 105-7, 109-10, 113-9, 121, 128, 134-42, 144-6, 149-56, 158-64, 166-75, 177-81, 183, 188, 190-9, 204, 208, 211, 221, 229, 231, 243, 245-6, 253-5, 257, 261-2, 265, 268, 273, 277-8, 280-3, 285-7, 289, 293-6, 298-303, 305, 307-11, 325-30, 333-6, 338, 342-3, 349-50, 361, 369, 371, 376, 381, 383, 396-7, 400, 409-10, 413-4, 418, 421-7, 431, 433-5, 438-9, 444-7, 459
 europeanët autentikë, 14, 16, 136
 Evropa islame, 93
 ez-Zehravi, 278-9

F

Fatimitët, 208
 feja, 16, 49, 134, 147, 250, 260, 263, 298, 363, 367, 390, 409, 427-9, 446
 feudalizmi kristian, 400
 Filip Xhenkins, 109
 filozofia islame, 270, 329
fundamentalizmi, 20, 54, 135

G

Gadameri, 312, 357
 Gadishulli Ballkanik, 293-5, 303, 310, 370, 373
 Gadishulli Iberik, 161, 190-2, 195, 198, 241, 243, 246, 250, 252, 259, 267, 280, 291, 300, 303, 305, 329
 George Berkeley, 285
 George Bush, 181
 Gerardi nga Kremona, 286
 Getoizimi, 123
 Glazovi, 46, 80-1
 Greqia, 95, 303-4, 344, 339-41, 354, 373

Gj

Gjakomo Bifi, 36

H

Hajnc Halmit, 189

halifati i emevitëve, 329

halifi Omer, 73

Hegeli, 12

hixhabi, 57

Husein Gradashçeviq, 343

I

Ibn Baxhe, 269, 275

Ibn el-Hejthem, 273

Ibn Rushdi, 269, 270, 274-5

Ibn Zuhejri, 279

idealet etike, 403

identiteti, 9-14, 16-9, 21, 23-4, 48-55, 57,
63, 73, 95, 101-3, 105, 120, 128-31,

134, 136, 149-50, 154, 159-60, 168,

172, 175-6, 184, 197, 253, 257, 260,

262-3, 272, 293-4, 297-8, 300-1, 304-12,

314, 325-9, 331, 337, 340, 347-8, 353-6,

363-4, 366-71, 383-4, 393, 395-6, 404,

409, 415-7, 419, 424-6, 429, 431, 433-4,

438, 440, 444-5, 447

identiteti european, 9, 11-2, 16-7, 32, 48,
101, 103, 149, 176, 310, 329, 369, 426,

431, 434, 445

identiteti islam i Europës, 9, 11, 19, 103,
149, 293-4

Ilija Garashanini, 373, 404, 407

Injac Lojola, 92

inkuizitorët nacionalistë, 323

integracionistët, 36

integrimi, 12, 37, 39, 104, 115-6, 19-20,
122-3, 127-30, 133-4, 138-9, 156, 159,
166, 178, 184, 381, 417-9

Iraku, 43, 98, 287, 319

islami, 9-13, 16-24, 26, 29, 32, 35, 38, 40,
48-50, 52-9, 61-6, 69-71, 74, 76, 79-80,
82-3, 88-9, 91-4, 96-9, 101-3, 106, 109,
113-4, 117, 119, 123, 126, 128-41,143-5, 147-50, 153, 155, 157-9, 162-3,
166, 173-5, 177, 179, 180, 181, 183,
185, 187-90, 192-5, 198, 199, 204, 260,
262, 264-70, 272-3, 280-1, 283-9,
293-306, 311-22, 325-31, 334-5, 338,
342-4, 349-51, 353-8, 360, 362, 366,
368, 371, 373, 375-7, 379-80, 382-92,
394-7, 400-6, 408-10, 414, 417-9, 421,
422-4, 426-31, 434-5, 442, 444-7, 459*Islami european*, 136

islamistët, 36, 62, 85, 150, 300

islamizimi i detyrueshëm, 383

islamofobia, 10, 19, 56, 115, 183

Ismail Kadare, 305-6, 308

Ivo Andriq, 403

J

James Stewart, 200

Jamie Glazov, 41

Jaroslav Hashek, 41

Jean-Paul Sartre, 270

John Lewis Burckhardt, 271

John Locke, 271, 285

Josif Brodski, 40

Jovan Cvijiqi, 406

Judah Halevi, 272

Junus Emre, 269

K

Karl Gustav Jungu, 436

Karli i Madh, 200, 203-4, 261, 433

klishetë kulturore, 36, 120, 420

Komiteti i Helsinkit, 139

Komonvelli Osman, 334, 336, 383

konflikti asimetric, 164

Kordoba, 191-2, 194-5, 198-9, 202,

205-12, 214-18, 225-6, 232, 237, 240,

243, 247-8, 253-7, 267-8, 271-5, 283-5,

287, 289

Kosova, 106, 112, 168, 178, 303, 407

- kristianët europianë, 13, 226
 Kristofer Koldvelli, 141
 kroatët, 160, 342, 346-7, 353-4, 356-7, 359, 363-4, 366, 417
 Kryqëzatat, 334, 444
 Kur'ani, 35, 73-4, 78-9, 267, 270, 313, 419, 440
Kushtetuta e Medinës, 58, 409, 418
- L
- Leiken, 161, 167-8, 179
 Leopold Fon Ranken, 339, 408
Les societe hidralique, 288
 Lev Nikolajevič Tolstoj, 35
 Libia, 25, 43, 48
Lidhja e Prizrenit, 344
 Liga Arabe, 82
 Liza Bjurvald, 144
logos, 459
 Ludovik Ariosto, 200
 lufta ruso-turke, 342
 Luis August Blankia, 164
- M
- Magarasheviqi, 404
 makina diabolike, 376, 380
 Mali i Zi, 95, 178, 337, 339-40, 344, 347, 373, 408
 manikeizmi kulturor, 149
maqedonët muslimanë, 156, 160
 Maqedonia, 95, 120-1, 140, 178, 304, 337, 339, 340, 347, 354, 373, 407, 431
 Marc Lynch, 182
 Marcel Maussi, 94
 Maria Todorova, 307
 Markgrof Hruotland, 200
 Mathew Carr, 100
 Matija Gubec, 423
mazokizmi european, 69
 megapolis, 151
- Mehmed el-Fatih II, 92
 Mehmeti II, 421
 mëkati i turqizimit, 322
 mitet nacionale, 403
 mjekësia, 268, 279, 286
 morali publik, 105
mosarabic, 283
 Moses Maimonides, 239
 Mozarabët, 263
 Mozes Maimonidesin, 273
 Muamer Gadafi, 48
 Mubaraku, 48
 Muhammaed Ali Pasha, 301
 Muhammedi a.s., 35, 74, 78-9, 99, 383
Murati II, 39
 Muslibegoviqi, 399-400
 muslimanët europianë, 13, 121
muslimanët e Ballkanit, 310, 370, 380, 407
- N
- Naçertanja*, 341, 404
 nacional-shovinizmi, 65
 Neçajevi, 164
 neobihejviorizmit, 23
 neo-fashizmi, 59, 304
 neo-nazistët, 83
 Nezim Frakulla, 301
 Niall Ferguson, 100
nikabi, 57
Nixon Centre, 180
 Njegoshi, 378, 405
- O
- Omer Hajami, 269
 Oriana Fallaçi, 82, 110
Osmanlı Devleti, 310, 317, 345, 370, 409, 411-2, 416, 427, 431

P

Pamela Geler, 41, 46, 66, 299, 302
 paroksizmi, 403
 Paul Bermiani, 182
 Pax Europa, 55
Pax Ottomanica, 55, 396, 420, 422
 Perandoria Romake, 188, 329, 434
 Pisarevi, 164
 plani Euro-Mes, 46
 Platoni, 254
 politika imigruese, 105
 popujt indigjenë, 77
 Portugalia, 180, 188, 190, 192, 225, 236,
 239, 241-6, 252, 264, 283, 401, 418
Ptolemeu, 274

R

Rabbi Maimonidesi, 241
 Rabbi Moses Ben Maimoni, 239
 Radovan Karaxhiqi, 56
 raja kristiane, 398
 Rajnhart Dozi, 188
 Ratko Mlladiqi, 56
 Rekonkuista, 192, 234, 244, 249, 256
 rendi i ri botëror, 132
 Rodrigo Díaz de Vivarit, 227
 Rolando, 200
 Rumania, 95, 420
 Rusia, 101, 106, 109, 164, 326, 328, 334,
 336, 343-4, 446

S

Said el-Endelusi, 280
 Sanxhaku, 95, 339, 340, 344, 354
segregacioni kulturor, 122
 serbët, 40, 96, 156-7, 159, 168, 332, 339,
 341-3, 345-7, 353-4, 356-7, 359-60,
 362-4, 366, 373, 378-9, 398, 404,
 406-8, 417
 serbët e islamizuar, 404, 406-7

Serbia, 178, 198, 337-8, 340, 343, 345,
 354, 358-9, 363-4, 368, 373, 375,
 377, 406-7
 SIOE, 46-7
 sionizmi ekstrem, 59
 Srebrenica, 56, 303, 380, 405-6
 Stalini, 150
standardet e Bolonjës, 151
 Stefen Runcimani, 39, 49
 Sulejman Demireli, 413
 supremacioni europerëndimor, 23

Sh

Shahoviqi, 339, 379, 408
 Shekspiri, 45
 shovinizmi europian, 146
 Shqipëria, 95, 106, 178, 300-4, 308,
 339-40, 344, 347, 373, 420

T

Tarik ibn Zijadi, 194
terroristi kristian, 440
 terrorizmi, 54, 105, 114, 158, 162-3, 166,
 175, 177, 179
 Tim Winter, 156
 Tomas Glik, 263
 torbeshët, 156, 160, 321, 344, 354, 378,
 407, 417, 420
 totalitarizmin kulturor, 253
turkizimi, 385
 Turqia, 106-8, 145, 162, 303, 310, 336,
 369, 373, 411-3, 415, 426-7, 430-1, 442

U

Umberto Eko, 44
 UNESCO, 257

V

Vaisse, 152-3, 155, 177
 Valve, 189

Vandaluzia, 188
Virxhinia Vulf, 55

W
W. Churchill, 35

Xh
Xhelaluddin Rumi, 269
Xheronimi, 16
xihadistët, 81, 83, 85, 127, 136, 150, 180-1

Xhingis Hani, 95

Y
Y. Masriya, 63

Z
Zeyno Baran, 183
Zhak Shiraku, 82
Zhizel Litmani, 63
Zija Gokalpi, 430

Shënimi i katalogut CIP të këtij libri ndodhet në
Bibliotekën Kombëtare Universitare "Shën Kliment Ohridski", Shkup

MUHIĆ, Ferid

Identiteti islam i Europës / Ferid Muhić ; [përktheu nga
boshnjakishtja Nexhat Ibrahimij]. - Shkup : Logos-A, 2013. -
456 faqe; 21 cm. - (Biblioteka Lexo)

Përkthim i veprës: Islamski identitet Evrope / Ferid Muhić. -
Fusnotat drejt tekstit

ISBN 978-9989-58-492-3


I. Muhić, Ferid shih Muhić, Ferid

a) Islam - Evropa

COBISS.MK-ID 94293002

www.logos-a.com

Copyright©Logos-A, 2013



LOGOS·A